

INSTITUTI I STUDIMEVE MARKSISTE-LENINISTE
PRANË KQ TË PPSH

DOKUMENTA KRYESORE
TË PARTISË
SI PUNËS TË SHQIPËRISË

BIBLIOTEKA
E
SHKOLLFS SE PARTISE

TIRANË, 1970

PROLETARË TË TË GJITHA VENDEVE, BASHKOHUNI!

DOKUMENTA KRYESORE

TE PARTISE

SHQIPTARE



DOKUMENTA KRYESORE TË PPSH

VËLLIMI IV

1961-1965

Faint, mostly illegible text in Albanian script, likely bleed-through from the reverse side of the page. Some words like 'për', 'në', 'me' are visible.

PARATHËNJE

Vëllimi IV i dokumentave kryesore të PPSH botohet në vazhdim të tri vëllimeve të para të botuara më 1960, 1961 dhe 1970.

Në këtë vëllim përfshihen dokumenta të periudhës qershor-1961 — dhjetor 1965. Disa nga dokumentat e këtij vëllimi botohen për herë të parë.

Në dokumentat e kësaj periudhe pasqyrohet lufta për zbatimin e detyrave të Kongresit IV të PPSH lidhur me etapën e re historike në të cilën hyri vendi ynë, etapën e ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste, në kushtet e bllokadës së egër imperialisto-revizioniste.

Në to del në pah lufta e PPSH dhe e popullit shqiptar për kapërcimin e vështirësive dhe pengesave të jashtëzakonshme, që lindën nga shkelja e marrëveshjeve ekonomike dhe kulturale nga ana e qeverisë sovjetike, nga presionet politike, ideologjike dhe ekonomike të revizionistëve hrushovianë mbi Partinë dhe popullin tonë.

Në këtë periudhë, më shumë se në çdo periudhë tjetër të mëparshme, mori një zhvillim të gjerë e të thellë zbatimi i parimit marksist-leninist të mbështetjes në forcat e veta në ndërtimin socialist të vendit.

Dokumentat e kësaj periudhe tregojnë për përpjekjet dhe mobilizimin e përgjithshëm të popullit nën udhëheqjen e Partisë për plotësimin e planit të tretë pesëvjeçar, për zbatimin e detyrave të mëdha të rritjes së forcave prodhuese, të industrializimit të mëtejshëm të vendit, të zhvillimit të bujqësisë nëpërmjet intensifikimit të saj, në rrugën e ndërtimit të plotë të bazës materialo-teknike të socializmit. Një mobilizim i tillë i paparë bëri që të dështonin synimet e revizionistëve hrushovianë për të mposhtur udhëheqjen e Partisë së Punës dhe Qeverinë e Republikës Popullore të Shqipërisë, për të gjuhëzuar komunistët dhe popullin shqiptar. Revizionistët nuk lanë mjet e mënyrë pa përdorur që t'i kthenin komunistët dhe popullin shqiptar nga rruga e drejtë revolucionare në rru-

gën e tyre regresive, antimarksiste, antileniniste. Dokumentat dëshmojnë për qëndresën e pamposhtur të Partisë së Punës të Shqipërisë kundërsht përprjekjeve, presioneve, shantazheve, komplotëve të udhëheqjes sovjetike dhe të revizionistëve të tjerë.

Për kapërcimin e vështirësive, që u krijuan nga veprimtaria armiqësore e revizionistëve sovjetikë, një rol të rëndësishëm luajti ndihma dhe përkrahja, që i dhanë Partisë së Punës të Shqipërisë dhe popullit shqiptar Partia Komuniste dhe Qeveria e Republikës Popullore të Kinës.

Dokumentat e këtij vëllimi vënë në dukje njëkohësisht luftën parimore, që ka zhvilluar PPSH në mbrojtje të marksizëm-leninizmit kundër revizionizmit modern, si politikë dhe ideologji borgjeze, antikomuniste. Letrat drejtuar KQ të PK të BS, deklaratat dhe materialet e tjera të PPSH nxjerrin në shesh kalbësinë e kursit revizionist të Kongresit XX dhe XXII të PK të BS, thelbin reaksionar të këtij kursi, degjenerimin kapitalist të rendit socialist në Bashkimin Sovjetik, asgjësimin nga revizionistët të fitoreve të mëdha të Revolucionit të Tetorit dhe të vijës luftarake marksiste-leniniste që pati ndjekur Partia Bolshevike me V.I. Leninin dhe më pas me J.V. Stalinin në krye.

Duke demaskuar thelbin borgjez reaksionar të revizionizmit hrushovian, PPSH e cilësoi luftën kundër tij dhe kundër revizionizmit në përgjithësi një detyrë historikisht të domosdoshme si në shkallë kombëtare ashtu dhe ndërkombëtare. Në kushtet kur revizionistët hrushovianë kishin filluar një luftë frontale kundër marksizëm-leninizmit, kundër Partisë Komuniste të Kinës, Partisë së Punës të Shqipërisë dhe kundër partive të tjera marksiste-leniniste revolucionare, pasi e kishin përçarë kështu lëvizjen komuniste ndërkombëtare dhe kampin socialist, PPSH ngrinte çështjen e drejtë të ndarjes përfundimisht të kufive me revizionistët në të gjitha fushat.

Dokumentat e këtij vëllimi kanë edhe një vlerë tjetër të madhe: në to është përpunuar dhe pasuruar më tej vija politike e PPSH për etapën e re të ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste në bazë të përvojës revolucionare të grumbulluar nga praktika e ndërtimit socialist gjatë periudhës pas Kongresit IV të PPSH, duke sjellë në këtë mënyrë edhe një pasurim në teorinë e praktikën e ndërtimit të shoqërisë socialiste në përgjithësi.

Duke përpunuar më tej dhe pasuruar vijën e vet politike për periudhën e ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste, PPSH nxori mësimet të rëndësishme nga përvoja e hidhur e lindjes së revizionizmit në PK të BS dhe e kthimit prapa të shtetit të parë socialist në rrugën e rivendosjes së kapitalizmit. Këto mësimet e ndihmuan atë të merrte një varg masash të rëndësishme, për t'i mbyllur rrugën degjenerimit revizionist të vetes së saj dhe të rendit socialist në

Shqipëri. Për të tilla masa flasin dokumentat e këtij vëllimi mbi forcimin e mëtejshëm të Partisë, mbi edukimin komunist të punonjësve, mbi luftën kundër burokratizmit dhe për një stil revolucionar në punë.

Në periudhën e mëpastajme të tilla masa marrin një zgjerim dhe thellim të mëtejshëm, masa që i japin një shtytje të vrullshme revolucionarizimit të mëtejshëm të Partisë dhe të gjithë jetës së vendit.

INSTITUTI I STUDIMEVE MARKSISTE-LENINISTE PRANË KQ TË PPSH

PLENUMI II I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Tiranë, 30 qershor — 1 korrik 1961

KOMUNIKATË

E PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Më 30 qershor dhe 1 korrik 1961 u mbledh Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH, nën kryesinë e Sekretarit të Parë, shokut Enver Hoxha.

Plenumi dëgjoi raportin e Byrosë Politike «Mbi masat që duhen marrë për forcimin e mëtejshëm të regjimit të kursimit», të mbajtur nga sekretari i Komitetit Qendror të PPSH, shoku Haki Toska dhe aprovoi vendimin përkatës.

Shoku Enver Hoxha foli në plenum mbi gjendjen ndërkombëtare dhe luftën e Partisë për mbrojtjen e paqes dhe forcimin e unitetit të kampit socialist. Plenumi aprovoi plotësisht politikën e ndjekur nga Partia për këto çështje.

Në plenum, përveç anëtarëve dhe kandidatëve të Komitetit Qendror, muarën pjesë edhe sekretarët e parë të komiteteve të Partisë dhe disa kryetarë komitetesh ekzekutive të rretheve, drejtorë ndërmarrjesh ekonomike dhe punonjës të aparateve qendrore shtetërore dhe të Partisë.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

V E N D I M

I PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË «MBI MASAT QË DUHEN MARRË PËR FORCIMIN E MËTEJSHËM TË REGJIMIT TË KURSIMIT»

1 korrik 1961

Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, i mbledhur më 30 qershor dhe 1 korrik 1961, nën kryesinë e Sekretarit të Parë të Komitetit Qendror, shokut Enver Hoxha, dë-

gjoji dhe shqyrtoi raportin e Byrosë Politike të mbajtur nga sekretari i Komitetit Qendror, shoku Haki Toska, «Mbi masat që duhen marrë për forcimin e mëtejshëm të regjimit të kursimit».

Kongresi IV i PPSH hapi perspektiva madhështore për zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë dhe të kulturës popullore. Ai shënoi kalimin e vendit tonë në një etapë të re, në etapën e ndërimit të plotë të socializmit. Vënja në jetë e këtyre detyrave të mëdha kërkon ngritjen në një nivel më të lartë të punës së organizatave të Partisë, të organeve shtetërore dhe të ekonomisë për perfeksionimin e mëtejshëm të drejtimit të ekonomisë popullore, për mobilizimin e gjithanshëm të popullit tonë punëtor dhe patriot, për forcimin e punës edukativo-politike me punonjësit, për rritjen e aftësive dhe të iniciativës krijuese të kadrove dhe të gjithë punonjësve, me qëllim që të gjitha burimet tona të brendshme të vihen në shërbim të zhvillimit të pandërprerë të ekonomisë dhe të kulturës.

Në trajtimin dhe në forcimin e mëtejshëm të regjimit të kursimit, Komiteti Qendror i PPSH mbështetet në mësimet e marksizëm-leninizmit mbi riprodhimin e zgjeruar socialist. . . në tezën se mënyra socialiste e prodhimit dhe e shpërndarjes është mënyra më kursimtare e drejtimit të prodhimit që ka njohur njerëzimi, se pakësimi i vazhdueshëm i shpenzimeve të prodhimit shoqëror është ligj ekonomik i socializmit.

Regjimi i kursimit është metodë drejtimi në ekonominë socialiste, ai shtrihet në ndërmarrjet dhe në organizatat ekonomike, në institucionet, në organizatat shoqërore, në aparatet shtetëror dhe kudo ku krijohen dhe shpenzohen të mirat materiale. Në gjirin e ekonomisë socialiste krijohen rezerva të pashtershme, të cilat duhet të mobilizohen për rritjen e pareshtur të prodhimit. Forcimi i regjimit të kursimit ka për qëllim t'i mobilizojë këto rezerva, që në prodhimin e të mirave materiale të arrihen rezultate sa më të mëdha me shpenzime sa më të vogla të punës, të mjeteve materiale dhe monetare. Kështu do të sigurohen burime të reja për zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë e të kulturës dhe për ngritjen e mëtejshme të mirëqenjes së popullit.

Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH vërejti se, në saje të orientimit dhe të kujdesit të vazhdueshëm të Partisë dhe të punës vetëmohuese të punonjësve tanë, janë arritur rezultate të kënaqshme në rritjen e akumulimeve të brendshme, në edukimin e punonjësve për të zbatuar regjimin e kursimit në gjithë veprimtarinë shtetërore dhe shoqërore të vendit tonë, për të ruajtur dhe administruar me kujdes të madh pronën socialiste. Hozrashoti është futur më thellë në ekonominë tonë popullore dhe është bërë metodë e drejtimit të ndërmarrjeve dhe organizatave ekonomike, të cilat, në shumicën e tyre janë rentabël dhe i sigurojnë nga viti në vit buxhetit të shtetit akumulimin e nevojshëm për të financuar zhvilli-

min e mëtejshëm të ekonomisë dhe të kulturës. Vitin e kaluar 62 ndërmarrje dhe organizata ekonomike dhanë mbi planin 538 milion lekë fitime, duke siguruar burime suplementare për financimin e ekonomisë popullore.

Puna për studimin e leverdishmërisë së objekteve është përmirësuar, kuadrot tanë inxhiniero-teknikë kanë rritur iniciativën në hartimin e projekteve dhe preventivave, i kanë bërë ato më të thjeshta e më pak të kushtueshme, është organizuar më mirë puna e ndërmarrjeve zbatuese të ndërimit. Të gjitha këto kanë bërë që fondet e investimeve për ndërtime të përdoren më racionalisht.

Një kujdes më i madh është treguar për rritjen e të ardhurave nga eksporti, nga transporti ynë detar, nga turizmi dhe është vendosur një regjim më i fortë kursimi në importimet, në shpenzimet jotregëtare etj.

Këto rezultate dëshmojnë për forcimin e drejtimit të ekonomisë, për organizimin më të mirë të kontrollit dhe për forcimin e disiplinës financiare. Ato tregojnë se organizatat e Partisë dhe organizatat e masave po merren më shumë me çështjet ekonomiko-financiare dhe punojnë për ta bërë regjimin e kursimit, sikurse porositi Kongresi IV i PPSH, një natyrë të dytë të punonjësve tanë. Në zbulimin dhe mobilizimin e rezervave të brendshme, një kontribut të çmueshëm kanë dhënë inxhinierët, teknikët, punonjësit e planifikimit dhe të financës, të cilët, të ndërgjegjshëm për detyrat që u ka besuar Partia, pa u lëkundur përpara asnjë vështirësie, përkrah gjithë punonjësve të tjerë, po vënë në jetë programin madhështor të saj.

Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH, krahas me rezultatet e arritura, vërejti se në zbatimin e regjimit të kursimit kanë vend akoma të meta e dobësi. Do të ishte gabim që të lihen në heshtje këto të meta e dobësi, përkundrazi, ne duhet të marrim masa për mënjanimin e tyre dhe kjo duhet të jetë një detyrë e dorës së parë për të gjitha organizatat e Partisë, për organizatat e masave, për organet shtetërore dhe të ekonomisë.

Krahas ndërmarrjeve dhe organizatave ekonomike që punojnë me rentabilitet, ka edhe nga ato që paraqiten dobët me përmbushjen e planit të fitimeve, ose punojnë me humbje të paparashikueshme, duke mos plotësuar kështu detyrat ndaj ekonomisë popullore. Kjo çështje duhet të shqetësojë veçanërisht ndërmarrjet e peshkimit, ato të tullave, disa ndërmarrje të bujqësisë dhe disa kooperative të konsumit.

Mungesa e studimeve të plota për disa vepra ka lejuar që të bëhen gabime në parashikimin e kapaciteteve prodhuese dhe në përcaktimin e vëllimit të punimeve dhe të fondeve. Kështu është dashur që të dhënat e projektimit të ndreqen, të shtohen fondet dhe të zgjatet koha e vënjes së tyre në shfrytëzim. Në zbatimin e ndërtimeve, në disa raste janë tejkuluar fondet e caktuara, pasi

nuk janë respektuar normativat e materialeve dhe është përdorur pa kriter fuqia punëtoare.

Mundësitë e krijuara nga zhvillimi i industrisë për shkurtimin e importimeve dhe shtimin e eksportimeve janë shfrytëzuar në mënyrë të pamjaftueshme. Akoma kanë vend kërkesa të fryra për importime dhe bëhen pak përpjekje për zëvendësimin e artikujve të importit me prodhime të vendit. Maqineritë ekzistuese nuk shfrytëzohen plotësisht me tërë kapacitetin e tyre dhe ka raste që ato lihen pa u vënë në përdorim.

Mund të punohet më tepër për shtimin e valutës nga rritja e sasive të mallrave të eksportit, nga eksportimi i artikujve industrialë dhe gjysmindustrialë, nga shtimi i artikujve të rinj, nga përmirësimi i cilësisë dhe i ambalazhimit të prodhimeve të eksportit, nga shkurtimi i shpenzimeve jotregëtare etj.

Të metat që vërtetohen në zbatimin e regjimit të kursimit e kanë burimin, në radhë të parë, në punën e pamjaftueshme për drejtimin me llogari dhe përgjegjësi të ekonomisë, në mungesën e studimeve të plota, në organizimin e dobët të kontrollit dhe të disiplinës financiare. Organizatat e Partisë duhet të hynin më thellë në çështjet ekonomiko-financiare të ndërmarrjeve, për ngritjen në një shkallë më të lartë të regjimit të kursimit dhe të luftonin më tepër për të rritur aftësitë e njerëzve në punë, për mënjanimin e shfaqjeve të huaja që prishin ndërgjegjen e punonjësve dhe dëmtojnë në një mënyrë apo në një tjetër pronën socialiste (shtetërore dhe kooperativiste).

Konsultimi popullor, që u organizua me porosi të Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH, për forcimin e mëtejshëm të regjimit të kursimit, tregoi edhe një herë rëndësinë e madhe të kësaj çështjeje për vendin tonë. Në këtë fushë të gjerë organizatat e Partisë mobilizuan forcat krijuese të masave punonjëse, bënë me to një punë të gjallë edukative sqaruese, si dhe propozuan masa konkrete për kurse. Si rrjedhim i kësaj pune kolektive u bë e mundur që, për vitin në vazhdim, t'i kursehen ekonomisë mbi 1 miliard e 700 milion lekë nga ulja e kostos, shkurtimi i investimeve jo të domosdoshme ose të parakohshme, zëvendësimi i artikujve të importit me prodhime të vendit etj. Nga konsultimi popullor për çështjet e kursimit dolën këto mësimë:

1. — Pjekuria politike dhe patriotizmi i popullit tonë është ngritur në një shkallë më të lartë, e cila u përgjigjet detyrave që lindin nga etapa historike që po kalojmë, se qëndrimi i drejtë, marksist-leninist i Partisë sonë në vlerësimin e çështjeve më të rëndësishme ndërkombëtare e në mënyrë të veçantë uniteti i përbashkët që u manifestua në Kongresin IV të Partisë, patën një jehonë të gjallë në të gjithë Partinë dhe popullin tonë. *Këtu e ka burimin gatishmëria e madhe që treguan komunistët dhe gjithë*

punonjësit për të vënë në jetë porosinë e Partisë për zbulimin dhe mobilizimin e rezervave të brendshme.

2. — Fakti që kursimet e mëdha të planifikuara, të cilat pri-tej të realizoheshin për vitin 1961, u arritën kryesisht nëpërmjet rishqyrtimit të planeve, tregoi se ato ishin hartuar pa kujdesin e duhur, me rezerva dhe sipas tendencës së njohur «për të qenë brenda», të meta këto që Partia i ka kritikuar edhe herë të tjera.

3. — Çështjet ekonomiko-financiare, të cilat kanë të bëjnë me mbarëvajtjen e ndërmarrjeve dhe të organizatave ekonomike, nuk trajtohen akoma me kujdesin e duhur. Ato nuk shqyrtohen në mënyrë sistematike, por në disa raste bëhen objekt analize vetëm atëhere kur ndërmarrjet ndodhen para vështirësish të mëdha dhe kërkojnë rrugëdalje.

Organizatat e Partisë, organizatat e masave, organet shtetërore dhe të ekonomisë duhet të nxjerrin mësimet e nevojshme nga konsultimi popullor për çështjet e kursimit, të organizojnë zbatimin e propozimeve të shumta që bënë punonjësit dhe, si gjithnjë të mbështetura në masat e popullit, të vazhdojnë punën për zbulimin dhe mobilizimin e mëtejshëm të rezervave të brendshme. Detyra e organizatave të Partisë është që çështja e kurseve të mos mbetet si një flakë kashte, por të bëhet metodë e përhershme e punës së tyre për drejtimin e ekonomisë. Është e domosdoshme që organet përkatëse në qendër e në bazë të nxjerrin mësimë që në të ardhshmen të përmirësojnë punën e planifikimit, në mënyrë që të merren me çështjen e kursimit që kur bëhen planet.

Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH theksoi se nevoja e rritjes së përpjekjeve për të kursyer nuk diktohet as nga dobësitë e sistemit tonë socialist të ekonomisë, as nga mungesa e fondeve për të siguruar financimin e zhvillimit të ekonomisë popullore në planin e tretë pesëvjeçar. Sot ekonomia jonë është më e fortë se kurrë ndonjëherë tjetër. Bazat materiale dhe financiare për realizimin e detyrave të pesëvjeçarit të tretë janë më reale, më të sigurta dhe më të qëndrueshme. Ato mbështeten në udhëheqjen e drejtë të Partisë sonë, në forcat e popullit dhe në aftësitë e tija krijuese, në burimet tona të brendshme dhe në ndihmën e vendeve të kampit socialist. Por, fakti që krahas rritjes së vazhdueshme të ekonomisë, rriten edhe rezervat tona të brendshme, si dhe etapa e re në të cilën është futur vendi ynë, krijon mundësi më të mëdha objektive dhe kërkon që të merren masa më efektive për të kursyer, për ta rritur akumulimin e brendshëm socialist, për të realizuar para afatit detyrat e pesëvjeçarit të tretë. Kjo bëhet e nevojshme për këto arsye:

Së pari, me ndërtimin e bazës ekonomike të socializmit, prona socialiste (shtetërore dhe kooperativiste) është bërë tani forma mbizotëruese e pronësisë. Si rrjedhim, u zgjerua sfera e veprimt

të regjimit të kursimit. Regjimi i kursimit shtrihet tani pothuajse në të gjithë ekonominë popullore. Në këtë mënyrë janë krijuar mundësi reale dhe është bërë e domosdoshme që rezervat e shumta të brendshme, që ekzistojnë dhe që krijohen pa ndërprerje në gjirin e ekonomisë, të mobilizohen tërësisht dhe të shndërrohen në burime suplementare për zhvillimin e ekonomisë e të kulturës.

Së dyti, me ndërtimin e bazës ekonomike të socializmit, ne bëme një hap të rëndësishëm në transformimin socialist të vendit tonë. Por na mbetet shumë për të bërë për ngritjen e mëtejshme të ndërgjegjes socialiste të punonjësve, për forcimin e disiplinës në punë, të ndjenjës së kursimit, për mënjanimin e mbeturinave mikroborgjeze, për një kuptim më të thellë të gërshetimit të drejtë të interesave individuale me ato të shoqërisë.

Së treti, vënja në jetë e masave për forcimin e mëtejshëm të regjimit të kursimit nuk mund të arrihet po qe se organizatat e Partisë do të kufizohen vetëm me ngritjen e ndërgjegjes së komunistëve e të punonjësve të tjerë pa parti dhe do të lënë mënjanimin e nivelit të tyre tekniko-profesional. Gërshetimi dhe zbatimimi më i mirë i këtyre dy vetive përbën fizionominë e drejtuesit të ekonomisë, për të cilin kanë nevojë Partia, shteti dhe populli ynë.

Së katërti, rrethimi gjeografik i vendit tonë nga shtetet kapitaliste krijon për ndërtimin tonë socialist vështirësi të njohura, që ne i kemi kapërcyer dhe do t'i kapërcejmë me sukses. Në këto kushte, duke mobilizuar më mirë e më shumë forcat tona, të punojmë dhe të vigjilojmë sipas parullës luftarake dhe thellësisht revolucionare për kushtet konkrete të vendit tonë: «Të mbajmë në njërin dorë kazmën dhe në tjetrën pushkën».

Druga që ka ndjekur Partia jonë ka qenë dhe mbetet gjithnjë e drejtë. Prandaj, cilatdo qofshin vështirësitë, ne jemi të vendosur t'i kapërcejmë me sukses. Ne jemi të sigurtë se, nën udhëheqjen e Partisë me themeluesin dhe organizatorin e saj në krye, shokun Enver Hoxha, populli ynë do të ecë kurdoherë përpara.

Rritja e përdërprerë e ekonomisë popullore, e kuadrove drejtues, e atyre inxhinierë-technikë dhe e punonjësve në përgjithësi bën të mundur që rezervat e mëdha për kursime të shndërrohen në realitet. Detyra e Partisë, si forca drejtuese e vendit tonë, ka qenë dhe mbetet gjithmonë që, me punën e saj të madhe edukuese, me masat e ndryshme që merr, të rrënjosë në ndërgjegjen e çdo punonjësi dhëmshurinë për pasurinë e popullit, papajtueshmërinë me shpenzimet e pavend.

Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH, duke pasur parasysh të metat në zbatimin e regjimit të kursimit dhe duke u mbështetur në aftësitë dhe në gatishmërinë e organizatave të Partisë, të kuadrove dhe të popullit tonë, me qëllim që rezervat e brendshme dhe

mundësitë e mëdha që krijon sistemi ynë socialist për kursime të përdoren drejt dhe që direktivat e Kongresit IV të PPSH të gjejnë zbatim të plotë,

Vendosi:

I

Për forcimin e hozrashotit dhe rritjen e rentabilitetit të ndërmarrjeve dhe organizatave ekonomike

1. — Të merren masa për forcimin e mëtejshëm të hozrashotit në ekonominë popullore, si metodë kryesore për drejtimin e ndërmarrjeve dhe organizatave ekonomike dhe si levë e rëndësishme për plotësimin dhe tejkalimin e planit ekonomik të shtetit. Organizatat e Partisë, organet shtetërore dhe ato ekonomike ta përqëndrojnë më tepër vëmendjen dhe të ngrenë në një shkallë më të lartë nivelin e punës për zbatimin e parimeve kryesore të hozrashotit në ndërmarrjet dhe në organizatat e tjera ekonomike.

Ministria e Minierave dhe e Gjeologjisë, Ministria e Industrisë, e Ndërtimit, e Bujqësisë, e Komunikacionit, e Tregëtisë, e Financës. Komisioni i Planit dhe organet e tjera shtetërore, komitetet ekzekutive të këshillave popullore të rretheve, komitetet dhe organizatat e Partisë, ta konsiderojnë forcimin e mëtejshëm të hozrashotit dhe rritjen e rentabilitetit të ndërmarrjeve dhe të organizatave ekonomike, si një nga detyrat e tyre kryesore për forcimin e gjithanshëm të regjimit të kursimit. Për këtë:

a) Të merren masa të shpejta për të mënjeluar humbjet, në mënyrë që në një periudhë sa më të shkurtër të mos ketë ndërmarrje që të dalë me humbje të paparashikuara, të shkohet drejt mënjanimin të tyre edhe për repartet brenda ndërmarrjeve. Në këtë drejtim ne duhet të udhëhiqemi nga porosia e V.I. Leninit, se

«trustet dhe ndërmarrjet në hozrashot bazohen pikërisht në faktin se ato vetë duhet të përgjigjen nga çdo pikëpamje për punën me humbje»¹.

Kjo çështje duhet të mbahet parasysh nga drejtuesit e ndërmarrjeve dhe organizatave ekonomike, nga organizatat e Partisë, të preokupojë thellë komitetet ekzekutive të këshillave popullore, byrotë e komiteteve të Partisë të rretheve dhe kolegjumet e organeve qendrore. Dalja e ndërmarrjeve ose reparteve me humbje të paparashikuara duhet të vlerësohet nga të gjithë punonjësit

¹ V. I. Lenin, Veprat, vëll. 54, f. 150, bot. V rus.

si një shfaqje e huaj për të marrë nga shoqëria më shumë nga sa i jepet asaj, si një shfaqje për të jetuar në kurriz të të tjerëve. Ras-tet e tilla të shqyrtohen në mbledhje të veçanta të Partisë dhe të organizatave të masave, për të vënë përpara përgjegjësisë personat që, me veprimtarinë e tyre, kanë penguar mbarëvajtjen e punës dhe të merren masa për të mbuluar humbjet.

b) Ngarkohet Këshilli i Ministrave të RPSH që brenda këtij viti të studjojë format për nxjerrjen në perspektivë nga prapambetja të ndërmarrjeve dhe të organizatave ekonomike që planifi-kohen me humbje, si ndërmarrjet e peshkimit, të materialeve të ndërtimit e në NBSH-të dhe NSHG-të prodhimin e mishit.

c) Të punohet pareshtur për uljen e kostos së prodhimeve dhe të shërbimeve, si dhe të shpenzimeve të qarkullimit, për të rritur rentabilitetin e ndërmarrjeve dhe të organizatave ekonomike. Rea-lizimi i fitimeve të planifikuara është një nga treguesit kryesorë të planit ekonomik dhe, si i tillë, duhet të mbahet vazhdimisht para-sysh nga organet shtetërore e të ekonomisë dhe nga organizatat e Partisë. Mosrealizimi i fitimeve të parashikuara të konsiderohet si një shkelje e rëndë e disiplinës së planit dhe asaj financiare.

ç) Të merren masa për forcimin e hozrashotit të brendshëm dhe t'u vihet fre shfaqjeve për të krijuar në hozrashot sektorë pa kriter. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda tremujorit të parë të vitit 1962, të studjojë shtrirjen e hozrashotit të brendshëm dhe gjendjen e sektorëve e të reparteve ndihmëse të ndërmarrjeve e të organizatave ekonomike dhe të marrë masat e duhura për të mënjeluar paralelizmat, për të shfrytëzuar plotësisht kapacitetet prodhuese, duke parë edhe mundësinë e përqëndrimit të tyre.

2. — Të gjitha organet shtetërore dhe të ekonomisë, organiza-tat e Partisë dhe ato të masave, të përmirësojnë punën për përdorimin racional të lëndëve të para, të materialeve ndihmëse dhe të lëndëve djegëse, të cilat janë burime të rëndësishme për uljen e kostos të prodhimeve dhe të shërbimeve. Për këtë:

a) Organizatat e Partisë dhe ato të masave përdorimin racio-nal, me kursim, të lëndëve të para, të materialeve ndihmëse dhe të lëndëve djegëse ta konsiderojnë si një çështje të madhe partie, në të cilën të aktivizohen gjerësisht inxhinierët, teknikët, ekonomis-tët, racionalizatorët dhe të gjithë punonjësit e tjerë. Të përkrahen dhe të përhapen në mënyrë të organizuar iniciativat e përparuara dhe të kthehen në lëvizje masive të të gjithë punonjësve.

b) Komisioni i Planit të Shtetit, në bashkëpunim me ministritë dhe Universitetin shtetëror të Tiranës, të studjojë brenda vitit 1961 masat për përmirësimin e planifikimit, normimit dhe furni-zimit të materialeve. Krahas me këtë, të hartohet plani konkret i shtrirjes së normave teknike të konsumit të materialeve, me qëllim që, brenda pesëvjeçarit të tretë, duke filluar qysh nga ky vit, të vendosen normat teknike në një pjesë të mirë të lëndëve të para

dhe të materialeve ndihmëse. Ministritë dhe Komisioni i Planit të Shtetit të rishqyrtojnë normat e konsumit të karburanteve për të gjithë sektorët e ekonomisë popullore. Gjithashtu është e nevojsh-me të rishqyrtohen disa nga standardet kryesore të prodhimeve në të cilat lëndët e para konsumohen më shumë. Të vendoset një re-gjim i rreptë kursimi në konsumin e energjisë elektrike për nevojat e prodhimit dhe të shërbimeve.


c) Të zbatohen me rreptësi proceset teknologjike të prodhimit dhe materialet e shtrenjta të zëvendësohen me më të lira. Të orga-nizohet më mirë puna për të mënjeluar skarcitetet dhe firot, nga të cilat dëmtohet ekonomia popullore dhe të punohet që edhe mbe-turinat e fundit të kthehen në vlera materiale. Brenda vitit minist-ritë dhe Komisioni i Planit të Shtetit të studjojnë dhe t'i raportoj-në Këshillit të Ministrave të RPSH masat konkrete që duhet të mer-ren për t'i mënjeluar mbeturinat dhe për t'i shfrytëzuar ato më mirë.

ç) Të bëhet rregull që pjesët e reja të këmbimit të jepen ve-tëm pasi të kthehen të vjetrat, të cilat të meremetohen, ose të shkrihen si metal. Ky rregull të shtrihet në radhë të parë në ofiçinat mekanike të industrisë, të minierave, të ndërtimit, të bujqë-sisë e të transportit dhe gradualisht në sektorët e tjerë të ekono-misë popullore. Të punohet sipas parullës: «Asgjë e re të mos jepet pa kthyer të vjetrën».

3. — Rritja e rendimentit të punës të vlerësohet nga të gjitha organet shtetërore e të ekonomisë, nga organizatat e Partisë e të masave si faktori vendimtar për uljen e mëtejshme të kostos së prodhimeve dhe shërbimeve. Për këtë:

a) Të shfrytëzohen më mirë mundësitë e mëdha që ekzistojnë për të rritur më tej rendimentin e punës. Organizatat e Partisë dhe ato të masave të preokupohen më shumë për zbulimin dhe mobi-lizimin e rezervave të brendshme, që rritin rendimentin e punës, duke e bërë këtë çështje të përditshme të kolektivave punonjës.

b) Të merren të gjitha masat e nevojshme për të mbrojtur e për të shfrytëzuar sa më mirë maqineritë dhe pajisjet ekzistuese, si dhe për mekanizimin e mëtejshëm të proceseve të punës. Në çdo ndërmarrje dhe organizatë ekonomike të merren në studim mirë-mbajtja dhe shfrytëzimi i maqinerive e i pajisjeve, të studjohen sistematikisht mundësitë e përdorimit me 2 ose 3 turne dhe të për-krahen iniciativat e përparuara për të zgjatur kohën e shfrytëzimit e të trajtimit të tyre më me kujdes. Ministria e Bujqësisë dhe or-ganizatat e Partisë të marrin masat për të shfrytëzuar të gjitha markat e traktorëve e të maqinerive të tjera bujqësore dhe të kuj-desen më shumë për mirëmbajtjen e tyre. Ministritë, brenda muajit nëntor 1961, të hartojnë masat që duhet të zbatohen për zgjerimin e mekanizimit të proceseve kryesore të punës të ngarkim-shkarkim



kimit, të transportimeve të brendshme të vetë ndërmarrjeve etj. Ky mekanizim të arrihet duke përdorur rezervat e brendshme dhe duke zgjeruar prodhimin e mekanizmave të thjeshta në vend. Në gjashtëmuajorin e parë të vitit 1962, Këshilli i Ministrave të shqyrtojë gjendjen e shfrytëzimit të maqinerive dhe të pajisjeve ekzistuese.

c) Një vëmendje e veçantë t'i kushtohet përmirësimit të organizimit të punës në brigada, në reparte dhe në ndërmarrje, për të shfrytëzuar më racionalisht kohën e punës, e cila përbën një rezervë të rëndësishme për rritjen e mëtejshme të rendimentit. Rastet e humbjes së kohës së punës nga avaritë, nga mungesa e furnizimit me materiale dhe nga ndërprerjet e energjisë elektrike, të diskutohen gjerësisht në mbledhjet e organizatave të Partisë dhe të kolektivave punonjës, si dhe të mënjahohen nëpërmjet vendosjes së rregullit, të disiplinës dhe të përgjegjësisë personale. Organizatat e Partisë dhe ato të masave të forcojnë punën edukative me punonjësit, për të ngritur më lart ndërgjegjen socialiste në punë. Nëpërmjet përmirësimit të teknikës së mbrojtjes në punë dhe shtimit të kujdesit për kushtet e punës dhe të jetesës së punonjësve, të kufizohen sa më tepër humbjet nga paaftësia e përkohshme.

Të shpejtohet puna për shtrirjen e normave teknike të punës sidomos në operacionet kryesore të prodhimit, pasi kjo është rruga më e drejtë për zbulimin dhe shfrytëzimin e mundësive të mëdha që ekzistojnë në rritjen e mëtejshme të rendimentit të punës dhe të realizimit të planit të prodhimit.

c) Komisioni i Planit të Shtetit, Komiteti Shtetëror i Punës dhe i Pagave, si dhe ministrinë, brenda tremujorit të parë të vitit 1962, të studjojnë mënyrën për të vendosur raporte më të drejta ndërmjet punëtorëve kryesorë dhe ndihmës në të gjitha ndërmarrjet dhe organizatat ekonomike. Zbatimi i kësaj detyre të sigurojë rritjen e numrit të punëtorëve kryesorë prodhues.

4. — Të gjitha organet shtetërore, ndërmarrjet, institucionet, organizatat e Partisë dhe ato të masave të pakësojnë sa më shumë shpenzimet në sferën joprodhuese, pa cënuar veprimtarinë e saj. Për këtë:

a) Të punohet vazhdimisht për shkurtimin e personelit administrativo-drejtues duke hequr nga organikat dhe listorganikat të gjitha postet e panevojshme, hallkat e tepërta, për ta bërë aparatit joprodhues më pak të kushtueshëm dhe më operativ.

b) Kujdes i veçantë të tregohet për mënjanimin e shpenzimeve jo të domosdoshme në institucionet social-kulturale, për të rritur efektivitetin e përdorimit të fondeve në shkollat, çerdhet, kopshtet, spitalet, në sigurimet shoqërore etj. Ministria e Financave, në bashkëpunim me Ministrinë e Arësimit e të Kulturës, me Ministrinë e Shëndetësisë dhe me Këshillin Qendror të Bashki-

meve Profesionale, t'i paraqesin Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH, brenda muajit tetor 1961, masat që duhet të merren për forcimin e mëtejshëm të regjimit të kursimit në sektorin social-kultural.

II

Për forcimin e mëtejshëm të regjimit të kursimit në investimet për ndërtimet kapitale

1. — Në investimet për ndërtimet kapitale, të cilat janë faktori vendimtar për zgjerimin e mjeteve themelore dhe për sigurimin e riprodhimit të zgjeruar socialist, shpenzohen çdo vit mjete të mëdha materiale e financiare. Realizimi i detyrës kryesore ekonomike të planit të tretë pesëvjeçar mbështetet në rritjen e madhe të investimeve dhe të ndërtimeve kapitale. Prandaj, organizatat e Partisë, organet shtetërore dhe ato të ekonomisë të sigurojnë, që fondet e investimeve të përdoren me efektivitet sa më të madh, që ndërtimet e planifikuara të kryhen me shpenzime sa më të pakta dhe në afate sa më të shkurtëra.

2. — Komisioni i Planit të Shtetit, Ministria e Ndërtimit dhe organet e tjera qendrore të përmirësojnë punën për të kryer studime të plota për leverdishmërinë ekonomike të veprave. Këto të shërbejnë si mbështetje kryesore për të hartuar projektet, për të ndërtuar vepra të thjeshta dhe sa më të lira, në përputhje me kushtet e vendit tonë. Të përcaktohen drejt aftësitë prodhuese të objekteve që ndërtohen, vëllimi i punimeve që do të kryhen dhe fondet që do të përdoren për to. Këto të konsiderohen si kushti themelor për të vendosur një regjim të fortë kursimi në përdorimin racional të mjeteve që investohen. Ministria e Ndërtimit të forcojë punën për të bërë sa më shumë projekte në vend.

3. — T'u jepet fund kërkesave të fryra dhe të pastudjuara mirë për investime dhe, në veçanti, për investime nën limit që bëhen nga ndërmarrjet, komitetet ekzekutive të këshillave popullore të rretheve dhe organet qendrore. Investimet nën limit të shërbejnë, në radhë të parë, për rritjen e prodhimit dhe përmirësimin e cilësisë së tij. Të konsiderohet si shkelje e rëndë e disiplinës shtetërore dhe të Partisë kryerja e ndërtimeve të parakohshme e të panevojshme dhe në asnjë mënyrë të mos lejohet tejkalimi i fondeve të investimeve mbi planin.

4. — Të merren masa të shpejta për përmirësimin e organizimit të punës në ndërmarrjet e ndërtim-montimit, pasi në punën e tyre ka rezerva të shumta për uljen e mëtejshme të kostos. Veçanërisht të punohet për të dorëzuar objektet në kohën e caktuar, për të shfrytëzuar më mirë maqineritë e rënda e mekanizmat, për

të respektuar dhe ulur vazhdimisht normativat e materialeve, si dhe të zgjerohet përdorimi i materialeve që gjenden në vend.

5. — Ndërmarrjet e ndërtimit, organizatat bazë të Partisë dhe ato të masave të shtojnë përpjekjet për të përmirësuar rrënjësisht cilësinë e punimeve të ndërtim-montimit, duke mënjanuar shpenzimet improdutive nga ripunimet. Ato duhet të rrënjosin në punonjësit frymën për të nxjerrë nga duart e tyre vepra me cilësi të lartë dhe për t'i shërbyer ekonomisë për një kohë të gjatë.

III

Për të rritur të ardhurat dhe për të kursyer shpenzimet në valutë

1. — Në kushtet e zhvillimit të vrullshëm të ekonomisë popullore, kur ne po zbatojmë gjerësisht politikën e industrializimit socialist të vendit dhe, si rrjedhim, importojmë shumë maqineri dhe pajisje industriale, rritja e të ardhurave dhe shkurtimi i shpenzimeve në valutë, për forcimin e bilancit të pagesave të shtetit, është një nga detyrat kryesore për organizatat e Partisë, për organet shtetërore dhe për ato të ekonomisë. Rritja e të ardhurave dhe shkurtimi i shpenzimeve në valutë duhet të kihen parasysh në gjithë veprimtarinë e ndërmarrjeve dhe të organizatave ekonomike, ato të përbëjnë një nga karakteristikat e rëndësishme në punën e kuadrove drejtues të ekonomisë dhe të bëhen çështje e të gjithë punonjësve.

2. — Të gjitha ministritë, komitetet ekzekutive të këshillave popullore të rretheve, komitetet dhe organizatat bazë të Partisë, ndërmarrjet dhe organizatat ekonomike të marrin këto masa për rritjen e të ardhurave në valutë:

a) Të punojnë për të realizuar dhe për të tejkaluar planet e eksportit për të gjithë artikujt, pasi ky përbën burimin kryesor për rritjen e të ardhurave në valutë. Një vëmendje të posaçme t'i kushtojnë përmirësimit të mëtejshëm të cilësisë dhe ambalazhimit të mallrave të eksportit, sepse kështu do të mund të dalim në tregjet ndërkombëtare me një nomenklaturë mallrash më të gjerë, do të rritim mundësitë për eksport dhe do të shtojmë të ardhurat në valutë. Organizatat e Partisë dhe kolektivat punonjës ta konsiderojnë nder realizimin e planit të mallrave për eksport dhe nxjerrjen në tregjet e jashtme të artikujve me cilësi të lartë. Të shtohen përpjekjet për të zgjeruar artikujt e eksportit, veçanërisht me mallra të industrializuara dhe gjysmë të industrializuara, si dhe me arti-kuj që nuk kërkojnë investime të mëdha.

b) Të përmirësojnë punën për shtimin e të ardhurave në valutë nga turizmi, nga transporti detar etj.

3. — Për shkurtrimin e shpenzimeve në valutë të gjitha orga-

nizatat e Partisë, kolektivat punonjës, të gjitha organet shtetërore e të ekonomisë dhe komitetet ekzekutive të këshillave popullore të rretheve të marrin këto masa:

a) Puna e filluar për shkurtrimin e importimeve të vazhdohet më tej, duke përkrahur gjerësisht iniciativat e përparuara për zëvendësimin e artikujve të importit me prodhime të vendit. Në vendin tonë tashmë është ngritur një industri e re, me një teknikë të përparuar, që drejtohet nga kadro të aftë, kështu që janë krijuar të gjitha kushtet për prodhimin e shumë artikujve, të cilët më parë na duhej t'i importonim.

Të mirëmbajmë maqineritë, pajisjet dhe artikujt e tjerë të importit dhe të përdoren këta sa më racionalisht. Komisioni i Planit të Shtetit, Ministria e Tregëtisë, Ministria e Financave dhe organet e tjera të marrin masa për të vënë rregull në sjelljen e mallrave nga importi dhe në shpërndarjen e tyre, për mbajtjen e llogarive, për nxjerrjen e bilancit të pagesave dhe të tregëtisë së jashtme në afatet e caktuara.

b) Të vendoset një disiplinë e fortë në shpenzimet e tjera me valutë. Të shfrytëzohen më mirë materialet e bashkëpunimit tekniko-shkencor që marrim nga vendet e tjera socialiste.

IV

Për ngritjen e drejtimit të ekonomisë në nivelin e detyrave të reja që shtron forcimi i mëtejshëm i regjimit të kursimit

1. — Ndryshimet rrënjësore që janë bërë në strukturën ekonomike të vendit tonë dhe zhvillimi i tij drejt ndërtimit të plotë të socializmit bëjnë të domosdoshëm shumëfishimin e forcave për të përmirësuar drejtimin e ekonomisë, që të mobilizohen në mënyrë të gjithanshme rezervat e brendshme dhe të rrënjoset thellë në ndërgjegjen e punonjësve ndjenja e kursimit, e administrimit me llogari dhe dhemshuri e pronës socialiste. Të merren masat e nevojshme për të përmirësuar drejtimin e ekonomisë, si kusht për rritjen e burimeve financiare, për rritjen e akumulimit të brendshëm socialist, që përbën burimin kryesor e vendimtar për riprodhimin e zgjeruar.

2. — Të gjitha organet shtetërore, ndërmarrjet dhe organizatat ekonomike, institucionet, organizatat e Partisë dhe ato të masave të përqëndrojnë vëmendjen kryesore për të vendosur një disiplinë të ndërgjegjshme në punë, për të zhvilluar më tej iniciativat krijuese të kuadrove dhe të punonjësve, për t'i zgjidhur çështjet në mënyrë operative, duke luftuar javashllëkun, frymën dikasteriale dhe shfaqjet e tjera të kësaj natyre, që janë të huaja për socializmin.

3. — Të organizohet më mirë kontrolli dhe të konsiderohet ky si hallkë e rëndësishme për të zbatuar detyrat në vendosjen e një regjimi të fortë kursimi. Kujdes i veçantë t'i kushtohet zbatimit me rreptësinë më të madhe të disiplinës financiare, pasi vetëm kështu mund të organizohet më mirë lufta kundër shpërdorimeve.

4. — T'u kushtohet më shumë kujdes shqyrtimit dhe aprovimit të planeve financiare të ndërmarrjeve, të organizatave ekonomike dhe të institucioneve, në mënyrë që të jenë plane mobilizuese. Të forcohet kontrolli preventiv mbi shpenzimet e ndryshme të buxhetit të shtetit, të analizohen me hollësi këto lloj shpenzimesh, që të kursehet leku i popullit. Për këtë duhet të përmirësojnë punën e tyre të gjitha organet drejtuese dhe veçanërisht Komisioni i Kontrollit, Ministria e Financave dhe Banka e Shtetit.

5. — Ministria e Bujqësisë, komitetet e Partisë dhe komitetet ekzekutive të këshillave popullore të rretheve të marrin të gjitha masat dhe të vendosin një regjim të fortë lidhur me administrimin dhe përdorimin e fondit të tokës bujqësore, të bëjnë një punë të vazhdueshme për të siguruar grumbullimin dhe përdorimin e plotë të të gjitha llojeve të plehrave organike dhe të kufizojnë në maksimum shpenzimet joprodhuese, me qëllim që të krijohen kushte për forcimin e mëtejshëm ekonomik të kooperativave bujqësore.

Kooperativat bujqësore dhe ndërmarrjet shtetërore të marrin masa për të rritur pjellshmërinë e bagëtive dhe për të pakësuar dëmtimet; të sigurojnë bazën ushqimore të blegtorisë dhe të shtojnë përdorimin e ushqimeve të njoma që janë më të lira, duke përhapur organizimin e konvejerit të gjelbër edhe në zonat malore.

6. — Rezervë e rëndësishme në kooperativat bujqësore për rritjen e prodhimit është pjesëmarrja e anëtarëve në punë dhe përdorimi i drejtë i krahëve të punës, prandaj duhet të tregohet më shumë kujdes për krijimin e fronteve të punës gjatë gjithë periudhave të vitit dhe për ngritjen e furrave kolektive, të çerdheve, të kopshteve, që lehtësojnë pjesëmarrjen e gruas në punë.

V

Për të ngritur në një shkallë më të lartë punën e Partisë, për të rrënjësuar te njerëzit dhëshurinë për pronën socialiste

1. — Komitetet dhe organizatat bazë të Partisë të merren vazhdimisht me çështjet konkrete të forcimit të mëtejshëm të regjimit të kursimit. Vlerësimi i punës së organizatave të Partisë të matet jo vetëm me rezultatet e realizimit të planit, por edhe me përfundimet ekonomiko-financiare që arrijnë ndërmarrjet, organizatat ekonomike dhe institucionet ku ato veprojnë.

2. — Komitetet dhe organizatat e Partisë, në punën e tyre të përditshme zbatimin e masave organizative ta koordinojnë me përmirësimin e punës politike që duhet të bëjnë për forcimin e regjimit të kursimit. Këto të shërbejnë për të forcuar bindjen e masave punonjëse për nevojën e kursimeve dhe administrimin me kujdes të pronës socialiste. Regjimi i kursimit është çështje e masave, ai duhet t'u bëhet edukatë njerëzve, prandaj të aktivizohen gjerësisht organizata e Bashkimeve Profesionale, organizata e Rinisë, ajo e Gruas dhe e Frontit Demokratik.

3. — Një kujdes i posaçëm t'i kushtohet ngritjes së vazhdueshme të aftësive drejtuese dhe përgatitjes profesionale të kuadrove të Partisë, të shtetit dhe të ekonomisë, pasi kjo përbën një kusht të domosdoshëm për të arritur rezultatet e dëshiruara në forcimin e mëtejshëm të regjimit të kursimit. Të përmirësohet puna për zgjedhjen dhe vendosjen e kuadrit. Komitetet dhe organizatat bazë të Partisë të caktojnë në vende drejtuese kuadro të zot, besnikë të Partisë dhe të popullit që kanë cilësi organizative, arësimin e nevojshëm dhe garanci për ta çuar punën përpara.

4. — Komitetet dhe organizatat e Partisë punën për kursime ta lidhin në mënyrë të pashmangshme me luftën kundër shfaqjeve të huaja që prishin ndërgjegjen e njerëzve.

Dëmtimi, administrimi i keq dhe vjedhja e pasurisë socialiste të konsiderohen si pasqyrim i luftës së klasave në frontin ekonomik,

«. . . vjedhësi, që grabit pasurinë e popullit dhe që u vë kazmën interesave të ekonomisë popullore, është po ai spiun dhe tradhëtar, në mos më keq»¹.

Prandaj duhet që puna edukative dhe ideologjike e Partisë të ngrihet në një nivel akoma më të lartë, për të forcuar ndërgjegjen socialiste dhe vigjilencën revolucionare të çdo punonjësi, për të ruajtur si sytë e ballit pronën socialiste (shtetërore dhe kooperativiste).

5. — Propaganda e Partisë të shërbejë për të aktivizuar më tepër punonjësit dhe që të kalitet në ndërgjegjen e tyre nevoja për të forcuar regjimin e kursimit, për të zbuluar e mobilizuar rezervat e brendshme. Çështja e kursimeve, si pjesë e pandarë e edukimit komunist të njerëzve, të trajtohet në format e edukimit të Partisë, të rinisë dhe të organizatave të tjera të masave. Për këtë të punojnë më shumë shtypi, radioja, kinostudioja dhe mjetet e tjera të propagandës.

6. — Organizatat e rinisë duhet të punojnë me kujdes të veçantë për të frymëzuar dhe për të mbujtur brezin e ri me ndje-

¹ J. V. Stalin. Veprat, vëll. 8, f. 139.

njën e kursimit, të dhemshurisë më të thellë për pronën e përbashkët socialiste, të fituar me gjak dhe të ndërtuar me djersën e popullit. E gjithë veprimtaria arësimore dhe kulturele, që nga institucionet më të ulëta deri në ato më të larta, të përshkohet nga dashuria për punën, si burim i të gjitha të mirave dhe nga ndjenja e kursimit si veti e çmueshme e njeriut të ri.

*
* * *

Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH thekson se realizimi me sukses i detyrave të mëdha të Kongresit IV të PPSH lidhet ngushtë me forcimin e mëtejshëm të regjimit të kursimit në gjithë veprimtarinë ekonomike të Partisë dhe të shtetit tonë.

Rezultatet e mira të arritura gjatë gjashtëmuorit të parë të vitit 1961 në realizimin e planeve ekonomike dhe në forcimin e regjimit të kursimit nga punonjësit, forcojnë bindjen se detyrat e pesëvjeçarit të tretë do të realizohen e do të tejkalohen.

Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH, i mbështetur në drejtësinë e vijës së përgjithshme të Partisë sonë marksiste-leniniste, në unitetin e pathyeshëm të Partisë e të popullit tonë heroik, në punën vetëmohuese të klasës punëtore, të fshatarësisë punonjëse, të inteligjencijës popullore si dhe me ndihmën internacionaliste të vendeve të kampit socialist, ka besim të patundur se detyrat që shtrohen në periudhën e tanishme për realizimin e planit, duke e forcuar më tej regjimin e kursimit, do të vihen me sukses në jetë.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Botohet sipas broshurës:

Vendim i Plenumit të Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë «Mbi masat që duhen marrë për forcimin e mëtejshëm të regjimit të kursimit».

Tiranë, 1961

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 161, 5 korrik 1961

LETËR E KQ TË PPSH DHE E KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË RPSH DREJTUAR KQ TË PARTISË KOMUNISTE TË BASHKIMIT SOVJETIK DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË BASHKIMIT SOVJETIK KU ZBULOHEN SHKAQET E VËRTETA TË KEQËSIMIT TË MARRËDHËNJEVE SHQIPTARO-SOVJETIKE

6 korrik 1961

Historia e Shqipërisë së re, themelet e së cilës janë hedhur në zjarrin e Luftës nacional-çlirimtare dhe të revolucionit popullor nga Partia Komuniste Shqiptare, sot Partia e Punës, është pasqyrë e gjallë e miqësisë midis Bashkimit Sovjetik dhe Shqipërisë socialiste, e miqësisë vëllazërore midis dy partive dhe dy popujve tanë... Miqësia shqiptaro-sovjetike nuk është rezultat i kombinacioneve diplomatike, i interesave të çastit të njëjës apo të tjetrës palë. Miqësia dhe dashuria e zjarrtë e Partisë dhe e popullit tonë ndaj Bashkimit Sovjetik i ka rrënjët në zemrat e Partisë e të popullit tonë, në zemrat e Partisë e të popullit të Bashkimit Sovjetik, në marksizëm-leninizmin. Ajo ka lindur që në ditët e para të Revolucionit të madh socialist të Tetorit, influenca e të cilit i dha hov të ri zhvillimit të lëvizjes çlirimtare antiimperialiste në Shqipëri dhe është në themel të lëvizjes demokratike të vitit 1924, të lindjes dhe rritjes së lëvizjes komuniste e punëtore në vendin tonë, të Luftës nacional-çlirimtare dhe të ndërtimit të socializmit.

Patriotët shqiptarë, që në vjetët e rëndë të Luftës së parë botërore, kur atdheu ynë ishte kthyer në fushë lufte dhe vuante nën zgjedhën e shkelësve të huaj, qëkurse Qeveria Sovjetike botoi Traktatin e fshehtë të Londrës, që parashikonte copëtimin e Shqipërisë midis fuqive imperialiste dhe shërbëtorëve të tyre, panë në shtetin e parë socialist, që drejtonte Lenini i madh, shpëtimtarin e tyre. Për të gjithë janë të njohura shpresat e mëdha që kishte patrioti Bajram Curri te Qeveria Sovjetike për vendosjen e drejtësisë në Ballkan, besimi i zjarrtë i patriotit Mihal Grameno te udhëheqësi i proletariatit rus, të cilin qysh në atë kohë ai e quante xhaxha Lenini, akti i lartë i patriotit Avni Rustemi, i cili detyroi parlamentin borgjez shqiptar në janar 1924 të mbante zi për vdekjen e Leninit, akti miqësor e i guximshëm i qeverisë demokratike shqip-

tare i vitit 1924 që vendosi marrëdhënje diplomatike me Qeverinë Sovjetike e të tjerë shembuj të panumërt.

Partia Komuniste Shqiptare, qysh në ditën e themelimit të saj, kur i dha kushtrimin popullit të ngrihej me armë në dorë kundër shkëlësve fashistë, e edukoi atë të shikojë nga Bashkimi Sovjetik si nga dielli, e lidhi Luftën e tij nacional-çlirimtare me Luftën e madhe patriotike të Bashkimit Sovjetik. Dhe partizanët trima shqiptarë ranë në fushën e betejës me librin e historisë së Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik në gji, të shpuar tej e tej nga plumbat e fashistëve si ushtarë të të njëjtit front, të të njëjtit ideal, të prirë nga flamuri i përbashkët i marksizëm-leninizmit. Partia jonë dhe populli shqiptar e mbrujtën me gjakun e bijve të tyre më të mirë miqësinë me Partinë Bolshevike të Leninit, me popujt vëllezër sovjetikë. Ushtria e Kuqe nuk erdhi në vendin tonë, por Partia dhe populli ynë e kanë konsideruar gjithmonë me të drejtë Bashkimin Sovjetik si çlirimtarin e tyre, sepse duke dërmuar forcat kryesore të maqinës luftarake hitleriane, Bashkimi Sovjetik bëri të mundur triumfin e Luftës sonë nacional-çlirimtare dhe të revolucionit popullor në Shqipëri, ashtu siç bëri të mundur çlirimin e të gjithë popujve të Evropës, çlirimin e njerëzimit nga kthe-trat e nazizmit.

Si në vjetët e Luftës së dytë botërore, ashtu dhe pas fitores mbi fashizmin, në vjetët e rimëkëmbjes së vendit të shkatërruar nga fashizmi, si në lëmin e ndërtimit të socializmit, ashtu dhe në fushën ndërkombëtare, kur ishte fjala për të mbrojtur të drejtat dhe interesat jetike të Shqipërisë në Konferencën e Paqes në Paris dhe në Organizatën e Kombeve të Bashkuara si dhe pavarësinë dhe paprekshmërinë e atdheut tonë, populli dhe Partia jonë, në çdo hap dhe në çdo vepër, kanë pasur gjithmonë përkrahjen e plotë dhe ndihmën e gjithanshme dhe bujare të Bashkimit Sovjetik...

Nuk kanë kaluar shumë vjet nga ngjarjet në Hungari, në Poloni e gjetkë, kur imperializmi dhe shërbëtorët e tij, revizionistët e çdo ngjyre u turrën, në kor të përbashkët, të villnin shpifjet më të poshtra kundër atdheut të Leninit, Bashkimit të lavdishëm Sovjetik. Në atë kohë kur sulmohej Bashkimi Sovjetik dhe kampi socialist, kur hidhej baltë mbi veprën e shkëlqyer të socializmit të ndërtuar gjatë 40 vjetëve të pushtetit sovjetik, kur bëheshin përpjekje për të vënë në dyshim parimet marksiste-leniniste, mbi të cilat mbështeten marrëdhënjet midis vendeve socialiste dhe kur në disa vende socialiste, nën influencën e imperialistëve dhe të revizionistëve modernë, elementë kundërrivolucionarë vrisnin edhe ushtarët çlirimtarë sovjetikë, në atë kohë detyra e çdo partie marksiste dhe e çdo shteti socialist ishte të mbronte me forcë dhe pa rezerva Bashkimin Sovjetik kundër këtyre sulmeve të poshtra e të pabesa. Dhe pikërisht menjëherë pas botimit të Deklaratës së Qeverisë Sovjetike në vitin 1956 «Mbi bazat e zhvillimit dhe të

forcimit të mëtejshëm të miqësisë e të bashkëpunimit midis Bashkimit Sovjetik dhe vendeve të tjera socialiste», Partia dhe qeveria jonë, kundër të cilave sot rrokullisen kaq akuza pa bazë, demaskuan dhe hodhën poshtë me vendosmëri sulmet dhe shpifjet e armiqve mbi marrëdhënjet midis Bashkimit Sovjetik dhe vendeve të demokracisë popullore. Në Deklaratën e saj, të shpallur më 3 nëntor 1956, Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë, duke ripohuar karakterin e drejtë parimor të marrëdhënjeve midis vendeve socialiste, theksonte ndër të tjera: «Marrëdhënjet tona me Bashkimin Sovjetik kanë qenë gjithmonë parimore dhe të drejta. . . » Edhe në Raportin e Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë të mbajtur në Kongresin IV të saj, në shkurt 1961, thuhet:

«Miqësia me Bashkimin Sovjetik është farkëtuar nga Partia jonë heroike në zjarrin e luftës për liri e pavarësi kombëtare, për socializëm dhe paqe; ajo është mbrujtur me gjakun e partizanëve tanë trima dhe të luftëtarëve të kuq të Ushtrisë së lavdishme Sovjetike, e cila, me fitoret e saja historike kundër fashizmit në Luftën e dytë botërore, krijoi kushtet dhe ndihmoi edhe për çlirimin e atdheut tonë nga kuçedra fashiste. . . Populli shqiptar do t'i jetë mirënjohës për jetë popullit vëlla sovjetik për ndihmën internacionale që i jep dhe e siguron atë se, ashtu si populli shqiptar ka te populli sovjetik mikun e tij të shtrenjtë e të dashur, edhe populli sovjetik ka te populli shqiptar një mik të tij besnik e të vendosur»¹.

Të tilla kanë qenë dhe mbeten ndjenjat, mendimet dhe qëndrimet e popullit shqiptar, të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe të Qeverisë Shqiptare ndaj Bashkimit Sovjetik, Partisë së tij Komuniste dhe popullit të madh sovjetik. Prandaj, Komitetin Qendror të Partisë sonë dhe Qeverinë Shqiptare i shqetëson thellë kursi i ri që ka filluar udhëheqja sovjetike në marrëdhënjet me Partinë e vendin tonë si dhe një sërë veprimesh të gabuara që janë kryer dhe po kryhen nga ana e udhëheqjes sovjetike në dëm të Republikës Popullore të Shqipërisë, në dëm të miqësisë së madhe shqiptaro-sovjetike, në dëm të vetë kampit socialist.

Komiteti Qendror i PPSH dhe Këshilli i Ministrave i RPSH, në një mbledhje të përbashkët, shqyrtuan me kujdes letrën e 26 prillit 1961, me anën e së cilës Qeveria e Bashkimit Sovjetik i përgjigjet letrës që Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë u drejtoi më 5 prill 1961 Qeverisë Sovjetike si dhe qeverive të vendeve të tjera vëllezër lidhur me vendimin e marrë në mbledhjen e

¹ Enver Hoxha. Raport mbi aktivitetin e KQ të PPSH. Kongresi IV i PPSH, f. 35. Tiranë, 1961

fundit të Komitetit politik konsultativ të Traktatit të Varshavës kundër Shqipërisë. Ne shprehim keqardhjen tonë të thellë se në letrën e Qeverisë Sovjetike të 26 prillit, duke mos u mbështetur mbi faktet reale, u bëhet një analizë e padrejtë çështjeve që ngrihen, formulohen akuza pa vend, të padrejta dhe jomiqësore ndaj Partisë së Punës të Shqipërisë dhe Qeverisë Shqiptare, bëhen përpjekje për t'i atribuar udhëheqjes shqiptare përgjegjësinë për veprime të gabuara të kryera nga udhëheqja sovjetike, ka plot kërcënime dhe presione të palejueshme dhe autorët e saj frymëzohen nga qëllimi i dukshëm për të dëmtuar edhe më tej marrëdhënjet sovjeto-shqiptare.

Me qëllim që çështjet të shihen nën dritën e vërtetë të miqësisë dhe të unitetit të vendeve dhe partive tona, në mbledhjen e përbashkët të Komitetit Qendror të PPSH dhe të Qeverisë Shqiptare, u vendos që t'u drejtohet kjo letër Komitetit Qendror të Partisë Komuniste dhe Këshillit të Ministrave të Bashkimit Sovjetik si përgjegje të letrës së 26 prillit 1961 dhe të notave e dokumentave të tjerë të Qeverisë Sovjetike drejtuar kohët e fundit Qeverisë Shqiptare si dhe në lidhje me një sërë veprimesh të shtrembëra dhe të padrejta, që po bëhen nga pala sovjetike prej disa kohësh ndaj vendit dhe Partisë sonë dhe që nuk mund të mos kenë influencë negative në marrëdhënjet tona dhe në gjithë kampin socialist.

Në letrën e saj të 26 prillit, Qeveria Sovjetike u referohet shfaqjeve jonormale që kanë lindur kohët e fundit në marrëdhënjet e Shqipërisë me Bashkimin Sovjetik dhe orvatet që për këtë gjendje përgjegjësinë t'ja hedhë udhëheqjes shqiptare.

Marrëdhënjet midis dy partive dhe dy vendeve tona kanë qenë pikërisht ashtu si i ka përcaktuar Sekretari i Parë i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, shoku Enver Hoxha, citati i të cilit përmendet në letrën e Qeverisë Sovjetike të 26 prillit 1961. Komiteti Qendror i Partisë Komuniste dhe Këshilli i Ministrave të Bashkimit Sovjetik e dinë fare mirë se nga ana e udhëheqjes shqiptare, asnjëherë dhe në asnjë rast nuk është bërë as gjesti më i vogël për t'i cënuar sado pak këto marrëdhënje, përkundrazi e gjithë politika dhe veprimtaria jonë kanë synuar dhe synojnë kurdoherë në zgjerimin dhe çelnikosjen e mëtejshme të marrëdhënjeve tona vëllazërore me Bashkimin Sovjetik si dhe me vendet e tjera vëllazër mbi bazat e internacionalizmit proletar.

Qeveria Sovjetike shtron pyetjen: Pse tani marrëdhënjet midis dy vendeve nuk janë si më parë? Por kësaj pyetjeje të drejtë në letrën e Qeverisë Sovjetike i jepet një përgjegje krejtësisht e shtrembër, si përsa i përket shkakut të vërtetë, burimit që ka sjellë ndryshimet që dihen në marrëdhënjet midis partive dhe vendeve tona, ashtu edhe përsa i përket shkaktarit, që me veprimet e veta ka krijuar marrëdhënjet ekzistuese jonormale midis dy partive

dhe vendeve tona. Sipas letrës së Qeverisë Sovjetike shkak i vërtetë, burimi që ka sjellë ndryshimet në marrëdhënjet tona, qenkan disa «fakte» që radhiten në letër, kurse fajtorë qenkan udhëheqësit shqiptarë që paskan ndryshuar qëndrimin ndaj Bashkimit Sovjetik. Ky është një konkluzion subjektiv dhe që nuk i përgjigjet aspak realitetit, prandaj ne e hedhim kategorikisht poshtë.

Atëhere cili është shkak, burimi i vërtetë që ka sjellë ndryshimet në marrëdhënjet tona? Ky burim e shkak nuk duhet kërkuar te disa «fakte», të cilat në çdo kohë dhe nga kushdo mund të trillohen e fabrikohen, por te mosmarrëveshjet ideologjike e politike që janë shfaqur midis dy partive tona, te Mbledhja e Bukureshtit e qershorit 1960, kur Partia e Punës e Shqipërisë nuk u bashkua me pikëpamjet e delegacionit të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe kundërshtoi orvatjet e tija për të dënuar padrejtësisht Partinë Komuniste Kineze, për të përjashtuar Republikën Popullore të Kinës nga kampi i socializmit.

Partia e Punës e Shqipërisë e mbrojti Partinë Komuniste të Kinës në Mbledhjen e Bukureshtit dhe do ta mbrojë edhe në të ardhshmen nga çdo sulm dhe akuzë e padrejtë, sepse Partia Komuniste e Kinës ka ndjekur dhe ndjek kurdoherë një politikë dhe vijë të drejtë marksiste-leniniste, sepse ajo ka qenë dhe është një luftëtare e vendosur e çështjes së paqes dhe e vendosjes së bashkëzistencës paqësore midis shteteve me sisteme të ndryshme shoqërore, sepse me guxim e vendosmëri ajo ka mbrojtur dhe mbrohet pastërtinë e marksizëm-leninizmit. Partia Komuniste e Kinës ka bërë një luftë të gjatë e heroike për çlirimin e popullit kinez dhe për triumfin e socializmit në Kinë, ajo ka dhënë një kontribut të madh në forcimin e sistemit socialist botëror, Kina bashkë me Bashkimin Sovjetik përbëjnë shtyllën kryesore të kampit të fuqishëm socialist. Prandaj, duke mbrojtur Kinën popullore dhe Partinë Komuniste të Kinës në Mbledhjen e Bukureshtit, Partia e Punës e Shqipërisë i bëri një shërbim të madh vetë unitetit të kampit socialist, miqësisë së madhe sovjeto-kineze, unitetit të lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare dhe jemi të bindur se për këtë lëvizja komuniste botërore nuk do të na hedhë gurin, siç po bën kundër nesh udhëheqja sovjetike qysh nga qershori i vitit 1960. Pra, që nga ky moment, për arsye të qëndrimit të përfaqësuesve të Partisë së Punës të Shqipërisë në kundërshtim me pikëpamjet e delegacionit të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik në Mbledhjen e Bukureshtit, filloi sulmi i hapur kundër Partisë dhe vendit tonë, filluan përpjekjet për të dëmtuar marrëdhënjet shqiptaro-sovjetike, filluan ndërhyrjet e palejueshme në punët e brendshme dhe presionet politike, ekonomike dhe ushtarake, të cilat kanë ardhur duke u shtuar nga dita në ditë, filloi qëndrimi jomiqësor i disa udhëheqësve sovjetikë ndaj Partisë dhe vendit tonë.

Në fakt, qysh nga Mbledhja e Bukureshtit, udhëheqësit sovjetikë e përcaktuan vijën e tyre të qëndrimit ndaj Shqipërisë dhe ndaj Partisë së Punës të Shqipërisë, që do të ishte vija e presioneve, e ndërhyrjeve të palejueshme në punët tona të brendshme, vija e dëmtimit të miqësisë shqiptaro-sovjetike, duke shpresuar se në këtë mënyrë do të gjunxtonin Partinë dhe popullin tonë, do të detyronin Partinë dhe udhëheqjen e saj të ndryshonin pikëpamjet e tyre ideologjike. Këtë e vërteton qëndrimi i mbajtur ndaj Partisë dhe vendit tonë që nga Mbledhja e Bukureshtit e deri në Konferencën e Moskës së 81 partive komuniste dhe punëtorë në nëntor të vitit 1960, e vërtetojnë veprimet e padrejta dhe presionet e ndryshme ekonomike e politike të udhëheqjes sovjetike, për të cilat ne kemi folur në Konferencën e Moskës dhe nuk duam t'i përsëritim. Që udhëheqësit sovjetikë e kishin përcaktuar qysh më parë vijën e tyre të qëndrimit ndaj Shqipërisë dhe Partisë së Punës të Shqipërisë, si rezultat i mosmarrëveshjeve që u shfaqën në Bukuresht midis dy partive tona, e vërteton fakti se N. Hrushovi, qysh përpara Konferencës së Moskës, qysh në tetor 1960, u deklaroi shokëve kinezë se «ne do ta trajtojmë Shqipërinë si Jugosllavinë» dhe më vonë më 6 nëntor 1960, përsëri përpara se të hapej Konferenca e Moskës e 81 partive, po N. Hrushovi i deklaroi delegacionit të Partisë Komuniste të Kinës se «Partia e Punës e Shqipërisë është hallka jonë e dobët» dhe se «ne (sovjetikët) humbëm një Shqipëri, kurse ju, kinezët fituat një Shqipëri».

Siç shihet, vija e trajtimit të Shqipërisë dhe Partisë së Punës të Shqipërisë, qëndrimi ndaj marrëdhënjeve shqiptaro-sovjetike, është paracaktuar me kohë nga disa udhëheqës sovjetikë. Kjo vijë është vendosur përpara se të «lindnin» të ashtuquajturat «fakte» e «incidente» që me aq zell përshkruhen në letrën e Qeverisë Sovjetike. Është më se e qartë se trillimi i «fakteve» dhe i «incidenteve» u nevojitej udhëheqësve sovjetikë për tri arsye:

E para, për të fshehur shkaku e vërtetë që nxiti udhëheqësit sovjetikë për të bërë kundërshtim Partisë së Punës të Shqipërisë dhe popullit shqiptar presionet e njohura ekonomike, politike dhe ushtarake. Nuk ka dyshim se udhëheqësve sovjetikë nuk u intereson, sidomos pas botimit të Deklaratës së 81 partive komuniste dhe punëtorë, që të deklarojnë hapur se veprimet e tyre jomiqësore ndaj Partisë së Punës të Shqipërisë dhe popullit shqiptar, janë si kundërveprim i qëndrimit që mbajti përfaqësuesi i Partisë së Punës të Shqipërisë në Mbledhjen e Bukureshtit, si rezultat i faktit se Partia e Punës e Shqipërisë nuk u pajtua me pikëpamjen e udhëheqjes së Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik në atë mbledhje.

E dyta, trillimi i «fakteve» dhe i «incidenteve» u nevojitej udhëheqësve sovjetikë për të akuzuar udhëheqjen shqiptare gjoja si shkaktare të keqësimit të marrëdhënjeve shqiptaro-sovjetike.

Pikërisht për këtë qëllim, për krijimin e këtyre «incidenteve» dhe «fakteve» të paqena, kanë vepruar disa punonjës të Ambasadës Sovjetike në Tiranë, disa nëpunës e oficerë madhorë, për veprimet e të cilëve prej kohësh, që në korrik të vitit të kaluar, në Konferencën e Moskës në nëntor të 1960-s e më vonë, Komiteti Qendror i Partisë sonë ju ka vënë në dijeni zyrtarisht. Është për të ardhur keq që veprimet e palavdishme të këtyre njerëzve të pandërgjegjshëm, që intrigat e deri provokacionet e tyre kanë gjetur kredi dhe janë përdorur si «argumenta» nga udhëheqja sovjetike për të akuzuar Partinë dhe popullin tonë për gjoja qëndrim jomiqësor ndaj Bashkimit Sovjetik.

E treta, më në fund «faktet» dhe «incidentet» e trilluara do të shërbenin edhe për të bindur e tërhequr në masat represive kundër Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Partisë së Punës të Shqipërisë dhe disa udhëheqës të disa vendeve të demokracisë popullore.

Pra, arsëyet e vërteta e objektive që kanë shkaktuar gjendjen e sotme të marrëdhënjeve shqiptaro-sovjetike nuk qëndrojnë në «faktet» e paqena e artificiale që radhiten në mënyrë tendencioze në letrën e Qeverisë Sovjetike, por në ndryshimin e qëndrimit të udhëheqjes sovjetike ndaj Shqipërisë, për shkak se Partia e Punës e Shqipërisë nuk është pajtuar me qëndrimin e disa udhëheqësve sovjetikë në disa çështje ideologjike e politike.

Partia e Punës e Shqipërisë e ka konsideruar dhe e konsideron si një të drejtë themelore të çdo partie komuniste e punëtorë që, mbi bazat e unitetit marksist-leninist të lëvizjes komuniste e punëtorë ndërkombëtare, të shprehë hapët dhe pa drojtje pikëpamjen e saj, qoftë kjo edhe kritikë ndaj një partie tjetër.

Për Partinë e Punës të Shqipërisë, ashtu siç e kemi vënë në dukje dhe do ta theksojmë kurdoherë, Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik, ka qenë fener ndriçues, mësues dhe shembull i lavdishëm. Duke zbatuar me vendosmëri mësimet dhe eksperiencën e saj universale në kushtet konkrete të Shqipërisë, duke e lidhur të gjithë luftën dhe veprimtarinë e saj dhe të popullit tonë me Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe me Bashkimin e madh Sovjetik, Partia jonë ka korrur fitore me rëndësi historike për popullin shqiptar, siç janë fitorja e Luftës nacional-çlirimtare dhe e revolucionit popullor si dhe fitoret në ndërtimin e socializmit në vendin tonë. Duke i qëndruar besnike marksizëm-leninizmit në çdo rrethanë e kundër çdo stuhie, Partia e Punës e Shqipërisë i ka qëndruar besnike Partisë së madhe të Leninit dhe kështu do të qëndrojë për jetë.

Por kjo konsideratë e drejtë internacionaliste nuk çënon aspak parimin e barazisë midis partive komuniste e punëtorë, të cilat janë reparte të së njëjtës ushtri, udhëhiqen nga e njëjta ideologji,

luftojnë për të njëjtat qëllime, për triumfin e komunizmit në botë. Duke u nisur nga ky parim Partia jonë foli në Mbledhjen e Bukureshtit. Por për fat të keq këtë parim të paprekshëm janë munduar ta marrin nëpër këmbë disa udhëheqës të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik në marrëdhënjet me Partinë e Punës të Shqipërisë, duke dashur t'i imponojnë kësaj, nga një pozitë epërsie e paternaliste, pikëpamjet e tyre që ne i quajmë të padrejta. Dhe kur Partia jonë nuk u pajtua me këto pikëpamje në Mbledhjen e Bukureshtit, pas saj shpërtheu sulmi i hapur jomiqësor i disa udhëheqësve sovjetikë kundër Partisë e vendit tonë, filluan presionet e gjithanshme për të nënshtruar me çdo kusht Partinë e Punës të Shqipërisë, filloi shtrirja e disa mosmarrëveshjeve ideo-politike midis dy partive tona edhe në fushën e marrëdhënjeve shtetërore, në fushën e marrëdhënjeve ekonomike, politike, kulturele dhe ushtarake.

Nga sa u tha më sipër del fare qartë përse tani marrëdhënjet midis dy vendeve tona nuk janë si më parë. Marrëdhënjet e mëparshme shqiptaro-sovjetike, të cilat kanë qenë më se shembëllore, dashuria e pakufishme dhe miqësia e singertë më se vëllazërore që lidh dy popujt tanë, besnikëria e pakufishme për njëri-tjetrin janë vënë në shenjë nga disa udhëheqës sovjetikë, vetëm sepse Partia e Punës e Shqipërisë «guxoi» të ketë pikëpamje të ndryshme nga ajo e udhëheqësve sovjetikë, vetëm sepse ajo ketë pikëpamje e shprehu hapur, me kurajë, në një mbledhje partish dhe konform të gjitha rregullave marksiste-leniniste, vetëm sepse ajo është një parti «e vogël» e një populli «të vogël» në numër, i cili siç duket, sipas konceptit të disa udhëheqësve sovjetikë nuk duhet të ketë mendim të vetin, por duhet t'u bindet të tjerëve, të përsëritë mekanikisht mendimet e të tjerëve.

Nga sa u tha më sipër del qartë gjithashtu se fajtorë për gjendjen e krijuar janë disa udhëheqës sovjetikë, të cilët efektivisht kishin paravendosur dhe po realizojnë si «hakmarrje» bllokadën ekonomike e politike kundër Partisë së Punës të Shqipërisë dhe Republikës Popullore të Shqipërisë, bllokadë në të cilën janë tërhequr edhe disa udhëheqës të disa vendeve të demokracisë popullore. Është e tepërt të theksohet se kjo bllokadë bëhet në dëm të interesave të popullit shqiptar, në dëm të një vendi socialist siç është Shqipëria, në dëm të miqësisë shqiptaro-sovjetike dhe në dëm të vetë kampit socialist dhe lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare.

Në letërën e 26 prillit të Qeverisë Sovjetike me hollësitë më të mëdha bëhet fjalë për përkrahjen që ka pasur Republika Popullore e Shqipërisë nga Bashkimi Sovjetik në fushat e ndryshme politike e ekonomike, për kreditë e ndihmat e shumta të llogaritura në qindra milion apo dhe në miliarda rubla dhe pas kësaj në atë letër apo në notat e mëvonshme të Qeverisë Sovjetike, i atri-

buohen palës shqiptare epitetet «mosmirënjohës», «farisej», «piratë» etj. etj. (!!).

Ne themi se kushdo që orvatet të shtrembërojë karakterin dhe qëllimet e larta internacionaliste të kësaj ndihme për të ngritur epitete të palejueshme kundër udhëheqësve shqiptarë, indinjon popullin dhe Partinë tonë dhe e fut veten në një rrugë pa krye. Partia, qeveria dhe gjithë populli shqiptar kanë folur dhe do të flasin vetë kurdoherë me zë të lartë, me mburrje dhe me mirënjohje për ndihmat e paçmuara të Bashkimit Sovjetik në të gjitha fushat, edhe për ato që llogariten me rubla, siç janë ndihmat ekonomike apo ushtarake, edhe për ato që nuk mund të llogariten me rubla, siç janë gjaku i derdhur nga Ushtria e lavdishme Sovjetike në luftën kundër fashizmit edhe për çlirimin e Shqipërisë, eksperiencia dritëdhënëse e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik për Partinë tonë, për edukimin e komunistëve dhe të popullit shqiptar me ndjenjat e internacionalizmit proletar, me ndjenjat e miqësisë dhe të dashurisë që ushqejnë Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik dhe populli sovjetik për popullin dhe Partinë tonë. Dhe këtë e bëjmë jo për «fariseizëm» ose për «mosmirënjohje», por sepse kjo është e vërteta e pamohueshme, këto janë ndjenjat e pastra që ushqejnë Partia dhe populli ynë për Bashkimin Sovjetik, për Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, për popullin sovjetik. Kështu ka qenë e kështu do të jetë gjithmonë, pavarësisht nga çdo gjë që po ndodh e mund të ndodhë.

Por Partisë dhe popullit tonë nuk u vjen mirë kur shtrembërohet karakteri i lartë internacionalist i kësaj ndihme, nuk u vjen mirë dhe nuk mund të pranojnë që ndihma bujare e Bashkimit Sovjetik të na përmendet tani si mjet presioni dhe nënshtrimi, siç veprohet nga udhëheqja sovjetike. Çdo vend socialist u jep ndihmë internacionaliste vendeve të tjera socialiste. Në këtë kuptim edhe Shqipëria socialiste u ka dhënë dhe u jep vendeve të tjera socialiste një ndihmë të madhe internacionaliste, jo me kredi në rubla, sepse të tilla nuk kemi, por me qëndrimin e saj konsequent në mbrojtje të pozitave të socializmit në këtë qoshe të Ballkanit, me luftën e vet kundër imperializmit dhe revizionizmit, me mbështetjen politike dhe solidaritetin vëllazëror të luftës së popujve për paqe, liri e pavarësi, me besnikërinë e saj të vendosur ndaj çështjes së socializmit e të komunizmit. Dhe për këtë ndihmë ne nuk kemi pritur as presim lëvdata, sepse ne nuk kemi bërë dhe nuk bëjmë tjetër veçse detyrën tonë internacionaliste. Po kështu edhe ato vende socialiste që ekonomikisht janë më të forta dhe u japin ndihmë ekonomike e materiale vendeve të tjera socialiste, nuk bëjnë tjetër veçse plotësojnë një detyrë internacionaliste. Prandaj, në këtë drejtim asnjë vend socialist nuk ka arësye që të mburret me ndihmat që jep. Dhe në qoftë se një gjë të tillë e vëmë në dukje, qoftë edhe në formë kritike, këtë e bëjmë jo pse jemi «mos-

mirënjohës», e duam «të hedhim baltë kundër Bashkimit Sovjetik», por sepse kemi respekt ndaj Bashkimit Sovjetik, ndaj karakterit internacionalist të ndihmës së tij, sepse kemi besim te Partia e madhe e Leninit.

Në Konferencën e Moskës të përfaqësuesve të 81 partive komuniste dhe punëtorë, që u mbajt në nëntor 1960, delegacioni i Partisë së Punës të Shqipërisë parashtrroi, haptas dhe në mënyrë shoqërore, pikëpamjet e Partisë sonë jo vetëm për ato çështje ideologjike e politike për të cilat ne kemi mendime të ndryshme me udhëheqjen e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, por edhe për disa shfaqje negative që ishin vënë re në marrëdhënjet shqiptaro-sovjetike që nga Mbledhja e Bukureshtit (qershor 1960) e deri në nëntor të 1960-s, të cilat ne nuk duam t'i përsëritim. Këtë gjë delegacioni ynë e bëri jo vetëm pse e kishte të drejtë dhe për detyrë si çdo parti komuniste e punëtorë pjesëmarrëse në atë mbledhje, por sepse kishte besim se Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik do ta kuptonte drejt këtë qëndrim parimor të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe do të nxirrte konkluzionet përkatëse, do të hiqte dorë nga veprimet e saj të shtrembëra dhe do t'u përgjigjej përpjekjeve tona të sinqerta me përpjekje të sinqerta për të mënjeluar veprimet e padrejta dhe për të forcuar akoma më shumë unitetin dhe bashkëpunimin tonë vëllazëror mbi bazat e marksizëm-leninizmit.

Për fat të keq, ne duhet të vëmë në dukje se udhëheqja sovjetike nuk nxori asnjë konkluzion pozitiv nga kjo mbledhje, por duke shkelur rëndë Deklaratën historike të aprovuar me atë rast, ashpërsoi me ndërgjegje edhe më tej qëndrimin e saj ndaj Partisë së Punës të Shqipërisë dhe ndërmori veprime të reja akoma më të rënda, të palejueshme edhe në marrëdhënjet normale midis shteteve. Këto veprime kundër Partisë, shtetit dhe popullit tonë, që me prova të shumta, në ditë të mira e të vështira, gjatë 20 vjetëve qysh nga themelimi i Partisë sonë, kanë treguar vetëm besnikëri të pafund, miqësi të sinqertë e dashuri të pakufi ndaj Bashkimit Sovjetik, Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe popujve sovjetikë, i kanë sjellë dëme të mëdha Republikës Popullore të Shqipërisë.

Le t'u referohemi fakteve konkrete.

Qysh nga qershori i vitit 1960 Qeveria Sovjetike sistematikisht ka ndjekur rrugën e prerjes «së heshtur» të çdo ndihme ekonomike për Republikën Popullore të Shqipërisë, për popullin shqiptar, duke shkelur në mënyrë të njëanshme çdo marrëveshje ekzistuese midis dy vendeve tona.

Sikundër dihet, në vijim të bisedimeve të nivelit të lartë të zhvilluara midis Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Bashkimit Sovjetik në Moskë, në dhjetor 1958, Bashkimi Sovjetik pranoi t'i akordonte Republikës Popullore të Shqipërisë një kredi prej 300

milion rublash për periudhën 1959-1965. Marrëveshja përkatëse midis të dy palëve u nënshkrua më 3 korrik 1959. Bashkimi Sovjetik pranoi gjithashtu t'i akordonte Shqipërisë një kredi suplementare prej 70 milion rublash për mekanizimin e bujqësisë dhe më 25 korrik 1960 pala sovjetike paraqiti projekt marrëveshjen përkatëse për nënshkrim. Edhe për shkëmbimet tregëtare midis të dy vendeve, për periudhën 1961-1965, në bazë të rekomandimeve të Këshillit të Ndhmës Ekonomike Reciproke, qysh më 3 prill 1959, u nënshkrua Protokollin përkatës nga kryetarët respektivë të Komisioneve të Planeve të Shtetit, K. Theodhosi dhe A. Kosigini. Por me gjithë përçapjet e përsëritura të Qeverisë Shqiptare, Qeveria Sovjetike deri më sot, nuk ka pranuar të zbatojë marrëveshjen e 3 korrikut 1959 mbi kreditë, as të nënshkruajë marrëveshjen mbi kredinë për mekanizimin e bujqësisë dhe as marrëveshjen mbi kleringun 1961-1965 në përputhje me Protokollin e 3 prillit 1959 dhe këto me qëllim të hapët presioni mbi Partinë e Punës të Shqipërisë dhe Qeverinë Shqiptare, për të penguar realizimin e planit të tretë pesëvjeçar 1961-1965 të Republikës Popullore të Shqipërisë, për të dëmtuar ndërtimin e socializmit në Shqipëri. Në letrën e 14 janarit 1961 drejtuar Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik mbi këto çështje lidhur me notën e Ambasadës Sovjetike në Tiranë, datë 6 janar 1961, letër që edhe sot e kësaj dite ka mbetur pa përgjegje, Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë shkruante ndër të tjera:

«Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë dëshiron t'i vërë në dukje Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik se, në qoftë se do të ecet në atë rrugë si i shtron çështjet Qeveria Sovjetike, në lidhje me marrëdhënjet midis dy vendeve tona, duke u munduar të krijojë vështirësi për ndërtimin socialist në Shqipëri, ajo është rrugë pa krye. Natyrisht, Qeveria Sovjetike do të mbante përgjegjësinë për rrjedhimet që do të kishin këto veprime në marrëdhënjet shqiptaro-sovjetike, veprime që janë të papajteshme me praktikën e deritanishme të marrëdhënjeve midis partive marksiste dhe vendeve socialiste. Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë ka besim te Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik dhe te Komiteti i saj Qendror, se do të mënjanohe pengesat artificiale që i vihen Partisë së Punës të Shqipërisë dhe një vendi mik e aleat, pjesëtar i kampit socialist, një partie marksiste dhe një vendi të vogël socialist që luftojnë pa u tundur, në kushtet e rrethimit gjeografik armiqësor, kundër imperialistëve dhe armiqtë të marksizëm-

-leninizmit, revizionistëve jugosllavë, për mbrojtjen jo vetëm të interesave të popullit shqiptar, por edhe të interesave të të gjithë kampit socialist»¹.

Duke shkelur arbitrarisht marrëveshjet në fuqi dhe duke penguar në mënyrë të njëanshme dhënjen e kredive të akorduara, udhëheqja sovjetike jo vetëm shkel parimet elementare të marrëdhënjëve midis shteteve socialiste, por i shkakton dëme kolosale ekonomisë popullore të Shqipërisë, duke ditur se vendi ynë ka pasur dhe ka nevojë për ndihmën vëllazërore të Bashkimit Sovjetik dhe të vendeve të tjera socialiste. Në rast se udhëheqja sovjetike, ashtu siç po e tregon në rastin e Shqipërisë, ndihmën ekonomike kërkon ta përdorë si mjet që të nënshtrojë udhëheqjen tonë, Partinë dhe qeverinë tonë ndaj pikëpamjeve të saja të padrejta, kësaj i thonë t'i bësh një shërbim shumë të keq Bashkimit Sovjetik si dhe ideve tona të mëdha të marksizëm-leninizmit. Ne jemi të bindur se të tilla nuk janë ndjenjat dhe mendimet e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe të popullit të madh sovjetik. Por me keqardhje kemi të drejtë dhe detyrë të vëmë në dukje shtrembërimet që po bën udhëheqja sovjetike në këtë çështje.

Duke ecur në rrugën e veprimeve të njëanshme, me qëllim presioni dhe dëmtimi me ndërjegje të ndërtimit socialist në Shqipëri, udhëheqja sovjetike, sikundër u njoftua me notën e Ambasadës Sovjetike në Tiranë, datë 24 prill 1961, vendosi të mos dërgojë specialistë të rinj në Shqipëri dhe të mos zgjatë afatin e qëndrimit të specialistëve sovjetikë që punonin deri në atë kohë në vendin tonë, ndërsa më 8 qershor 1961, Qeveria Sovjetike, përmes ambasadorit të saj në Tiranë, njoftoi se po tërhiqte nga Shqipëria edhe specialistët, të cilëve nuk u kishte mbaruar akoma afati i qëndrimit në vendin tonë.

Duke marrë parasysh orvatjet që bëhen nga pala sovjetike në notat e Ambasadës Sovjetike të 24 prillit dhe të 27 majit 1961, ashtu dhe letrën e Qeverisë Sovjetike të 26 prillit 1961 për të shtrembëruar të vërtetën dhe për t'ja hedhur palës shqiptare përgjegjësinë mbi këto veprime të njëanshme dhe shumë negative të udhëheqjes sovjetike, ne e shohim me vend ta sqarojmë pak me hollësi çështjen e tërheqjes së specialistëve sovjetikë nga Shqipëria.

Në radhë të parë, ne duam të theksojmë se specialistët sovjetikë në Shqipëri kanë ardhur për të dhënë ndihmën e tyre në fushat e ndryshme të ekonomisë sonë popullore, jo qysh nga viti 1951, siç thuhet në letrën e 26 prillit, por disa vjet më parë, që më 1946. Fjalët pa bazë dhe të pahijshme që thuhën në dokumentat

¹ Dokumenta kryesore të PPSH. Vëll. III, f. 508. Tiranë, 1970.

e sipërm të udhëheqjes sovjetike mbi gjoja trajtimin joshoqëror, të padrejtë e mospërfillës nga ana shqiptare ndaj specialistëve dhe njerëzve sovjetikë në Shqipëri, janë trillime dhe fyerje të rënda që u bëhen ndjenjave të dashurisë vëllazërore, të respektit të thellë dhe bashkëpunimit të përzemërt të popullit shqiptar ndaj njerëzve sovjetikë, që u bëhen vetë njerëzve sovjetikë, të cilët kanë jetuar dhe kanë punuar në Shqipëri. Kundrejt specialistëve sovjetikë në Shqipëri njerëzit tanë, të edukuar nga Partia me dashurinë dhe respektin më të thellë ndaj njerëzve sovjetikë, jo vetëm nuk kanë pasur kurrë dhe në asnjë rast dyshim e mosbesim, por përkundrazi me zemër të hapur u kanë krijuar kushtet optimale të mundshme për punë, nuk u kanë mbajtur asgjë të fshehtë, janë sjellë me ta si vëllezër të vërtetë.

Kush harton trillime të tilla tendencioze nuk e njuh realitetin e lidhjeve të pathyeshme që bashkojnë popullin shqiptar me popullin sovjetik. Ashtu sikundër në luftën për çlirimin e Shqipërisë nga pushtimi fashist me gjakun e partizanëve shqiptarë u derdh e u përzie edhe gjaku i Ushtrisë së Kuqe të lavdishme, ashtu u derdh e u përzie në luftën për ndërtimin e socializmit në Shqipëri edhe djersa e punëtorëve dhe specialistëve shqiptarë me djersën e punëtorëve dhe specialistëve sovjetikë. Njerëzit tanë kanë mësuar shumë nga njerëzit sovjetikë, qoftë në Shqipëri, qoftë në fabrikat, shkollat, universitetet dhe akademitë e Bashkimit Sovjetik. Vetëm kush niset nga qëllime të këqia, kush mendon të sabotojë ndërtimin ekonomik të Shqipërisë dhe të minojë miqësinë shqiptaro-sovjetike mund të pretendojë se pala shqiptare «nuk është e interesuar për ndihmën e specialistëve sovjetikë» dhe «rëndohet nga qëndrimi i tyre në Shqipëri», se bile gjoja «orvatet në mënyrë indirekte të ushtrojë presion mbi palën sovjetike» që të largojë specialistët nga Shqipëria. Ne mund t'ju themi se sado orvatje që të bëhen, nuk mund të justifikohet dot vendimi i padrejtë i Qeverisë Sovjetike për të tërhequr specialistët sovjetikë nga Shqipëria. Dëshmitarët më të mirë të ndjenjave, qëndrimit dhe trajtimit të njerëzve sovjetikë nga ana e popullit shqiptar dhe Partisë e qeverisë së tij, dëshmitarët më të mirë të tezës sonë të drejtë, janë vetë qytetarët sovjetikë, specialistët dhe ushtarakët që kanë qenë në vendin tonë, çdo qytetar sovjetik që ka pasur kontakt, kudo qoftë në Shqipëri, në Bashkimin Sovjetik, apo në ndonjë vend tjetër, me cilindo qytetar të Republikës sonë Popullore.

Qeveria Sovjetike e di fare mirë se më 21 dhjetor 1960 zëvendëskryetari i Këshillit të Ministrave të Republikës Popullore të Shqipërisë, Abdyl Këllezi, i drejtoi kryetarit të Komitetit Shtetëror për marrëdhënjet ekonomike me botën e jashtme pranë Këshillit të Ministrave të BRSS, A.S. Skaçkov, kërkesën e Qeverisë Shqiptare për ndihmë teknike nga Bashkimi Sovjetik për vitin 1961, duke

përfshirë edhe zgjatjen e qëndrimit të specialistëve sovjetikë në Shqipëri për naftën dhe për sektorë të tjerë.

Ndërsa Qeveria Shqiptare priste një përgjegje pozitive për këtë kërkesë, më 20 janar 1961, zëvendëskëshilltari për çështjet ekonomike pranë Ambasadës Sovjetike në Tiranë, A. Pikalov, me kërkesën e vet, mori takim me ministrin e minierave dhe të gjeologjisë të Republikës Popullore të Shqipërisë, Adil Çarçani dhe i njoftoi këtë zyrtarisht se Komiteti Shtetëror për marrëdhënje ekonomike me botën e jashtme pranë Këshillit të Ministrave të BRSS kishte vendosur që, brenda një kohe prej 7-10 ditësh, të tërhiqte specialistët sovjetikë që punonin në sistemin e naftës në Shqipëri për arsye se marrëveshja e 22 nëntorit 1957 ishte plotësuar, si dhe brigadën sovjetike të shpimit të naftës për arsye se nuk do të shpohej në shtresat e mezozoit.

Shoku Adil Çarçani, duke shprehur habi dhe keqardhje për këtë vendim të prerë të palës sovjetike, në një kohë kur Qeveria Shqiptare priste përgjegje për zgjatjen e afatit të qëndrimit të specialistëve sovjetikë, tha se, me gjithë nevojën e vendit tonë për specialistët e naftës, do të merrte masat e nevojshme që ata, në pajtim me kërkesën zyrtare të Qeverisë Sovjetike nga e cila ata varen, të mund të largoheshin brenda 7-10 ditësh. Dhe në fakt ai dha menjëherë udhëzimet përkatëse.

Ishte e drejta e Qeverisë Sovjetike të mos pranonte zgjatjen e afatit të qëndrimit të specialistëve sovjetikë të naftës në Shqipëri, kërkuar më 21 dhjetor 1960 nga Qeveria Shqiptare, por përse pastaj bëhen shtrembërime të fakteve dhe orvatje të pahijshme për t'ju shmangur përgjegjësive për masën e padrejtë të marrë nga Qeveria Sovjetike dhe për t'ja hedhur atë Qeverisë Shqiptare, e cila, në të kundërtën, një muaj më parë kishte kërkuar zyrtarisht zgjatjen e qëndrimit të tyre në Shqipëri?

Është fakt se, pas njoftimit të A. Pikalovit, më 20 janar 1961, largimi i specialistëve sovjetikë të sistemit të naftës u zvarrit pa asnjë arsye dhe pa asnjë konsultim me autoritetet kompetente shqiptare për afro një muaj dhe gjatë kësaj kohe përfaqësuesit e Komitetit Shtetëror Sovjetik për marrëdhënjat ekonomike me botën e jashtme në Shqipëri u munduan të shtrembërojnë realitetin; bile Gonçarovi, nëpunës i përfaqësimit të Komitetit Shtetëror sovjetik për marrëdhënjet ekonomike me botën e jashtme në Tiranë, arriti sa t'i thotë kryeinxhinierit të Kombinatit të naftës, Ramiz Xhabija, duke shpifur në mënyrë të paturpshme, se gjoja largimin e specialistëve sovjetikë të naftës e kishte kërkuar jo pala sovjetike, por ministri i minierave dhe i gjeologjisë të Republikës Popullore të Shqipërisë, Adil Çarçani. Me sa duket, pala sovjetike, duke ndjerë përgjegjësinë e rëndë që merrte përsipër me këtë masë të njëanshme, në dëm të një shteti tjetër socialist, u mundua gjatë kësaj kohe të krijonte pretekste pa bazë për të justifikuar ve-

primin e saj të padrejtë. Dhe tani një shpifje të tillë të trilluar me porosi nga një element provokator si Gonçarovi, Qeveria Sovjetike nuk ngurron ta përdorë si «argument» për të justifikuar jo vetëm masën e njëanshme për largimin e 26 specialistëve të naftës, por edhe vendimin tjetër të saj të njoftuar me notën e lartpërmendur të 24 prillit për të mos dërguar specialistë të rinj në Shqipëri dhe për të mos zgatur afatin e qëndrimit të specialistëve sovjetikë që në atë kohë punonin në vendin tonë.

Vlen të theksohet se qysh më 25 prill në mëngjes, domethënë vetëm disa orë pas dorëzimit të notës së lartpërmendur në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Republikës Popullore të Shqipërisë, me porosi të Ambasadës Sovjetike, afro 50 specialistë lanë punën dhe muarën urdhër nga ajo për t'u larguar menjëherë nga Shqipëria dhe disa prej tyre u dhanë qendrave ku punonin vetëm një paralajmërim prej dy orësh. Brenda disa ditësh, pa pritur as përgjegjen e Qeverisë Shqiptare, u tërhoqën pothuaj të gjithë specialistët sovjetikë, bile edhe nga ata të cilëve nuk u kishte mbaruar afati i qëndrimit në Shqipëri, duke lënë edhe për një kohë vetëm grupin e specialistëve të hartës gjeologjike dhe këtë me qëllim që të bëheshin orvatje të tjera për të krijuar incidente që të mund të përdroreshin nga pala sovjetike kundër palës shqiptare, siç e dëshmon nota sovjetike e 27 majit 1961. A mund të konsiderohen normale dhe miqësore mënyra të tilla veprimi?

Është rasti të vihet në dukje se specialistët sovjetikë ishin në shërbim të shtetit shqiptar, të paguar nga ai për të kryer detyra të caktuara me marrëveshje dhe kontrata të rregullta. Pavarësisht nëse u kishte mbaruar ose jo afati i qëndrimit në Shqipëri, ata vazhdonin të punonin, prandaj rregullat më elementare kërkonin që ata të dorëzonin punën e kryer siç duhet dhe siç ju kërkuar zyrtarisht ambasadorit sovjetik në Tiranë nga Qeveria Shqiptare më 26 prill 1961, të jepnin raport të rregullt mbi këtë, të shfaqnin pikëpamjet dhe rekomandimet e tyre për vazhdimin e punës së lënë në mes prej tyre, punë që duhej të kryhej nga ata. Ky është minimumi që mund të pretendohet në raste të tilla. Por kjo nuk u bë dhe shumica dërmuese e specialistëve sovjetikë u hoqën nga Shqipëria pa dorëzuar rregullisht punën e tyre. Veprime të tilla, aspak normale, jo vetëm nuk mund të ngjasin në marrëdhënjet midis vendeve socialiste, por janë e pakta që mund të thuhet edhe të çuditshme.

Kështu qëndron e vërteta. Tërheqjen e specialistëve sovjetikë nga Shqipëria e vendosi vetë Qeveria Sovjetike, për qëllime të caktuara, të huaja me karakterin e marrëdhënjeve midis vendeve socialiste, të dëmshme për miqësinë shqiptaro-sovjetike dhe në kundërshtim me parimet e Deklaratës së Moskës të 81 partive komuniste dhe punëtore të vitit 1960, duke thurur njëkohësisht një

sërë trillimesh fantastike dhe pa asnjë bazë kundër Qeverisë Shqiptare.

Por veprimet arbitrare të Qeverisë Sovjetike kundrejt Republikës Popullore të Shqipërisë nuk u ndalën me kaq. Ata vazhduan edhe më tutje. Në letrën e saj të 26 prillit Qeveria Sovjetike deklaroi: «Është e kuptueshme që udhëheqja shqiptare nuk mund të shpresojë më tutje se Bashkimi Sovjetik do ta ndihmojë atë mbi bazën e mëparshme, ndihmë të cilën kanë të drejtë ta marrin vetëm miqtë dhe vëllezërit e vërtetë».

Ne e themi sinqerisht, për ne është e paimagjinueshme se si një deklaratë e tillë mund të gjejë vend në një dokument zyrtar të Qeverisë Sovjetike drejtuar qeverisë së një shteti tjetër socialist. Qeveria Sovjetike e njeh shumë mirë fuqinë ekonomike të Republikës Popullore të Shqipërisë, ajo e di fare mirë sa nevojë ka populli shqiptar për ndihmën internacionaliste të vendeve vëllezër dhe në radhë të parë të Bashkimit Sovjetik, për ndërtimin e socializmit. Duke dëgjuar një deklaratë të tillë menjëherë të lindin pyetjet: Mos vallë udhëheqësit sovjetikë, duke prerë ndihmat për Shqipërinë kërkojnë të pengojnë ndërtimin e socializmit në këtë vend? Mos vallë ata popullin shqiptar, i cili kurdoherë ka qenë, është dhe do të jetë mik me besë i popujve sovjetikë dhe i Partisë së Leninit, nuk e konsiderojnë më as mik as vëlla, por armik, kundër të cilit duhet vendosur blokada ekonomike? Mos vallë miq e vëllezër të vërtetë të Bashkimit Sovjetik, simbas mendimit të disa udhëheqësve sovjetikë, janë udhëheqës të tillë si Nehru, Nasution, Tito etj.?

Ne nuk jemi kundër ndihmës që u jep Bashkimi Sovjetik vendeve të pavarura josocialiste, përkundrazi këtë e konsiderojmë të drejtë dhe të dobishme, por për popullin tonë, për popullin sovjetik dhe për gjithë popujt e vendeve të tjera socialiste do të jetë e pakuptueshme se përse i pritet ndihma Shqipërisë socialiste dhe i jepet me të dy duart ndihmë borgjezisë indiane dhe Nehruit që provokojnë Republikën Popullore të Kinës për llogari të imperializmit amerikan dhe persekutojnë komunistët indianë, u jepet ndihmë në të gjitha fushat edhe shumë përfaqësuesve të tjerë të borgjezisë që më se një herë janë ngritur kundër Bashkimit Sovjetik, kundër komunistëve.

Shpifjet kundër udhëheqjes shqiptare nuk e mbulojnë dot faktin se udhëheqja sovjetike në marrëdhënjet e saja me Shqipërinë e vogël i lejon vetes qëndrime dhe veprime që nuk mund të quhen marksiste. Shqipëria vërtet është një shtet i vogël, Partia e Punës e Shqipërisë vërtet është një parti e vogël, populli shqiptar vërtet është një popull i vogël, por V.I. Lenini, Partia Bolshevike dhe marksizëm-leninizmi na kanë mësuar se të gjitha vendet, të gjitha partitë, të gjithë popujt janë të barabartë dhe sjellin secili kontributin e vet në zhvillimin e shoqërisë. Kjo është e vërtetë si-

domos në radhët e familjes së vendeve socialiste dhe të lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare.

Me modestinë më të madhe, por dhe me vendosmëri, ne i themi udhëheqjes sovjetike se ajo, duke u orvatur që ta trajtojë popullin shqiptar, Partinë dhe qeverinë e tij nga të tilla pozita të huaja për marksizmin, jo vetëm e ka të humbur davanë, sepse as na tremb, as na nënshtron dot, por duke vepruar në këtë mënyrë, ajo u vë kazmën parimeve bazë të unitetit midis vendeve socialiste dhe lëvizjes komuniste botërore, u vë kazmën parimeve dhe idealeve që frymëzojnë popujt e botës, të cilët në marrëdhënjet midis vendeve socialiste kanë të drejtë të shikojnë tiparet e botës së ardhshme.

Ne jemi të bindur se populli sovjetik dhe popujt e vendeve të tjera vëllezër, Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik dhe partitë komuniste e punëtore të vendeve të tjera, kur të mësojnë të vërtetën, do të aprovojnë qëndrimin tonë dhe jo tuajin. Ndërgjegjja jonë është e pastër dhe e qetë dhe, sado përpjekje që të bëhen nga kushdo qoftë për të errësuar dhe shtrembëruar qëndrimin konsekuent marksist-leninist të Partisë, qeverisë dhe të popullit tonë si dhe miqësinë dhe unitetin tonë me Bashkimin Sovjetik, Partinë Komuniste dhe popullin sovjetik si dhe me popujt dhe vendet e tjera vëllezër, e vërteta do të dalë në shesh. Partia e Punës e Shqipërisë dhe Qeveria Shqiptare për çdo veprim apo pikëpamje të tyre mbajnë çdo përgjegjësi përpara popullit shqiptar dhe përpara opinionit të gjithë lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare, por udhëheqja sovjetike me veprime të tilla nuk mund të përgjigjet me ndërgjegje të qetë as përpara popullit shqiptar dhe popullit sovjetik, as përpara lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare.

Në letrën e lartpërmendur të Qeverisë Sovjetike si dhe në një sërë dokumentash të tjerë zyrtarë sovjetikë, përpara dhe pas datës 26 prill 1961, një vend i posaçëm i kushtohet gjendjes në bazën ushtarako-detare të Vlorës. Nën dritën e ngjarjeve dhe të këtyre dokumentave, njeriu krijon përshtypjen se ato personalitete udhëheqëse sovjetike që kanë hartuar politikën e keqësimit të marrëdhënjeve me Republikën Popullore të Shqipërisë dhe Partinë e Punës të Shqipërisë, çështjen e bazës së Vlorës e kanë zgjedhur si hallkën kryesore të zinxhirit të veprimeve të gabuara, të presioneve dhe padrejtësive ndaj vendit dhe Partisë sonë, për të nënshtruar udhëheqjen e Partisë dhe të shtetit në Shqipëri, për të krijuar tension edhe në fushën e marrëdhënjeve ushtarake midis dy vendeve tona.

Edhe në këtë drejtim duket sheshit se pala sovjetike vepron në bazë të një vije të caktuar me ndërgjegje qysh me parë. Dihet se qysh në tetor të vitit 1960, pra akoma pa «lindur» të ashtuquajturat «incidente» në bazën e Vlorës që përmenden në letrën e Qe-

verisë Sovjetike të 26 prillit 1961 mareshali Greçko i deklaroi shefit të Shtatmadhorisë së Ushtrisë sonë Popullore se «Ju më për më jeni në Traktatin e Varshavës», gjë që tregon se mareshali Greçko qysh atëhere e paska ditur se si do të zhvilloheshin ngjarjet e «incidentet», e se do të krijohen «situata të padurueshme» për ushtarake sovjetikë në Shqipëri, gjë që do të detyronte Qeverinë Sovjetike për të tërhequr bazën e Vlorës! Dhe fajin e përgjegjësive për këtë, pa dyshim, do ta ketë pala shqiptare (!). A nuk është si shumë i çuditshëm ky parashikim?

Por le të shohim faktet.

Partia e Punës e Shqipërisë dhe Qeveria Shqiptare, duke u nisur nga fakti se Republika Popullore e Shqipërisë, si pjesëtare e kampit socialist dhe e Traktatit të Varshavës, ka një pozitë të veçantë gjeografiko-strategjike dhe se mbrojtja e saj është pjesë e pandarë e mbrojtjes së integritetit të kampit socialist, i kanë kushtuar kurdoherë kujdes të veçantë çështjes së mbrojtjes, duke mos kursyer për këtë qëllim as njerëzit, as mjetet. Në këtë drejtim, Bashkimi Sovjetik na ka dhënë një ndihmë të çmuar, goftë në teknikë dhe materiale, goftë në përgatitjen e kuadrove të Ushtrisë sonë Popullore dhe kjo ndihmë nuk mund të llogaritet me shifra, siç bën Qeveria Sovjetike në letrën e saj, ajo ka qenë shprehje e bashkëpunimit internacionalist midis vendeve tona dhe u është përgjegjur më së miri interesave të mbrojtjes së Republikës Popullore të Shqipërisë si dhe interesave të mbrojtjes të të gjithë kampit tonë. Ne, jo vetëm e kemi vlerësuar lart dhe me mirënjohje vëllazërore këtë ndihmë dhe e kemi përdorur shumë mirë për qëllimet e caktuara të përbashkëta, por e kemi konsideruar dhe e konsiderojmë të domosdoshme vazhdimin e saj si dhe bashkëpunimin e plotë të forcave të armatosura të të dy vendeve tona socialiste, miq dhe aleatë, pjesëtarë të Traktatit të Varshavës.

Por edhe në fushën e marrëdhënjeve ushtarake, qysh pas Mbledhjes së Bukureshtit të qershorit 1960, filloi ndryshimi i qëndrimit të udhëheqësve sovjetikë ndaj Ushtrisë sonë Popullore. Qysh atëhere efektivisht filloi prerja e furnizimeve ushtarake, goftë në armatime, goftë në materiale të tjera. Në gushtin e vitit 1960 ishte planifikuar dhe bile njoftuar zyrtarisht se do të vinin në Shqipëri një pjesë armatimesh, por ato nuk kanë ardhur as sot e kësaj dite. Në gusht-shtator të vitit 1960 do të bëhej dorëzimi teknik i dy nëndetseve ekipazheve shqiptare, të cilët simbas planit dhe marrëveshjeve të përbashkëta ishin përgatitur plotësisht për një gjë të tillë me ndihmën dhe nën drejtimin e instruktorëve sovjetikë, por as kjo nuk u bë. Në tremujorin e tretë korrik-shtator, të vitit 1960 si çdo vit dhe konform marrëveshjeve ekzistuese, duhej të vinin në Shqipëri pajisjet e planifikuara për Ushtrinë Popullore të Shqipërisë, por as sot e kësaj dite ato nuk kanë ardhur. Në atë kohë, d.m.th. para nëntorit 1960 përçarjeve të palës

shqiptare për të ditur arësytet e mosplotësimit të detyrimeve të mësipërme nga pala sovjetike i janë dhënë nga autoritetet përkatëse sovjetike përgjegje të tilla: «për arësytet teknike», «janë duke u ngarkuar», «do të marrim masa» etj., etj. Natyrisht, për ne ishin të qarta «arësytet teknike» që shtynin udhëheqësit sovjetikë të vepronin në një mënyrë të atillë ndaj Shqipërisë e Ushtrisë Shqiptare.

Është fare e qartë se edhe në fushën e marrëdhënjeve ushtarake qëndrimi ishte përcaktuar me kohë dhe është përdorur e përdoret vetëm si mjet presioni kundër Partisë dhe popullit tonë, për shkak të mosmarrëveshjeve që u shfaqën në Mbledhjen e Bukureshtit 1960. Kjo tregon se të gjitha veprimet e fundit të Qeverisë Sovjetike, siç janë prerja e ndihmës dhe e furnizimeve të tjera ushtarake, dhënja e të cilave është gjykuar e domosdoshme edhe nga Komanda e Bashkuar e Traktatit të Varshavës, si dhe likuidimi i njëanshëm i bazës së Vlorës, jo vetëm janë të padrejta dhe nuk kanë lidhje aspak me «faktet» e «incidentet» e trilluara me qëllim të keq nga disa të pandërgjegjshëm e provokatorë, të cilëve fatkeqësisht ju zë besë edhe Qeveria Sovjetike, por edhe fyese, sepse janë shprehje mosbesimi ndaj forcave të armatosura të një vendi socialist pjesëtar i Traktatit të Varshavës.

Duke u nisur nga qëllimet e miqësisë dhe të unitetit, si dhe nga dëshira për të rritur akoma më shumë aftësinë mbrojtëse të Republikës Popullore të Shqipërisë dhe të mbarë kampit socialist, Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë mori iniciativën për krijimin e bazës ushtarake-detare të Vlorës. Kjo iniciativë u mirëprit dhe u aprovua nga Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe midis dy qeverive tona, për këtë qëllim, u nënshkruan marrëveshja e 12 shtatorit 1957 dhe marrëveshja e 3 majit 1959. Mbi bazat e këtyre marrëveshjeve, në saje të punës së madhe e vetëmohuese të njerëzve tanë dhe të njerëzve sovjetikë, u ndërtua baza ushtarake-detare e Vlorës, e cila u bë një pikëmbështetje e fuqishme për mbrojtjen e Republikës Popullore të Shqipërisë, si dhe të vendeve të tjera pjesëtare të Traktatit të Varshavës dhe të mbarë kampit socialist në zonën e rëndësishme të Mesdheut. Ajo u bë një tjetër hallkë për forcimin e mëtejshëm të miqësisë së pathyeshme midis popujve vëllazërorë shqiptarë dhe sovjetikë.

Republika Popullore e Shqipërisë ka bërë të gjitha përpjekjet, duke mos kursyer për këtë qëllim edhe mjetet ekonomike e financiare të rëndësishme, për të kryer plotësisht detyrimet që i takojnë nga marrëveshjet e lartpërmendura për ndërtimin dhe forcimin e bazës ushtarake-detare të Vlorës, si dhe për ngritjen e gatishmërisë së saj luftarake. Në saje të punës së Partisë dhe të qeverisë sonë dhe të përpjekjeve e qëndrimit vëllazëror të natyreshëm të qytetarëve shqiptarë ndaj njerëzve sovjetikë, marinarëve

sovjetikë që, simbas marrëveshjeve në bazën e Vlorës kishin ardhur me cilësinë e instruktorëve pranë Flotës ushtarako-detare shqiptare, u ishin krijuar të gjitha lehtësitë dhe kushtet e përshatshme për punë dhe ata ishin rrethuar me një atmosferë dashurie vëllazërore të vërtetë.

Marrëdhënjet shembëllore midis ekipazheve shqiptare dhe instruktorëve sovjetikë filluan të dëmtohen në gjashtëmuorin e dytë të vitit 1960, për arsye dhe qëllime krejt të huaja me bazën e Vlorës. Nga ana e udhëheqjes sovjetike janë bërë dhe po bëhen përpjekje për t'ja hedhur Partisë dhe qeverisë sonë përgjegjësinë për keqësimin e gjendjes në bazën e Vlorës dhe për këtë qëllim nuk ngurrohet që të trillohen akuza pa baza dhe shpifje të pahijshme. Ne e kemi deklaruar dhe e përsëritim me keqardhje se i vetmi burim dhe shkak i ndryshimit të gjendjes në bazën e Vlorës është ndryshimi i qëndrimit të udhëheqjes sovjetike ndaj Partisë dhe qeverisë sonë, pas Mbledhjes së Bukureshtit të qershorit 1960.

Vlen të theksohet se, që me sinjalizimin e parë të keqkuptimeve dhe incidente artificiale të krijuara nga disa oficerë sovjetikë, të dërguar posaçërisht pas qershorit 1960, Komanda shqiptare në bazën e Vlorës dhe Ministria e Mbrojtjes Popullore e Republikës Popullore të Shqipërisë ndërhyjnë pranë organeve kompetente sovjetike që të mos përsëriteshin veprime të tilla, ndërsa, pavarësisht nga çka mund të pretendohet nga organizatorët dhe krijuesit e mosmarrëveshjeve dhe të incidenteve në bazën e Vlorës, nga ana e efektivit shqiptar nuk është krijuar asnjëherë as incidenti më i vogël dhe me durim, gjakftohtësi dhe frymë të lartë shoqërore janë sprapsur të gjitha rastet provokuese.

Zhvillimi i ngjarjeve tashmë e ka bërë të qartë se masat e ndryshme jomiqësore të marra nga Qeveria Sovjetike për të keqësuar gjendjen në bazën e Vlorës kanë pasur si objektiv të fundit likuidimin e saj për qëllime të caktuara, duke u përpjekur në të njëjtën kohë të krijohen pretekste për t'ja hedhur fajin për këtë Qeverisë Shqiptare dhe për të justifikuar në këtë mënyrë në sytë e popullit sovjetik dhe të vendeve të tjera socialiste vendimin arbitrar dhe të dënueshëm për likuidimin e bazës së Vlorës.

Është interesant të vihet në dukje se, ndërsa në letrën e 26 prillit, si dhe në promemorianet dhe notat e mëvonshme të Qeverisë Sovjetike, theksohet me të madhe se gjendja në bazën e Vlorës kohët e fundit po bëhet e padurueshme për faj të palës shqiptare, «faktet» që paraqiten për të mbështetur një pretendim të tillë, në shumicën e tyre, ose jepen pa datë ose i përkasin periudhës së fundit të vitit të kaluar dhe disa tremujorit të parë të këtij viti të ngritura më parë dhe për të cilat është dhënë përgjegje e plotë me promemorian datë 22 mars 1961 që Kryetari i Këshillit të Ministrave të Republikës Popullore të Shqipërisë, shoku Mehmet Shehu, i dorëzoi përfaqësuesit të Komandës së Bashkuar

të Traktatit të Varshavës në Shqipëri, gjeneral-kolonel A. M. Andrejevit, me porosi që përmbajtjen e saj t'ja njoftonte Qeverisë Sovjetike, prandaj nuk na duket e nevojshme që të kthehemi përsëri në to.

Të tërheq vëmendjen fakti se, në përpjekjet për të krijuar argumenta kundër ekipazheve dhe komandantëve shqiptarë, arrihet deri sa të deformohen ngjarjet dhe faje të rënda të shkaktuara nga pjesëtarë të personelit sovjetik në bazën e Vlorës t'u atribuohen ekipazheve shqiptare. Tipik në këtë drejtim është rasti i incidentit që ka ndodhur më 30 prill 1961 në nëndetësen shqiptare 196: roja sovjetike në këtë nëndetëse, kapter Trofimenko, në bazë të udhëzimit të dhënë personalisht nga instruktori sovjetik në këtë nëndetëse, kapiten i rangut III, Kllaponov dhe nga zëvendëshefi i sigurimit, kapiten-leitnant Finin, kërcënoi me automatik zëvendëskomandantin e nëndetëses, togerin shqiptar B. Gerbi, si dhe efektivin shqiptar të anijes. Për këtë ngjarje të rëndë që mund të kishte pasur rrjedhime serioze sikur komandanti dhe efektivit shqiptar të mos kishin ruajtur gjakftohtësinë, u thirr ambasadori sovjetik në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Republikës Popullore të Shqipërisë dhe ju kërkua të merrte masa që të mos përsëriteshin incidente të tilla me shumë përgjegjësi. Në vend që të vepronte si më sipër, Ambasada Sovjetike, duke e deformuar ngjarjen, çlisa ditë më vonë e ngriti pa gjë të keq këtë rast si shembull për të akuzuar ekipazhin shqiptar për qëndrim jomiqësor ndaj instruktorëve sovjetikë!

Qeveria Shqiptare, nuk ka lejuar që nga ana e organeve dhe personelit shqiptar të shkaktohet keqkuptimi ose incidenti më i vogël që mund të dëmtonte marrëdhënjet midis ekipazheve shqiptare dhe instruktorëve sovjetikë në bazën e Vlorës, ose të cënonte sado pak gatishmërinë luftarake të kësaj të fundit, por në të kundërtën ka marrë të gjitha masat dhe ka bërë të gjitha përpjekjet që vareshin prej saj për forcimin e gjendjes dhe të gatishmërisë luftarake të bazës së Vlorës, në përputhje me marrëveshjet në fuqi, me miqësinë shqiptaro-sovjetike, me interesat e larta të përbashkëta. Këtë qëndrim të saj të drejtë, konsequent qeveria jonë e ka treguar me vepra, e ka bërë shumë të qartë edhe me promemorian e lartpërmendur të 22 marsit 1961, në mbledhjen e fundit të Komitetit Politik Konsultativ të Traktatit të Varshavës, në letrën e saj të 5 prillit 1961 drejtuar qeverive të vendeve socialiste, si dhe në Komisionin e përbashkët shqiptaro-sovjetik për evakuimin e forcave ushtarako-detare sovjetike nga baza e Vlorës dhe që zhvilloi punimet e tij në Tiranë më 22-25 maj 1961. Ne jo vetëm kemi vërtetuar se sa pa themel dhe tendencioze janë akuzat që na bëhen, por edhe se si është krijuar nga ana sovjetike gjendja e rëndë në bazën e Vlorës dhe kemi theksuar me këmbëngulje se, për shkak të ndalimit nga ana e Qeve-

risë Sovjetike të furnizimeve të nevojshme dhe të parashikuara nga marrëveshjet, u ul dhe u dëmtua gatishmëria luftarake e bazës.

Partia dhe qeveria jonë kanë qenë gjithmonë të bindura se, në qoftë se nga pala sovjetike nuk do të ishin krijuar me dashje incidente të ndryshme të padëshirueshme dhe do të ishin zbatuar me përpikmëri edhe nga ajo marrëveshjet e 12 shtatorit 1957 dhe të 3 majit 1959, gjendja në bazën e Vlorës do të kishte vazhduar të ishte plotësisht normale. Por, me sa duket, disa udhëheqës sovjetikë kishin qëllime të tjera. Këto u bënë akoma më të qarta në Mbledhjen e Komitetit Politik Konsultativ të Traktatit të Varshavës, që u mbajt në Moskë më 28-29 mars 1961. Sikundër dihet, objekt kryesor i kësaj mbledhjeje nuk u bënë çështjet me shumë rëndësi që ishin në rendin e ditës, por akuzat tendencioze kundër Republikës Popullore të Shqipërisë dhe orvatjet për ta dënuar atë, duke adoptuar për këtë qëllim edhe një vendim që do të mbetet si një akt i errët në analet e Organizatës së Traktatit të Varshavës. Me këtë vendim të padrejtë dhe të pabazuar i kërkohet Qeverisë Shqiptare në formë ultimatum, që, ose të pranonte që shqiptarët të largoheshin nga baza e Vlorës dhe kjo të vihej vetëm në duart e ekipazheve sovjetike dhe të një komande unike sovjetike, ose Qeveria Sovjetike do të procedonte në likuidimin e bazës. Autorët dhe përkrahësit e këtij vendimi përlules për një shtet sovran e të pavarur, e dinin mirë se ai ishte i papranueshëm për Qeverinë Shqiptare, sepse ai është i papajtueshëm me marrëveshjet në fuqi, me parimet e Traktatit të Varshavës dhe me parimet marksiste-leniniste, që janë në themel të marrëdhënjeve midis shteteve socialiste, në dëm të Republikës Popullore të Shqipërisë, të Bashkimit Sovjetik dhe të gjithë kampit socialist. Ai u paraqit dhe u aprovua vetëm për të acaruar më tej qëndrimin jomiqësor të adoptuar nga udhëheqja sovjetike ndaj vendit dhe Partisë sonë dhe për të krijuar pretekstin «legal» për likuidimin e bazës së Vlorës.

Është për të ardhur keq që, në këtë mbledhje kaq të rëndësishme, sekretari i parë i Komitetit Qendror të Partisë Komuniste dhe kryetari i Këshillit të Ministrave të Bashkimit Sovjetik, N.S. Hrushov, me qëllim sensacioni dhe për të nxitur artificialisht ndjenjat, përdori si argument, duke u larguar nga realiteti rastin e policit shqiptar që, në bazën e Vlorës, simbas rregullit dhe si gjithë të tjerëve, u kërkoi letër njoftimin 5 grave sovjetike dhe as «i talli», as i «përzuri nga autobuzi», si pretendohet edhe në letrën e 26 prillit, por i lejoi të udhëtonin pasi i këshilloi që herë tjetër për udhëtime të pajiseshin me letër njoftimi. Në letrën e saj të 26 prillit Qeveria Sovjetike thotë se, sikur këtë fakt ta merrnin vesh njerëzit sovjetikë, do të ishte e vështirë për të t'ua shpjegonte këtë sjellje të zyrtarëve shqiptarë. Por edhe ne nuk mund të mos na

lind pyetja: në qoftë se do të mësonin të vërtetën rreth kësaj ngjarjeje, ç'do të mendonin dhe si do ta gjykonin njerëzit sovjetikë qeverinë e tyre që një rast të tillë të zakonshëm, dhe sa të tjera të trilluara, i vë në balancë me ruajtjen e bazës së Vlorës, me ruajtjen e marrëdhënjeve me një shtet tjetër socialist?

Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë, siç e ka shpjeguar edhe në letrën e saj të 5 prillit 1961, si dhe në raste të tjera, ka qenë kurdoherë e pikëpamjes se e vetmja rrugë e drejtë e normalizimit të gjendjes në bazën e Vlorës dhe e ngritjes së aftësisë së saj luftarake ka qenë zbatimi i përpiktë i marrëveshjeve të 12 shtatorit 1957 dhe të 3 majit 1959, në bazë të të cilave të gjitha llojet e anijeve dhe mjeteve të tjera luftarake, të vendosura në gjirin e Vlorës, t'u dorëzoheshin ekipazheve shqiptare. Në fakt, në saje të punës së madhe të bërë në këtë drejtim, me përkrahjen edhe të instruktorëve sovjetikë, ekipazhet shqiptare tani kanë fituar të gjitha aftësitë tekniko-organizative për t'i përdorur këto mjete. Me largimin gradualisht, në bazë të marrëveshjeve ekzistuese, të personelit sovjetik, i cili i gjithë kishte ardhur në bazën e Vlorës me cilësinë e instruktorëve, nuk do të cënohej aspak gatishmëria e bazës; flota ushtarako-detare shqiptare do të kryente më së miri detyrat e saja në interesin e mbrojtjes së Republikës Popullore të Shqipërisë, të Bashkimit Sovjetik dhe të gjithë kampit socialist. . . Baza e Vlorës do të shërbejë kurdoherë si avanpost në prapavijat e armikut për mbrojtjen e përbashkët të kampit socialist. Ne kështu e kuptojmë detyrën tonë internacionaliste dhe kështu do të veprojme në rast nevojë, pavarësisht se ç'mendojnë e ç'bëjnë të tjerët. Pikëpamja e drejtë e Partisë dhe e qeverisë sonë lidhur me bazën e Vlorës u theksua edhe në letrën e Qeverisë Shqiptare të 8 majit 1961, drejtuar Qeverisë Sovjetike, edhe në punimet e Komisionit të përbashkët shqiptaro-sovjetik mbi evakuimin e forcave ushtarako-detare sovjetike nga baza e Vlorës.

Por udhëheqja e Bashkimit Sovjetik, duke mos përfillur propozimet tona të drejta dhe duke shkelur hapët marrëveshjet e lartpërmendura, me letrën e 26 prillit të Qeverisë Sovjetike, njoftoi qëndrimin e saj të vendosur për likuidimin e bazës ushtarako-detare të Vlorës, duke marrë kështu përsipër përpara popullit shqiptar, popullit sovjetik dhe popujve të tjerë të kampit socialist një përgjegjësi historike shumë të rëndë.

Për të justifikuar këtë veprim të rrezikshëm dhe shkeljen brutale të marrëveshjeve në fuqi, Qeveria Sovjetike mundohet më kot të mbështetet në argumentin e trilluar prej saj se paskan ndërruar kushtet, pra, paskan rënë nga fuqia edhe marrëveshjet e 12 shtatorit 1957 dhe të 3 majit 1959. Sipas këtij pretendimi, fund e krye pa bazë, duke akuzuar Qeverinë Shqiptare dhe Partinë e Punës të Shqipërisë se gjoja tani këto ndjekin një politikë jomiqësore ndaj Bashkimit Sovjetik, arrihet në konkluzionin se

kështu nuk ekziston më baza mbi të cilën ndërtohej më parë bashkëpunimi ushtarak midis dy vendeve tona, pra edhe baza mbi të cilën mbështeteshin marrëveshjet në lidhje me bazën ushtarako-detare të Vlorës. Jo vetëm kaq, por Qeveria Sovjetike nuk ngurron të shkojë edhe më larg në këtë drejtim dhe të shtyjë akoma më tej, jashtë çdo logjike dhe baze juridike, argumentimin e saj të paqëndrueshëm, duke afirmuar se është Qeveria Shqiptare që paska shkelur marrëveshjet mbi bazën e Vlorës. Bile në notën e Qeverisë Sovjetike të 3 qershorit, me cinizëm të pafshehur thuhet, se meqë nuk mori parasysh vendimin e Komitetit Politik Konsultativ të Traktatit të Varshavës, «Qeveria Shqiptare kaloi me vetëdije në rrugën e likuidimit të bazës ushtarako-detare të Vlorës».

Kjo është me të vërtetë një logjikë e çuditshme. Ne e kuptojmë se sa të vështirë e ka udhëheqja sovjetike të pranojë dhe të justifikojë përgjegjësinë për veprime kaq të rënda siç është likuidimi i bazës së Vlorës, por nuk mund të pranojmë kurrsesi dhe i hedhim poshtë këto orvatje absurde për t'ja hedhur fajin atij që s'e ka, për të ngarkuar me përgjegjësi Partinë dhe qeverinë tonë, «faji» i vetëm i të cilave është qëndrueshmëria në vijën e miqësisë e të unitetit me Bashkimin Sovjetik, në respektimin e marrëveshjeve mbi bazën e Vlorës dhe të detyrimeve ndaj Traktatit të Varshavës dhe kampit socialist, në zbatimin besnik të Deklaratës së Moskës të vitit 1960. Në rast se udhëheqja sovjetike nuk është dakord me këtë qëndrim konsekuent të patundur të Partisë dhe qeverisë sonë dhe në rast se ajo vetë ka ndryshuar qëndrimin e saj në këto çështje themelore, përsëri kjo nuk mund të shërbejë si bazë as nga ana politike, as nga ana morale dhe juridike që të hedhë poshtë në mënyrë të njëanshme marrëveshjet shqiptaro-sovjetike mbi krijimin e bazës ushtarako-detare të Vlorës.

Argumentimi që parashtrohet në letrën e lartpërmendur të Qeverisë Sovjetike, nuk ka asnjë bazë juridike, është në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare dhe me parimet më elementare të marrëdhënjëve midis shteteve socialiste. Vendimi i Qeverisë Sovjetike për të mos plotësuar detyrimet e saj në lidhje me bazën ushtarako-detare të Vlorës, për të mos njohur marrëveshjet përkatëse dhe për të likuiduar bazën e Vlorës, përbën, pra, një shkelje të hapur të angazhimeve të saj dhe një anullim të paligjshëm të marrëveshjeve në fjalë.

Përveç kësaj, Qeveria Sovjetike, pa asnjë bazë, me qëllim dëmtimi të aftësisë mbrojtëse të Republikës Popullore të Shqipërisë dhe acarimi të mëtejshëm të marrëdhënjëve midis dy vendeve, duke kërkuar evakuimin e forcave ushtarako-detare sovjetike nga baza e Vlorës, ngriti pretendimin që të tërhiqte të gjitha anijet e çdo lloji, të gjitha pajisjet, teknikën dhe materialet e ardhura në bazën e Vlorës, në përputhje me marrëveshjet e 12 shta-

torit 1957 dhe të 3 majit 1959. Qeveria Shqiptare, që me letrën e 8 majit 1961, e bëri të qartë qëndrimin e saj në këtë çështje.

Në bazë të marrëveshjeve të përfunduara midis dy vendeve, datë 12 shtator 1957 dhe datë 3 maj 1959, të gjitha luftanijet dhe mjetet e tjera detare që kanë ardhur në bazën e Vlorës i janë dhënë falas Republikës Popullore të Shqipërisë (neni 3 paragrafi 4, marrëveshja datë 12 shtator 1957 dhe neni 2 paragrafi 1 i marrëveshjes datë 3 maj 1959). Të gjitha mjetet detare në fjalë kanë kaluar në pronësi të shtetit shqiptar që me mbërritjen e tyre në Shqipëri dhe për këtë qëllim janë nënshkruar midis dy palëve dokumentat përkatës të rregullt. Prandaj, përsa u përket mjeteve detare marrëveshjet e kanë kryer efektin e tyre, këto mjete kanë kaluar tashmë në pronësi të shtetit shqiptar, kjo është një gjë e kryer, e mbaruar.

Në bazë të marrëveshjeve të lartpërmendura dhe të rregullores së bazës së Vlorës, datë 3 gusht 1959, i gjithë personeli sovjetik qëndronte në bazën e Vlorës me cilësinë e instruktorëve.

Është pra e qartë, në bazë të dispozitave të marrëveshjeve të përfunduara më sipër, se të gjitha mjetet detare të bazës së Vlorës janë pronë e Republikës Popullore të Shqipërisë dhe çdo kontestim në këtë drejtim është krejt pa bazë dhe në kundërshtim të hapët me marrëveshjet ekzistuese dhe me dokumentat e tjerë përkatës të rregullt. Si rrjedhim, pretendimi i Qeverisë Sovjetike për tërheqjen nga baza e Vlorës e cilësdo nga anijet e lartpërmendura dhe e çdo mjeti tjetër detar është i padrejtë, arbitrar dhe në kundërshtim flagrant me marrëveshjet e nënshkruara midis dy qeverive. Pala shqiptare jo vetëm hedh poshtë protestën pa asnjë bazë të Qeverisë Sovjetike, bërë për këtë çështje në notën e saj të 3 qershorit 1961, por indinjohet thellësisht nga akuzat dhe termat provokuese që përdoren në këtë notë, duke shpifur gjoja se Qeveria Shqiptare «ka pushtuar» mjetet sovjetike duke kryer «veprime pirateske» etj. Neve nuk na lejon respekti që kemi për veten tonë dhe për Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik që t'u përgjigjemi këtyre fyerjeve me fjalët që meritojnë.

Qeveria Shqiptare, për hir të miqësisë së përjetshme midis popullit shqiptar dhe popujve të Bashkimit Sovjetik, i bëri të ditur Qeverisë Sovjetike, me letrën e datës 8 maj 1961, se nuk do të kundërshtonte që mjetet detare, në të cilat shërbimi kryhej akoma nga ekipazhe sovjetike me cilësinë e instruktorëve — konkretisht tetë nëndetëse dhe baza lundruese «Kotelnikov» — të largoheshin nga baza ushtarako-detare e Vlorës, në të njëjtën kohë duke mos hequr dorë aspak nga e drejta e pronësisë legjitime mbi këto mjete.

Siç dihet, në vijim të propozimit të Qeverisë Shqiptare, bërë me të njëjtën letër të 8 majit dhe që gjeti aprovimin e Qeverisë Sovjetike, prej 22-25 maj 1961 zhvilloi punimet në Tiranë Komi-

sioni i përbashkët i përbërë nga përfaqësuesit e plotfuqishëm të të dy qeverive, për të caktuar modalitetet në lidhje me evakuimin e forcave ushtarake-detare sovjetike nga baza e Vlorës.

Me gjithë përpjekjet që bëri delegacioni shqiptar në këtë komision për një zgjidhje të drejtë të çështjes së bazës së Vlorës, në përrputhje të plotë me marrëveshjet përkatëse, duke u dorëzuar ekipazheve shqiptare të gjitha anijet luftarake dhe mjetet detare të ndodhura në bazën e Vlorës, të cilat, siç u tha më lart, janë pronë e pakontestueshme e shtetit shqiptar, delegacioni sovjetik nuk u pajtua me qëndrimin e drejtë të Qeverisë Shqiptare dhe, duke mos hequr dorë nga rruga e shtrembër e likuidimit të bazës, ai njoftoi dëshirën e Qeverisë Sovjetike për tërheqjen e forcave ushtarake-detare sovjetike nga baza e Vlorës ku përfshiheshin si mjetet detare 8 nëndetëse dhe baza lundruese «Kotielnikov» që u përmendën më lart, ndërsa për largimin e personelit që kishin shërbyer si instruktorë pranë ekipazheve shqiptare të grupit të nëndetëseve, ai deklaroi se i duhej të konsultohesh me qeverinë e tij. Në fakt, delegacioni sovjetik preu në mënyrë të njëanshme bisedimet e Komisionit të përbashkët pa mbaruar punë dhe u largua për në Bashkimin Sovjetik. Duke konfirmuar sa kishte thënë në letrën e 8 majit, Qeveria Shqiptare nuk kundërshtoi që 8 nëndetëset dhe baza lundruese «Kotielnikov» të largoheshin, duke kërkuar që të ikte njëkohësisht edhe personeli tjetër sovjetik, mbasi për këta instruktorë nuk ndihej më nevoja në Flotën ushtarake-detare shqiptare. Tetë nëndetëset dhe baza lundruese «Kotielnikov» lanë ujërat shqiptare më 26 maj 1961, ndërsa personeli i instruktorëve u largua më 5 qershor 1961.

Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë dhe Qeveria Shqiptare nuk mund të kalojnë në heshtje se, krahas me këtë veprimtari të etshme të udhëheqjes sovjetike për të likuiduar pa vonesë bazën e Vlorës, nga ana e autoriteteve sovjetike u ndërmuarën edhe disa veprime të tjera provokuese dhe jomiqësore ndaj popullit shqiptar dhe Republikës Popullore të Shqipërisë.

Pas vendimit të parëvokueshëm të Qeverisë Sovjetike për të tërhequr forcat dhe anijet ushtarake-detare nga baza e Vlorës, Qeveria Shqiptare vendosi të thërresë në atdhe, para kohe, të gjithë pjesëtarët e Flotës ushtarake-detare shqiptare, që studjonin në Bashkimin Sovjetik meqenëse përgatitja e tyre e mëtejshme nuk kishte asnjë kuptim. Për këtë qëllim, me autorizim të qeverisë së tij, ish-atasheu ushtarak i Republikës Popullore të Shqipërisë në Bashkimin Sovjetik, gjeneral-major Halim Ramohito, mori kontakt me Ministrinë e Mbrojtjes të Bashkimit Sovjetik dhe kërkoi ndihmën e autoriteteve sovjetike në qendër, ashtu siç e kërkoi edhe në komandat e akademive dhe të shkollave ku studjonin oficerët dhe kursantët shqiptarë. Por në vend të ndihmës që pri-

tej, nga ana e autoriteteve sovjetike u muarën masa të pasqembëllta penguese: në Leningrad kursantët shqiptarë u ndaluan të dilnin jashtë, u izoluan dhe u vunë në survejim të rreptë dhe atsheut tonë ushtarak ju ndalua takimi me ta. Në këtë rrugë pa precedent Qeveria Sovjetike shkoi edhe më tej, duke kërkuar pa asnjë arsye largimin, brenda 24 orëve, nga toka e Bashkimit Sovjetik të gjeneral-major Ramohitos, i cili ka kryer me nder detyrën e tij dhe ka punuar në mënyrë shembëllore për forcimin e vazhdueshëm të miqësisë midis dy ushtrive dhe dy popujve tanë. Vetëm pas kërkesave të përsëritura të Qeverisë Shqiptare, Qeveria Sovjetike pranoi më së fundi të kthejë në Shqipëri oficerët dhe kursantët shqiptarë, por deri në minutën e fundit këta i mbajti të izoluar dhe i ndaloi të merrnin kontakt me Ambasadën e Republikës Popullore të Shqipërisë në BRSS.

Komiteti Qendror i Partisë së Punës dhe Këshilli i Ministrave i Republikës Popullore të Shqipërisë vendimin e udhëheqjes sovjetike për të prishur bazën ushtarake-detare të Vlorës e konsideron si një ngjarje të hidhur në historinë e marrëdhënjeve shqiptaro-sovjetike. Ne kemi të drejtë të themi se, në këto momente, kur nga ana e imperialistëve dhe e shërbëtorëve të tyre komplotohet kundër Republikës Popullore të Shqipërisë dhe kur situata ndërkombëtare është shumë e rëndë, udhëheqja e Partisë Komuniste dhe e Shtetit Sovjetik, e mikut dhe aleatit tonë të fuqishëm e besnik, Bashkimit të Lavdishëm sovjetik, duhej të na nëihmonte për të forcuar akoma më shumë potencialin tonë mbrojtës dhe jo të na e dobësonte këtë potencial dhe të na krijonte situata të rrezikshme, siç bëri me vendimin për të likuiduar bazën ushtarake-detare të Vlorës që mund të përshendetet vetëm nga armiqtë e vendeve tona socialiste. Këto veprime të padrejta që bëhen kundër Shqipërisë, bëhen njëkohësisht kundër gjithë kampit socialist, ato janë në dëm të vetë Bashkimit Sovjetik dhe ngarkojnë me përgjegjësi të madhe ata që i vendosin dhe i kryejnë.

Bindja jonë është se këto veprime të padrejta dhe aspak miqësore të bëra në këto kushte të rrezikshme ndërkombëtare ndaj një vendi të vogël, aleat e vëlla, besnik deri në fund, siç është Shqipëria socialiste, do të kujtohen me hidhërim e keqardhje dhe do të dënohen nga populli sovjetik dhe nga Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik.

Me gjithë vështirësitë serioze që krijon për vendin tonë vendimi i lartpërmendur i Qeverisë Sovjetike, ne deklarojmë se do ta ruajmë bazën e Vlorës me ato mjetet që kemi, do ta bëjmë një bazë të fortë për mbrojtjen e Republikës Popullore të Shqipërisë dhe të kampit socialist në këtë zonë, si pjesëtarë të Traktatit të Varshavës, do të koordinojmë veprimet tona me Komandën e Bashkuar dhe e konsiderojmë gjithashtu të nevojshme të ruaj-

më kontaktet edhe me komandën e Flotës luftarako-detare sovjetike të Detit të Zi.

Përveç organizimit të bllokadës ekonomike e asaj ushtarake në dëm të Republikës Popullore të Shqipërisë, me iniciativën e udhëheqësve të Bashkimit Sovjetik, është organizuar sistematikisht edhe bllokada politike kundrejt Partisë së Punës të Shqipërisë dhe popullit shqiptar.

Partia e Punës e Shqipërisë, që ditën e parë të themelimit të saj, ka edukuar komunistët dhe të gjithë popullin shqiptar me dashurinë më të thellë ndaj Bashkimit Sovjetik, ndaj Partisë dhe popullit të tij të lavdishëm. Çështjen e miqësisë me Bashkimin Sovjetik dhe të mbrojtjes së Bashkimit Sovjetik ajo e ka shtruar kurdoherë si një detyrë internacionaliste dhe jetike për popullin shqiptar dhe Republikën popullore të Shqipërisë. Ashtu si në kohën e Luftës nacional-çlirimtare që nuk kishte trakt, buletin dhe faqe të shtypit ilegal të Partisë sonë dhe fjalim e bisedim të partizanëve dhe komunistëve shqiptarë pa përmendur Bashkimin Sovjetik, ashtu dhe akoma më shumë pas çlirimit të atdheut dhe vendosjes së pushtetit popullor nuk ka pasur dhe nuk ka numër gazete, asnjë fjalim dhe raport zyrtar të udhëheqësve të Partisë e të shtetit tonë në kongrese të Partisë, në mbledhje të Kuvendit Popullor, në kongrese të organizatave të masave dhe në mbledhje publike, asnjë deklaratë të qeverisë sonë mbi çështje të rëndësishme ndërkombëtare në shtyp dhe në konferenca ndërkombëtare, ku të mos jetë folur me dashuri dhe respekt për Bashkimin Sovjetik dhe për realizimet e tij, ku të mos jetë theksuar miqësia dhe uniteti ynë me Bashkimin Sovjetik, ku të mos jetë përkrahur me vendosmëri dhe plotësisht politika e jashtme paqësore e Bashkimit Sovjetik... Në këtë çështje ne nuk nisemi nga ç'mendon e ç'bën kundër vendit dhe Partisë sonë ndonjë udhëheqës sovjetik, por nga pozita internacionaliste, nga interesat e larta të atdheut tonë, të kampit socialist dhe të lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare.

Prandaj, ne i hedhim poshtë shpifjet provokuese që përmban letra e Qeverisë Sovjetike e 26 prillit, se gjoja midis popullit shqiptar zhvillohet një fushatë propagandistike jomiqësore kundrejt Bashkimit Sovjetik. Kuptohet që ndërgjegjja e disa njerëzve, udhëheqës të Bashkimit Sovjetik, të mos jetë e qetë për veprimet e tyre të padrejta ndaj Republikës Popullore të Shqipërisë dhe t'u duket sikur ne zhvillojmë fushatë midis popullit shqiptar, por atyre që guxojnë të trillojnë shpifje të tilla ne kemi të drejtë t'u themi: Nxirrni qoftë edhe një dokument të vetëm ku të jetë thënë diçka jomiqësore nga ana jonë kundrejt Bashkimit Sovjetik.

Atëhere për ç'qëllim bëhen akuza të tilla pa themel? Ato s'mund të bëhen për qëllim tjetër veçse për të gabuar ata që nuk

dinë të vërtetën mbi politikën jomiqësore konsekuente që po ndjek udhëheqja sovjetike ndaj Partisë së Punës të Shqipërisë dhe Republikës Popullore të Shqipërisë që pas Mbledhjes së Bukureshtit të qershorit 1960 dhe për të justifikuar veprime të reja më të rënda në këtë rrugë.

Se si e kuptojmë ne miqësinë me Bashkimin Sovjetik, se si propagandojmë ne për Bashkimin Sovjetik midis popullit shqiptar, se si i luftojmë ne armiqtë e Bashkimit Sovjetik, këtë e provoi edhe një herë më së miri Kongresi IV i Partisë së Punës të Shqipërisë që zhvilloi punimet e tij në shkurt të këtij viti. Kongresi i fundit i Partisë sonë qe një manifestim i shkëlqyer i dashurisë dhe besnikërisë së patundur të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe të mbarë popullit shqiptar ndaj Bashkimit të lavdishëm Sovjetik, Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe popujve sovjetikë, i miqësisë së përjetshme shqiptaro-sovjetike të mbështetur mbi parimet e marksizëm-leninizmit. Të habit fakti që shtypi sovjetik, me përjashtim të ndonjë njoftimi të cunguar, nuk informoi popullin sovjetik për Kongresin e Partisë sonë, ashtu siç bën rregullisht për kongrese të partive motra të vendeve socialiste. Dhe nga ana jonë nuk mund të mos konsiderohet si një akt jomiqësor fakti që udhëheqja sovjetike zyrtarisht ndaloi shpërndarjen në Bashkimin Sovjetik të Raportit mbi aktivitetin e Komitetit Qendor të Partisë së Punës të Shqipërisë, mbajtur në Kongresin IV të Partisë.

Kuptohet se këto nuk bëhen pa qëllime. Ato janë pjesë e një plani të tërë, i cili synon në fillim të errësojë në sytë e popullit sovjetik të vërtetën mbi Republikën Popullore të Shqipërisë, mbi veprimtarinë e Partisë dhe të qeverisë sonë dhe pastaj, kur të jetë përgatitur terreni, të mbillet fara e armiqtësisë ndaj popullit shqiptar, Partisë dhe qeverisë së tij në radhët e popullit sovjetik dhe të opinionit publik ndërkombëtar. Në fakt, puna ka filluar në këtë drejtim.

Nuk është aspak e rastit që, pas Mbledhjes së Bukureshtit, gradualisht në shtypin dhe organet e tjera të propagandës sovjetike filloi të injorohet Republika Popullore e Shqipërisë dhe tani mund të thuhet se është vendosur bllokada e plotë e heshtjes ndaj vendit tonë sikur Shqipëria të mos ekzistonte fare, sikur këtu me djersë e me gjak, në kushte me të vërtetë të rënda, të mos luftonte një popull i vogël, por i patrembur, nën udhëheqjen e Partisë së tij marksiste-leniniste, për ndërtimin e socializmit, për mbrojtjen e kampit socialist dhe të paqes.

Karakteristikë është se organet e shtypit e të radios sovjetike nuk bëjnë zë fare për ngjarje shumë të rëndësishme në vendin tonë siç kanë qenë botimi i projektdirektivave të planit të tretë pesëvjeçar, aktet provokuese nga ana e Jugosllavisë dhe e Greqisë, gjyqi i fundit kundër një grupi tradhëtarësh në shër-

bim të spiunazhit amerikan, jugosllav e grek etj. Bile në shtypin sovjetik nuk ka vend as për të pasqyruar veprimtarinë e madhe që zhvillon vazhdimisht në fushat e ndryshme Shoqata e Miqësisë Shqipëri-Bashkimi Sovjetik. Popullit sovjetik nuk i jepet mundësia të mësojë se me ç'gëzim i ka përshëndetur populli shqiptar realizimet maçhështore të Bashkimit Sovjetik në fushat e ndryshme, siç ishte, ndër të tjera, fluturimi me sukses të plotë i kozmonautit të parë në botë, Juri Gagarin, me ç'indinjatë e dënoi populli shqiptar vrasjen barbare të heroit kombëtar kongolez, Patris Lumumba, se si ai u ngrit i tëri më këmbë në mbrojtje të Kubës heroike kundër agresionit imperialist amerikan etj. Në shumë raste, shtypi dhe organet e tjera të propagandës sovjetike, sa herë që flasin për vendet socialiste dhe i numërojnë këto, gjejnë mënyrën për të mos përmendur Shqipërinë në radhën e tyre. Siç dihet, radio Tirana transmeton dy emisione në ditë të radio Moskës në gjuhën shqipe, por kohët e fundit nga ana e autoriteteve përgjegjëse sovjetike këto emisione në vend që t'i shërbejnë forcimit të miqësisë midis dy vendeve, po kthehen gradualisht në një instrument për të nxitur dëgjuesit shqiptarë kundër politikës së drejtë marksiste-leniniste të udhëheqjes së Partisë dhe të shtetit tonë.

Kush mund të pretendojë se këto qëndrime janë të rastit? Vetëm kush ka humbur respektin për vetëveten dhe për mençurinë e njerëzve mund të guxojë të akuzojë palën shqiptare për propagandë antisovjetike, kurse është pikërisht në dëm të Shqipërisë që po zhvillohet një veprimtari e gjerë propagandistike. Ne e dimë se mundësitë e Bashkimit Sovjetik dhe përpjekjet e tija për të informuar opinionin janë shumë më të mëdha se tonat dhe ne vëmë re se nuk po lihet rast e mjet pa u përdorur kundër popullit shqiptar, Partisë dhe qeverisë sonë.

Çdo komunisti të ndershëm do t'i vinte rëndë të lexonte në një letër zyrtare të Qeverisë Sovjetike trillime dhe sulme pa bazë e tendencioze si ato që bëhen në letrën e Qeverisë Sovjetike të 26 prillit, lidhur me politikën e jashtme të Republikës Popullore të Shqipërisë. Veprimet e padrejta të udhëheqësve sovjetikë mund t'i krijojnë vështirësi serioze për një farë kohe Republikës Popullore të Shqipërisë dhe popullit shqiptar; mundet që trillimet dhe shpifjet, të mbështetura në një propagandë të gjerë, të gjejnë diku kredi për një farë kohe, por, sado e fortë të jetë shpifja, e drejta më në fund del në shesh, triumfon dhe mësohet nga të gjithë popujt.

Më mirë se kushdo tjetër e dini ju, shokë të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste dhe të Qeverisë së Bashkimit Sovjetik, se, në çështjet e politikës së jashtme, vija e Partisë dhe qeverisë sonë ka qenë kurdoherë në përputhje me politikën e gjithë kampit socialist, me politikën paqësore të Bashkimit Sovjetik.

Kjo vijë, siç e përcaktoi edhe Kongresi i fundit i Partisë sonë, siç e vërteton edhe veprimtaria e Partisë dhe e qeverisë sonë, mbetet e pandryshuar dhe është absurde dhe djallëzore të mendohet ose të bëhen insinuata se gjoja ne po ndjekim një politikë të jashtme të ndryshme nga ajo e kampit socialist. Politika jonë e jashtme mbështetet në marksizëm-leninizmin, në Deklaratën e Moskës të 81 partive komuniste dhe punëtore dhe, ashtu siç theksohet në rezolutën e Kongresit IV të Partisë së Punës të Shqipërisë, miqësia me Bashkimin Sovjetik ka qenë, guri themel-tar i politikës së jashtme të Shqipërisë së re. A mos vallë sepse qëndrojmë vendosmërisht në këto pozita parimore, prandaj pas-kemi faj në sytë e disa udhëheqësve sovjetikë?

Ne me të vërtetë na çuditin dhe njëkohësisht na hichërojnë së tepërmi akuzat e padrejta që na bëhen. Ne shpeshherë kemi dëgjuar dhe dëgjojmë sulme dhe akuza për politikën tonë të jashtme nga ata, që e kanë halë në sy ekzistencën dhe lulëzimin e Shqipërisë socialiste këtu në brigjet e Adriatikut, në prapavijat e kampit imperialist, që e kanë sulmuar kurdoherë, por pa sukses miqësinë tonë të paprekshme me Bashkimin Sovjetik, luftën tonë parimore për mbrojtjen e unitetit dhe të interesave të kampit socialist, që janë armiq të betuar të Deklaratës së Moskës dhe të marksizëm-leninizmit, domethënë nga imperialistët amerikanë dhe revizionistët jugosllavë, monarko-fashistët grekë dhe neofashistët italianë. Por të vjen shumë keq kur shikon se këto shpifje të armiqve tanë të përbashkët e të betuar përdoren edhe nga disa shokë të udhëheqjes sovjetike për të akuzuar padrejtësisht Partinë dhe qeverinë tonë.

Por asnjëri nuk mund t'i zërë besë trillimit se Shqipëria nuk është për paqen, se ajo «fryn histerinë e luftës», apo «acaron gjendjen në Ballkan», siç thuhet në letrën e Qeverisë Sovjetike, sepse kushdo e di se në radhën e popujve që urrejnë luftën dhe e duan paqen, është edhe populli i vogël shqiptar, i cili gjatë gjithë historisë ka qenë i detyruar të luftojë me armë në dorë dhe të derdhë gjakun pa kursim për nderin e tij, për jetën dhe lirinë e tij dhe i cili për herë të parë tani që është vërtet zot në vendin e tij ka mundësi, nën udhëheqjen e Partisë së Punës të Shqipërisë, me punë të palodhur, me ndihmën dhe në unitet të çelniktë me Bashkimin Sovjetik dhe vendet e tjera socialiste, të ndërtojë në paqe jetën e tij të lumtur. Prandaj, nuk është nevoja të zgjatemi këtu për të vërtetuar se sa pa baza janë shpifjet që bën Qeveria Sovjetike në letrën e saj të 26 prillit për politikën e jashtme të qeverisë sonë.

Është e çuditshme se si mund të konceptohet nga udhëheqësit sovjetikë që një parti marksiste, siç është Partia jonë e Punës, që qeveria e një vendi socialist, siç është Shqipëria, të ndjekë një politikë kundër paqes, «të fryjë histerinë e luftës»? Në vend që

t'u besonin përrallave dhe shpifjeve të zakonshme të imperialistëve dhe revizionistëve jugosllavë kundër Shqipërisë socialiste, udhëheqësit sovjetikë do të bënin mirë të njiheshin me parimet dhe përmbajtjen konkrete të politikës së jashtme të Republikës Popullore të Shqipërisë nga veprimet e përditshme politike të Qeverisë sonë Popullore, nga dokumentat e shumtë të botuar, nga materialet e Kongresit IV të Partisë sonë, nga puna që zhvillojnë në favor të paqes botërore përfaqësuesit e qeverisë sonë në organizatat ndërkombëtare si në OKB etj.

Por duke qenë se në letrën e Qeverisë Sovjetike të 26 prillit 1961 akuza se Qeveria Shqiptare gjoja «fryn histerinë e luftës» lidhet me çështjen e komplotit të Greqisë, Jugosllavisë dhe Flotës së gjashtë amerikane që u demaskua në Kongresin IV të PPSH, do të ndalemi pak në këtë çështje.

Dihet se, qëkurse në Shqipëri fitoi revolucioni popullor dhe vendi ynë, nën udhëheqjen e Partisë së Punës të Shqipërisë, hyri vendosmërisht në rrugën e ndërtimit të socializmit, rreziku i kompleteve dhe i sulmeve të ndryshme kundër Republikës Popullore të Shqipërisë nga ana e armiqve ka qenë dhe vazhdon të jetë kurdoherë aktual. Duke marrë parasysh se Shqipëria është një vend i vogël që ndërton socializmin në kushtet e rrethimit kapitalist dhe revizionist dhe ndodhet gjeografikisht e veçuar nga vendet e tjera të kampit socialist, armiqtë kanë kujtuar se do të ishte relativisht lehtë për ta që të përmbysin pushtetin popullor në vendin tonë. Partia e Punës, qeveria jonë dhe i gjithë populli shqiptar për vjete me radhë kanë vazhduar të luftojnë dhe po luftojnë pa lëkundje kundër imperializmit dhe sidomos imperializmit amerikan që është armiku ynë kryesor i përbashkët, si dhe veglave të tija në vendet fqinj Itali, Greqi e Jugosllavi.

Siç dihet, dhe për këtë çështje është folur me hollësi në letrën e Qeverisë Shqiptare drejtuar më 5 prill 1961 qeverive të të gjitha vendeve të kampit socialist, disa muaj të shkuar organet tona zbuluan dhe asgjësuan një komplot të organizuar nga Jugosllavia dhe Greqia, në bashkëpunim me disa tradhëtarë shqiptarë dhe në koordinim me Flotën e gjashtë amerikane në Mesdhe.

Gjyqi publik që u zhvillua kohët e fundit në Tiranë kundër grupit të tradhëtarëve që ishin vënë në shërbim të organizatorëve të huaj të këtij komploti, dëshmoi në mënyrë të padiskutueshme se ky komplot ishte përgatitur dhe organizuar nga Jugosllavia, Greqia dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, se ai synonte në krijimin e turbullirave brenda, të cilat do t'u jepnin pretext Jugosllavisë, Greqisë dhe Flotës së gjashtë amerikane të ndërhyjnë ushtarakisht në Shqipëri. Qëllimi i komplotit ishte përmbysja e pushtetit popullor dhe rivendosja e kapitalizmit në Shqipëri, copëtimi i vendit, likuidimi i Republikës Popullore të Shqipërisë si shtet socialist, sovran e i pavarur.

Me rastin e zbulimit të komplotit dhe gjatë zhvillimit të gjyqit, siç mund të pritej, qarqet drejtuese jugosllave, greke dhe amerikane, si dhe shtypi i tyre, të zënë me presh në dorë dhe të tërbuar nga dështimi i komplotit kriminal kundër vendit tonë, jo vetëm u orvatën pa sukses të mohonin përgjegjësinë e tyre, por shpërthyen në fushata hysterike dhe në sulme të ulëta kundër Republikës Popullore të Shqipërisë dhe popullit shqiptar.

Megjithkëtë si shtypi sovjetik, ashtu edhe ai i disa vendeve të tjera socialiste zgjodhën rrugën e heshtjes absolute. Por pavarësisht nga kjo, ne besojmë se tani është edhe më e qartë se sa pa vend ishin dyshimet që shprehën në mbledhjen e fundit të Komitetit Politik Konsultativ të Traktatit të Varshavës udhëheqësit sovjetikë dhe disa udhëheqës të disa vendeve të demokracisë popullore lidhur me vërtetësinë e deklaratës sonë për ekzistencën dhe zbulimin e këtij komploti. Ne mendojmë se këta udhëheqës, siç e do logjika dhe solidariteti internacionalist, sikur të mos ishin nisur nga paragjykimet ndaj Shqipërisë, aq sa të kërkohej edhe krijimi i një komisioni për të kontrolluar saktësinë e deklaratës së një partie motër, por t'u kishin zënë besë fjalëve të Partisë dhe qeverisë sonë, ose së paku të kishin duruar deri në zhvillimin e procesit, nuk do ta kishin vënë veten në një pozitë të tillë, që nuk është aspak për ta pasur zili.

Ne besojmë se tashmë as nuk është nevoja të theksojmë se sa fyese, jo vetëm për Partinë dhe qeverinë tonë, por edhe për vetë autorët e letrës sovjetike të 26 prillit, tingëllojnë shprehjet me të cilat komploti i zbuluar quhet si propagandë e bërë me qëllim nga udhëheqësit shqiptarë për të krijuar «përshtypjen» sikur gjoja «Shqipërinë e kërcënon rreziku direkt i sulmit ushtarak», ose se udhëheqësit shqiptarë «fryn histerinë e luftës», apo siç u pretendua në mbledhjen e 29 marsit të Komitetit Politik Konsultativ të Traktatit të Varshavës se komploti ishte trillim i fabrikuar «për konsum të brendshëm» etj. etj.

Këto janë faktet.

Faktet tregojnë se disa udhëheqës sovjetikë me N. S. Hrushovin në krye, qysh mbas Mbledhjes së Bukureshtit dhe deri sot, kanë ndjekur sistematisht ndaj Partisë së Punës të Shqipërisë, ndaj popullit shqiptar, ndaj Republikës Popullore të Shqipërisë, një vijë presionesh dhe veprimesh të palejueshme për marrëdhënjet midis shteteve socialiste. Kjo vijë, e justifikuar me «disa fakte» të trilluara nga disa provokatorë dhe elementë të pandërgjegjshëm, është shtrirë me nxitjen e disa udhëheqësve sovjetikë edhe në marrëdhënjet shtetërore midis dy vendeve tona, si në fushën e marrëdhënjeve ekonomike e politike, ashtu edhe në atë ushtarake. «Faktet» që përmenden në letrën e Qeverisë Sovjetike të 26 prillit, si dhe në notat e mëvonshme janë kurdisur me qëllim që të arësyetohej bllokada ekonomike, ushtarake dhe politike

kundër Partisë së Punës të Shqipërisë dhe Republikës Popullore të Shqipërisë, si dhe për të tërhequr në këtë bllokadë edhe disa udhëheqës të disa vendeve të demokracisë popullore.

Duke u nisur nga premisa të gabuara, nga trillime dhe supozime absurde mbi qëndrimin dhe veprimet e udhëheqjes shqiptare ndaj Bashkimit Sovjetik dhe vendeve të tjera socialiste, në letrën e saj të 26 prillit 1961 Qeveria Sovjetike nxjerr konkluzione të gabuara dhe kërcënon hapët Shqipërinë se «do të rishqyrtojë çështjen e marrëdhënjeve të mëtejshme me Republikën Popullore të Shqipërisë», se «këto do t'i ndërtojë mbi një bazë të re», se nuk do ta ndihmojë më vendin tonë dhe se heq dorë nga «parimet e mëparshme të lidhjeve tona reciproke në të gjitha fushat e bashkëpunimit politik, ekonomik dhe ushtarak», përderisa pala shqiptare nuk do t'i rishikojë qëndrimet e saj ndaj Bashkimit Sovjetik dhe vendeve të tjera të kampit socialist.

Siç dihet, në nëntor 1960, në Moskë zhvilloi punimet e saj Konferenca e përfaqësuesve të 81 partive komuniste dhe punëtorë dhe u aprovua Deklarata e njohur, ky dokument historik për gjithë kampin socialist dhe lëvizjen komuniste e punëtorë ndërkombëtare. Ajo përbën bazën, platformën e aprovuar të përbashkët. Logjika marksiste e donte që, pas kësaj ngjarjeje, marrëdhënjet midis të gjitha partive komuniste e punëtorë dhe midis të gjitha vendeve të kampit socialist, pra edhe midis Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe Partisë së Punës të Shqipërisë, si dhe midis Bashkimit Sovjetik dhe Republikës Popullore të Shqipërisë, të zhvilloheshin në frymën e kësaj deklaratë, në bazë të parimeve të shprehura atje dhe të dy palët të punonin për të forcuar miqësinë dhe unitetin tonë, për të vënë në jetë deklaratën. Duhet theksuar se Partia e Punës e Shqipërisë pikërisht duke u nisur nga këto konsiderata dhe me qëllim që të mos acaronte më tej marrëdhënjet midis dy partive tona, nuk ju përgjegj letrës që Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik më datën 1 dhjetor 1960 i dorëzoi delegacionit tonë dhe të gjitha delegacioneve të partive motra që muarën pjesë në Konferencën e Moskës, letër e cila ishte plot shpifje, insinuata dhe e mbështetur fund e krye mbi argumenta false. Por fatqëësia është se ndërsa Partia dhe qeveria jonë si më parë, ashtu edhe pas Konferencës së Moskës vepruan sinqerisht për përmirësimin e marrëdhënjeve sipas Deklaratës së Moskës, udhëheqja sovjetike ndoqi udhën e kundërt, udhën e hakmarrjes, të presionit, të masave njëra më e rëndë se tjetra kundër Partisë së Punës të Shqipërisë dhe Republikës Popullore të Shqipërisë duke marrë nëpër këmbë pa skrupull Deklaratën e Moskës, miqësinë tonë të shenjtë dhe çdo parim mbi të cilët janë ndërtuar marrëdhënjet midis vendeve socialiste.

Partia e Punës e Shqipërisë dhe Qeveria Shqiptare kanë res-

pektuar kurdoherë plotësisht dhe pa më të voglin ngurrim të gjitha detyrimet që rrjedhin për vendin tonë si pjesëtar i kampit socialist dhe i Traktatit të Varshavës, kanë ruajtur dhe do të ruajnë me besnikërinë më të madhe, pa marrë parasysh asnjë sakrificë, interesat tona të përbashkëta dhe kufitë e kampit të socializmit në këtë pjesë të Evropës, kanë zbatuar dhe do të zbatojnë me vendosmëri Deklaratën e Moskës të nëntorit 1960.

Ne e themi me bindje të plotë se jo vetëm në Shqipëri e në Bashkimin Sovjetik, por në asnjë vend tjetër socialist, në asnjë vend në botë nuk do të ketë njeri të ndershëm dhe me arësye që t'u zërë besë parullave se gjoja Republika Popullore e Shqipërisë, Partia e Punës e Shqipërisë dhe Qeveria Shqiptare kërkojnë të shkëputen nga Bashkimi Sovjetik dhe se kanë marrë qëndrim kundër miqësisë me Bashkimin Sovjetik apo me vendet e tjera të kampit socialist. Këto janë shpifje që nuk i mban dheu. Bashkimi Sovjetik ka pasur, ka dhe do të ketë te populli shqiptar një mik dhe aleat besnik deri në fund.

Miqësia që lidh popujt sovjetikë me popullin shqiptar, si dhe pjesëmarrja e Republikës Popullore të Shqipërisë në kampin socialist nuk janë rezultat i makinacioneve diplomatike, as i dëshirave subjektive të këtij apo të atij personi. Ato janë krijuar historikisht dhe kanë një bazë të shëndoshë objektive. Në themel të miqësisë shqiptaro-sovjetike dhe të pjesëmarrjes së Republikës Popullore të Shqipërisë në kampin socialist qëndrojnë faktorë objektive siç janë: futja e popujve dhe vendeve tona në rrugën e përbashkët të socializmit e të komunizmit, esenca e përbashkët klasore e rendit social-ekonomik dhe e pushtetit shtetëror, interesat rrënjësore dhe qëllimet e përbashkëta në luftën kundër imperializmit për fitoren e socializmit dhe të komunizmit, ideologjia e marksizëm-leninizmit dhe parimet e internacionalizmit proletar, të përbashkëta për të gjithë, lufta për paqen dhe bashkëzistencën paqësore midis vendeve me sisteme të ndryshme shoqërore. Për këto arësye ne themi me bindje të plotë se miqësinë shqiptaro-sovjetike nuk mund ta prishë dhe aq më pak ta anulojë asnjë dekret, i asnjë personi, cilido qoftë ai, kjo është një miqësi popujsh, prandaj dhe është e pathyeshme.

Populli shqiptar ka vuajtur shumë gjatë shekujve, por edhe për të Partia e Leninit, Revolucioni i madh socialist i Tetorit çeli epokën e çlirimit e të lumturisë dhe në shtetin e madh sovjetik ai gjeti mikun dhe aleatin e tij besnik. Në rast se disa udhëheqës sovjetikë sot, duke shtrëmbëruar parimet bazë mbi të cilat mbështeten marrëdhënjet midis vendeve socialiste, do të ndjekin një politikë josocialiste ndaj Republikës Popullore të Shqipërisë, kjo është punë e tyre dhe për këtë janë vetë përgjegjës. Përsa na përket neve, ashtu si kurdoherë, ndaj Bashkimit Sovjetik ne do të ndjekim edhe në të ardhshmen politikën leniniste të miqësisë dhe besnikë-

risë së patundur. Po kështu edhe ndaj vendeve të tjera vëllezër. Këtë e kemi thënë dhe e ritheksojmë edhe një herë. Politika e Partisë së Punës të Shqipërisë dhe e Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë as ka ndryshuar, as do të ndryshojë kurrë.

Ne jemi mësuar me vështirësi e privacione dhe këto nuk na trembin. Ne jemi në rrugë të drejtë dhe jemi të bindur se Partia Komuniste dhe populli sovjetik do të na kuptojnë dhe do të na japin të drejtë. Rrugën tonë e ndriçojnë mësimet e Leninit të madh, besimi se luftojmë për një çështje të drejtë që është në interes të popullit shqiptar, të Bashkimit Sovjetik, të kampit socialist, të marksizëm-leninizmit. Kjo na jep forca të përballojmë me vendosmëri çdo vështirësi e privacion dhe na bind se më së fundi e vërteta do të fitojë...

Ne jemi të ndërgjegjshëm se për zgjidhjen e këtyre mosmarrëveshjeve duhet kohë dhe durim reciprok, duhen përpjekje të mëdha, me qëllim që të krijohen konditat e nevojshme për likuidimin e fenomeneve negative që prej afro një viti janë shfaqur në marrëdhënjet miqësore, vëllazërore, e mund të themi, pa pikë dyshimi, më se shembëllore që kanë ekzistuar më parë midis dy partive, dy vendeve dhe dy popujve tanë vëllezër. Në radhë të parë, në këtë drejtim, duhet të hiqet dorë nga shtrirja e mosmarrëveshjeve ideologjike që ekzistojnë midis dy partive tona, në fushën e marrëdhënjeve shtetërore, qoftë në lëmin ekonomik, qoftë në atë politik e ushtarak.

Partia dhe qeveria jonë kurrë ndonjëherë nuk kanë refuzuar që për çdo çështje të zhvillojnë bisedime dypalëshe. Por ne kemi theksuar dhe theksojmë se për një gjë të tillë duhen krijuar konditat e nevojshme, konditat e barazisë për të dy palët. Ne nuk kemi shkuar dhe nuk mund të shkojmë në asnjë bisedim, kur këto kondita nuk janë siguruar, sepse çdo bisedim i tillë do të ishte i pavlefshëm, i padobishëm dhe në vend që të ndihmonte për të zgjidhur mosmarrëveshjet ekzistuese do t'i thellonte ato edhe më shumë. Përpara duhet të zhduken pengesat e krijuara në mënyrë të njëanshme në marrëdhënjet midis dy vendeve e dy partive tona, si në fushën ekonomike, ashtu edhe në atë politike e ushtarake dhe pastaj të vijmë të bisedimet. Prandaj, e quajmë krejt të padrejtë orvatjen e bërë në letren e Qeverisë Sovjetike të 26 prillit 1961 për të akuzuar Partinë dhe qeverinë tonë sikur gjoja ato kanë refuzuar dhe refuzojnë çdo bisedim. Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë shpresojnë se nga ana e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe Qeverisë Sovjetike, do të merren masat e përshtatshme për të rishikuar me gjakftohtësi gjendjen e krijuar në marrëdhënjet midis të dy partive dhe popujve tanë, do të merren masat përkatëse që t'u jepet fund qëndrimeve dhe veprimeve të padrejta ndaj Republikës Popullore të

Shqipërisë dhe Partisë së Punës të Shqipërisë, shpresojnë se edhe nga ana e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe Qeverisë Sovjetike, do të bëhen përpjekje të njëjta për të vënë marrëdhënjet shqiptaro-sovjetike në rrugë të drejtë dhe për t'i zhvilluar ato më tej mbi parimet e internacionalizmit proletar, në interes të Republikës Popullore të Shqipërisë dhe të Bashkimit Sovjetik, në interes të miqësisë së pavdekshme shqiptaro-sovjetike, në interes të mbarë kampit socialist dhe të çështjes sonë të lavdishme të komunizmit dhe të paqes.

Me përshëndetje komuniste.

**ME AUTORIZIM
TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË RPSH
KRYETARI I KËSHILLIT
TË MINISTRAVE**

MEHMET SHEHU

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë.*

**ME AUTORIZIM
TË KOMITETIT QENDROR
TË PARTISË SË PUNËS
TË SHQIPËRISË
SEKRETARI I PARË**

ENVER HOXHA

DEKLARATË E KOMITETIT QENDROR TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË MBI ÇËSHTJEN E PËRFUNDIMIT TË TRAKTATIT TË PAQES ME GJERMANINË

7 gusht 1961

Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë e priti me kënaqësi propozimin për këtë mbledhje¹ të rëndësishme mbi çështjen e përfundimit të Traktatit të Paqes me Gjermaninë dhe shpreh besimin se shkëmbimi i pikëpamjeve mbi këtë çështje do të jetë mjaft i dobishëm dhe do të ndihmojë në përcaktimin e masave praktike për vënjen në jetë të qëndrimit tonë parimor të përbashkët, përfundimit të Traktatit të Paqes me Gjermaninë brenda këtij viti.

Partia e Punës e Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë kanë përkrahur kurdoherë dhe me vendosmëri përpjekjet e Bashkimit Sovjetik dhe të Republikës Demokratike Gjermane për zgjidhjen paqësore të çështjes gjermane që përbën një nga problemet kyçe të kohës sonë, që ka të bëjë drejt-përsëdrejti jo vetëm me interesat jetike të popullit gjerman, por dhe me interesat e paqes e të sigurimit në Evropë dhe në botë. Pikëpamja e Partisë dhe e Qeverisë sonë, ashtu siç është shprehur në mjaft raste të ndryshme, ka qenë dhe mbetet se Traktati i Paqes me Gjermaninë duhet nënshkruar sa më parë dhe në këtë mënyrë të gjejë zgjidhje edhe çështja e Berlinit Perëndimor. Ne çmojmë faktin se përfundimi i Traktatit të Paqes me Gjermaninë është bërë një kërkesë urgjente e kohës në interes të Republikës Demokratike Gjermane dhe të mbarë kampit socialist, në interes të forcimit të paqes dhe të sigurimit të përgjithshëm.

¹ Është fjala për Mbledhjen e përfaqësuesve të partive komuniste dhe punëtoresh, pjesëtare të Traktatit të Varshavës që u mbajt në Moskë prej 3-5 gusht 1961. Në këtë mbledhje do të mbante një fjalim kryetari i delegacionit të PPSH, anëtari i Byrosë Politike të KQ të PPSH shoku Ramiz Alia. Por meqenëse kjo mbledhje në mënyrë arbitrare dhe në kundërshtim flagrant me parimet e marksizëm-leninizmit nuk lejoi të marrë pjesë delegacioni ynë në punimet e saj, Byroja Politike e KQ të PPSH vendosi ta botojë në shtyp këtë fjalim në formën e një deklaratë më 8 gusht 1961.

Gjermania Perëndimore me nxitjen dhe përkrahjen aktive të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të Anglisë dhe të Francës, sot është bërë një rrezik i vërtetë për paqen. I gjithë potenciali i saj është vënë në shërbim të politikës imperialiste të agresionit. Në fuqi kanë ardhur të njëjtat grupe shoqërore dhe ekonomike që dikur mbështetën Hitlerin, financuan dhe përkrahën politikën e tij kriminale të luftës shfarosëse. Ish-anëtarët e trupave SS po rehabilitohen dhe ish-kriminelët nazistë mbajnë pozita komanduese në shtet, në ushtri dhe në forcat e NATO-s. Militarizmi revanshist gjerman i ringjallur kërkon armë atomike dhe bërthamore për Bundesverin; në qoftë se tashmë nuk zotëron baza ushtarake në tokë të huaj, parashtron haptas pretendime tokësore ndaj shteteve të tjera dhe i jep tonin kursit të politikës së Bonit. Gjermania Perëndimore është kthyer në forcë sulmuese kryesore të imperializmit në Evropë kundër vendeve socialiste në radhë të parë. Qeveria e kancelarit Adenauer jo vetëm kundërshton çdo propozim bashkëpunimi me Republikën Demokratike Gjermane dhe përfundimin e Traktatit të Paqes, por nuk i fsheh kërcënimet dhe pretendimet për aneksimin e Republikës Demokratike Gjermane. Është e kuptueshme se vendet tona pjesëtare të Traktatit të Varshavës dhe i gjithë kampi socialist nuk mund të qëndrojnë indiferentë përpara një zhvillimi të tillë të ngjarjeve. S'ka dyshim se në këto rrethana përfundimi brenda këtij viti, siç e ka propozuar qeveria e Bashkimit Sovjetik, i Traktatit të Paqes, qoftë edhe vetëm me Republikën Demokratike Gjermane, do të jetë një grusht dhe një paralajmërim i bërë në kohë kundër kursit agresiv të Gjermanisë Perëndimore dhe partnerëve të saj të Paktit Atlantik.

Sipas mendimit tonë, edhe gjendja ndërkombëtare është e favorshme për të përfunduar Traktatin e Paqes sivjet. Raporti i forcave është në favorin tonë. Kampi i fuqishëm i socializmit është bërë një forcë kolosale dhe faktori vendimtar në zhvillimin e ngjarjeve në botë. Fuqia e tij ushtarake, politike dhe ekonomike është shumë e madhe dhe në zhvillim të vazhdueshëm dhe të pakrahasueshëm me atë të kampit imperialist... Realizimet madhështore të Bashkimit Sovjetik dhe vendeve të tjera socialiste në ndërtimin paqësor, si dhe politika paqësore konsekuente e vendeve tona kanë rritur influencën e sistemit botëror të socializmit. Lufta nacional-çlirimtare e popujve kolonialë po zhvillohet me vrull të pandalshëm dhe me sukses. Në vendet kapitaliste pakënaqësia e masave punonjëse po rritet, grevat dhe lufta e klasës punëtoresh për kushte më të mira jetese dhe për më shumë të drejta po zgjerohen mjaft. Papunësia dhe kriza ekonomike po rriten, ndërsa kontradiktat e gjithanshme midis vendeve kapitaliste po thellohen. Iluzionet që ngjalli ditët e para demagogjia e presidentit Kenedi në shtresa të ndryshme të vendeve perëndimore dhe asnjëse u shkrinë si vesa në diell; ngjarjet e Kubës, të Lao-

sit, të Kongos, qëndrimi ndaj problemit të çarmatimit, të ndalimit të provave të armëve atomike e bërthamore, si dhe ndaj problemit gjerman, zbuluan edhe një herë në sytë e të gjithë popujve se imperializmi amerikan është po ai, armik i betuar i paqes dhe i lirisë së popujve, koka e reaksionit ndërkombëtar.

Kërcënimet dhe vringëllimi i armëve nga ana e militaristëve të Pentagonit dhe të Bonit kundër propozimit sovjetik për Traktatin e Paqes me Gjermaninë dhe kthimin e Berlinit Perëndimor në qytet të lirë e të çmilitarizuar nuk gjejnë përkrahje aktive jo vetëm në popujt, por as në shumë qeveri të vendeve kapitaliste. Popujt e Evropës nuk i zënë shumë besë propagandës borgjeze se gjoja Bashkimi Sovjetik dhe vendet e tjera socialiste duan luftë; ata e kanë të gjallë kujtimin e agresionit hitlerian dhe vështrojnë me frikë nga Gjermania Perëndimore, prandaj janë në favor të çdo mase që do ta pengojë militarizmin gjerman t'i vërë zjarrin botës përsëri. Një masë e tillë do të ishte Traktati i Paqes me Gjermaninë.

Kanë kaluar 16 vjet qëkurse mbaroi Lufta e dytë botërore dhe Gjermania hitleriane u detyrua të kapitullojë, por Traktati i Paqes me Gjermaninë akoma nuk është nënshkruar. Historia moderne nuk njih tjetër rast të tillë. E gjithë përgjegjësia për këtë gjendje anormale dhe plot rrezik për paqen, bie mbi fuqitë e mëdha perëndimore, të cilat shkelën arbitrarisht marrëveshjet e Potsdamit, shkaktuan ndarjen e Gjermanisë në dy shtete të ndryshme duke u mbështetur në militarizmin revanshist gjerman, e kthyen Gjermaninë Perëndimore në një vatër agresioni dhe sabotuan të gjitha përpjekjet e Bashkimit Sovjetik për përfundimin e Traktatit të Paqes, të gjitha përpjekjet në rrugën drejt bashkimit të Gjermanisë në një shtet demokratik e paqedashës.

Vendet tona socialiste janë shprehur kurdoherë për një zgjidhje demokratike dhe paqësore të çështjes gjermane, për bashkimin e Gjermanisë në një shtet të vetëm, demokratik e paqedashës. Në konditat e sotme, kur ekzistojnë dy shtete gjermane, Republika Demokratike Gjermane dhe Republika Federale Gjermane, me sisteme shoqërore e politike krejt të ndryshme, rruga drejt bashkimit kalon përmes konfederatës të propozuar nga Republika Demokratike Gjermane. Traktati i Paqes me Gjermaninë, duke u dhënë fund mbeturinave të rrezikshme të Luftës së dytë botërore, jo vetëm që çoi t'i kthente popullit gjerman sovranitetin dhe dinjitetin e tij të plotë, por do të krijonte kushte të favorshme në rrugën e bashkimit, do të zhdukte edhe vatrën e luftës së pashuar që përbën Berlinit Perëndimor. Vendet tona nisen nga parimi se zgjidhja e çështjes gjermane është në radhë të parë punë e vetë popullit gjerman. Përfundimi i Traktatit të Paqes dhe kthimi i Berlinit Perëndimor në një qytet të lirë e të

çmilitarizuar do të ndihmonin në shkallë të ndieshme në këtë drejtim.

Fuqitë perëndimore më kot çirren se gjoja propozimi i Bashkimit Sovjetik për të thirrur konferencën e paqes dhe për përfundimin e Traktatit të Paqes me Gjermaninë brenda këtij viti është një sfidë dhe kërcënim për luftë. Traktati i Paqes është një akt i madh që forcon paqen dhe largon rrezikun e luftës. Kundër tij mund të jenë vetëm ata që janë për luftë dhe kundër paqes, vetëm ata që ndarjen e Gjermanisë dhe Berlinit Perëndimor duan t'i përdorin për të dëmtuar Republikën Demokratike Gjermane, për të përgatitur dhe për të kryer agresion kundër vendeve të Traktatit të Varshavës. Taktika e shteteve imperialiste tashmë është e njohur: ata kanë përdorur dhe po përdorin lloj-lloj manevrash për të zvarritur zgjidhjen e çështjes gjermane dhe përfundimin e Traktatit të Paqes, për t'i pasur duart e lira në veprimtarinë dhe në planet e tyre armiqësore, për të përgatitur agresionin. Ata nuk e kanë fshehur kurrë qëllimin e tyre për t'i aneksuar Gjermanisë Perëndimore shtetin e parë socialist gjerman në histori, Republikën Demokratike Gjermane. Militaristët revanshistë të Bonit rivencikojnë tokat perëndimore të Republikës Popullore të Polonisë dhe kundërshtojnë me arrogancë kufirin Oder-Najse, kufi përfundimtar, i vulosur me gjakun e derdhur si lumë nga populli vëlla polak në luftë kundër agresorëve hitlerianë. Po kështu ata nuk i fshehin lakmitë e tyre kundër tërësisë tokësore të padiskutueshme të Republikës Socialiste Çekoslovakë, populli i së cilës qe viktimë e parë e agresionit hitlerian. Për të gjithë imperialistët duhet të jetë e qartë se kufitë e këtyre shteteve vëllezër janë përfundimtarë, se kufitë e secilit shtet të kampit tonë që shtrihet nga Adriatiku dhe deri në Oqeanin Paqësor, janë kufitë e të gjithë kampit, pra, kush prek Republikën Demokratike Gjermane ose kufitë e çdo shteti tjetër socialist ka prekur gjithë kampin e socializmit. Çdo akt i çmëndur në këtë drejtim do të marrë përgjegjen e merituar dhe do të thotë shpërthim i luftës botërore.

Duke shprehur përkrahjen tonë për projekttraktatin e propozuar nga Bashkimi Sovjetik në janar 1959, ne kemi vënë në dukje se ky Traktat Paqeje siguron plotësisht lirinë dhe pavarësinë e popullit gjerman, sovranitetin e Gjermanisë dhe i siguron kësaj barazi në arenën ndërkombëtare, zhvillim të lirë të ekonomisë paqësore, të tregëtisë dhe të lundrimit, hyrje të lirë në tregjet botërore, si dhe të drejtën që të ketë forcat e saja të armatosura në masën e nevojshme për mbrojtjen e vendit. Traktati i Paqes do të fiksojë kufitë ekzistues të Gjermanisë, të cilët janë përfundimtarë dhe nuk do të çënojnë aspak sistemin politik dhe shoqëror që ekziston në të dy shtetet gjermane dhe në Berlinit Perëndimor. Republika Popullore e Shqipërisë, si shtet socialist

dhe si vend që ka luftuar në Luftën e dytë botërore në radhët e koalicionit antifashist dhe ka pësuar humbje të rënda në luftën kundër pushtuesve hitlerianë, përfundimin e Traktatit të Paqes me Gjermaninë e quan si një masë të domosdoshme për sigurimin e saj, për sigurimin e Republikës Demokratike Gjermane dhe të vendeve të tjera socialiste, për ruajtjen e paqes në Evropë.

Dëshira e shteteve tona socialiste ka qenë dhe mbetet që Traktati i Paqes me Gjermaninë të nënshkruhet me përfaqësuesit e konfederatës gjermane, po të krijohej kjo, ose me të dy shtetet gjermane ekzistuese dhe nga të gjitha shtetet pjesëmarrëse në luftën kundër Gjermanisë hitleriane. Por në rast se Republika Federale Gjermane dhe fuqitë e tjera perëndimore refuzojnë të nënshkruajnë Traktatin e Paqes, ne nuk duhet të ndalemi në rrugën tonë dhe ashtu siç e ka propozuar Bashkimi Sovjetik, ne duhet të nënshkruajmë traktat të veçuar me Republikën Demokratike Gjermane, duke zgjidhur në të njëjtën kohë edhe çështjen e Berlinit Perëndimor. Vetë Shtetet e Bashkuara të Amerikës e krijuan precedentin me Traktatin e Paqes me Japoninë dhe në mënyrë të njëanshme u dhanë fund të drejtave të Bashkimit Sovjetik si fuqi fituese në Japoni ashtu edhe Bashkimi Sovjetik ka plotësisht të drejtë të bëjë të njëjtën gjë ndaj Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe aleatëve të tyre në Berlinin Perëndimor. Në këtë mënyrë, sipas mendimit tonë, siç u theksua edhe në Kongresin IV të Partisë sonë, do të prisheshin planet e imperializmit me taktikën e zgjatjes e të zvarritjes dhe do të bëhej një hap i madh përpara në rrugën e paqes e të sigurimit ndërkombëtar. Sa më shpejt të kryhet ky hap, aq më mirë do të jetë për sigurimin e paqes dhe për zhvillimin demokratik të Gjermanisë.

Me sa duket, pas notave të tyre në lidhje me Memorandumin sovjetik të 4 qershorit 1961 dhe fjalimit luftënxitës të fundit të presidentit Kenedi, fuqitë perëndimore edhe këtë radhë janë kundër propozimit sovjetik për përfundimin e Traktatit të Paqes me Gjermaninë. Në këto rrethana, ne mendojmë se është plotësisht e arësyeshme që t'u bëhet ftesë zyrtare të gjitha shteteve pjesëtare në luftë kundër Gjermanisë hitleriane për të marrë pjesë në Konferencën e Paqes mbi përfundimin e Traktatit të Paqes me Gjermaninë duke propozuar në të njëjtën kohë datën dhe vendin e konferencës. Në rast se që të gjithë pranojnë dhe Traktati i Paqes do të nënshkruhet me të dy shtetet gjermane, aq më mirë; në rast se fuqitë perëndimore, Gjermania e Bonit dhe disa shtete të tjera të lidhura me to nuk pranojnë, atëherë në datën dhe në vendin e propozuar të mbliçhen ato shtete që janë të gatshme të përfundojnë Traktatin e Paqes të veçuar me Republikën Demokratike Gjermane dhe të kryejnë këtë akt me rëndësi historike për popullin gjerman dhe për paqen. Traktati i Paqes do të fiksojë edhe statutin e Berlinit Perëndimor, si qytet i lirë

e i çmilitarizuar. Në këtë mënyrë, nga një qendër veprimesh subversive dhe komplotesh të vazhdueshme kundër Republikës Demokratike Gjermane dhe vendeve të tjera socialiste, nga një fuqi baruti që është sot, Berlinit Perëndimor do të kthehej në një faktor paqeje dhe bashkëpunimi, në një mjet afrimi midis dy shteteve gjermane.

Si në çështjen e Traktatit të Paqes të veçuar me Republikën Demokratike Gjermane, ashtu edhe në çështjen e Berlinit Perëndimor, pozita jonë është fare e drejtë e plotësisht e justifikuar nga ana politike, morale dhe juridike.

Bindja jonë është se, pavarësisht nga kritikrat dhe nga kërcënimet e qarqeve drejtuese të Vashingtonit dhe të Bonit, përfundimi i Traktatit të Paqes me Republikën Demokratike Gjermane do të ketë rezultate të mëdha pozitive për kampin socialist, për çështjen e paqes dhe të sigurimit ndërkombëtar dhe do të prishë planet agresive të imperialistëve amerikanë dhe gjermano-perëndimorë. Në radhë të parë do t'i japë Republikës Demokratike Gjermane të gjitha atributet e saj si shtet sovran, do të forcojë se tepërmi sigurimin dhe pozitën e saj ndërkombëtare dhe do t'i japë fund gjendjes së rrezikshme të Berlinit Perëndimor. Duan s'duan fuqitë perëndimore, kur të kenë të bëjnë vetëm me autoritetet e Republikës Demokratike Gjermane për të hyrë e për të dalë nga Berlinit Perëndimor, do të detyrohen ta njohin Republikën Demokratike Gjermane de facto menjëherë dhe de jure shpejt ose vonë.

Nuk ka dyshim se jo vetëm popujt e vendeve tona dhe populli gjerman, por edhe popujt e tjerë, në radhë të parë popujt e Evropës që kanë qenë viktimat të agresionit hitlerian, do ta kuptojnë drejt qëndrimin tonë, do ta përkrahin dhe do ta përshëndetin përfundimin e Traktatit të Paqes me Republikën Demokratike Gjermane dhe caktimin e statutit të ri të Berlinit Perëndimor.

Është e drejtë, nga ana tjetër, të parashikojmë se fuqitë perëndimore jo vetëm do të orvaten të fitojnë kohë për të penguar përfundimin e Traktatit të Paqes, por edhe do ta kërcënojnë.

Për këtë dëshmon shumë qartë fjalimi i ditëve të fundit i presidentit Kenedi që po ndez me furi psikozën e luftës dhe po ndërmerri hapa të rinj drejt luftës.

Partia e Punës e Shqipërisë dhe qeveria shqiptare nuk kanë qenë dhe nuk janë kundër bisedimeve me fuqitë perëndimore për zgjidhjen e çështjes gjermane, përkundrazi. Por ne nuk mund të mos kemi parasysh eksperiencën e derisotshme, që tregojnë se bisedimet nga ana e fuqive perëndimore janë përdorur pikërisht për të mos arritur asnjë zgjidhje dhe me këto bisedime ato janë përpjekur të mbulojnë politikën e tyre të rrezikshme në Gjermaninë Perëndimore. Ne jemi plotësisht dakord me deklaratën që

bën N. Hrushovi më 20 qershor 1961 se «ne, së bashku me shtetet e tjera paqëndashëse, do të nënshkruajmë në fund të këtij viti Traktatin e Paqes me Republikën Demokratike Gjermane»¹.

Nga ana tjetër, ne nuk mund të mos i kemi parasysh dhe as t'i nënvleftësojmë kundërshtarët tanë. Qëndrimet dhe veprimet e fundit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, siçomos lidhur me çështjen e Berlinit Perëndimor, e kërcënojnë seriozisht paqen. Faktet vërtetojnë se, siç deklaroi dhe N. Hrushovi më 8 korrik të këtij viti, «nuk duhet menduar se mundësia e shpërthimit të luftës është përjashtuar tanimë plotësisht derisa ekzistojnë fuqitë imperialiste»². Ne jemi të bindur se forca e Bashkimit Sovjetik dhe e gjithë kampit është shumë e madhe, por përpara imperializmit agresiv dhe veprimtarisë së tij të ethëshme, ne duhet të marrim masa për të rritur edhe më shumë aftësitë mbrojtëse dhe gatishmërinë tonë luftarake. Duke ju sjellë zërin e Partisë së Punës të Shqipërisë, të qeverisë dhe të popullit të Republikës Popullore të Shqipërisë, e cila siç dihet, ndodhet në kushtet e rrethimit gjeografik kapitalist, unë deklaroj se në çdo gjendje dhe në çdo rast të rrezikshëm ne do të luftojmë deri në fund përkrah Bashkimit Sovjetik dhe vendeve të tjera vëllezër, pa marrë parasysh asnjë sakrificë, në çdo rast dhe si kurdoherë do të jemi solidarë deri në fund dhe do të kryejmë me nder detyrën tonë. Përkëpamja e Partisë së Punës të Shqipërisë është se në gjendjen e sotme detyrë kryesore për të gjitha partitë dhe vendet tona është forcimi i unitetit të kampit tonë socialist rreth Bashkimit

1 N. Hrushovi dhe udhëheqësit e tjerë sovjetikë deklarorin se Bashkimi Sovjetik nuk mund ta zgjaste më tutje përfundimin e Traktatit të Paqes me Gjermaninë. Në rast se qeveria e Gjermanisë Perëndimore do ta kundërshtonte, ky traktat duhej të përfundohej vetëm me RD Gjermane. Ky qëndrim ishte i drejtë, prandaj PPSH e mbështeste një qëndrim të tillë. Mirëpo udhëheqësit revizionistë sovjetikë një qëndrim të tillë e mbanin vetëm me fjalë dhe nuk tregonin asnjë vendosmëri për ta zbatuar. Jo vetëm nuk e nënshkruan në fund të vitit 1961 Traktatin e Paqes me RD Gjermane, siç deklarorin, por e zvarritën nga viti në vit dhe më në fund hoqën dorë fare, në bazë të një marrëveshje të heshtur me SHBA. Në vend të Traktatit të Paqes me Gjermaninë, ata nënshkruan, në gusht 1970, një traktat me RF Gjermane, që përbën në të vërtetë një rrezik për sigurimin e popujve të Evropës dhe të botës dhe dëmton rëndë interesat e RD Gjermane.

2 Kjo thënje është plotësisht e drejtë, por Hrushovi dhe udhëheqësit e tjerë revizionistë, si në shumë probleme të tjera, edhe në këtë rast ndryshe flisnin ndryshe vepronin, me fjalë goditnin imperializmin, në praktikë ndiqnin politikën e afrimit e të bashkëpunimit me të. PPSH, për të demaskuar këtë qëndrim me dy faqe të revizionistëve hrushovianë, kapej me qëllim pas thënjeve të drejta, duke vënë në dukje tërthorazi veprimet e tyre anti-marxiste që binin në kundërshtim me ato thënje.

Sovjetik. Partia e Punës e Shqipërisë, ashtu si kurdoherë, nuk do t'i kursejë përpjekjet e saja në këtë drejtim.

Ne mendojmë se përfundimi i Traktatit të Paqes me Republikën Demokratike Gjermane, jo vetëm do të ishte një provë shumë e qartë e politikës paqësore të Bashkimit Sovjetik dhe të mbarë kampit socialist, por do t'i kufizonte mundësitë e imperialistëve për veprime agresive, do ta demaskonte edhe më shumë politikën e tyre kundër paqes, do të forconte bindjen e popujve se kush është për paqen dhe kush është për luftën. Duke ecur në këtë rrugë ne do të forcojmë çështjen e paqes dhe pozitën e përgjithshme të kampit tonë të socializmit.

KOMITETI QENDROR I PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË

*Botohet sipas gazetës
«Zëri i Popullit», Nr. 190,
8 gusht 1961*

**PROMEMORJE E KQ TË PPSH DREJTUAR KQ
TË PARTISË KOMUNISTE TË BASHKIMIT SOVJETIK
LIDHUR ME VENDIMIN E PADREJTË TË QEVERISË
SOVJETIKE PËR PRERJEN E BURSAVE DHE DËBIMIN
NGA BASHKIMI SOVJETIK TË STUDENTËVE
SHQIPTARË¹**

16 shtator 1961

Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë mësoi me keqardhje për vendimin e padrejtë të Qeverisë Sovjetike, sipas të cilit gjithë qytetarëve civilë të Republikës Popullore të Shqipërisë u pritët praktikisht mundësia për të ndjekur studimet në shkollat e ndryshme të Bashkimit Sovjetik, ndërsa oficerët dhe kursantët ushtarakë të Ushtrisë Popullore të Shqipërisë me vendim të Qeverisë Sovjetike janë zbur nga shkollat ushtarake sovjetike dhe kthyer në Shqipëri. Nuk mund ta konsiderojmë ndryshe këtë masë të udhëheqësve të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe të Qeverisë Sovjetike, veçse si një hallkë të re në vargun e veprimeve antishqiptare e të presioneve të shumëllojshme kundër Partisë dhe popullit tonë, që bëhen me qëllim që të krijohen vështirësi në ndërtimin e socializmit në Republikën Popullore të Shqipërisë, të keqësohen akoma më tej marrëdhënjet midis dy partive dhe vendeve tona. Një veprim i tillë nuk pajtohet aspak me parimet e bashkëpunimit e të ndihmës reciproke vëllazërore, që duhet të karakterizojnë marrëdhënjet midis vendeve socialiste dhe partive komuniste e punëtore motra, ai është krejt në kundërshtim me frymën e internacionalizmit proletar dhe dëmton rëndë interesat e forcimit të unitetit të kampit socialist e të lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Ata që mendojnë se, me veprime të tilla arbitrare, me presione e masa të tjera jomiqësore, mund të gjunjëzohen Partia dhe populli ynë, të largohen ata nga pozitat e tyre të drejta parimore, gabojnë rëndë. Veprime të tilla nuk do të kenë kurrë sukses.

Partia e Punës e Shqipërisë ka gjetur kurdoherë te Partia

¹ Më 16 shtator 1961 u thirr në Drejtorinë e Jashtme të KQ të PPSH i ngarkuari me punë a. i. i BRSS në RPSH, P.G. Krekotenj, të cilit ju dorëzua kjo promemorje. Ai, pasi e lexoi promemorjen, refuzoi ta merrte në dorëzim.

e lavdishme Komuniste e Bashkimit Sovjetik një përkrahje e mbështetje vëllazërore internacionaliste në të gjitha fushat. Midis të tjerash, për vjete me radhë Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik i kishte dhënë mundësi Partisë së Punës të Shqipërisë që të dërgonte për studime në Shkollën e Lartë pranë Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik me dhjetëra kadro të Partisë, të cilët jo vetëm pajiseshin me kulturën marksiste-leniniste, por njiheshin drejtpërdrejt me jetën e popullit sovjetik, me luftën e tij të madhe për ndërtimin e komunizmit dhe merrnin direkt eksperiencën e çmuar të Partisë së madhe të Leninit. Kuadrot tanë që kanë studjuar në Shkollën e Lartë të Partisë pranë Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, jo vetëm që kanë ditur si të përfitojnë kulturë dhe të përvetësojnë teorinë marksiste-leniniste në shkollë, por ata kanë punuar me të gjitha forcat dhe energjitë e tyre për forcimin e miqësisë midis të dy popujve dhe vendeve tona; ata, të edukuar nga Partia e Punës e Shqipërisë, si anëtarë të denjë të saj, si gjatë kohës së studimit në Bashkimin Sovjetik ashtu edhe tani kanë bërë e bëjnë një punë të madhe e shumë të vlefshme për ta zbatuar e përhapur në Partinë e në vendin tonë eksperiencën e madhe të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe punojnë për ta ruajtur dhe forcuar akoma më shumë miqësinë dhe dashurinë e popullit tonë ndaj Bashkimit të lavdishëm Sovjetik dhe Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. Për këtë ndihmë të çmuar internacionaliste Partia e Punës e Shqipërisë ka qenë dhe do t'i jetë kurdoherë mirënjohëse Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik.

Si duket, udhëheqja e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe Qeveria Sovjetike në vazhdim të gjithë veprimtarisë armiqësore që kanë ndërmarrë ndaj Partisë dhe vendit tonë, nuk munguan të marrin edhe këtë masë, t'u heqin mundësinë kuadrove të Partisë dhe të shtetit tonë, të mësojnë në Shkollën e Lartë të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik me po ato kushte që kanë mësuar deri në mbarim të vitit shkollor 1960-1961. Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë shfaq keqardhjen e tij të thellë ndaj këtij gjesti jomiqësor të udhëheqjes së Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe Qeverisë Sovjetike.

**KOMITETI QENDROR I PARTISË
SË PUNËS TË SHQIPËRISË**

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

**PLENUMI IV I PËRBASHKËT I KOMITETIT QENDROR TË
PPSH DHE I KOMITETIT QENDROR TË BRPSH**

Tiranë, 25-26 shtator 1961

KOMUNIKATË

**E Mbledhjes së Përbashkët të Komitetit Qendror
të PPSH dhe Komitetit Qendror të BRPSH**

Më datën 25 dhe 26 shtator 1961, u mbajt mbledhja e përbashkët e Komitetit Qendror të PPSH dhe e Komitetit Qendror të BRPSH, nën kryesinë e Sekretarit të Parë të Komitetit Qendror të PPSH, shokut Enver Hoxha.

Mbledhja dëgjoi e diskutoi raportin e Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH «Kongresi IV i PPSH dhe detyrat për edukimin komunist e mobilizimin e mëtejshëm të rinisë për ndërtimin e plotë të socializmit në vendin tonë», mbajtur nga anëtari i Byrosë Politike dhe sekretar i Komitetit Qendror të PPSH, shoku Rita Marko dhe aprovoi vendimin përkatës.

Në mbledhje mbajti një fjalim shoku Enver Hoxha.

Si të ftuar në mbledhje muarën pjesë sekretarët e parë të komiteteve të Partisë dhe të komiteteve të rinisë të rretheve, si dhe punonjës të aparatit të Komitetit Qendror të Partisë dhe të Komitetit Qendror të Rinisë.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH
PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË BRPSH

VENDIM

**I PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PARTISË SË
PUNËS TË SHQIPËRISË «MBI FORCIMIN E MËTEJSHËM
TË PUNËS PËR EDUKIMIN KOMUNIST TË RINISË DHE
MOBILIZIMIN E SAJ PËR NDËRTIMIN E PLOTË TË
SHOQËRISË SOCIALISTE NË VENDIN TONË»**

26 shtator 1961

Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH, në mbledhjen e tij të përbashkët me Komitetin Qendror të BRPSH, që u mbajt në datën 25 dhe 26 shtator 1961, mori në shqyrtim detyrat që dalin nga vendimet historike të Kongresit IV të PPSH për edukimin komunist dhe mobilizimin e rinisë për ndërtimin e plotë të shoqërisë socialiste në vendin tonë. Plenumi konstatoi me kënaqësi se, që prej 20 vjetësh, organizata luftarake e Rinisë Komuniste Shqiptare (sot Bashkimi i Rinisë së Punës të Shqipërisë) ka qenë aruar vazhdimisht me besnikëri të patundur pranë Partisë, si rezervë e saj luftarake dhe kurdoherë ka mbështetur fuqimisht vijën e saj të përgjithshme marksiste-leniniste, duke luajtur kështu një rol të madh, si gjatë Luftës nacional-çlirimtare ashtu edhe në punën për ndërtimin e socializmit. Si kurdoherë, në unitet të çelniktë me Partinë, rinia dhe BRPSH aprovan plotësisht vendimet historike të Kongresit IV të PPSH dhe i janë përveshur punës me forca të shumëfishuara për t'i zbatuar ato.

Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH vërejti me kënaqësi të madhe se në procesin e revolucionit socialist që po kryhet në vendin tonë, në saje të udhëheqjes së Partisë dhe të kujdesit të saj të gjithanshëm për edukimin komunist të rinisë, kanë lindur dhe po kaliten te rinia tiparet karakteristike morale të njeriut të ri. Rinia jonë dallohet për patriotizmin e saj të lartë socialist, të cilin e shfaq kurdoherë dhe kudo që punon e mëson, duke u bërë kështu trashëgimtare e denjë e traditave të mëdha e të lavdishme të popullit tonë dhe e zonja për t'i pasuruar ato me përmbajtje të re socialiste. Shprehjen më të plotë të këtij patriotizmi, ajo e ka treguar dhe po e tregon në vendosmërinë e përkulur për mbrojtjen e pavarësisë dhe të sovranitetit të Republikës sonë Popullore, si dhe në punën e palodhur plot vetëmohim dhe heroizëm për lulëzimin e atdheut, për ndërtimin e socializmit në qytet dhe në fshat.

Në vendin tonë është rritur dhe eçukuar një rini e guximshme, plot aftësi dhe talent, e cila punon me optimizëm për ta çuar veprën e ndërtimit të socializmit përpara, sepse asaj i janë

krijuar mundësi reale për të përvetësuar shkencën dhe teknikën, për të pushtuar kalanë e diturisë. Me gëzim i shijon populli frutet e para të punës së kuadrove të rinj teknikë e shkencorë, të cilët, së bashku me kuadrat e vjetër, po tregojnë jo vetëm patriotizëm të lartë në punën vetëmohuese në të mirën e atdheut tonë socialist, por edhe zotësi të mëdha në shfrytëzimin e teknikës, në zbulimin e pasurive të tokës dhe të nëntokës, për t'i rrëmbyer natyrës gjithshka që mund të kthehet në vlera të dobishme materiale për rritjen e mirëqenjes së popullit.

Masat e gjera të rinisë dhe organizatat e BRPSH, nën udhëheqjen e Partisë, kanë treguar bindje të thellë dhe besnikëri të pakufi ndaj ideologjisë së Partisë, ndaj marksizëm-leninizmit dhe kjo duket kudo, në punë dhe në veprimtarinë e gjithanshme ideopolitike dhe kulturalë që ato zhvillojnë dhe që nga viti në vit shkon duke u rritur. Rinia jonë zhvillon një jetë të gjallë në lëmin e kulturës, të arteve, letërsisë, pikturës dhe fiskulturës, si në qytet edhe në fshat, duke treguar rritjen e nivelit të saj arësimor e kultural dhe në të njëjtën kohë pajisjen e saj me moral të shëndoshë, me një botë shpirtërore shumë të pasur, ku mbi gjithshka sundon ideali për një jetë të lumtur, që mund të gjejë realizimin e vet vetëm në socializëm. Në fytyrat plot gjallëri dhe shëndet të fëmijëve tanë, të shpresës së ardhshme të atdheut, në gjallërinë, forcën e shëndetit e rinisë sonë, në zhvillimin e saj kultural, pasqyrohen në mënyrë të shkëlqyer realizimet e mëdha të pushtetit tonë popullor.

Tabloja e rinisë sonë dëshmon mbi forcën e madhe edukuese të Partisë, e cila, pa u kursyer, e ka rrethuar rininë me kujdesin e nënës për fëmijën, dëshmon për vitalitetin e madh të Partisë dhe të pushtetit popullor, për freskinë e shoqërisë sonë pa klasa antagonistë, për triumfin e pashmangshëm të socializmit dhe të komunizmit. Prandaj ndjenjat më të thella, fjalët më të zjarrta të mirënjohjes së pakufi brezi i ri dhe organizata e tij luftarake i kanë thurur për Partinë, me të cilën kanë lidhje gjaku, lidhje që nuk kanë mort kurrë.

Vendimet e Kongresit IV të Partisë, i cili shënoi hyrjen e vendit tonë në një etapë të re historike — në etapën e ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste, e cila kërkon kalitjen e mëtejshme politike, ideologjike e tekniko-profesionale të rinisë, rritjen e ndërgjegjes së saj socialiste, si dhe situata ndërkombëtare, shtrojnë përpara Partisë detyra akoma më të mëdha për ta pasur rininë kurdoherë mbështetje të fuqishme për realizimin e programit të saj dhe BRPSH ndihmëse besnike dhe rezervë luftarake.

Në raportin që mbajti në Kongresin IV të PPSH në emër të KQ të PPSH, shoku Enver Hoxha përcaktoi një program të qartë të punës që duhet të bëjë Partia me rininë. Ai tha:

«Rininë duhet ta edukojmë me normat e moralit komunist, me qëndrimin e papajtueshëm ndaj shfaqjeve të ideologjisë borgjeze, ta bëjmë që të zgjerojë dijet e saja politike e tekniko-profesionale, të ushqehet vazhdimisht me traditat e lavdishme të popullit tonë dhe me heroizmin e ditëve të sotme, të edukohet me qëndrimin socialist ndaj punës dhe pronës shoqërore, me dashurinë për atdheun dhe me besimin e patundur në triumfin e çështjes së socializmit dhe të komunizmit»¹.

Pikërisht për vënjen në jetë të këtij programi duhet të punojnë Partia dhe BRPSH.

I

Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH theksoi se detyra themelore në punën e Partisë me rininë dhe në tërë veprimtarinë e BRPSH në kohën e sotme, është propagandimi i vijës së drejtë të Partisë dhe i programit të zhvillimit ekonomik, kultural e shoqëror të vendit që u përcaktua në Kongresin IV të Partisë, në mënyrë që rinia t'i kuptojë drejt e thellë ato dhe të mobilizohet me të gjitha forcat, për të plotësuar me nder detyrat e rëndësishme që shtrohen para saj në etapën e tanishme të ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste.

Hovi i fuqishëm patriotik që ka rrëmbyer kudo masat e gjera të rinisë në punë për plotësimin dhe tejkalimin e detyrave madhështore të planit të tretë pesëvjeçar, rritja e vigjilencës revolucionare për mbrojtjen e atdheut socialist nga të gjitha orvatjet kriminale të imperialistëve amerikanë dhe të shërbëtorëve të tyre, revizionistëve jugosllavë dhe monarko-fashistëve grekë, vërtetojnë se rinia jonë i ka kuptuar drejt vendimet historike të Kongresit IV të PPSH, nxjerrin në pah me qartësinë më të madhe se ne kemi një rini të mrekullueshme, të pastër, të vendosur deri në fund për çështjen e socializmit dhe të edukuar me një besnikëri të pakufishme ndaj Partisë sonë të lavdishme.

Qëndrimi heroik i rinisë sonë e ka burimin te vija e drejtë marksiste-leniniste që ka ndjekur kurdoherë Partia jonë në të gjitha çështjet dhe situatat, te lufta e saj e vendosur kundër imperialistëve dhe shërbëtorëve të tyre, revizionistëve, për mbrojtjen

¹ Enver Hoxha, Raport mbi aktivitetin e KQ të PPSH. Kongresi IV i PPSH, f. 137. Tiranë, 1961.

tjen e atdheut tonë socialist dhe të marksizëm-leninizmit, e ka burimin te puna e madhe edukative ideo-politike që zhvillon Partia me masat e gjera të rinisë dhe te rezultatet e punës së mirë që zhvillon BRPSH.

Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH porositi që të merren masa për një përmirësim të mëtejshëm të punës së Partisë dhe BRPSH, për edukimin komunist dhe ideo-politik të rinisë, duke siguruar një pjesëmarrje sa më masive të rinisë dhe sidomos të të rejave të fshatit në jetën politike të vendit, duke luftuar kundër formalizmit që vihet re aty-këtu në punën politike me rininë, me qëllim që të bëhet një punë e mirë, e diferencuar sipas moshave, shtresave, zonave dhe me një cilësi më të lartë. Në punën ideo-politike me rininë është e domosdoshme t'u jepet sa më shumë gjallëri dhe të marrin përhapje të gjerë format e punës që janë tërheqëse e të dobishme. Puna e Partisë me rininë duhet të synojë në armatosjen akoma më të mirë të rinisë dhe të BRPSH për t'i bërë ato luftëtare përherë më të vendosura për vijën e Partisë, sepse kështu do të dërmohet më me sukses propaganda e armikut, e cila synon të ngjallë konfuzion, të krijojë iluzione të kota në rini për botën kapitaliste dhe kuptime false mbi jetën në marksizëm, përpiqet ta largojë atë nga problemet e vërteta që e preokupojnë, duke e thirrur për një jetë të shturur, pa përgjegjësi ndaj shoqërisë. Puna politike në rini duhet të shërbejë për mobilizimin e ndërgjegjshëm të rinisë në luftën për zbatimin e detyrave praktike të ndërtimit socialist dhe për mbrojtjen e atdheut, duke mbajtur kurdoherë në njërin dorë kazmën dhe në tjetrën pushkën. Të ruhet dhe të pasurohet veçoria karakteristike e punës edukative të Partisë sonë me rininë për kalitjen e saj në luftë me armiqtë dhe me vështirësitë. Të paharruara janë heroizmat e pashembullta të rinisë gjatë Luftës nacional-çlirimtare, të paharruara do të mbeten edhe heroizmat e vendosmëria e saj e papërkulur në luftë kundër vështirësive të rindërtimit të vendit, si dhe puna e madhe ndërtimtare e plot vetëmohim që bën ajo sot për ndërtimin e socializmit.

Partia dhe organizata e BRPSH duhet të zhvillojnë një punë të madhe për të sqaruar në rini problemet themelore të zhvillimit të sotëm botëror, probleme të luftës kundër ideologjisë borgjeze dhe revizionizmit në bazë të Deklaratës së Moskës të 81 partive komuniste dhe punëtore dhe vendimeve të Kongresit IV të PPSH.

Një punë e dendur duhet të zhvillohet në rini për demaskimin e kapitalizmit, të njohë ajo vuajtjet dhe mjerimet e rinisë në vendet kapitaliste, luftën e saj për punë, paqe e të drejta shoqërore. Kjo të shërbejë për të forcuar në rini bindjet për epër-

sinë dhe triumfin e pashmangshëm të socializmit mbi kapitalizmin. Në këtë çështje duhet të nisemi nga fakti se rinia e sotme nuk e ka jetuar vetë kapitalizmin. Nëpërmjet të gjitha formave të propagandës, të bëjmë që ajo të njihet me fatin e punëtorëve të vjetër, me fatin e atyre që kanë kaluar një pjesë të jetës në mërgim, duke punuar nën shfrytëzimin e egër të kapitalistëve, me fatin e bujkut që ka hequr të zitë e ullirit nën kërbacën e beut, i krehur në padije dhe në analfabetizëm, me fatin e intelektualëve, të cilët trajtoheshin si mos më keq dhe shpesh braktiseshin rrugëve me mospërfillje e liheshin pa punë. Nëpërmjet materialit faktik të jetës së sotme në vendet kapitaliste, t'i japim rinisë një tablo sa më të gjallë të vuajtjeve dhe të mjerimeve të rinisë në vendet kapitaliste. Në këtë mënyrë të luftohet në rini propaganda e armikut, e cila përpiqet ta lustrujë jetën në botën kapitaliste dhe njëkohësisht të demaskohet kapitalizmi, plagët e tija të pashërueshme dhe shkaqet që e brejnë këtë sistem të urryer.

Krahas luftës për demaskimin e kapitalizmit, imperializmit dhe ideologjisë borgjeze, vazhdimisht duhet të demaskohet në rini revizionizmi modern dhe veçanërisht ai jugosllav. Nën udhëheqjen e Partisë, rinia ka luftuar pa mëshirë tentativat e revizionistëve jugosllavë dhe të agentëve të tyre Koçi Xoxe, Pandi Kristo etj., që synonin në dobësimin e rolit të organizatës së rinisë dhe të vetë rinisë, për t'ja shkëputur Partisë këtë forcë të madhe kolosale. Ajo ka luftuar me konsekuencë kundër oportunistëve të të gjitha markave, që nga Tuk Jakova e Bedri Spahiu e deri te Liri Belishova e Koço Tashko. Armiqtë e Partisë nuk kanë mundur asnjëherë, në asnjë rrethanë, të prekin sado pak, unitetin e çelniktë të Bashkimit të Rinisë dhe të të gjithë rinisë me Partinë, me udhëheqjen e saj, Komitetin Qendror të PPSH, dashurinë e pakufi që ka rinia jonë për shokun Enver, sepse kurdoherë rinia dhe organizata e saj luftarake e kanë konsideruar udhëheqjen e Partisë si faktorin kryesor të të gjitha sukseseve të rinisë dhe të BRPSH, garanci për të ardhshmen e lumtur të popullit dhe të rinisë.

Plenumi theksoi se një punë e madhe duhet të bëhet për edukimin e rinisë me traditat patriotike revolucionare të popullit tonë, veçanërisht me traditat e Luftës nacional-çlirimtare. Duke njohur sa më mirë të djeshmen, rinia do të dijë të vlerësojë si duhet të sotmen, do të njohë përpjekjet që janë dashur për triumfin e revolucionit popullor. Kështu do të veprojë më aktivisht, për të ngritur lart e më lart lavdinë e popullit tonë heroik e të talentuar. Mësimi i së kaluarës duhet t'i shërbejë të tanishmes e së ardhshmes, heroika e së djeshmes duhet lidhur ngushtë me heroikën e viteve të pasçlirimit dhe me atë të ditëve tona në fabrika, kooperativa bujqësore, në aksione, në çdo front të luftës

për ndërtimin e socializmit. Partia ka për detyrë të shenjtë të rritë në rini besimin në aftësitë krijuese dhe në forcat e pashtershme të popullit, i cili ka qenë dhe është faktori vendimtar i të gjitha fitoreve tona. Sidomos në këtë vit jubilar të 20-vjetorit të themelimit të Partisë sonë të lavdishme dhe të 20-vjetorit të organizatës së rinisë sonë heroike, të zhvillohet një punë e gjithanshme për t'ja bërë sa më të njohur brezit të ri rrugën heroike të Partisë, epopenë e lavdishme të komunistëve, që me veprat e tyre kanë sintetizuar dhe kanë ngritur në lartësi të madhe çdo gjë të mrekullueshme, heroike dhe fisnike të popullit dhe të rinisë sonë. Edukimi patriotik i rinisë duhet t'i shërbejë rritjes së vigjilencës revolucionare për mbrojtjen e fitoreve të revolucionit popullor, të lirisë e të pavarësisë së atdheut. Partia dhe Bashkimi i Rinisë duhet të bëjnë një punë edhe më të madhe që të forcojnë në rini dashurinë për forcat e armatosura, për ushtrinë dhe për repartet e kufirit e të ndjekjes, për Sigurimin e Shtetit, armë të pamposhtura të diktaturës së proletariatit. Të rinjtë e ushtrisë dhe të BRPSH në ushtri, nën udhëheqjen e Partisë, kanë arritur rezultate të shkëlqyera në përgatitjen ushtarako-politike, në zotërimin e teknikës moderne luftarake. Është e domosdoshme që organet politike, organizatat e Partisë dhe ato të BRPSH në ushtri dhe në repartet e kufirit të bëjnë një punë edhe më të përsosur për rritjen në një shkallë më të lartë të gatishmërisë së përhershme luftarake, të përhapet lëvizja organizatë rinie shembëllore, të mprehet vigjilenca politike në radhët e të rinjve, për të zbuluar e goditur me kohë të gjithë armiqtë e Republikës Popullore të Shqipërisë.

Edukimi i rinisë me atdhedashurinë e patriotizmin socialist duhet të bëhet lidhur ngushtë me edukimin e saj me frymën e internacionalizmit proletar. Rinia jonë duhet të ushqehet, siç e ka vënë në dukje kurdoherë Partia, me eksperiencën e Komso-molit leninist të Bashkimit Sovjetik, ajo duhet të forcojë e të çelnikosë dashurinë dhe miqësinë e pakufi për popujt dhe rininë sovjetike, miqësi e lindur në luftën kundër fashizmit, e kalitur nga Partia jonë dhe e bazuar në interesat e përbashkëta të ndërtimit të socializmit dhe komunizmit, miqësi popujsh që do të rrojë në shekuj. Gjithashtu ajo duhet të forcojë miqësinë me popujt e rininë e vendeve socialiste, si dhe solidaritetin me rininë që lufton kundër kolonializmit dhe imperializmit, për çlirimin nacional, kundër shfrytëzimit të kapitalit gjakatar. Të rritet më tej pjesëmarrja aktive e rinisë sonë në Federatën Botërore të Rinisë Demokratike dhe në Bashkimin Ndërkombëtar të Studentëve për forcimin e unitetit të lëvizjes ndërkombëtare të rinisë e studentëve. Rinia duhet të vazhdojë të edukohet me ndjenjën e urrejtjes kundër imperialistëve luftënxitës me ata të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në krye.

Në situatën aktuale, forcat agresive të imperializmit, të kryesuar nga ato të SHBA-së, po e shpien njerëzimin në prakun e rrezikut të shpërthimit të luftës së tretë botërore, atomike. Militaristët dhe revanshistët e Gjermanisë Perëndimore janë bërë kërcënimi serioz për paqen. Pikërisht për këto arsye Partia dhe qeveria, gjithë populli dhe rinia jonë kanë mbështetur fuqimisht propozimet e Bashkimit Sovjetik për nënshkrimin brenda këtij viti të Traktatit të Paqes me Gjermaninë për zgjidhjen e problemit të Berlinit Perëndimor, si dhe masat e fundit të qeverisë sovjetike për rifillimin e provave të armëve bërthamore dhe për forcimin e aftësisë mbrojtëse të Bashkimit Sovjetik. Në këtë situatë, Partia, populli dhe rinia jonë duhet të forcojnë vazhdimisht vigjilencën revolucionare, të demaskojnë pa mëshirë luftënxitësit imperialistë dhe të gjitha veglat e tyre, të çelnikosin më tej fuqinë mbrojtëse të atdheut, të ruajnë e të forcojnë unitetin e kampit socialist me Bashkimin Sovjetik në krye, faktor kryesor për sigurimin dhe triumfin e kauzës së paqes dhe të socializmit në botë.

Puna politike në rini duhet të ketë karakter konkret dhe luftarak, të jetë e faktuar dhe e argumentuar mirë. Propaganda e Partisë duhet t'u bëjë ballë problemeve që dalin dhe t'i sqarojë me durim të rinjtë. T'i kushtohet rëndësi punës së diferencuar me kategoritë e ndryshme të të rinjve, të luftohet njëlojshmëria dhe të mbahen parasysh si duhet moshat, profesionet, si dhe zonat e ndryshme me problemet e tyre të veçanta. Puna me rininë intelektuale, studenteske e shkollore duhet të bëhet në një nivel më të lartë, në përshatje me kërkesat e saja. Kujdes gjithnjë e më i madh të tregohet për perfeksionimin e formave e të mjeteve të punës politike. Një sërë eksperiencash pozitive të përdorimit të formave me efekt siç janë gazetatat folëse, festimi i ditës së themelimit të organizatës bazë të rinisë, mbledhjet «Pyetje e përgjigje», mbrëmjet tematike, mbledhjet ceremoniale të pionierëve e të rinisë para monumenteve, lapidareve, shtëpive e qendrave me rëndësi historike, organizimi i ekskursioneve në vendet e luftimeve, mësimi i këngëve revolucionare, vizitat në muzeume etj. duhet të bëhen sistem pune për organizatat e BRPSH. Në të ardhshmen organizatat e Partisë të tregojnë më shumë kujdes për sistemin e arësimit politik në rini, të rritet niveli i punës me leksione, të caktohen në punën me rininë propagandistët më të mirë të Partisë.

Gazeta «Zëri i Rinisë» ka luajtur dhe luan një rol me shumë rëndësi në edukimin e rinisë. Ajo duhet të pasqyrojë akoma më mirë dinamizmin e jetës së rinisë, të përhapë eksperiencën e përparuar, të përdorë gjini shkrimi sa më tërheqëse. Emisioni i radio Tiranës për rininë ta ngrejë më shumë nivelin e përmbajtjes së materialeve. Gazeta për fëmijë «Pionieri», si dhe revista «Fatosi»,

të cilat japin një ndihmë të çmueshme në edukimin komunist të fëmijëve, ta përmirësojnë më shumë punën e tyre. Partia ka theksuar më se një herë se puna ideo-politike me rininë është çështje me rëndësi të madhe partie. Prandaj, është e domosdoshme që me problemet e edukimit të rinisë të merren më seriozisht organizatat dhe komitetet e Partisë. Me këtë punë të merren më shpesh kuadrot kryesorë të Partisë dhe të pushtetit në rreth, si dhe institucionet e ndryshme shtetërore, kulturele dhe shoqërore.

II

Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH vërejtë se rinia jonë nën udhëheqjen e Partisë është shquar në punën për ndërtimin e socializmit jo vetëm për hovin e saj revolucionar, por edhe për inteligjencën, talentin, aftësitë e saja teknike dhe kulturele, të cilat janë rritur nga viti në vit.

Nga radhët e rinisë që mori pjesë aktive në veprat e pesëvjeçarëve kanë dalë kuadro punëtorë të kualifikuar, inxhinierë dhe drejtues të ekonomisë. Në tërë punën e saj Partia ka pasur parasysh se duke mobilizuar rininë në punë, duke i besuar asaj vepra të mëdha dhe të vogla, do të plotësoheshin me nder jo vetëm detyrat ekonomike, por njëkohësisht do të edukohesh brezi i ri, do të formohesh njeriu i ri, me tipare karakteristike të njeriut të socializmit.

Partia ka vënë re me kënaqësi se rinia shquhet për ndërgegje të lartë socialiste në punë, për iniciativë dhe veprimtari krijuese. Lëvizja e brigadave të punës socialiste, iniciativa për të realizuar pesëvjeçarin në katër vjet e gjysmë, lëvizja «1+2», iniciativa për grumbullimin e metaleve, naftës etj. tregojnë shkallën e lartë të mobilizimit dhe ndërgjegjen e rinisë punëtoare. Gjithashtu, rinia fshatare, e cila përqafoi me entuziazëm vijën e Partisë për kolektivizimin e bujqësisë, me pjesëmarrjen e saj të gjallë në bujqësi, në lëvizjen e skuadrave të punës socialiste dhe të rendimenteve të larta, me pjesëmarrjen e saj në blegtori, në lëvizjen e 300-ditshit, në realizimin e planeve të avancuara të pemëve frutore, të ullirit, të pyllëzimeve etj. po tregon se edhe në fshat ka lindur dhe po kalitet njeriu i ri.

Realizimi i planit të tretë pesëvjeçar që aprovoi Kongresi IV i Partisë kërkon mobilizimin e të gjitha energjive krijuese të masave, ai kërkon në radhë të parë të vihen në shërbim forca, mundi, djersa dhe aftësitë e rinisë sonë heroike. Komitetet e Partisë dhe BRPSH ta shikojnë mobilizimin e rinisë në punë jo vetëm duke u nisur nga fakti se fronti kryesor i luftës sonë është puna dhe prodhimi, por edhe se rinia do të edukohet në punë e

nëpërmjet punës. Partia dhe organizatat e bashkimit të rinisë ta mobilizojnë rininë punëtoare për rritjen e rendimentit në punë dhe shfrytëzimin e regjimit të kursimeve. Ato duhet të nxitin dhe të përkrahin iniciativat e shkëlqyera të rinisë në prodhim siç janë, lëvizja e brigadave të punës socialiste, lëvizja «1+2», iniciativa për të realizuar pesëvjeçarin në katër vjet e gjysmë, duke realizuar orë-normat nga çdo i ri dhe e re, grumbullimi i metaleve, i naftës, iniciativa për shpikje dhe racionalizime, për prodhimin e mjeteve të këmbimit në vend etj.

Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH duke pasur besim të madh në forcën dhe në energjinë krijuese të rinisë sonë heroike dhe të organizatës së saj luftarake, BRPSH, e ngarkon rininë që të ketë nën patronazh këto vepra të rëndësishme të pesëvjeçarit të tretë: 1) Minierën e bakrit në rrethin e Kukësit (Gjegjan), e cila do të fillojë vitin e ardhshëm (1962), bashkë me metalurgjinë që do të ngrihet aty; 2) Uzinën metalurgjike që do të ngrihet në Elbasan dhe 3) Kombinatin e tekstileve në Berat. Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH shpreh bindjen se rinia jonë heroike, ashtu si kurdoherë, do të tregojë vendosmëri, aftësi, zgjuarësi dhe talent në kryerjen e detyrave që do t'i ngarkohen për përfundimin me sukses të objekteve të mëdha të pesëvjeçarit të tretë.

Për zbatimin e vendimeve të Kongresit IV të Partisë për bujqësinë, një rol i veçantë i takon rinisë dhe organizatave të BRPSH, të cilat duhet të qëndrojnë në ballë të luftës për forcimin e mëtejshëm organizativo-ekonomik të kooperativave bujqësore. Zbatimi në kompleks i kodit agroteknik të konsiderohet fronti kryesor i luftës së rinisë për rendimente të larta në bujqësi. Të përhapen kudo iniciativat e rinisë në bujqësi, lëvizja e skuadrave të punës socialiste dhe e skuadrave që luftojnë për rendimente të larta. BRPSH të përqëndrohet në këto aksione konkrete në bujqësi: 1) në realizimin e planit të shtetit për zhvillimin e frutikulturës dhe olivikulturës; 2) në pyllëzimin dhe mbrojtjen nga erozionet; 3) në dërgimin e të rinjve e të rejave në blegtori, në lëvizjen për të marrë 1 200-3 000 litra qumësht nga çdo lopë, ose 100 litra mbi planin, në sigurimin e bazës ushqimore.

Detyrat e mëdha që dalin para rinisë do të kryhen në saje të punës së Partisë dhe të BRPSH, e cila duhet të përqëndrohet në dy drejtime kryesore: së pari, në ngritjen e mëtejshme të shkallës së ndërgjegjes socialiste në punë dhe së dyti, në edukimin tekniko-profesional të rinisë punëtoare dhe agrozooteknik të rinisë fshatare.

Tani, që vendi ynë arriti të përfundojë me sukses ndërtimin e bazës ekonomike të socializmit, tani që kanë triumfuar marrëdhënjet e reja socialiste në prodhim dhe çështja e mobili-

zimit të masave në punë dhe e sigurimit të pjesëmarrjes së tyre në ruajtjen dhe në administrimin e pronës shoqërore shtrohet me tërë mprehtësinë e saj, edukimi i rinisë për një qëndrim të ndërgjegjshëm socialist ndaj punës dhe pronës shoqërore merr rëndësi të veçantë. Te ne shumë fakte flasin qartë mbi qëndrimin e ndërgjegjshëm socialist të rinisë ndaj punës dhe ndaj pronës. Por puna e Partisë dhe e BRPSH me rininë duhet të synojë në luftën për mënjanimin e mbeturinave mikroborgjeze, për një kuptim më të drejtë dhe më të thellë të nevojës për harmonizimin e interesave personale me ato të të gjithë shoqërisë, për zbatimin me rigorozitet të parimit «kush nuk punon, nuk ha». Organizatat e Partisë dhe ato të rinisë në qendrat e prodhimit dhe veçanërisht në kooperativat bujqësore, duhet t'ja bëjnë sa më të qartë rinisë nevojën e një qëndrimi socialist ndaj punës, sepse puna është baza e jetës së shoqërisë, burimi kryesor i pasurive materiale dhe shpirtërore. Patriotizmi popullor dhe internacionalizmi socialist, romantika revolucionare dhe heroizmi i ditëve tona konsistojnë pikërisht në kryerjen me sukses të punës së sotme, e cila është begatia e së nesërme, e së ardhshmes së ndritur që e pret popullin tonë në rrugën e ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste. Të edukohet rinia me shembullin e heronjve të punës socialiste, me shembullin e punëtorëve të dalluar në prodhim.

Një rëndësi të veçantë merr puna e Partisë me rininë për ta bërë atë luftëtare kundër qëndrimeve konservatore, prapanike e mikroborgjeze ndaj punës, kundër paragjyqimeve fetare që pengojnë pjesëmarrjen në punë. Organizatat e Partisë dhe ato të rinisë të zhvillojnë një veprimtari të gjerë dhe qëndrimeve negative t'u kundërvënë shembullin e kolektivit, forcën e tij edukuese. Roli i kolektivit duhet ngritur në atë të celulës së vërtetë të shoqërisë socialiste, ku të triumfojë vetëm e reja dhe ku çdo gjë e huaj të luftohet që në embrion, ku të ziejë jeta e gjallë plot aktivitet dhe iniciativa krijuese, ku të vlojë emulacioni socialist dhe më të dobët e të prapambeturit të ndihmohen e të ngrihen në radhën e të përparuarve, ku secili të respektojë dhe të zbatojë parullën «një për të gjithë, të gjithë për një». Organizatat e rinisë duhet të luftojnë shfaqjet e egoizmit, individualizmit, mendjemadhësisë dhe shpirtvogëlsisë, si në punë ashtu edhe jashtë saj. Të luftojnë rastet kur më «i afti» ngurron të ndihmojë më të riun, apo të prapambeturin, kur njëri apo tjetri e vë veten mbi kolektivin, kur paaftësinë, dembelizmin ose mungesën e vullnetit ndonjëri mundohet ta mbulojë me llafazanllëk e servilizëm ndaj përgjegjësve, me mungesë sinqeriteti dhe shpifje ndaj shokëve. Të tilla shfaqje të neveritshme organizata duhet t'i luftojë me forcë me anën e kritikës e të autokritikës dhe me punë të vazhdueshme edukative. Rinia duhet

të bëhet kudo luftëtare, për të vënë rregull shembëllor dhe disiplinë në punë.

T'u shpjegohet herë pas here të rinjve përmbajtja e masave që merr Partia për zhvillimin e ekonomisë socialiste, në mënyrë që ata t'i kuptojnë edhe më mirë detyrat që u dalin. Vendimet e Kongresit IV të PPSH mbi ritmet e larta të pandërprera të zhvillimit të prodhimit industrial, mbi shtimin e degëve të reja të industrisë të pajisura me teknologji të përparuar, kërkesat e kohës për të vënë në zbatim metodat e përparuara dhe realizimet e shkencës etj. kanë vënë përpara si detyrë të menjëhershme edukimin tekniko-profesional të rinisë. Gjithashtu, orientimi i Kongresit IV të PPSH për zhvillimin e mëtejshëm të bujqësisë, duke ndjekur si rrugë kryesore intensifikimin e bujqësisë, rritjen e pandërprerë të rendimenteve të kulturave bujqësore dhe shtimin e prodhueshmërisë së bagëtisë, nxjerrin si detyrë të menjëhershme edukimin agrozooteknik të rinisë. Sot nuk mund të bëhet asnjë hap përpara pa njohuritë e domosdoshme profesionale, prandaj më shumë se kurdoherë, edukimi tekniko-profesional i rinisë mund të konsiderohet detyra numër një për organizatat e Partisë, për organet shtetërore dhe për organizatat e rinisë. Përgatitja dhe kualifikimi i kuadrit kanë shkuar në përputhje me zhvillimin e vullshëm të ekonomisë popullore dhe sukseset e arritura në këtë drejtim janë të mëdha. Ato dëshmojnë jo vetëm për zhvillimin e madh të ekonomisë dhe aftësimin e klasës sonë punëtoare, por edhe për mundësitë e pakufizuara që janë krijuar në vendin tonë për pajisjen e rinisë me profesione, për ta futur atë sa më të përgatitur në jetë, për ta bërë të luajë rol pararojë në prodhim, për ta bërë luftëtare për përparimin teknik.

Plani i tretë pesëvjeçar synon të pakësojë disnivelele që ekzistonin midis kërkesave për kuadro të kualifikuar dhe masës së sigurimit të tyre nga njëra anë, si dhe midis nivelele të lartë të teknikës me të cilën po pajiset vazhdimisht ekonomia jonë dhe përgatitjes profesionale të rinisë, nga ana tjetër. Këtyre detyrave duhet t'u përgjigjet rinia, sepse niveli i ulët tekniko-profesional ndikon negativisht në rezultatet e punës. Edhe përgatitja e ulët agrozooteknike në bujqësi e në blegtori ndikon negativisht në prodhimin bujqësor dhe blegtoral. Kongresi IV i PPSH caktoi detyra të rëndësishme lidhur me përgatitjen e kuadrit. Sipas planit të tretë pesëvjeçar, në vitin 1965 do të kemi 9 700 kuadro të lartë, kundrejt 4 700 që kemi tani dhe 35 100 kuadro të mesëm, kundrejt 20 000 që kemi tani. Në kurset dhe në shkollat do të përgatiten gjithashtu mbi 57 000 punëtorë të rinj të kualifikuar dhe në të njëjtën kohë do të ngrihen aftësitë e jo më pak se 115 000 punëtorëve specialistë. Këto janë detyra të mëdha, për plotësimin e të cilave, nën drejtimin e Partisë, organet shtetërore, shkollat dhe organizata e BRPSH duhet të vënë të gjitha forcat.

Rëndësi e veçantë t'i kushtohet edukimit profesional të punëtorëve nëpërmjet kurseve të kualifikimit pa ndërprerje nga puna. Bashkimet Profesionale dhe BRPSH të mobilizojnë punëtorët e rinj që, duke filluar nga klasa e pestë e poshtë, të marrin çdo vit arësim teknik të detyruar për një dhe dy klasa më lart nga klasa në të cilën ndodhen efektivisht. Për rezultate më të mira në këtë punë duhet, së pari, t'u bëhet e qartë punëtorëve, nevoja e ngritjes profesionale, se po nuk mësuam, nuk do të mund ta kryejnë atë punë që u është ngarkuar. Kjo është e domosdoshme për ndjekjen e rregullt të kurseve. Së dyti, të sistemohej programet në mënyrë që të mos ketë përsëritje të kota dhe t'u përgjigjen nevojave, të mbajnë parasysh nivelin arësimor dhe profesional të punëtorëve. Së treti, për drejtimin e kurseve, si instruktorë, të zgjidhen kadro inxhiniero-teknikë nga më të aftët. Së katërti, t'i jepet kudo rëndësi më e madhe organizimit dhe përhapjes së lëvizjes «1+2». Nuk duhet të ketë ndërmarrje ku të mos vihet në jetë një metodë e tillë. Burim i pashtershëm kuadrosh janë shkollat. Organizatat e Partisë, të rinisë dhe organet ekonomike duhet të tregojnë më shumë kujdes për shkollat në përgjithësi dhe veçanërisht për shkollat e rezervave të punës.

Edukimi agrozooteknik i rinisë fshatare kooperativiste është sot kusht i domosdoshëm për përparimin e bujqësisë. Për edukimin agrozooteknik të masave dhe veçanërisht të rinisë, është bërë një punë e madhe nëpërmjet kurseve me shkëputje dhe pa shkëputje nga puna, nëpërmjet teknikumeve dhe Institutit të lartë shtetëror të bujqësisë. Plani i tretë pesëvjeçar ka vënë detyrë që të kalojnë në teknikumet bujqësore 2 000 nxënës, të marrin arësim të lartë bujqësor mbi 1 000 vetë dhe të kryejnë kurset agrozooteknike mbi 3 000 të rinj e të reja. Për zbatimin e këtyre detyrave ekzistojnë si baza ashtu edhe kadri i nevojshëm. Për rezultate më të mira duhet, së pari, të ngrihen detyrimisht kurse me program dyvjeçar në të gjitha kooperativat, ku ka agronomë ose teknikë të mesëm. Pjesëmarrja në to të mos jetë e kufizuar si deri tani. Ministria e Bujqësisë të sigurojë tekstet e nevojshme dhe organet e saj të kujdesen për punën që duhet të bëjë kadri agronom e zooveteriner. Së dyti, të zgjerohet praktika e ngritjes së kurseve të shkurtëra pranë NBSH-ve nga vetë rrethet. Së treti, të zhvillohen më gjerësisht me rininë konsultat, seminarët, veçanërisht ekskursionet bujqësore dhe të përfitohet nga eksperiencia e bujqve të përparuar. Të tregohet kujdes më i madh për shkollat bujqësore.

Për të përballuar me sukses detyrën e edukimit tekniko-profesional, është e domosdoshme që kjo punë të lidhet ngushtë me edukimin arësimor. Rinisë i takon e ardhshmeja, prandaj ajo duhet të zotërojë me këmbëngulje teknikën, diturinë, shkencën.

III

Duke marrë parasysh kërkesat e mëdha që shtroi pesëvjeçari i tretë për zhvillimin e vendit përgjithësisht dhe veçanërisht për arësimin dhe pregatitjen e kuadrit, si dhe faktin se përherë e më tepër zhvillimi i arësimit të ne po lidhet ngushtë me gjithë rininë, plenumi e konsideron shkollën si një nga frontet kryesore të punës së rinisë. Parulla «Mësimi dhe puna janë fronti kryesor i luftës së rinisë shkollë dhe studenteske» duhet të udhëheqë rininë në punën e saj. Në luftën për diturinë dhe shkencën, ajo të tregojë vullnet të pathyeshëm, guxim, durim dhe këmbëngulje.

Problemi i shkollës duhet të bëhet problemi i familjes, i organizatave shoqërore, i institucioneve arësimore-kulturale, duhet të bëhet problem i gjithë shoqërisë. BRPSH ka detyra të mëdha veçanërisht në shkollë. Ajo duhet të zhvillojë një aktivitet të gjithanshëm për të zgjuar të fëmijët dhe të rinjtë dashurinë dhe etjen për dijen, për t'u kalitur atyre vullnetin dhe këmbënguljen në kapërcimin e vështirësive që u dalin në këtë rrugë, për t'u mësuar se pushtimi i shkencës është detyra kryesore patriotike dhe shoqërore e tyre.

Organizatave e BRPSH, nën udhëheqjen e Partisë, të ndihmojnë shkollën dhe mësuesit, për ta bërë problemin e përparimit një problem shoqëror, për të siguruar një përparim të lartë të nxënësve në mësim, për të mos lejuar prapambetjen, të krijojnë për këtë një opinion shoqëror aktiv dhe luftarak midis nxënësve, duke mënjeluar pakujdesinë e përtacinë, duke organizuar kontrollin shoqëror dhe ndihmën reciproke. Drejtoritë dhe kolektivat pedagogjikë të shkollave, nga ana e tyre duhet të nxitin dhe të përkrahin iniciativat e organizatës së pionierit dhe të rinisë, që janë në dobi të përparimit dhe përgjithësisht të edukimit komunist të rinisë e pionierëve.

Komitetet dhe organizatat bazë të Partisë duhet të ndihmojnë organizatat e rinisë, si dhe organizatën e pionierit, që e gjithë puna të bëhet e gjallë dhe të drejtohet në zgjidhjen e detyrave konkrete dhe me cilësi të lartë. Të mënjanohej rastet e formalizimit dhe të kënaqjes me pak dhe frutet e punës të shihen nga përmbajtja e veprimtarisë që zhvillon dhe nga përfundimet në mësim.

Plenumi i Komitetit Qendror porositi që t'i kushtohet rëndësi e madhe rolit të organizatës së rinisë dhe të pionierit për riorganizimin e shkollës, sidomos pjesëmarrjes së rinisë shkollë në punë. Lidhjes së shkollës me jetën, të teorisë me praktikën, që përbën përmbajtjen themelore të reformës së re shkollë, duhet t'i kushtohet veprimtaria kryesore e organizatës së rinisë dhe të pionierit brenda e jashtë shkollës. Duke i lidhur ngushtë nxënësit dhe studentët me përvetësimin e lëndëve teorike

dhe me praktikën e ndërtimit të socializmit, ku shembullin më të mirë duhet ta japin anëtarët e BRPSH dhe pionierët, do të përgatiten kuadro të aftë për të përballuar siç duhet detyrat në jetë. Organizatat e rinisë dhe të pionierit të merren konkretisht me luftën kundër disa dobësive që shfaqen në qëndrimin ndaj punës fizike dhe me luftën e disa pikëpamjeve të gabuara që duken aty-këtu te disa të rinj, të cilët u shmangen punëve të vështira, duan të qëndrojnë në qytet etj. Po kështu duhet të punojnë kundër zgjedhjes së njëanshme të disa profesioneve në kurriz të disa të tjerave dhe të zhvillojnë te të rinjtë dëshira dhe interesa të gjithanshme, t'i mësojnë të duan dhe të nderojnë të gjitha profesionet, të mësojnë të kuptojnë nevojat e vendit dhe të shoqërisë dhe t'i harmonizojnë dëshirat e kërkesat e tyre me këto nevoja.

Plenumi kërkoi që të bëhet një përmirësim rrënjësor në punën edukative me nxënësit nga organizata e rinisë dhe e pionierit dhe në radhë të parë nga vetë shkolla dhe mësuesit, që kjo punë të shihet si një mjet shumë efektiv për ngritjen e përparimit të nxënësve. Puna në organizatën e pionierit të zhvillohet e shkallëzuar dhe të mbajë parasysh moshën, nivelin dhe kërkesat e fëmijëve, të mos jetë monotone dhe uniforme, por sa më e gjallë dhe e diferencuar.

Në shkollat tona punon një armatë e tërë mësuesish që janë të rinj dhe anëtarë të BRPSH. Një nga detyrat e tyre më të rëndësishme duhet të jetë marrja e arësimit përkatës gjatë pesëvjeçarit të tretë. Organizatat e bashkimit të rinisë të mësuesve duhet të kërkojnë nga anëtarët e tyre që të jenë aktivistët më të dalluar.

Arësimi i natës, ku çdo vit marrin pjesë me mijëra të rinj, jo vetëm po i shërben prodhimit, por po bëhet njëkohësisht një rezervë e madhe për përgatitjen e kuadrit. Organizatat e Partisë dhe ato të rinisë të tregojnë më tepër vëmendje përgjithësisht për arësimin e natës, në mënyrë që të arrihen rezultate më të kënaqshme në zgjerimin e numrit të pjesëmarrësve dhe sidomos në ndjekjen e rregullt dhe në përfitimin në mësim. Shembullin në këtë drejtim duhet ta japin pjesëmarrësit e lëvizjes për të fituar titullin «Brigadë» apo «Skuadër e punës socialiste»

IV

Plenumi i Komitetit Qendror vuri në dukje se një rëndësi të madhe për edukimin e gjithanshëm të rinisë ka puna ideopolitike dhe kulturele që zhvillohet jashtë shkollës, puna për të ngulitur dashurinë për shkencën, teknikën, artin, literaturën,

fiskulturën, përgjithësisht puna për edukimin e rinisë me një qëndrim të ri socialist ndaj shoqërisë, kolektivit, familjes.

Plenumi vërejti me kënaqësi se rinia, si në qytet edhe në fshatin e kooperuar, lufton për t'u pajisur sa më tepër me arësim e kulturë, për të gjallëruar jetën e qendrës së prodhimit, jetën e kooperativës bujqësore, lufton që e reja socialiste të pushtojë të gjitha anët e jetës kolektive. Organizatat e Partisë dhe ato të BRPSH duhet t'i shohin problemet e edukimit kultural të rinisë nën prizmin e kushteve të reja të krijuara, të kërkesave gjithmonë në rritje të rinisë, e cila sot, edhe pse punon në fabrikë, mëson dhe ngrihet nga ana kulturele nën prizmin e kërkesave më të mëdha të rinisë fshatare të organizuar në kooperativa bujqësore. Me kujdesin e Partisë dhe të pushtetit popullor janë krijuar mundësi të mëdha dhe kushte të favorshme për edukimin e rinisë. Por përpara nesh qëndrojnë akoma mjaft probleme të rëndësishme, me të cilat duhet të merren seriozisht organizatat e Partisë, ato të rinisë, shkollat dhe institucionet kulturele.

Edukimi i rinisë me botëkuptimin materialist shkencor për ta bërë atë luftëtare të vendosur kundër zakoneve prapanike, paragjyqimeve të ndryshme dhe besimeve fetare, është një detyrë me rëndësi për organizatat bazë të Partisë dhe të rinisë, sidomos për disa zona ku influenca e fesë dhe prapambetja në të kaluarën kanë qenë më të theksuara. Organizata e BRPSH, nën udhëheqjen e Partisë, ka punuar dhe ka arritur suksese, të cilat duken në faktin se rinia jo vetëm nuk pajtohet me prapambetjen që përfaqësohet nga feja dhe nga zakonet prapanike, që janë mbeturina të së kaluarës, por dhe lufton aktivisht kundër tyre. Megjithatë, në këtë drejtim, propaganda e Partisë duhet të jetë më e madhe, më sistematike dhe më bindëse, sepse lufta kundër këtyre shfaqjeve negative, që ushqehen e mbahen gjallë nga kleri, si dhe nga mbeturinat e klasave shfrytëzuese, është një luftë e gjatë ideologjike, që ka të bëjë me çlirimin shpirtëror të njerëzve. Organizatat e Partisë ta ruajnë rininë nga influencat e dëmshme të fesë, të paragjyqimeve dhe zakoneve prapanike, sidomos të tregojnë më shumë kujdes për masat e të rejave dhe t'i hedhin masat e rinisë në luftë kundër këtyre shfaqjeve të dëmshme, që pengojnë ndërtimin e socializmit.

Lufta kundër zakoneve prapanike të lidhet ngushtë me punën e gjerë edukative që duhet bërë për të mbajtur gjallë dhe për të zhvilluar më tej zakonet e mira dhe vetitë e larta që ka trashëguar brez pas brezi populli ynë, si trimërinë, besën, mikpritjen, nderin, bujarinë, duke futur në to një përmbajtje të re si dhe duke zhvilluar e përhapur më shumë zakonet e reja që lindin nga jeta socialiste. T'i jepet rëndësi organizimit të festave të formimit të çetave partizane, të kooperativave bujqësore, të organizatave të rinisë, ditës së minatorit, të arësimitarit, das-

mave të rinisë etj. Rinia të bëhet shpirti i organizimit të tyre dhe njëkohësisht të nxjerrë përfitime edukative.

Për të formuar në rini një botëkuptim materialist shkencor, duhet forcuar, zgjeruar e ngritur në një shkallë më të lartë propaganda ateiste-shkencore. Në të ardhshmen kjo punë duhet të lidhet më ngushtë me detyrat ekonomike të ndërtimit të socializmit, të jetë më e gjallë dhe më e lidhur me jetën e rinisë, të bëhet në përshtatje me kushtet konkrete të krahinës dhe të fshatit, të jetë e argumentuar dhe bindëse. T'i kushtohet rëndësi e posaçme njohjes së rinisë me zbulimet e fundit të shkencës. Të përmirësohet rrënjësisht propaganda në këtë drejtim, të gjen den forma sa më të përshtatshme për t'ja dhënë rinisë këto të reja, në mënyrë sa më të thjeshtë dhe të kuptueshme. Të merren masa për botimin e një reviste tekniko-shkencore për rininë. Të vihen më mirë në veprim për propagandën ateiste-shkencore shtëpitë dhe vatrat e kulturës, shkollat dhe estradat, të zhvillohen më sistematikisht dhe në nivel më të mirë leksione e biseda. Në këtë punë nevojitet të japin kontributin e tyre të madh arësimtarët, mjekët, agronomët, punonjësit e letërsisë e të arteve.

Plenumi porositi që organizatat e Partisë dhe ato të rinisë të punojnë në mënyrë të vazhdueshme dhe sistematike për forcimin e mëtejshëm në rini të frymës së kolektivizmit socialist, të qëndrimit socialist ndaj shoqërisë, kolektivit, familjes dhe shok-shokut. Një fitore shumë e madhe e Partisë, e rendit tonë socialist, është edukimi i brezit të ri me moralin komunist. Duhet të ruhet dhe të pasurohet nga përmbajtja një nga vetitë e popullit tonë që është interesimi i përgjithshëm për veprimin e secilit. Edhe në çështjet e edukimit të rinisë dhe të fëmijëve organizatat e Partisë kanë mobilizuar opinionin shoqëror. Por në të ardhshmen në këtë drejtim duhet të punohet më shumë, në mënyrë që të shtohet kujdesi i shoqërisë për edukimin e çdo të riu e të çdo fëmije. Të ngrihet në një shkallë më të lartë përgjegjësia e familjes për edukimin e fëmijëve. Ne kemi një familje të shëndoshë, së cilës i detyrohet në një shkallë të madhe edukimi i drejtë i rinisë sonë. Organizatat e Partisë dhe të rinisë duhet të kujdesen sidomos për ata të rinj, që sapo hyjnë në marrëdhënje pune dhe, duke u munguar eksperiencë e jetës, duke qenë larg kontrollit të familjes dhe të organizatës, bien në gabime.

Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH vërejti se problemet e familjes, të martesës e të dashurisë janë përgjithësisht probleme që janë futur në rrugë të drejtë në vendin tonë, në shoqërinë tonë socialiste. Një ndikim të rëndësishëm, përveç të tjerave, ka luajtur në këtë çështje forca e kolektivit. Organizatat e Partisë dhe ato të masave, duke u marrë më shumë me këto probleme, duhet të sqarojnë sidomos të rinjtë dhe të rejtat se në themel të problemeve të dashurisë, të martesës e të familjes qëndron

morali komunist, qëndrojnë konceptet e shëndosha të popullit tonë mbi familjen, nderin dhe besnikërinë bashkëshortore, qëndrojnë edhe interesat e atdheut, i cili është i fortë atëhere kur familja është e gjallë e plot shëndet.

Edukimi komunist i brezit të ri nëpërmjet librit, të konsiderohet detyrë me shumë rëndësi për Partinë dhe organizatat e BRPSH, për institucionet kulturele, për bibliotekat dhe një mision fisnik për shkrimtarët. Shtimi i vazhdueshëm i tirazhit dhe i titujve, si dhe numri i madh gjithnjë në rritje i lexuesve në bibliotekat, lëvizja «Miku i librit» etj. dëshmojnë mbi sukseset e mëdha që janë arritur në këtë lëmë, dëshmojnë për rritjen e nivelit kultural dhe arësimor të masave dhe veçanërisht të rinisë. Por mbetet për t'u bërë akoma një punë e madhe, në mënyrë që libri të bëhet për çdo të ri e të re shok dhe mik i pandarë. Për këtë duhet të përmirësohet puna e bibliotekave, e shtëpive dhe e vatrave të kulturës, puna e shkollës për të ngjallur në rini dashurinë për librin. Një kontribut më të madh nevojitet të japin shkrimtarët dhe poetët tanë, me të cilët rinia dhe pionierët të organizojnë herë pas here takime. Të bëhet një punë më e organizuar në rini për t'u njohur ajo me jetën dhe punën e njerëzve të mëdhenj të shkencës, të artit etj. Të tregohet një kujdes më i madh për edukimin ideo-politik të shkrimtarëve të rinj. Një punë më e organizuar të zhvillohet në rini për ta njohur dhe lidhur më ngushtë atë me artet figurative.

Muzika ushtron një ndikim të madh në edukimin e rinisë. Që të rritet më shumë efekti i muzikës në edukimin estetik të rinisë, duhet të përmirësohet dhënja e saj në shkollë. Në drejtim të zhvillimit të lëvizjes amatore diletante muzikore duhen marrë masa jo vetëm për zhvillimin e mëtejshëm të masivitetit, duke siguruar një pjesëmarrje më të gjerë të rinisë në grupet korale dhe orkestrale, por krahas saj të bëhet një punë më serioze për ngritjen e cilësisë. Për këtë, Ministria e Arësimit dhe e Kulturës, duhet të marrë masa për përgatitjen e kuadrit. Për edukimin muzikor të rinisë do të shërbejnë edhe botimet e broshurave dhe materialeve të tjera nga ana e Ministrisë së Arësimit e të Kulturës nëpërmjet të cilave të shpjegohen veprat më të rëndësishme të muzikës botërore e të muzikës sonë.

Rinia dhe organizatat e rinisë duhet të bëhen shpirti i institucioneve kulturele dhe të gjallërojnë sidomos jetën kulturele në kooperativat bujqësore. Organizatat e Partisë të mbajnë mirë parasysh në punën me rininë nevojën e kombinimit të punës kulturele me atë politike. Të mendohet e të bëhet më shumë për zbavitjen e rinisë dhe aktivitetet të zhvillohen me përmbajtje e qëllime edukative; organet shtetërore dhe bashkimet profesionale, brenda planeve të studjuara, të shtojnë mundësitë për çlodhjen dhe dëfrimin e kulturuar të rinisë dhe të fëmijëve. Edhe

në të ardhshmen t'i jepet shumë rëndësi në radhë të parë shfrytëzimit të natyrës së bukur të vendit tonë. Të organizohen nga organizata e BRPSH, në bashkëpunim me SHNUM-in dhe organizatat e rinisë në ushtri, ekskursione turistike në rrugët e brigadave partizane. Kështu rinia jo vetëm çlodhet, por kalit vullnetin, forcohet fizikisht dhe edukohet si patriote e vendit të vet.

Përgjithësisht fiskulturës dhe sporteve duhet t'u kushtohet kujdes i madh për kalitjen e brezit të ri me cilësi të larta fizike e morale, për ta bërë atë të gatshëm për punë e mbrojtje. Edhe në këtë lëmë rinia ka arritur suksese të ndijshme. BRPSH të bashkëpunojë shumë me BFSSH dhe vëmendjen kryesore t'ja kushtojë sporteve masive përgjithësisht dhe veçanërisht fshatit, duke shfrytëzuar si duhet kushtet e reja që janë krijuar me kolektivizimin e bujqësisë. Për zhvillimin e mëtejshëm si të masivitetit, ashtu dhe të rritjes së cilësisë, BRPSH dhe BFSSH duhet të merren më mirë me organizimin e kompleksit fiskultural GPM dhe BGPM, që janë baza e lëvizjes sonë fiskurale. T'i kushtohet vëmendje organizimit të atletikës, turizmit, alpinizmit, notit, sporteve ushtarake, sporteve popullore të vendit etj. Të tërhiqen sa më shumë të reja në fiskulturë e sport. BRPSH duhet të mobilizohet më seriozisht për sigurimin e bazës materiale për zhvillimin e sportit. Rëndësi e veçantë t'i kushtohet edukimit komunist të sportistëve dhe fiskulturistëve.

V

Partia kurdoherë e ka çmuar shumë rolin e BRPSH për organizimin, mobilizimin dhe edukimin e rinisë, duke e parë atë si levën e saj kryesore për përmbushjen e kësaj detyre të rëndësishme.

Plenumi i Komitetit Qendror e konsideroi në përgjithësi të frutshme, të dobishme dhe të kënaqshme veprimtarinë që ka zhvilluar BRPSH nën udhëheqjen e PPSH, për edukimin komunist të rinisë.

Por, në të ardhshmen, organizatat e Partisë duhet ta përmirësojnë më tej përmbajtjen e punës së BRPSH. Para së gjithash, nevojitet të zgjerohet gjithnjë më shumë influenca e organizatës së rinisë në masat e rinisë dhe të sigurohet një aktivizim akoma më luftarak i të gjithë anëtarëve. BRPSH të punojë pareshtur si për edukimin e anëtarëve të vet, ashtu edhe për edukimin dhe mobilizimin e masave të gjera të rinisë. Plenumi konstatoi me kënaqësi se numri i anëtarëve të BRPSH është rritur në 140 000 dhe se nuk ka asnjë sektor jete dhe veprimtarie ku gjenden të rinj dhe të mos veprojnë organizata bazë e BRPSH. Por megjithatë duhet të punohet më gjerësisht për shtimin e ra-

dhëve dhe kjo të arrihet nëpërmjet aktivizimit të rinisë. Duhet futur më gjerësisht në sistemin e punës së vetë organizatave bazë aktivitete masive me gjithë rininë. Të ngrihet niveli i jetës së organizatës bazë dhe të bëhet ajo më e gjallë dhe më tërheqëse. Të zhvillohet më shumë vetiniciativa e organizatave të BRPSH.

BRPSH është fidanishtja e Partisë, aty rriten komunistët e ardhshëm, elementët besnikë për përtëritjen e pandërprerë të Partisë. Plenumi porositi në mënyrë të veçantë që të përmirësohet puna e Partisë dhe e BRPSH me masat e të rejave, që janë një forcë e madhe në shoqërinë tonë, sepse puna me to nuk është në lartësinë që kërkojnë kushtet dhe detyrat. Të punohet si me vetë të reja, ashtu edhe me prindërit e tyre. Anëtarët e Partisë në radhë të parë, si dhe ata të BRPSH, duhet të kujdesen për punën në familjet e tyre, me motrat dhe gratë e tyre. Për të siguruar rezultate të frutshme në këtë drejtim, duhet të koordinohet më mirë veprimtaria e BRPSH dhe BGSH, nën udhëheqjen e Partisë. Duke punuar në mënyrë të veçantë për shtimin e radhëve të organizatës me të reja, të tregohet kujdes edhe për gjallërimin e organizatave të tyre të veçanta.

Për një punë më të frutshme të BRPSH duhet të përmirësohet metoda e punës së organeve udhëheqëse, duke filluar që nga Komiteti Qendror i BRPSH, sidomos në drejtim të një ndihme më të mirë dhe më të kualifikuar që duhet t'i jepet bazës dhe në drejtim të rritjes së mëtejshme të vetiniciativës. Një vend shumë të rëndësishëm duhet të zërë puna me aktivin. Duhet treguar më tepër kujdes për ngritjen e të rinjve dhe të rejave në përgjegjësi në organizatë. Niveli arësimesor i kuadrit drejtues të rinisë duhet të rritet.

Për BRPSH kusht i domosdoshëm për sigurimin e sukseseve në edukimin komunist të rinisë ka qenë dhe mbetet udhëheqja e Partisë, për sigurimin e së cilës duhet të punojnë pa u lodhur kuadrot dhe organizatat e rinisë. Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH ka besim të plotë se, si kurdoherë, komunistët e ngarkuar me punën e rinisë, forumet dhe organizatat e rinisë do t'i kryejnë me nder detyrat e tyre madhështore, do ta kalitin rininë në frontin e luftës për ndërtimin e socializmit me frymën e besimit të thellë e pakufi ndaj Partisë, do ta farkëtojnë e çelniksin atë për ta bërë sa më të aftë për të marrë në duart e veta flamurin ngadhënjimtar të Partisë.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Botohet sipas gazetës
«Zëri i Popullit», Nr. 235,
29 shtator 1961

**LETËR E KQ TË PPSH DREJTUAR KQ TË PARTISË
KOMUNISTE TË BASHKIMIT SOVJETIK NË PËRGJEGJE
TË LETRËS SHPIFËSE TË UDHËHEQJES SË PK TË BS
TË 24 GUSHTIT 1961**

12 tetor 1961

Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, në mbledhjen e tij të datës 12 tetor 1961, shqyrtoi me kujdes letrën e 24 gushtit 1961 që Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik i drejtoi Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë. Lidhur me këtë letër, Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë i drejtohet Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, të zgjedhur në Kongresin XXII të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, me përgjegjen e mëposhtme.

Letra e 24 gushtit 1961 e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, e cila që nga fillimi e deri në fund është mbushur me shpifje dhe akuza nga më monstruoze kundër Partisë së Punës të Shqipërisë dhe udhëheqësve të saj, e ka indinjuar thellë Plenumin e Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë. Për ne është shumë e dhimbshme dhe e pakuptueshme se si Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, që ka themeluar Lenini i madh, të jetë mashtruar aq rëndë dhe të ketë shkuar aq larg, sa të akuzojë Partinë e Punës të Shqipërisë se «ka hyrë në rrugën e largimit nga marksizëm-leninizmi» dhe udhëheqësit e saj si «agjentë të zbulimeve të huaja imperialiste».

Por respekti që kemi për Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik nuk na lejon t'i përgjigjemi letrës së 24 gushtit 1961 me fjalët që meriton. Akuzat që i bëhen Partisë së Punës të Shqipërisë dhe udhëheqësve shqiptarë janë frut i pasioneve keqdashëse e antimarksiste dhe prandaj janë absurde e jo serioze. Ne jemi të bindur se Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, i zgjedhur nga Kongresi XXII i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, pasi të lexojë këtë letër-përgjegje tonën, do ta kuptojë se sa të padrejta, subjektive e antimarksiste janë akuzat dhe pikëpamjet e shprehura në letrën e 24 gushtit 1961 në adresë të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe të udhëheqësve të saj.

Le t'i hedhim qoftë edhe një vështrim, sado të shkurtër, jetës

dhe veprimtarisë revolucionare të Partisë së Punës të Shqipërisë gjatë historisë së saj 20-vjeçare dhe do të shikojmë se ajo është udhëhequr kurdoherë nga mësimet e marksizëm-leninizmit dhe nga eksperiencia e pasur e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, të cilat i ka zbatuar në mënyrë krijuese në përshtatje me kushtet konkrete historike të vendit.

Partia e Punës e Shqipërisë, e cila këtë vit feston 20-vjetorin e krijimit të saj, lindi më 8 nëntor 1941. Atë e themeluan bijtë më të mirë të popullit tonë, komunistët shqiptarë, me shokun Enver Hoxha në krye. Partia e Punës e Shqipërisë lindi nga gjiri i popullit shqiptar, ndau me të vuajtje e gëzime dhe, duke luftuar me të gjitha forcat për interesat e tij jetike, duke i mbrojtur ato me fanatizëm në çdo moment e situatë, u lidh me popullin si mishi me koskën.

Partia e Punës e Shqipërisë lindi në zjarrin e luftës, kur fashistët italianë kishin pushtuar atdheun tonë, kur nazistët gjermanë kishin sulmuar Bashkimin Sovjetik dhe ndodheshin para Moskës e Leningradit dhe udhëhoqi luftën çlirimtare të popullit shqiptar kundër pushtuesve fashistë. Ajo lindi si një parti e tipit të ri, e ndriçuar nga mësimet e marksizëm-leninizmit dhe idetë e Revolucionit të madh socialist të Tetorit. Ajo lindi mbi bazën e miqësisë jetëdhënëse të popullit tonë me popujt sovjetikë në luftën e përbashkët kundër murtajës fashiste.

Mbi këto baza të shëndosha ajo përcaktoi vijën e saj gjatë Luftës nacional-çlirimtare të popullit shqiptar dhe i bëri atij thirrje për Luftë të armatosur e pa kompromis kundër pushtuesve fashistë dhe tradhëtarëve të vendit për çlirimin e atdheut dhe vendosjen e një regjimi demokratik popullor. Partia e Punës e Shqipërisë e lidhi Luftën tonë nacional-çlirimtare me luftën heroike të popujve të Bashkimit Sovjetik, që ishte baza e shëndoshë edhe për çlirimin e vendit tonë, si dhe me luftën çlirimtare të popujve të vendeve fqinj dhe të gjithë popujve të tjerë që ishin ngritur kundër fashizmit. Partia e Punës e Shqipërisë, që nga themelimi i saj, e edukoi popullin shqiptar me dashurinë e pakufishme për atdheun e parë të socializmit, Bashkimin Sovjetik dhe për Partinë e lavdishme Komuniste të Bashkimit Sovjetik.

Partia jonë qëndroi kurdoherë e pa asnjë lëkundje në ballë të luftës së popullit shqiptar kundër pushtuesve fashistë, e udhëhoqi atë me guxim, duke dhënë gjakun e shumë prej bijve të saj më të mirë në këtë luftë. Ajo zbatoi me besnikëri mësimet leniniste mbi revolucionin, duke ua përshtatur kushteve konkrete të vendit tonë. Nën udhëheqjen e Partisë, i bashkuar në Frontin Nacional-Çlirimtar, populli shqiptar u ngriti i tëri në luftë. Nën udhëheqjen e Partisë u organizua Ushtria partizane Nacional-Çlirimtare, e cila më 1944 numëronte mbi 70 mijë luftëtarë. Nën udhëheqjen e Partisë dhe me luftë u shkatërrua nga themeli pushteti i vjetër i

pushtuesve dhe i klasave shfrytëzuese dhe u ngrit pushteti i këshillave nacional-çlirimtare, embrioni i pushtetit popullor. Partia e Punës e Shqipërisë nuk lejoi gjatë luftës që të ndahej pushteti me organizatat tradhëtare të feudalëve e të borgjezisë, të cilat ishin të lidhura si me pushtuesit fashistë italianë e gjermanë, ashtu dhe me imperialistët amerikano-anglezë. Ajo mbajti gjithashtu një qëndrim të drejtë e parimor ndaj «aleatëve» të atëhershëm amerikano-anglezë të luftës dhe nuk u lejoi atyre të përçanin luftën e popullit shqiptar dhe as të ndërhyjnë në punët e tija të brendshme. Në saje të udhëheqjes së drejtë të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe të luftës së madhe çlirimtare të Bashkimit Sovjetik kundër fashizmit, Lufta nacional-çlirimtare e popullit shqiptar u kurorëzua me fitore: me çlirimin e plotë të vendit dhe vendosjen e pushtetit popullor.

Pas çlirimit të vendit, duke marrë parasysh faktin se Shqipëria ishte një vend i prapambetur e gjysmefeudal, si dhe kushtet e favorshme ndërkombëtare (ekzistencën e Bashkimit Sovjetik dhe të kampit socialist), Partia e Punës e Shqipërisë, e udhëhequr në mënyrë konsekuente nga mësimet e marksizëm-leninizmit, përcaktoi rrugën e zhvillimit të Shqipërisë drejt socializmit, duke ju shmangur fazës së zhvillimit të gjerë të kapitalizmit në vendin tonë. Ajo udhëhoqi me sukses kryerjen e transformimeve demokratike e socialiste, industrializimin socialist të vendit, kolektivizimin e bujqësisë, revolucionin kultural dhe masat për ngritjen e nivelit të jetesës së popullit. Kështu, nën udhëheqjen e Partisë së Punës të Shqipërisë, brenda një periudhe historike shumë të shkurtër prej 17 vjetësh, ndërtimi socialist në Republikën Popullore të Shqipërisë bëri hapa të mëdhenj përpara. Jo vetëm u likuiduan plotësisht mbeturinat e feudalizmit, por u përfundua me sukses edhe periudha e ndërtimit të bazës ekonomike të socializmit. Nga një vend agrar krejt i prapambetur, Shqipëria është bërë një vend agraro-industrial, nga një vend me 80 për qind të popullsisë analfabete, Shqipëria është bërë një vend me një rrjet të gjerë shkollash e institucioneve të ndryshme kulturalo-artistike, ku në çdo 5 vetë njëri mëson, me një shtresë të gjerë inteligjencie të re, të kualifikuar e besnike ndaj interesave të popullit e të socializmit. Brenda 17 vjetëve që kanë kaluar, qysh nga çlirimi i vendit dhe vendosja e pushtetit popullor, prodhimi industrial në Shqipëri është rritur mbi 25 herë, prodhimi bujqësor mbi 2 herë dhe të ardhurat kombëtare mbi 4 herë. Këto suksese të mëdha tanimë njihen nga gjithë bota. Gjithashtu, dihet nga të gjithë se ato janë arritur me luftën dhe përpjekjet heroike të popullit shqiptar, nën udhëheqjen e drejtë të Partisë së Punës të Shqipërisë, në krye të së cilës vazhdimisht ka qëndruar themeluesi i Partisë sonë, shoku Enver Hoxha, si dhe në saje të ndihmës së pakursyer, internacionaliste, që i kanë dhënë atij Bashkimi Sovjetik, në radhë të parë

dhe vendet e tjera të kampit socialist. Kjo ndihmë, për të cilën Partia e Punës e Shqipërisë dhe populli shqiptar do t'i jenë përjetë mirënjohës Bashkimit Sovjetik dhe vendeve të tjera socialiste, si dhe eksperiencat e pasur sovjetike, siç tregojnë rezultatet e arritura, janë shfrytëzuar drejt nga ana e Partisë sonë të Punës dhe kjo ka qenë një ndër faktorët e rëndësishëm të sukseseve tona.

Tani, siç theksoi Kongresi IV i Partisë së Punës të Shqipërisë, Republika Popullore e Shqipërisë ka hyrë në një etapë të re historike të ndërtimit socialist: në etapën e ndërtimit të plotë të socializmit, të ngritjes së plotë të bazës materialo-teknike të socializmit, të shndërrimit të vendit tonë në një vend industrialo-agrar e më pas në një vend industrial të përparuar, me një bujqësi socialiste të zhvilluar intensive, me një kulturë masive dhe një nivel të lartë jetese për popullin.

Në këtë mënyrë, Partia jonë e Punës jo vetë lufton për interesat jetike të popullit shqiptar, por kryen dhe detyrën e saj internacionaliste për ta çuar vendin tonë përpara në rrugën e socializmit e të komunizmit, krahas për krahas me tërë familjen e bashkuar të sistemit socialist botëror. Lufta e popullit shqiptar, nën udhëheqjen e Partisë së Punës të Shqipërisë, kundër fashizmit italian e gjerman dhe për ndërtimin e socializmit, e bëri Republikën Popullore të Shqipërisë pjesëtare të denjë e të barabartë të kampit të madh të socializmit, që udhëhiqet nga Bashkimi Sovjetik.

Ndërtimi i socializmit në vendin tonë është bërë dhe bëhet në kushtet e vështira të rrethimit gjeografik kapitalist e revizionist. Në fakt, lufta e popullit për lirinë dhe pavarësinë e tij nuk mbaroi me dëbimin e pushtuesve fashistë. Edhe pas çlirimit të vendit Partia dhe populli ynë kanë qenë dhe janë të detyruar t'u bëjnë ballë komplotëve dhe veprimtarisë së shumtë armiqësore që frymëzohet dhe drejtohet nga imperialistët amerikano-anglezë, nga imperialistët italianë, revizionistët jugosllavë dhe monarko-fashistët grekë. Duke pasur parasysh këto rrethana, si dhe faktin që gjatë tërë periudhës pas Luftës së dytë botërore fuqitë imperialiste, me Shtetet e Bashkuara të Amerikës në krye, kanë zhvilluar një veprimtari të pareshtur armiqësore kundër vendeve socialiste, Partia e Punës e Shqipërisë, e udhëhequr kurdoherë nga mësimet leniniste mbi natyrën agresive luftënxitëse të imperializmit, ka mbajtur vazhdimisht parasysh çështjen e mbrojtjes së lirisë e të pavarësisë së vendit tonë. Për këtë qëllim, ajo i ka bërë thirrje popullit për ta ndërtuar socializmin duke mbajtur në njërin dorë kazmën e në tjetrën pushkën, e ka mësuar atë të mos dobësojë për asnjë moment vigjilencën dhe gatishmërinë luftarake kundër gjithë armiqve të brendshëm e të jashtëm. Në të njëjtën kohë, ajo i ka kushtuar kujdes forcimit të pareshtur të fuqisë mbrojtëse të vendit, duke mos kursyer për këtë mjetet e nevojshme materiale e financiare. Ushtria jonë popullore u modernizua dhe u stërvit në shembullin

e me traditat heroike të luftëtarëve trima të Shqipërisë dhe të Ushtrisë së lavdishme Sovjetike, ajo u pajis me armatime moderne e me kuadro të kualifikuar në akademitë e Bashkimit Sovjetik.

Për mbrojtjen e lirisë e të pavarësisë së atdheut tonë Partia e Punës e Shqipërisë nuk është mbështetur vetëm në forcat e brendshme të popullit tonë, por edhe në fuqinë e bashkuar të tërë kampit socialist, në ndihmën dhe përkrahjen e tij ushtarakë e politike, në radhë të parë të Bashkimit të fuqishëm Sovjetik. Nën udhëheqjen e Partisë së Punës të Shqipërisë, Republika Popullore e Shqipërisë është pjesëtare e denië e Traktatit të Varshavës dhe si e tillë kryen detyrën e saj internacionaliste për mbrojtjen e interesave të përbashkëta të kampit socialist në brigjet e Adriatikut. Pikërisht, duke u mbështetur nga këto interesa të përbashkëta, Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë, në marrëveshje e bashkëpunim me Qeverinë e Bashkimit Sovjetik, ngriti bazën ushtarako-detare të Vlorës, e cila ishte një pikë e rëndësishme për mbrojtjen e kampit socialist nga çdo agresion i mundshëm nga ana e imperialistëve amerikanë dhe e satelitëve të tyre në zonën e Detit Mesdhe. Nën udhëheqjen e Partisë sonë, ushtria e Republikës Popullore të Shqipërisë, ashtu si dhe tërë populli shqiptar, është edukuar në frymën e internacionalizmit socialist, me ndjenjat fisnike të dashurisë dhe besnikërisë ndaj Bashkimit Sovjetik dhe ndaj popujve të të gjitha vendeve të kampit socialist.

Edhe përsa i përket politikës së saj të jashtme, Partia e Punës e Shqipërisë, qysh në ditët e para të jetës dhe të veprimtarisë së saj revolucionare, është udhëhequr me besnikëri gjithashtu nga mësimet e marksizëm-leninizmit. Baza e politikës së jashtme të Partisë së Punës të Shqipërisë kurdoherë ka qenë dhe mbetet:

a) Krijimi dhe forcimi i pandërprerë i marrëdhënjeve të miqësisë, bashkëpunimit vëllazëror dhe të ndihmës e përkrahjes reciproke të Republikës Popullore të Shqipërisë me vendet e tjera të kampit socialist, në radhë të parë me Bashkimin e lavdishëm Sovjetik...

b) Përkrahja e luftës nacional-çlirimtare antiimperialiste dhe antikoloniale të popujve dhe kombeve të shtypura, si dhe e luftës revolucionare të punonjësve në vendet kapitaliste.

c) Përpjekjet për sigurimin e marrëdhënjeve të bashkekzistencës paqësore të Republikës Popullore të Shqipërisë me vendet kapitaliste, sidomos me vendet fqinje, mbi bazën e parimeve të respektimit të pavarësisë, të sovranitetit dhe integritetit tokësor, të mosndërhyrjes në punët e brendshme të njëri-tjetrit, të barazisë e të dobisë reciproke.

ç) Lufta kundër politikës imperialiste të luftës dhe agresionit, për ruajtjen dhe forcimin e paqes në botë, sidomos në rajonin e Ballkanit e të Adriatikut.

Një politikë e tillë paqedashëse e përparimtare, e përpunuar

nga Partia dhe e zbatuar me vendosmëri dhe konsekuencë nga qeveria jonë, ka forcuar pozitën ndërkombëtare të Shqipërisë, ka rritur autoritetin e saj, ka bërë që vendi ynë të zgjerojë marrëdhënjet me vendet e tjera, të përhapë, brenda mundësive të tija, me shembullin e vet pozitiv, idetë dhe influencën e socializmit në popujt e tjerë që posa kanë shpëtuar nga sundimi kolonial ose ndodhen në frontin e luftës për liri, ka kontribuar në përpjekjet e përbashkëta të vendeve socialiste, me Bashkimin Sovjetik në krye, për uljen e tensionit ndërkombëtar, për triumfin e vijës së socializmit mbi atë të imperializmit. Një politikë e tillë leniniste ka bërë që vendi ynë, duke ecur krah për krah me vendet e tjera socialiste, të jetë një faktor paqeje në zonën e Ballkanit e të Adriatikut.

Politika e hapët, e vendosur, marksiste-leniniste, që nuk njeh kompromise e lëshime në parime e as lajka për armiq të, vigjilente dhe paqedashëse e Partisë sonë, ua ka vënë armiqve kufirin «te thana». Tërbimi dhe veprimtaria antishqiptare e armiqve imperialistë dhe revizionistë të çdo ngjyre kundër Partisë e pushtetit tonë popullor, kundër ndërtimit të socializmit në Shqipëri, tregon në mënyrë të pakundërshtueshme se Partia e Punës e Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë janë vendosmërisht, me të dyja këmbët në binarët e drejtë të marksizëm-leninizmit, janë armiq të armiqve të marksizëm-leninizmit, armiq të armiqve të socializmit, armiq të armiqve të paqes në botë.

Gjatë gjithë historisë së ekzistencës së Republikës Popullore të Shqipërisë politika e jashtme e Qeverisë Shqiptare u është përgjegjur plotësisht interesave të përbashkëta të kampit socialist, kursit të përgjithshëm politik, të ndjekur nga vendet socialiste. Partia e Punës dhe Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë kanë përkrahur kurdoherë politikën paqedashëse të Partisë Komuniste dhe të Qeverisë së Bashkimit Sovjetik për zgjidhjen në rrugë të drejtë, në favor të paqes e të forcave të demokracisë e të socializmit, të çështjeve të ndryshme ndërkombëtare.

Besnikërinë e saj të patundur ndaj marksizëm-leninizmit Partia e Punës e Shqipërisë e ka treguar gjithashtu me luftën e saj parimore kundër armiqve të marksizëm-leninizmit. Ajo ka dënuar, së bashku me gjithë lëvizjen komuniste e punëtore ndërkombëtare, largimin nga pozitë e marksizëm-leninizmit të udhëheqësve revizionistë jugosllavë.

Në të njëjtën kohë, Partia jonë në tërë veprimtarinë e saj ka luftuar në mënyrë efektive çdo shfaqje të dogmatizmit apo sektarizmit, si dhe çdo fenomen tjetër që është në kundërshtim me mësimet e marksizëm-leninizmit. Vetë fakti që Partia e Punës e Shqipërisë ka ditur të zbatojë drejt dhe në mënyrë krijuese mësimet e marksizëm-leninizmit, që ajo është e lidhur ngushtësisht me masat më të gjera të popullit shqiptar tregojnë se për të janë të huaja dogmatizmi e sektarizmi. Por, duke bërë një luftë efek-

tive kundër rrezikut të dogmatizmit e sektarizmit, Partia e Punës e Shqipërisë nuk ka lejuar asnjëherë që parulla e «luftës kundër dogmatizmit» të përdorej për të përhapur pikëpamjet revizioniste. Ajo ka mbrojtur e mbron pikëpamjet se pa ndarë si duhet kufirin me revizionizmin, që mbetet rreziku kryesor në lëvizjen komuniste, lufta kundër dogmatizmit mbetet një fjalë boshe.

Vija që ka ndjekur e ndjek në mënyrë konsekuente Partia e Punës e Shqipërisë për të gjitha çështjet përpunet plotësisht me parimet dhe konkluzionet e dy dokumentave të përbashkët aktualë të lëvizjes komuniste ndërkombëtare, të deklaratave të Moskës të vjetëve 1957 dhe 1960, të cilat Partia jonë i ka zbatuar me përpikëri dhe i ka vënë në bazën e tërë punës së saj.

Rruga e përshkuar nga Partia e Punës e Shqipërisë, vija që ka ndjekur ajo qysh nga themelimi i saj është fakti më bindës që dëshmon për besnikërinë e saj të patundur ndaj marksizëm-leninizmit, ndaj interesave jetike të popullit shqiptar, ndaj çështjes së madhe të socializmit e të komunizmit, si dhe ndaj çështjes së paqes. Klasikët e marksizëm-leninizmit na mësojnë se jeta, praktika është kriteri i së vërtetës, se për individët dhe partitë e ndryshme duhet gjykuar nga faktet, nga veprimtaria e tyre praktike. Çdo largim nga ky parim themelor i shkencës marksiste-leniniste të shpie në subjektivizëm e në gabime të rënda. Duke shtrembëruar realitetin e duke shpifur pa skrupull kundër Partisë së Punës të Shqipërisë dhe udhëheqjes së saj, autorët e letrës së 24 gushtit 1961 kanë hyrë në një rrugë krejt të huaj për marksizëm-leninizmin.

Meqë e shohin se shpifjet e tyre janë krejt të pathemelta, autorët e letrës së 24 gushtit përpiqen t'i dalin së keqes përpara, duke e kufizuar kuadrin e akuzave të tyre për veprimtarinë e Partisë së Punës të Shqipërisë dhe të udhëheqësve të saj me shprehjen «gjatë kohëve të fundit». Por edhe ky «zbulim» nuk e bën më të lehtë pozitën e tyre të vështirë.

Është e vërtetë se «gjatë kohëve të fundit» janë keqësuar marrëdhënjet shqiptaro-sovjetike, janë acaruar mosmarrëveshjet midis Partisë sonë dhe udhëheqjes sovjetike. Por këtu ka rëndësi të dorës së parë të nxirren mirë në dritën e fakteve arsyeve pse janë keqësuar marrëdhënjet, pse ndodhi ky ndryshim, kush është fajtori i krijimit të një gjendjeje të tillë, cili është shkaku. Çdo njeri i ndershëm, çdo marksist i vërtetë nuk mund t'u besojë «argumentave» subjektivistë e të karakterit policor që servirin autorët e letrës së 24 gushtit 1961, se gjoja shkaku qenkan qëndrimet «antisovjetike» të udhëheqësve shqiptarë, të cilët qenkan kthyer në «agjentë të zbulimeve të huaja».

Shkaku i vërtetë i keqësimit të marrëdhënjeve midis dy partive dhe dy vendeve tona duhet kërkuar në veprimet antimarksiste, në masat represive dhe presionet e pashembullta në historinë e lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare, që ka ndërmarrë

udhëheqja sovjetike me N. Hrushovin në krye, kundër Partisë së Punës të Shqipërisë dhe Republikës Popullore të Shqipërisë lidhur me qëndrimin parimor që mbajti Partia e Punës e Shqipërisë në Mbledhjen e Bukureshtit të qershorit 1960, si dhe në Mbledhjen e Moskës të nëntorit 1960, qëndrim që ishte në kundërshtim me planet e qëllimet që ndoqi në ato mbledhje delegacioni i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, i udhëhequr nga N. Hrushovi.

Në Mbledhjen e Bukureshtit u shfaqën hapur mosmarrëveshjet e thella ideologjike e politike që ekzistonin në lëvizjen komuniste e punëtore ndërkombëtare. Atje u përdorën metoda që janë në kundërshtim të hapur me rregullat më elementare të marrëdhënjeve midis partive komuniste e punëtore motra. Atje u shkelën parimet bazë që karakterizojnë këto marrëdhënje, siç janë parimi i konsultimit dhe i barazisë midis të gjitha partive komuniste e punëtore. Në këtë mbledhje delegacioni i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, i kryesuar nga sekretari i parë i Komitetit Qendror, N. Hrushovi, organizoi sulmin kundër Partisë Komuniste të Lavdishme të Kinës, duke kërkuar t'i impononte asaj pikëpamjet e tija të gabuara ose, në rast mosnënshtrimit, ta vinte efektisht Partinë Komuniste të Kinës dhe Republikën Popullore të Kinës jashtë lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare dhe kampit socialist. Ky sulm i befasishëm, që kishte pamjen e një komploti të organizuar me kujdes, përbënte në fakt një sulm kundër marksizëm-leninizmit, prandaj ai hasi mosaprovimin dhe kundërshtimin e rreptë të delegacionit të Partisë Komuniste të Kinës dhe të disa delegacioneve të tjera të partive motra, midis të cilave edhe të delegacionit të Partisë sonë, i cili, siç dihet, dënoi metodat antimarksiste që u përdorën në atë mbledhje kundër Partisë Komuniste motër të Kinës dhe mbrojti kështu pozitat revolucionare të marksizëm-leninizmit. Ky qëndrim i vendosur i Partisë së Punës të Shqipërisë nuk i pëlqeu N. Hrushovit. Që këtej, pra, që nga Mbledhja e Bukureshtit, si rezultat i sulmeve hakmarrëse që N. Hrushovi ndërmori për të gjuhëzuar Partinë e Punës të Shqipërisë, sulme që arrijnë kulmin me shpifjet tendencioze që përmban letra e 24 gushtit 1961, filloi keqësimi i marrëdhënjeve shqiptaro-sovjetike.

Udhëheqësit sovjetikë, me N. Hrushovin në krye, duke dashur të fshehin shkaku e vërtetë të keqësimit të marrëdhënjeve shqiptaro-sovjetike, shkojnë aq larg sa në letrën e 24 gushtit 1961 përpiqen të falsifikojnë edhe qëllimet e përmbajtjen e vetë Mbledhjes së Bukureshtit. Në letër thuhet: «Me qëllim që të justifikojnë në një farë mënyre kursin e tyre të tanishëm politik, udhëheqësit shqiptarë nxjerrin pohimin absurd se gjoja shkaku i keqësimit të marrëdhënjeve sovjeto-shqiptare duhet kërkuar në «mosmarrëveshjet ideologjike e politike, që u shfaqën midis dy partive tona në Mbledhjen e Bukureshtit», ku delegacioni shqiptar doli gjoja

kundër «orvatjeve për të dënuar në mënyrë të padrejtë Partinë Komuniste të Kinës, për ta përjashtuar Republikën Popullore të Kinës nga kampi socialist». Për të njëjtat qëllime të pahijshme në letër përmbahet edhe një pohim tjetër qesharak se gjoja Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik dhe partitë e tjera motra «hakmerrren» për këtë ndaj udhëheqjes së Partisë së Punës të Shqipërisë.

Nuk është vështirë të bindesh se këto deklarata nuk kanë asgjë të përbashkët me realitetin. Së pari, në *Mbledhjen e Bukureshtit nuk lindi dhe nuk mund të lindte çështja për të mbrojtur cilëndo nga partitë motra për arësyen e thjeshtë se në këtë mbledhje askush nuk sulmoi askend*. (Nënvizimi ynë).

Duhet të kesh humbur çdo ndjenjë të moralit komunist që të arrish deri në një falsifikim të tillë. Për Mbledhjen e Bukureshtit dhe përmbajtjen e saj dëshmojnë stenogramet që ekzistojnë, dëshmon dokumenti prej 74 faqesh, i shpërndarë në prak të mbledhjes nga delegacioni sovjetik, dëshmojnë 51 përfaqësuesit e partive të ndryshme motra që asistuan në mbledhje. Këta dokumente tregojnë se në Mbledhjen e Bukureshtit në qendër të diskutimit ishte sulmi ndaj Partisë Komuniste të Kinës, ndaj vijës së saj të përgjithshme, ndaj politikës së saj të jashtme dhe të brendshme. Partia Komuniste e Kinës u akuzua si «luftënxitëse», si «kundërshtarë» e politikës së bashkekzistencës paqësore. Ajo u akuzua për «agresivitet» lidhur me incidentet e krijuara në kufirin kino-indian nga reaksionarët indianë me nxitjen e imperialistëve amerikanë. Ajo u akuzua si «fraksioniste» në lëvizjen komuniste e punëtore ndërkombëtare dhe si «dogmatike», «sektare», «aventuriste» etj. Është e tepërt të theksojmë edhe në këtë letër se të gjitha këto akuzat e shpifje ishin në kundërshtim me realitetin, sepse ato i ka hedhur poshtë vetë jeta, vetë veprimtaria konkrete e përditshme e Partisë Komuniste të lavdishme të Kinës, e cila ka ndjekur me konsekuencë një politikë të drejtë marksiste-leniniste në të gjitha drejtimet, si në arenën ndërkombëtare, ashtu edhe në jetën e brendshme të vendit të vet. Ajo ka luftuar dhe lufton me vendosmëri për forcimin e unitetit të kampit socialist dhe të lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare, për triumfin e çështjes së paqes dhe të lirisë së popujve, për fitoren e socializmit e të komunizmit dhe për shkatërrimin e planeve agresive e të kompleteve të imperializmit, për mbrojtjen e pastërtisë së marksizëm-leninizmit, duke zbatuar në jetë deklaratat e Moskës dhe çdo vendim tjetër të aprovuar së bashku. Megjithkëtë, kaq e zjarhtë ishte dëshira dhe vendosmëria e organizatorëve të Mbledhjes së Bukureshtit për të gjykuar, diskredituar dhe dënuar Partinë Komuniste të Kinës, sa që në diskutime u bënë edhe deklarata të tilla: «Ju (kinezët) e vini veten në një radhë me Adenauerin, sepse Adenaueri është kundër bashkekzistencës paqësore dhe çarmatimit të përgjithshëm». (Stenogram i datës 24 qershor. Fjalimi i V. Ulbrihtit.)

Teodor Zhivkovi shkoi edhe më larg. Në mbledhjen e datës 24 qershor ai tha se komunistët kinezë «përdorin metodat që përdor Jugosllavia» dhe «kanë lejuar gabime serioze si nga pikëpamja strategjike, ashtu edhe nga pikëpamja taktike», «janë larguar nga parimet e planit kooperativist të Leninit» etj.

Dhe më në fund, në mbledhjen e 25 qershorit, kur shokët kinezë kërkonin një afat për të nënshkruar komunikatën, N. Hrushovi i akuzoi se ata gjoja përpiqen të jenë komisarë në lëvizjen komuniste ndërkombëtare dhe tha se partitë e tjera do ta nënshkruajnë komunikatën, kurse Partia Komuniste Kineze po të dojë le të qëndrojnë veças.

Ndoshta, autorët e këtyre deklaratave, si dhe të shumë të tjerave të ngjashme me këto, që përmbajnë stenogramet, përpiqen tani t'i lënë në harresë dhe nuk duan që ato të përmenden, por një gjë e tillë nuk bëhet duke falsifikuar realitetin. Marksizëm-leninizmi mëson se kur dikush bën gabim dhe e kupton atë, ai duhet të bëjë autokritikë dhe jo të falsifikojë të vërtetën. Natyrisht, për një gjë të tillë duhet burrëri e ndershmëri bolshevike.

Mbledhja e Bukureshtit është një njollë e zezë në historinë e lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare. Qëndrimi që u mbajt ndaj Partisë Komuniste të Kinës dhe praktika antileniniste që u përdor atje sollën pasoja shumë serioze në gjirin e komunizmit ndërkombëtar. Në Mbledhjen e Bukureshtit u pa qartë se ekzistojnë mosmarrëveshje të tilla ideologjike në lëvizjen komuniste ndërkombëtare, se burimi i tyre nuk ishte Partia Komuniste e Kinës, por pikëpamjet dhe politika antimarksiste e N. Hrushovit. Praktika që u përdor nga organizatorët e Mbledhjes së Bukureshtit për zgjidhjen e këtyre mosmarrëveshjeve ishte në kundërshtim me rregullat më elementare organizative leniniste dhe, si rrjedhim, mosmarrëveshjet ekzistuese jo vetëm nuk u zgjidhën, por ato u thelluan edhe më tej. Këtë përgjegjësi siç duket, kanë frikë ta marrin përsipër organizatorët e Mbledhjes së Bukureshtit, prandaj orvaten ta paraqesin çështjen sikur në Mbledhjen e Bukureshtit nuk ndodhi asgjë.

Në Mbledhjen e Bukureshtit Partia e Punës e Shqipërisë kundërshtoi qëllimet e errëta të N. Hrushovit për të goditur Partinë Komuniste të Kinës. Këtë gjë Partia jonë e bëri me guxim e konsekuencë, në bazë të së drejtës që ka çdo parti, goftë ajo e madhe apo e vogël, për të thënë fjalën e vet në rrugë partie e pa drojtje kundër kujtdo që gabon dhe për të mbështetur me të gjitha forcat cilindro që është në rrugë të drejtë dhe mbron marksizëm-leninizmin. Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë e quan për nder që Partia jonë në Mbledhjen e Bukureshtit u gjend në anën e së drejtës, në anën e marksizëm-leninizmit. Qëndrimi parimor dhe burrëror i Partisë sonë u sulmua hapur në Mbledhjen e Bukureshtit nga sekretari i parë i Komitetit Qendror të Partisë

Komuniste të Bashkimit Sovjetik, N. Hrushovi, i cili në mbledhjen e 24 qershorit deklaroi: «Pasi dëgjova fjalimin e përfaqësuesit të Partisë shqiptare unë u dëshpërova, ai ishte ofendim për Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik». Udhëheqja sovjetike nuk e vlerësoi qëndrimin e drejtë të Partisë sonë, siç duhet ta vlerësojë kritikën çdo parti leniniste, por «u ofendua» dhe, për t'u hakmarrë (kjo është fare e qartë për cilindo), u fut në marrëdhënjet me Partinë tonë në një rrugë të gabuar, që nuk ka asgjë të përbashkët me mësimet e marksizëm-leninizmit, me deklaratat e partive komuniste e punëtore të vjetëve 1957 e 1960 dhe me marrëdhënjet vëllazërore midis vendeve socialiste, u fut në rrugën e presioneve të gjithanshme, duke i shtrirë mosmarrëveshjet me karakter partie edhe në fushën e marrëdhënjeve shtetërore, duke vendosur bllokadën e plotë ekonomike, politike dhe ushtarake ndaj Republikës Popullore të Shqipërisë, blokadë që nuk është vendosur deri më sot as nga imperialistët kundrejt ndonjë vendi tjetër. Duke e ndjerë pozitën e dobët, në të cilën ajo gjendet për shkak të këtyre veprimeve të palejueshme e të padëgjueshme në historinë e lëvizjes komuniste ndërkombëtare, udhëheqja sovjetike, me N. Hrushovin në krye, orvatet të krijojë me çdo kusht bindjen se gjoja burimi i masave dhe i presioneve të saj të pashembullta në dëm të Republikës Popullore të Shqipërisë nuk është as te mosmarrëveshjet ideo-politike dhe as te Mbledhja e Bukureshtit. Ajo përpiqet me çdo mënyrë të evitohet diskutimin e çështjes së marrëdhënjeve midis dy partive dhe dy vendeve tona mbi një bazë parimore. Prandaj, në letren e saj të 24 gushtit 1961 ajo e hedh diskutimin në një terren tjetër, në terrenin policor, duke e akuzuar paturpësisht Partinë e Punës të Shqipërisë dhe udhëheqjen e saj për «antiso-vjetizëm», si «agjenturë të imperializmit» etj.

Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë deklaroi se përpjekjet për t'i kërkuar shkaqet e gjendjes së krijuar në marrëdhënjet shqiptaro-sovjetike atje ku nuk janë, si dhe përpjekjet për të bërë përgjegjës për këtë gjendje ata që në të vërtetë nuk kanë asnjë faj, do të dështojnë kurdoherë me turp. Përpjekje të tilla nuk i shërbejnë as përmirësimit të marrëdhënjeve shqiptaro-sovjetike, as forcimit të unitetit të kampit socialist dhe të lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare.

Mosmarrëveshjet që ekzistojnë midis Partisë sonë dhe disa udhëheqësve sovjetikë nuk duhen parë si çështje të shkëputura, të veçanta dhe as vetëm si rrjedhim i disa veprimeve të gabuara praktike të këtij apo atij personi. Ato duhen parë si shprehje dhe në lidhje të ngushtë me mosmarrëveshjet e thella ideologjike e politike që ekzistojnë në gjirin e lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare, për të cilat u fol edhe në Mbledhjen e përfaqësuesve të partive komuniste dhe punëtore në Moskë, në nëntor 1960.

Në Mbledhjen e përfaqësuesve të partive komuniste e punë-

tore në Moskë, në nëntor 1960, Partia jonë, me anë të delegacionit të saj, të kryesuar nga shoku Enver Hoxha, në bazë të rregullave leniniste, shprehu hapur pikëpamjen e saj lidhur me një sërë çështjesh të rëndësishme të politikës aktuale dhe të taktikës e strategjisë së lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare, duke kritikuar edhe disa pikëpamje e veprime të gabuara e në kundërshtim me mësimet e marksizëm-leninizmit të N. Hrushovit, me të cilat Partia jonë nuk ishte dakord. Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë sonë mendon se pikërisht në këtë fakt, në ekzistencën e mendimeve tona të kundërta me mendimet e N. Hrushovit për disa çështje parimore, si dhe në faktin që kritika jonë parimore u konsiderua si «hedhje baltë ndaj Bashkimit Sovjetik» gjendet shkaku tjetër, pas Mbledhjes së Bukureshtit, që shtyu udhëheqësit sovjetikë në acarimin e mëtejshëm të marrëdhënjeve shqiptaro-sovjetike.

Dihet se, si përfundim i shkëmbimit të pikëpamjeve të ndryshme, Mbledhja e Moskës aprovoi Deklaratën e përfaqësuesve të 81 partive komuniste dhe punëtore, në të cilën u përcaktua qëndrimi unik i komunistëve të botës për çështjet më të rëndësishme politike aktuale të taktikës dhe strategjisë së lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare, si dhe parimet bazë, mbi të cilat duhet të mbështeten marrëdhënjet midis partive motra. Por jeta dhe praktika e përditshme provoi se disa udhëheqës sovjetikë, me N. Hrushovin në krye, shumë shpejt filluan jo vetëm të harrojnë parimet e Deklaratës së vitit 1960 në shumë çështje të rëndësishme të politikës, të taktikës e strategjisë së lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare, por edhe të marrin nëpër këmbë parimet bazë të marrëdhënjeve midis partive motra, siç janë parimet e barazisë dhe të konsultimit reciprok. Kjo shihet fare qartë në qëndrimet që mban udhëheqja e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik ndaj Partisë së Punës të Shqipërisë. Me këto veprime N. Hrushovi vërtetoi në praktikë qëndrimin që ai mbajti ndaj Deklaratës së Moskës qysh më 22 tetor 1960, ku në drekën për nder të pjesëtarëve të komisionit redaktues të deklaratës theksoi se ky dokument është një dokument kompromisi dhe si i tillë nuk do të ketë jetë të gjatë.

Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Shqipërisë është i mendimit se veprime të tilla, të cilat në fakt i thellojnë akoma më tej mosmarrëveshjet që ekzistojnë, në të ardhshmen, do të sjellin pa dyshim pasoja shumë më të rënda për gjithë lëvizjen komuniste e punëtore ndërkombëtare. Prandaj, duhen bërë përpjekje të drejta për zgjidhjen rrënjësore të këtyre mosmarrëveshjeve. Rruga e zgjidhjes së tyre, sipas mendimit tonë, nuk është e nuk mund të jetë as praktika antileniniste e përdorur në Mbledhjen e Bukureshtit, as metodat që janë përdorur e po përdoren kundër Partisë së Punës të Shqipërisë, metodat e presioneve,

të bllokadave, të izolimit apo të sulmeve shpifarake. Mosmarrëveshjet mund të zgjidhen vetëm duke zbatuar me besnikëri deklaratat e Moskës të vjetëve 1957 e 1960, duke vënë në jetë normat e vendosura bashkërisht për marrëdhënjet midis partive motra, duke ndjekur me besnikëri mësimet e marksizëm-leninizmit.

Pra, mosmarrëveshjet midis Partisë së Punës të Shqipërisë dhe disa udhëheqësve sovjetikë kanë të bëjnë me ekzistencën e pikëpamjeve të kundërta për një radhë çështjesh me karakter ideologjik e politik, ndërsa shkak i acarimit të marrëdhënjeve midis dy partive dhe dy vendeve tona është përdorimi nga ana e udhëheqjes sovjetike, me N. Hrushovin në krye, i metodave antimarksiste, në dëm të Partisë së Punës të Shqipërisë e të Republikës Popullore të Shqipërisë, për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ekzistuese. Këtë të vërtetë të dukshme përpiqen ta mohojnë autorët e letrës së 24 gushtit 1961, të cilët i shmangen qëllimisht diskutimit të çështjes së mosmarrëveshjeve tona mbi një bazë parimore ideologjike, mbi bazën e përcaktuar nga Deklarata e Moskës, duke kërkuar ta zhvendosin problemin në një terren të ri, në terrenin policor-agjentural. Vetëm kush ka shkarë nga parimet, vetëm ai i trembet diskutimit të hapur e të ndershëm parimor.

Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë e quan të domosdoshme të ndalet shkurtimisht në disa nga problemet kryesore, për të cilat ka mosmarrëveshje midis Partisë së Punës të Shqipërisë dhe udhëheqjes sovjetike.

I. — Çështja e parë është e lidhur me Kongresin XX të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, në mënyrë të veçantë me raportin e posaçëm që mbajti N. Hrushovi në atë kongres «Mbi kultin e personit dhe pasojat e tij», si dhe me disa teza me karakter të theksuar oportunist, që u shtruan nga ai në raportin kryesor përpara kongresit. Këtu fjala nuk është aspak për çështje të brendshme të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, për të cilat ne e quajmë të drejtë që vetëm Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik mund të thotë fjalën e vet, por për çështje që kanë të bëjnë me gjithë lëvizjen komuniste ndërkombëtare, për çështjen që patën jehonën dhe influencën e tyre edhe në partitë e vendeve të tjera.

Të marrim më parë çështjen e qëndrimit ndaj J. V. Stalinit pas vdekjes së tij. Sipas pikëpamjes së Partisë sonë J. V. Stalini, në gjithë veprimtarinë e tij teorike e praktike, ka qenë dhe mbetet një nga udhëheqësit dhe personalitetet më të shquara jo vetëm të Bashkimit Sovjetik e të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, por edhe të lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare, një nga mbrojtësit më të zjarrtë dhe teoricienët më të mëdhenj të marksizëm-leninizmit. Merita e tij e madhe historike qëndron në faktin se për shumë vjet me radhë ai ka qenë një nxënës besnik dhe shok armësh i vendosur i V. I. Leninit në luftën për përmbysjen e carizmit dhe triumfin e Revolucionit të madh socialist të Tetorit,

kurse pas vdekjes së Leninit ai, në krye të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, mbrojti me besnikëri leninizmin nga sulmet e trockistëve, buharinistëve, zinovievistëve e të tjerë dhe i shpartalloi ata ideologjikisht dhe politikisht. J. V. Stalini, si drejtuesi kryesor i partisë, dha një kontribut të madh në udhëheqjen me sukses të ndërtimit të socializmit në Bashkimin Sovjetik dhe të luftës së madhe patriotike të Bashkimit Sovjetik kundër fashizmit, ai zhvilloi më tej marksizëm-leninizmin për një sërë çështjesh të rëndësishme të shoqërisë socialiste sovjetike dhe të ndërtimit të socializmit e të komunizmit, dha një kontribut të çmuar në forcimin e kampit socialist e të lëvizjes komuniste ndërkombëtare, si dhe në demaskimin e revizionizmit modern të grupit tradhëtar revizionist të Titos. Duke e vlerësuar kështu veprimtarinë e J. V. Stalinit, nuk ka dyshim se gabimet që ai mund të ketë bërë gjatë vjetëve të fundit të jetës së tij ishin të pjesshme dhe nuk mund të shërbejnë si kriter për të dhënë vlerësimin e përgjithshëm të personit të J. V. Stalinit dhe të veprimtarisë së tij. Në vlerësimin e përgjithshëm të veprimtarisë së J.V. Stalinit qëndrojnë në plan të parë meritat e tija të mëdha, lufta për mbrojtjen e leninizmit, lufta për ndërtimin e socializmit në Bashkimin Sovjetik, lufta për formimin dhe forcimin e kampit socialist, për forcimin e unitetit të lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare, lufta konsekuente kundër imperializmit, politika e tij për mbrojtjen e paqes e të bashkekzistencës paqësore. Ato përbëjnë karakteristikën themelore të tij si udhëheqës e si komunist. E tillë ka qenë dhe mbetet pozita e patundur e Partisë së Punës të Shqipërisë lidhur me vlerësimin e veprës së J. V. Stalinit.

Në Kongresin XX të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, në raportin e posaçëm «Mbi kultin e individit dhe pasojat e tij», N. Hrushovi e kritikoi J.V. Stalinin në mënyrë të njëanshme, nga baza të shtrembëra e me qëllime jo të mira. Sipas mendimit të Partisë sonë, pozita e shtrembër dhe antimarksiste e N. Hrushovit në kritikën ndaj J.V. Stalinit qëndron në këto gjëra:

a) Në Kongresin XX të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, në mënyrë të njëanshme e tendencioze dhe në frymën e një mërie të egër, nga N. Hrushovi u ekzagjeruan dhe u frynë së tepërmi gabimet e J.V. Stalinit, duke arritur bile deri në shpifje të ulëta ndaj tij. Stalini u paraqit gati si «armik» i Bashkimit Sovjetik dhe i komunizmit, ai u karakterizua si njeri «brutal», «kapricioz», «despot», «vrasës», «gjakpirës» e «kriminel» ndaj kadrove të partisë dhe revolucionarëve besnikë e të sprovuar dhe «sylesh» ndaj imperialistëve e fashistëve, si njeri që bënte «marrëzira» të mëdha, si në praktikë ashtu dhe në çështjet teorike, që «nuk kishte haber» se ç'bëhej në Bashkimin Sovjetik, që shfaqte «mungesë respekti ndaj kujtimit të Leninit» e mjaft akuza të tjera të këtij lloji. Deklaratat e shkëputura që u bënë në Kongresin XX

dhe pas tij se Stalini mbetet një marksist-leninist i shquar etj. janë krejt formale, ato bëheshin për të ulur përshtypjen e keqe dhe zemërimin e ligjshëm që ngjallën në komunistët e gjithë botës këto akuza kundër Stalinit. Në fakt, as në Kongresin XX dhe as deri më sot nga Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik dhe në propagandën e saj nuk është bërë asnjë vlerësim pozitiv i trashëgimit teorik të J.V. Stalinit për të treguar se ku qëndrojnë anët e tija pozitive dhe kontributi i tij në mbrojtjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të marksizëm-leninizmit. Përkundrazi, në shtypin dhe propagandën e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, qysh nga Kongresi XX e këtej, flitet vetëm për «gabimet» e J.V. Stalinit, veprat e tija janë zhdukur gati krejt nga programet e shkollave të larta të Bashkimit Sovjetik. Menjëherë pas Kongresit XX të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, në Bashkimin Sovjetik dhe në disa vende të tjera socialiste, filloi me bujë të madhe t'u hiqet emri i Stalinit qyteteve e institucioneve të ndryshme, të hiqen monumentet e Stalinit etj. Puna ka arritur bile deri atje sa në Bashkimin Sovjetik jo vetëm dalin në qarkullim, por dhe propagandohen me bujë vepra të tilla të poshtira kundër personit të Stalinit, si poema «Horizonte të gjera», e cila është lauruar dhe me çmimin «Lenin» apo filmi «Qielli i kaltërt».

b) Në mënyrë të njëanshme e të shtrembër u trajtua nga N. Hrushovi në Kongresin XX dhe në propagandën sovjetike pas këtij kongresi çështja e luftës kundër kultit të individit, duke lënë krejt në harresë anën tjetër të problemit — mësimet e rëndësishme të Leninit mbi rolin e madh të udhëheqësve të klasës punëtore dhe të partisë së saj komuniste. I madhi Lenin, sidomos në librin e tij gjenial «Sëmundja foshnjore e «majtizmit» në komunizëm» theksonte me forcë domosdoshmërinë e krijimit në çdo parti marksiste të një grupi drejtuesish, pak a shumë të qëndrueshëm, të përbërë nga njerëzit më me autoritet, më me influencë, më me eksperiencë, që quhen udhëheqës. Pa një udhëheqje të tillë të qëndrueshme lufta e klasës punëtore dhe e partisë së saj komuniste nuk mund të kurorëzohet me sukses. Në kundërshtim me këto mësimet të qarta të Leninit, në Kongresin XX, me pretextin e luftës kundër kultit të personit, rolit të udhëheqësve ju kundërvu demokracia e masave. Nuk është keq të kujtojmë se ç'shkruan lidhur me këtë V.I. Lenini:

«Të arrish, për këtë arsye, sa ta vësh *përgjithësisht* diktaturën e masave përballë diktaturës së udhëheqësve është absurditet qesharak dhe marrëzi. Është veçanërisht qesharake kur sheh se në vend të udhëheqësve të vjetër, që kishin pikëpamje njerëzore për gjërat e thjeshta, vënë në

të vërtetë (nën maskën e parullës: «poshtë udhëheqësit!») *udhëheqës të rinj*, të cilët flasin gjepura që s'i ngre kandari»¹. (V. I. Lenini. Veprat, vëll. 31, f. 25-26, bot. IV rus.).

Partia jonë e Punës i ka pasur kurdoherë parasysh mësimet e marksizëm-leninizmit mbi rolin e masave, klasave, partive dhe udhëheqësve, ajo e ka dënuar në parim kultin e individit si një shfaqje të huaj për marksizëm-leninizmin dhe, kur ka qenë rasti, nuk ka ngurruar të kritikojë shfaqjet e ndryshme të kultit të individit në radhët e saja. Por Partia jonë ka qenë qysh në fillim kundër kritikës, në mënyrë se si ju bë ajo J.V. Stalinit në Kongresin XX nga ana e N. Hrushovit dhe këtë N. Hrushovi e ndjeu qysh atëhere. Fakti që Partia jonë u rezervua të flasë në shtypin e saj kundër Stalinit, që ajo nuk mori masa për të diskredituar personin e Stalinit, për të hequr emrin dhe portretet e tij nga qarkullimi, shpreh në të vërtetë mosaprovimin e saj ndaj veprimeve të shtrembëra të N. Hrushovit lidhur me kritikën kundrejt Stalinit. Por, megjithkëtë, Partia jonë nuk foli hapur atëhere për këtë çështje ashtu si edhe për disa çështje të tjera që u ngritën në Kongresin XX dhe për të cilat do të flasim më poshtë. Ky qëndrim në atë kohë kishte arsye të veta të shëndosha:

Së pari, Partia jonë nuk foli sepse pas Kongresit XX të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, siç dihet, të gjitha sulmet e armiqve imperialistë dhe të revizionistëve ishin përqëndruar për të përçarë unitetin e kampit socialist dhe të lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Në atë kohë ndodhën ngjarjet e Polonisë dhe të Hungarisë, elementët revizionistë u aktivizuan në shumë parti si në Itali, Francë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në Angli, Danimarkë, Kanada e gjetkë. Gjithë propaganda e reaksionit fliste për të ashtuquajturën «krizë të komunizmit». Revizionistët jugosllavë u bënë edhe më aktivë. Një fushatë e gjerë shpifëse shpërtheu sidomos kundër Bashkimit Sovjetik për të ulur autoritetin e tij e për të diskredituar Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. Në këto kushte detyra internacionaliste ishte që të mbrohej me të gjitha forcat Bashkimi Sovjetik dhe Partia Komuniste e Leninit, të ruhej autoriteti dhe prestigji i tyre, të mos i jepej asnjë armë armikut, të mbrohej uniteti i kampit dhe i lëvizjes komuniste. Pikërisht, duke i qëndruar besnik kësaj detyre internacionaliste Partia e Punës e Shqipërisë u përmbajt dhe nuk u shpreh hapur kundër udhëheqjes sovjetike, me N. Hrushovin në krye, por atyre u dha në atë kohë gjithë mbështetjen e duhur.

Së dyti, në fillim, për Partinë tonë gabimet e N. Hrushovit nuk ishin aq të qarta sa u bënë me kalimin e kohës, kur ato filluan të thellohen gjithnjë e më shumë, kurse përsa i përket qëndrimit

¹ V. I. Lenini. Veprat, vëll. 31, f. 31.

të tij ndaj personit dhe veprës së Stalinit ai gjithashtu ishte vësh-
tirë të kuptohej menjëherë, pasi N. Hrushovi në fjalimet e tij herë
e fuste në dhë dhe herë i bënte lëvdata Stalinit. Kështu, ndërsa
në Kongresin XX ai bëri shpifjet më të ulëta kundër Stalinit, të
cilat i përmendëm më sipër, më 17 janar 1957, në një pritje në
Ambasadën e Republikës Popullore të Kinës në Moskë deklaroi
publikisht se «Kur ishte fjala për çështjen e revolucionit, për
mbrojtjen e interesave të klasës së proletariatit në luftën revolu-
cionare kundër armiqve tanë të klasës, Stalini mbronte me trimëri
dhe papajtueshmëri çështjen e marksizëm-leninizmit», se «në gjënë
kryesore e themelore, — dhe gjëja kryesore e themelore për mark-
sistë-leninistët është mbrojtja e interesave të klasës punëtore, e
çështjes së socializmit, lufta kundër armiqve të marksizëm-leniniz-
mit, — në këtë gjë kryesore e themelore, sikurse thuhet, dhëntë
zoti që çdo komunist të dijë të luftojë ashtu sikurse luftoi Stalini»,
se «emri i Stalinit është i pandarë nga marksizëm-leninizmi».

Ndërsa në Mbledhjen e Bukureshtit në qershor 1960 ai e quajti
me përbuzje Stalinin «kalë të ngordhur e pavlerë», në një miting
në Tbilisi më 12 maj 1961 deklaroi përsëri se Stalini «... u bë
personaliteti më i shquar i partisë sonë» etj.

Me kalimin e kohës filloi të bëhet e qartë se N. Hrushovi dhe
grupi i tij e përdorën kritikën kundër Stalinit për qëllimet e veta.
Se si e përdori ai këtë dhe për ç'qëllime vepronte në planin e brend-
shëm (në Bashkimin Sovjetik dhe në Partinë Komuniste të
Bashkimit Sovjetik) kjo nuk është puna jonë, për këtë mund të
gjykojë vetëm Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik. Por, duke
qenë se çështja e luftës kundër kultit të Stalinit u përdor edhe në
plan ndërkombëtar dhe pati pasoja shumë të dëmshme për tërë
lëvizjen komuniste ndërkombëtare, Partia e Punës e Shqipërisë,
si dhe çdo parti tjetër marksiste-leniniste, jo vetëm ka të drejtë,
por dhe e ka për detyrë të thotë fjalën e saj. N. Hrushovi dhe grupi
i tij çështjen e Stalinit dhe të luftës kundër kultit të personit e
përdorën për të shkurorëzuar leninizmin, për të përgatitur kështu
terrenin që të revizionojnë marksizëm-leninizmin dhe të përhapin
pikëpamjet e veta oportuniste për çështjet më të rëndësishme
të zhvillimit të sotëm botëror e të lëvizjes komuniste ndërkombë-
tare, gjë që filloi të duket qysh në Kongresin XX dhe deri në ditët
e sotme. Kjo nuk është ndonjë gjë e re. Në fakt, të njëjtën taktikë
ka përdorur në luftën kundër leninizmit edhe Trocki.

«... Trocki në shkrimet e tij, — thotë J.V. Stalini, — bën
edhe një (edhe një!) orvatje për të përgatitur konditat e
zëvendësimit të leninizmit me trockizmin. Trocki i duhet
«me çdo kusht» të diskreditojë partinë, kuadrin e saj që
bënë kryengritjen, me qëllim që nga diskreditimi i par-
tisë të hidhet në diskreditimin e leninizmit. Kurse diskre-

ditimi i leninizmit i nevojitet për të futur kontrabandë
trockizmin, si «të vetmen» ideologji «proletare» (mos e
merrni me shaka!). Gjithë kjo bëhet, sigurisht (o, sigu-
risht!), nën flamurin e leninizmit, me qëllim që procedu-
ra e kësaj kontrabande të kryhet «pa kurrfarë dëmi»¹.
(J. V. Stalin, Veprat, vëll. 6, f. 348, bot. rus.).

N. Hrushovi e përdori gjithashtu çështjen e Stalinit për të
goditur elementët e shëndoshë marksistë-leninistë në udhëheqjet
e partive komuniste e punëtore të vendeve të ndryshme, për të
trembur dhe, në rast rezistence, edhe për të likuiduar çdo njeri që
guxonte ta kundërshtonte, për të vënë në heshtje partitë e tjera
dhe udhëheqës të ndryshëm që nuk mbështetnin pikëpamjet e tija.
Çështja e kultit të personit, me një fjalë, u përdor si gogol për të
bërë presione mbi partitë. A nuk shprehet kjo tendencë edhe në
letrën e 24 gushtit, ku në formë shantazhi akuzohen Partia jonë
dhe udhëheqësit e saj se gjoja po kultivojnë kultin e personit?
Duhet thënë se shfaqjet e kultit të personit, për të cilat u akuzua
me aq tërbim, mëri e sarkazëm nga N. Hrushovi në Kongresin XX
J.V. Stalini, po duken tani çdo ditë e më tepër në Bashkimin Sov-
jetik, bile shpeshherë në forma më të hapëta dhe më ekzaltuese
për vetë personin e N. Hrushovit. Kështu është vështrirë të gjesh
numër të revistave të ilustruara sovjetike ku të mos ketë fotogra-
fi të N. Hrushovit; faqet e shtypit sovjetik janë mbushur me citate
nga fjalimet e N. Hrushovit; në të katër anët dhe për të gjitha
çështjet flet vetëm N. Hrushovi; një film i tërë i kushtohet jetës
të N. Hrushovit dhe filma të tjerë vizitave të tija në vende të ndry-
shme të botës; lëvdata të shumta i bëhen në fjalime e shkrime të
ndryshme duke i atribuar atij personalisht sukseset më të mëdha të
Bashkimit Sovjetik në fushën e zhvillimit të industrisë, bujqësisë,
shkencës e teknikës. Për t'i konkretizuar të gjitha këto mund të
sillen shumë shembuj, por këtu do të riprodhojmë vetëm një pa-
sazh nga kryeartikulli i gazetës «Sovjetskaja kultura» e datës 15
shtator 1960, e cila shkruante: «Vapori, me të cilin lundron drejt
brigjeve të Amerikës i shtrenjti ynë Nikita Sergejeviç Hrushov,
është vapori më i madh që kanë mundur të krijojnë deri më sot
jo vetëm duart njerëzore, por bile edhe fantazia njerëzore. Ky
vapor nuk mund të jetë vapor i vogël, sepse në të ndodhet ngar-
kesa më e rëndë dhe më e çmuar, që deri më sot në histori kanë
ngritur në anije. Kjo ngarkesë është shpresa e gjithë njerëzimit
për paqe, dashuria e qytetarëve sovjetikë për të dërguarin e tyre
të lartë, ngrohtësia e zemrave të të gjithë njerëzve të ndershëm
të planetit».

¹ J. V. Stalin. Veprat, vëll. 6, f. 361.

Ku qëndron atëhere «principliteti» i N. Hrushovit në luftën kundër shfaqjeve të kultit të personit, të cilin ai e reklamoi me aq bujë në luftën e tij të paprinciptë kundër partive të tjera motra dhe udhëheqësve të tyre.

Më në fund, çështja e Stalinit dhe e kultit të personit u përdor nga N. Hrushovi dhe grupi i tij për të përgatitur terrenin për rehabilitimin e plotë të klikës revizioniste e tradhëtare të Titos, për ta paraqitur atë si «viktimë» të gabimeve të Stalinit, për të inkurajuar kështu renegatët revizionistë nga ish-in e nga s'ishin që të fillonin veprimtarinë e tyre kundër marksizëm-leninizmit nën parullat demagogjike të «antistalinizmit» etj. Dihet se pikërisht për këtë arsye çështja e kritikës ndaj kultit të Stalinit, ashtu siç u bë ajo në Kongresin XX nga N. Hrushovi, solli shumë turbullira jo vetëm për Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, por edhe në gjithë lëvizjen komuniste e punëtore ndërkombëtare. Dihet gjithashtu se konsekuencat e një veprimi të tillë ishin dhe vazhdojnë të jenë të hidhura.

Shkurorëzimi i J.V. Stalinit dhe i veprës së tij i krijoi N. Hrushovit mundësinë që në raportin e tij në Kongresin XX të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik të shtronte disa teza «të reja», që kishin të bënin me zhvillimin e gjendjes ndërkombëtare dhe me gjithë lëvizjen komuniste e punëtore të botës. Në fakt, këto teza «të reja», që u paraqitën si fjala e fundit e marksizmit krijues, kishin karakter oportunist dhe përbënin një shkarje serioze nga pozitat e marksizmit revolucionar. Komiteti Qendror i Partisë sonë të Punës, për disa teza të caktuara të Kongresit XX, për të cilat do të ndalemi më poshtë, nuk ka qenë dakord. Por edhe për këto çështje, ashtu si për rastin e kritikës ndaj J.V. Stalinit, Partia jonë për arsyet që përmendëm nuk u prononcua hapur, megjithëse në veprimtarinë e saj për këto çështje është udhëhequr nga pikëpamje të drejta, marksiste-leniniste.

II. — Tezat e shpallura nga N. Hrushovi në Kongresin XX të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, u bënë bazë për një sërë pikëpamjesh dhe veprimesh oportuniste edhe në fushën e politikës së jashtme, si mbi çështjet e paqes dhe të luftës, mbi problemin e bashkekzistencës paqësore, mbi imperializmin, mbi çështjen e kalimit në socializëm etj.

1. — Lidhur me çështjen e qëndrimit kundrejt imperializmit, pas Kongresit XX të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, udhëheqësit sovjetikë me N. Hrushovin në krye dhe udhëheqësit e disa partive komuniste e punëtore të vendeve të tjera, në mjaft fjalime dhe në shtypin e tyre, filluan të nxjerrin disa konkluzione «të reja», të cilat janë në kundërshtim me mësimet e Leninit dhe nuk i përgjigjen aspak realitetit të sotëm. Në këto konkluzione, në fakt, nënvleftësohen forcat e imperializmit dhe çështja paraqitet sikur imperializmi nuk ka më asgjë në dorë dhe tanimë është i

detyruar të bëjë ashtu si themi ne. Kjo, natyrisht, të shpie në uljen e vigjilencës dhe në aventura të rrezikshme. Por, çka është akoma më e rëndësishme, filluan të përhapen iluzionet e dëmshme se gjoja, për shkak të ndryshimit të raportit të forcave në favor të socializmit natyra e imperializmit ka ndryshuar.

Duke qëndruar në këto pozita antileniniste, N. Hrushovi filloi të përhapë iluzionin se qysh në kohën e tanishme mund të përjash-tohen luftërat nga jeta e shoqërisë, se qysh sot mund të krijohet bota pa armë, pa ushtri e pa luftëra. Nga ana tjetër, N. Hrushovi në fjalimet e veta filloi të ngrejë në qiell përfaqësuesit e fuqive imperialiste, duke i paraqitur ata si «engjëj të paqes». Kështu, në fjalimin e mbajtur në Moskë më 29 shtator 1959, pas kthimit të tij nga vizita në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ai deklaroi se «Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, D. Ajzenhauer, u tregua një burrë shteti i urtë në vlerësimin e gjendjes së sotme ndërkombëtare, tregoi burrëri dhe vullnet të fortë», se «ai është një njeri që gëzon mirëbesimin absolut të popullit të tij...», se «ai dëshiron sinqerisht likuidimin e gjendjes së «luftës së ftohtë», krijimin e marrëdhënjeve normale midis vendeve tona, përkrahjen e përmirësimit të marrëdhënjeve midis të gjitha vendeve».

Në fjalimet e N. Hrushovit krijohet gjithashtu iluzioni se, duke shkurtuar buxhetet ushtarake e duke u çarmatosur, borgjezia monopoliste do të jepte vullnetarisht një pjesë të mjeteve të kursyera për përmirësimin e jetesës së punonjësve, për lulëzimin e vendeve të ndryshme, se shtetet imperialiste mund të jenë të gatshme të ndihmojnë vendet e prapambetura për të arritur këto qëllime: «Një paqe e qëndrueshme në kushtet e çarmatimit të përgjithshëm e të plotë — ka thënë ai — ... do të lejonte që të vihe-shin të gjitha rezervat që ekzistojnë në botë në shërbim të plotësimit më të madh të nevojave materiale dhe kulturele të njerëzve, do të hapte mundësi të mëdha për progresin e gjithanshëm të njerëzimit». (Nga fjalimi i N. Hrushovit në parlamentin e Indisë, 11 shkurt 1960). Në të njëjtin fjalim ai, duke i bërë thirrje «ndërgjegjes» së fuqive koloniale, tha gjithashtu: «Do të ishte fare e drejtë që vendet Perëndimore tani t'u kthenin popujve që në të kaluarën ndodheshin në varësinë koloniale të paktën një pjesë të pasurive të grabitura».

Është për t'u habitur, por pikëpamje krejt analoge me këto shprehu gjatë vizitës së tij në vendet e Afrikës edhe renegati Tito, duke u përpjekur të krijojë iluzione në popujt e këtyre vendeve ndaj imperializmit.

Është e qartë se përhapja e pikëpamjeve të tilla oportuniste mbi imperializmin, sidomos mbi atë amerikan, i sjell një shërbim të keq çështjes sonë, sepse ul vigjilencën e popujve dhe i largon ata nga lufta aktive kundër imperializmit. Pikëpamjet oportuniste të N. Hrushovit për këtë çështje janë në kundërshtim të hapët me

deklaratat e partive komuniste e punëtore të vjetëve 1957 dhe 1960 në të cilat imperializmi amerikan demaskohet si kështjella e reaksionit botëror, si xhandar ndërkombëtar, si armik i tërbuar i popujve dhe i paqes në botë.

2. — Pas Kongresit XX të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, veçanërisht në vjetët e fundit, filloi të duket shtrembërimi i mësimave marksiste-leniniste mbi luftën dhe paqen nga N. Hrushovi dhe nga udhëheqësit e disa partive të tjera komuniste e punëtore. Këto shtrembërime u shfaqën sidomos qartë në periudhën e vizitës së N. Hrushovit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Në mjaft fjalime të N. Hrushovit dhe në shtypin sovjetik filloi të përhapet pikëpamja se qysh në kohën e sotme ka mundësi të ndalohej jo vetëm lufta botërore, por dhe çdo luftë, pa bërë dallim midis luftërave agresive që shpërthen imperializmi dhe luftërave të drejta revolucionare që bëjnë popujt e robëruar në vendet koloniale e të varura dhe klasat e shfrytëzuara në vendet kapitaliste. Kjo nga njëra anë është e lidhur me nënvleftësimin e imperializmit dhe me iluzionet ndaj tij dhe nga ana tjetër të shpie në mospërkrahjen e luftërave të drejta nacional-çlirimtare e revolucionare nga ana e partive komuniste e punëtore dhe e vendeve socialiste. Kështu, në një intervistë dhënë drejtorit të gazetës argjentinase «Klarin» më 30 dhjetor 1959, N. Hrushovi deklaroi se «... viti 1960 do të hyjë në histori si viti i fillimit të realizimit të ëndrrës shekullore të njerëzimit mbi botën pa armë e ushtri, mbi botën pa luftë».

Ndërsa në një fjalim, mbajtur në Indonezi më 21 shkurt 1960, ai tha se «Që në kohën e tanishme po krijohet mundësia reale për të përjashtuar përfundimisht e përgjithnjë luftën nga jeta e shoqërisë».

Në këtë mënyrë, u lanë në harresë mësimet e marksizëm-leninizmit se vetëm me fitoren e socializmit në mbarë botën ose në vendet kryesore kapitaliste do të arrihet garancia absolute për përjashtimin e çdo lloj lufte nga jeta e shoqërisë. I madhi Lenin e ka shkruajtur qartë se

«Vetëm pasi ta kemi përmbysur, ta kemi mundur përfundimisht dhe ta kemi shpronësuar borgjezinë në gjithë botën, dhe jo vetëm në një vend, vetëm atëhere luftërat do të bëhen të pamundshme»¹. (V.I. Lenin. Veprat, vëll. 23, f. 67, bot. IV rus).

Duke u nisur nga koncepte të tilla të gabuara, në propagandën sovjetike dhe në atë të disa partive të tjera komuniste e punëtore

¹ V. I. Lenin. Veprat, vëll. 23, f. 89.

filloi të flitet në mënyrë të njëanshme vetëm për mundësinë e evitimit të luftës botërore, duke lënë krejt në heshtje rrezikun real të shpërthimit të saj nga ana e imperialistëve, gjë që shpie në uljen e vigjilencës së popujve. Një gjë e tillë është e lidhur dhe me faktin që N. Hrushovi dhe pasuesit e tij ushqenin iluzionin se gjoja imperializmi, i detyruar nga forca e kampit tonë, ka hequr dorë nga veprimet e veta agresive, ka ndryshuar natyrën e tij. Lidhur me këtë, filloi bile të mos flitej për imperializmin amerikan, filluan të lavdërohen e të paraqiten si paqedashës krerët e imperializmit etj.

Një gabim tjetër serioz në politikën e N. Hrushovit dhe të pasuesve të tij është se shpresat më të mëdha për sigurimin e paqes ata i mbështetën te takimet e bisedimet midis personaliteteve, te mbledhja e të mëdhenjve, te politikanët e veçantë dhe te «arësyeja e qëllimet e mira» të krerëve të imperializmit si Ajzenhaueri, Makmilani, Dë Goli, Kenedi e të tjerë dhe jo te lufta e popujve, te bashkimi dhe aksioni i fuqishëm i forcave të paqes, siç thekson Deklarata e Moskës e vitit 1957. Si rrjedhim, lëvizja për paqe filloi të bjerë, organizatat ndërkombëtare filluan të dobësohen. Një pozitë e tillë është në kundërshtim flagrant me tezën e njohur të marksizëm-leninizmit mbi rolin vendimtar të masave popullore në histori dhe i ka sjellë një dëm të madh lëvizjes për mbrojtjen e paqes. Natyrisht, Partia e Punës e Shqipërisë nuk është dhe nuk ka qenë kurrë kundër bisedimeve me qeveritë e fuqive imperialiste, as kundër takimeve me personalitetet e ndryshme shoqërore, por ajo qëndron në pikëpamjen se këto bisedime janë vetëm një faktor ndihmës, se faktori vendimtar për sigurimin e paqes është lufta e vendosur e popujve kundër luftënxitësve imperialistë, se për hir të bisedimeve nuk duhet ulur vigjilenca e popujve dhe nuk duhen përhapur iluzione mbi «qëllimet e mira» të fuqive imperialiste e të qeverive të tyre.

Në propagandën sovjetike dhe në atë të disa partive të tjera komuniste e punëtore të Evropës filloi të lihet në harresë teza që në rast se imperialistët, pa marrë parasysh pasojat, do të guxojnë të shpërthejnë luftën e tretë botërore, ata do të pësojnë disfatë dhe popujt do ta fshijnë përfundimisht imperializmin nga faqja e dheut. Në vend të kësaj teze, filloi të flitet në mënyrë të njëanshme për pasojat katastrofale që do të kishte një luftë e re botërore me përdorimin e armëve termobërthamore, duke rënë bile në pozitë e propagandës borgjeze se në rast të një lufte të tillë nuk do të kishte as fitimtarë e as të mundur. Në një fjalim të mbajtur më 2 korrik 1960 në shoqërinë austro-sovjetike, N. Hrushovi tha: «Në qoftë se në këtë tokë ne nuk mund të jetojmë ashtu si qenjet e gjalla mundën të jetojnë në arkën e Noes dhe do të fillojmë të zgjidhim me luftë mosmarrëveshjet midis shteteve — kujt nuk i pëlqen socializmi dhe kujt nuk i pëlqen kapitalizmi, — atëhere

ne do ta zhdukim arkën tonë të Noes, rruzullin tokësor». Kjo nuk mund të konsiderohet ndryshe veçse si kapitullim para shantazhit atomik të imperializmit.

Të gjitha këto pikëpamje të shtrembëra të N.Hrushovit e të grupit të tij janë në kundërshtim të hapur me dy deklaratat e Moskës të partive komuniste e punëtore, si dhe me faktet e përditshme të jetës së sotme ndërkombëtare. Ato i kanë sjellë e i sjellin një dëm të madh çështjes së ruajtjes e të forcimit të paqes.

3. — Pas Kongresit XX të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, udhëheqësit sovjetikë me N.Hrushovin në krye, filluan ta interpretojnë e ta zbatojnë ndryshe, në mënyrë oportuniste, parimin leninist të bashkekzistencës paqësore:

Së pari, ata e quajnë këtë parim si «vijën e përgjithshme të politikës së jashtme të vendeve socialiste», thonë se «politika e bashkekzistencës paqësore përbën gjithë përmbajtjen e politikës së jashtme të vendeve socialiste». Kjo është krejt e shtrembër, sepse duke u nisur nga një tezë e tillë, për hir të bashkekzistencës paqësore me vendet kapitaliste, duke përfshirë dhe fuqitë imperialiste e koloniale, lihet në heshtje përkrahja që vendet socialiste duhet t'i japin luftës nacional-çlirimtare të popujve të robëruar kundër imperializmit, si dhe luftës revolucionare të klasës punëtore kundër kapitalizmit në vendet kapitaliste. Kjo është e shtrembër gjithashtu edhe për faktin se, sipas kësaj teze, parimi i bashkekzistencës paqësore shtrihet dhe në marrëdhënjet midis vendeve socialiste, kurse dihet se midis tyre duhet të ekzistojnë marrëdhënjet e bashkëpunimit të ngushtë e të ndihmës reciproke vëllazërore mbi bazën e parimeve të internacionalizmit socialist.

Së dyti, nga një koncept i tillë i gabuar i bashkekzistencës paqësore kanë rrjedhur dhe qëndrimet e tjera të gabuara lidhur me këtë çështje, kur parimi i bashkekzistencës paqësore është shtrirë edhe në marrëdhënjet midis klasave në vendet kapitaliste, duke mohuar në këtë mënyrë domosdoshmërinë e luftës së klasave e të revolucionit socialist për përmbyshjen e kapitalizmit. Kështu, sekretari i parë i Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Bullgare, T. Zhivkov, shkruante në revistën «Probleme të paqes e të socializmit» (Nr. 8, gusht 1960): «...Përmbajtja e politikës së bashkekzistencës paqësore është pasuruar e thelluar, është bërë më i qartë se kurrë qëllimi i saj i fundit — fitorja e socializmit mbi kapitalizmin në shkallë botërore gjatë garës paqësore të dy sistemeve». Këtu, në fakt, lihen mënjanë mësimet e marksizëm-leninizmit mbi luftën e klasave dhe revolucionin socialist, çdo gjë mbështetet te bashkekzistenca paqësore, duket sikur socializmi do të vijë vetë, sikur atë do t'ua sjellë popujve si dhuratë politika e bashkekzistencës paqësore që ndjekin vendet socialiste. Gjithashtu anëtar i Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, B.Ponomarjov, në artikullin «Bashkekzistenca pa-

qësore — domosdoshmëri jetike», botuar në «Pravda», datë 12 gusht 1960, shkruante se vetë parimi i bashkekzistencës paqësore «nuk është gjë tjetër, veçse forma më e lartë e luftës së klasave midis dy sistemeve të kundërta — socializmit dhe kapitalizmit...».

Së treti, për hir të bashkekzistencës paqësore, nga frika se mos dëmtohet ajo, udhëheqësit sovjetikë me N.Hrushovin në krye pushuan për një kohë gati fare luftën për demaskimin e imperializmit amerikan. Në mjaft fjalime të N.Hrushovit e të disa udhëheqësve të tjerë sovjetikë filluan lavdërimet për krerët e imperializmit, Dë Goli u quajt «krenaria e kombit francez», (kurse gazeta «Pravda» e datës 21 korrik 1961, në artikullin me titull «Lojë e dyfishtë», shkruan se «Adenaueri po merr përsipër rolin e Hitlerit, duke i lënë gjeneralit Dë Gol rolin e Musolinit»), Ajzenhaueri u paraqit si përkrahës i vendosur i paqes dhe i bashkekzistencës paqësore, shpresa të mëdha u mbështetën te ardhja e Kenedit në fuqi e u krijuan rreth tij shumë iluzione oportuniste etj. Lidhur me luftën politike kundër imperializmit, për demaskimin e tij, filloi të flitet se nuk duhet acaruar puna, duhet vepruar me kujdes të madh, sepse kështu e do politika e bashkekzistencës paqësore e të tjera. Tipike në këtë drejtim është shuarja gati e plotë e luftës ideologjike e politike kundër revizionizmit jugosllav, me pretekstin se gjoja Jugosllavia në disa çështje të rëndësishme të politikës së jashtme mbështet propozimet sovjetike.

Partia e Punës e Shqipërisë nuk ka qenë dhe nuk mund të jetë kurrë dakord me një trajtim të tillë oportunist të parimit të bashkekzistencës paqësore, i cili është në kundërshtim me deklaratat e partive komuniste e punëtore të vjetëve 1957 dhe 1960. Bashkekzistenca paqësore nuk mund të arrihet duke u bërë lëshime parimore e lajka imperialistëve, duke hequr dorë nga lufta e vendosur ideologjike e politike kundër tyre. Ajo u duhet imponuar atyre me një luftë të vendosur, sepse imperialistët nuk heqin dorë vullnetarisht nga «lufta e ftohtë», nga bloqet ushtarake, nga gara e armatimeve, nuk heqin dorë me dashje nga ndërhyrja në punët e brendshme të vendeve të tjera, nga shkelja e parvarësia dhe e sovranitetit të popujve etj.

4. — Në Kongresin XX të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik u shtrembëruan në mënyrë oportuniste mësimet e marksizëm-leninizmit mbi format e kalimit nga kapitalizmi në socializëm:

Së pari, atje nga N. Hrushovi u absolutizua e u fry së tepërmi mundësia e rrugës paqësore të marrjes së pushtetit nga ana e klasës punëtore. Pas Kongresit XX në propagandën sovjetike dhe në propagandën e disa partive komuniste e punëtore të vendeve të ndryshme filloi të flitet në mënyrë të njëanshme vetëm për rrugën paqësore të kalimit në socializëm, duke lënë krejt në ha-

rrësë mundësinë tjetër — atë të kryengritjes së armatosur. Kongresi XX nuk i orientonte partitë që të përgatiteshin njëkohësisht për të dyja mundësitë, si për rrugën paqësore, ashtu dhe për kryengritjen e armatosur, por vetëm për njërin prej tyre — ose për rrugën paqësore ose për kryengritjen e armatosur, duke vënë theksin mbi rrugën paqësore. Si rrjedhim, udhëheqjet e disa partive komuniste e punëtore, duke përfshirë dhe ato të vendeve ku aparati burokratik, ushtarak e policor ka arritur proporcione të papara, siç janë Gjermania Perëndimore, Italia, bile edhe Spanja frankiste etj. janë orientuar kryekëput vetëm nga rruga paqësore, gjë që do të thotë në fakt të heqësh dorë nga revolucioni. Kjo është në kundërshtim flagrant me mësimet themelore të leninizmit, si dhe me vetë gjendjen reale të vendeve sot në botë, ku aparatet burokratiko-ushtarake borgjeze jo vetëm nuk po dobësohen, por përkundrazi po forcohen e fryhen gjithnjë e më shumë, si në vendet e zhvilluara kapitaliste, ashtu edhe në vendet e paparura, të çliruara nga zgjedha koloniale e imperializmit.

Lenini theksonte se klasa punëtore e cilitdo vend duhet të jetë e përgatitur në çdo moment për të marrë pushtetin me çdo rrugë qoftë, por duke qenë e përgatitur mirë sidomos për kryengritjen e armatosur, ai vinte gjithashtu në dukje se edukimi i proletariatit në këtë frymë është një nga detyrat më të rëndësishme të çdo partie komuniste.

«Nevoja për t'i edukuar në mënyrë sistematike masat me këtë ide dhe pikërisht me këtë ide të revolucionit me dhunë është baza e gjithë doktrinës së Marksit dhe Engelsit. Tradhëtia e doktrinës së tyre nga ana e rrymave socialshoviniste dhe kautskiane, që sundojnë sot, shihet në mënyrë veçanërisht të qartë në atë, që si njëra ashtu edhe tjetra e kanë harruar këtë propagandë, këtë agjitacion»¹. (V. I. Lenin. Veprat, vëll. 25, f. 372, bot. IV rus).

Së dyti, në Kongresin XX u përhap iluzioni se gjoja vetëm duke siguruar shumicën në parlamentin borgjez klasa punëtore dhe partia e saj komuniste mund ta marrin pushtetin në duart e veta, u revizionua dhe u la krejt në heshtje teza themelore e marksizëm-leninizmit se pa shkatërruar nga themeli aparatit shtetëror borgjez dhe pa e zëvendësuar atë me organet e diktaturës së proletariatit nuk është e mundur të realizohet revolucioni socialist dhe të përmbysset borgjezia. Kjo s'është gjë tjetër veçse ringjallja e iluzioneve parlamentariste borgjeze, kundër të cilave ka luftuar me ashpërsi të madhe V.I.Lenini.

Këto pikëpamje thellësisht oportuniste të N.Hrushovit, që

¹ V. I. Lenin. Veprat, vëll. 25, f. 473.

u përhapën në Kongresin XX të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe pas tij, i kanë sjellë një dëm të madh lëvizjes komuniste ndërkombëtare, çështjes së klasës punëtore.

III. — Mosmarrëveshjet e Partisë sonë me N.Hrushovin dhe disa udhëheqës të tjerë sovjetikë janë të lidhura gjithashtu edhe me qëndrimin ndaj revizionizmit të sotëm, veçanërisht ndaj klipes tradhëtare të revizionistëve jugosllavë.

Dihet se klika revizioniste e Titos u dënua botërisht, si në letrat e njohura të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste (b) të Bashkimit Sovjetik, të firmuara nga J.V.Stalini e V.M.Molotov, ashtu dhe me Rezolucionin e Byrosë Informative të disa partive komuniste e punëtore të qershorit 1948 «Mbi gjendjen në Partinë Komuniste Jugosllave», i cili më vonë u mbështet nga të gjitha partitë komuniste e punëtore të botës. Përse u dënuan në atë kohë udhëheqësit e Partisë Komuniste të Jugosllavisë? Ata u dënuan sepse në problemet themelore të politikës së jashtme e të brendshme ndiqnin një vijë të gabuar, që përbënte largim nga marksizëm-leninizmi, sepse ndiqnin një politikë të jashtme jomiqësore ndaj Bashkimit Sovjetik, të cilin e vinin në një plan me imperializmin amerikan dhe anglez, duke e akuzuar për ekspansionizëm, sepse në politikën e brendshme kishin devijuar nga pozitat e klasës punëtore dhe nga teoria marksiste e klasave dhe e luftës së klasave, merrnin masa që shpinin në restaurimin e kapitalizmit dhe përkrahnin kulakët, sepse kishin revizionuar teorinë marksiste-leniniste mbi partinë revolucionare të klasës punëtore dhe e kishin shkrirë partinë në frontin popullor, sepse kishin vendosur në parti një regjim policor, në kundërshtim me të gjitha rregullat leniniste të jetës së partisë, ishin futur në rrugën e tradhëtisë së çështjes së solidaritetit ndërkombëtar të punonjësve etj. Më pas, në nëntor të vitit 1949, doli Rezolucioni i dytë i Byrosë Informative, i adaptuar mbi bazën e raportit të shokut Georgiu-Dezh «Partia Komuniste e Jugosllavisë në duart e vrasësve e të spiunëve», në të cilin tregohet se klika e Titos ishte degjeneruar përfundimisht në një agjenturë të imperializmit, se ajo likuidoi fitoret e revolucionit në Jugosllavi, se largoi Jugosllavinë nga rruga e socializmit dhe nga kampi socialist dhe e vuri atë nën varësinë ekonomike e politike të imperializmit, se banda titiste zhvillonte një veprimtari të gjerë spiunazhi e komplotesh kundër vendeve të ndryshme socialiste, se përkrahte në forma të ndryshme politikën imperialiste të luftës dhe të agresionit etj.

Pikëpamja e Partisë së Punës të Shqipërisë ka qenë dhe mbetet se konkluzionet e Stalinit dhe të Byrosë Informative lidhur me klikën renegate revizioniste të Titos kanë qenë dhe mbeten të drejta. Këto konkluzione janë vërtetuar dhe vërtetohen si nga realiteti jugosllav në atë kohë, ashtu edhe nga ngjarjet e mëvonshme e ato të ditëve të sotme. Revizionistët jugosllavë u bënë

qendra e diversionit dhe e kompleteve në shërbim të imperia-
lizmit kundër vendeve të kampit socialist. Nën drejtimin e tyre
punoi në Shqipëri banda e Koçi Xoxes, e cila synonte të shkatër-
ronte Partinë e Punës dhe të likuidonte pushtetin popullor.
Nga Jugosllavia e Titos kalonin nëpër vendet socialiste me dhje-
tëra e qindra agjentë e provokatorë, spiunë e diversantë, detyra
e të cilëve ishte terrori, sabotimi, pregatitja e kompleteve kundër
socializmit në këto vende. Mjafton të përmendim se vetëm në
Shqipëri gjatë 12 vjetëve (1949-1960) janë futur 1 363 spiunë e
diversantë të ndryshëm, të dërguar në 331 banda të armatosura
nga organet e UDB-së Jugosllave. Klika revizioniste e Titos gjith-
një e më hapur që nga viti 1948 e këtej është vënë në shërbim
të imperializmit amerikan, me të cilin e lidhin milionat e mili-
ardat e dollarëve që përbëjnë kreditë ekonomike e ushtarake
amerikane për Jugosllavinë, e lidh pjesëmarrja në Paktin Ball-
kanik, që s'është tjetër veçse një aneks i Paktit të Atlantikut, e
lidh politika e diversionit dhe e kompleteve kundër vendeve
socialiste dhe kundër lëvizjes nacional-çlirimtare të popujve të
porsaçliruar ose që akoma vuajnë nën kthetrat e kolonializmit.

Deri në vitin 1955 të gjitha partitë komuniste e punëtore
ishin unanime në dënimin e udhëheqjes revizioniste jugosllave
dhe zhvillonin një luftë të vendosur e parimore ideo-politike kun-
dër saj. Mirëpo pikërisht në këtë kohë N.Hrushovi shpalli se ndaj
Jugosllavisë dhe udhëheqësve të saj qenkish bërë një padrejtësi
e madhe, se «nën influencën e agjentit Beria» kundër tyre
janë bërë akuza të pathemelta, se edhe në çështjen jugosllave paska
gabuar rëndë J.V.Stalini. Dhe menjëherë ai mori iniciativën, vajti
në Beograd, ku e quajti Titon «shok të dashur», hodhi në shportë
Rezolucionin e Informbyrosë dhe shpalli me zë të lartë se Jugos-
llavia është vend socialist dhe se udhëheqësit jugosllavë, me-
gjithëse kanë disa lëkundje, janë në përgjithësi marksistë-lenin-
nistë. Ditën që arriti në Beograd, më 26 maj 1955, N. Hrushovi
deklaroi: «Ne i studjuam hollësisht materialet, mbi të cilat bazo-
heshin akuzat dhe fyerjet e rënda që u bënë atëhere kundër udhë-
heqësve të Jugosllavisë. Faktet tregojnë se këto materiale ishin
fabrikuar nga armiqitë e popullit, nga agjentët e urryer të impe-
rializmit që kishin depërtuar në mënyrë mashtruese në radhët e
partisë sonë».

Ndërsa më 19 qershor 1956, në mitingun e miqësisë sovjet-
-jugosllave që u mbajt në Moskë, N.Hrushovi deklaroi se «Repu-
blika Federative Popullore e Jugosllavisë gjithashtu po ndërton
me sukses socializmin».

Në lidhje me çështjen jugosllave dhe qëndrimin ndaj saj,
nga sa u tha më sipër, të bien në sy dy metoda të ndryshme
vlerësimi. Nga njëra anë, vlerësimi që u bëhej udhëheqësve re-
vizionistë jugosllavë në bazë të fakteve objektive, në bazë të

veprimtarisë së tyre konkrete, gjë që është shprehur në letrat e
Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik
të firmuara nga Stalini dhe në rezolucionet e Informbyrosë,
dhe nga ana tjetër, vlerësimi që u bëri N.Hrushovi udhëheqësve
jugosllavë dhe veprimtarisë së tyre në bazë të mendimeve su-
bjektive dhe «të demaskimit të agjentit Beria». Ç'tregon ekspe-
riencia, ç'tregon jeta? Eksperienca dhe jeta praktike, edhe para,
edhe pas vitit 1955, tregon se në vlerësimin e çështjes jugosllave
kishin të drejtë Stalini dhe Informbyroja, sepse vlerësimi i tyre
mbështetej në faktet objektive, në mësimet e marksizëm-lenin-
izmit. Eksperienca dhe jeta praktike tregojnë, nga ana tjetër,
se në qëndrimin ndaj klikës revizioniste të Titos nuk kanë të
drejtë N.Hrushovi dhe ata që e pasojnë, sepse veprimet e tyre
mbështeten në pikëpamje subjektive dhe janë në kundërshtim
me mësimet e marksizëm-leninizmit, në kundërshtim me reali-
tetin objektiv.

Le t'u referohemi fakteve. Ç'rezultate dhanë përpjekjet e
N.Hrushovit për rehabilitimin e klikës së Titos? Udhëheqësit re-
vizionistë jugosllavë nuk hoqën dorë as nga pikëpamjet e tyre
antimarksiste, as nga veprimtaria e tyre armiqësore kundër
kampit socialist dhe partive komuniste e punëtore motra. Ju-
gosllavia nuk u kthye në gjirin e kampit socialist. Rezultati më
i dukshëm që dhanë përpjekjet e N.Hrushovit ishte fakti se pas
vitit 1955 u krijuan mundësi për bandën e renegatëve jugosllavë
që të veprojnë më lirisht, nën maskën e «shokut të persekutuar»,
kundër lëvizjes komuniste dhe vendeve të kampit socialist, du-
ke shfrytëzuar në këtë drejtim edhe patronazhin e sekretarit
të parë të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit
Sovjetik, N.Hrushovit. Rehabilitimi i kryerevizionistëve solli me
vete edhe rehabilitimin e gjithë agjentëve e shokëve të tyre në
disa parti motra, ku nën maskën e «korrigjimit të gabimeve»,
filloi një fushatë e vërtetë kundër kadrove të shëndoshë të
partisë dhe një aktivizim i të gjithë elementëve antiparti. Kë-
shtu ndodhi si në disa parti të vendeve socialiste të Evropës,
ashtu edhe në disa parti të vendeve kapitaliste. Më tipike në
këtë drejtim janë ngjarjet e Hungarisë, ku aktivizimi i elemen-
tëve revizionistë me Imre Nagin në krye, që kishin përkrahjen
dhe nxitjen aktive të revizionistëve jugosllavë, çoi deri në
shpërthimin e kundërrevolucionit, i cili vuri në rrezik vetë ekzisten-
cën e Hungarisë si shtet i demokracisë popullore.

N.Hrushovi vazhdimisht, me besim të madh të Titua dhe
shokët e tij, ndoqi me këmbëngulje politikën e afrimit, të lajka-
ve dhe përkëdheljeve me revizionistët jugosllavë. Ngjarjet e Hun-
garisë e tregojnë fare qartë këtë qëndrim. Kur filloi kundërrevo-
lucioni në Hungari, për çdo njeri ishte e qartë se në ngjarjet
hungareze një rol të poshtër po luanin revizionistët jugosllavë.

Kjo dukej në influencën e tyre në diskutimet e klubit «Petefi», kjo u duk gjatë kryengritjes kundërrevolucionare dhe nga entuziazmi që shprehnin jugosllavët në atë kohë, por akoma më qartë u pa edhe në faktin se tradhëtari Imre Nagi, pas shpartallimit të kundërrevolucionit gjeti strehë në ambasadën jugosllave në Budapest. Në vend që të demaskoheshin pa mëshirë renegatët e Beogradit si nxitës e përkrahës të drejtëpërdrejtë të grushtit kundërrevolucionar në Hungari, N.Hrushovi me çdo mënyrë përpiqet ta zbusë përgjegjësinë e tyre, ta minimizojë dhe, më në fund, ta eliminojë plotësisht. Ky është një fakt i dokumentuar. Kështu, në muajin nëntor 1956, ish-ambasadori i Bashkimit Sovjetik në Shqipëri L.I.Krillov i komunikoi Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë letrën që N.Hrushovi i kishte dërguar J.B.Titos më datën 9 nëntor 1956. Në letër thuhet: «Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik e shqyrtoi letrën tuaj të fundit. Ne e quajmë të mundshme të biem dakord me pikëpamjet tuaja që tani të mos i jepet një rëndësi e veçantë çështjes nëse ambasada jugosllave në Budapest veprimi drejt ose jo duke strehuar Imre Nagin me shokë... Ne vëmë re me kënaqësi se qysh në bisedimet e Brionit ju keni qenë plotësisht dakord me qëndrimin tonë ndaj shokut Janosh Kadar, si një personalitet i shquar e me autoritet revolucionar në Hungari, i aftë në këto momente e kondita të vështira për të kryesuar qeverinë e re revolucionare... Ju ishit plotësisht të kënaqur me faktin që Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik qysh në verën e këtij viti, në lidhje me largimin e Rakoshit, përpiquej që shoku Kadar të bëhej sekretar i parë i Komitetit Qendror të Partisë së Punonjësve në Hungari».

Çdo koment lidhur me këtë letër është i tepërt. Kjo letër tregon fare qartë se N. Hrushovi, duke marrë nëpër këmbë çdo rregull që përcakton marrëdhënjet midis partive motra, ka shkuar aq larg sa të ndërhyjë edhe në një çështje kaq të rëndësishme dhe me një karakter të theksuar të brendshëm partie siç është caktimi në vendin e sekretarit të parë të një partie motër të këtij apo atij personi. Ajo tregon gjithashtu fare qartë se N.Hrushovi ka qenë prej kohësh plotësisht dakord me J.B.Titon, se ai e ka parë të arësyeshme që për çdo gjë, bile edhe për «emërimin» e sekretarit të parë të një partie tjetër të këshillohej me J.B.Titon, me këtë armik të socializmit, me vetë frymëzuesin e kundërrevolucionit në Hungari. Nga kjo kuptohet qartë dhe është fare logjike pse N.Hrushovi u përpoq të mbyllej çështja e ndërhyrjes jugosllave në ngjarjet e Hungarisë: sepse nuk mund të bëhen dy gjëra në të njëjtën kohë, edhe të këshillohej me Titon edhe të demaskonte Titon.

Pikëpamja e Partisë së Punës të Shqipërisë ka qenë se revizionistët jugosllavë janë tradhëtarë të marksizëm-leninizmit,

se ata punonin për të minuar unitetin e kampit socialist dhe të lëvizjes komuniste ndërkombëtare, se ata me veprimet e tyre anti-marksiste, kundër Partisë së Punës të Shqipërisë dhe partive të tjera komuniste e punëtoje, bënin plotësisht punën e imperia-listëve amerikanë. Prandaj, sipas pikëpamjes sonë, asnjë shpresë nuk kishte që udhëheqja jugosllave, klika e Titos, të përmirësohej, të kthehej në pozita të drejta marksiste-leniniste. Këtë gjë Komiteti Qendror i Partisë sonë ja ka bërë të ditur Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik qysh në maj 1955, pra, qysh përpara vizitës së Hrushovit në Jugosllavi. Këtë pikëpamje tonën të ilustruar edhe me ngjarjet e Hungarisë dhe veprimtarinë kundër Partisë sonë gjatë vitit 1956, ja shtruan N. Hrushovit edhe në prill 1957 gjatë bisedimeve midis dy delegacioneve të partive tona në Moskë. N.Hrushovi kërcënoi se do të ndërpriste bisedimet midis dy delegacioneve tona, duke thënë: «Ashtu siç folët ju për udhëheqjen jugosllave, duhet menduar se udhëheqja jugosllave ka tradhëtuar, se ajo nuk është fare në taban... sipas jush ne duhet të kthehemi në metodat që përdori Stalini...»

Për Partinë tonë ishte e qartë se e drejta ishte në anën tonë, sepse ne mbështeteshim në realitetin objektiv, në mësimet e marksizëm-leninizmit, kurse N.Hrushovi nuk kishte aspak të drejtë, sepse ai mbështetej në pikëpamje oportuniste, të cilat puqeshin plotësisht me ato të udhëheqësve revizionistë jugosllavë.

Pas fjalimit famëkeq të Titos në Pula u gjallërua lufta e partive komuniste e punëtoje kundër revizionizmit jugosllav dhe u kritikuan udhëheqësit jugosllavë për qëndrimin e tyre. Por grupi tradhëtar i Titos jo vetëm nuk bëri asnjë autokritikë apo hap pozitiv ndaj lëvizjes komuniste, por në vitin 1958 e gjykoji bile të volitshme të formulonte e të përmbledhte idetë e veta revizioniste në të ashtuquajturin program të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë, i cili u botua si kundërpeshë e Deklaratës së partive komuniste e punëtoje të nëntorit 1957. Dukej sikur tashmë nuk kishte vend as për iluzionin më të vogël, sepse Titua dhe grupi i tij atë çka fshihnin prej vjetësh nën parulla demagogjike pseudo-marksiste e pseudosocialiste, në program e shkruan hapur. Por ç'ndodhi? Në fillim nga N.Hrushovi, i cili e ndjeu veten ngushtë para opinionit publik dhe lëvizjes komuniste ndërkombëtare, megjithëse me gjysmë zemre, u mbajt qëndrim për revizionistët jugosllavë. Në fjalimin e mbajtur në Kongresin e Partisë Komuniste Bullgare në 3 qershor 1958, N.Hrushovi deklaroi në mënyrë të bujshme: «Revizionizmi i sotëm është një farë kali i Trojës. Revizionistët përpiquej t'i dekompozojnë nga brenda partitë revolucionare, të minojnë unitetin, të shkaktajnë rrëmuje e konfuzion në ideologjinë marksiste-leniniste... Për lëvizjen revolucionare janë

veçanërisht të rrezikshëm ata që duke e quajtur veten marksistë-leninistë, e duan ose jo një gjë të tillë, në të vërtetë luajnë rolin e agjenturës së armikut të klasës në lëvizjen punëtore... Forca e socializmit, uniteti i partive komuniste e punëtore mund të forcohen vetëm në luftë kundër revizionizmit, në luftë për pastërtinë e teorisë marksiste-leniniste».

Rreth një muaj më vonë, më 11 korrik 1958, duke folur në Kongresin V të Partisë Socialiste të Bashkuar Gjermane, N.Hrushovi tha gjithashtu: «Pavarësisht nëse duan ose jo personalitetet jugosllave, ata i ndihmojnë armikut të klasës punëtore dhe prandaj, atyre u japin kredi. Për këtë imperialistët lavdërojnë politikën e tyre «të pavarur e jashtë bloqeve», të cilën forcat reaksionare e shfrytëzojnë për të minuar kampin socialist. Kur njerëzit e quajnë veten marksistë-leninistë, por në thelb u ndihmojnë imperialistëve, ne e konsiderojmë si detyrën tonë që t'i demaskojmë me vendosmëri këta njerëz».

Por kjo nuk zgjati shumë. Me një shkathtësi të habitshme dhe në kundërshtim me logjikën më elementare, N.Hrushovi po në Kongresin V të Partisë Socialiste të Bashkuar Gjermane dha orientimin që të mos flitet për revizionistët jugosllavë, duke thënë: «Në luftën tonë për çështjet e përbashkëta nuk duhet t'u kushtojmë revizionistëve jugosllavë më shumë vëmendje nga sa meritojnë. Ata duan që t'u ngrihet vlera, që njerëzit të mendojnë se ata janë qendra e botës... Ne nuk do të ndihmojmë në ndezjen e pasioneve, në ashpërsimin e marrëdhënjeve. Edhe në gjendjen e krijuar në marrëdhënjet tona me Lidhjen Komuniste Jugosllave do të jetë e dobishme të ruhet një shkëndijë shprese, të kërkohen forma të pranueshme për disa çështje».

Këtë gjë ai e theksoi edhe gjatë vizitës së tij në Shqipëri në maj 1959, ku deklaroi se «delegacioni sovjetik, për shkaqe të kuptueshme, në fjalimet e tij nuk do të prekë çështjen jugosllave dhe shpreson se miqtë shqiptarë në fjalimet e tyre do ta kenë parasysh si duhet këtë gjë».

Në të njëjtën kohë, gjithnjë më shpesh filloi të qarkullojë përsëri fjala mbi «shokun Tito», filloi sërish të propagandohet se «Jugosllavia është shtet socialist», se midis Bashkimit Sovjetik dhe Jugosllavisë «ekziston mirëkuptimi reciprok për shumë probleme të politikës së jashtme» (shih bisedën e N.Hrushovit me S. V. Tempon më 16 janar 1960) etj.

Është me vend të kujtojmë se V.I.Lenini në kohën e tij ka zhvilluar një luftë të papajtueshme jo vetëm kundër oportunitetit, por edhe kundër atyre që predikonin «unitetin» me oportunistët, duke e justifikuar këtë me faktin se gjoja konditat objektive e lejojnë një gjë të tillë. Lenini këtyre «optimistëve» të oportunitetit u është drejtuar me këto fjalë:

«...ju tani, nëpër vendet imperialiste të Evropës peruleni si shërbëtorë përpara oportunistëve, të cilët janë të huaj për proletariatin si klasë agjentësh, shërbëtorësh, përcues të influencës borgjeze; po nuk u çlirua prej tyre, lëvizja punëtore do të mbetet një lëvizje punëtore borgjeze. Propaganda juaj «e unitetit» me oportunistët, me Leginë dhe Davidët, Plehanovët ose Çhenkelët dhe Potresovët etj. është objektivisht mbrojtje e sk'lavërimin të punëtorëve nga ana e borgjezisë imperialiste me anën e agjentëve më të mirë të saj në lëvizjen punëtore. Fitorja e socialdemokracisë revolucionare në shkallë botërore është absolutisht e pashmangshme, por ajo shkon dhe do të shkojë, zhvillohet dhe do të zhvillohet vetëm kundër jush, do të jetë fitore mbi ju»¹. (V. I. Lenin. Veprat, vëll. 23, f. 100, bot. IV rus).

Grupi revizionist i udhëheqësve jugosllavë, duke u lënë i qetë në punën e tij tradhëtare, antisocialiste e komplotiste, vazhdoi më me intensitet veprimtarinë e tij si për përçarjen e lëvizjes komuniste, ashtu edhe për minimin e lëvizjes nacional-çlirimtare dhe antiimperialiste të popujve që luftojnë për liri ose që sapo kanë fituar pavarësinë kombëtare. Revizionistët jugosllavë përditë e më shumë e treguan veten si armiq të komunizmit e të lirisë së popujve. Pikërisht sepse banda revizioniste e Titos është e tillë, përfaqësuesit e 81 partive komuniste e punëtore motra në Deklaratën e Moskës të vitit 1960 i dënuan me vendosmëri udhëheqësit revizionistë jugosllavë. Në deklaratë, siç dihet, theksohet se udhëheqësit jugosllavë mbasi tradhëtuan marksizëm-leninizmin, e shkëputën vendin e tyre nga kampi socialist, e vunë atë nën varësinë e së ashtuquajturës «ndihmë» të imperialistëve amerikanë dhe të imperialistëve të tjerë dhe në këtë mënyrë krijuan rrezikun e humbjes së fitoreve revolucionare të arritura me luftën heroike të popullit jugosllav, se revizionistët jugosllavë bëjnë një punë minuese kundër kampit socialist dhe lëvizjes komuniste ndërkombëtare, se ata nën pretekstin e politikës jashtë bloqeve zhvillojnë një veprimtari që i sjell dëm çështjes së unitetit të të gjitha forcave dhe shteteve paqedashëse. Më në fund, në deklaratë theksohet nevoja e domosdoshme e një lufte të vazhdueshme për demaskimin e plotë të grupit të udhëheqësve jugosllavë.

Megjithkëtë, pas nëntorit 1960, në të shumtën e rasteve nga udhëheqja sovjetike dhe ajo e disa partive të tjera, këto teza të drejta të Deklaratës së Moskës u lanë në harresë. Bile, si për të inkurajuar klikën revizioniste të Titos, për të «zbutur» zemëri-

1 V. I. Lenin. Veprat, vëll. 23, f. 129-130.

min e saj, nga udhëheqësit sovjetikë u pa e arësyeshme të bëhen deklarata zyrtare të ngrohta në adresë të «shokëve» jugosllavë. Kështu, vetëm pak ditë pas daljes së Deklaratës së 81 partive motra, anëtari i Komitetit Qendror të Partisë Komuniste dhe ministri i jashtëm i Bashkimit Sovjetik, A.Gromiko, në datën 23 dhjetor deklaroi në Sovjetin Suprem të Bashkimit Sovjetik se në disa gjëra themelore politika e jashtme e Bashkimit Sovjetik përputhet plotësisht me politikën e jashtme të Jugosllavisë. Kurse vetë N. Hrushovi në intervistën e dhënë vëzhguesit të gazetës «Nju Jork Tajms», Sulzberger, botuar në «Pravda» më 10 shtator 1961, deklaroi: «ne, natyrisht, e konsiderojmë Jugosllavinë një vend socialist». A nuk është një deklaratë e tillë në kundërshtim me Deklaratën e 81 partive komuniste dhe punëtore motra? A nuk duhet menduar se N.Hrushovi me këtë deklaratë ka synuar «të zbusë» zemërimin e udhëheqësve revizionistë jugosllavë dhe t'u bëjë atyre të ditur publikisht se çka shkruhet në Deklaratën e Moskës apo edhe në ndonjë dokument tjetër të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik është formale, kurse pikëpamjet e tija janë të tjera?

Përse vallë ndodh një gjë e tillë? Përse mbahet një qëndrim i tillë dashamirës me kaq këmbëngulje ndaj një bande renegatësh të marksizëm-leninizmit, të zhytur kokë e këmbë në llumin e revizionizmit e të tradhëtisë dhe, në të njëjtën kohë, sulmohen me tërbim partitë komuniste e punëtore që i kanë qëndruar kurdoherë besnike doktrinës revolucionare të marksizëm-leninizmit dhe çështjes së socializmit?

Partia e Punës e Shqipërisë nuk mund të ishte dhe as që mund të jetë dakord me një qëndrim të tillë oportunist ndaj bandës së rrezikshme revizioniste të Titos, që është një agjenturë e regjur e imperializmit dhe një armike e egër e socializmit dhe e komunizmit, e Partisë së Punës të Shqipërisë dhe e popullit shqiptar. Në luftën kundër revizionizmit të sotëm, sidomos kundër klikës revizioniste të Titos, Partia jonë e Punës ka mbajtur dhe mban kurdoherë parasysh mësimet e çmueshme të të madhit Lenin, i cili theksonte me forcë se

«Çdo qëndrim jokonsekuent ose dobësi në demaskimin e atyre që e tregojnë veten si reformistë ose «centristë», do të thotë një shtim i drejtëpërdrejtë i rrezikut të përmbysjes së pushtetit të proletariatit nga borgjezia, e cila do të përdorë nesër për kundërrevolucionin atë që njerëzve dritëshkurtër sot u duket vetëm si një «divergjencë teorike»¹. (V. I. Lenin. Veprat, vëll. 31, f. 166, bot. IV rus).

1. V. I. Lenin. Veprat, vëll. 31, f. 205.

Këto mësimet të rëndësishme të Leninit ishin aq më tepër të kuptueshme për Partinë tonë, sepse ajo e kishte provuar në kurrizin e saj se çdo të thotë revizionizëm jo vetëm në teori, por dhe në praktikë. Sepse, në fakt, klika e Titos kurrë ndonjëherë, as përpara vitit 1948 dhe as pas vitit 1955, jo vetëm nuk ka hequr dorë nga komploti e diversioni kundër Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Partisë së Punës të Shqipërisë, por bile i ka shtuar ato. Pra, lufta e Partisë së Punës të Shqipërisë kundër revizionizmit jugosllav ishte jo vetëm një detyrë e rëndësishme internacionaliste e Partisë sonë si parti marksiste-leniniste, por dhe një detyrë e shenjtë patriotike për të mbrojtur atdheun tonë socialist nga synimet dhe komplotet e revizionistëve jugosllavë. N.Hrushovit nuk i pëlqente ky qëndrim i Partisë së Punës të Shqipërisë, i cili ishte në kundërshtim me pikëpamjet e tija dhe përbënte një pengesë për planet e tij të afrimit e të përqafimit me klikën titiste. Filluan të qarkullojnë parullat se «shqiptarët janë gjaknxehtë», «shohin ngushtë dhe e bëjnë luftën kundër udhëheqësve jugosllavë nga pozitë e nacionalizmit», se «shqiptarët duan të rrëmbejnë flamurin e antirevizionizmit» dhe se «po i rritin vlerën klikës së Titos» etj. etj. Por Partia jonë nuk u lëkund nga pozitë e saja parimore dhe vazhdoi me konsekuencë e pa kompromis luftën kundër revizionistëve jugosllavë. Ky veprim i Partisë sonë asnjëherë nuk i ka pëlqyer N.Hrushovit.

Qëndrimi i udhëheqjes sovjetike ndaj revizionizmit jugosllav, në fakt, nuk është qëndrim i ndryshëm vetëm nga ai i Partisë së Punës të Shqipërisë, por nga ai i gjithë lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare, nga qëndrimi i shprehur në Deklaratën e Moskës të vjetërë 1957 e 1960, ku revizionizmi cilësohet si rreziku kryesor në lëvizjen komuniste e punëtore ndërkombëtare dhe revizionizmi jugosllav si minues i kampit socialist dhe i forcave të paqes. Pra, është e qartë se udhëheqja sovjetike me N. Hrushovin në krye përpiqet të zbusë luftën kundër oportunitizmit dhe revizionizmit në lëvizjen komuniste. Këtu e kanë burimin edhe orvatjet e N.Hrushovit e të grupit të tij për të shtrembëruar me gjithfarëlloj manipulimesh tezën e qartë të dy Deklaratave të Moskës mbi revizionizmin si rreziku kryesor në lëvizjen komuniste e punëtore dhe për të nxjerrë në plan të parë luftën kundër dogmatizmit. Për Partinë tonë ka ardhur duke u bërë çdo ditë e më e qartë se, duke e pranuar me fjalë nevojën e luftës kundër revizionizmit dhe duke mos e bërë në fakt, N.Hrushovi dhe ata që e pasojnë, nën pretekstin e luftës kundër dogmatizmit (edhe Titua shpall luftën kundër «stalinizmit» e «dogmatizmit»), luftojnë kundër marksizëm-leninizmit, bëjnë përpjekje për të hedhur poshtë tezat themelore të doktrinës revolucionare të proletariatit, pikërisht ashtu siç u orvat të bënte më parë Titua dhe siç janë orvatur në të kaluarën oportunistët e revizionistët e kallëpeve të ndryshme.

Cilat qenë pasojat e luftës së paprinciptë kundër J.V.Stalinit, e përhapjes së pikëpamjeve oportuniste të Kongresit XX dhe e politikës së pajtimit me klikën tradhëtare revizioniste të Titos që kanë ndjekur me këmbëngulje N.Hrushovi dhe grupi i tij? Megjithëse ata ngrenë në qiell me bujë të madhe «pasojat e mrekullueshme» që dhanë gjoja «kritika e kultit të personit të J.V. Stalinit» dhe «normalizimi i marrëdhënjeve me Jugosllavinë», megjithëse e paraqesin çështjen sikur me Kongresin XX filloi një epokë e re në zhvillimin dhe forcimin e mëtejshëm të lëvizjes komuniste botërore, faktet flasin krejt të kundërtën. Këto pikëpamje e veprime të shtrembëra u bënë flamur në duart e elementëve oportunistë e revizionistë në shumë vende për të shpërthyer sulmin revizionist kundër partive marksiste-leniniste. Kështu ndodhi në Partinë Komuniste të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të Danimarkës, Hollandës, Italisë, Francës, Anglisë, etj. Nën ndikimin e pikëpamjeve oportuniste, të paraqitura nga N.Hrushovi në Kongresin XX, revizionizmi u gjallërua dhe mori një përhapje të gjerë, duke u bërë një rrezik shumë serioz për tërë lëvizjen komuniste ndërkombëtare. Pikërisht nën parullat e luftës kundër «despotizmit stalinist», të huajtura nga raporti «sekret» i N.Hrushovit në Kongresin XX «Mbi kultin e individit dhe pasojat e tij», i cili për çudi u ra në dorë qarqeve reaksionare në Perëndim dhe u ribotua prej tyre me tonelata, reaksioni imperialist dhe revizionistët modernë, sidomos renegatët revizionistë të Beogradit — armiq të socializmit, të Bashkimit Sovjetik dhe të popujve të të gjitha vendeve të kampit socialist, organizuan veprimet kundërrevolucionare kundër rendit socialist në Poloni dhe grushtin kundërrevolucionar në Hungari, i cili kishte për qëllim të krijonte një vatër luftime në mes të vendeve socialiste, të përmbyste pushtetin popullor dhe ta zëvendësonte atë me pushtetin e çifligarëve e të kapitalistëve, ta bënte Hungarinë një Jugosllavi të dytë për veprimtari minuese kundër kampit socialist dhe lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare. Pikërisht nën mbrojtjen e tezave oportuniste të Kongresit XX, të sulmeve kundër Stalinit dhe të qëndrimeve pajtuese të N.Hrushovit, u gjallërua më tepër se kurrë banda renegate e Titos, ju la dorë e lirë asaj për të zhvilluar gjerësisht veprimtarinë e saj minuese kundër kampit socialist dhe lëvizjes komuniste ndërkombëtare.

Për ne është krejt e qartë se një konkluzion i tillë nuk është i pranueshëm as për N.Hrushovin, as për pasuesit e tij. Por është logjike të shtrojmë pyetjen: përse pikërisht pas Kongresit XX dhe duke u mbështetur mbi tezat e tija u gjallëruan menjëherë renegatët dhe revizionistët në radhët e partive komuniste e punëtore të vendeve të ndryshme, ngriti përsëri krye klika revizioniste jugosllave dhe të gjithë së bashku shpërthyen sulmin fron-

tal kundër marksizëm-leninizmit? Përse flamur i tyre nuk u bënë, të themi, tezat e Kongresit XIX apo XVIII të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik? Këtu ka vetëm një shpjegim: tezat që N.Hrushovi shtroi në Kongresin XX ishin teza oportuniste, prandaj përbënin ushqimin ideologjik të renegatëve e revizionistëve në luftën e tyre kundër marksizëm-leninizmit, qëndrimet e tij ndaj Stalinit dhe ndaj klikës së Titos ishin antimarksiste, prandaj u përdorën me aq sukses për qëllimet e tyre nga armiqtë e marksizmit e të socializmit.

Për këtë dëshmojnë qartë edhe vlerësimet që i kanë dhënë Kongresit XX revizionistët e ndryshëm. Duke folur për rëndësinë e Kongresit XX të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, teoricieni i revizionizmit jugosllav Kardel qysh më 29 shkurt 1956 në konferencën e Lidhjes së Komunistëve Jugosllavë të Novisadit pati deklaruar: «S'ka dyshim se Kongresi XX është një ngjarje e madhe, influenca e së cilës do të ndihet gjatë shumë vjetëve, kurse rëndësia e saj e vërtetë mund të vlerësohet plotësisht vetëm në të ardhshmen. Rëndësia e këtij kongresi nuk qëndron aq në vendimet konkrete që u formuluan prej tij, por para së gjithash në ato procese, zhvillimin e të cilave ai filloi ose shpejtoi. Kongresi tërhoqi vëmendjen në një varg fenomenesh me karakter subjektiv e objektiv, të cilat në fusha të ndryshme të zhvillimit socialist ishin shkak i frenimit dhe amullisë. Me këtë kongresi jo vetëm që përmirësoi kushtet për zhvillimin e brendshëm socialist, por futi shumë gjëra që e gjallëruan lëvizjen dhe zhvillimin socialist ndërkombëtar». (Gazeta «Pravda», 4 mars 1956). Pasojat e Kongresit XX dhe të tezave të tija oportuniste, të qëndrimeve antimarksiste të N.Hrushovit ndaj J.V.Stalinit dhe politikës së tij oportuniste ndaj klikës së Titos, u ndjenë edhe në Shqipëri. Në vendin tonë elementët oportunistë të tipit Tuk Jakova e Bedri Spahiu, si dhe mjaft elementë të tjerë të përjashtuar nga Partia për veprimtari antiparti u aktivizuan dhe, me nxitjen direkte të revizionistëve jugosllavë, organizuan komplotin në Konferencën e Partisë për qytetin e Tiranës në prill të vitit 1956. Dihet se një rol kryesor në këtë komplot luajti tradhëtari Panajot Plaku, agjent i vjetër i spiunazhit jugosllav, të cilit, mbasi u arratis nga Shqipëria, N. Hrushovi qysh më 1957 propozoi t'i jepej edhe strehim politik në Bashkimin Sovjetik. Parullat e këtyre tradhëtarëve ishin parullat demagogjike «të liberalizimit e demokratizimit të diktaturës së proletariatit», «të normalizimit të marrëdhënjeve me Jugosllavinë», «të rehabilitimit të Koçi Xoxes» dhe të elementëve antiparti të dënuar më parë etj. Është mjaft kuptimplotë fakti që pikërisht në atë kohë, në prill-maj 1956, N.Hrushovi me anë të M.Susllovit dhe të P.Pospjellovit u përpoq të bindte Partinë tonë për të rehabilituar tradhëtarin Koçi Xoxe, armik i Partisë e i popullit shqiptar, agjent i klikës së Titos, i pushkatuar

për veprimtarinë e tij armiqësore, i cili synonte likuidimin e Partisë e të pushtetit popullor dhe shndërrimin e Shqipërisë në një republikë të shtatë të Jugosllavisë titiste.

Kongresi XX dhe qëndrimet antimarksiste të N.Hrushovit për çështjet e mësipërme i sollën, pra, një dëm të madh çështjes sonë të përbashkët të socializmit e të komunizmit...

Megjithkëtë, lëvizja komuniste e punëtore ndërkombëtare mundi t'i bëjë ballë me sukses sulmit të renegatëve revizionistë. Radhët e partive komuniste e punëtore u forcuan dhe kjo i detyrohet forcës e qëndrueshmërisë së partive komuniste e punëtore motra, vitalitetit të ideve të marksizëm-leninizmit. Dhe kështu do të ndodhë gjithnjë. Marksizëm-leninizmi është flamuri i fitores, prandaj armiqtë e tij, revizionistët dhe oportunistët, kanë dështuar e do të dështojnë kurdoherë me turp.

Nga sa u tha më sipër del fare qartë se shkaku i vërtetë i kontradiktave tona qëndron në mosmarrëveshjet e thella ideologjike e politike që janë shfaqur në lëvizjen komuniste ndërkombëtare, si rezultat i pikëpamjeve dhe i veprimtarisë oportuniste të N.Hrushovit për disa çështje jetike të zhvillimit të sotëm ndërkombëtar e të lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare, pikëpamje që janë në kundërshtim me disa nga parimet themelore të marksizëm-leninizmit dhe përbëjnë një shkelje të rëndë të deklaratave të partive komuniste e punëtore të vjetëve 1957 dhe 1960. Këtu, pra, duhet kërkuar burimi i kontradiktave dhe i mosmarrëveshjeve tona ideologjike e politike, të cilat zjerrin në gjirin e lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare dhe që shpërthyen haptazi në Mbledhjen e Bukureshtit.

Por ekzistenca e këtyre pikëpamjeve të shtrembëra të udhëheqësit sovjetikë, me N.Hrushovin në krye, është vetëm gjysma e së keqes. E keqja më e madhe është se konceptet e tyre oportuniste ata përpigën t'ua imponojnë me çdo kusht të gjitha partive komuniste e punëtore, pa u ndalur për këtë qëllim as përpara presioneve, shantazheve e sulmeve më brutale kundër atyre partive motra dhe udhëheqësve të tyre që nuk janë dakord me tezat revizioniste të N.Hrushovit, që i kundërshtojnë ato dhe mbrojnë me vendosmëri marksizëm-leninizmin. Dëshmia më e qartë për këtë është qëndrimi armiqësor, pa precedent, i N.Hrushovit kundërshtues të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe udhëheqjes së saj. Duke e parë se orvatjet e tija të shumëllojshme, për të gjunjëzuar Partinë e Punës të Shqipërisë dhe për t'i imponuar asaj pikëpamjet e veta antimarksiste dështuan me turp para qëndrimit të patundur marksist-leninist të Partisë sonë dhe duke dashur të justifikojë përpara partisë së tij dhe përpara lëvizjes komuniste ndërkombëtare veprimtarinë e vet të palejueshme armiqësore kundërshtues të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe Republikës Popullore të Shqipërisë (presionet, shantazhet, blokatat,

orvatjet për të përmbytur udhëheqjen e Partisë sonë etj.), N. Hrushovi është hedhur në shpifje të egra, duke arritur deri atje sa pa pikë turpi ta akuzojë udhëheqjen e Partisë sonë se është vënë gjoja në shërbim të zbulimeve të huaja imperialiste.

Ne e kuptojmë mirë gjendjen e vështirë në të cilën e ka vënë veten N. Hrushovi, saqë detyrohet të përdorë dhe armën e fëlliqur të shantazhit politik kundër një partie motër dhe udhëheqësve të saj. Vlen t'u kujtojmë këtu partizanëve të shantazhit politik fjalët e V. I. Leninit, i cili shkruante:

«Shantazh politik do të thotë të kanosesh se do të nxjerrësh në shesh ose të nxjerrësh në shesh «histori» të vërteta, e më të shumtën e herëve edhe të trilluara, me qëllim që ta dëmtosh politikisht kundërshtarin, të shpifësh kundër tij, t'ja heqësh ose t'ja vështirësosh kundërshtarit mundësinë e veprimtarisë politike... Ne duhet të ndjekim të patundur rrugën tonë, të ruajmë aftësinë e partisë sonë për punë, t'i ruajmë udhëheqësit e saj dhe të mos i lëmë bile që ta harxhojnë kohën për t'u marrë me maskarenjtë dhe me shpifjet e tyre të fëlliqura»¹. (V. I. Lenin. Veprat, vëll. 25, f. 236, 329, bot. IV rus).

*
* *

Në letren e 24 gushtit 1961 bëhen shpifje dhe trillohen me paramendim akuza për të fshehur ekzistencën e blokatës e të izolimit në fushën ekonomike, politike e ushtarake, që qysh pas Mbledhjes së Bukureshtit udhëheqja sovjetike, e frymëzuar nga N. Hrushovi dhe nga disa udhëheqës të shteteve socialiste të Evropës kanë organizuar sistematikisht kundër Partisë dhe popullit tonë. Autorëve të letrës nuk u pëlqen që Komiteti Qendror i Partisë sonë i quan gjërat me emrin e tyre të vërtetë, prandaj me këmbëngulje, duke thurur lloj-lloj shpifjesh e falsifikimesh, kërkojnë të bindin botën se masat që janë marrë kundër Shqipërisë nuk kanë karakter hakmarrës, se për zbatimin e tyre qenkan faktorë udhëheqësit shqiptarë, të cilët bile vetë (!) paskan kërkuar edhe largimin e specialistëve nga Shqipëria, edhe anullimin e punimeve në Pallatin e kulturës, edhe likuidimin e bazës ushtarako-detare të Vlorës etj. etj. Por faktet dhe dokumentat e shumtë janë kryeneçe, ato nuk mund të lejojnë asnjëri që të mashtrojnë opinionin publik për një kohë të gjatë. Përpara tyre shpifjet e trillimet, kurthet dhe grackat e ndryshme, bëhen pluhur e hi. Me anën e letrës së 6 korrikut 1961 të Komitetit Qendror të Partisë

¹ V. I. Lenin. Veprat, vëll. 25, f. 299, 303.

së Punës të Shqipërisë dhe të Këshillit të Ministrave të Republikës Popullore të Shqipërisë, drejtuar Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe Këshillit të Ministrave të BRSS, është folur me hollësi mbi faktet e shumta e të pakundërshtueshme të veprimtarisë praktike antimarksiste e antishqiptare që po zbatojnë N. Hrushovi dhe disa udhëheqës të vendeve socialiste të Evropës për të bllokuar e izoluar ekonomikisht, politikisht dhe ushtarakisht Partinë e Punës të Shqipërisë dhe Republikën Popullore të Shqipërisë. Ne e kemi theksuar dhe do ta theksojmë se bllokada e vendosur kundër Partisë së Punës të Shqipërisë dhe Republikës Popullore të Shqipërisë ka karakter hakmarrës, se ajo është frymëzuar dhe organizuar nga N. Hrushovi kundër një partie të një vendi të vogël, e cila ka bërë të vetmin «krim» se ngriti zërin e saj të drejtë në mbrojtje të marksizëm-leninizmit, pavarësisht se fajtori, në këtë rast, ishte udhëheqësi i një partie të madhe. Me anën e kësaj blokade N. Hrushovi dhe pasuesit e tij synojnë, nga njëra anë, të gjunjëzojnë Partinë e Punës të Shqipërisë e të likuidojnë udhëheqjen e saj dhe, nga ana tjetër, të mashtrojnë partitë komuniste e punëtore motra, gjithë opinionin e lëvizjes komuniste ndërkombëtare, se gjoja Partia e Punës e Shqipërisë ka hyrë në rrugën e armiqësisë me Bashkimin Sovjetik dhe ka marrë anën e Perëndimit. Por, përse i përket qëllimit të parë, N. Hrushovi dhe pasuesit e tij nuk do të kenë kurrë sukses, ata do të dështojnë me turp, siç kanë dështuar të gjitha synimet e këtij lloji të armiqve të Partisë e të popullit tonë. Përse i përket qëllimit të dytë, edhe në qoftë se do të arrijnë ndonjë farë suksesi, ky do të jetë vetëm i përkohshëm. Ne jemi të bindur se me kalimin e kohës të gjithë njerëzit e ndershëm do të kuptojnë qëllimet e N. Hrushovit.

Si pasojë e blokadës, marrëdhënjet ekonomike midis Bashkimit Sovjetik dhe Republikës Popullore të Shqipërisë janë keqësuar shumë. Të gjitha kreditë që kishte akorduar Qeveria e Bashkimit Sovjetik për financimin e planit të tretë pesëvjeçar të Republikës Popullore të Shqipërisë për periudhën 1959-1965 janë anuluar në mënyrë të njëanshme. Dihet se marrëveshja përkatëse për akordimin e kësaj kredie prej 300 milion rublash të vjetra është nënshkruar qysh më 3 korrik 1959. Qeveria Sovjetike refuzoi të nënshkruajë marrëveshjen mbi kredinë për mekanizimin e bujqësisë, për të cilën ishte marrë konfirmimi zyrtar qysh nga mesi i vitit 1960. Akoma deri sot, si rezultat i refuzimit të palës sovjetike, nuk është nënshkruar marrëveshja dypalëshe mbi kleringun që duhej nënshkruar për periudhën 1961-1965 në përputhje me protokollin, gjë që i ka sjellë dëme kolosale ekonomisë popullore të Shqipërisë. Jo vetëm kaq, por edhe marrëveshja e vitit 1961 mbi kleringun e firmuar rregullisht nga përfaqësuesit e dy qeverive tona, u ndërpre nga pala sovjetike në mënyrë të njëanshme

dhe ultimative në gjashtëmuorin e dytë të këtij viti me pretekstin se Qeveria Shqiptare duhet të shlyejë më parë ratat përkatëse të kredive të mëparshme që Bashkimi Sovjetik i ka akorduar Shqipërisë. Në bazë të letrës së 25 prillit 1960, të firmuar nga N. Hrushovi, shlyerja e ratave dhe e interesave që rrjedhin prej tyre shtyhej për 10-15 vjet, d.m.th. do të bëhej që nga viti 1971 e tutje, dhe në fakt, në bazë të kësaj letre, u ndalua menjëherë pagimi i ratave dhe i interesave dhe bankat shtetërore të të dy vendeve nuk kryen më veprime për këtë çështje, kurse në gjysmën e dytë të vitit 1961 kërkohet pagimi i ratave dhe i interesave qysh tani. Është e qartë se këto masa e presione ekonomike kanë për qëllim të krijojnë vështirësi ekonomike për Partinë dhe Qeverinë Shqiptare, aq më tepër që udhëheqësit sovjetikë e njohin mirë forcën dhe kapacitetin tonë ekonomik. Megjithkëtë, autorët e letrës së 24 gushtit 1961 kërkojnë të mohojnë karakterin hakmarrës të këtyre masave armiqësore ndaj popullit shqiptar dhe të provojnë se këto masa gjoja i kërkuar vetë udhëheqësit shqiptarë.

Në letrën e 24 gushtit 1961, autorët e saj mohojnë edhe faktin e tërheqjes së specialistëve sovjetikë nga Shqipëria, duke e paraqitur çështjen sikur edhe kjo gjë është bërë me kërkesën e autoriteteve shqiptare. Ata, siç duket, mendojnë se mund të gjenden njerëz naivë që të besojnë se Partia e Punës dhe udhëheqësit shqiptarë kanë vendosur të dëmtojnë interesat e ndërtimit të socializmit në Shqipëri, të pengojnë me vullnetin e tyre ndërtimin e uzinave dhe të fabrikave, të industrisë dhe të minierave, të arësimin e të kulturës! Sepse dihet nga të gjithë se Shqipëria, me gjithë përparimet që ka bërë, edhe në fushën e pregatitjes së kuadrove, ka pasur dhe ka nevojë shumë të madhe për specialistë të huaj, veçanërisht në degët më të rëndësishme të ekonomisë e të kulturës. Tërheqja e specialistëve sovjetikë nga Shqipëria është bërë me kërkesën dhe iniciativën e njëanshme të Qeverisë Sovjetike. Këtë e provojnë notat zyrtare të Ambasadës Sovjetike në Tiranë të datave 24 prill 1961, 8 qershor 1961 etj., e provojnë vetë teknikët e specialistët sovjetikë që kanë punuar në Shqipëri dhe që janë dëshmitarë të gjallë të dashurisë, miqësisë e respektit të madh, me të cilin i kanë pasë rrethuar punonjësit shqiptarë gjatë kohës së qëndrimit të tyre në Shqipëri. Dihet, veç kësaj, se tërheqja e specialistëve sovjetikë, si metoda presioni, nuk përdoret për herë të parë në drejtim të Shqipërisë nga Qeveria Sovjetike. Më parë e njëjta gjë dhe me të njëjtat qëllime është bërë edhe në drejtim të disa vendeve të tjera socialiste. Për këto metoda dëshmon gjithashtu edhe fakti se Qeveria Sovjetike, duke filluar që nga 1 shtatori 1961, u preu bursat e studimit mbi 1 000 studentëve, aspirantëve e kursantëve shqiptarë, që vazhdonin studimet e tyre në shkollat e ndryshme sovjetike, në bazë të marrëveshjeve ekzistuese të firmuara midis dy qeverive tona më 5 korrik 1952. Është

e qartë se edhe kjo masë, ashtu si ajo e largimit të specialistëve sovjetikë, u muar me qëllim që të vështirësohet sa më shumë ndërtimi ekonomik e kultural i vendit tonë, që të krijohen sa më shumë pengesa në rrugën e Partisë së Punës të Shqipërisë dhe të Qeverisë Shqiptare.

Në letrën e 24 gushtit 1961 përmendet dhe një absurditet i tillë në lidhje me ndërtimin e Pallatit të kulturës në Tiranë, sikur gjoja Qeveria Shqiptare mori një vendim «për të mënjeluar organizatat sovjetike nga ndërtimi i pallatit dhe për ta përfunduar ndërtimin me forcat e veta». E vërteta është se Qeveria Shqiptare mori vendim për të mos e lënë si varr të zbuluar hapjen e themeleve të Pallatit të kulturës, në mes të qytetit, por për ta përfunduar atë me forcat e veta. Nga ana tjetër, është shpifje e autorëve të letrës së 24 gushtit 1961, kur thonë se Qeveria Shqiptare desh të mënjante organizatat sovjetike nga ndërtimi i Pallatit të kulturës. Partia, qeveria dhe populli ynë e pritën me mirënjohje të madhe vendimin e Qeverisë Sovjetike për të ndërtuar si dhuratë për popullin tonë, si simbol të miqësisë së përjetshme shqiptaro-sovjetike, Pallatin e kulturës në Tiranë. Por, duke filluar nga janari 1961, pala sovjetike i ndërpreu krejtësisht furnizimet për ndërtimin e pallatit si në projekte, ashtu dhe në materiale, megjithëse edhe deri në atë kohë ishte dërguar vetëm një pjesë e vogël e tyre. Mosdërgimi i projekteve dhe materialeve shkaktoi në këtë objekt mosrealizimin e planit të 4-mujorit të parë të vitit 1961, i cili u realizua vetëm 52 për qind. Në këto kondita ndërmarrja jonë kërkoi shumë herë nga përfaqësia sovjetike që të ndërmetësonte për sigurimin e projekteve dhe materialeve.

Më 11 prill 1961 ministri i ndërtimit i dërgoi një letër ambasadorit sovjetik në Tiranë, J. V. Shikin, me anën e së cilës i paraqiti gjendjen e vështirë të ndërtimit të Pallatit të kulturës, të krijuar për faj të palës sovjetike. Pala sovjetike jo vetëm nuk u dha asnjë përgjegjë këtyre kërkesave urgjente, por më datën 26-27 prill 1961, në mënyrë të njëanshme, tërhoqi gjithë specialistët sovjetikë që punonin për ndërtimin e pallatit. Vlen të shënohet se më 13 prill 1961 në Portin e Durrësit erdhi vapori sovjetik «Vostok», i cili, përveç mallrave të tjera që sillte në Shqipëri, kishte në ngarkesë edhe materiale të destinuara për Pallatin e kulturës. Këto materiale u tërhoqën përsëri me pretekstin se gjoja ishin ngarkuar gabimisht dhe se nuk ishin materiale të destinuara për Shqipërinë. E vërteta është se këto materiale ishin për Pallatin e kulturës sipas konosamentit Nr. 180 dhe, në fakt, në ambalazhimin e tyre ishte shkruar qartë destinacioni.

Para një situatë të tillë, kur punimet e pallatit u ndërpreu për faj të palës sovjetike, Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë më datën 5 maj 1961 mori vendimin për financimin e ndërtimit të Pallatit të kulturës dhe pregatitjen e projekteve për-

katëse nga organizatat tona të projektimit. Kështu qëndron e vërteta mbi Pallatin e kulturës në Tiranë.

Tashmë është e qartë se N. Hrushovi u bë iniciatori i vendimit të padrejtë dhe në dëm të interesave të mbrojtjes së Republikës Popullore të Shqipërisë dhe të kampit socialist për likuidimin e njëanshëm të bazës ushtarako-detare të Vlorës. Megjithkëtë, autorët e letrës së 24 gushtit 1961, duke i qëndruar besnikë vijës së paracaktuar për të mohuar çdo gjë, për të hedhur përgjegjësitë mbi udhëheqësit shqiptarë (sepse ndryshe si do të «argumentohet» se ata janë agjentë të imperializmit ?), përpiqen ta paraqesin çështjen krejt ndryshe nga faktet, nga dokumentat, nga realiteti.

Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë nuk e sheh të nevojshme të zgjatet edhe në këtë çështje, sepse në letrën e tij të 6 korrikut 1961 e ka shpjeguar me hollësi se si qëndron puna në të vërtetë. Ne e kuptojmë se, veçanërisht në konditat e sotme të acarimit ndërkombëtar, kur me plot të drejtë Bashkimi Sovjetik dhe vendet e tjera socialiste po marrin masa efektive për të përballuar eventualitetin e një aventure ushtarake të imperializmit, likuidimi i bazës së Vlorës nga vetë udhëheqësit sovjetikë dhe ata të vendeve socialiste të Evropës i ngarkon ata me një përgjegjësi të pafalshme. Por megjithkëtë kjo nuk justifikohet duke bërë përgjegjës të tjerët, sepse dihet mirë se ka qenë komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë ai që mori iniciativën dhe propozoi krijimin e bazës së Vlorës si pikëmbrojtje me rëndësi të madhe strategjike, si për Republikën Popullore të Shqipërisë, në radhë të parë, ashtu edhe për interesat e mbarë kampit socialist. Nuk mund të gjendet njeri me logjikë e arësye që të besojë se Shqipëria, Partia e saj e Punës dhe udhëheqësit shqiptarë, që janë detyruar të ndërtojnë socializmin në kushtet e rrethimit gjeografik kapitalist, nën presionin e vazhdueshëm të provokacioneve dhe të kompleteve të kurdisura dhe të mbështetura nga imperialistët amerikanë dhe Flota e tyre e gjashtë në Mesdhe, nga monarko-fashistët grekë, imperialistët italianë apo revizionistët jugosllavë, të kërkojnë dobësimin e fuqisë mbrojtëse të vendit, të kërkojnë likuidimin e bazës ushtarako-detare të Vlorës, të mos kenë nevojë për përkrahjen ushtarake të Bashkimit Sovjetik dhe të vendeve të tjera të Traktatit të Varshavës! Faktet dhe dokumentat tregojnë qartë se jo Shqipëria, por N. Hrushovi, me qëllim presioni mbi Shqipërinë, likuidoi bazën e Vlorës, se likuidimi i saj është bërë me paramendime, të cilat qysh në nëntor 1960 N. Hrushovi ja shprehu delegacionit të Partisë së Punës të Shqipërisë. Likuidimi i bazës së Vlorës gëzoi pa masë vetëm armiqtë e socializmit, armiqtë e Shqipërisë dhe të Bashkimit Sovjetik, gëzoi imperialistët amerikanë dhe aleatët e shërbëtorët e tyre, të cilët mendojnë se tashmë Shqipëria është e «zbuluar», se pellgu i Mesdheut në rast lufte është plotësisht në duart e tyre.

Por armiqtë gabojnë rëndë. Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë deklaroi se, pavarësisht nga vështirësitë që na janë krijuar jo vetëm si rezultat i likuidimit të bazës së Vlorës, por dhe i prerjes së furnizimeve ushtarake, në rast të një konflikti Republika Popullore e Shqipërisë me mjetet që disponon do të kryejë me nder detyrën e saj si vend socialist, si pjesëtar i Traktatit të Varshavës, se ajo do të mbrojë lirinë dhe pavarësinë e saj dhe interesat e kampit socialist në brigjet e Adriatikut dhe në pellgun e Mesdheut, pa marrë parasysh asnjë sakrificë.

Disa udhëheqës sovjetikë, me N. Hrushovin në krye, janë edhe autorët e krijimit të bllokadës së heshtjes, të bllokadës së izolimit politik kundër atdheut e popullit tonë, kundër pjesëtarit më të vogël të familjes së vendeve socialiste, me anën e së cilës përpara Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, përpara popujve vëllezër të Bashkimit Sovjetik kanë për qëllim të fshehin të vërtetën mbi jetën dhe veprimtarinë e Partisë, të qeverisë dhe të popullit shqiptar. Disa udhëheqës sovjetikë, me mundësitë e shumta që kanë në dorë, sidomos nëpërmjet organeve të shtypit e të propagandës, përploqen që popujt e Bashkimit Sovjetik të mos marrin vesh ç'bëhet në Shqipëri, të mos informohen për përpjekjet dhe fitoret e aleatit të tyre në ndërtimin e socializmit, të mos informohen për politikën e miqësisë vëllazërore që ndjek Partia e Punës dhe Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë ndaj Bashkimit Sovjetik. Puna ka arritur deri atje sa njerëzit sovjetikë të mos vihen në dijeni për veprimtarinë konkrete që u zhvillua në të katër anët e atdheut tonë me rastin e festës së madhe popullore, muajit tradicional të miqësisë shqiptaro-sovjetike. Një muaj veprimtari e gjithanshme politike e shoqërore, kulturele e artistike për miqësinë midis dy popujve vëllezër nuk gjeti shprehjen e saj në asnjë rresht në shtypin dhe propagandën sovjetike.

Veprimtaria e Partisë dhe qeverisë sonë në fushën e politikës së jashtme, përkrahja e plotë dhe e vendosur e politikës së Qeverisë së Bashkimit Sovjetik për rregullimin paqësor të problemit gjerman nëpërmjet përfundimit brenda këtij viti të Traktatit të Pages me Gjermaninë dhe të shndërrimit të Berlinit Perëndimor në një qytet të lirë e të çmilitarizuar, si dhe aprovimi i njëzëshëm nga ana e Partisë, qeverisë dhe popullit tonë i vendimit të Qeverisë Sovjetike për rifillimin e provave bërthamore gjithashtu nuk u janë bërë të ditura opinionit publik. Përpara popullit sovjetik fshihet e vërteta mbi veprimtarinë që zhvillon Partia dhe qeveria jonë në përgjithësi në fushën e politikës së jashtme, në fushën e politikës së bashkëpunimit vëllazëror e internacionalist me vendet e tjera socialiste dhe me partitë komuniste e punëtoreshë motra të botës, fshihet lufta jonë konsekuente dhe parimore për demaskimin e imperializmit amerikan dhe revizionizmit jugosllav, fshihet përkrahja që ne i japim lëvizjes nacional-

-çlirimtare të popujve të shtypur, lëvizjeve revolucionare dhe antiimperialiste në vendet e ndryshme. Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, popujve sovjetikë, nga N. Hrushovi dhe ata që e pasojnë, u është mbyllur çdo shteg për t'u informuar drejt mbi Shqipërinë, atyre u serviren vetëm falsifikime të së vërtetës, shpifjet më monstruoze ndaj Partisë, qeverisë dhe popullit shqiptar. Me të drejtë komunistët sovjetikë, njerëzit sovjetikë, që e dinë mirë se në zemrat e Partisë së Punës e të popullit shqiptar, ashtu si dhe në zemrat e tyre, është e fortë, me rrënjë të thella dhe e pathyeshme miqësia shqiptaro-sovjetike, pyesin: Përse heshtet për Shqipërinë? Përse ngrihet bllokada e heshtjes, bllokada e izolimit politik ndaj këtij vendi të vogël dhe aleat, trim e besnik për jetë e vdekje ndaj Bashkimit Sovjetik dhe marksizëm-leninizmit? Udhëheqja bullgare, me T. Zhivkovin në krye, arriti deri atje sa të botojë telegramin e përshëndetjes që Partia, Qeveria dhe Presidiumi i Kuvendit Popullor të Shqipërisë i dërgonin popullit vëll bullgar me rastin e festës së tij kombëtare, 9 shtatorit, me vonesë të madhe dhe e detyruar nga presioni i opinionit publik bullgar, pasi kishte botuar edhe përshëndetjet e mbretit të Greqisë, të renegatit Tito, të imperatorit të Japonisë, të mbretëreshës së Hollandës dhe të «personaliteteve» të tjera të kësaj kategorie të vendeve kapitaliste. Duke zbatuar me zell metodat antimarksiste dhe antisocialiste të izolimit të Shqipërisë, V. Ulbrihti arriti deri atje sa të mos ftojë as delegacion nga Partia dhe qeveria jonë për të marrë pjesë në festën e 12-vjetorit të themelimit të Republikës Demokratike Gjermane, në një kohë kur kishte ftuar edhe agjentin e regjrit të imperializmit amerikan, revizionistin me damkë, Titon, ta nderonte me pjesëmarrjen e delegacionit të tij. Ky qëndrim armiqësor dhe diskriminues i V. Ulbrihtit, që është në kundërshtim të hapët me ndjenjat e miqësisë vëllazërore që ushqen populli i Republikës Demokratike Gjermane dhe komunistët gjermanë për popullin shqiptar dhe që ka indinjuar thellë Partinë, qeverinë dhe masat punonjëse të vendit tonë, u shërben vetëm armiqve tanë të përbashkët të kampit të socializmit, imperialistëve dhe shërbëtorëve të tyre. Veprime të këtij lloji, që synojnë të mbjellin dyshime e armiqësi midis popujve vëllezër e aleatë, i ngarkojnë me përgjegjësi të rëndë N. Hrushovin dhe disa udhëheqës në vendet e tjera socialiste të Evropës.

Heshtja, izolimi politik si dhe falsifikimet e paturpshme që bëhen për të fshehur të vërtetën mbi politikën e urtë marksiste-leniniste që ndjek Partia e Punës e Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë ndaj Bashkimit Sovjetik dhe vendeve të tjera socialiste, tregojnë se N. Hrushovi dhe ata që e pasojnë kanë frikë t'u thonë popujve të tyre, partive të tyre, të vërtetën mbi Shqipërinë, të vërtetën mbi politikën dhe qëndrimet e Partisë së Punës të Shqipërisë. Kurse krejt ndryshe vepron udhë-

heqja e Partisë dhe qeverisë sonë. Vija e Partisë së Punës të Shqipërisë, siç u theksua edhe më parë, ka qenë dhe mbetet vija e miqësisë së pathyeshme me Bashkimin Sovjetik dhe me Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, vija e miqësisë dhe e lidhjeve vëllazërore me të gjitha vendet socialiste dhe partitë komuniste e punëtoresh të botës. Këtu nuk ka «farisej». Ju vetë e kuptoni se kjo është një shpifje e ulët, sepse është vështirë për cilindo që të edukojë popullin me dashuri e miqësi për një popull tjetër dhe në të njëjtën kohë të kërkojë ta bëjë armik me të. Provoni dhe ju të flisni e të shkruani për Shqipërinë. Ose shihni a shkruajnë e flasin për Bashkimin Sovjetik revizionistët jugosllavë, megjithëse do t'u interesonte atyre dhe vetë N. Hrushovit për t'i paraqitur revizionistët si miq të Bashkimit Sovjetik. Farisej janë N. Hrushovi dhe grupi i tij, të cilët qysh në kohën kur marrëdhënjet midis dy vendeve tona zhvilloheshin normalisht, qysh në kohën kur ata bënin deklaratat të bujshme për ndjenjat e miqësisë së singërtë ndaj popullit e Partisë shqiptare, kishin vendosur në ambasaden tonë në Moskë dhe për udhëheqësit shqiptarë survejimin me anë të aparateve të përgjimit. Partia jonë i flet hapur, me zë të lartë, me zemër të pastër popullit të vet, me anë fjalimesh, me anë të shtypit, me anë të radios dhe me mjetet e tjera të propagandës, për miqësinë me Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, për sukseset e Bashkimit Sovjetik, për miqësinë dhe për sukseset në vendet e tjera të kampit të socializmit, për jetën dhe veprimtarinë e partive dhe qeverive të vendeve socialiste. Dhe këtë punë, edukimin e masave të Partisë e të popullit me ndjenjat e dashurisë, të miqësisë e të vëllazërimit me Bashkimin Sovjetik, me popujt e vendeve socialiste, Partia jonë e konsideron si një nevojë dhe detyrë internacionaliste të dorës së parë, që shërben për forcimin e unitetit të kampit të socializmit, të sistemit botëror të socializmit, si një grusht kundër armiqve tanë të përbashkët të klasës, imperialistëve dhe shërbëtorëve të tyre, revizionistëve të çdo ngjyre. Këto ndjenja miqësie e dashurie për Partinë Komuniste dhe popullin sovjetik janë të singërtat e të pastra, të ngrohta e të përzemërta, të fuqishme e të përjetshme, prandaj nuk ka bllokadë heshtjeje apo izolim politik që të mundë t'i pengojë të arrijnë deri në zemrën dhe ndërjegjen e çdo komunisti apo qytetari të Bashkimit Sovjetik, sado të mundohen t'i shtrembërojnë ato 75 punonjësit e Ambasadës Sovjetike në Tiranë. (Sa për dijeni, lidhur me shpifjet se gjoja kohët e fundit Legata Italiane në Tiranë ka dyfishuar personelin e saj, ju njoftojmë se Legata Italiane në Tiranë është e përbërë vetëm nga 4 vetë personel diplomatik). Ka ardhur koha që nga ana e Partisë Komuniste dhe e Qeverisë Sovjetike të vihen para përgjegjësisë së rëndë punonjësit e Ambasadës Sovjetike në Tiranë, me ambasadorin në krye, për veprimtarinë e tyre që po minojnë një kauzë kaq të shtrenjtë për

Partinë dhe popullin tonë, për partinë dhe popullin sovjetik, siç është miqësia shqiptaro-sovjetike, miqësi popujsh e partish, e mbrojtur me gjak të përbashkët, me djersë të përbashkët, me gëzime e hidhërimi të përbashkëta, me ideale të përbashkëta.

Në letrën e 24 gushtit 1961, drejtuar Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, përmbahet «ankesa» se në shtypin shqiptar nuk u botua plotësisht projektprogrami i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe thuhet se gjoja «udhëheqësit shqiptarë përpiqen të fshehin nga anëtarët e Partisë së Punës të Shqipërisë dhe nga populli i tyre të vërtetën mbi këtë dokument shumë të rëndësishëm të kohës së sotme». Ky është një pretendim shumë i çuditshëm.

Dihet mirë prej të gjithëve se shtypi i Republikës Popullore të Shqipërisë shkruan vazhdimisht mbi jetën dhe sukseset e Bashkimit Sovjetik, përkrah hapat dhe propozimet e ndryshme të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik e të Qeverisë Sovjetike lidhur me çështjet e ndryshme ndërkombëtare. Kurse në shtypin sovjetik, në të kundërtën, prej muajsh të tërë nuk shkruhet asnjë fjalë jo më për Partinë e Punës të Shqipërisë, por as për Shqipërinë, sikur mbi tokë të mos ekzistonte fare as Republika Popullore e Shqipërisë dhe as populli shqiptar. Puna arriti bile deri atje sa jo që s'u botua plotësisht ose në përmbledhje të hollësishme në shtypin sovjetik Raporti i Kongresit IV të Partisë së Punës të Shqipërisë, por bile nga udhëheqësit sovjetikë u ndalua qarkullimi në Bashkimin Sovjetik i materialeve të Kongresit IV të Partisë sonë. Dhe pas të gjitha këtyre masave të pashembullta diskriminuese ndaj një partie komuniste motër dhe ndaj një vendi socialist, me ç'sy e faqe mund të dilet me pretendime të tilla ndaj Partisë së Punës të Shqipërisë? Me sa duket, N. Hrushovi dhe grupi i tij e kanë hedhur në shportë parimin e barazisë midis partive komuniste e punëtoresh dhe midis vendeve socialiste.

Por pavarësisht nga kjo si dhe nga fakti që në projektprogram përmbahen edhe një varg tezash oportuniste, shumë prej të cilave janë në kundërshtim flagrant me deklaratat e partive komuniste e punëtoresh të vjetëve 1957 dhe 1960, Partia e Punës e Shqipërisë botoi një faqe të tërë gazete nga projektprogrami i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik aq më tepër që ai është akoma një projekt.

Blokada e heshtjes që është ngritur kundër Shqipërisë nuk është pasive, por aktive. Ajo nuk kufizohet vetëm me urdhërin e dhënë që në shtyp e në radio të mos i përmendet as emri Partisë së Punës dhe Republikës Popullore të Shqipërisë. Përkundrazi, vetë iniciatori i vijës antishqiptare jep shembullin se si duhet kuptuar e konkretizuar izolimi politik kundër Shqipërisë. Në intervistën që N. Hrushovi i dha vëzhguesit të gazetës «Nju Jork Tajms», Sulzberger, botuar në «Pravda» me 10 shtator 1961, mi-

dis të tjerash theksohet: «Ju keni vendosur baza edhe në Greqi dhe prej andej kërcënimi aleaten tonë Bullgarinë». Mos vallë Greqia nuk kërcënon njëloj edhe Shqipërinë? A nuk është edhe Shqipëria njëloj aleate e Bashkimit Sovjetik, qoftë si pjesëtare e kampit të socializmit, qoftë si pjesëtare e Traktatit të Varshavës? Atëhere përse kjo heshtje? Përse ky dallim? A nuk del këtu edhe një herë në mënyrë shumë të qartë, pas deklaratës së bërë një vit më parë Venizellosit për çështjen e autonomisë së Vorio-Epirit, politika antimarksiste, antishqiptare e N. Hrushovit? Deklarata e sipërme publike e N. Hrushovit, ku jo pa qëllim injorohet Shqipëria, përbën një goditje të rëndë jo vetëm kundër interesave kombëtare rrënjësore të popullit shqiptar, por edhe kundër unitetit të kampit socialist. Ajo u shërben haptazi armiqve të Shqipërisë si një ndërsim kundër Republikës Popullore të Shqipërisë, i inkurajon ata në veprën e tyre të ndyrë për përmbysjen e pushtetit popullor në Shqipëri. Nuk është e rastit thirrja e radios «Spanja nacionale», e transmetuar kohët e fundit, ku ndër të tjera thuhet: «Ka ardhur koha që shqiptarët kudo që janë, brenda dhe jashtë atdheut, duhet të jenë gati për t'i dhënë grushtin e fundit klikës gjakatare të Tiranës».

Populli shqiptar, Partia dhe qeveria e tij janë thellësisht të indinjuar nga qëndrimi që mbajti shtypi sovjetik kundrejt komplotit të organizuar nga imperialistët amerikanë, monarko-fashistët grekë dhe revizionistët jugosllavë në bashkëpunim me disa tradhëtarë shqiptarë dhe që kishte për qëllim të përmbyste pushtetin popullor në Shqipëri. Heshtja e tij dhe, për më tepër, shpifjet pa skrupull se gjoja komploti ishte i trilluar e zemëruan pa masë popullin tonë, i cili në këtë rast kur e kërcënonte rreziku i likuidimit të fitores së tij më të shtrenjtë pushtetit të krijuar me gjakun e bijve të tij, rreziku i likuidimit të lirisë, të integritetit tokësor e të pavarësisë së vendit, priste me të drejtë përkrahjen e aleatit të tij më të madh për t'u treguar vendin armiqve të Republikës Popullore të Shqipërisë, sikurse ka vepruar gjithmonë Bashkimi Sovjetik, partia e tij e lavdishme në mbrojtje të interesave të atdheut tonë. Por N. Hrushovi me qëndrimin e tij ndaj komplotit të armiqve të pushtetit të popullit në Shqipëri bëri lodrën e tyre. Në këtë lodër u futën edhe disa nga udhëheqësit e disa vendeve socialiste të Evropës. Kështu, udhëheqësit hungarezë dhe bullgarë, J. Kadari dhe T. Zhivkovi, shkuan edhe më tej. Ata, siç del nga letrat që i kanë dërguar Komitetit Qendror të Partisë sonë, marrin haptazi nën mbrojtje agjentët e imperializmit, të cilët u dënuan dhe u pushkatuan pas gjyqit publik që u zhvillua në Tiranë. Për ne është krejt e pakuptueshme përse udhëheqësit hungarezë dhe bullgarë marrin mbi vete një përgjegjësi kaq të madhe jo vetëm përpara popullit tonë, por përpara vetë popujve të

tyre, përpara historisë së lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare.

Në letrën e 24 gushtit 1961 N. Hrushovi, duke ndërhyrë në mënyrë brutale në punët e brendshme të Partisë sonë, kërkon t'i dalë punës përpara edhe lidhur me elementët antiparti Liri Belishovën e Koço Tashkon (për çudi ai ka harruar të përmendë edhe Maqo Çomon), duke akuzuar Partinë tonë sikur ajo do të organizojë gjyqe simbas «metodave të Berias». Përse ai tregon kaq interesim për ata që janë dënuar si elementë antiparti nga Partia e Punës e Shqipërisë, kjo është punë e N. Hrushovit dhe koha do ta provojë qartë se ku është qëllimi. Por faktin që N. Hrushovi i lejon vetes të ndërhyjë kaq paturpësisht në punët e brendshme të Partisë sonë ne nuk mund ta lëmë në heshtje. Ne do t'i kujtojmë N. Hrushovit se kur në Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik u dënuan si grup antiparti V. Mollotovi, G. Malenkovi, L. Kaganoviçi e shumë të tjerë dhe kundër tyre u muarën masa disiplinore, Partisë së Punës të Shqipërisë as nuk i ka shkuar ndër mend t'i mbronte ata, sepse e konsideronte këtë thjesht si një çështje të brendshme të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, të cilën vetëm ajo është në gjendje dhe ka për detyrë ta zgjidhë.

Në letrën e 24 gushtit 1961 N. Hrushovi, duke marrë nën mbrojtje elementët antiparti dhe duke folur abuzivisht edhe në emër të partive motra, sipas logjikës së tij, thotë se ato paskan të drejtë «ta shikojnë persekutimin e shokëve Liri Belishova, Koço Tashko dhe të komunistëve të tjerë të ndershëm shqiptarë si një çështje që i përket gjithë lëvizjes komuniste ndërkombëtare».

Por ç'qëndrim u rekomandon ai të mbajnë partitë e tjera komuniste e punëtore ndaj njerëzve që u shpallën elementë antiparti në Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, siç janë V. Mollotovi, G. Malenkovi, L. Kaganoviçi e G. Zhukovi etj. kur pa pikë turpi ngre zërin e mbron të tillë elementë mizerabël si Liri Belishova e Koço Tashko, të cilëve në lëvizjen komuniste s'ua ka dëgjuar kush emrin? Po të ndjekim logjikën e N. Hrushovit edhe çështja e njerëzve të dënuar në Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik duhet konsideruar një çështje që i përket gjithë lëvizjes komuniste ndërkombëtare dhe, pra, si e tillë duhet parë. Këtu të çon metoda antimarksiste e ndërhyrjes në punët e brendshme të partive të tjera që përdor N. Hrushovi.

Në një kor, me të njëjtin ton, me të njëjtat kërcënime me N. Hrushovin e T. Zhivkovin, ngrenë zërin për mbrojtjen e elementëve antiparti të vendit tonë edhe revizionistët jugosllavë. Më 21 mars të këtij viti radio Beogradi njoftonte se gazeta «Borba» shkruante: «Në kongresin që u mbajt para do kohe (është fjala për Kongresin IV të Partisë së Punës të Shqipërisë) u radhitën në grupin e zakonshëm të armiqve: Liri Belishova e Koço Tashko.

E gjithë kjo imponon pyetjen: në se kjo politikë e re e likuidimit është hyrje në një proces të ri gjyqësor, në mënjanimin nga jeta publike dhe në terrorin e përgjithshëm?»

Në serinë e akuzave që drejtohen nga N. Hrushovi kundër Partisë së Punës të Shqipërisë dhe udhëheqësve të saj është edhe trillimi se gjoja në Shqipëri po vihen në përdorim «metodat e Berias». Është e tepërt të ndalemi gjatë në këtë çështje, sepse për çdo njeri me logjikë e të ndershëm, mbasi lexon me kujdes letrën e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik të 24 gushtit 1961 dhe njihet me shantazhet që përmban ajo, me shpifjet dhe akuzat e shumta të karakterit policor, del fare qartë se kush përdor në të vërtetë «metodat e Berias». Disa udhëheqës sovjetikë, me N. Hrushovin në krye, për të realizuar qëllimet e tyre, i kanë përvetësuar në mënyrë të shkëlqyer «metodat e Berias». Përdorimi i «metodave të Berias» dhe masat e shantazhet e ndryshme kundër Partisë së Punës të Shqipërisë pa pikë dyshimi nuk janë llogaritur vetëm për të gjuhëzuar Partinë tonë. Ato përbëjnë edhe një paralajmërim për cilindo që në të ardhshmen do të guxojë të mos kurdisë orën sipas akrepeve të N. Hrushovit, që do të guxojë të shfaqet kundër pikëpamjeve të tija antimarksiste. Kundër kujtdo mund të lëshohen epitetet e «agjentit të zbulimit të huaj», ose e «përkrahësit të metodave të Berias» ose edhe e «partizanit të kultit të personit». Në letrën e 24 gushtit 1961 thuhet gjithashtu se dikush në Shqipëri përpiqet të marrë nën mbrojtje Berian. Të merret ose të mos merret nën mbrojtje Beria, kjo nuk i përket Partisë së Punës të Shqipërisë. Për këtë arsye, në qoftë se ndokush kërkon të marrë Berian nën mbrojtje ai nuk duhet e nuk mund të kërkohet në Partinë tonë.

N. Hrushovi në letrën e 24 gushtit 1961 akuzon Partinë tonë se gjoja ajo po përhap në Shqipëri tendencat nacionaliste, se po i vë «interesat e saj të ngushta nacionale» mbi interesat e përgjithshme të kampit socialist e të lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare, se është larguar nga parimet e internacionalizmit socialist etj. Ç'kuptim i çuditshëm i internacionalizmit socialist! Në qoftë se Partia e Punës e Shqipërisë «guxoi» të ketë një mendim të ndryshëm nga ai i N. Hrushovit dhe këtë e shfaq hapur në mbledhje partie dhe jo sokaqeve e pas shpine, në qoftë se ajo nuk e lejoi N. Hrushovin të ndërhyjë në punët e brendshme të Partisë e të vendit tonë, duke u bërë ballë pa u përkulur presioneve e shantazheve të tij të shumta, në qoftë se ajo lufton me vendosmëri për mbrojtjen e interesave kombëtare të popullit shqiptar kundër veprimtarisë armiqësore jo vetëm të imperialistëve, por edhe të klikës tradhëtare revizioniste të Titos — kjo na qenka «nacionalizëm»! Detyrohemi të kujtojmë se në bisedën e tij me S. V. Tempon më 16 janar 1960 N. Hrushovi tha: «Jam thellësisht i bindur se Shqipëria, megjithëqë nuk është një vend i madh, ka

po aq të drejtë të shfaqë mendimin e saj për çdo çështje, si çdo vend i madh». Mos vallë pas disa muajsh, që në Mbledhjen e qershorit 1960 në Bukuresht, Partia e Punës e Shqipërisë e humbi të drejtën për të shprehur lirisht mendimin e saj? Si mund të përputhen me parimet e internacionalizmit proletar qëndrimet përbuzëse, masat poshtëruese diskriminuese, presionet, shantazhet e blokatat e shumanshme, të ushtruara nga N. Hrushovi dhe pasuesit e tij ndaj një partie motër, siç është Partia e Punës e Shqipërisë, ndaj një vendi socialist, siç është Republika Popullore e Shqipërisë dhe ndaj një populli që tërë energjitë dhe jetën e tij ja ka kushtuar çështjes së socializmit e të komunizmit, siç është populli i vogël shqiptar? Asgjë të përbashkët këto veprime nuk kanë as me marksizëm-leninizmin e as me internacionalizmin proletar. Ato dëshmojnë vetëm për një gjë, se N. Hrushovi dhe grupi i tij janë futur thellë në rrugën e shovinizmit dhe përpiqen t'u imponojnë partive komuniste e punëtore vullnetin e tyre antimarksist.

Duke dashur të «provojë» se gjoja Partia e Punës e Shqipërisë qëndron në pozita nacionaliste dhe e vë veten mbi partitë e tjera komuniste e punëtore (?!), N. Hrushovi në letrën e 24 gushtit i referohet thënjes së shokut Mehmet Shehu në Kongresin IV të Partisë së Punës të Shqipërisë, ku ai e quan Partinë tonë një brigadë sulmuese të lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Në letër thuhet: «Dihet se një shprehje të tillë e përdori për herë të parë J. V. Stalini ndaj Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe popullit sovjetik, kur BRSS akoma ishte vendi i vetëm socialist. Tani, kur ekziston sistemi botëror i socializmit, udhëheqësit shqiptarë vendosën ta përvetësojnë këtë përkufizim». Duket se N. Hrushovi e ka ndërjerë veten shumë ngushtë për «argumenta», saqë detyrohet të bëjë dhe një shtrembërim të tillë kaq të trashë. Për hir të së vërtetës u rekomandojmë autorëve të letrës së 24 gushtit të lexojnë edhe një herë fjalimin e J.V. Stalinit në Kongresin XIX të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, ku ai thotë:

«Pas marrjes së pushtetit nga partia jonë në vitin 1917 dhe pasi partia mori masa reale për likuidimin e shtypjes kapitaliste e çifligare, përfaqësuesit e partive motra, duke admiruar trimërinë dhe sukseset e partisë sonë, e quajtën atë «Brigadë Sulmuese» të lëvizjes revolucionare e punëtore botërore... Sigurisht, ishte shumë e vështirë ta kryejë këtë rol nderi derisa «Brigada Sulmuese» ishte një e vetme dhe ajo detyrohej ta luante këtë rol pararojë gati e vetmuar. Po kjo ishte dikur. Tani është krejt ndryshe. Tani, kur nga Kina e Korea deri te Çekoslovakia e Hungaria lindën «Brigada Sulmuese» të reja, që janë vendet e demokracisë popullore, tani partia jonë e ka më lehtë të luftojë...».

Del, pra, që akuza se gjoja Partia e Punës e Shqipërisë kërkon ta vëjë veten mbi partitë e tjera, s'është gjë tjetër, veçse një trillim qesharak.

Veprimet e N. Hrushovit për të hedhur baltë kundër Partisë së Punës të Shqipërisë, vijës së saj të drejtë, demaskohen edhe nga fakti se ku është mbështetur ai, ç'argumenta merr hua dhe nga kush. Ai i mbështet shpifjet e veta për të akuzuar udhëheqësit shqiptarë se po afrohen me Perëndimin mbi «argumenta» të tillë si fakti që fjalimi i mbajtur nga shoku Enver Hoxha në Mbledhjen e partive komuniste dhe punëtore në nëntor 1960 u ka rënë në dorë gazetave perëndimore (megjithëse po të dojë N. Hrushovi, në bazë edhe të eksperiencës së asaj që ndodhi me raportin e tij «sekret» në Kongresin XX të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, e gjen fare lehtë se ku fshihet provokatori që «kujdeset» t'i furnizojë qarqet reaksionare në Perëndim me materialet sekrete të lëvizjes komuniste) dhe mbi trillimet e fantazisë së kalemshinjeve të gazetës konservatore angleze «Dejli Telegraf». Po të kapemi pas «argumentave» të tillë, siç bën N. Hrushovi, do të shohim se për kursin politik të tij të zbutjes së luftës kundër imperializmit janë shkruar jo vetëm qindra artikuj, por edhe dhjetëra libra.

Në artikullin e gazetës konservatore angleze «Sandej Ekspres», transmetuar me 20 shtator 1959 nga agjencia e lajmeve AFP shkruhej: «Kush mund të thotë me siguri nëse vetë Hrushovi nuk është shpresa jonë e fundit? Në qoftë se ne nuk e pranojmë, a nuk do të mund t'ja zinte vendin atij një Stalin i panjohur?».

Agjencia «Junajted Press Internejshenell» më 8 dhjetor 1960 njoftonte për një propozim në parlamentin britanik: «Tridhjetë e tetë deputetë laburistë britanikë thanë sot se Britania duhet ta falenderojë zyrtarisht kryeministrin sovjetik, Nikita Hrushov, sepse ritheksoi «rëndësinë e bashkeksiztencës paqësore». Parlamentarët paraqitën një rezolutë në Dhomën e Komuneve, në të cilën thuhet se kryeministrin sovjetik duhet t'i dërgohet një mesazh». Një lajm nga Londra i agjencive AFP më 4 korrik 1957 thoshte: «Mendohet se përta i përket politikës ndërkombëtare duket se Kremli po bën një kthesë të jashtëzakonshme. Akuzat personale të bëra kundër Mollotovit tregojnë se Hrushovi dëshiron të ketë dorë të lirë për të ndjekur një politikë pajtimi kundrejt Perëndimit».

Ndërsa gazeta britanike «Tajms», në një koment rreth vizitës së N. Hrushovit në Francë, shkruante më 10 mars 1960: «Në të gjitha rastet në lidhje me Algjerinë, francezët nuk duhet të presin nga Hrushovi ndonjë gjë tjetër, përveç një asnjësie të heshtur dhe oportuniste».

Ne sollëm vetëm pak citate të marra nga shtypi perëndimor,

të cilit i referohen dhe autorët e letrës së 24 gushtit 1961. Askush nuk do t'u kushtonte kujdes këtyre deklaratave të reaksionit imperialist në qoftë se veprimtaria politike konkrete e N. Hrushovit do të ishte me të vërtetë revolucionare dhe konsekuente marksiste-leniniste. Por N. Hrushovi, në fakt, ka ndjekur dhe ndjek një politikë të jashtme që gëzon imperialistët. Përta i përket Partisë së Punës të Shqipërisë dhe udhëheqësve shqiptarë, ata për 20 vjet rresht kanë dëgjuar dhe dëgjojnë nga imperialistët dhe ideologët e tyre vetëm shpifje, sharje dhe akuza. Dhe kjo shpjegohet se nga ne as kanë dëgjuar, as do të dëgjojnë asnjë lajkë apo përkëdhelje, asnjë lëshim, sepse politika e Partisë sonë ka qenë dhe mbetet një politikë konsekuente marksiste-leniniste, politikë e luftës së papajtueshme kundër imperializmit dhe oportunitizmit. Asnjë shpifje në çdo drejtim dhe ngado që ajo të vijë nuk do të ketë sukses.

Duhet shënuar, për të nxjerrë në shesh akoma më mirë falsitetin e akuzës që i bëhet Partisë së Punës të Shqipërisë, se deri me 24 gusht 1961 Partia e Punës e Shqipërisë akuzohet nga N. Hrushovi për një politikë të çmendur, «aventureske», «kundër bashkekzistencës paqësore» etj. ndërsa tani akuzohet për «afirim me imperializmin», dhe se gjoja nuk dënon vendosjen e bazave të raketave në Itali dhe veprimet e imperializmit francez, etj. Ne e kuptojmë shumë mirë përta N. Hrushovi ishte i detyruar që në akuzat e shpifjet e tija të bëjë të tilla kapërcime nga njëri ekstrem në tjetrin, të cilave zor se do t'u besonte çdo njeri i arësyeshem.

Historia dhe koha janë të pamëshirshme. Sot për arësye të ndryshme ndokush mund ta ndjekë N. Hrushovin, por nesër do të shohin se Partia e Punës e Shqipërisë kishte të drejtë, se ajo mbronte një çështje të drejtë. Sot mund të gjenden shumë pak njerëz nga më besnikët e N. Hrushovit që të besojnë se udhëheqësit shqiptarë dhe Partia e Punës e Shqipërisë i shërbejnë imperializmit, ashtu siç u gjenden të tillë që me naivitet i besuan N. Hrushovit se klika e Titos nuk është armike e socializmit, nuk është agjente e imperializmit. Por do të kalojë pak kohë dhe jeta do ta tregojë çdo ditë më qartë se Partia e Punës e Shqipërisë dhe udhëheqësit shqiptarë i qëndrojnë besnikë marksizëm-leninizmit dhe çështjes së komunizmit, janë luftëtarë të sprovuar kundër imperializmit, fashizmit dhe revizionizmit. Jeta do ta tregojë këtë, ashtu siç tregoi se klika e Titos, të cilën e mbron N. Hrushovi, ishte me të vërtetë agjente e imperializmit, «kalë i Trojës» në lëvizjen komuniste e punëtore ndërkombëtare, komplotiste kundër kampit socialist dhe minuese e lëvizjes nacional-çlirimtare. N. Hrushovi pati deklaruar se edhe «Ajzenhaueri është luftëtar për paqen» dhe u gjenden trumbetierë që e besuan, por koha shumë shpejt tregoi se Ajzenhaueri, si gjithë udhë-

heqësit e tjerë të imperializmit, ishte aq luftënxitës dhe aq armik i betuar i socializmit si edhe Dallesi, etj. N. Hrushovi në Mbledhjen e Bukureshtit pati deklaruar se Republika Popullore e Kinës është luftënxitëse dhe kundër bashkekzistencës paqësore dhe u gjendën njerëz që e duartrokitën këtë deklaratë antimarksisiste, por nuk kaloi shumë kohë dhe gjithë bota po e sheh se N. Hrushovi nuk kishte të drejtë, se ai shpifte. Bile tani edhe vetë N. Hrushovi përpiqet ta paraqesë çështjen se në Bukuresht nuk ndodhi asgjë, se atje nuk është thënë asgjë e tillë.

Është interesant dhe kuptimplotë fakti që pëmbajtja e letrës së 24 gushtit 1961 dhe në përgjithësi akuzat shpifëse të N. Hrushovit qysh nga Mbledhja e Bukureshtit e këtej ngajnë si dy pika uji qoftë nga forma, qoftë nga metodat e përdorura, qoftë nga brendia, qoftë nga qëllimet që i ka vënë vetes autori i tyre, me akuzat shpifëse që kanë bërë e vazhdojnë të bëjnë revizionistët jugosllavë kundër Partisë sonë, qeverisë dhe popullit shqiptar.

N. Hrushovi e akuzon udhëheqjen e Partisë sonë se ajo paska «ndërmarrë një fushatë antisovjetike» dhe kjo fushatë, sipas N. Hrushovit, u zhvillua në Shqipëri nga «dikush» që qenka «komprometuar nga lidhjet me zbulimet e shteteve të huaja».

Për t'i qëndruar besnike historisë, duhet thënë se këto shpifje tendencioze armiqësore në adresë të udhëheqjes së Partisë sonë ne nuk i dëgjojmë për herë të parë. Këtë shpifje identike kundër Partisë sonë e ka bërë edhe J.B. Titua në nëntorin e vitit 1947, kur pa se hasi në kundërshtimin e vendosur të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe nuk mundi të realizonte planet e tij djallëzore për likuidimin e udhëheqjes së Partisë, për skllavërimin e vendit tonë, për ta kthyer atë në një republikë të shtatë të Jugosllavisë, sikurse e vërtetojnë dokumentat zyrtarë që disponon Partia jonë. Në letrën dërguar Komitetit Qendror të Partisë sonë të Punës (atëherë Partia Komuniste Shqiptare), në nëntorin e 1947-s, revizionisti Tito ndër të tjera akuzonte me emër shokun Nako Spiru, në atë kohë anëtar i Byrosë Politike të Komitetit Qendror të Partisë, si «bashkëpunëtor me armikun» dhe tërhiqte vëmendjen e gjithë Byrosë Politike se në këtë «fushë antijugosllave» të udhëheqjes shqiptare «ka gisht armiku». Se cili ishte qëllimi i kësaj akuze shpifarake të Titos e vërtetoi koha, e vërtetoi tradhëtia e grupit të tij. Se cili qe rezultati i kësaj shpifjeje gjithashtu dihet: Partia e Punës e Shqipërisë as nuk u përku, as nuk u gjunjëzua, ndërsa armiqtë revizionistë dështuan njëri pas tjetrit. Por për shokun Nako Spiru akuza shpifëse qe fatale, sepse ai, njeri me nerva të dobëta, duke mos i bërë dot ballë shpifjes, vrau veten.

Sot që Partia jonë ndodhet përpara të njëjtës akuzë shpifëse prapë mund të deklarojmë, kësaj radhe akoma më me siguri e vendosmëri, se edhe shpifja e N. Hrushovit do të dështojë me

turp. Partia jonë, pjellë e denjë e popullit të saj, nuk e ka zakon as të gjunjëzohet, as të trembet përpara kërcënimeve. «Dikushet» e fabrikua nga fantazia e N. Hrushovit për të frikësuar, përçarë e likuiduar udhëheqjen e Partisë sonë nuk ekzistojnë në Partinë tonë. «Kuajt e Trojës» nuk kanë grazhd në Partinë tonë. Pra, më kot e ka edhe N. Hrushovi, ashtu si Titua, që përpiqet të gjejë ndonjë të çarë në radhët e Partisë sonë, të gjejë ndonjë «dikush» me nerva të dobëta sa të vrasë veten.

Por nuk është vetëm ky fakt që tregon ngjashmërinë e plotë të akuzave të autorëve të letrës së 24 gushtit 1961 kundër Partisë sonë dhe udhëheqësve të saj me akuzat e shpifjet e J.B. Titos. Për ta vërtetuar këtë le të ballafaqojmë qoftë dhe vetëm disa prej akuzave që përmbahen në letrën e 24 gushtit 1961 me akuzat që janë bërë prej kohësh kundër Partisë sonë nga ana e revizionistëve jugosllavë.

1. — Titua na akuzonte se «Në Shqipëri po kristalizohet një vijë e dytë, antijugosllave, një front antijugosllav dhe kundër kampit». (Letër e KQ të PKJ drejtuar KQ të PKSH, qershor 1947).

Edhe Hrushovi, duke i mbajtur iso, na akuzon për një «vijë antisovjetike», për «frymë armiqësore kundër Bashkimit Sovjetik», «kundër kampit të socializmit». (Letra e 24 gushtit 1961).

2. — Titua na akuzonte se «politika e qeverisë shqiptare është diametralisht në kundërshtim me aspiratat dhe qëndrimin e popullit shqiptar». (Letra e J. B. Titos drejtuar KQ të PKSH, nëntor 1947).

Edhe Hrushovi na akuzon se «e gjithë veprimtaria e udhëheqësve shqiptarë... drejtohet kundër interesave rrënjësore të popullit shqiptar». (Letra e 24 gushtit 1961).

3. — Titua na akuzon, se «prej vjetësh në Shqipëri punohet në mënyrë të planifikuar për mbjelljen e ndjenjave armiqësore dhe të urrejtjes kundërshtim Jugosllavisë». (Libri i bardhë jugosllav, botim i vitit 1961).

Edhe Hrushovi thotë se «udhëheqësit e PPSH mbjellin në punonjësit mosbesim dhe armiqësi ndaj Bashkimit Sovjetik», se «udhëheqja shqiptare, me paramendim hap pas hapi, e ka çuar punën drejt minimimit të vetë bazave të miqësisë shqiptaro-sovjetike». (Letra e 24 gushtit 1961).

4. — Titua na akuzon se «në kuadrin e politikës armiqësore që ndjek Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë kundrejt Jugosllavisë, autoritetet shqiptare... kanë bërë të pamundur që nëpunësit e përfaqësimit jugosllave të kryejnë normalisht detyrat e tyre dhe i kanë detyruar këta që të jetojnë në kushte shumë të rënda e të padurueshme, në kundërshtim me normat elementare të së drejtës ndërkombëtare». (Libri i bardhë jugosllav, botim i vitit 1961).

Edhe Hrushovi na akuzon se «kursi që ka marrë udhëheqja shqiptare për acarimin e marrëdhënjeve me Bashkimin Sovjetik po shfaqet në një masë gjithnjë më të madhe edhe në krijimin e kushteve të padurueshme për veprimtari normale të ambasadorit sovjetik... duke marrë nëpër

këmbë normat elementare të së drejtës ndërkombëtare». (Letra e 24 gushtit 1961).

5. — Titua na akuzonte se «në të katër anët e vendit mbahet një qëndrim armiqësor ndaj njerëzve jugosllavë». (Letra e J. B. Titos, nëntor 1947).

Edhe Hrushovi na akuzon se «në Shqipëri mbahet një qëndrim armiqësor ndaj njerëzve sovjetikë». (Letra e 24 gushtit 1961).

6. — Titua na akuzon se «një varg shembujsh tregojnë se udhëheqja e Enverit e solli Shqipërinë në një situatë me të vërtetë të pamundshme edhe në planin ndërkombëtar, duke e izoluar bile edhe nga vendet e tjera socialiste, nga vendet e kampit». (Radio Beogradi, 16 maj 1961).

Edhe Hrushovi na akuzon se «tani Shqipëria ndodhet në një gjendje të vështirë përsa i përket politikës së jashtme», se «udhëheqësit shqiptarë ndjekin një politikë të jashtme të veçantë nga vendet e tjera të Traktatit të Varshavës», «politikën e vetizolimit nga vendet e tjera socialiste». (Letra e 24 gushtit 1961).

7. — Titua na akuzon se «udhëheqësit shqiptarë me politikën e tyre i ofrojnë popullit poteren e përditshme historike mbi rrezikun e luftës, helmatisin marrëdhënjet në Ballkan, duke përfaqësuar një nga pengesat kryesore për të gjitha përpjekjet që bëhen për forcimin e paqes në këtë zonë dhe bëjnë të pamundur bashkëpunimin ndërbalkanik». (Libri i bardhë jugosllav, botim i vitit 1961).

Edhe Hrushovi na akuzon se «udhëheqësit shqiptarë... fryjnë historinë e luftës brenda vendit, ndër marrin ndaj shteteve fqinje veprime, të cilat nuk mund të mos sjellin acarimin e gjendjes në Ballkan», se «Qeveria Shqiptare nuk përkrah propozimet... për bashkëpunimin ndërbalkanik». (Letra e 24 gushtit 1961).

8. — Titua na akuzonte se «udhëheqësit shqiptarë po orientojnë vendin nga Italia dhe Franca si në lëmin tregëtar, ashtu dhe në atë kultural». (Letra e J. B. Titos, nëntor 1947).

Edhe Hrushovi na akuzon se «udhëheqësit shqiptarë kanë filluar... t'u japin të kuptojnë fuqive imperialiste se ata nuk do të ishin kundër të përfitojnë nga «ndihma» e tyre. Vallë a nuk flasin për këtë disa përcapje politike të Qeverisë Shqiptare kundrejt Italisë dhe Francës?» (Letra e 24 gushtit 1961).

9. — Titistët na akuzonin se udhëheqja e Partisë sonë «pushtimin e vendit nga Italia fashiste e ka konsideruar si një faktor pozitiv për industrializimin e vendit, për zhvillimin e proletariatit në Shqipëri, për formimin e partisë». (Dushan Mugosha, intervistë dhënë radio Beogradit, 19 prill 1961).

Edhe Hrushovi na akuzon se «dikush në udhëheqjen e Partisë së Punës të Shqipërisë ka filluar të përhapë fjalë se Italia fashiste, në periudhën e pushtimit nuk i ka bërë asgjë të keqe Shqipërisë dhe bile i ka dhënë asaj një ndihmë të konsiderueshme për ngritjen e ekonomisë dhe të kulturës». (Letra e 24 gushtit 1961).

10. — Titistët na akuzojnë se «në Partinë e Punës të Shqipërisë është krijuar një gjendje e rrezikshme, ku është shkelur demokracia dhe disku-

timi i lirë», se «Enver Hoxha dhe Mehmet Shehu likuidojnë çdo ditë fizikisht dhe politikisht kuadrot më të shquar revolucionarë», se «shumë njerëz po kalben nëpër burgje duke pritur vendimin e Enverit dhe të Mehmetit si qengji thikën». (Dushan Mugosha, intervistë dhënë gazetës jugosllave «Dello», gusht 1961).

Edhe Hrushovi akuzon se «në Partinë e Punës të Shqipërisë është krijuar një gjendje krejt e sëmurë, e cila është rezultat i kursit politik të shtrembër të udhëheqjes së sotme», se «në parti është ndaluar shprehja e lirë e mendimeve», se «çdo njeri që guxon të flasë për ruajtjen dhe zhvillimin e marrëdhënjeve me të vërtetë miqësore me Bashkimin Sovjetik u nënshtrohet presioneve dhe persekutimeve të egra». (Letra e 24 gushtit 1961).

11. — Titua na akuzon se Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë «në përbërjen e tij ka lidhje farefisi dhe familjariteti, të cilat kanë mbytur demokracinë dhe shfaqjen e lirë të mendimeve». (Radio Beogradi, 23 mars 1961).

Edhe Hrushovi na akuzon se udhëheqja e Partisë së Punës të Shqipërisë «përbën një grup të ngushtë personash me lidhje farefisi që ka zaptuar në duart e tija gjithë postet komanduese në parti e në shtet», se «ka familjaritet», «kult të individit», të cilat kanë bërë «të pamundur zhvillimin e demokracisë në parti». (Letra e 24 gushtit 1961).

12. — Titua, duke marrë nën mbrojtje armiq të Partisë e të popullit shqiptar, duke strehuar e organizuar edhe kriminelët shqiptarë të arratisur, duke marrë pjesë në komplotet kundër Shqipërisë, bashkë me imperialistët amerikanë dhe monarko-fashistët grekë, me anë të shtypit dhe të radios, me anë fjalimesh, ndërhyr brutalisht në punët e brendshme të Shqipërisë dhe bën thirrje haptazi për kryengritje për likuidimin e Partisë e të qeverisë së popullit shqiptar.

Edhe Hrushovi, duke marrë nën mbrojtje elementët armiq të Partisë, bën gjithashtu thirrje për likuidimin e udhëheqjes së Partisë e të qeverisë së popullit shqiptar. Kjo del e qartë nga letra e 24 gushtit 1961, ku thuhet: «Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe Qeveria Sovjetike janë të bindur se komunistët shqiptarë, popullit shqiptar do ta kthejnë vendin e tyre në rrugën e miqësisë dhe të bashkëpunimit me Bashkimin Sovjetik dhe vendet e tjera socialiste».

13. — Titua na akuzon se «Enver Hoxha po vazhdon taktikën e forcimit të pozitës së tij personale dhe të krijimit me dhunë të kultit të vet të individit». (Radio Beogradi, shkurt 1961).

Edhe Hrushovi na akuzon se «në udhëheqjen e Partisë së Punës të Shqipërisë mori një përhapje të gjerë kulti i individit, çka influencoi në mënyrë negative në gjithë punën ideologjike dhe organizative të Partisë», se «zvarrisja e mëtejshme në pozitat e kultit të individit filloi në mënyrë veçanërisht intensive në PPSH qysh nga mesi i vitit 1960», se «udhëheqja shqiptare është për ruajtjen e kultit të individit». (Letra e 24 gushtit 1961).

14. — Titua na akuzon se «në udhëheqjen e Shqipërisë ekziston një tendencë e theksuar e nacionalizmit dhe këtë ajo e përdor me të gjitha format kundër Jugosllavisë». (Radio Beogradi, mars 1961).

Edhe Hrushovi, duke kopjuar Titon, na akuzon se udhëheqja shqiptare «që përpiqet të mbrojë shfaqjet e ngushtësisë nacionale është patjetër e detyruar t'i marrë hua argumentat e saj nga arsenali i revizionistëve». (Letra e 24 gushtit 1961).

Pas gjithë këtyre ballafaqimeve Tito — Hrushov e gjejmë pa vend të provojmë se kush merr hua nga arsenali i revizionistëve. Analogjia në shpifjet dhe akuzat midis Titos dhe Hrushovit është fare e qartë dhe e plotë.

Jeta dhe veprimtaria revolucionare e Partisë së Punës të Shqipërisë që përshkohet fund e krye nga qëndrimet e vendosura miqësore dhe nga besnikëria e patundur ndaj Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, ndaj kauzës sonë të përbashkët, ndërtime të socializmit e të komunizmit, hedh poshtë shpifjet e letrës së 24 gushtit, ku thuhet sikur gjoja udhëheqësit shqiptarë, duke radhitur faktet e shumta të presioneve hakmarrëse, që janë bërë kundër Partisë dhe popullit shqiptar qysh nga Mbledhja e Bukureshtit, kanë për qëllim të çënojnë prestigjin e Bashkimit Sovjetik. Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë kurdoherë ka qenë dhe është i mendimit se duhet ruajtur dhe mbrojtur prestigji i Bashkimit të lavdishëm Sovjetik, prestigji, të cilin ai e ka fituar me luftë e me punë jo vetëm në të mirën e popujve sovjetikë, por edhe të gjithë popujve të tjerë, në të mirën e popullit tonë, të gjithë lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare. Këtë prestigj e kemi për detyrë ta ruajmë si sytë e ballit që të gjithë, por në radhë të parë atë duhet ta ruajë vetë udhëheqja e Bashkimit Sovjetik. Dhe bashkë me prestigjin e Bashkimit Sovjetik, njëkohësisht duhet ruajtur edhe prestigji i të gjitha partive komuniste e punëtore motra. Kjo është rruga e drejtë marksiste. Kurse në realitet nuk ndodh gjithmonë kështu. Disa udhëheqës sovjetikë, me N. Hrushovin në krye, mendojnë se për ata është e lejueshme të shkelin me këmbë prestigjin e partive të tjera. Ata, kur ne i kritikojmë në rrugë partie dhe u bëjmë thirrje të heqin dorë nga veprimtaria antimarksiste, antisocialiste dhe antishqiptare që zhvillojnë kundër vendit tonë, mendojnë se paskan të drejtë të bëjnë njëmijë e një padrejtësira kundër Partisë sonë, ta përbuzin atë, të ulin prestigjin e saj, t'i ngjisin gjithfarëloj epitetesh, të cilat i përdorin kundër Partisë e popullit tonë vetëm imperialistët dhe revizionistët. Një logjikë e tillë nuk ka asgjë të përbashkët me marksizmin.

Është i çuditshëm edhe një argument tjetër që përmbahet në letrën e 24 gushtit 1961, ku akuzohet udhëheqja e Partisë sonë se gjoja paska për qëllim t'ja kundërvejë Komitetin Qendror dhe Qeverinë Sovjetike gjithë partisë dhe popullit sovjetik. Dihet se N. Hrushovi dhe disa udhëheqës sovjetikë janë autorët e veprimeve të shumta antisocialiste e antishqiptare, se ata janë inicia-

torët dhe frymëzuesit e represioneve kundër vendit tonë, se fuqatën për bllokadën ekonomike, politike apo ushtarake kundër Partisë së Punës të Shqipërisë e Republikës Popullore të Shqipërisë e filloi N. Hrushovi, se ai personalisht filloi sulmin kundër Partisë sonë në Bukuresht dhe në Mbledhjen e Moskës të nëntorit 1960, se ai ka deklaruar «që do ta trajtojë Shqipërinë si Jugosllavinë», se ai në mbledhjen e Komitetit Konsultativ Politik të Traktatit të Varshavës në mars të këtij viti kërkoi likuidimin e bazës ushtarake-detare të Vlorës etj. etj. Partia jonë ka plotësisht të drejtë ta kritikojë N. Hrushovin në rrugë partie dhe simbas rregullave leniniste dhe kjo nuk do të thotë aspak se qëllimi i saj është t'ua kundërvejë N. Hrushovin dhe Komitetin Qendror Partisë Komuniste dhe popullit sovjetik. Ndahet apo nuk ndahet N. Hrushovi nga partia e populli i tij kjo nuk është puna e Partisë sonë, kjo është çështje e brendshme e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe e popullit sovjetik. Për një gjë të tillë ne nuk u jemi drejtuar as kemi ndër mend t'u drejtohem as masave të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, as masave të popullit sovjetik. Teza që mbrohet në letrën e 24 gushtit 1961 lidhur me këtë çështje është e çuditshme edhe nga një pikëpamje tjetër. Kur N. Hrushovi kritikoi J.V. Stalinin, i cili kishte udhëhequr Partinë dhe shtetin sovjetik për afro 30 vjet me radhë që pas vdekjes së Leninit, vetë ai e ndau J. Stalinin nga Komiteti Qendror, nga partia, nga populli sovjetik dhe deklaroi se gabimet e tij nuk kishin prekur vijën e përgjithshme të partisë etj. etj. Është e ligjshme pyetja: Përse në rastin e Stalinin kritika kundër tij nuk përbënte sulme kundër Partisë Komuniste, kundër Bashkimit Sovjetik apo popullit sovjetik, nuk ishte baltë e hedhur kundër prestigjit të Bashkimit Sovjetik, ndërsa kritika jonë parimore dhe e faktuar kundër N. Hrushovit qenka sulm kundër Partisë Komuniste dhe popullit sovjetik?

Duke dërguar këtë përgjigje për letrën e 24 gushtit 1961 që Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik i drejtoi Komitetit Qendror të Partisë sonë, Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë ka për qëllim të hedhë dritë mbi zhvillimin e marrëdhënjeve shqiptaro-sovjetike dhe të marrëdhënjeve midis Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe Partisë së Punës të Shqipërisë, mbi shkaqet e vërteta të acarimit të tyre dhe shkaktarët e tij, në mënyrë që të gjendet rruga e drejtë për normalizimin e marrëdhënjeve tona, për rivendosjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të frymës internacionaliste, të bashkëpunimit vëllazëror e të respektit reciprok, që ka karakterizuar kurdoherë marrëdhënjet midis Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe Partisë së Punës të Shqipërisë deri para

Mbledhjes së Bukureshtit. Partia e Punës e Shqipërisë ka bërë edhe më parë shumë përpjekje në këtë drejtim.

Por ne detyrohemi të konstatojmë me keqardhje se qëllimet e mira të Partisë së Punës të Shqipërisë nuk kanë gjetur mirëkuptim dhe janë hedhur poshtë në mënyrë brutale nga disa udhëheqës sovjetikë me N. Hrushovin në krye, të cilët, duke shkelur pa drojtje të gjitha rregullat e parimet marksiste-leniniste të marrëdhënjëve midis partive komuniste e punëtove motra, kanë çuar hap pas hapi dhe me metodat më të palejueshme drejt acarimit të vazhdueshëm të marrëdhënjëve tona. Nuk është vështirë të kuptohet se rruga e zgjedhur nga N. Hrushovi për të luftuar kundër Partisë së Punës të Shqipërisë, rruga e shtrirjes së mosmarrëveshjeve ideologjike në fushën e marrëdhënjëve shtetërore, rruga e presioneve ekonomike, politike e ushtarake, e bllokadave ekonomike e të heshjtjes, rruga e zhvendosjes së problemit nga terreni i partisë, nga terreni i mosmarrëveshjeve tona ideologjike e politike në terrenin e diskutimit të Partisë së Punës të Shqipërisë e të udhëheqësve të saj me anë shpifjesh e akuzash policore — është një rrugë thellësisht e gabuar. Ajo dëshmon të paktën për dy gjëra:

Së pari, se pasi dështuan plotësisht në orvatjet e tyre për të gjunjzuar Partinë tonë dhe për t'i imponuar asaj me forcë pikëpamjet e tyre antimarksiste, N. Hrushovi dhe grupi i tij janë vënë në rrugën e rrezikshme të veprimtarisë së hapur armiqësore kundër Partisë së Punës të Shqipërisë dhe popullit shqiptar. Qëllimi i tyre është të përmbysin me çdo mjet udhëheqjen e Partisë së Punës të Shqipërisë. Këtë e tregon më së miri edhe fakti që ata mbështesin e përkrahin elementët antiparti në Shqipëri, u bëjnë thirrje atyre që të ngrihen kundër Partisë së Punës të Shqipërisë dhe udhëheqësve të saj, gjë që shihet qartë edhe në letrën e 24 gushtit 1961. Detyrohemi të vëmë në dukje se nuk është hera e parë që orvatje të tilla kundër Partisë sonë kanë dështuar me turp. Do të dështojnë gjithashtu me turp edhe orvatjet e N. Hrushovit për të ngjallur dyshime për udhëheqësit e Partisë sonë shokët Enver Hoxha, Mehmet Shehu etj. të cilët gjatë 20 vjetëve jetë të Partisë sonë, në luftë e në zjarr, në punën ndërtimore, në luftë kundër armiqve imperialistë e revizionistë, kundër armiqve të Partisë e të popullit tonë, kanë udhëhequr me uredësi e guxim Partinë tonë nga fitorja në fitore. Qenja e tyre në krye të Partisë sonë qysh nga themelimi i saj nuk ka ardhur si rezultat i ndonjë kombinacioni të rastit, por si rezultat i luftës konsekuente, i besnikërisë, i aftësive dhe devocionit të tyre të sprovuar për çështjen e komunizmit, për çështjen e popullit, për çështjen e internacionalizmit proletar. Prandaj, Partia jonë i ka mbrojtur e do t'i mbrojë me vendosmëri udhëheqësit e saj nga çdo sulm e shpifje, ngado që të vijë ato.

Së dyti, futja në një rrugë të tillë dëshmon gjithashtu se

N. Hrushovi dhe pasuesit e tij e ndjejnë veten ngushtë për shkak të pikëpamjeve të tyre të shtrembëra dhe të veprimeve të tyre të palejueshme antikomuniste ndaj Partisë së Punës të Shqipërisë dhe vendit tonë, pikëpamje e veprime që nuk kanë asgjë të përbashkët me marksizëm-leninizmin dhe me parimet e internacionalizmit proletar, prandaj i shmangen me të gjitha mënyrat diskutimit të problemit të marrëdhënjëve tona mbi një bazë parimore ideologjike. I madhi Lenin na mëson se e vetmja politikë e drejtë është politika parimore, se i vetmi qëndrim i drejtë është ai që bazohet në parimet. Vetëm ai që ka shkarë nga parimet, që i ka shkelur brutalisht ato, i trembet diskutimit të hapur e të ndershëm parimor, i bën bisht atij me të gjitha mënyrat e metodat.

Duke qenë thellësisht e preokupuar për gjendjen e padëshirueshme e shumë të rëndë të marrëdhënjëve shqiptaro-sovjetike në kohën e sotme, që e ka burimin në veprimet brutale antimarksiste të N. Hrushovit e të grupit të tij, Partia e Punës e Shqipërisë i bën thirrje Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik që të shikojë me gjakftohtësi gjendjen e krijuar dhe të marrë masat e nevojshme për normalizimin e saj. Duhet të rivendosen sa më parë, si kusht i domosdoshëm, parimet leniniste që rregullojnë marrëdhënjet midis partive motra, parime, të cilat janë shpallur edhe në Deklaratat e Moskës të vjetëve 1957 e 1960, por që janë marrë e po mirren nëpër këmbë nga disa udhëheqës sovjetikë dhe po zëvendësohen me parime e metoda që nuk kanë asgjë të përbashkët me leninizmin. Autorët e letrës së 24 gushtit 1961 «ankohen» se gjoja udhëheqësit shqiptarë kanë sabotuar çdo përpjekje të udhëheqësve sovjetikë për t'i zgjidhur mosmarrëveshjet tona me anë të bisedimeve, por një afirmim i tillë nuk i përgjigjet së vërtetës. E si mund të flitet për dëshirë të udhëheqësve sovjetikë për të zgjidhur mosmarrëveshjet, kur ata nuk krijojnë as kushtet e nevojshme më minimale të barazisë për këto bisedime, kur ata qysh më parë e kanë vendosur se udhëheqësit shqiptarë janë «agjentë të zbulimeve të huaja» dhe «pregatitin terrenin për t'u afruar me ata që janë kundër përfundimit të Traktatit të Paqes me Gjermaninë» etj etj.? Në këto kondita dhe mbasi është vendosur bllokada e plotë ekonomike, politike e ushtarake ndaj Republikës Popullore të Shqipërisë ç'mund të kuptohet me fjalën «përpjekje për bisedime»? Natyrisht, duke shfrytëzuar autoritetin e madh, forcën dhe mundësitë e padiskutueshme të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, N. Hrushovi dhe ata që e përkrahin mund të arrijnë, për një farë kohe të izolojnë Partinë e Punës të Shqipërisë, mund të ngjallin dyshime e mund të krijojnë përkohësisht rreth saj një mjegull shpifjesh e intrigash të shumëllojshme, por me këtë problem themelor nuk do të zgjidhet. Mosmarrëveshjet tona, mosmarrëveshjet në gjirin e lëvizjes komuniste në këto kushte do të ekzistojnë, bile ato do të thellohen

edhe më shumë, duke gëzuar vetëm armiqtë e komunizmit. Prandaj Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë është i mendimit se për shërimin e kësaj sëmundjeje të rrezikshme që ekziston duhet ndërhyrja urgjente dhe e guximshme e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik...

Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë sonë mendon se shqyrtimi i kujdesshëm i marrëdhënjeve të krijuara midis dy partive tona, shqyrtimi i kujdesshëm i gjithë korrespondencës së shkëmbyer midis dy partive tona nga ana e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, do të hedhë dritë akoma më qartë se në ç'rrugë të gabuar ka hyrë udhëheqja sovjetike, me N. Hrushovin në krye, në marrëdhënjet me Partinë e Punës së Shqipërisë. Ne jemi të bindur se Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik në qoftë se do t'i shikojë çështjet me gjakftohtësi dhe objektivitet, pa u influencuar nga pasionet, do të arrijë në konkluzionin se Partia e Punës e Shqipërisë dhe udhëheqësit shqiptarë janë në rrugë të drejtë dhe luftojnë për forcimin efektiv të unitetit të lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare mbi bazën e marksizëm-leninizmit e të internacionalizmit proletar, për forcimin e unitetit të kampit socialist me Bashkimin Sovjetik në krye, për forcimin e miqësisë shqiptaro-sovjetike.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror të
Partisë*

DEKLARATË

E KOMITETIT QENDROR TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË KUNDËR SULMIT DHE SHPIFJEVE TË N. HRUSHOVIT NË KONGRESIN XXII TË PK TË BS

20 tetor 1961

Në Kongresin XXII të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, N. Hrushovi sulmoi botërisht Partinë e Punës të Shqipërisë. Shpifjet dhe sulmet antimarksiste të N. Hrushovit u shërbejnë vetëm armiqtë të komunizmit dhe të Republikës Popullore të Shqipërisë, imperialistëve të ndryshëm dhe revizionistëve jugosllavë. N. Hrushovi, duke nxjerrë në shesh përpara armiqtë mosmarrëveshjet që ekzistojnë prej kohësh midis udhëheqjes së Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe Partisë së Punës të Shqipërisë, shkeli brutalisht Deklaratën e Moskës të vitit 1960, në të cilën theksohet se mosmarrëveshjet që lindin midis partive motra duhet të zgjidhen me durim, në frymën e internacionalizmit proletar dhe mbi bazën e parimeve të barazisë e të konsultimeve. Duke sulmuar botërisht Partinë e Punës të Shqipërisë, N. Hrushovi efektivisht filloi sulmin e hapur kundër unitetit të lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare, kundër unitetit të kampit socialist. Për këtë akt antimarksist dhe për të gjitha pasojat që rrjedhin prej tij, N. Hrushovi mban përgjegjësi të plotë.

Partia e Punës e Shqipërisë, e udhëhequr nga interesat e unitetit të lëvizjes komuniste botërore dhe të kampit socialist, me durim të madh, qëkurse lindën mosmarrëveshjet tona me udhëheqjen sovjetike, është përpjekur t'i zgjidhë ato në rrugën e drejtë marksiste-leniniste, në rrugën që përcakton Deklarata e Moskës. Kurse N. Hrushovi zgjodhi rrugën antimarksiste të acarimit të tyre, rrugën e sulmeve e të shpifjeve, të presioneve e të kërcënimeve, rrugën e denoncimit publik të mosmarrëveshjeve tona.

Partia e Punës e Shqipërisë e priti me simpati deklaratën e kryetarit të delegacionit të Partisë Komuniste të Kinës në Kongresin XXII të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, shokut Çu En Lai, në të cilën theksohet se kritikata e njëanshme dhe nxjerrja në shesh, përpara armikut, e mosmarrëveshjeve midis partive motra nuk mund të konsiderohen si një qëndrim serioz e marksist-

edhe më shumë, duke gëzuar vetëm armiqtë e komunizmit. Prandaj Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë është i mendimit se për shërimin e kësaj sëmundjeje të rrezikshme që ekziston duhet ndërhyrja urgjente dhe e guximshme e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik...

Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë sonë mendon se shqyrtimi i kujdesshëm i marrëdhënjeve të krijuara midis dy partive tona, shqyrtimi i kujdesshëm i gjithë korrespondencës së shkëmbyer midis dy partive tona nga ana e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, do të hedhë dritë akoma më qartë se në ç'rrugë të gabuar ka hyrë udhëheqja sovjetike, me N. Hrushovin në krye, në marrëdhënjet me Partinë e Punës së Shqipërisë. Ne jemi të bindur se Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik në qoftë se do t'i shikojë çështjet me gjakftohtësi dhe objektivitet, pa u influencuar nga pasionet, do të arrijë në konkluzionin se Partia e Punës e Shqipërisë dhe udhëheqësit shqiptarë janë në rrugë të drejtë dhe luftojnë për forcimin efektiv të unitetit të lëvizjes komuniste e punëtoresh ndërkombëtare mbi bazën e marksizëm-leninizmit e të internacionalizmit proletar, për forcimin e unitetit të kampit socialist me Bashkimin Sovjetik në krye, për forcimin e miqësisë shqiptaro-sovjetike.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror të
Partisë*

DEKLARATË

E KOMITETIT QENDROR TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË KUNDËR SULMIT DHE SHPIFJEVE TË N. HRUSHOVIT NË KONGRESIN XXII TË PK TË BS

20 tetor 1961

Në Kongresin XXII të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, N. Hrushovi sulmoi botërisht Partinë e Punës të Shqipërisë. Shpifjet dhe sulmet antimarksiste të N. Hrushovit u shërbejnë vetëm armiqtë të komunizmit dhe të Republikës Popullore të Shqipërisë, imperialistëve të ndryshëm dhe revizionistëve jugosllavë. N. Hrushovi, duke nxjerrë në shesh përpara armiqtë mosmarrëveshjet që ekzistojnë prej kohësh midis udhëheqjes së Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe Partisë së Punës të Shqipërisë, shkeli brutalisht Deklaratën e Moskës të vitit 1960, në të cilën theksohet se mosmarrëveshjet që lindin midis partive motra duhet të zgjidhen me durim, në frymën e internacionalizmit proletar dhe mbi bazën e parimeve të barazisë e të konsultimeve. Duke sulmuar botërisht Partinë e Punës të Shqipërisë, N. Hrushovi efektivisht filloi sulmin e hapur kundër unitetit të lëvizjes komuniste e punëtoresh ndërkombëtare, kundër unitetit të kampit socialist. Për këtë akt antimarksist dhe për të gjitha pasojat që rrjedhin prej tij, N. Hrushovi mban përgjegjësi të plotë.

Partia e Punës e Shqipërisë, e udhëhequr nga interesat e unitetit të lëvizjes komuniste botërore dhe të kampit socialist, me durim të madh, qëkurse lindën mosmarrëveshjet tona me udhëheqjen sovjetike, është përpjekur t'i zgjidhë ato në rrugën e drejtë marksiste-leniniste, në rrugën që përcakton Deklarata e Moskës. Kurse N. Hrushovi zgjodhi rrugën antimarksiste të acarimit të tyre, rrugën e sulmeve e të shpifjeve, të presioneve e të kërcënimeve, rrugën e denoncimit publik të mosmarrëveshjeve tona.

Partia e Punës e Shqipërisë e priti me simpati deklaratën e kryetarit të delegacionit të Partisë Komuniste të Kinës në Kongresin XXII të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, shokut Çu En Lai, në të cilën theksohet se kritikata e njëanshme dhe nxjerrja në shesh, përpara armikut, e mosmarrëveshjeve midis partive motra nuk mund të konsiderohen si një qëndrim serioz e marksist-

-leninist. Por nga tribuna e Kongresit XXII të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, edhe pas këtij paralajmërimi parimor të përfaqësuesit të Partisë Komuniste të Kinës, vazhdojnë sulmet e shpifjet më të egra kundër Partisë së Punës të Shqipërisë dhe Republikës Popullore të Shqipërisë, si nga disa pjesëtarë të udhëheqjes sovjetike, ashtu edhe nga disa udhëheqës të partive komuniste dhe punëtoresh të vendeve të tjera, duke marrë kështu edhe ata mbi vete një përgjegjësi të rëndë historike, si përçarës të unitetit të lëvizjes komuniste e punëtoresh ndërkombëtare.

Në këto kushte, përpara sulmit të organizuar antimarksist të N. Hrushovit dhe të atyre që e pasojnë, përpara shpifjeve e trillimeve, që kanë për qëllim diskreditimin e Partisë sonë, përpara rrezikut serioz për fatet e mëtejshme të unitetit të lëvizjes komuniste e punëtoresh ndërkombëtare dhe të kampit socialist, Partia e Punës e Shqipërisë nuk mund të heshtë. Ajo, me fakte e dokumenta, do t'i bëjë të njohur gjithë lëvizjes komuniste e punëtoresh, si dhe gjithë opinionit publik ndërkombëtar, se si qëndron e vërteta mbi marrëdhënjet midis Partisë së Punës të Shqipërisë dhe udhëheqjes së Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, se nga ç'anë është e drejta dhe do të demaskojë veprimet antimarksiste e antishqiptare të N. Hrushovit dhe të grupit të tij.

Uniteti i kampit socialist dhe i lëvizjes komuniste e punëtoresh ndërkombëtare po rrezikohet seriozisht nga veprimet antimarksiste të N. Hrushovit e të pasuesve të tij. Në këtë situatë, për të mbrojtur interesat e larta të popullit dhe të atdheut, fitoret e tija socialiste, për të mbrojtur pastërtinë e marksizëm-leninizmit dhe unitetin e radhëve të lëvizjes komuniste e të kampit socialist, Partia e Punës e Shqipërisë, me ndërgjegje të pastër, ka marrë dhe do të marrë përgjegjësinë për çdo veprim të saj, si përpara lëvizjes komuniste e punëtoresh ndërkombëtare, ashtu edhe përpara popullit shqiptar.

Lufta që po i imponohet Partisë dhe popullit tonë, do të jetë e gjatë dhe e vështirë. Por vështirësitë nuk e kanë trembur kurrë Partinë e popullin tonë. Partia dhe populli ynë janë kalitur në luftë kundër shpifjeve, sulmeve e kompleteve të shumta e të vazhdueshme të imperialistëve të ndryshëm e të revizionistëve jugosllavë. Ata nuk do të përkulen e nuk do të gjunjëzohen as përpara sulmeve shpifëse, shantazheve e presioneve të N. Hrushovit dhe të atyre që e pasojnë. Partia e popullit, në unitet të çelniqtë, si kurdoherë, do të çajmë përpara të vendosur dhe do të fitojmë në rrugën e tyre të drejtë, në rrugën e triumfit të marksizëm-leninizmit e të çështjes së socializmit e të komunizmit. Ne do të fitojmë, sepse nuk jemi vetëm. Me ne, me çështjen e madhe të marksizëm-leninizmit, janë komunistët dhe popujt e Bashkimit Sovjetik, me të cilët na lidh një dashuri e miqësi e pathyeshme që ne kurdoherë, në çdo stuhi e furtunë, do ta ruajmë të paprekur

në zemrat tona; me ne janë komunistët dhe popujt e Kinës, janë gjithë komunistët dhe popujt e vendeve të tjera socialiste. Flamuri fitimtar i Partisë, flamuri i pamposhtur i marksizëm-leninizmit, do të valojë kurdoherë krenar në Shqipërinë e re socialiste.

KOMITETI QENDROR I PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË

Botohet sipas gazetës

«Zëri i Popullit»,

Nr. 254, 21 tetor 1961

PLENUMI VI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Tiranë, 24-25 janar 1962

KOMUNIKATË

E PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Më 24 dhe 25 janar 1962 u mbledh Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë nën kryesinë e Sekretarit të Parë të Komitetit Qendror, shokut Enver Hoxha.

Plenumi dëgjoi raportin e Byrosë Politike të Komitetit Qendror «Mbi rezultatet e plotësimit të planit dhe të buxhetit të shtetit për vitin 1961 dhe mbi masat që duhen marrë për plotësimin e detyrave të planit dhe të buxhetit të vitit 1962», mbajtur nga kandidati i Byrosë Politike të Komitetit Qendror dhe President i Komisionit të Planit të Shtetit, shoku Koço Theodhosi dhe aprovoi vendimin përkatës.

Në mbledhjen e Plenumit të Komitetit Qendror mbajti një fjalim të rëndësishëm Sekretari i Parë i Komitetit Qendror të PPSH, shoku Enver Hoxha.

Në punimet e Plenumit të Komitetit Qendror muarën pjesë si të ftuar sekretarët e parë të komiteteve të Partisë dhe kryetarët e komiteteve ekzekutive të k.p. të rretheve, disa drejtorë ndërmarrjesh ekonomike dhe punonjës të aparateve qendrore shtetërore e të Partisë.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

VENDIM

I PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË «Mbi rezultatet e plotësimit të planit dhe të buxhetit të shtetit për vitin 1961 dhe mbi masat që duhen marrë për plotësimin e detyrave të planit dhe të buxhetit të vitit 1962»

25 janar 1962

Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, në mbledhjen e tij të datës 24 dhe 25 janar 1962, nën kryesinë e Sekretarit të Parë të Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, shokut Enver Hoxha, dëgjoi dhe aprovoi raportin e Byrosë Politike, mbajtur nga kandidati i Byrosë Politike dhe President i Komisionit të Planit të Shtetit, shoku Koço Theodhosi, «Mbi rezultatet e plotësimit të planit dhe të buxhetit të shtetit për vitin 1961 dhe mbi masat që duhen marrë për plotësimin e detyrave të planit dhe të buxhetit për vitin 1962».

I

Gjatë vitit 1961, populli ynë, nën udhëheqjen e Partisë, arriti suksese të mëdha në plotësimin e planit në të gjithë sektorët e ekonomisë dhe të kulturës popullore. Viti 1961, si viti i parë i planit të tretë pesëvjeçar dhe i provës së madhe në kushtet e blokadës ekonomike që po zbaton grupi revizionist i Hrushovit dhe pasuesit e tij, u karakterizua nga një mobilizim dhe entuziazëm i paparë i popullit tonë për të vënë në jetë vendimet historike të Kongresit IV të Partisë së Punës të Shqipërisë, nga një vendosmëri e madhe dhe patriotizëm i flakët për të kapërcyer të gjitha vështirësitë dhe pengesat dhe nga një unitet i çelniktë i masave punonjëse rreth Partisë dhe Komitetit të saj Qendror me në krye shokun Enver Hoxha. Në saje të qëndrimit të drejtë marksist-leninist të Partisë sonë në të gjitha çështjet ideologjike dhe politike, të luftës parimore dhe të guximshme që ajo ka bërë për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit dhe të interesave të popullit dhe të atdheut tonë, dështuan me turp të gjitha presionet dhe veprimet armiqësore të imperialistëve dhe të revizionistëve jugosllavë.

Sukseset e mëdha të arritura gjatë vitit të kaluar, treguan edhe një herë në mënyrë bindëse, drejtësinë e vijës së përgjithshme të Partisë, e cila ka ngjallur me të drejtë një ndjenjë krenarie të ligjshme në të gjithë Partinë dhe popullin, që, të lidhur ngushtë njëri

me tjetrin dhe të ndërgjegjshëm për detyrat e ngarkuara, i janë përveshur punës së madhe të ndërtimit socialist të vendit.

Në këtë rrugë revolucionare Partia dhe populli ynë gëzojnë respektin dhe ndihmën internacionaliste të vendeve miq, në radhë të parë të popullit të madh të Kinës.

Vëllimi i prodhimit të përgjithshëm industrial në vitin 1961 u realizua 105 për qind kundrejt planit dhe 7 për qind më shumë në krahasim me vitin 1960. Plani i prodhimit industrial u realizua nga të gjitha ministritë dhe degët më të rëndësishme, në sasi dhe në treguesit kryesorë, cilësorë e tekniko-ekonomikë.

Gjatë vitit 1961, në krahasim me vitin 1960, u prodhuan më shumë naftë brut — 6 për qind, benzinë — 4 për qind, bitum fluksat — 9 për qind, mineral hekuri — 41 për qind, bakër blister — 37 për qind, energji elektrike — 17 për qind, pjesë këmbimi — 17 për qind, çimento — 64 për qind, rimeso — 12 për qind, pëlhura të pambukta — 3 për qind, pëlhura të leshta — 12 për qind, trikotazhe — 13 për qind, birra — 36 për qind, peshk i njomë — 22 për qind, verëra — 67 për qind, djathë — 56 për qind etj.

Suksese të mëdha kanë arritur punonjësit e gjeologjisë dhe të minierave, të cilët, me punën e tyre vetëmohuese, në luftë me vështirësitë e natyrës, po meritojnë me vepra vendin e nderit që u ka besuar Partia si pararojë e industrializimit socialist. Me guxim, ata muarën mbi shpatullat e veta barrën e madhe të vazhdimit të punës së ndërprerë nga largimi arbitrar i specialistëve të huaj dhe po vënë në shërbim të ekonomisë popullore vendburime të reja minierale të dobishme.

Me gjithë thatësinë e vitit 1961, prodhimi i përgjithshëm bujqësor u rrit 19 për qind më shumë se në vitin 1960.

Në vitin 1961 u prodhuan më shumë se në vitin 1960: drithëra buke 35 për qind, pambuk 14 për qind, perime 35 për qind, patate 29 për qind, fasule 48 për qind, ullinj mbi 6 herë, fruta 2,7 herë, rrush 2 herë, agrume 52 për qind e të tjera.

Përfundimet e arritura në bujqësi do të ishin edhe më të mira po të ishin plotësuar detyrat e parashikuara në plan përsa i përket prodhimit të drithërave të bukës, orizit, panxhar sheqerit dhe sidomos duhanit, i cili u dëmtua rëndë nga sëmundja e vrugut.

Plani i ndërtimeve u plotësua 104 për qind. Gjatë vitit 1961 u dhanë për shfrytëzim një sërë veprash me rëndësi si fabrika e briketit të qymyrit, katër fabrika për përpunimin e rrushit, dy kantina për ruajtjen e verës, linja e tensionit të lartë Skuraj-Laç, fabrikat e pijeve alkoolike dhe joalkoolike në Tiranë, dy fabrika për përpunimin e ullirit, Frigoriferi i madh i Tiranës, radiostacioni i ri, një hotel turistik në Durrës, Sanatoriumi i Tiranës, shkollat e konviktet e parashikuara, si dhe u tejkalua grafiku i dorëzimit të banesave.

Në transportin automobilistik të mallrave të Ministrisë së Komunikacionit plani u plotësua 102 për qind, në transportin hekurudhor të mallrave 107 për qind, ndërsa transporti detar i jashëm planin e të ardhurave e plotësoi 120 për qind.

Përmirësime janë arritur gjatë vitit 1961 edhe në drejtim të ngritjes së mirëqenjes materiale dhe nivelit kultural të masave punonjëse. Plotësimi me sukses i planeve për shtimin e prodhimit, për zgjerimin e asortimenteve dhe ulja e fundit e çmimeve të mallrave të përdorimit të gjerë bënë të mundur që populli të furnizohet më mirë dhe të përmirësohet shërbimi i tij. Plani i edukimit u plotësua dhe u tejkalua në të gjithë sistemin tonë të arësimit. Gjatë vitit 1961 u përgatitën 850 quadro të lartë, 2 330 quadro të mesëm dhe 9 700 punëtorë të rinj të kualifikuar. Suksese janë arritur edhe në zhvillimin e kulturës si dhe në zgjerimin e përmirësimin e shërbimit shëndetësor.

Buxheti i shtetit u plotësua 97 për qind për të ardhurat dhe 98 për qind për shpenzimet.

Nga analiza e realizimit të planit dhe të buxhetit të vitit 1961 dhe nga rezultatet e arritura, Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH arriti në këto konkluzione:

Qëndrimi i drejtë marksist-leninist i Partisë sonë në vlerësimin e çështjeve më të rëndësishme ndërkombëtare, mbrojtja e vendosur e marksizëm-leninizmit dhe e interesave të popullit dhe të atdheut tonë nga veprimet armiqësore të revizionistëve modernë kanë forcuar edhe më shumë unitetin, vendosmërinë dhe besimin e popullit për të ecur përpara duke kaluar çdo vështirësi.

Në këtë gjendje, pjekuria politike dhe patriotizmi i popullit tonë është ngritur në një shkallë më të lartë dhe kjo u përgjigjet detyrave që lindin në etapën historike që po kalojmë. Këto u shprehën vitin e kaluar me shumë forcë, në të gjithë kolektivat punonjës, për plotësimin e detyrave të planit.

Në vitin 1961 u vërtetua më qartë, se në ekonominë tonë popullore ka mundësi të shumta të pashfrytëzuara. U vërtetua gjithashtu, se quadrot tanë kanë arritur një nivel më të lartë teknik, që u jep mundësi të zgjidhin shumë probleme të ekonomisë.

Gjatë kësaj periudhe u shpreh më me forcë iniciativa krijuese e masave tona punonjëse, u bënë shumë propozime të vlefshme në drejtim të prodhimit dhe të zgjidhjes së problemeve të ndryshme teknike dhe ekonomike. Mjaft nga këto iniciativa dhe propozime janë vënë në jetë, por një pjesë e mirë e tyre janë në fazën eksperimentale, që kërkojnë një organizim dhe përkrahje të gjithanshme për t'u zbatuar në shkallën e gjithë ekonomisë popullore.

Plenumi i korrikut i vitit 1961 i Komitetit Qendror të Partisë ka pasur një efekt të madh për forcimin e regjimit të kursimit. Zbatimi i detyrave, që caktoi plenumi, tregoi edhe një herë rezër-

vat e shumta në këtë drejtim dhe në gjendjen e sotme është e mundshme dhe e domosdoshme të forcohet akoma më shumë regjimi i kursimit, në të gjithë sektorët e ekonomisë dhe të kulturës popullore.

II

Mbështetur në direktivat e Kongresit IV të PPSH për planin e tretë pesëvjeçar si dhe në sukseset e arritura gjatë vitit 1961, në mundësitë reale për shfrytëzimin e rezervave të brendshme, për forcimin e mëtejshëm të regjimit të kursimit, në aftësitë krijuese, në entuziazmin dhe gatishmërinë e masave punonjëse dhe në ndihmën që i japin vendit tonë vendet miq e në mënyrë të veçantë Republika Popullore e Kinës, plani i vitit 1962 parashikon detyra shumë të rëndësishme për zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë popullore.

Vëllimi i përgjithshëm i prodhimit industrial për vitin 1962 do të jetë 6 për qind më shumë se plotësimi i pritshëm i vitit 1961. Kundrejt vitit 1961 rritja e prodhimit industrial për disa degë kryesore do të jetë si vijon: industria e naftës 28 për qind, e qymyrgurit 21 për qind, e kromit 10 për qind, e bakrit 64 për qind, e hekurit 17 për qind, industria elektrike 12 për qind, mekanike 12 për qind, materialeve të ndërtimit 2 për qind, industria e lehtë 6 për qind, ushqimore 3 për qind etj.

Vëllimi i përgjithshëm i prodhimit bujqësor në vitin 1962 do të jetë 25 për qind më shumë se plotësimi i vitit 1961. Prodhimi i disa kulturave kryesore do të rritet si vijon: drithëra buke 32 për qind, pambuk 21 për qind, duhan 308 për qind, panxhar sheqeri 50 për qind, tagjira 17 për qind më shumë se në vitin e kaluar. Në vitin 1962 në krahasim me vitin 1961 grumbullimi i prodhimeve bujqësore dhe blegtorale do të rritet: në drithëra buke 45 për qind, oriz çeltik 147 për qind, fasule 26 për qind, pambuk 21 për qind, panxhar sheqeri 43 për qind, duhan 297 për qind, patate 22 për qind, fruta 21 për qind, qumësht 10 për qind, mish 26 për qind etj.

Vëllimi i përgjithshëm i ndërtimeve do të jetë 4 për qind më i madh nga ai i parashikuar në planin e tretë pesëvjeçar dhe 14 për qind më i madh nga vëllimi i ndërtimeve që u realizua në vitin 1961. Do të vazhdojnë dhe do të fillojnë punimet për ndërtimin dhe bonifikimin e më shumë se 65 veprave të rëndësishme industriale, bujqësore dhe social-kulturale siç janë: hidrocentralet e Shkopetit e të Bisticës, linjat e tensionit të lartë, fabrikat e tjerrjes së fillit dhe zgjerimi i fabrikës së trikotazhit në Korçë, bonifikimi i fushës së Maliqit, Lezhës, Hoxharës, i kënetës së Durrësit dhe Karavastasë, përfundimi i hekurudhës Vorë-Milot,

hapja e rrugëve pyjore, ndërtimi i Pallatit të kulturës në Tiranë, Shtëpia e kulturës në Durrës etj. Do të fillojnë punimet për ndërtimin e kombinatit të tekstileve, të kombinatit të drurit, të uzinës për prodhimin e pjesëve të këmbimit për traktorë, të fabrikës së gozhdëve dhe bullonave etj. Gjithashtu do të fillohet nga puna për ndërtimin e disa veprave të tjera industriale siç janë: uzina e metalurgjisë së bakrit, uzina e metalurgjisë së zezë, uzinat për prodhimin e telave prej bakri etj.

Vëllimi i transportit automobilistik të Ministrisë së Komunikacionit do të rritet 14 për qind më shumë se në vitin 1961. Vëllimi i përgjithshëm i transportit hekurudhor të mallrave në ton do të rritet 6 për qind më shumë nga viti i kaluar, ndërsa vëllimi i punës në transportin detar të jashtëm do të rritet në ton 63 për qind më shumë.

Mbi bazën e shtimit të prodhimit industrial dhe bujqësor do të arrihet ngritja e mëtejshme e mirëqenjes materiale dhe nivelit kultural të popullit. Numri i punonjësve në vitin 1962 do të rritet 6 për qind.

Vëllimi i përgjithshëm i të ardhurave kombëtare në vitin 1962 kundrejt vitit 1961, do të rritet 15 për qind dhe qarkullimi i mallrave me pakicë — 5 për qind. Do t'i shiten popullit, më shumë se në vitin 1961, mallra të konsumit të gjerë në masën që vijon: miellra 13 për qind, fasule 35 për qind, mish 9 për qind, peshk 63 për qind, qumësht 22 për qind, djathë 12 për qind, patate 25 për qind, fruta 76 për qind, agrume 13 për qind, sheqer 23 për qind, yndyrna 6 për qind, tekstile të pambukta 10 për qind, këpucë të ndryshme 35 për qind etj.

Në vitin 1962 numri i përgjithshëm i nxënësve do të rritet në 22 mijë, ose 8 për qind më shumë se në vitin 1961. Gjatë vitit 1962 do të mbarojnë studimet 850 kuadro të lartë, 2 500 kuadro të mesëm dhe do të përgatiten 10 000 punëtorë të rinj të kualifikuar. Një zhvillim të mëtejshëm do të marrë kultura sidomos në fshat.

Do të rriten në masën 9 për qind institucionet e mjekimit dhe 9 për qind numri i vendeve në to.

Të ardhurat e buxhetit të shtetit për vitin 1962 do të jenë me një tepricë prej 1,7 për qind më shumë se sa shpenzimet.

III

Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH, duke analizuar masat për realizimin e planit, shtron këto detyra kryesore ku duhet përqëndruar vëmendja e organizatave të Partisë, organeve shtetërore dhe të ekonomisë për të plotësuar me sukses detyrat e planit të vitit 1962:

1. — Të merren të gjitha masat për të realizuar dhe tejkaluar planin e vitit 1962 në sasi, cilësi dhe në gjithë sektorët e ekonomisë dhe të kulturës popullore.

Detyrat e mëdha që parashikon plani i vitit 1962 janë plotësisht të realizueshme dhe vendimtare për plotësimin e pesëvjeçarit të tretë. Zbatimi i këtyre detyrave, duke marrë parasysh dhe vështirësitë e krijuara nga veprimtaria armiqësore e revizionistëve modernë kundra Partisë dhe popullit tonë, kërkon një mobilizim të përgjithshëm edhe më të madh të masave punonjëse, të kuadrove tanë, të organizatave të Partisë e të masave dhe të organeve shtetërore të ekonomisë për shfrytëzimin e të gjitha mundësive dhe të rezervave që ka ekonomia jonë popullore, për rritjen e entuziazmit dhe të ndërgjegjes së masave punonjëse, me qëllim që të realizohen dhe të tejkalohen detyrat e planit në të gjithë sektorët e ekonomisë popullore, duke kursyer lëndët e para e materialet dhe duke prodhuar ato mallra që tërheq tregu i brendshëm dhe i jashtëm.

Për plotësimin me sukses të detyrave të planit, Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH porositi të kihet parasysh se

a) Plani i vitit 1962 parashikon një rritje të theksuar për prodhimet e industrisë së naftës dhe atyre minerale. Kjo kërkon një punë të madhe dhe të kujdesshme. Të kryhen në kohë punimet e nevojshme për zbulimin e vendburimeve të reja të naftës dhe të mineraleve, të përgatiten frontet ekzistuese të shfrytëzimit për një prodhim ritmik dhe me cilësi të mirë. Rëndësi e posaçme t'u kushtohet kërkimeve gjeologjike.

b) Një nga detyrat kryesore për ndërmarrjet dhe organizatat ekonomike është përmirësimi i mëtejshëm i cilësisë së prodhimit, i ndërtimit dhe i shërbimit, në mënyrë që këto t'u përgjigjen më mirë kërkesave të tregut, gustos dhe nevojave të popullit. Kjo kërkon që organizatat e Partisë, të masave dhe organet ekonomike të bëjnë një punë të gjallë edukative me njerëzit për të ngritur më lart ndërgjegjen socialiste në punë, shkallën e kualifikimit dhe kontrollin për organizimin më të mirë të punës.

Viti 1962 duhet të jetë vendimtar në pakësimin e gjerë të mallrave mbi normativë, në përgjithësi për artikujt industrialë dhe në mënyrë të veçantë për prodhimet e industrisë lokale dhe të artizanatit.

c) Zgjerimi i prodhimit të artikujve të rinj për plotësimin më të mirë të nevojave të ekonomisë, për shtimin e eksportimit dhe pakësimin e importit, është një problem i kohës, që duhet të merret seriozisht nga çdo organ shtetëror dhe i Partisë, si në qendër ashtu dhe në bazë. Në mënyrë të veçantë duhet parë prodhimin i pjesëve të këmbimit, i veglave dhe i pajisjeve të ndryshme. Industria mekanike duhet të zbatojë detyrat e mëdha që i dalin

duke aktivizuar për këtë qëllim si uzinat mekanike me karakter kombëtar, ashtu edhe ofiçinat e vogla pranë çdo ndërmarrjeje ekonomike.

ç) Për t'u bërë ballë ndërtimeve dhe montimeve të veprave të mëdha dhe të vështira industriale në vitin 1963-1965, duhet jo vetëm të realizojmë plotësisht ndërtimet e këtij viti, por njëkohësisht të përgatitemi edhe për punën e madhe që na del përpara në të ardhshmen. Detyrat e planit të ndërtimit të vitit 1962 kanë një rëndësi të madhe për realizimin e gjithë ndërtimeve të pesëvjeçarit të tretë, prandaj të forcohet bashkëpunimi i organeve zbatuese dhe investitore.

d) Në kushtet e tanishme çështja e shtimit dhe e ruajtjes së rezervave në lëndë të parë e materiale, e lëndëve djegëse e të tjera, është kusht i rëndësishëm dhe i domosdoshëm për të prodhuar dhe ndërtuar pa ndërprerje. Këtë e kërkon jo vetëm situata konkrete, por dhe nevoja e përmirësimit të vazhdueshëm të drejtimit të ekonomisë me plan. Prandaj, viti 1962 duhet të jetë viti i shtimit të rezervave të stabilizuara në lëndë të parë, lëndë djegëse dhe mallra të ndryshme të nevojshme për ekonominë kombëtare; këto rezerva duhet të krijohen nga të gjitha organet shtetërore dhe ndërmarrjet ekonomike.

2. — Realizimi i planit të vitit 1962 në bujqësi kërkon të merren masa serioze nga të gjitha organizatat dhe organet e Partisë dhe të pushtetit në rrethe e në qendër.

Në kushtet e krijuara, realizimit të planit të bujqësisë për të plotësuar nevojat e vendit me artikuj ushqimorë, sidomos realizimit të prodhimit të drithërave të bukës, orizit, panxhar sheqerit, prodhimeve blegtorale e të tjera dhe të artikujve të tjerë që lidhen me eksportin dhe sigurimin e lëndëve të para për industrinë si duhani, pambuku etj. duhet t'u kushtohet një vëmendje shumë e madhe si nga Ministria e Bujqësisë dhe organet e saj vartëse ashtu dhe nga të gjitha organet e Partisë dhe të pushtetit në rrethe.

Të luftohet më shumë për shfrytëzimin dhe administrimin e fondit të tokës që është mjeti kryesor i prodhimit bujqësor. Të merren të gjitha masat e nevojshme për realizimin e planit të hapjes së tokave të reja dhe për vënjen e tyre nën kulturë. Organizatat e Partisë dhe organet e bujqësisë të luftojnë me këmbëngulje për shfrytëzimin sa më racional të tokës, duke mbjellë të gjithë sipërfaqen që ka në përdorim çdo ekonomi bujqësore dhe kudo që janë kushtet të merren jo vetëm një, por dy dhe tri prodhime në vit. Porositen edhe një herë Ministria e Bujqësisë, komitetet ekzekutive të rrethëve si dhe organizatat e Partisë për

të marrë masa të rrepta për mënjanimin e të metave që vihen re në administrimin dhe përdorimin joracional të fondit të tokës, sidomos të tokave ara.

Të përqëndrohet edhe më shumë vëmendja e Ministrisë së Bujqësisë si dhe e organeve shtetërore dhe të Partisë në rrethe mbi prodhimin e drithërave të bukës. Partia jonë e ka vlerësuar gjithmonë problemin e rritjes së drithërave të bukës si detyrën më kryesore të bujqësisë, ashtu si e ka përcaktuar V. I. Lenini: «Lufta për bukë është lufta për socializëm»¹. Në kushtet e sotme rritja e prodhimit të drithërave të bukës merr një rëndësi edhe më të madhe.

Për të realizuar këtë detyrë është e nevojshme që çdo ndër-marrje bujqësore shtetërore, kombëtare ose lokale, çdo kooperativë bujqësore dhe çdo rreth, detyrën për prodhimin e drithërave të bukës ta konsiderojnë detyrën më kryesore, pavarësisht nga pe-sha që zënë këto prodhime në ekonominë e tyre.

Ministria e bujqësisë, komitetet e Partisë dhe komitetet ekzekutive të rretheve duhet të marrin masat e nevojshme që të përhapet më shumë mbjellja e grurit në zonat malore e kodrinore, ku prodhimi i misrit është më pak i garantuar, si dhe në zonën fushore ku ka mundësi të merren dy prodhime, duke mbjellë edhe misër hamullor pas korrjes së grurit.

Për rritjen e rendimenteve është e domosdoshme që viti 1962 të karakterizohet nga një luftë dhe mobilizim më i madh për zbatimin e të gjitha masave sipas kodit agroteknik që shtron Kongresi IV i Partisë. Në mënyrë të veçantë duhet t'i kushtohet kujdes problemit të plehërimeve. Shfrytëzimi i sa më shumë plehrave duhet të bëhet problem i madh nga organizatat e Partisë, kryesitë e kooperativave bujqësore dhe drejtoritë e ndërmarrjeve bujqësore. Komitetet e Partisë të rretheve ta organizojnë këtë në formën e një aksioni të vazhdueshëm dhe ta ndjekin si një nga detyrat kryesore të ekonomisë bujqësore në rreth.

Të merren masat për sigurimin e prodhimit të duhanit. Duhani, artikulli më i rëndësishëm bujqësor për eksportin, gjatë vitit 1961 u dëmtua rëndë nga sëmundja e vrugut. Kundër kësaj sëmundje duhet punuar në mënyrë shumë të organizuar për të pakësuar në minimum dëmet që do të shkaktojnë ajo mbi kulturën e duhanit.

Për të siguruar prodhimin e duhanit dhe për të kufizuar influencën e sëmundjes së rrezikshme të vrugut, duhet të merren këto masa: Së pari, të tregohet kujdes i veçantë për zhdukjen e vatrave të infeksionit dhe të bëhet plugimi i tokave që do të mbillen me duhan në thellësi jo më pak se 30 cm. Së dyti, të tregohet kudes i veçantë për prodhimin e fidaneve në sasi, cilësi dhe

¹ Shih: V. I. Lenin. Veprat, vëll. 27, f. 546.

në kohë. Çdo kooperativë të mbjellë farishte rezervë në shumë duar dhe të tregojë kujdes të plotë duke zbatuar të gjitha rregullat agroteknike. Së treti, të mbillet duhan sa më herët dhe t'i bëhen shërbimet kulturale me kujdesin më të madh. Së katërti, të merren masa për rritjen e vlerës së duhanit. Për këtë, të organizohet vjelja e gjëhit në kohë, si dhe tharja në kushte të për-shtatshme duke siguruar bazën materiale si hangare, depo etj.

T'u kushtohet kujdes më i madh problemeve të kullimit dhe të ujitjes, si faktorët më kryesorë për arritjen e rendimenteve të planifikuara në bimët e ndryshme bujqësore. Në kushtet klimaterike të vendit tonë duhet t'i kushtohet një rëndësi e posaçme zgjerimit dhe përmirësimit të mëtejshëm të sistemit të kanaleve dhe vijave kulluese. Të organizohen dhe të mbahen skuadra të përhershme në kooperativat bujqësore dhe në ndërmarrjet bujqësore shtetërore, të cilat të merren kryesisht me kullimin dhe vaditjen.

Duke marrë parasysh mundësitë e mëdha lokale për shtimin e sipërfaqes nën ujë, eksperiencën e fituar në ndërtimin e veprave lokale dhe ndihmat që do t'u jepen nga ana e shtetit ekonomive bujqësore në fonde, mjete dhe projekte, të merren të gjitha masat që plani i vitit 1962 për shtimin e sipërfaqeve të ujitshme të tejkalohet dhe plani pesëvjeçar të realizohet para afatit.

Ministria e Bujqësisë, komitetet ekzekutive dhe drejtoritë e ujrave të marrin masa që të shfrytëzojnë të gjithë aftësinë ujitëse të veprave të mëdha, të venë në jetë teknikën e ujitjes dhe të përhapin eksperiencën e përparuar në këtë drejtim.

T'u kushtohet kujdes i veçantë kulturave frutore dhe në mënyrë të posaçme kulturës së ullirit që është baza për prodhimin e yndyrnave për furnizimin e popullit.

Fshtatarësia, teknikët dhe specialistët e bujqësisë, organet e pushtetit dhe organizatat e Partisë duhet të tregojnë më shumë kujdes për realizimin e detyrave që shtron plani i tretë pesëvjeçar për kulturat frutore. Në radhë të parë ata duhet të marrin masa rrënjësore agroteknike (si krasitje, punime, plehërime dhe spërkatje) për përmirësimin e gjendjes së kulturave frutore, që janë në prodhim në mënyrë që të realizohet prodhimi i planifikuar. Kujdes i veçantë duhet të tregohet për mbjelljet e reja të ullirit, të agrumeve, të pemëve frutore, të vreshtave dhe të pjergullave në mënyrë që të sigurohet plotësisht zënja e tyre dhe të vihet plotësisht në jetë detyra që shtron Kongresi IV i Partisë.

Duke marrë parasysh se puna për zgjerimin e sipërfaqes së ujitshme, të kullimeve dhe të sistemeve agrare, si dhe shërbimet kryesore për kulturat frutore ekzistuese dhe mbjelljet e reja të pemëve frutore, ullinjve, vreshtave dhe agrumeve bëhen gjatë periudhës nëntor-mars, kur krahët e punës në fshat janë

më të lira nga punët e tjera të bujqësisë, kjo periudhë të konsiderohet për punonjësit e bujqësisë si fushata më me rëndësi ku forcat e punës duhet të mobilizohen për zgjerimin e sipërfaqes së ujitshme për kullimin dhe sistemimin e tokave, për hapjen e tokave të reja, për shërbimet agroteknike të të gjitha kulturave frutore dhe për mbjelljet e reja të pemëve frutore, ullinjve, agrumeve, vreshtave dhe pjergullave, për përgatitjen e fidanishëve frutore dhe rritjen e fidaneve.

Për realizimin e planit të blegtorisë të vazhdojë me këmbëngulje puna për organizimin e fermave blegtorale në kooperativat bujqësore, për përmirësimin e masave zooveterinare dhe sidomos për forcimin e bazës ushqimore.

Të merren masa për mbjelljen me kultura të vlefshme foragjere në të gjitha sipërfaqet e caktuara për këtë qëllim dhe t'u bëhen atyre shërbimet e nevojshme për marrjen e rendimenteve të larta, si dhe për të marrë nga e njëjta sipërfaqe dy dhe tri prodhime foragjere në vit.

Kullotat natyrore janë një rezervë shumë e madhe për bazën ushqimore të blegtorisë, prandaj për përmirësimin e kullotave duhet bërë një punë e tillë që të sjellë patjetër rritjen e prodhimit të tyre. Ministria e Bujqësisë duhet të caktojë detyra konkrete për çdo ndërmarrje bujqësore dhe për çdo ndërmarrje pyjore që ka në administrim kullota po ashtu dhe komitetet ekzekutive të rretheve në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë për çdo kooperativë bujqësore.

Përqëndrimi i blegtorisë në ferma kolektive të organizuara dhe detyra e caktuar nga Partia për shtimin e prodhueshmërisë së blegtorisë me anë të përmirësimit të racës, ngarkon me përgjegjësi Ministrinë e Bujqësisë dhe të gjithë specialistët e blegtorisë dhe organizatat e Partisë që të marrin masa konkrete për rritjen e numrit të gjësë së gjallë kolektive, për mbarështrimin e drejtë të blegtorisë, si dhe për mbrojtjen preventive të saj nga sëmundjet. Në zbatimin e këtyre detyrave rëndësi të madhe ka përgatitja dhe kualifikimi i kadrove në numër të mjaftë për blegtorinë.

3. — Të tregojmë më shumë kujdes për arësimin dhe kulturën popullore, të bëhen këto probleme të gjithë shoqërisë.

Të përqëndrohet vëmendja në mbylljen e vitit shkollor në vazhdim me rezultate sa më të mira në mësim, në cilësinë e punës mësimore-edukative, në lidhjen e mësimi me jetën. Të tregohet më tepër kujdes për arësimin e mbrëmjes dhe me korrespondencë të punonjësve dhe sidomos të arësimtarëve.

Të merren të gjitha masat e nevojshme si për anën ekonomi-

ko-organizative ashtu edhe mësimore-edukative për përgatitjet e vitit të ri shkollor 1962-1963. Kujdes i veçantë të tregohet për sigurimin e kontingjenteve të nxënësve për të gjitha kategoritë e shkollave e të formave të ndryshme të përgatitjes së kuadrit dhe sidomos për kontingjentet e instituteve pedagogjike dyvjeçare.

Organizatat e Partisë, organet e pushtetit dhe organizatat e masave duhet t'u kushtojnë më shumë vëmendje problemeve të kulturës me qëllim që të bëhet një punë më e madhe dhe më e kualifikuar për ngritjen e mëtejshme të nivelit kultural të masave punonjëse.

Të punohet më seriozisht për të organizuar më mirë jetën e kulturuar të punonjësve, si në çështjet ekonomike e të jetesës familjare ashtu dhe në mirëmbajtjen e higjienës e të shëndetit në çdo fshat, qendër pune apo familje. Organet e Partisë e të pushtetit duhet të marrin të gjitha masat për gjallërimin e mëtejshëm të jetës kulturele në qytete, qendra pune e sidomos në fshat, për të organizuar më mirë kohën e lirë pas pune të punonjësve e veçanërisht të rinisë, duke aktivizuar dhe inkurajuar akoma më shumë talentet e reja në fushën e letërsisë, arteve dhe gjithë lëvizjen diletante e artistike.

4. — Të luftohet në mënyrë më të organizuar për të shfrytëzuar të gjitha mundësitë dhe rezervat e brendshme që ka në ekonominë tonë, të ngrihet në shkallë më të lartë iniciativa krijuese e punonjësve për prodhimin në vend të artikujve të rinj.

Në vendin tonë është krijuar tani një bazë deri diku e fuqishme materialo-prodhuese, është rritur numri dhe aftësia e klasës punëtore, e kadrove drejtues dhe inxhiniero-teknikë, faktorë këta të rëndësishëm për shtimin e prodhimit dhe shfrytëzimin më të gjerë dhe të thellë të të gjitha mundësive të mëdha dhe pasurive të shumta natyrore të vendit, për t'i shndërruar ato në të mira materiale.

Mbështetur mbi këtë bazë, duke e lidhur ngushtë atë me faktorët moralo-politikë dhe me iniciativat e shumta e të guximshme që kanë ndërmarrë punonjësit, organizatat e Partisë, organet ekonomike shtetërore dhe organizatat e masave kanë për detyrë të përkrahin dhe t'i japin një drejtim më të organizuar kësaj lëvizjeje të madhe.

Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH porositi që në zhvillimin e iniciativave për shfrytëzimin e rezervave të brendshme të përqëndrohet vëmendja në këto drejtime kryesore:

Së pari, në ngritjen, zgjerimin apo rindërtimin e ndërmarrjeve, reparteve dhe punishteve, pajisjet e të cilave sigurohen në vend.

Së dyti, në shtimin dhe zgjerimin e prodhimit të pjesëve të këmbimit, maqinerive dhe pajisjeve të ndryshme si dhe në ripërtëritjen e tyre.

Së treti, në shtimin dhe zgjerimin e prodhimit të asortimenteve të mallrave të konsumit të gjerë.

Së katërti, në grumbullimin dhe përpunimin e mbeturinave të prodhimit dhe të përdorimit.

Të synohet që iniciativat e ndërmarrura të vihen sa më parë në zbatim në dobi të ekonomisë sonë popullore.

Partia i bën thirrje klasës punëtore, gjithë punonjësve dhe kuadrove inxhiniero-teknikë, që të marrin pjesë aktive në këtë lëvizje të gjerë patriotike.

5. — Të forcohet edhe më shumë regjimi i kursimit në përdorimin e mjeteve materiale e monetare në të gjithë ekonominë popullore.

Të vazhdohet puna e madhe që po bëhet për zbatimin e vendimeve të Komitetit Qendror të PPSH në lëmin e kursimeve, të ngrihet më lart ndërgjegjja e punonjësve dhe kursimi të bëhet edukatë në të gjithë veprimtarinë ekonomiko-shoqërore të vendit tonë.

Të luftohet për të ulur më tej shpenzimet e prodhimit dhe të qarkullimit, të rritet akumulimi i brendshëm socialist dhe në përgjithësi rentabiliteti i ndërmarrjeve dhe i organizatave ekonomike.

Përdorimi i drejtë dhe me kursim i lëndëve të para, i materialeve dhe lëndëve ndihmëse, kursimi i çdo gjëje të vogël ose të madhe, grumbullimi dhe përdorimi i mbeturinave është detyrë e dorës së parë dhe e vazhdueshme për organet ekonomike shtetërore dhe organizatat e Partisë. Të përmirësohet planifikimi i furnizimit materialo-teknik, normimi dhe përdorimi i lëndëve të para dhe i materialeve, duke mos u kufizuar me normat mesatare. Të vazhdohet puna në lidhje me vendosjen e normave teknike dhe përmirësimin e normave ekzistuese të përdorimit të lëndëve të para dhe ndihmëse.

Lufta për forcimin e mëtejshëm të regjimit të kursimit, shfrytëzimi më i mirë i aftësive prodhuese dhe i maqinerive nga çdo njeri në orë dhe vëllim pune, ruajtja, mirëmbajtja dhe administrimi më i mirë i pronës socialiste të jenë nga detyrat kryesore të organizatave të Partisë, të shtetit dhe të ekonomisë.

Të merren të gjitha masat që maqineritë e ndryshme dhe në radhë të parë maqineritë dhe agregatet e NBSH-ve, SMT-ve dhe kooperativave bujqësore të strehohen brenda muajit shtator 1962, duke bërë po qe nevoja dhe ndërtime të thjeshta.

6. — Të mbahet gjallë entuziazmi që ka shpërthyer dhe të ngrihet në një shkallë më të lartë emulacioni socialist për zbatimin e detyrave të Kongresit IV të PPSH.

Emulacioni socialist që shpërtheu për nder të Kongresit IV të PPSH dhe të 20-vjetorit të themelimit të saj ngjalli një entuziazëm të paparë ndonjëherë në të gjithë punonjësit e vendit tonë, të cilët u bënë faktori i dorës së parë i rezultateve madhështore të arritura në planin e vitit të kaluar.

Organizatave të Partisë dhe të masave kanë për detyrë që ta mbajnë gjallë, ta ngrejnë në një nivel edhe më të lartë entuziazmin, mobilizimin dhe pjesëmarrjen e masave punonjëse për zbatimin me sukses të detyrave të planit të vitit 1962, viti vendimtar i realizimit të planit të tretë pesëvjeçar.

Të gjallërohen emulacioni dhe garat socialiste midis rrethëve, ndërmarrjeve dhe organizatave ekonomike, të mobilizohen punonjësit që çdo qendër pune, çdo brigadë dhe çdo individ të realizojnë ritmikisht detyrat e planit dhe zotimet për vitin 1962 nën parullën «për nder të 50-vjetorit të shpalljes së pavarësisë dhe 18-vjetorit të çlirimit».

Kujdes i veçantë, t'u kushtohet zhvillimit të mëtejshëm të lëvizjes së brigadave dhe sulmuesve të punës socialiste, gjallërimin të shkollave me eksperiencë të përparuar, brigadave të përziera të novatorëve dhe racionalizatorëve të prodhimit.

Të përdoren më gjerësisht stimujt moralë për punonjësit e dalluar, të cilët me punën dhe sugjerimet e tyre kontribuojnë në realizimin e detyrave të planit dhe në zhvillimin e ekonomisë dhe të kulturës popullore.

Të zgjerohet dhe të gjallërohet emulacioni socialist në fshat dhe në kooperativat bujqësore.

7. — Përmirësimi i mëtejshëm i organizimit të punës — kusht i domosdoshëm për të arritur suksese më të mëdha.

Organizatave të Partisë, organizatave të masave dhe organet ekonomike shtetërore të përmirësojnë më tej metodën e drejtimit, të organizojnë më mirë ndihmën ndaj bazës, të rritin aftësitë e tyre për planifikimin e drejtë, të sigurojnë qëndrueshmërinë e rezultateve dhe ritmikën e prodhimit.

Të parashikohen vështirësitë, të përcaktohen me kohë masat tekniko-organizative që sigurojnë kapërcimin e tyre dhe të mos lejohet që këto vështirësi të trashen dhe të bëhen pengesë serioze për realizimin e detyrave të planit.

Të kombinohet edhe më mirë puna e gjallë politike, ideologjike dhe organizative e Partisë, e cila të ketë për synim kryesor

bindjen e punonjësve në drejtësinë e vijës së përgjithshme të Partisë, arritjen dhe sigurimin e qëndrueshmërisë së sukseseve ekonomike.

Të bëhet një luftë më sistematike dhe më këmbëngulëse nga organizatat e Partisë për të rrënjosur te njerëzit një disiplinë të fortë, ndjenjën e përgjegjësisë për zbatimin e detyrave, për t'u prerë rrugën shfaqjeve të huaja që prishin ndërjegjen e punonjësve, në mënyrë që çdo punonjës të lidhë interesat e tij personale me interesat e përgjithshme të shoqërisë.

Tani më fort se kurrë shtrohet detyra që çdo drejtues të jetë administrator i përsosur, ekonomist i fortë dhe edukator i dalluar i punonjësve, me të cilët ai bashkëpunon.

Të punohet për ngritjen e aftësive tekniko-profesionale të punonjësve, për shfrytëzimin më të mirë të kohës së punës, për ngritjen e pandërprerë të rendimentit të punës dhe në përgjithësi të treguesve cilësorë dhe tekniko-ekonomikë.

*
* * *

Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH ka besim se masat punonjëse të vendit tonë, si kurdoherë, do të mobilizohen me një vendosmëri dhe patriotizëm më të madh për të vënë në jetë detyrat e planit të vitit 1962.

Garanci e sigurtë për realizimin e planit të këtij viti janë udhëheqja e drejtë e Partisë sonë të lavdishme, patriotizmi i lartë socialist i masave punonjëse, gatishmëria dhe vendosmëria e tyre për të bërë realitet fjalën e Partisë.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

V E N D I M

I KOMITETIT QENDROR TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË «MBI ZHVILLIMIN E MËTEJSHËM TË FISKULTURËS DHE SPORTIT»

1 mars 1962

Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë, pasi mori në shqyrtim gjendjen e kulturës fizike dhe të sporteve, si dhe masat për zhvillimin e tyre të mëtejshëm, konstatoi se lëvizja fiskulturale e sportive, nën udhëheqjen e Partisë, ka arritur suksese të mëdha. Fiskultura dhe sporti janë bërë të masave dhe ndihmojnë në edukimin komunist të punonjësve, sidomos të rinisë, për forcimin e shëndetit, përgatitjen e tyre për punë dhe për mbrojtjen e atdheut socialist. Gjatë vjetëve të pushtetit popullor është kapërcyer prapambetja që ekzistonte më parë në lëmin e edukimit fizik. Në vendin tonë është krijuar një sistem unik shkencor i edukimit fizik. Me dhjetëra mijë të rinj e të reja, punonjës të qytetit e të fshatit ushtrojnë fiskulturën dhe sportin. Vetëm gjatë vitit 1961, në aktivitetet e organizuara sportive, u aktivizuan mbi 120 000 vetë. Pjesëmarrja e gjerë e rinisë në fiskulturë e sport ka bërë që të vendosen rekorde të reja e norma më të larta, ka krijuar mundësitë për thyerjen e të gjitha rekordeve të mëparshme.

Sukseset e arritura në fushën e kulturës fizike dhe të sportit janë dëshmi e gjallë e kujdesit të madh që tregon Partia për edukimin e gjithanshëm të brezit të ri. Ato flasin qartë mbi epërsinë dhe forcën vitale të rendit tonë socialist mbi rendin kapitalist, tregojnë se në vendin tonë janë krijuar kushtet dhe mundësitë që fiskultura dhe sporti të bëhen elemente të veprimtarisë së përditshme të çdo qytetari të Republikës sonë duke filluar nga mosha e fëmënisë.

Me gjithë përparimet e arritura, akoma vërehen disa të meta, të cilat pengojnë zhvillimin e mëtejshëm të fiskulturës e sportit në mënyrë që ato t'u përgjigjen kërkesave të kohës. Kongresi IV i Partisë së Punës të Shqipërisë porosi që fiskultura dhe sporti të synojnë për përgatitjen fizike të masave punonjëse, e sidomos të rinisë, t'i bëjnë ato të forta fizikisht dhe të afta për të

kapërcyer çdo vështirësi, me moral të lartë, me vullnet të çelnik-të, siç e kërkon koha, siç e kërkon ndërtimi socialist në vendin tonë.

Për të vënë në jetë vendimet e Kongresit IV të Partisë dhe me qëllim që fiskultura dhe sporti të përmbushin në të ardhshmen më mirë misionin e tyre fisnik për edukimin e një brezi të ri, të shëndetshëm, të fortë, të guximshëm, të gëzuar, të aftë për të rritur lavdinë e atdheut tonë socialist dhe ta mbrojnë atë nga çdo armik, Komiteti Qendror i PPSH vendosi t'u bëjë të rinjve të Shqipërisë, prindërve, edukatorëve, drejtuesve e kuadrove të fiskulturës, organizatave të masave dhe enteve shtetërore rekomandimet e mëposhtme.

I

Fiskultura dhe sporti duhet të hyjnë në jetën e përditshme të masave tona punonjëse dhe sidomos të rinisë së vendit tonë, kudo ku ajo punon e mëson. Kjo është e domosdoshme për të pasur shëndet të mirë dhe për t'i shërbyer më mirë dhe sa më gjatë çështjes së madhe të Partisë dhe të popullit. Fiskultura dhe sporti i bëjnë gjymtyrët më të forta dhe më të afta, syrin më të mprehtë, trupin më të shkathët e të kalitur, mendjen më të qartë e krijuese, nervat të shëndoshë dhe shpirtin të gëzuar.

Fiskultura dhe sporti zënë një vend të rëndësishëm në realizimin e qëllimit të lartë të Partisë sonë, ngritjes së mirëqenjes së popullit, sigurimit të jetës sa më të lumtur dhe të gëzuar të tij, sepse mirëqenja dhe jeta e gëzuar janë të lidhura me socializmin, që po lulëzon në vendin tonë, por edhe me shëndetin e mirë, me jetën e gjatë dhe aftësinë për punë.

1. — Komiteti Qendror i PPSH thekson se detyrat kryesore në sektorin e kulturës fizike e të sportit janë zhvillimi masiv i lëvizjes fiskurale, ngritja e mëtejshme e cilësisë sportive dhe mbi këtë bazë, përfaqësimi i denjë i vendit tonë në arenën sportive ndërkombëtare për degët kryesore të sportit.

Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë, duke i dhënë një rëndësi të madhe shtetërore zhvillimit të mëtejshëm të kulturës fizike e sportit në vendin tonë porosit Ministrinë e Arësimit dhe të Kulturës, organizatën e BFSSH, organizatat e Partisë, të BRPSH dhe të BPSH të mënjanojnë dobësitë që ekzistojnë në lëmin e kulturës fizike e të sportit dhe të sigurojnë zhvillimin e tyre më masiv midis punonjësve të qytetit e të fshatit.

Përhapja dhe zhvillimi i mëtejshëm i fiskulturës dhe sportit, gjallërimi më i madh i jetës sportive nëpërmjet lojnavë popullore, zhvillimi i gjimnastikës në kuptimin e gjerë, shfrytëzimi i faktorëve natyralë dhe higjienikë — diellit, ajrit, ujit, përhap-

ja e sporteve në masë dhe sidomos e turizmit të brendshëm, i cili luan një rol të madh edukativ e patriotik, të gjitha këto kërkojnë sot që t'u kushtohet një vëmendje e posaçme jo vetëm nga organizatat e fiskulturës, por edhe nga organizatat e Partisë, të rinisë dhe nga organet e pushtetit. Rritja e aftësisë fizike, edukimi i gjithanshëm dhe harmonik i popullit, sidomos i brezit tonë të ri, është problem kombëtar, problem i Partisë dhe i pushtetit tonë popullor.

2. — Të sigurohet zhvillimi masiv i llojeve kryesore të sporteve në kolektivat e qendrave të punës dhe në shkollat, sidomos gjimnastika, atletika e lehtë, volejboli, noti, basketboli, futboli etj. dhe të organizohen rregullisht ekskursionet, kroset, spartakiadat, duke tërhequr në sport një masë gjithnjë e më të madhe.

Është e nevojshme që organizatat e Partisë, të BRPSH, të BPSH t'i kushtojnë një kujdes më të madh zhvillimit të sporteve ushtarake dhe veçanërisht aktivizimit të masave në SHNUM.

Kujdes i posaçëm i duhet kushtuar zhvillimit të fiskulturës me të rejat. Në qoftë se vajzat do të merren me fiskulturë dhe sport, ato do të gëzojnë shëndet të plotë, do të jenë luftëtare të afta për ndërtimin e plotë të socializmit dhe të komunizmit. Kjo është e lidhur veçanërisht me misionin e tyre të ardhshëm si nëna, sepse në prehërin e nënave rriten gjeneratat e ardhshme, të cilat duhet të përgatiten të forta dhe të denja për ta ngritur edhe më lart flamurin e Partisë sonë të Punës. Organizatat e Partisë dhe të rinisë, si edhe organizatat e gruas e të BPSH të aktivizojnë më mirë femrat, si në spartakiada të veçanta më të rejat edhe në aktivitetet e tjera të fiskulturës dhe të sportit.

Shtëpitë e pushimit të bashkimeve profesionale të bëhen qendra për çlodhjen aktive të punonjësve, për kalitjen e tyre fizike, duke zhvilluar notin, turizmin e alpinizmin, lojnat sportive, gjimnastikën higjienike etj.

3. — Faktor i rëndësishëm drejtues i punës për edukimin fizik të masave janë kuadrot. Ky problem merr edhe më shumë rëndësi po të kemi parasysh zgjerimin e lëvizjes fiskuralo-sportive. Të organizohet përgatitja e kuadrove shoqërore të fiskulturës, të kualifikohen instruktorët, mësuesit dhe edukatorët e rinisë me anën e kurseve, seminarëve si dhe në shkollat pedagogjike e në Institutin e fiskulturës. Instruktori i fiskulturës dhe mësuesit duhet të jenë jo vetëm pedagogë të mirë, por edhe aktivistë dhe edukatorë të vërtetë, udhëheqës të denjë dhe organizatorë të aftë të masave për realizimin e detyrave të Partisë.

4. — Komiteti Qendror i PPSH porosit Ministrinë e Arësimit dhe të Kulturës të përmirësojë edukimin fizik të fëmijëve të moshave parashkollore, të nxënësve dhe studentëve, të marrë masat e nevojshme për realizimin e plotë të programit mësimor të edukatës fizike, duke ngritur nivelin e punës mësimore, duke or-

ganizuar më mirë aktivitetin jashtëshkollor, punën në rrethet dhe në shkollat sportive të fëmijëve dhe të rinisë. Të organizohen me cilësi të lartë spartakiadat dhe manifestimet, të krijohen kushtet e domosdoshme të bazës materiale si terrenet sportive për fëmijët, të sigurohet inventari sportiv, sidomos për gjimnastikën dhe atletikën e lehtë, duke bërë të mundshëm realizimin e detyrës, që brenda vitit 1962 të gjitha shkollat të kenë inventarin e nevojshëm sipas normativës.

a) Edukimi i gjithanshëm i njeriut, ndërtues i shëndetshëm, aktiv dhe i ndërgjegjshëm i socializmit, fillon që nga fëmënia. Edukimi fizik i fëmijëve duhet të hedhë bazat e zhvillimit fizik normal të brezit të ri, ta pajisë atë me shprehitë higjienike e fizike të nevojshme, ta kalitë fëmijën për veprimtarinë e tij të ardhshme. Organizimi i mirë i edukimit fizik në institucionet parashkollore është hapi i parë drejt zhvillimit të gjithanshëm të aftësive fizike të brezit të ri, që rritet dhe edukohet në shkollat. Lojnat, ushtrimet fizike e gjimnastikore, ajri, uji e dielli janë mjete të rëndësishme për rritjen e mirë të fëmijëve. Prandaj, programi i kopshteve të përmbajë lodra dhe ushtrime të përshatshme për moshën e fëmijëve dhe ato të pajisen me mjetet e nevojshme për edukimin fizik të fëmijëve.

b) Edukimi fizik në shkolla, si pjesë organike e edukimit komunist të rinisë, duhet të bëhet në unitet me edukimin mendor, politeknik, moral dhe estetik.

Shkolla jonë e re duhet ta edukojë të riun e të renë në mënyrë të gjithanshme, si nga ana mendore ashtu edhe fizike, që ata të dinë të veprojnë shpejt e bukur, të jenë të zhvilluar në mënyrë harmonike dhe të shëndetshëm, të gatshëm për të luftuar dhe kapërcyer çdo vështirësi. Kjo do të arrihet në qoftë se mësimi i edukatës fizike do të çmohet si një nga mësimet kryesore, krahas me lëndët e tjera.

Nëpër bankat e shkollës kalon e gjithë rinia e vendit tonë. Nga puna e drejtorive, këshillave pedagogjike të shkollave, mësuesve të edukatës fizike, të cilëve u është besuar detyra e shenjtë dhe me përgjegjësi e edukimit të brezit të ri, varen shumë shëndeti dhe përgatitja fizike e rinisë sonë, sikurse dhe e ardhshmja e lëvizjes sonë fiskulturalo-sportive.

Në qoftë se shkolla jonë do ta kryejë këtë mision të lartë si duhet, atëherë fiskultura dhe sporti në vendin tonë do të ecin me një shpejtësi edhe më të madhe drejt masivititetit dhe mjeshtërisë sportive.

Ministria e Arësimit dhe e Kulturës, seksionet e arësimit, dhe personeli arësitor në shkolla, të marrin masa për një vlerësim më të drejtë të fiskulturës në shkollat tona, sidomos në shkollat fillore, ku puna është edhe më e dobët. Universiteti shtetëror

dhe institutet e larta duhet të luajnë një rol edhe më të madh për rezultate më të mira në këtë drejtim.

Të punohet për krijimin e kushteve të nevojshme për realizimin e plotë dhe me cilësi të programit mësimor dhe aktivitetit jashtëshkollor, duke pasur si bazë kompleksin «Bëhu Gati për Punë e Mbrojtje» (BGPM) dhe «Gati për Punë dhe Mbrojtje» (GPM).

I rekomandohet Këshillit të Ministrave të RPSH të marrë masat që shkollat e reja që do të ngrihen të jenë të pajisura me salla për mësimin e edukatës fizike dhe me kënde sportive.

Gjithashtu, nëpër rrethet kryesore të vendit, krahas me shtëpitë e pionierit, të ketë edhe parqe të pionierëve për aktivitetin sportiv të organizuar jashtëshkollor, si dhe një numër sheshesh sportive nëpër lagje.

c) Në misionin e lartë të edukimit të brezit të ri një rol të madh duhet të luajnë prindërit. Detyra e tyre është që të ngjallin te fëmijët interesin për ushtrimet fizike dhe për sportin.

Regjimi i ditës i fëmijëve fillon që në shtëpi, nën drejtimin e prindërve, nëpërmjet gjimnastikës së mëngjezit dhe procedurave të ujit dhe fërkimit. Prindërit duhet të kujdesen që të kontrollojnë, të drejtojnë dhe, në bashkëpunim me shkollën dhe organizatën e pionierit, të organizojnë lojnat e fëmijëve, në mënyrë që ato të vlejnjë për edukimin e përgjithshëm dhe veçanërisht për edukimin fizik të tyre.

Të merren masa që të prodhohen lodra, të cilat zhvillojnë te fëmija aftësitë fizike e mendore dhe cilësitë e nevojshme për jetën dhe punën e ardhshme.

5. — Fiskultura e sporti rritin entuziazmin, forcat dhe energjitë e rinisë, e bëjnë atë më të gatshme dhe më të aftë për punë. Lidhja e edukimit fizik me detyrën për përgatitjen e rinisë sonë për punë aktive duhet të jetë një nga karakteristikat më të rëndësishme të sistemit tonë të edukimit fizik.

Organizatat e BPSH, drejtoritë e ndërmarrjeve, organizatat e BRPSH në qendrat e punës, punonjësit e pararojës duhet ta konsiderojnë fiskulturën dhe sportin si një mjet për ruajtjen dhe forcimin e shëndetit të punëtorëve, për rritjen e rendimentit në punë, për realizimin e planit të shtetit në sasi e në cilësi, për çlodhjen aktive të punëtorëve, për mënjanimin e sëmundjeve profesionale. Për këtë të zhvillohet gjimnastika e mëngjezit dhe e prodhimit dhe të tërhiqen në aktivitetin sportiv të organizuar masa e punëtorëve, sidomos të rinjtë. Në ballë të kësaj lëvizjeje fiskurale masive të vihen brigadat e punës socialiste. Drejtoritë e ndërmarrjeve të përkrahin iniciativat e rinisë punëtore për ndërtimin e fushave të thjeshta sportive pranë ndërmarrjeve dhe problemin e edukimit fizik, të çlodhjes aktive e të dëfrimit

të kulturuar të punëtorëve, të mos e konsiderojnë të shkëputur nga kujdesi i tyre për realizimin e planit të prodhimit.

6. — Kolektivizimi i bujqësisë ka ndërruar pamjen e fshatit, ka përmirësuar shumë jetën e fshatarësisë dhe ka krijuar kushte të favorshme për zhvillimin e fiskulturës e të sportit në fshatin tonë të ri.

Në fshat jeton dhe punon pjesa dërmuese e rinisë sonë. Që rinia fshatare të rritet e të edukohet e shëndetshme, e gëzuar, e fortë fizikisht dhe e pajisur me veti të larta morale si guximi, këmbëngulja, shpirti vetëmohues, vullneti e vendosmëria në luftën për ndërtimin e socializmit në fshat, Komiteti Qendror i PPSH porositi organizatat e BRPSH që të përmirësojnë punën e edukimit fizik me rininë fshatare, të forcojnë e të zgjerojnë kolektivat fiskulturalë, të organizojnë aksionet sportive masive, spartakiadat dhe dhënjen e normave të kompleksit GPM. Detyrat kryesore për zhvillimin masiv të fiskulturës e sportit në fshat janë përgatitja e kuadrove shoqërore, forcimi i punës për edukimin fizik të fëmijëve në shkollë, ngritja e terreneve të thjeshta sportive, agjitacioni dhe propaganda për të tërhequr në aktivitetet sportive gjithë rininë fshatare, organizimi i ndihmës së organizatave fiskurale të qytetit për fshatin.

Spartakiada e parë kombëtare për kooperativat dhe ndërmarrjet bujqësore të bëhet një aksion i vërtetë, objektivat e së cilës t'i arrijë rinia sportive e fshatit tonë të ri, duke realizuar numrin e të aktivizuarve, numrin e sportistëve të kategorizuar dhe ndërtimin e terreneve të thjeshta sportive. Brenda 2 vjetëve të ardhshëm, në çdo kooperativë të zmadhuar të ndërtohen qendra sportive që t'u përgjigjen nevojave të aktivitetit sportiv, ndërsa në sektorë të ketë fusha të thjeshta.

Të sigurohen mësuesit e edukatës fizike në shkollat 7-vjeçare të fshatit, duke e organizuar punën që ata të japin mësim në shkollat e afërme të zonës. Këta mësues të luajnë rolin e organizatorit të fiskulturës në atë zonë.

Spartakiada kombëtare e kooperativave dhe e ndërmarrjeve bujqësore të zhvillohet rregullisht çdo dy vjet.

II

Komiteti Qendror i PPSH porositi Ministrinë e Arësimit dhe të Kulturës, organizatat fiskurale e sportive, organizatat e Partisë që ngritjen e mëtejshme të cilësisë sportive ta konsiderojnë si një nga detyrat më të rëndësishme në lëmin e kulturës fizike e të sportit. Klubet sportive «Partizani», «Dinamo», Universiteti shtetëror i Tiranës, qyteti i Tiranës, rrethet e Shkodrës,

Korçës, Durrësit, Vlorës, Elbasanit, në kuadrin e Spartakiadës së dytë kombëtare, të ngrenë nivelin e cilësisë sportive, për degët kryesore të sporteve në nivelin e rekordeve dhe rezultateve kombëtare dhe, mbi këtë bazë, sportistët më të mirë të vendit tonë të arrijnë nivelin e cilësisë të vendeve të përparuara.

Rritja e kërkesave të cilësisë në lëvizjen sportive t'u përgjigjet suksesëve madhështore që janë arritur në të gjithë sektorët e jetës sonë ekonomike e shoqërore, ritmeve të jetës sonë të re. Lufta këmbëngulëse për zbatimin e normave të përfaqësimit në aktivitetet kombëtare për ngritjen e vazhdueshme të kërkesave dhe normave teknike sportive të bëhet një stimul i fuqishëm drejt majave të mjeshtërisë së lartë sportive.

Përfaqësimi i denjë i ngjyrave sportive të kolektivit fiskultural të rrethit e klubit sportiv, i ngjyrave kombëtare, duke ruajtur dhe zhvilluar më tej traditat sportive, duhet të konsiderohet si një nder i madh dhe njëkohësisht detyrë shoqërore me përgjegjësi, për realizimin e së cilës duhet luftuar pa kursyer forcat fizike e morale. Komitetet ekzekutive dhe komitetet e Partisë, përfaqësimin me sukses të rretheve të tyre në aktivitetet kombëtare nuk duhet ta shkëputin nga lufta dhe puna që bëjnë për të zënë vend nderi në garat socialiste të shpallura me rrethet e tjera.

Në lëvizjen tonë sportive duhet të marrin pjesë mijëra të rinj e të reja, sepse nga gjiri i kësaj mase sportistësh do të dalin më shpejt e më lehtë talentet, të cilat janë të shumta në rininë tonë të mrekullueshme, mjeshtrit dhe rekordmenët e ardhshëm të aftë për ta ngritur më lart flamurin e sportit tonë të ri.

Përgatitja dhe edukimi i sportistit është një proces edukativo-mësimor vjetor e shumëvjetor, i organizuar në baza shkencore. Trainerët tanë, edukatorë të sportistëve dhe të mjeshtërvë, duhet të përmirësojnë punën pedagogjike mësimore, të rritin njohuritë e tyre me shkëmbimin e eksperiencës së përparuar dhe me të dhënat e reja metodike, teknike e taktike. Ministria e Arësimit dhe e Kulturës, nëpërmjet Komitetit të Kulturës Fizike dhe të Sporteve, të marrë masat e nevojshme për përgatitjen dhe kualifikimin e trainerëve duke krijuar kushtet e duhura që sportistët e talentuar të ndjekin Institutin e lartë të fiskulturës dhe mjeshtrit e sportit me eksperiencë të gjatë, si dhe trainerët shoqërorë, të kualifikohen me anën e kurseve njëvjeçare dhe seminareve.

Me qëllim që të përpunohen çështjet e edukimit fizik, për punën masive dhe mjeshtërinë e lartë, të krijohet pranë Institutit të fiskulturës «Vojo Kushi» qendra shkencore metodike, e cila të merret me studimin e problemeve të teorisë, me metodikën e teknikës së sporteve. Për ruajtjen dhe forcimin e shëndetit të sportistëve dhe me qëllim që trainerët të nxjerrin konkluzione shkencore nga stërvitjet me sportistët, Komiteti i Kulturës Fizike dhe i Sporteve në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndet-

tësisë, të organizojnë kontrollin mjekësor sistematik të të gjithë sportistëve përfaqësues, me perspektivë. Një punë e tillë të bëhet edhe në rininë tonë shkollorë.

Ngritja e cilësisë sportive në nivelin e kërkesave të kohës dhe frekuentimi gjithnjë e më i madh i fushave sportive nga rinia sportdashëse bëjnë të domosdoshëm zgjerimin e mëtejshëm të bazës materiale sportive. Për këtë duhet të kujdesen në mënyrë të veçantë komitetet ekzekutive dhe komitetet e Partisë duke parashikuar objekte të tilla në planet rregulluese të qyteteve dhe duke përkrahur iniciativat për ndërtimin e tyre.

Komiteti Qendror i PPSH i rekomandon Këshillit të Ministrave që çështjen e investimeve sportive ta studjojë në përputhje me detyrat e reja që i shtrohen lëvizjes fiskurale e sportive në vendin tonë, në drejtim të rritjes së masivitetit dhe të ngritjes së cilësisë sportive me ritme më të shpejta.

Propaganda për fiskulturën dhe sportin duhet të zgjerohet dhe të pasurohet me mjete dhe në forma të ndryshme. Ajo duhet t'ua bëjë të qartë masave punonjëse rëndësinë e madhe të zhvillimit të fiskulturës e sportit dhe detyrat që ka çdo punonjës, çdo i ri dhe çdo e re në këtë drejtim. Duhet të bëhet e qartë se të mërrsh me fiskulturë e sport nuk do të thotë vetëm të kalosh kohën në një mënyrë të këndshme dhe të gëzuar, por të kryesh një detyrë të madhe për përgatitjen fizike dhe për të qenë i gatshëm për punë dhe për mbrojtje. Duhet të bëhet e qartë se shëndeti i secilit, përgatitja fizike, varet shumë nga ai vetë, nga mënyra se si ai e organizon regjimin e punës dhe të pushimit, se si e përgatit fizikun dhe e kalit atë me anën e ushtrimeve fiskuralo-sportive dhe me anën e shfrytëzimit të elementëve të natyrës — diellit, ajrit dhe ujit. Këto e bëjnë fizikun të aftë t'u rezistojë sëmundjeve, të ftohtit, të nxehtit dhe t'i kapërcejë vështirësitë me lehtësi.

Një vëmendje më e madhe duhet t'i kushtohet edukimit të sportistëve në mënyrë që shfaqjet e huaja të mos kenë vend në asnjë nga fushat tona sportive. Sporti ynë popullor duhet të përshkohet nga idetë e Partisë sonë dhe të luftojë çdo ndikim të sportit borgjez e dekadent.

*
*
*

Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë shpreh bindjen se në saje të punës së organizatave shtetërore, të organizatave të masave dhe të organizatave të Partisë, në saje të mobilizimit të rinisë, të edukatorëve dhe kuadrove të fiskulturës, fis-

kultura dhe sporti do të bëhen të masave punonjëse të qytetit dhe të fshatit, cilësia sportive do të rritet në një nivel më të lartë, se detyrat që caktoi Kongresi IV i PPSH në lëmin e kulturës fizike e të sportit do të realizohen me sukses.

KOMITETI QENDROR I PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË

*Botohet sipas broshurës:
Vendim i Komitetit Qendror
të PPSH «Mbi zhvillimin e
mëtejshëm të fiskulturës dhe
sportit».*

Tiranë, 1962

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Zëri i Popullit»,
Nr. 80, 4 prill 1962*

PLENUMI VII I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Tiranë, 18-19 korrik 1962

KOMUNIKATË

E PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË

Më 18 dhe 19 korrik 1962 u mbledh Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë nën kryesinë e Sekretarit të Parë të Komitetit Qendror të Partisë, shokut Enver Hoxha.

Plenumi dëgjoi raportin e Byrosë Politike të Komitetit Qendror «Mbi përmirësimin e mëtejshëm të punës për përgatitjen dhe kualifikimin e kuadrit», mbajtur nga anëtari i Byrosë Politike të Komitetit Qendror, shoku Manush Myftiu dhe aprovoi vendimin përkatës.

Në mbledhjen e Plenumit të Komitetit Qendror mbajti një fjalim Sekretari i Parë i Komitetit Qendror të PPSH, shoku Enver Hoxha.

Në punimet e Plenumit të Komitetit Qendror muarën pjesë si të ftuar sekretarët e parë të komiteteve të Partisë dhe kryetarët e komiteteve ekzekutive të këshillave popullore të rretheve, kuadro kryesorë të aparateve qendrore të Partisë e të pushtetit, drejtues e specialistë nga shkollat dhe qendrat e punës, kuadro të organizatave të masave e të shtypit.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

VENDIM

I PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH «MBI PËRMIRËSIMIN E MËTEJSHËM TË PUNËS PËR PREGATITJEN DHE KUALIFIKIMIN E KUADRIT»

19 korrik 1962

Rezultatet e mëdha që janë arritur në ndërtimin socialist të vendit tonë, e kanë burimin në punën vetëmohuese të masave punonjëse, në vijën e drejtë marksiste-leniniste të Partisë sonë të

Punës si dhe në ndihmën e vendeve të kampit socialist. Për arritjen e këtyre sukseseve një meritë e veçantë u takon kuadrove, specialistëve dhe teknikëve tanë të mrekullueshëm, inteligjencies popullore, që rriti dhe edukoi Partia në zjarrin e revolucionit popullor dhe në punën për ndërtimin socialist të vendit.

Partia jonë e ka pasur gjithmonë të qartë se përgatitja me ritme të shpejta e kuadrove të nevojshëm ka qenë dhe është një nga detyrat më kryesore për fitoren e rendit socialist në vendin tonë.

Përgatitja brenda një kohe shumë të shkurtër e një armate të madhe kuadrosh, besnikë ndaj çështjes së popullit dhe të Partisë, të aftë për të kryer me sukses detyrat e mëdha të ndërtimit socialist, për të kapërcyer prapambetjen e trashëguar nga e kaluara, vështirësitë e rritjes dhe pengesat e shumta që na kanë krijuar e na krijojnë në rrugën tonë imperialistët dhe revizionistët modernë, është një nga fitoret më të shkëlqyera të Partisë sonë, të vijës së saj të drejtë marksiste-leniniste.

Si rezultat i punës së madhe që ka bërë Partia dhe i ndihmës që na kanë dhënë Bashkimi Sovjetik e vendet e demokracisë popullore janë arritur suksese të mëdha në përgatitjen dhe në kualifikimin e kuadrit.

Sot në vendin tonë përgatiten kuadro për të gjitha degët kryesore të ekonomisë e të kulturës popullore.

Ndërsa para çlirimit kishte 1 600 mësues, shumica e të cilëve ishin për shkollat fillore, 380 kuadro të lartë dhe një numër shumë të kufizuar teknikësh të mesëm, sot kemi 6 000 kuadro të lartë, 21 600 kuadro me arësim të mesëm profesional e kurse dhe rreth 95 000 punëtorë të kualifikuar.

Në arësimin e ulët tekniko-profesional, në shkolla e kurse, mësojnë 42 700 vetë, në shkollat e mesme dhe gjysmë të larta profesionale — 12 400 dhe në shkollat e larta — 4 600. Veç këtyre, mësojnë pa u shkëputur nga prodhimi, në shkollat e mesme profesionale — 6 500 dhe në shkollat e larta — 2 900 vetë.

Për përgatitjen e shpejtë të kuadrove pranë fakulteteve të shkollave të larta janë çelur kurse dy e trevjeçare dhe pranë shkollave të mesme profesionale shkolla dyvjeçare të punëtorëve, ku janë përgatitur me mijëra kuadro të mesëm e të lartë. Është rritur numri i shkollave të ulëta e të mesme profesionale, i shkollave të larta, si dhe i degëve e i specialiteteve të tyre. Në shkollat e ulëta profesionale ka 28 specialitete, në shkollat e mesme profesionale e gjysmë të larta — 57 dhe në ato të larta — 42. Pranë shkollave të larta është organizuar aspirantura.

Për arësimin popullor dhe për format e tjera të përgatitjes dhe të kualifikimit të kuadrove, shteti ynë ka caktuar dhe shpenzon çdo vit shuma të mëdha, të cilat këtë vit arrijnë në 2 miliard e 505 milion lekë. Rreth 70 për qind e nxënësve të teknikumeve

dhe 90 për qind e studentëve mësojnë me shpenzimet e plota të shtetit.

Është krijuar inteligjencia e re popullore, e përbërë nga bijtë e bijat e masave punonjëse, e lidhur ngushtë me popullin e Partinë. Nën udhëheqjen e drejtë të Partisë, inteligjencia popullore është bërë një forcë e madhe në ndërtimin e socializmit dhe i ka vënë të gjitha energjitë e saja krijuese në shërbim të popullit dhe të atdheut. Teknikët dhe specialistët tanë të talentuar po zgjidhin probleme të rëndësishme në dobi të zhvillimit të mëtejshëm të prodhimit dhe të përparimit teknik.

Plenumi i Komitetit Qendror vëren se detyrat e caktuara nga Kongresi IV i Partisë për pregatitjen dhe kualifikimin e kuadrit gjatë pesëvjeçarit të tretë, në përgjithësi, po kryhen në mënyrë të kënaqshme.

Por megjithkëtë në punën për pregatitjen dhe kualifikimin e kuadrit vihen re edhe të meta. Ka deficite në plotësimin e planit të nxënësve e të studentëve për disa degë të ekonomisë e të kulturës, ka mungesa të ndieshme për punëtorë të kualifikuar të kategorive të larta. Dobësi vihen re edhe në punën mësimore të arësimit tekniko-profesional të ulët, të arësimit të mesëm profesional dhe të lartë. Për kualifikimin e mëtejshëm dhe përdorimin sa më racional të specialistëve nuk bëhet një punë e organizuar, ashtu si duhet, në përshtatje me kërkesat e zhvillimit ekonomik e kultural të vendit.

Etapa e re e ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste në të cilën ka hyrë vendi ynë, ndërtimi me ritme të shpejta i bazës materiale-teknike të socializmit, shndërrimi i vendit tonë nga një vend agraro-industrial në një vend industrialo-agrar, përparimi teknik dhe zhvillimi i shkencës kërkojnë përmirësimin e mëtejshëm të punës për pregatitjen, kualifikimin dhe edukimin e kuadrit.

Zhvillimi dhe thellimi akoma më shumë i revolucionit kultural në vendin tonë është i domosdoshëm për të siguruar rritjen e numrit dhe të aftësive të punonjësve, të personelit inxhiniero-teknik, të kuadrove drejtues dhe të specialistëve të degëve të ndryshme të ekonomisë e të kulturës.

Plenumi i Komitetit Qendror, duke pasur parasysh detyrat që shtroi Kongresi IV i Partisë për pregatitjen dhe kualifikimin e kuadrit, duke u mbështetur në forcat krijuese të punonjësve, të teknikëve e specialistëve tanë dhe në kushtet e reja të zhvillimit të vendit tonë,

Vendosi:

I

Mbi sigurimin e kuadrit për pesëvjeçarin e tretë

1. — Në vitin 1965 do të kemi gjithsej 9 800 kuadro me arësim të lartë, ose 3 800 më shumë nga sa kemi sot dhe 25 500 kuadro me arësim të mesëm, ose 9 500 më shumë. Në këtë mënyrë do të plotësohen detyrat e planifikuara për vjetët 1960-1965 për kuadro të lartë e të mesëm.

Më 1965 numri i punëtorëve të kualifikuar do të arrijë gjithsej në 133 000, të cilët do të përfaqësojnë 74 për qind të numrit të përgjithshëm të punëtorëve.

Plotësimi i këtyre detyrave që ka caktuar Kongresi IV i Partisë është i domosdoshëm, po të kemi parasysh se me gjithë rezultatet e mëdha që do të arrihen, në vitin 1965 do të kemi përkundrejt nevojave, akoma mbi 11 000 vende pune ku do të punojnë kuadro pa pregatitjen e duhur arësimore. Prandaj, t'i kushtohet më tepër kujdes pregatitjes së kuadrit në të gjithë sistemin e saj.

a) Rëndësi e posaçme t'i jepet sigurimit dhe ruajtjes së kontingjenteve të nxënësve dhe studentëve në të gjitha hallkat e arësimit të përgjithshëm dhe profesional. Çdo sektor e rreth, çdo ndërmarrje e kooperativë bujqësore jo vetëm duhet të realizojë plotësisht planin e kontingjenteve në përgjithësi, por edhe veç e veç për çdo degë apo specialitet. Gjithashtu të punohet me perspektivë për të plotësuar nevojat e kuadrit për të gjitha degët.

Kooperativat bujqësore duhet t'i sigurojnë vetë nevojat për kuadro teknike, duke dërguar nxënës për t'u pregatitur në shkollat e ndryshme profesionale me shpenzimet e tyre, ose të vetë familjeve kooperativiste.

b) Kujdes i veçantë t'i kushtohet sigurimit të kuadrove të nevojshëm për veprat e reja që do të vihen në shfrytëzim. Për këtë duhet jo vetëm të planifikohen mirë nevojat, por edhe të merren të gjitha masat për plotësimin e kontingjenteve dhe për pregatitjen e tyre me kohë.

c) Duke pasur parasysh se një e pesta e kuadrit për pesëvjeçarin e tretë do të sigurohet nga arësimi i mbrëmjes e me korrespondencë, organet shtetërore dhe ekonomike, institucionet dhe organet arësimore, organizatat e Partisë e të masave t'i kushtojnë shumë më tepër vëmendje pjesëmarrjes sa më të gjerë të punonjësve në shkollat e mbrëmjes e me korrespondencë dhe të ndjekin sistematikisht mbarëvajtjen e tyre në mësim.

ç) Për të arritur përqindjet e caktuara të kuadrit arësitor me arësimin përkatës, të çelen shkolla të mesme trevjeçare të kulturës së përgjithshme me nxënës nga fshati, të cilët, menjë-

herë pas mbarimit të këtyre shkollave, të ndjekin të gjithë pa përjashtim institutet pedagogjike dyvjeçare.

Të hapen pranë instituteve pedagogjike dyvjeçare kurse të shpejta, për t'u dhënë arësimin përkatës mësuesve të shkollave 7-vjeçare që nuk kanë arësimin e duhur. Të studjohet mundësia për të çelur institute të tjera pedagogjike dyvjeçare.

Ministria e Arësimit dhe e Kulturës, organet shtetërore në qendër e në bazë si dhe organizatat e Partisë e të rinisë të marrin të gjitha masat për organizimin e këtyre formave, për përgatitjen e shpejtë të mësuesve dhe për sigurimin e kontingjentëve, me qëllim që ato të hapen në vitin shkollor 1962-1963.

d) Dikasteret ekonomike, në bashkëpunim me Komisionin e Planit të Shtetit dhe me Ministrinë e Arësimit dhe të Kulturës, të rishikojnë mundësinë e bashkimit, ndarjes ose krijimit të degëve të reja në disa teknikume e shkolla të larta dhe propozimet përkatëse t'ja paraqesin për aprovim Këshillit të Ministrave brenda vitit 1962.

2. — Plenumi i Komitetit Qendror porositi Këshillin e Ministrave që, brenda vitit 1963, të hartojë planin orientues perspektiv të përgatitjes së kuadrit, duke u bazuar në zhvillimin perspektiv ekonomik e kultural të vendit tonë.

II

Mbi përgatitjen dhe rritjen e kualifikimit të punëtorëve

Zbatimi i detyrave që shtroi Kongresi IV i Partisë për përvetësimin dhe shfrytëzimin sa më të plotë të teknikës dhe teknologjisë së prodhimit, për rritjen e pandërprerë të rendimentit në punë, për zhvillimin e mëtejshëm të prodhimit shoqëror, *kërkon që t'i kushtohet shumë më tepër kujdes përgatitjes dhe, veçanërisht, rritjes së kualifikimit të punëtorëve.*

1. — Me gjithë sukseset e arritura, Plenumi i Komitetit Qendror vërejtë se puna e bërë deri tani për rritjen e kualifikimit të punëtorëve nuk është në nivelin e kërkesave të Kongresit IV të Partisë. Në disa degë kryesore të ekonomisë ka mungesa të ndieshme për punëtorë të kualifikuar dhe veçanërisht për punëtorë të kategorive të larta.

Prandaj, puna për rritjen e kualifikimit të punëtorëve duhet të synojë, në radhë të parë, në zvogëlimin e vazhdueshëm të shpërpjesëtimit midis nivelit të lartë të teknikës dhe nivelit relativisht të ulët tekniko-profesional të punëtorëve.

a) Duke pasur parasysh detyrën që gjatë planit të tretë pesëvjeçar do të kualifikohen 118 000 punëtorë, organet ekonomike, organizatat e Partisë dhe ato të Bashkimeve Profesionale duhet

t'i kushtojnë më tepër vëmendje punës që punëtorët të ndjekin kurset dhe format e tjera të kualifikimit dhe të përfitojnë sa më shumë.

b) Organet shtetërore dhe ekonomike të tregojnë kujdes të posaçëm për përmbajtjen e punës së kurseve të kualifikimit në përshtatje me nevojat e teknikës së prodhimit. Për këtë të rishikohen programet dhe, brenda vitit 1963, të hartohen programet tip për çdo profesion. Këto programe të konkretizohen në vend, sipas nevojave të çdo ndërmarrjeje, pa ulur kërkesat e detyrueshme.

c) Të synohet që në kurset dhe në format e tjera të rritjes së kualifikimit pa shkëputje nga puna të marrin pjesë, në radhë të parë, punëtorë që merren drejtpërdrejt me teknikën dhe të së njëjtës kategori, sidomos të përgatiten punëtorë për ato kategori për të cilat kemi më tepër nevojë.

ç) Për të zbatuar detyrën që shtroi Kongresi IV i Partisë, lidhur me rritjen e kualifikimit të punëtorëve, Këshilli i Ministrave brenda vitit 1962, të rishikojë dispozitat që rregullojnë kohën e paraqitjes së tyre në komisionet e kualifikimit.

d) Në kualifikimin e punëtorëve një vend të rëndësishëm duhet të zënë edhe format e tjera që praktikohen në ndërmarrjet dhe organizatat ekonomike, siç është metoda e njohur «1+2», përgatitja e punëtorëve që të përvetësojnë dy e më shumë profesione, sidomos në ndërtim, në bujqësi dhe në degë të tjera me karakter stinor prodhimi.

2. — *Plenumi i Komitetit Qendror e quan të domosdoshme të ritheksojë se rritja e kualifikimit të punëtorëve duhet të shoqërohet edhe me ngritjen e nivelit arësimor të nevojshëm, sidomos për punëtorët e atyre profesioneve që kërkojnë një përgatitje më të madhe tekniko-profesionale.*

Prandaj, organet shtetërore dhe ekonomike, organizatat e Partisë dhe veçanërisht ato të Bashkimeve Profesionale e të BRPSH, t'i kushtojnë vëmendje të veçantë këtij problemi, duke pasur parasysh se niveli i ulët arësimor i punëtorëve vështirëson kualifikimin e tyre tekniko-profesional. Arësimi 7-vjeçar të jetë kusht i domosdoshëm veçanërisht për punëtorët e rinj nga moshja, si dhe për ata që merren për herë të parë në punë në ato degë të ekonomisë që kanë krijuar bazën e nevojshme me punëtorë të kualifikuar.

3. — *Krahas rritjes së kualifikimit të punëtorëve, të merren masa për përgatitjen e punëtorëve të rinj të kualifikuar, për të plotësuar detyrat e caktuara në planin e tretë pesëvjeçar.*

Një vend të rëndësishëm në përgatitjen e punëtorëve të rinj të kualifikuar me aftësitë e nevojshme tekniko-profesionale duhet të zënë shkollat e ulëta profesionale, nga të cilat gjatë pesëvjeçarit të tretë të jenë siguruar 25 për qind e punëtorëve të kualifikuar.

a) Për të zbatuar detyrën që shtroi Kongresi IV i Partisë lidhur me riorganizimin e arësimit të ulët profesional, Plenumi i Komitetit Qendror porositi Këshillin e Ministrave të studjojë dhe të përcaktojë masat konkrete që duhen marrë në të gjitha drejtimet, me qëllim që zbatimi i tyre të fillojë në vitin shkollor 1963-1964.

b) Në shkollat e ulëta profesionale, si rregull, të pranohen nxënës nga qyteti dhe nga qendrat e mëdha të punës.

Kontingjentet e punëtorëve që përgatiten në këto shkolla të përdoren, në radhë të parë, për të plotësuar nevojat që kanë veprat e reja për punëtorë të kualifikuar.

c) Për përgatitjen e punëtorëve të rinj, të kualifikuar, të përdoren më mirë format e tjera, si ajo e nxënësve në ekonomi, e kurseve përgatitore para marrjes në punë dhe e vënjes së tyre pranë punëtorëve të kualifikuar, për plotësimin e nevojave të kufizuara të ndërmarrjeve, për plotësimin e nevojave të veprave të reja dhe të atyre për mjeshtëri të rralla.

ç) Organizatat e Partisë, të Bashkimeve Profesionale, të rinisë dhe drejtuesit e ndërmarrjeve e të kooperativave bujqësore të shtojnë kujdesin për punëtorët e rinj që marrin nga shkollat e ulëta dhe nga kurset profesionale, t'u krijojnë atyre lehtësi për të kapërcyer vështirësitë e para dhe të luftojnë kundër qëndrimeve mospërfillëse që shfaqen në disa raste ndaj tyre.

4. — *Të organizohet puna për përgatitjen në masë të punonjësve të bujqësisë me njohuritë e nevojshme agrozooteknike. Për këtë:*

a) Ministria e Bujqësisë, KQ i BRPSH, këshillat popullore dhe kryesitë e kooperativave bujqësore të marrin masa për të përmirësuar punën e kurseve dyvjeçare pranë NBSH-ve, SMT-ve dhe kooperativave bujqësore dhe të sigurojnë pjesëmarrjen sa më të gjerë të rinisë.

b) Të zgjerohet rrjeti i shkollave të ulëta bujqësore dyvjeçare pranë shkollave 7-vjeçare të fshatit, ku ka edhe teknikë bujqësorë, si dhe në ndërmarrjet bujqësore. Këto shkolla të funksionojnë gjatë dimrit pas punës dhe të zëvendësojnë kurset agrozooteknike dyvjeçare.

5. — Dikasteret, ndërmarrjet ekonomike dhe kooperativat bujqësore, të marrin masa serioze për të përmirësuar gjendjen jo të kënaqshme të bazës materiale-mësimore të kurseve të ndryshme dhe të shkollave të ulëta profesionale që kanë në vartësinë e tyre. Brenda vitit 1962-1963 të sigurohen ato me mjetet dhe punishtet e nevojshme mësimore; të plotësohen e të përmirësohen programet, tekstet e dispensat dhe për të dhënë mësim në këto kurse e shkolla të caktohen instruktorë të aftë nga personeli inxhiniero-teknik dhe specialistët e bujqësisë.

6. — Për të përmirësuar punën për drejtimin metodiko-mësimor dhe organizativ të arësimit të ulët tekniko-profesional, të ngrihet pranë Këshillit të Ministrave Drejtorja e arësimit të ulët tekniko-profesional. Kjo drejtori të merret me problemet e riorganizimit të sistemit të arësimit të ulët tekniko-profesional, me përmirësimin e përmbajtjes së tij, me planet e programet mësimore të shkollave të ulëta dhe me unifikimin e planeve dhe programeve tip të kurseve të ndryshme sipas kategorizimit të profesioneve, si dhe me ndjekjen e me përmirësimin e punës mësimore-edukative.

7. — *Plenumi i Komitetit Qendror e quan të nevojshme të tregohet më tepër kujdes për zhvillimin e mendimit teknik dhe agrozooteknik, për propagandimin e teknikës së prodhimit në masën e punëtorëve e të fshatarëve dhe veçanërisht të rinisë.*

Përhapja e njohurive dhe zhvillimi i aftësive tekniko-profesionale në masat e gjera popullore është mjet për rritjen e rendimentit të punës. Prandaj, organet shtetërore dhe ekonomike, organizatat e Partisë, të Bashkimeve Profesionale e të BRPSH, ta organizojnë më mirë punën për propagandimin e njohurive teknike dhe agrozooteknike.

Kujdes i posaçëm t'u kushtohet, sidomos nga organizatat e Bashkimeve Profesionale, iniciativave për shpikje e racionalizime të punëtorëve tanë, të nxiten dhe të ndihmohen ata, të luftohet për të zgjeruar vazhdimisht numrin e novatorëve dhe racionalizatorëve, e brigadave komplekse, brigadave të punës socialiste dhe të sigurohet një bashkëpunim më i ngushtë midis tyre dhe teknikëve e specialistëve të lartë.

III

Mbi masat për përgatitjen e teknikëve të mesëm dhe kualifikimin e mëtëjshëm të tyre

Në bazë të detyrave që shtroi Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë i vitit 1960 për riorganizimin e shkollës, është punuar për përmirësimin e programeve, për rregullimin e përpjesëtimin midis teorisë dhe praktikës mësimore e të prodhimit, si dhe në drejtime të tjera, është vënë në rrugë më të drejtë përgatitja e kuadrove me arësim të mesëm.

1. — Plenumi i Komitetit Qendror e quan të nevojshme që edhe në të ardhshmen të vazhdohet puna për të zbatuar sa më mirë masat e caktuara, duke i kushtuar vëmendje të veçantë përgatitjes teorike dhe praktike sa më të shëndoshë të teknikëve të mesëm, me qëllim që t'u përgjigjet si duhet kërkesave të përparimit të vazhdueshëm të teknikës e të prodhimit.

a) Të ngrihet në një shkallë më të lartë cilësia e punës mësimore-edukative, me qëllim që të sigurohet një përparim më i lartë dhe të pakësohet në një shkallë të rëndësishme humbja e kontingjenteve nga mbetjet në klasë.

Drejtoritë e shkollave profesionale, organizatat e Partisë në to dhe, veçanërisht, organizatat e rinisë, ta forcojnë më tepër punën për edukimin sa më mirë të nxënësve me tiparet e moralit komunist, me dashurinë ndaj punës dhe sidomos ndaj profesionit për të cilin përgatiten. Gjithashtu, të tregojnë kujdes për ruajtjen e kontingjenteve të nxënësve nga largimet, sidomos të nxënësve të vjetëve të parë.

b) Dikasteret ekonomike të marrin masa për të plotësuar e pasuruar bazën materiale-mësimore të teknikumeve që varen prej tyre, në mënyrë të veçantë të teknikumeve bujqësore, të Teknikumit të minierave e të gjeologjisë etj.

Kujdes i posaçëm t'u kushtohet sigurimit dhe përmirësimit të teksteve mësimore, në mënyrë që ato të plotësohen brenda vitit 1963 dhe me cilësi të mirë.

c) Puna e deritanishme lidhur me zbatimin e detyrave për përmirësimin e praktikës mësimore e të prodhimit është e pamjaftueshme. Prandaj, Plenumi i Komitetit Qendror porositi dikasteret dhe ndërmarrjet ekonomike që të marrin masat e nevojshme për të zbatuar plotësisht detyrat që caktohen në vendimin e Plenumit të Komitetit Qendror të vitit 1960 mbi riorganizimin e sistemit të arësimit popullor.

Ndërmarrjet ekonomike ku nxënësit e teknikumeve bëjnë praktikën e prodhimit, të kujdesen posaçërisht për ta organizuar sa më mirë praktikën dhe për ta drejtuar atë të caktojnë kuadro të aftë nga personeli inxhiniero-teknik.

2. — Për të përgatitur teknikë të mesëm, një burim tjetër i rëndësishëm, edhe në të ardhshmen, do të jetë arësimi i mbrëmjes dhe me korrespondencë pranë shkollave të mesme profesionale.

a) Organizatat e Partisë, dikasteret dhe ndërmarrjet ekonomike të kujdesen më tepër për të rritur numrin e punëtorëve që i kanë mundësitë dhe aftësitë për të ndjekur shkollat. Pjesëmarrja e sa më shumë punëtorëve, në mënyrë të veçantë e teknikëve që nuk kanë arësimin përkatës, në shkollat e mesme profesionale të mbrëmjes ose me korrespondencë, të konsiderohet, nga organizatat e Partisë dhe nga organet ekonomike shtetërore, si rruga më e përshtatshme që teknikët e mesëm me praktikë të përfitojnë arësimin e duhur profesional. Kjo çështje duhet t'i nënshtrohet një shqyrtimi të hollësishëm nga çdo organizatë bazë partie dhe të bëhet problem i të gjithë kolektivit punonjës.

Për të plotësuar nevojat e ekonomisë me punëtorë të kualifikuar dhe me teknikë të mesëm nga radhët e klasës punëtorë,

brenda vitit 1962-1963 Ministria e Arësimit dhe e Kulturës, në bashkëpunim me dikasteret përkatëse, të studjojë mundësinë për ngritjen e shkollave të mesme profesionale të mbrëmjes në rrethet kryesore dhe në qendrat e mëdha industriale për disa profile. si atë elektrik, mekanik, të ndërtimit etj. Këto shkolla mund të jenë me dy etapa: në etapën e parë të përgatiten punëtorë të kualifikuar dhe në të dytën — teknikë të mesëm.

3. — Për të siguruar drejtimin e punës mësimore-edukative të shkollave të mesme profesionale, dega përkatëse pranë Ministrisë së Arësimit dhe të Kulturës të ngrihet në drejtori të arësimit profesional dhe të lartë. Dikasteret ekonomike të vazhdojnë, si edhe sot, të administrojnë shkollat e mesme profesionale dhe të kenë për detyrë, në radhë të parë, sigurimin dhe plotësimin e bazës materiale mësimore-laboratorike dhe të kuadrit mësimor për lëndët e kulturës profesionale.

4. — *Plenumi i Komitetit Qendror e quan të nevojshme të theksojë se kualifikimi i mëtëjshëm i teknikëve të mesëm duhet të tërheqë më tepër vëmendjen e organeve shtetërore dhe ekonomike, të organizatave të Partisë dhe të Bashkimeve Profesionale.*

Sipas mundësive, në bazë rrethesh ose ndërmarrjesh, me grupe teknikësh të mesëm të një specialiteti ose të specialiteteve të afërta, të organizohen seminare e konferenca tekniko-ekonomike, ku të zhvillohen dhe të diskutohen tema lidhur me përgjithësimin e eksperiencës së përparuar, me problemet tekniko-ekonomike që preokupojnë rrethën ose ndërmarrjet dhe me të rejtat në fushën e teknikës. Të tilla seminare e konferenca tekniko-ekonomike mund të organizohen disa herë në vit në bazë të një plani. Për përgatitjen dhe zhvillimin e tyre të bashkëpunohet me specialistët e lartë të prodhimit, me dikasteret dhe me katedrat e shkollave të larta.

Organizatat e Partisë, ndërmarrjet ekonomike dhe organizatat e Bashkimeve Profesionale të tregojnë kujdes të posaçëm për përgatitjen dhe zhvillimin e këtyre seminarëve dhe konferencave në nivel sa më të lartë, me qëllim që dëgjuesit të ndihmohen si duhet për të ngritur nivelin e njohurive teknike dhe të zhvillohet më tej mendimi teknik.

5. — *Plenumi i Komitetit Qendror thekson se përdorimi sa më racional dhe aktivizimi sa më i gjerë i teknikëve të mesëm për zgjidhjen e problemeve tekniko-ekonomike të prodhimit, është detyrë shumë e rëndësishme për organet ekonomike, organizatat e Partisë dhe të Bashkimeve Profesionale.*

Tekniku i mesëm është hallka ndërlidhëse e inxhinierit me masën punëtorë, është përçues dhe zbatues i drejtimit teknik e teknologjik, ai është figura kryesore e drejtimit të përditshëm të procesit të prodhimit në sektorin e tij. Për këtë:

a) Organet ekonomike, organizatat e Partisë e të masave të

rritin më tepër kujdesin për punën e teknikëve të mesëm e të mjeshtërvë, t'i aktivizojnë ata sa më racionalisht për përmirësimin e teknikës dhe të teknologjisë së prodhimit.

b) Të tregohet më tepër kujdes për teknikët e mesëm që porsa kanë mbaruar shkollat profesionale, të ndihmohen në punën e tyre për të fituar sa më shpejt praktikën e prodhimit, me qëllim që të ecin përpara. Ndërmarrjet ekonomike të studjojnë e të përcaktojnë më konkretisht detyrat dhe vendin që zë në prodhim tekniku i mesëm.

c) Organet ekonomike dhe organizatat e Partisë t'i aktivizojnë ata edhe më mirë për zgjidhjen e problemeve tekniko-ekonomike që preokupojnë ndërmarrjen, të përkrahin e të nxitin iniciativat e tyre dhe t'u japin ndihmën e nevojshme për të kapërcyer vështirësitë që mund të hasin.

ç) Të sigurohet bashkëpunimi dhe ndihma reciproke midis teknikëve të mesëm dhe specialistëve të lartë, nga njëra anë, si dhe midis teknikëve të mesëm dhe punëtorëve nga ana tjetër. Vetëm kështu do të çohet përpara prodhimi, do të zhvillohet mendimi teknik, do të shpejtohet përparimi teknik në degët e ndryshme të ekonomisë.

IV

Mbi përgatitjen, kualifikimin dhe përdorimin sa më racional të kuadrove me arësim të lartë

Partia jonë, duke zbatuar në jetë mësimet e marksizëm-leninizmit, i ka kushtuar vazhdimisht kujdes dhe vëmendje të posaçme përgatitjes së specialistëve të lartë, krijimit të inteligjencies popullore.

Zbatimi i detyrave që shtroi Kongresi IV i Partisë për zhvillimin ekonomik dhe kultural të vendit tonë, kërkon që t'i kushtohet më tepër kujdes përgatitjes së specialistëve me arësim të lartë dhe sidomos kualifikimit të tyre të mëtijshëm.

1. — Përmirësimi i mëtijshëm i punës mësimore-edukative për përgatitjen e specialistëve të rinj me arësim të lartë është detyrë e rëndësishme e shkollave të larta.

Shkollat tona të larta duhet t'i pajisin studentët me njohuri të thella shkencore, teorike dhe praktike, t'i edukojnë ata me ndjenjën e dashurisë për punën, t'i bëjnë luftëtarë aktivë për çështjen e popullit e të Partisë, të gatshëm për të kapërcyer çdo vështirësi dhe për të shërbyer ku ta lypë nevoja.

a) Plenumi i Komitetit Qendror porosit punonjësit mësimorë-shkencorë, drejtuesit e shkollave të larta dhe organizatat e Partisë që t'i kushtojnë kujdes të posaçëm përmirësimit të vazh-

dueshëm të përmbajtjes së leksioneve, të seminareve, të praktikave etj. Katedrat të ngrenë në një nivel më të lartë punën e tyre drejtuese shkencore, të udhëheqin nga afër dhe më thellë procesin mësimor për t'i përgatitur në një nivel sa më të lartë specialistët e rinj.

Të luftohet kundër shfaqjeve të shkollarizmit që vihen re në disa raste. Punonjësit mësimorë-shkencorë t'ja përshtatin më mirë leksionet nivelit që kërkon shkolla e lartë, zhvillimi i shkencës e i teknikës dhe në të njëjtën kohë të kërkojnë nga studentët një përgatitje sistematike, të thellë e të gjithanshme.

Shkollat e larta të kujdesen vazhdimisht për pasurimin e mëtijshëm të bazës laboratorike-mësimore duke shfrytëzuar të gjitha mundësitë që ato kanë me forcat dhe mjetet e tyre. Nga ana tjetër, organet shtetërore të interesohen më tepër për plotësimin e nevojave në këtë drejtim.

Brenda vitit 1963 të plotësohet mungesa e tanishme e teksteve dhe e dispensave, të përmirësohen ato që nuk janë të përshtatshme. Kujdes i posaçëm t'i kushtohet botimit të literaturës ndihmëse.

b) Komiteti Qendror e quan të drejtë orientimin që kanë shkollat e larta për të përgatitur specialistë me profil të gjerë, si më i përshtatshmi për nevojat e ekonomisë dhe të kulturës së vendit tonë. Për të ndihmuar në përgatitjen sa më të mirë të specialistëve të rinj, që ata të njihen më shpejt me degën ku do të punojnë, Komisioni i Planit të Shtetit në bashkëpunim me dikasteret ekonomike dhe me Ministrinë e Arësimin e të Kulturës të caktojnë me kohë ndarjen e studentëve sipas degëve për të cilat do të përgatiten.

c) Plenumi i Komitetit Qendror thekson nevojën për ngritjen e nivelit të përgatitjes së specialistëve në bazë të parimit të lidhjes së ngushtë të të mësuarit me punën prodhuese. Duke theksuar rolin e praktikës mësimore në prodhim të sigurohet me çdo kusht ngritja e mëtijshme e nivelit të përgatitjes së tyre shkencore-teorike. Të ruhet përpjesëtimi i nevojshëm midis teorisë dhe praktikës në përgjithësi, të vendoset midis tyre një lidhje e tillë në mënyrë që mësimi praktik të forcojë njohuritë teorike dhe të ndihmojë për vënjen e tyre në jetë. Lidhur me këtë, në disa fakultete e degë të rishikohet përpjesëtimi midis teorisë dhe praktikës mësimore e në prodhim, në mënyrë që të mos cenohet përgatitja e nevojshme shkencore-teorike. Nga ana tjetër, specialisti i ri, të fitojë njohuritë e nevojshme praktike, të njohë jetën, luftën vetëmohuese të masave punonjëse dhe nevojat e prodhimit.

Gjithashtu, të rishikohet vendosja më e drejtë e lëndëve në planet mësimore si dhe mundësia për të lehtësuar ngarkesën e studentëve, për t'u dhënë më tepër kohë për punë individuale, si

kusht i rëndësishëm për përgatitjen sa më të mirë të specialistëve të lartë.

Shkollat e larta, dikasteret dhe sidomos ndërmarrjet ekonomike të marrin masa për të zbatuar sa më mirë detyrat e praktikës në prodhim që ka caktuar Plenumi i Komitetit Qendror mbi riorganizimin e sistemit të arësimit popullor.

Të zgjerohet puna e filluar në disa fakultete që diplomat e studentëve të trajtojnë tema konkrete për t'i ardhur në ndihmë më mirë prodhimit.

ç) Shkollat e larta të marrin masa për ta organizuar më mirë ndihmën metodiko-pedagogjike për studentët e arësimit të mbrëmjes e me korrespondencë, të sigurojnë dhe të përmirësojnë tekstet e nevojshme.

Organizatata bazë të Partisë dhe qendrat e punës të kujdesen në mënyrë të posaçme që punonjësit e tyre të ndjekin fakultetet e profilit të afërt me punën e tyre dhe të vazhdojnë rregullisht studimet. Gjithashtu të kujdesen për t'u krijuar kushte lehtësuese punonjësve që ndjekin shkollat. Të rritet shumë më tepër kujdesi për arësimin me korrespondencë të arësimitarëve, me qëllim që të plotësohet plani i përgatitjes së kuadrit arësimitarë të arësimin përkatës.

2. — *Plenumi i Komitetit Qendror thekson se kualifikimi i mjetshëm dhe specializimi i kuadrove me arësim të lartë është kusht i domosdoshëm për të zgjidhur sa më mirë detyrat për zhvillimin e prodhimit, për përparimin e teknikës, të shkencës dhe të kulturës në vendin tonë.*

Specialisti ynë duhet të ketë njohuri të gjithanshme e të thella teorike e shkencore për specialitetin e vet dhe njëkohësisht të njohë mirë praktikën. Këto cilësi, ndër të tjera, fitohen në radhë të parë nëpërmjet punës praktike dhe studimit të vazhdueshëm. Specialistët tanë janë relativisht të rinj nga mosha dhe me stazh të vogël praktik.

a) Puna për rritjen e kualifikimit të specialistëve të lartë të merret në dorë seriozisht nga organet shtetërore dhe ekonomike, nga organizatat e Partisë e të masave. Praktika është një shkollë e madhe, po për të ecur përpara ajo ka nevojë të ushqehet me teori, me teknikën dhe me shkencën, që zhvillohen vazhdimisht.

Kusht vendimtar për zgjerimin e njohurive teknike dhe shkencore është studimi individual dhe sistematik që bën vetë çdo specialist, prandaj në masën e specialistëve të nxitet dhe të ngjallet zëlli për të studjuar vazhdimisht.

Komiteti Qendror porositi specialistët e të gjithë kuadrot që, si kurdoherë, të mësojnë në mënyrë të veçantë nga kultura, teknika e nga shkenca sovjetike; të bëhen përpjekje për të kapërcyer gjithë vështirësitë dhe pengesat që na janë krijuar në këtë drejtim.

b) Sipas mundësive dhe natyrës së punës të çdo sektori, dikasteret në bashkëpunim me fakultetet dhe me katedrat e shkollave të larta të organizojnë kurse kualifikimi me afate të ndryshme. Në këto kurse të zhvillohen tema mbi të rejtat e shkencës e të teknikës dhe të përgjithësohet eksperiencia e përparuar e punës. Për këtë qëllim, brenda këtij viti, të hartohen plane konkrete, duke parashikuar që në këto kurse të kalojnë me radhë çdo vit grupe specialistësh.

c) Të organizohen më mirë seminarët, informacionet dhe sidomos sesionet shkencore që zhvillohen në shkollat e larta duke bashkëpunuar ngushtë me dikasteret përkatëse dhe duke përcaktuar një tematikë sa më të pasur e të dobishme. Seminarët dhe sesionet shkencore të shërbejnë veçanërisht për përgjithësimin e eksperiencës së përparuar dhe në to të marrin pjesë gjerësisht specialistët e prodhimit.

ç) Të organizohet më mirë aspirantura, si një formë e veçantë për kualifikimin e specialistëve të lartë. Në të ardhshmen të zgjerohet më tepër aspirantura me shkëputje nga puna. Të planifikohet dhe të organizohet më mirë përgatitja e aspirantëve jo vetëm nga radhët e kuadrove të shkollave të larta dhe instituteve shkencore, por edhe nga qendrat e prodhimit. T'i kushtohet kujdes përgatitjes shkencore dhe teorike të aspirantëve dhe temave të disertacioneve, të cilat duhet të jenë të lidhura ngushtë me problemet e ekonomisë e të kulturës sonë¹.

d) Organet shtetërore të studjojnë më mirë problemin e specializimit të kuadrove për kualifikim të lartë dhe të përcaktojnë masa konkrete duke shfrytëzuar mundësitë tona të brendshme, sidomos në fushën e mjekësisë, të agronomisë dhe të albanologjisë dhe njëkohësisht duke dërguar jashtë shtetit kuadro të sektorëve më të rëndësishëm për specializim më të thellë.

dh) Puna kërkimore-shkencore të shërbejë si një formë shumë e rëndësishme dhe e nevojshme për thellimin e njohurive shkencore-teorike të specialistëve. Prandaj, organet shtetërore dhe ekonomike, institucionet e ndryshme, organizatat e Partisë dhe të Bashkimeve Profesionale t'i nxitin dhe t'i përkrahin sa më shu-

1 Me vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 39, datë 19 shkurt 1970 «Mbi sistemin e kualifikimit të kuadrove të shkollave të larta, të institucioneve kërkimore-shkencore dhe të kuadrove të lartë të prodhimit dhe mbi dhënjen e titujve shkencorë» u vendos një sistem i ri kualifikimi. Ky sistem përfshin të gjithë kuadrot e lartë pavarësisht nga shkalla e kualifikimit të tyre dhe përmban një sërë formash kualifikimi e specializimi. Vendimi Nr. 287, datë 16 korrik 1963 mbi aprovimin e rregulloreve «Mbi aspiranturën dhe doktoratën» është shfuqizuar.

më specialistët që të merren me studime të ndryshme shkencore në dobi të ekonomisë dhe të kulturës.

Në një të ardhshme të afërt qendrat shkencore e mësimore të arësimit të lartë të plotësohen me kuadrot e nevojshëm, në bazë të vendimeve që janë marrë dhe të planit 10 — 15-vjeçar të punës shkencore që është aprovuar nga Byroja Politike dhe nga Këshilli i Ministrave. Sigurimi i këtij kuadri të shikohet si një nevojë për zhvillimin e shkencës dhe të procesit mësimor në nivel më të lartë. Të krijohen kushte që pedagogët e kualifikuar për lëndët kryesore të kenë asistentë, si dhe të krijohen mundësitë që kuadrot e sotëm me tituj e me grada shkencore të udhëheqin kuadro të rinj në punën shkencore.

e) Për t'u ardhur në ndihmë më mirë specialistëve, është e nevojshme të përmirësohet rrënjësisht shërbimi i bibliotekave, si në drejtim të krijimit të lehtësive për shfrytëzimin e literaturës tekniko-shkencore, ashtu edhe të informacionit bibliografik e të propagandimit të librit tekniko-shkencor.

Të bëhen më tepër përpjekje për pasurimin e literaturës tekniko-shkencore duke shpejtuar ritmet e botimit të saj në gjuhën shqipe, në radhë të parë të manualeve teknike të përdorimit të përditshëm. Të ngrihet niveli shkencor i revistave e i buletineve shkencore që dalin sot dhe të studjohet mundësia për të nxjerrë revista e buletine të tjera për disa degë të teknikës. Gjithashtu të sigurohet një literaturë më e gjerë tekniko-shkencore në gjuhë të huaja. Duke marrë parasysh mungesën e literaturës së mjaftueshme tekniko-shkencore në gjuhën shqipe, specialistët dhe studentët tanë të mësojnë dhe gjuhë të tjera kryesore.

3. — *Përdorimi sa më racional dhe aktivizimi i specialistëve sa më shumë në punë krijuese tekniko-ekonomike e shkencore, kërkon të rritet shumë më tepër kujdesi i organeve shtetërore dhe ekonomike, i institucioneve të ndryshme dhe i organizatave të Partisë e të masave.*

Plenumi i Komitetit Qendror vëren me kënaqësi se specialistët tanë të talentuar, me punën e tyre të palodhur, së bashku me teknikët e punëtorët, nën udhëheqjen e Partisë, kanë arritur rezultate të shkëlqyera në të gjitha degët e ekonomisë dhe të kulturës sonë.

Me gjithë vështirësitë e krijuara nga veprimet armiqësore të grupit të Nikita Hrushovit ndaj vendit tonë, si tërheqja e specialistëve, shkelja e marrëveshjeve ekonomike të bashkëpunimit tekniko-shkencor etj. specialistët tanë po zgjidhin me sukses detyra të shumta e të ndërlikuara si p.sh. në fushën e kërkimeve e të studimeve gjeologjike, në projektimin dhe ndërtimin e fabrikave, të uzinave të reja e të tjera.

Me hyrjen e vendit tonë në etapën e ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste, me futjen e teknikës së re dhe me rritjen e nu-

mrut e të cilësisë së kuadrove, *zhvillimi i mëtejshëm i mendimit krijues teknik dhe shkencor merr një rëndësi të dorës së parë.*

a) Organet shtetërore dhe ekonomike të studjojnë dhe të përcaktojnë më mirë detyrat e specialistëve të lartë të prodhimit, të cilët të çlirohen nga punët e vogla administrative, me qëllim që të ndihmojnë efektivisht në përcaktimin dhe në zbatimin e masave teknike e teknologjike që sigurojnë plotësimin e detyrave të përditshme të planit, në studimin e problemeve aktuale tekniko-ekonomike dhe në studimin e problemeve që kanë të bëjnë me perspektivën e zhvillimit të prodhimit të sektorëve ku punojnë.

b) Specialistët të rritin edhe më tepër iniciativën, të bëhen vetë kërkues këmbëngulës e novatorë për modifikime e projekte, për hartime modelesh e skemash të reja teknologjike. Kryeinxhinieri, përgjegjësi i prodhimit e i repartit, duke vënë në lëvizje gjithë personelin inxhiniero-teknik, të mendojnë e të krijojnë, të marrin përsipër përpunimin e masave teknike dhe të organizojnë zbatimin e tyre, për të siguruar përparimin teknik të ndërmarrjes.

c) Dikasteret dhe ndërmarrjet ekonomike, pasi të kenë bërë një punë të studjuar mirë dhe të kujdesshme, të nxjerrin problemet aktuale dhe të perspektivës së prodhimit dhe të ngarkojnë me detyra konkrete specialistë si dhe t'u rekomandojnë institucioneve mësimore-shkencore probleme studimi për t'i përfshirë në planin e punës së tyre shkencore.

Duke pasur parasysh kushtet tona konkrete të bazës laboratorike dhe të forcave tona, brenda këtij viti organet shtetërore dhe ekonomike, të studjojnë mundësinë për të shfrytëzuar në mënyrë të koordinuar laboratorët që kemi pranë ndërmarrjeve, fabrikave etj.

Brenda vitit 1963 dikasteret ekonomike të hartojnë një plan të studjuar mirë, në bazë të mundësive tona praktike, për të krijuar disa forma organizative të përshtatshme, siç kanë filluar të krijohen në disa dikastere e qendra pune, për t'u marrë me studime të prodhimit, si byro teknike, drejtori projektuese, institute kërkimore etj.

ç) Për të çuar përpara prodhimin, për të shpejtuar përparimin teknik është e domosdoshme të forcohet sa më shumë bashkëpunimi midis specialistëve të lartë të prodhimit dhe teknikëve e punëtorëve pararojë si dhe bashkëpunimi midis specialistëve të prodhimit dhe punonjësve mësimorë-shkencorë të shkollave të larta.

Punonjësit mësimorë-shkencorë duhet të hyjnë më thellë në jetën e prodhimit, të njohin më mirë problemet që e preokupojnë ekonominë tonë. Në bazë të planeve të koordinuara në punën kërkimore-shkencore, shkollat e larta që kanë marrë përsipër tema për t'i studjuar duhet të tregojnë kujdes për përfundimin e

tyre sa më parë, kurse dikasteret duhet të interesohen më tepër për t'i vënë në jetë përfundimet e arritura nga këto studime.

d) Dikasteret ekonomike, duke pasur parasysh kushtet dhe nevojat e tanishme, të luftojnë për ta kombinuar edhe më mirë drejtimin ekonomiko-administrativ me atë teknik e teknologjik të prodhimit.

Këshillat teknike të ndërmarrjeve të përmirësojnë punën duke u kushtuar kujdes dhe vend të veçantë problemeve teknike. Kabinetet teknike të gjallërohen duke u ngarkuar me detyra konkrete.

dh) Komitetet e Partisë të merren më tepër me probleme të kualifikimit, përdorimit dhe aktivizimit të specialistëve dhe, sipas rastit e nevojës, t'i shqyrtojnë ato në mbledhjet e byrove e të plenumeve dhe në aktive të Partisë.

Organizatave bazë të Partisë në qendra pune dhe në institucione mësimore-shkencore të rritin më tepër kujdesin për këto çështje.

V

Mbi disa çështje të punës me kuadrin

Me kujdesin e posaçëm dhe me punën e vazhdueshme që ka bërë Partia, u rriten dhe u kalitën kuadro të aftë e luftarakë, punonjës të aparateve të organeve të Partisë, të pushtetit, të organizatave të masave dhe drejtues të ekonomisë e të kulturës.

1. — *Mbi kuadrot e aparateve të Partisë dhe të pushtetit popullor.*

Plenumi vëren me kënaqësi se kuadrot e aparateve të Partisë, të pushtetit, të organizatave të masave dhe drejtuesit e ekonomisë e të kulturës i kanë kryer me nder detyrat dhe nga viti në vit kanë rritur aftësitë e tyre në punë e sipër, si dhe nëpërmjet shkollave me shkëputje dhe pa shkëputje nga puna.

a) Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH thekson se realizimi i detyrave të caktuara për ngritjen e nivelit arësimor të këtyre kuadrove deri në vitin 1965 kërkon një punë këmbëngulëse, si nga vetë kuadrot, ashtu edhe nga organizatat e Partisë e të masave dhe nga organet shtetërore. Detyrat e caktuara do të plotësohen kryesisht duke u dhënë arësimin përkatës kuadrove që kemi, sidomos nëpërmjet arësimit të mbrëmjes e me korrespondencë si dhe nëpërmjet Shkollës së Partisë «V.I.Lenin» dhe kurseve 2-3 vjeçare pranë shkollave të larta. Kuadrot e organizatave të Partisë, të masave e të pushtetit duhet që edhe në të ardhshmen të bëjnë përpjekje për të rritur gjithnjë e më shumë aftësitë e tyre ideo-politike, kulturele e profesionale.

b) Duke marrë parasysh ndryshimet që kanë ndodhur në përbërjen shoqërore të vendit tonë si dhe ngritjen e nivelit arësimor e profesional të masave dhe veçanërisht të klasës punëtore, Plenumi i Komitetit Qendror porositi që të punohet edhe më shumë për përgatitjen dhe për edukimin e kuadrove nga radhët e punëtorëve, për ngritjen në përgjegjësi të më shumë njerëzve nga prodhimi.

c) Plenumi i Komitetit Qendror porositi organizatat e Partisë, organet shtetërore dhe të ekonomisë si dhe organizatat e masave të shtojnë kujdesin për përgatitjen, për edukimin dhe për ngritjen në përgjegjësi të kuadrove nga radhët e grave duke mbajtur parasysh dhe duke zbatuar të gjitha vendimet që ka marrë në këtë drejtim Komiteti Qendror i Partisë.

Për këtë është e nevojshme të rriten përpjekjet e grave dhe të të rejave për të ngritur nivelin arësimor e tekniko-profesional të tyre, sidomos të atyre që janë në marrëdhënie pune. Gjithashtu të shtohet më shumë numri i vajzave, veçanërisht i atyre nga fshati, në shkollat dhe në fakultetet e ndryshme.

2.— *Mbi vendosjen, shpërndarjen dhe drejtimin e punës me kuadrin.*

a) Duke pasur parasysh zhvillimin ekonomik e kultural të rrethëve të ndryshme në bazë të direktivave të Kongresit IV të PPSH, organet e Partisë e të shtetit, edhe në të ardhshmen, duhet të punojnë për një shpërndarje edhe më të mirë të kuadrove duke plotësuar më mirë nevojat e rrethëve dhe të ndërmarrjeve.

Për këtë është e nevojshme të përmirësohet puna që nga planifikimi në përpjesëtim të drejtë i kontingjenteve për shkollat e kurset e deri te shpërndarja e kuadrove midis rrethëve, qendrës e bazës, midis prodhimit e administratës.

b) Plenumi i Komitetit Qendror e quan të nevojshme të theksojë se tani që kuadrot po specializohen gjithnjë e më shumë duhet të mënjanohej sa të jetë e mundur lëvizjet e shpeshta të tyre, sidomos lëvizjet horizontale dhe të luftohet për ruajtjen e profileve që kanë.

c) Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë porositi që të forcohet edhe më shumë drejtimi i punës me kuadrin nga organet e Partisë dhe të pushtetit, si në qendër ashtu edhe në bazë. Veçanërisht dikasteret qendrore dhe organet e tjera ekonomike duhet që punën me kuadrin ta shohin si një nga çështjet më kryesore të punës së tyre dhe realizimin e planit të përgatitjes dhe të edukimit të kuadrit si një tregues shumë të rëndësishëm të realizimit të planit. Organet udhëheqëse të dikastereve si dhe degët apo zyrat e kuadrit të merren më shumë e më mirë me problemet e përgatitjes e të kualifikimit të kuadrit.

3.— Mbi edukimin ideologjik e politik të kuadrit.

Inteligjencia jonë karakterizohet nga besnikëria e pakufishme ndaj çështjes së socializmit, të popullit dhe të atdheut.

Inteligjencia jonë është e pastër ideologjikisht e politikisht, ajo është e lidhur ngushtë me Partinë e popullin dhe në të gjitha situatat që ka kaluar vendi ynë ajo ka qëndruar e qëndron rreth Partisë dhe ka mbrojtur e mbrojt me vendosmëri vijën e saj të drejtë.

Në shumicën e saj dërmuese inteligjencia jonë është e re, e pregatitur pas çlirimit, e dalë, në radhë të parë, nga gjiri i klasës punëtore dhe i fshatarësisë punonjëse, e rritur dhe e edukuar me kujdes të posaçëm nga Partia jonë me dashuri për popullin, për atdheun, për punën, me shpirtin e sakrificës, karakteristika këto që i ka sot edhe ajo pjesë e vogël e inteligjencies që ishte pregatitur para çlirimit. Partia jonë bëri një punë të madhe e këmbëngulëse, me durim e me takt për riedukimin e inteligjencies së vjetër. Një shkollë e madhe për edukimin e inteligjencies sonë që vetë jeta, lufta për ndërtimin e socializmit, pjesëmarrja aktive e inteligjencies në këtë luftë.

a) Me gjithë punën e madhe që është bërë, Plenumi i Komitetit Qendror i porositi organizatat e Partisë që t'i kushtojnë një kujdes edhe më të madh edukimit politik dhe ideologjik të intelektualëve duke i dhënë rëndësi në mënyrë të veçantë punës së diferencuar me ta sipas profesioneve, nivelit dhe kërkesave të tyre. Të organizohen më shpesh e më mirë takimet me intelektualët, për t'i njohur ata me politikën dhe me problemet aktuale të Partisë.

Organizatave të Partisë duhet të punojnë vazhdimisht për ta edukuar inteligjencien në frymën e traditave patriotike e liridashëse të popullit tonë. Ato duhet të veprojnë në mënyrë që të bëhet një lidhje më e mirë e njohurive politike dhe profesionale me idetë bazë të teorisë marksiste-leniniste duke i shpjeguar në mënyrë më të thellë problemet ideologjike e politike të kohës. E gjithë puna e Partisë duhet t'i shërbejë forcimit të bindjeve të thella marksiste-leniniste të intelektualëve dhe të të gjithë kuadrove tanë, mobilizimit të tyre në një luftë edhe më aktive kundër influencës së ideologjisë borgjeze dhe teorive oportuniste e revizioniste. Veç kësaj puna edukative e organizatave të Partisë dhe e atyre të masave duhet të vlejë për t'i kalitur intelektualët dhe të gjithë kuadrot tanë në luftën kundër vështirësive që nxjerr puna për ndërtimin e plotë të shoqërisë socialiste si dhe për të zhvilluar edhe më shumë në to shpirtin e sakrificës dhe të vetëmohimit në punë.

b) Komiteti Qendror porositi organizatat e Partisë e të masave, organet shtetërore e ekonomike dhe institucionet e ndryshme që t'i kushtojnë kujdes të veçantë nxitjes së mëtejshme të mendimit

mit krijues të inteligjencies sonë, diskutimit të shëndoshë të problemeve të prodhimit, teknikës, shkencës, kulturës e të arteve.

c) Në punën e tyre organizatat e Partisë duhet t'i aktivizojnë intelektualët jo vetëm për çështje thjesht profesionale, por edhe për një punë të gjerë shoqërore, politiko-kulturale me masat. Të punohet më shumë që teknikët dhe specialistët tanë, intelektualët dhe kuadrot tanë ta njohin më afër jetën e popullit, të jetojnë me problemet e tij, të bashkëpunojnë më ngushtë me punëtorët dhe me fshatarët, t'u japin atyre pa kursim diturinë dhe njohuritë që kanë dhe, nga ana tjetër, të përfitojnë edhe vetë nga eksperiencia e tyre.

Komiteti Qendror porositi organizatat e Partisë që të organizohet më mirë puna për aktivizimin e intelektualëve dhe të specialistëve të ndryshëm, sidomos për përhapjen e kulturës në masat e fshatit dhe për edukimin e gjithanshëm komunist të brezit të ri.

ç) Me gjithë përmirësimet e vazhdueshme të kushteve materiale e morale të kuadrove, Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë i porositi organizatat e Partisë, organizatat e masave dhe organet shtetërore që, edhe në të ardhshmen, t'i kushtojnë kujdesin e duhur trajtimit dhe edukimit të kuadrit nëpërmjet një kombinimi të mirë të stimuljeve materialë me ata moralë. Trajtimi i kuadrit në punë e sipër, ndihma konkrete në vend, kritika me kohë e të metave ose e shfaqjeve jo të shëndosha e të huaja, njohja e preokupacioneve dhe zgjidhja e kërkesave të drejta të tyre duhet të jetë një detyrë e përditshme e çdo drejtuesi dhe e çdo organizate bazë partie.

*
*
*

Në gjithë vendin tonë ka shpërthyer një valë mobilizimi dhe entuziazmi të gjerë në punë. Pas realizimit me sukses të planit të vitit 1961, klasa jonë punëtore, fshatarësia punonjëse dhe inteligjencia popullore i janë përveshur punës për të realizuar me nder planin e vitit 1962 dhe detyrat historike të Kongresit IV të PPSH.

Një fitore e madhe e Partisë sonë dhe e vijës së saj të drejtë, një fitore e gjithë popullit tonë qenë rezultatet e shkëlqyera të zgjedhjeve të 3 qershorit. Ato treguan nivelin shumë të lartë të vetëdijes politike dhe patriotike të popullit tonë, unitetin e çelëniktë të tij rreth Partisë. Ato qenë një grusht i rëndë për të gjithë armiqtë e vendit e të Partisë sonë.

Plenumi i Komitetit Qendror ka besim të plotë se masat punonjëse të vendit tonë, nën udhëheqjen e drejtë të Partisë, me entuziazmin e madh politik dhe me vrullin në punë që i karakterizon ato, do të arrijnë rezultate edhe më të mëdha.

Plenumi i Komitetit Qendror shpreh bindjen se detyrat e rëndësishme, që shtrohen në këtë vendim, do të kryhen me sukses. Inteligjencia jonë popullore, ashtu si gjithë populli punonjës i vendit tonë, do të vërë të gjitha energjitë dhe aftësitë e saja për arritjen e fitoreve të reja gjithnjë më të mëdha, për zhvillimin e ekonomisë e të kulturës sonë, për përparimin e teknikës e të shkencës, për lulëzimin e forcimin e gjithanshëm të atdheut tonë socialist.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

*Botohet sipas broshurës:
«Mbi përmirësimin e më-
tejshëm të punës për pre-
gatitjen dhe kualifikimin e
kuadrit». Tiranë, 1962*

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Zëri i Popullit»,
Nr. 174, 22 korrik 1962*

PLENUMI VIII I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Tiranë, 26-28 tetor 1962

KOMUNIKATË

MBI MBLEDHJEN E PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË

Nga 26 deri më 28 tetor 1962 u mbledh Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, nën kryesinë e Sekretarit të Parë të Komitetit Qendror, shokut Enver Hoxha. Plenumi dëgjoi raportin e Byrosë Politike «Mbi masat për zhvillimin e mëtejshëm të bujqësisë, për sigurimin e rritjes së vazhdueshme të prodhimit bujqësor», mbajtur nga anëtari i Byrosë Politike dhe sekretar i Komitetit Qendror të PPSH, shoku Hysni Kapo.

Plenumi diskutoi gjerësisht rreth raportit të Byrosë Politike dhe e aprovoi atë njëzëri.

Në fund të punimeve të plenumit foli shoku Enver Hoxha, i cili, veç çështjeve të bujqësisë, foli edhe për disa çështje aktuale të situatës ndërkombëtare.

Në plenum muarën pjesë edhe sekretarët e parë të komiteve të Partisë dhe kryetarët e komiteteve ekzekutive të k.p. të rretheve, kuadro nga dikasteret dhe institucionet qendrore, nga organizatat e masave dhe nga aparati i Komitetit Qendror të Partisë, drejtorë të ndërmarrjeve bujqësore shtetërore, të SMT-ve, specialistë të bujqësisë, pedagogë të Institutit të lartë shtetëror të bujqësisë dhe të teknikumeve bujqësore, kryetarë kooperativash bujqësore dhe përfaqësues të shtypit.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

RAPORT

I BYROSE POLITIKE TË KQ TË PPSH «MBI MASAT PËR ZHVILLIMIN E MËTEJSHËM TË BUJQËSISË, PËR SIGURIMIN E RRITJES SË VAZHUESHME TË PRODHIMIT BUJQËSOR»

26 tetor 1962

Shokë,

Mbledhja e këtij plenumi, i cili do të shqyrtojë masat që duhen marrë për zhvillimin e mëtejshëm të bujqësisë, me qëllim që të arrihet një shtim i vazhdueshëm dhe i shpejtë i prodhimeve bujqësore e blegtorale, bëhet në një kohë kur kanë kaluar afro 19 muaj nga data kur zhvilloi punimet Kongresi IV i Partisë sonë

Kjo kohë ka qenë me të vërtetë një provë e madhe për Partinë dhe popullin tonë, provë kjo që dëshmon edhe një herë për pjekurinë e lartë politike dhe ideologjike të Partisë sonë, për unitetin e saj të çelniktë, për aftësinë, urtësinë dhe guximin e saj për të kapërcyer çdo vështirësi dhe pengesë, për ta udhëhequr popullin tonë në luftën dhe në punën vetëmohuese për ndërtimin socialist të vendit, në kushtet e vështira të rrethimit imperialist e revizionist.

Partisë sonë, gjatë gjithë periudhës 21-vjeçare të jetës së saj, i është dashur të luftojë jo vetëm kundër vështirësive të brendshme për ta bërë Shqipërinë zonjë, kështu si është sot, por i është dashur të bëjë një luftë të pabarabartë dhe të shumanshme edhe kundër armiqve të jashtëm, të shumtë në numër dhe të fuqishëm. Partia jonë kurdoherë ka dalë fitimtare në këtë luftë, sepse ajo udhëhiqet nga doktrina e madhe dhe e lavdishme e marksizëm-leninizmit dhe i qëndron asaj besnike deri në fund. Kështu shpjegohet dështimi me turp i të gjitha planeve që ndërmuarën armiqtë e Partisë dhe të vendit tonë, imperialistët dhe revizionistët. Këtë fat po pëson edhe grupi revizionist dhe renegat i N.Hrushovit në orvatjet dhe komplotet e pabesa që bëri dhe po bën kundër Partisë sonë.

Shembulli heroik i Partisë sonë për mbrojtjen e pastërtisë së marksizëm-leninizmit në luftë kundër revizionizmit modern, shembulli i Shqipërisë së vogël socialiste, që qëndron si kështjellë graniti dhe u bën ballë sulmeve të tërbuara të armiqve imperialistë dhe revizionistë, duke ua hedhur në erë planet e tyre, dëshmon më së miri se vetëm duke mbrojtur me besnikëri, vendosmëri e konsekuencë marksizëm-leninizmin, duke demaskuar botërisht haptazi armiqtë dhe tradhëtarët, imperializmin dhe revizionizmin, mund të mbrohen fitoret e arritura, socializmi, paqja dhe të ecet përpara drejt fitoreve të reja.

Shqipëria socialiste dhe Partia e Punës e Shqipërisë, në kundërshtim me dëshirat e armiqve tanë, nuk u izoluan, përkundrazi, sot ato kanë edhe më shumë miq e shokë lufte për çështjen e marksizëm-leninizmit.

U shemb porsi kala prej letre blokada që ngriti N.Hrushovi kundër Republikës Popullore të Shqipërisë. Ndërtimi i socializmit në Shqipëri nuk qëndroi në vend si dëshironte grupi i Hrushovit, por ecën me hov përpara. Detyrat historike që shtroi Kongresi IV i Partisë po vihen me sukses në jetë. Masat punonjëse të vendit tonë, nën udhëheqjen largpamëse të Partisë, të ndërgjegjshme për gjendjen e vështirë që krijuan ndaj vendit tonë armiqtë e betuar revizionistë, të ndërgjegjshme për detyrat e mëdha historike që shtroi Kongresi IV i Partisë, duke treguar një patriotizëm të pashembullt, duke qenë kurdoherë vigjilente dhe të gatshme për mbrojtjen e atdheut, edhe me jetën e tyre po qe nevoja, me kazmën në njërin dorë dhe me pushkën në dorën tjetër, gjatë këtyre dy vjetëve kanë korrur suksese të mëdha. Viti 1961, viti i parë i pesëvjeçarit të tretë, viti i parë i blokadës, shënoi fitore të shkëlqyera. Prodhimi i përgjithshëm industrial në vitin 1961 u realizua si vlerë 104, 8 për qind dhe në krahasim me vitin 1960 pati një tejkalim prej 2 miliard e 300 milion lekësh ose 7, 2 për qind. Ministria e Minierave dhe e Gjeologjisë e realizoi planin e vitit 1961 103, 2 për qind ose 3,7 për qind më shumë se në vitin 1960, Ministria e Industrisë — 105,7 për qind ose 11,9 për qind më shumë se në vitin 1960, e Ndërtimit — 114,5 për qind ose 3 për qind më shumë se në vitin 1960, e Tregëtisë — 112,6 për qind, kooperativat e artizanatit — 104,3 për qind, kooperativat e konsumit — 108,6 për qind dhe përkatësisht më shumë se në vitin 1960, 8,3 për qind, 9,4 për qind dhe 34,4 për qind. Në sektorin e bujqësisë u prodhua 30 për qind më shumë se në vitin 1960.

Përparime të kënaqshme u arritën në lëmin e arësimit, kulturës dhe të ruajtjes së shëndetit të popullit. Si rezultat i realizimit të planit të prodhimit, të ardhurat kombëtare u shtuan 5,7 për qind. Populli për vitin 1961, në krahasim me vitin 1960, u furnizua me yndyrna 16 për qind më shumë, me mish — 2 për qind më shumë, me qumësht — 9 për qind më shumë, me sheqer — 4,3 për qind më shumë, me sapun — 10,5 për qind më shumë, me fanella e triko — 3,4 për qind më shumë, me çorape — 21,2 për qind më shumë etj.

Inkurajuese janë edhe rezultatet e punës për realizimin e planit të vitit 1962. Nëntëmuajori i këtij viti u mbyll me sukses në të gjitha degët e ekonomisë. Prodhimi i përgjithshëm industrial si nëntëmuajor u realizua 101 për qind ose 5 për qind më shumë se e njëjta periudhë e vitit të kaluar. Ministria e Minierave dhe e Gjeologjisë e realizoi planin si nëntëmuajor 15 për qind më shumë se e njëjta periudhë e vitit të kaluar dhe ajo e Industrisë — 3 për qind më shumë etj.

Një emulacion i paparë ka shpërthyer në punonjësit e vendit tonë për nder të 50-vjetorit të pavarësisë dhe 18-vjetorit të çlirimit të atdheut. Këto suksese të mëdha, që korr çdo ditë populli ynë nën udhëheqjen e Partisë, kjo luftë vetëmohuese, që po bëjnë punonjësit e qytetit dhe të fshatit në vendin tonë për ta pritur festën e 50-vjetorit të shpalljes së pavarësisë dhe 18-vjetorin e çlirimit të Shqipërisë nga pushtuesit fashistë me plane të realizuara, është një shprehje tjetër e besimit të pakufishëm, e dashurisë dhe e unitetit të çelniktë të masave punonjëse rreth Partisë e Komitetit të saj Qendror me shokun Enver në krye. Sukseset që po korr çdo ditë dhe do të korrë kurdoherë populli ynë me Partinë e tij të lavdishme në krye, si në luftën për ndërtimin e socializmit, ashtu dhe në atë për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit, i gëzojnë miqtë e shumë të Partisë dhe të popullit tonë, i dëshpërojnë armiqtë, pse u shpartallohen planet e tyre tradhëtare, e entuziazmojnë dhe e inkurajojnë akoma më shumë popullin tonë në luftën e vështirë, por fisnike që bën, çelnikosin edhe më shumë besimin se me Partinë e tij të lavdishme në krye, ai do të marshojë gjithmonë përpara drejt fitoreve të reja.

Shokë,

Partia e ka pasur kurdoherë në qendër të vëmendjes dhe si një nga detyrat e saja themelore zhvillimin e bujqësisë. Në saje të vijës së drejtë marksiste-leniniste të Partisë sonë, të kujdesit të veçantë që ajo ka treguar për transformimin socialist të fshatit dhe nxjerrjen e bujqësisë nga prapambetja, në të cilën e kishin zhytur regjimet e kaluara, me punën e palodhur të punonjësve të vendit tonë, të fshatarësisë punonjëse dhe patriote, e cila ndoqi vullnetarisht dhe në masë rrugën e kolektivizimit të bujqësisë, siç e mëson dhe e udhëheq Partia, shumë vështirësi dhe pengesa sot janë kapërcyer. Bujqësia ka bërë përparime të mëdha.

Transformimi socialist i ekonomisë bujqësore, zgjerimi i sipërfaqeve të mbjella, bonifikimi në stil të gjerë i tokave fushore, zgjerimi i sipërfaqeve nën ujë, mekanizimi në shkallë të lartë i bujqësisë, futja e kulturave të reja në bujqësinë tonë dhe përhapja në shkallë të gjerë e kulturave industriale, sipas kërkesave të ekonomisë popullore, zgjerimi në masë të konsiderueshme i sipërfaqes së drithërave dhe përmirësimi në përgjithësi i strukturës së kulturave të arave, zhvillimi i degëve të tjera të ekonomisë bujqësore, sikurse janë blegtoaria dhe fruti-vitikultura, pa të cilat nuk mund të bëhet fjalë për një bujqësi të përparuar, si dhe organizimi i ri i punës, të gjitha këto karakterizojnë ndryshimet e mëdha që janë bërë në bujqësinë tonë, rrugën e zhvillimit dhe të përparimit në të cilën është vënë dhe po ecën vendosmërisht bujqësia jonë.

Si rezultat i shtimit, në radhë të parë, të sipërfaqes së tokës nën kulturë, të frutikulturës dhe të numrit të blegtorisë dhe pjesërisht nga rritja e rendimenteve, është arritur që në vitin 1961 të dyfishohet prodhimi i përgjithshëm bujqësor, në krahasim me vitin 1938. Rritja e prodhimit të përgjithshëm bujqësor, sipas degëve kryesore, paraqitet si vijon (me çmimet e vitit 1960):

Në milion lekë

Nr.	Emërtimi	1938	1961	1961 në përqindje kundrejt 1938
	Vëllimi i përgjithshëm i prodhimit bujqësor	13 068	26 674	204
	Nga ky :			
1.	Bimët e arave	5 593	12 285	220
	Nga të cilat :			
	Drithërat e bukës	3 718	5 237	141
	Bimët industriale	279	2 232	800
2.	Fruti-vitikultura	826	3 433	416
3.	Blegtoaria	6 642	10 125	152
4.	Ekonomia pyjore dhe bimët mjekësore	7	831	

Nga këto të dhëna del konkluzioni se bimët industriale dhe fruti-vitikultura janë rritur me ritme shumë më të shpejta se prodhimi blegtoral e sidomos ai i drithërave të bukës. Nga më sipër del se është përmirësuar edhe struktura e prodhimit bujqësor. Kështu, me gjithë rritjen absolute shumë të madhe, pesha specifike e prodhimit të drithërave ishte ulur nga 30, 9 për qind më 1938 në 21,6 për qind më 1961, ndërsa ajo e blegtorisë është ulur nga 50,8 për qind në 38 për qind. Në të njëjtën kohë pesha specifike e fruti-vitikulturës është rritur nga 6 për qind në 13 për qind dhe ajo e bimëve industriale nga 2 për qind në 8,3 për qind.

Duke marrë parasysh lëkundjet që pëson prodhimi bujqësor nga njëri vit në tjetrin, një krahasim më të mirë do të na jepte realizimi mesatar si pesëvjeçar i prodhimit bujqësor me numrin e popullsisë të llogaritur në këtë bazë. Për periudhën 1956—1960 prodhimi mesatar vjetor, për frymë, i popullsisë është rritur 17 për qind më shumë në krahasim me vitin 1938. Kjo rritje nuk është e vogël, por megjithatë ajo është e pamjaftueshme, po të marrim parasysh faktin se në mënyrë të vazhdueshme është rri-

tur e po rritet niveli i jetesës së masave punonjëse, se shteti ka bërë investime të mëdha për modernizimin e bujqësisë.

Në saje të rritjes së prodhimit dhe të politikës së drejtë të Partisë në çështjen e çmimeve dhe të grumbullimit të prodhimeve bujqësore e blegtorale, janë rritur edhe të ardhurat e fshatarësisë. Kështu, të ardhurat reale të fshatarësisë, për frymë, në vitin 1961 ishin 35,3 për qind më të mëdha se në vitin 1950, ndërsa me vitin 1938 as që mund të bëhet krahasim. Niveli i jetesës së fshatarësisë është përmirësuar vazhdimisht edhe në drejtim të arësimit, shëndetësisë dhe ndërtimit të banesave të reja.

Këto suksese të rëndësishme në lëmin e zhvillimit të bujqësisë janë shprehje e politikës së drejtë të Partisë sonë dhe të punës së madhe që ka bërë fshatarësia jonë punonjëse.

Me gjithë sukseset e arritura në bujqësi, ritmi i shtimit të prodhimit bujqësor akoma nuk u përgjigjet kërkesave që lindin nga shtimi me ritme të shpejta i popullsisë së vendit tonë dhe sidomos plotësimit të nevojave të saja, që rriten vazhdimisht. Si rezultat i të metave në punët e bujqësisë dhe sidomos i mosshfrytëzimit si duhet të të gjitha mundësive që ekzistojnë në bujqësi, shtimi i prodhimit bujqësor nuk ka qenë i mjaftueshëm që të kënaqë si kërkesat e popullsisë që shtohen vazhdimisht edhe nevojat e industrisë dhe ato të eksportit. Dihet se çfarë zhvillimi të vullshëm ka marrë industria jonë këta vjetët e fundit. Në vitin 1961 prodhimi i industrisë ishte 27 herë më i madh në krahasim me vitin 1938, ndërsa vlera e prodhimit bujqësor është rritur vetëm 104 për qind. Në të njëjtën kohë numri i popullsisë së vendit tonë është rritur 60 për qind, kurse prodhimi i drithërave dhe i blegtorisë, siç u tha më lart, është rritur përkatësisht vetëm 41 për qind dhe 52 për qind.

Sot, përpara nesh, shtrohen detyra të mëdha për shtimin me ritme më të shpejta të prodhimeve bujqësore e blegtorale, duke ndjekur të gjitha rrugët dhe duke i shfrytëzuar të gjitha mundësitë në drejtim të zgjerimit të sipërfaqeve të mbjella, por sidomos në drejtim të shtimit të rendimenteve në bujqësi.

Deri më sot, prodhimi bujqësor në vendin tonë është rritur më shumë për llogari të rritjes së sipërfaqeve të tokës së mbjellë dhe më pak nga rritja e rendimenteve. Kështu, prodhimi i përgjithshëm bujqësor në vitin 1961, siç u tha më lart, ishte 104 për qind më i madh se në vitin 1938, ndërsa sipërfaqja e tokës nën kulturë gjatë kësaj periudhe u rrit vetëm 64 për qind. Në këtë mënyrë, rritja e prodhimit të përgjithshëm bujqësor u shtua 62 për qind për llogari të sipërfaqes së tokës dhe vetëm 38 për qind për llogari të rendimenteve. E kundërta duhet të ndodhë gjatë pesëvjeçarit të tretë. Sikurse del nga detyrat që shtroi Kongresi IV i Partisë, sipërfaqja e tokës nën kulturë në vitin 1965 do të jetë vetëm 13 për qind më shumë se në vitin 1960, ndërsa pro-

dhimi i përgjithshëm bujqësor do të jetë 72 për qind më i madh. Pra, peshën kryesore të rritjes së prodhimit bujqësor në pesëvjeçarin e tretë do ta ketë rritja e rendimenteve të kulturave bujqësore e blegtorale.

Plotësimi i detyrave të planit të pesëvjeçarit të tretë, duke u nisur nga kjo bazë, kërkon luftë dhe përpjekje të mëdha për shfrytëzimin e tokës në thellësi, për rritjen e rendimenteve për çdo hektar tokë, pse këtu qëndron baza kryesore për shtimin e prodhimit bujqësor në të ardhshmen. Atje ku janë shfrytëzuar mirë këto rezerva, atje ku toka është shfrytëzuar më mirë, në thellësi, me një bujqësi sa më intensive, janë rritur në mënyrë të dukshme rendimentet në prodhimet bujqësore. Sa kohë që do të kalojë, aq më i vështirë do të jetë zgjerimi i bujqësisë në sipërfaqe, sepse, siç dihet, territori i vendit tonë është malor dhe, si rrjedhim, perspektiva e zgjerimit të sipërfaqeve të mbjella në të ardhshmen është relativisht e kufizuar. Në bazë të një studimi të përafërt del se në një perspektivë të largët, për 2 — 3 pesëvjeçarët e ardhshëm, tokat që mund të vihen nën kulturë në të gjithë Republikën mund të arrijnë në një sipërfaqe prej rreth 700-750 mijë hektarësh, nga 508 mijë hektarë që do të arrijnë në vitin 1965. Por këtu duhet shënuar se në të gjithë Republikën vetëm rreth 400 mijë hektarë mund të punohen me traktor dhe mjaft toka që mbeten pa u hapur, pas vitit 1965, janë të tilla që mund të shfrytëzohen për zhvillimin e fruti-vitikulturës.

Lidhur me sa u tha më lart, sipërfaqja nën kulturë për çdo frymë të popullsisë së vendit, në krahasim me vitin 1938, si për vitin 1960 ashtu edhe për vitin 1965, bile edhe pas 10-15 vjetësh, megjithëse mund të arrijë 700-750 mijë hektarë gjithsej nën kulturë, prapëseprapë mbetet relativisht e ulët. Për shembull, në qoftë se në vitin 1938 për çdo frymë të popullsisë kishte 0,28 ha. tokë nën kulturë, në vitin 1965 do të kemi 0,27 ha. Po të arrinim në 710 mijë hektarë në 1980, duke marrë parasysh dhe shtimin normal të popullsisë, në atë kohë, ne do të kishim 0,26 ha. tokë për çdo frymë, d.m.th. më pak se më 1938. Sipërfaqja për frymë që ne kemi sot, është shumë e ulët në krahasim me çdo vend të Ballkanit dhe të Evropës. Pra, sipërfaqja shumë e kufizuar e tokës së punueshme na detyron që të përqendrojmë forcat dhe mjetet për shtimin e prodhimit bujqësor, për shfrytëzimin në thellësi dhe sa më të mirë të tokës, të marrim prodhime sa më të larta për çdo hektar të mbjellë, d.m.th. të kalojmë në një bujqësi gjithnjë e më intensive, në mënyrë që vëllimi i përgjithshëm i prodhimit bujqësor, veçanërisht prodhimi i drithit, mishit, qumështit, të rritet me ritme të shpejta, për të përballuar si nevojat në rritje të popullsisë, ashtu edhe nevojat e tjera të ekonomisë popullore.

Duke u nisur nga zbatimi i detyrave të mëdha që shtrohen para bujqësisë sonë për shtimin e prodhimeve bujqësore e bleg-

torale brenda pesëvjeçarit të tretë, si dhe për të hedhur bazat për një shtim më të shpejtë të prodhimeve bujqësore në pesëvjeçarët e ardhshëm, kuptohet qartë se sa i drejtë dhe i rëndësishëm është orientimi që u dha nga shoku Enver në Kongresin IV të Partisë sonë.

«... rruga kryesore — tha shoku Enver — për zhvillimin e bujqësisë dhe shtimin e prodhimeve bujqësore e blegtorale për pesëvjeçarin e tretë dhe për më vonë, pa pashuar luftën për hapjen e tokave të reja, është rritja e pandërprerë e rendimenteve... duke u bazuar në kushtet tona si vend me tokë të punueshme shumë të kufizuar, të merren masa që të kalojmë në një bujqësi intensive»¹.

Sikurse shihet, bujqësia jonë do të kalojë nga një bujqësi ekstensive që ka qenë, në një bujqësi sa më intensive, duke përqendruar kujdesin kryesor në rritjen e rendimentit të kulturave bujqësore me ritme më të shpejta se rritja e sipërfaqeve të mbjella. Kjo është detyra kryesore që shtrohet sot para nesh për zhvillimin e shpejtë të bujqësisë, për sigurimin e rritjes së vazhdueshme të prodhimit bujqësor.

I. — KALIMI I BUJQËSISË SONË SOCIALISTE NË NJË BUJQËSI INTENSIVE ËSHTË RRUGA KRYESORE PËR SIGURIMIN E RRRITJES SË VAZHDUESHME TË PRODHIMIT BUJQËSOR

Ç'kuptojmë me intensifikimin e bujqësisë? Me intensifikimin e bujqësisë, shkenca ekonomike kupton rritjen sistematike të investimeve, shtimin e mjeteve të prodhimit, të sasisë e cilësisë së punës, rritjen sistematike të nivelit agroteknik për të shtuar pje-llorinë e tokës dhe për të marrë më shumë prodhime bujqësore e blegtorale nga e njëjta sipërfaqe toke.

Në lidhje me këtë, Marks thoshte se në kuptimin ekonomik, si kulturë intensive ne nuk kuptojmë gjë tjetër veçse koncentrimin e kapitalit në të njëjtën sipërfaqe toke. Duke folur për bujqësinë intensive V.I. Lenini theksonte se ajo zhvillohet kryesisht jo me anë të shtimit të sasisë së tokës së punueshme, por me anë të përmirësimit të cilësisë së punimit, me anë të shtimit të masave të kapitalit që investohet në sasinë e mëparshme të tokës.

¹ Shih: Enver Hoxha. Raport mbi aktivitetin e Komitetit Qendror të PPSH, Kongresi IV i PPSH, fq. 94-95. Tiranë 1961.

A i kemi ne kushtet organizative, materiale dhe teknike që bëjnë të mundur ecjen drejt intensifikimit sa më të madh të bujqësisë? A ekzistojnë mundësi reale që ne të realizojmë detyrat që shtroi Kongresi IV i Partisë për të shtuar rendimentin e kulturave bujqësore dhe produktivitetin e bagëtisë me ritme më të shpejta se zgjerimi i sipërfaqeve të mbjella dhe shtimi i numrit të krerëve të bagëtisë? Po, ne i kemi kushtet objektive për intensifikimin e bujqësisë. Te ne tani ekzistojnë mundësitë reale për rritjen më të shpejtë të rendimentit të kulturave bujqësore dhe të produktivitetit të blegtorisë.

Pushteti popullor ka bërë një punë kolosale deri më sot për krijimin e premisave që bëjnë të mundur intensifikimin e bujqësisë. Organizimi socialist i ekonomive të mëdha bujqësore, i kooperativave bujqësore dhe i ndërmarrjeve bujqësore shtetërore, ndërtimi i sistemeve të mëdha të kullimit e të ujitjes, forcimi dhe zgjerimi i bazës tekniko-materiale të bujqësisë, sidomos mekanizimi i bujqësisë, përdorimi në shkallë të gjerë i farërave të zgjedhura etj. për ngritjen e rendimentit të drithërave dhe të bimëve industriale, rritja me ritme të shpejta e sipërfaqeve të mbjella me pemë frutore, vreshta, agrume e ullinj, futja dhe përhapja e kulturave të reja industriale dhe foragjere, zgjerimi i sipërfaqeve të mbjella me perime e patate, mbjellja e kulturave të dyta, përdorimi në një shkallë më të madhe i plehrave organike dhe plehrave të ndryshme që ndodhen në vend, si dhe i plehrave kimike, plotësimi i vazhdueshëm i nevojave me kuadro e specialistë, sigurimi i udhëheqjes së drejtë operative të bujqësisë nga ana e organeve shtetërore dhe të Partisë, — të gjitha këto së bashku pasqyrojnë, në mënyrë të koncentruar, tërësinë e investimeve të mëdha kapitale që ka bërë pushteti popullor në sektorin e bujqësisë dhe që kanë krijuar premisat e domosdoshme, kushtet paraprake për kalimin në një bujqësi sa më intensive.

Mbi këto baza mbështetemi kur shtrojmë çështjen se sot te ne ekzistojnë mundësitë reale për rritjen me ritme më të shpejta të prodhimeve bujqësore e blegtorale për çdo njësi toke.

A. — MASAT QË DUHEN MARRË PËR NGRITJEN E NIVELIT AGROTEKNIK NË LARTËSINË E DETYRAVE TË NJË BUJQËSIE INTENSIVE (ZBATIMI I KODIT AGROTEKNIK)

Sikurse dihet, rritja e rendimenteve të kulturave bujqësore varet kryesisht nga shkalla e zbatimit të kompleksit të masave agroteknike, nga të tëra hallkat që përbëjnë kodin agroteknik. Atëhere, ç'masa duhet të marrim për ngritjen e nivelit të përgjithshëm agroteknik në lartësinë e detyrave të një bujqësie intensive?

1. — Ta plugojmë tokën thellë

Sipas të dhënave të kërkimeve shkencore bujqësore të bëra në vendin tonë dhe në vende të tjera, punimi i thellë i tokës (qilizma) sjell ndryshime të rëndësishme në vetitë fiziko-mekanike të tokave bujqësore. Me një fjalë, punimi i thellë ose qilizma, përmirëson shumë regjimin ujqor dhe termik të tokës dhe influencën direkt në rritjen e pjellorisë së saj. Në kushtet e krijuara nga thellimi i brazdës, sistemi rrënjor dhe pjesa ajrore e bimëve zhvillohen në kushte më të përshtatshme dhe, si pasojë, sigurohet një prodhueshmëri më e madhe se sa në kushtet kur punimi bëhet në thellësi më të vogla. Punimi i thellë i tokës, kur bëhet gjatë verës, është metoda kryesore dhe mjeti më efektiv për luftimin e barërave të këqia.

Shkalla e thellimit të brazdës duhet të bëhet në vartësi të plotë me trashësinë e horizontit humusor të tokës. Në shumicën e tokave bujqësore, me pak përjashtime, sipas të dhënave të ekspeditës pedologjike të Institutit të lartë shtetëror të bujqësisë, thellësia e horizontit humusor sillet rreth 35-40 cm. Sigurisht punimi i thellë mund dhe duhet të shkojë edhe 5-10 cm. më shumë, pa dëmtuar pjellorinë e tokës.

Problemi i efektit të punimit të thellë, sipas eksperimenteve të bëra për kulturën e pambukut, në bazë të të dhënave masatare trevjeçare të Institutit të lartë shtetëror të bujqësisë, paraqitet si më poshtë:

1. —	Punimi 18-22 cm. me plug e paraplor	rendimenti	100%
2. —	» 25-30 cm. » » » »	»	107%
3. —	» 30-35 cm. » » » »	»	110%
4. —	» 35-40 cm. » » pa plor, pa vesh »	»	103%
5. —	» 45-50 cm. » plug «Martinelli» »	»	119%
6. —	» 55-60 cm. » » » »	»	115%

Këto të dhëna janë jo të plota, sepse kufizohen vetëm në eksperimentet e Institutit të lartë shtetëror të bujqësisë, por eksperiencia e shumë kooperativave bujqësore ka treguar se vetëm për efekt të punimit të thellë 45 cm., rendimenti i drithit është rritur 8-10 kv/ha.

Sidoqoftë, nga eksperiencia e Institutit të lartë shtetëror të bujqësisë, thellësia më e favorshme është ajo prej 45-50 cm. Të përafërta janë edhe rezultatet krahasuese të provuara në ndërmarrjet bujqësore, ku rritja e rendimentit të pambukut në tokat e punuara thellë 45-50 cm. ka qenë 36,5 për qind më shumë në Lushnjë dhe

17,5 për qind më shumë në Fier, në krahasim me rendimentin që është marrë nga punimi në thellësi 25-30 cm.

Të dhëna mjaft bindëse mbi efektin e punimit të thellë të tokës për shtimin e rendimentit të kulturave bujqësore japin edhe provat në praktikën e gjerë të prodhimit, si në ndërmarrjet ashtu edhe në kooperativat bujqësore.

Gjatë të korrurave të vitit 1962, si rregull, të gjitha ngastrat e pluguara thellë mbi 30-35 cm. e të mbjella me grurë, kanë dhënë rendimente më të larta se sa tokat që janë pluguar në thellësi të zakonshme. Në Ndërmarrjen bujqësore shtetërore të Llakatundit, në 120 hektarë të mbjellë me grurë të llojit «San Pastore», të pluguar gjatë muajve korrik-gusht në thellësinë 45-50 cm., u muarën mesatarisht 22 kv/ha. dhe me grurë të llojit «Senator Kapeli» të pluguar në të njëjtën kohë e thellësi u muarën 17 kv/ha. Në Ndërmarrjen bujqësore shtetërore të Beratit, në 26 hektarë të pluguar 45-50 cm. u muarën mesatarisht 32 kv/ha.; në Shkodër, në 25 hektarë, u muarën 27 kv/ha.; në Lushnjë u muarën 50 kv/ha. etj. Kooperativat bujqësore të rrethit të Korçës kanë marrë kurdoherë rendimente më të larta në grurë e në panxhar sheqeri, kur i kanë pluguar tokat thellë. Kështu p.sh. në tokat e punuara qilizmë 40-50 cm. janë marrë 30-35 për qind më shumë prodhime në panxhar sheqeri, misër e patate dhe në disa parcela të kooperativave të Sovjanit, Maliqit e Përgut prodhimi është rritur deri dyfish. Më 1961 kooperativa e Zemblakut në një ngastër prej 15 hektarësh të punuar qilizmë, mori 305 kv/ha. panxhar, ndërsa në të gjithë sipërfaqen mori mesatarisht 195 kv/ha.; kooperativa e Sovjanit, vitin e kaluar, në 12 hektarë të punuar qilizmë, me parabitë panxhari mori 22 kv/ha. grurë, ndërsa rendimenti mesatar i gjithë kooperativës ishte 16,5 kv/ha. Sivjet kooperativa e Zemblakut në 40 hektarë qilizmë mori mbi 30 kv. grurë për hektarë, ajo e Pojanit në 50 hektarë mori 28 kv. grurë për hektar, e Rrëmbecit në 20 hektarë mori mbi 30 kv. grurë për hektar etj.

Rezultatet e provave që janë bërë lidhur me luftimin e barërave të këqia tregojnë se pakësimi i tyre (i barërave të këqia) shkon në raport me thellësinë e punimit të tokës.

Jo më kot fshatarët thonë se qilizma është në fakt përtëritje e tokës, një qilizmë është baras me një plehërim të mirë. Të gjitha të dhënat krahasuese të mësipërme tregojnë se sa e drejtë dhe e rëndësishme është porosia që bëri Kongresi IV i Partisë për punimin e thellë të tokës. Këtë problem duhet ta ndjekim me seriozitetin më të madh dhe të merren të gjitha masat për të praktikuar në shkallë të gjerë punimin e thellë të tokave. Puna e bërë deri më sot në ndërmarrjet bujqësore dhe kooperativat bujqësore në lidhje me plugimin e thellë nuk mund të konsiderohet veçse si fillim. Prandaj, Ministria e Bujqësisë, organet e bujqësisë në rrethet e lokalitete, të gjitha ndërmarrjet dhe kooperativat bujqësore,

punimin e thellë të tokës (qilizmën), duhet ta konsiderojnë si një nga masat më të rëndësishme agroteknike për rritjen e rendimentit të kulturave bujqësore.

Ne sot i kemi të gjitha mundësitë teknike dhe organizative për të kaluar në punimin e thellë të tokës në shkallë të gjerë. Në vitin 1965, numri i traktorëve në 15 kuaj-fuqi do të arrijë në 9 000 ose 118 për qind më shumë se në vitin 1960. Kështu në vitin 1965, për çdo 100 hektarë tokë are të mundshme për mekanizim, do të kemi 3,14 traktorë në 15 kuaj fuqi, nga 1,6 që kishim në vitin 1960 dhe SMT-të, në vitin 1965, do të kryejnë një punë baras me 8,1 hektarë unitet hamullor për çdo hektar fizik arë, kundrejt 1,69 hektar unitet hamullor që kanë kryer në vitin 1956.

Fondi i tokës arë në vitin 1962 është 434 850 hektarë, nga të cilët rreth 60 000 hektarë i takojnë sektorit shtetëror. Sipas disa llogaritjeve të përafërta rezulton se në të gjithë Republikën rreth 250 000 hektarë janë toka fushore, të cilat mund të plugohen thellë me plugje speciale dhe rreth 70 000 hektarë janë toka kodrinore të mekanizueshme. Pra, gjithsejt mund të mekanizohen rreth 320 000 hektarë tokë.

Përsa i përket zonës fushore, baza kryesore materiale për plugimin e thellë janë traktorët, plugjet speciale dhe një pjesë plugjesh të tjera që mund të adaptohen për këtë qëllim. Me plugjet speciale që disponohen, krahas çeljes së tokave të reja, në mënyrë të sforcuar mund të punohen rreth 30 000 hektarë d.m.th. rreth 10 për qind e sipërfaqes; ndërsa Kongresi IV i Partisë vuri detyrën që tokat të plugohen thellë (qilizmë) një herë në çdo 3-4 vjet. Ne duhet të përpiqemi që çdo kooperativë, çdo ekonomi bujqësore shtetërore, çdo rreth, të marrë masa të tilla që detyra që shtron Kongresi IV jo vetëm të realizohet, por dhe të tejkalohet *duke arritur që në vitin 1965 punimi i thellë i tokës 40-50 cm. të bëhet një herë në 2-3 vjet dhe të arrijmë që në gjysmën e sipërfaqes nën kulturë të bëjmë plugimin e thellë çdo vit.* Për këtë qëllim është e nevojshme:

E para, të ngarkohet Këshilli i Ministrave që të sigurojë mjetet financiare për importimin e plugjeve speciale në sasinë e nevojshme. Ndërkaq, Ministria e Bujqësisë, komitetet e Partisë dhe komitetet ekzekutive të rretheve, të marrin masa të forta që stacionet e maqinave e të traktorëve dhe ndërmarrjet bujqësore shtetërore të rritin koeficientin e gatishmërisë teknike të plugjeve speciale dhe të sigurojnë një shfrytëzim sa më të madh të tyre.

E dyta, pavarësisht nga masat e mësipërme, organet përkatëse të Partisë e të pushtetit, një vëmendje të posaçme duhet t'u kushtojnë punimeve të thella me anë të krahëve të punës. Nuk do të ishte aspak e drejtë të nënvleftësohej punimi i thellë i tokës me krahë. Nga eksperiencia shumëvjeçare fshatarësia jonë e di

mirë sa vlerë ka qilizma e tokës. Në të gjitha rrethet, pa përjashtim, sidomos gjatë periudhës së dimrit, ka forca krahu të lira, që nuk përdoren në punë të tjera bujqësore. Prandaj është e domosdoshme që një pjesë e punimeve të thella të përballohet duke mobilizuar në radhë të parë, gjatë dimrit, krahët e punës të kooperativave bujqësore për të punuar tokën, sipas rastit, me dy dhe me tre bela thellësi. Në zonat fushore e kodrinore kooperativat bujqësore disponojnë rreth 200 000 krahë pune që punojnë në bujqësi, të cilët, duke bërë secili qoftë edhe 1 dynym qilizmë në vit, mund të bëjnë rreth 20 000 hektarë punime të thella në vit. Parulla mobilizuese le të jetë: *«Çdo kooperativist të bëjë jo më pak se 1 dynym qilizmë në vit me krahë».*

Duhet pasur parasysh që plugimi i thellë i tokës ose qilizma nuk përjashton në asnjë mënyrë luftën e vendosur që duhet bërë për plehërimin e tokave me plehra organike dhe kimike, as nuk përjashton nevojën e plugimit të dytë të tokës për bimët prashitëse, dhe atje ku është e nevojshme, edhe për bimët joprashitëse.

2. — Të sigurojmë plehërimin e tokës

Nëpërmjet plehërimit, sidomos me plehra organike, arrihet në përmirësimin e cilësive kimike dhe fizike të tokës, të cilat influencojnë në një masë të theksuar në ngritjen e rendimentit të kulturave bujqësore.

Me kujdesin e vazhdueshëm të Partisë e të qeverisë, një hap i madh përpara është bërë në drejtim të grumbullimit, manipulimit dhe shfrytëzimit të plehut organik. Nga rreth 500 000 ton pleh organik, që u përdorën në vitin 1959, në vitin 1960 u përdorën mbi një milion ton. Në lidhje me grumbullimin dhe shfrytëzimin e plehut organik kanë punuar më mirë rrethi i Korçës, i Shkodrës, i Elbasanit dhe i Fierit dhe ndërmarrjet bujqësore në Shkodër, në Maliq, në Tiranë, ferma «Gjergj Dimitrov», ajo e Sukthit në Durrës etj. Në përgjithësi, detyra e caktuar nga Komiteti Qendror i Partisë dhe nga qeveria për të grumbulluar mesatarisht 5 ton pleh organik për çdo hektar tokë nën kulturë, nuk është zbatuar nga asnjë rreth dhe ndërmarrje bujqësore, jo se nuk ka pleh, por nga që lufta për mbledhjen e të gjitha llojeve të plehut është akoma e pamjaftueshme. Gjithashtu nuk po merr rrugëzgjidhje përdorimi i leguminozeve për plehërimin e gjelbër.

Shteti çdo vit ka importuar sasi të mëdha plehu kimik, të cilat janë përdorur kryesisht për bimët industriale dhe për parcelat e farës.

Dihet efekti i plehrave për ngritjen e rendimenteve të kulturave bujqësore. Të dhënat eksperimentale dhe të prodhimit të gjerë

tregojnë se problemet të përdorimit racional të plehut, sidomos të plehut organik, të gjithë ne duhet t'i kushtojmë një vëmendje më të madhe. Stacioni qendror eksperimental i Lushnjës, gjatë tre vjetëve të fundit, ka provuar se duke hedhur në tokë 200 kv/ha. pleh stalle, rendimenti i pambukut është rritur 23 për qind më shumë, ndërsa duke hedhur 4,5 kv/ha. superfosfat dhe afro 2 kv/ha. nitrat amoniumi, rendimenti i pambukut është rritur në 31 për qind më shumë.

Në lidhje me grumbullimin dhe përdorimin e plehrave është e domosdoshme të marrim masa në këto drejtime:

E para, të shfrytëzohen plotësisht dhe me ekonomi të gjitha burimet e plehut organik që janë në vendin tonë. Kjo pasuri e madhe duhet të bëhet çështje e të gjitha masave punonjëse të bujqësisë. Vëmendja e punonjësve të bujqësisë duhet të përqëndrohet jo vetëm në shfrytëzimin e të gjitha burimeve të plehut organik, por edhe në manipulimin e mirë të tij, në shpërndarjen racionale dhe në kohën e duhur që bën efektin më të mirë për pasurimin e tokës dhe shtimin e prodhimit.

Burimet e plehut organik në vendin tonë janë të mëdha dhe të shumëllojshme.

a) Ka sasi të mëdha plehrash të blektorisë dhe të qyteteve, që nuk shfrytëzohen plotësisht. Në bazë të llogaritjeve me norma mesatare del se vetëm nga plehu i gjësë së gjallë, çdo vit mund të grumbullohen afro 2 000 000 ton pleh stalle; nga mbeturinat e të fshirat e qyteteve afro 150 000 ton, ndërsa nga fekalet dhe ujërat e zeza rreth 50 000 ton në vit. Për të gjitha këto sasi të vlefshme plehu duhet të merren masa që ato të grumbullohen dhe të përdoren për nevojat e bujqësisë dhe të *synohet që, një herë në 4 vjet, të hidhet mesatarisht rreth 200 kv. pleh organik për hektar.* Mundësitë janë që këtë ta bëjmë dhe duhet patjetër ta bëjmë.

...Lufta për plehun duhet të konsiderohet si lufta për të pasur më shumë bukë, mish, gjalpë. qumësht etj. Grumbullimi i plehut të blegtorisë nuk duhet të lihet në spontaneitet. Kjo punë duhet organizuar mirë. Çdo ndërmarrje shtetërore bujqësore dhe çdo kooperativë bujqësore duhet të ngrëjë skuadra të posaçme për grumbullimin e plehut, jo vetëm të bagëtive kolektive, por edhe të oborreve kooperativiste; por nuk mjafton vetëm puna për grumbullimin e plehut. Rëndësi të veçantë ka manipulimi i mirë i plehut, mënyra si do të përdoret për çdo kulturë bujqësore, koha më e përshtatshme që plehu të bëjë efekt për rritjen e prodhimit bujqësor. Të gjitha këto çështje kërkojnë që çdo ekonomi bujqësore shtetërore ose kooperativiste të mendojë seriozisht, të përgatitë kuadro që të merren me këtë punë në mënyrë që pasuritë e mëdha të plehut organik që kemi në vendin tonë të përdoren sa më mirë dhe të kenë sa më shumë efekt në shtimin e prodhimit bujqësor.

Grumbullimi dhe shfrytëzimi i ujërave të zeza, i gropave me plehra të ndryshme dhe të fshirave të qyteteve, si dhe i mbeturinave të industrisë e të tjera të bëhet një problem i madh për organet e bujqësisë, të shëndetësisë, të shërbimit komunal, të industrisë, për organizatat e Partisë dhe për organizatat e masave. Organet komunale të marrin masa për grumbullimin, manipulimin dhe kompostimin e të gjitha plehrave, të ujërave të zeza, të fshirave dhe të mbeturinave të tjera. . . Ministria e Ndërtimit dhe Drejtoria e ekonomisë komunale të kenë parasysh që projektimi i kanalizimeve të qyteteve të parashikojë edhe grumbullimin e ujërave të zeza për qëllime bujqësore, ato të mos derdhen nëpër lumenjtë ose në det, por të depozitohen në ambiente të posaçme ku të përpunohen që të bëhen të përshtatshme për t'u përdorur në arë për plehërimin e tokës.

Komitetet ekzekutive të këshillave popullore të rretheve, me anë të organeve përkatëse të shërbimit komunal, të shëndetësisë, të bujqësisë, të industrisë etj. brenda vitit 1962, të caktojnë stacionet për depozitimin dhe kompostimin e të fshirave dhe mbeturinave, si dhe vendet e ngritjes së fushave për depozitimin dhe kompostimin e materialeve fekale e të gropave septike. . .

b) Torfa, burim i vlefshëm plehu për pasurimin e tokës, nuk po shfrytëzohet. Me përjashtim të Korçës, Elbasanit deri diku dhe të Lushnjës, që sapo kanë filluar, në rrethet e tjera nuk po punohet për shfrytëzimin e torfës. Përdorimi i gjerë i këtij plehu të vlefshëm ka leverdi të madhe ekonomike. Duke u kompostuar me plehra të tjera organike, efekti i saj bëhet më i madh. Provat e bëra tregojnë se duke hedhur në tokë 400 kv/ha. pleh komposto (2/3 torfë + 1/3 fekale), rendimenti në grurë është rritur mbi 21 për qind dhe në pambuk mbi 26 për qind. Prandaj, si rregull, torfa të hidhet në arë, pasi të jetë kompostuar me pleh stalle ose fekale.

Në Maliq e në Tërbuf, tani për tani, të përdoret torfa e nxjerrë nga hapja ose pastrimi i kanaleve. Ndërkaq, është e domosdoshme që Ministria e Bujqësisë dhe ajo e Komunikacioneve, pa humbur kohë, të marrin masa për mekanizimin e ngarkimit dhe të shkarkimit të automjeteve, sidomos për zonën e Korçës, ku automjetet mund të shfrytëzohen fare mirë duke i ngarkuar me torfë gjatë rrugës kur shkojnë bosh për të marrë panxhar sheqeri në kooperativat bujqësore. Ministria e Bujqësisë dhe Komisioni i Planit të Shtetit, brenda tremujorit I 1962 të studjojnë mundësitë për shfrytëzimin e torfës së Maliqit, Tërbufit, Roskovecit dhe të Velipojës së Shkodrës dhe kudo që ka plehra torfike për plehërimin e tokave dhe të merren masat përkatëse për shfrytëzimin e kësaj torfe.

E dyta, plehërimi i gjelbër te ne praktikohet shumë pak. Përveç disa ndërmarrjeve bujqësore, si ajo e Vlorës, Sukthit, Lushnjës, Beratit etj. ekonomitë e zonave të tjera pothuajse nuk e prakti-

kojnë fare. Shumë teori bëhet për rëndësinë e plehut të gjelbër. Nuk ka punonjës të bujqësisë që të mos flasë se 1 hektar i mbjellë me bimë leguminoze dhe i përmbysur në formë të gjelbër, i jep tokës lëndë ushqyese barazi me rreth 200 kv. pleh stalle. Shumë ekonomi, sidomos ndërmarrjet bujqësore shtetërore, me provat e bëra, kanë treguar se me anë të plehërimit të gjelbër rendimenti i pambukut është rritur 3,4 kv/ha. dhe i misrit 5,1 kv/ha. Atëhere përse nuk përhapet metoda e plehërimit të gjelbër? Çfarë pritjet? Thonë se përhapja e plehërimit të gjelbër pengohet nga mungesa e farërave të bimëve leguminoze. Por, po të merret me seriozitet ky problem nga organet e bujqësisë, nga specialistët e saj, nga drejtuesit e kooperativave bujqësore dhe nga organizatat e Partisë, problemi i farës do të ishte zgjidhur. Kudo, në fshatra, ka qenë zakon mbjellja e bathës, por asnjëri nuk interesohet të mblihet kjo për farë, presin që fara t'u sigurohet nga shteti. Ky qëndrim nuk është i drejtë. Gjatë vitit 1962 ndërmarrjet bujqësore shtetërore kanë hedhur bazat për prodhimin e farës së bathës e të lupinit, i cili përdoret me sukses, kryesisht në tokat ranore e të varfëra dhe në ato që kanë reaksion acidik. Ato duhet të furnizojnë që këtë vjeshtë kooperativat bujqësore me farë bathe dhe farë lupini sa më shumë që të jetë e mundur, por është e nevojshme që kooperativat bujqësore, duke filluar që këtë vit, të marrin masa t'i sigurojnë vetë këto farëra. Duhet bërë çmos që nga viti i ardhshëm dhe sidomos në vitin 1964. të mbillet sa më shumë bathë dhe lupin për përmbysjen për plehërim të gjelbër të tokave.

Pas vitit 1965 plehërimi i gjelbër të zgjerohet në të gjithë zonën bregdetare dhe të arrihet që në një të ardhshme jo shumë të largët, rreth 10 për qind e sipërfaqes së tokave nën kulturë të plehërohet duke përmbysur kulturat leguminoze.

E treta, ne kemi përdorur dhe do të përdorim edhe për disa vjet deri në ngritjen e industrisë sonë kimike, sasi të kufizuara plehrash kimike. Prandaj, detyra e punonjësve të bujqësisë është që t'i përdorin plehrat kimike me nikoqirllëk të madh dhe kryesisht për parcelat e farës dhe për kulturat më të rëndësishme. Atje ku ka mundësi dhe forcë krahu të mjaftë të gjitha llojet e plehrave si plehu organik dhe plehu kimik, sidomos plehu azotik, për bimët prashitëse, të përdoren jo në sipërfaqe, por t'i hidhen çdo bime rrënjë më rrënjë, me dorë. Kujdes i veçantë duhet t'i kushtohet prodhimit të plehrave fosfatike në vend. Ministria e Industrisë duhet ta marrë me seriozitetin më të madh punën për prodhimin e plehrave fosfatike dhe ajo e Bujqësisë të marrë të gjitha masat për përdorimin e tyre në të gjitha tokat që kanë nevojë për këtë lloj plehu.

3. — Të luftojmë kundër lagështirës, erozionit dhe thatësirës

Të organizohet më mirë lufta kundër lagështirës së tepërt të tokave në dimër: Shqipëria është një nga vendet më të lagëta të Evropës dhe ka një regjim jonormal në shpërndarjen e reshjeve vjetore, të cilat, sipas zonës, lëvizin nga 800 në rreth 2 000 m/m dhe numri i ditëve me shi nga 70 në 115 në vit. Në periudhën vjeshtë-dimër bie 70 për qind e reshjeve, kurse në pranverë rreth 10 për qind.

Këto kushte klimatike, kaosi hidraulik që trashëguam nga regjimet e kaluara, relievi dhe përbërja e tokave të fushave tona bënë që fill pas çlirimit, Partia dhe qeveria t'u kushtonin kujdesin më të madh problemeve ujore të bujqësisë, duke e konsideruar zgjidhjen e tyre si një nga faktorët më të domosdoshëm e më të rëndësishëm për sigurimin e prodhimeve bujqësore, në përputhje me kërkesat e ekonomisë.

Investimet e bëra për ndërtimin e veprave të bonifikimit (kullim e vaditje), deri në fund të vitit 1961, llogariten në 6 miliard. e 300 milion lekë. Këto investime janë kryer në një sipërfaqe bujqësore prej rreth 214 000 hektarësh. Si rezultat i kësaj pune të madhe nga tharja e kënetave e moçaleve është përfituar mbi 23 000 hektarë tokë e re, janë përmirësuar mbi 125 000 hektarë tokë ara. Gjithashtu në këto investime u bë e mundur që sipërfaqja e tokës nën ujë të rritej nga 29 000 hektarë, që ishte para çlirimit, në 156 000 hektarë në vitin 1961, ose 38,6 për qind e gjithë sipërfaqes së mbjellë të Republikës.

Shpenzimet kolosale që ka bërë shteti për bonifikimet nuk i kanë dhënë akoma rezultatet e dëshiruara, sepse rendimentet e kulturave bujqësore jo vetëm që janë shumë larg llogaritjeve e studimeve të bëra me rastin e projektimit të këtyre veprave, por, me ndonjë përjashtim, ato qëndrojnë në një nivel të ulët, pothuajse në atë nivel që ishin këtu e 4-5 vjet të shkuara. Byroja Politike kritikoi Ministrinë e Ndërtimit, e cila nuk ka marrë masat për të përfunduar ndërtimin e veprave të bonifikimit në afatet e caktuara në plan dhe nuk ka kryer në mënyrë frontale të gjitha objektet që kondicionojnë përfundimin në kompleks të veprës. Byroja Politike kritikoi gjithashtu dhe vuri para përgjegjësisë Ministrinë e Bujqësisë dhe organet përkatëse të pushtetit e të Partisë, të cilat nuk kanë marrë të gjitha masat e nevojshme për të shfrytëzuar më mirë tokat e bonifikuara dhe për mirëmbajtjen e veprave të ndërtuara.

Cilat janë problemet dhe detyrat më të ngutshme që dalin në lidhje me kullimin e tokave dhe me luftën kundër lagështirës?

a) *Të përfundohen plotësisht dhe në afatet e caktuara veprat e bonifikimit.* Disa nga veprat e mëdha të bonifikimit akoma nuk kanë përfunduar plotësisht si p.sh. Tërbufi e Thumana; në disa

të tjera pjesët e përfunduara të veprave të ndryshme akoma nuk janë kolauduar dhe nuk kanë hyrë në shfrytëzim të plotë. Disa të tjera që kanë përfunduar ose janë në përfundim e sipër, kanë nevojë për studime dhe punime plotësuese dhe më në fund, të gjitha këto së bashku pengojnë si vënjen në eficientë të të gjithë veprës në tërë kompleksin e saj, ashtu edhe kullimin e fushave, të çdo ngastre e bloku veç e veç. Prandaj, Ministria e Ndërtimit, e cila është ngarkuar për kryerjen e këtyre objekteve dhe Ministria e Bujqësisë si investitore, të marrin masa sa më parë për të kryer plotësisht drejt dhe në kohën e caktuar të gjitha punimet, në mënyrë që veprat t'i dorëzohen në rregull bujqësisë dhe të shfrytëzohen plotësisht për qëllimin që janë ndërtuar.

Ministria e Ndërtimit duhet të përmirësojë punën e saj në veprat e bonifikimit. Të niset jo nga kryerja e vëllimit të punës për të dalë me plan të realizuar si vëllim, por nga ndërtimi kompleks, pjesërisht ose tërësisht i veprës, në mënyrë që bujqësia të mos pengohet në shfrytëzimin e tokës. Ministria e Bujqësisë duhet të kërkojë me këmbëngulje përmirësimin e cilësisë së punimeve nga ana e organizatave të ndërtimit që merren me bonifikimin, të marrë në dorëzim objektet e ndryshme dhe krejt veprën, kur çdo gjë të jetë bërë në përputhje të plotë me projektet e aprovuara.

b) *Të shfrytëzohen plotësisht veprat e bonifikimit, të tregohet më shumë kujdes për mirëmbajtjen e tyre.* Duhet thënë se pak përpjekje bëhen për shfrytëzimin e mirë të objekteve të bonifikuara dhe akoma më pak kujdes tregohet për mirëmbajtjen e tyre. Kjo situatë mund t'i sjellë dëme të mëdha ekonomisë bujqësore, prandaj Ministria e Bujqësisë dhe komitetet ekzekutive të rrethëve, ndërmarrjet e kooperativat bujqësore dhe drejtoritë e ujërave, duhet të marrin masa serioze për mirëmbajtjen e veprave të bonifikimit, për shfrytëzimin e të gjitha maqinerive që disponojnë dhe për mobilizimin e forcave të punës në mënyrë që çdo vit, para fillimit të dimrit, kullimi i ngastrave të mos pengohet në asnjë mënyrë nga mungesa e gatishmërisë së krejt veprës.

c) Por problemi qendror në periudhën e tanishme, kur janë kryer bonifikimet në fushat më të rëndësishme të vendit tonë, qëndron në *masat praktike që duhen marrë për kullimin e ngastrave.* Në këtë drejtim është bërë një punë e madhe. Rezultatet e arritura sivjet në prodhimin e të lashtave, përveç të tjerave, janë të lidhura ngushtë me punën këmbëngulëse që kanë bërë punonjësit e bujqësisë për kullimin e ngastrave. Megjithatë, nuk mund të thuhet se është bërë gjithshka për kullimin e ngastrave, përkundrazi, mbetet akoma një punë shumë e madhe për t'u bërë. Mjaft kuadro teknikë dhe punonjës të bujqësisë nuk i kanë të qarta akoma disa probleme që kanë të bëjnë me kullimin

dhe vetë Ministria e Bujqësisë nuk është marrë seriozisht me këtë problem.

Sistemimi i sipërfaqes dhe kombinimi i drejtë i këtij sistemi, për kullimin, ujitjen dhe për mekanizimin e punimeve bujqësore, janë probleme të lidhura shumë ngushtë me njëra-tjetrën. Në ç'drejtim duhen pluguar tokat, në të njëjtin drejtim, apo në drejtim të kundërt me kanalet e treta. Në ç'drejtim duhet të mbillen të lashtat (në përgjithësi bimët joprashitëse) dhe bimët prashitëse (misri, pambuku etj.)? Në ç'drejtim duhen hapur vijat kulluese e ujitëse, sa larg duhet të jenë këto nga njëra-tjetra, sa të thella e sa të gjera? Si duhet të sistemohet sipërfaqja e tokës, në formë «të rrafshët» apo në formë «kurriz peshku»? Këto janë disa çështje që kondicionojnë drejtpërdrejt në kullimin dhe ujitjen e ngastrës. Pa zgjidhur drejt këto çështje, në përputhje dhe në harmoni me sistemin e përgjithshëm të kullimit e të ujitjes së krejt zonës, nuk është e mundur të zgjidhet drejt problemi i kullimit dhe i ujitjes së ngastrës.

Punimi i tokës, mbjellja etj. nuk mund të lihen, sikurse veprohet akoma në shumë raste, në dorë të traktoristit ose të brigadierit të fushës. Pa caktimin e drejtimin të plugimit të tokave dhe të mbjelljes së bimëve nuk mund të trajtohet e të zgjidhet drejt çështja e sistemimit të sipërfaqes së tokave në formë «të rrafshët» ose «kurriz peshku», kjo nuk mund të zgjidhet sipas konsideracioneve subjektive të ndonjë specialisti. Nuk ka më vend caktimi spontan i drejtimin të hapjes së vijave kulluese ose të ujitjes, pa u mbështetur në kritere të shëndosha teknike. Këto çështje duhen njohur, duhen studjuar hollësisht dhe duhen udhëhequr e zgjidhur në mënyrë konkrete, në radhë të parë, nga komitetet ekzekutive të këshillave popullore të rrethëve që kanë organe të posaçme të bujqësisë dhe specialistë nga organet përkatëse të Ministrisë së Bujqësisë e të Ministrisë së Ndërtimit.

Në këtë drejtim duhet të merren këto masa:

E para, të mbahet në gjendje të mirë i gjithë rrjeti i kanaleve dhe sidomos kanalet e treta kulluese. Duhet të bëhet e qartë për të gjithë punonjësit e bujqësisë se çdo ngastër tokë, si rregull, mund dhe duhet të kullojë vetëm nëpërmjet kanaleve të treta kulluese. Nga kjo kuptohet se për kullimin e ngastrës, vijat kulluese që e përshkojnë, si rregull, duhet të derdhen në kanalet e treta. Veprojnë gabim ato kooperativa bujqësore që hapin vija kulluese kryq e tërthor, pa kritere teknike, që shpeshherë i lënë mënjane kanalet e treta dhe përpiqen që të hapin vija të thella duke i derdhur ujërat në kanalet e dyta e të para, ngandonjëherë edhe drejtpërdrejt në kolektorët kryesorë pa qenë aspak nevoja dhe duke lënë pas dore kanalet e treta.

E keqja më e madhe është se mjaft kooperativa bujqësore nuk i kanë hapur akoma kanalet e treta. Sipas të dhënave që ka Ministria e Bujqësisë, në tokat që përfshihen në zonën e bonifikuar të Zadrimës, Krujës, Kavajës, Myzeqesë së madhe, Roskovecit, Vrinës, Vurgut etj. mbeten për t'u hapur kanalet e treta kulluese edhe në rreth 20 000 hektarë tokë. Kjo gjendje nuk mund dhe nuk duhet të lejohet më tutje. Ka ardhur koha që t'i jepet fund një pakujdesie të tillë. Prandaj, organet përkatëse të Ministrisë së Bujqësisë dhe komitetet ekzekutive të këshillave popullore të rretheve të marrin menjëherë masat që kanalet e treta kulluese, në bloqet dhe në ngastrat që do të mbillen gjatë kësaj vjeshte, të hapen jo më vonë se deri në fund të muajit nëntor të këtij viti dhe në ato toka që do të mbillen në pranverën e ardhshme puna për kullimin e tokave të shpejtohet në mënyrë që gjatë muajve dhjetor-janar tokat të jenë kanalizuar dhe të mos mbajnë ujëra.

E dyta, të përgatiten fizikisht tokat për kullim (njëkohësisht edhe për ujitje), të bëhet sistemimi i sipërfaqeve të tokave. Pjesa më e madhe e fushave tona sot kanë një disnivel shumë të madh në sipërfaqen e tyre, ato paraqesin një relief natyral shumë të çrregullt, të keqësuar edhe më shumë nga shpyllëzimet, sistemimet, mbyllja e rrugëve dhe e kanaleve të vjetra, nga plugimet pa kujdes e pa kriter, plot gropa e sopa, ku më të mëdha e ku më të vogla, që pengojnë si kullimin ashtu edhe ujitjen e mekanizimin, gjë që influencon negativisht në rendimentin e të gjitha kulturave bujqësore.

Çështja se si duhet të sistemohen tokat për të kulluar ujërat, në formë «të rrafshët» apo «kurriz peshku», shpeshherë ngrihet si çështje e mënyrës së plugimit, duke lënë mënjanë një fakt me shumë rëndësi: për të pluguar rrafsh duhet që më parë tokat të rrafshohen. Rrafshimi i tokave është një ndërmarrje e vështirë që kërkon shpenzime të mëdha, maqineri të posaçme dhe kuadro për përdorimin e tyre, teknikë të mjaftueshme për matjet e projektimet dhe pas rrafshimit kërkon punë me cilësi shumë të lartë në plugimet.

Prandaj, në kushtet konkrete të vendit tonë, për sistemimin e sipërfaqeve të tokave forma më e mirë është ajo e «kurrizit të peshkut» sepse bëhet më lehtë dhe më shpejt, me vetë maqineritë bujqësore dhe brenda periudhave të punimeve bujqësore, nuk ka nevojë për kualifikim aq të lartë sa rrafshimi dhe mund të drejtohet nga vetë teknikët bujqësorë. Ky sistemim, në vetëvete, nuk kërkon pothuaj asnjë shpenzim shtesë dhe shpenzimet për ndryshimet eventuale të rrjetit dhe sidomos për lartësimin e rrjetit ujitës, do të jenë shumë më të vogla se ato të rrafshimit. Kështu, për tokat fushore të pasistemuara, që mbajnë lagështirë, sistemimi i tokës në formë «kurriz peshku» është jo vetëm mënyra më e lehtë,

por edhe mënyra më e shpejtë për të zgjidhur brenda pak vjetëve problemin e sistemimit të sipërfaqeve.

Ne duhet t'i përgatitim tokat që të evitohet mbajtja e lagështirës në dimër dhe të bëhet ujitja e rregullt e saj. Pikërisht për këto arsye sistemimit të sipërfaqes së tokave në përgjithësi organet e Partisë dhe të pushtetit dhe organet e bujqësisë duhet t'i kushtojnë një vëmendje shumë më të madhe se deri tani. Çështja e sistemimit të sipërfaqes së tokave, çështja e zhdukjes së gropave dhe e disnivelit të tokave, duhet të bëhet objekt i një fushate të madhe dhe, për t'ja arritur këtij qëllimi, të përdoren të gjitha mjetet, jo vetëm buldozerët, por edhe karrot, qerret, karrocet e dorës dhe puna e krahut. Ne duhet të marrim masa të atilla që, deri në fund të këtij pesëvjeçari, sipërfaqet e tokave fushore të pasistemuara që mbajnë lagështirë të kenë marrë formën e tyre përkatëse, «kurriz peshku» ose «të rrafshët», duke i dhënë prioritet punimit në formë «kurriz peshku» në të gjitha tokat fushore që kanë pjerrësi natyrale të vogël dhe që kullojnë e ujitën me vështirësi.

Në lidhje me problemin e sistemimit të sipërfaqes së tokave dhe me çështjet e tjera që kanë të bëjnë me ujitjen, është e domosdoshme dhe urgjente që komitetet ekzekutive të këshillave popullore të rretheve, me ndihmën e drejtëpërdrejtë të Ministrisë së Bujqësisë, të hartojnë brenda tremujorit të parë të vitit të ardhshëm, rregullore të posaçme, të cilat të zbatohen detyrimisht nga të gjitha NBSH-të, SMT-të dhe kooperativat bujqësore.

ç) *Të merren masa për mbrojtjen e tokave nga gërryerja (eruzioni)*: Sa problem i madh është kullimi për zonat fushore të vendit tonë, po aq preokupant dhe jo më pak i ndërlikuar është edhe problemi i gërryerjes për zonat kodrinore e malore. Mijëra hektarë tokë janë shterpëzuar në zonat kodrinore e malore nga shpërlarja dhe në zonën fushore nga mbathja e tyre me materiale të ngurta. Sipërfaqe të konsiderueshme i hiqen bujqësisë çdo vit për shkak të gërryerjeve anësore të përrrenjve e të lumenjve.

Por gërryerja nuk godet vetëm bujqësinë. Ajo rrezikon gjithashtu veprat e mëdha të bonifikimit në fushë, rrugët dhe urat e komunikacionit, rezervuarët e hidrocentraleve, fshatrat dhe jetën e popullit.

Për të vënë në dukje pasojat shkatërrimtare që sjell gërryerja mjafton të përmendim shifrat që vijnë: 95 për qind e të gjithë sipërfaqes tokësore të vendit tonë i nënshtrohet ku më shumë e ku më pak gërryerjes; rreth 150 000 hektarë, baras me 7,4 për qind të sipërfaqes tokësore kodrinore e malore, janë vatra rrëshqitjeje të një gërryerje intensive; rreth 55 000 hektarë, baras me 2,6 për qind të sipërfaqes së fushave tona, është gërryer ose mbathet me materiale të ngurta; rreth 150 000 — 160 000 hektarë tokë arë në kodra e në male, baras me 35 për qind të të gjithë sipërfaqes arë,

me pak përjashtime, për shkak të degradimit të tyre nga gërryerjet, japin prodhime të pakta.

Në të kaluarën fenomeni i gërryerjes në vendin tonë nuk është studjuar, megjithëse në shumë krahina populli ka tradita të mira në luftimin e tij. Vetëm pas çlirimit, me fillimin e ndërtimit të veprave të mëdha të bonifikimit dhe me fillimin e hapjes së tokave të reja në zonat kodrinore e malore, në radhën e problemeve të rëndësishme doli edhe ai i gërryerjes së tokave, pasi shkalla e mirëmbajtjes së veprave të ndërtuara dhe të atyre që do të ndërtohen, si dhe mundësia e zhvillimit të një bujqësie të përparuar, në fushë e në kodër, varet edhe nga masat që do të merren për luftimin e gërryerjes.

Krahas ndërtimit dhe mbrojtjes së veprave për bonifikimin e fushave, sot, megjithëse në një shkallë më të vogël se sa nevojat, janë kryer punime edhe për sistemimin e zonës malore. Këto punime kanë konsistuar në korrigjimin e shtretërve të përrenjve me anë veprash hidroteknike (prita e vepra të tjera forcimi) të shoqëruara, ku më shumë e ku më pak, edhe me pyllëzime të reja dhe me punime për përmirësimin e pyjeve të degraduara.

Punime të tilla janë kryer në pjesën ujëmbledhëse të përrenjve që i derdhin ujërat në fushën e Zadrimës, Thumanës, Kavajës, Lushnjës, Levanit, Elbasanit, Korçës, Beratit, Gjirokastrës, Vurgut; punime janë kryer në përrenjtë që i derdhin ujërat në agrumishtet e bregdetit etj.

Por, ndërsa po kryhen punime të konsiderueshme për të luftuar gërryerjet e fuqishme, shumë pak punime po kryhen për sistemimin e tokave të pjerrëta bujqësore, për rregullimin e rrjedhjes së ujërave në sipërfaqe dhe për mbrojtjen e tyre nga gërryerja. Është e natyrshme se prodhimi bujqësor në kodër nuk mund të përmirësohet pa zvogëluar pjerrësinë dhe pa gjetur mënyrën e afrimit të kushteve pedologjike të kodrës me ato të fushës. Këtij qëllimi i arrihet me anën e sistemimit të tokave të pjerrëta bujqësore.

Masat për sistemimin e tokave të pjerrëta bujqësore janë të një natyre organizative, hidroteknike dhe agroteknike. Një ndër masat organizative me rëndësi të veçantë për organet e bujqësisë është renditja e kulturave në përshtatshmëri me pjerrësinë e tokës. Faqet shumë të pjerrëta duhet të ruhen për kulturat frutore dhe për vreshtat, ndërsa për kulturat njëvjeçare — faqet më pak të pjerrëta duke synuar që në to të mbillen më shumë bimë joprashitëse. Kështu jo vetëm që mënyrat e sistemimit të tokës do të gjejnë zbatim më të mirë, por edhe bujqësia do të jetë më rationale, më e qëndrueshme dhe toka do të jetë më e mbrojtur nga gërryerjet.

Lidhur me masat hidroteknike, mënyrat e sistemimit janë të

shumta, por ne duhet ta përqëndrojmë vëmendjen në radhë të parë në mënyrat më të thjeshta, sikurse janë sistemimi i kanaleve horizontale, të përkulura apo të drejta dhe sistemimi i taracave të vazhdueshme ose ndërtimi i vetulloreve për kulturat drusore.

Ministria e Bujqësisë dhe organet e saj, bashkë me komitetet ekzekutive të këshillave popullore të rretheve, duhet të studjojnë me vëmendje të madhe eksperiencën shumë të vlefshme që ka fshatarësia për mbrojtjen e tokave nga gërryerjet, sidomos fshatarësia e bregut të detit, e Peshkopisë, e malësisë së Tiranës e gjetkë dhe ta përhapin atë sistematikisht.

Ndër masat agroteknike për të evituar gërryerjen, midis të tjerave, rëndësi e veçantë duhet t'i jepet punimit të thellë të tokës, sidomos në pjesën e sipërme të ngastrës. Duhet të vendoset një disiplinë e rreptë përsa i përket drejtimin të plugimeve në zonat kodrinore. Plugimet të bëhen në drejtim të kundërt me pjerrësinë dhe, kur kjo nuk është e mundur, është e domosdoshme që pas mbjelljes të hapen vija të tërthorta, diagonale me rrjedhjen natyrale të ujit, kundër gërryerjes, në distanca të afërta me njëra-tjetrën dhe të sigurohet një numër relativisht më i madh bimësh për hektar. Duhet ndaluar rreptësisht hapja e vijave kulluese, pas mbjelljes, në të njëjtin drejtim me rrjedhjen natyrale të ujërave në tokat kodrinore e malore.

Masat organizative, hidroteknike dhe agroteknike janë vendimtare lidhur me shtimin e prodhimit bujqësor në tokat kodrinore dhe me mbrojtjen e tyre nga gërryerjet. Mjafton të përmendim se në kodrat e Saukut, në një ngastër vreshti me pjerrësi 20 për qind e pasistemuar, me rreshta të vendosur sipas pjerrësisë dhe në rreth 4 000 bimë për hektar, u vërtetua një gërryerje prej 302 m³ për hektar; në një ngastër të dytë, me pjerrësi të një-llojtë, por të sistemuar me kanale horizontale dhe me rreshta të vendosur sipas vijave rushkulluese, u vërtetua një gërryerje prej 108 m³ për hektar, ndërsa në një parcelë të tretë në të njëjtën pjerrësi, ku, përveç ndërtimit të kanaleve dhe vendosjes së rreshtave sipas vijave rushkulluese, u krye edhe valëzimi i tokës, u vërtetua një gërryerje vetëm prej 28 m³ për hektar. Natyrisht, gërryerja e tokës do të ishte edhe më e vogël, në qoftë se vreshti do të kishte më shumë bimë për hektar; prandaj, në tokat e pjerrëta ku mbillen kultura frutore, sidomos vreshta, është e domosdoshme të hiqet dorë nga praktika e gabuar e mbjelljes së pak hardhive për hektar. Në toka të tilla duhet të synohet të mbillen 8 000 — 12 000 rrënjë hardhi për hektar, sipas eksperiencës së kooperativave të rrethit të Vlorës etj.

Del pra e nevojshme që, për të zbatuar detyrat që ka vënë Partia për shfrytëzimin e tokave kodrinore me kultura bujqësore,

të gjithë specialistët e bujqësisë, të pyjeve e të SMT—ve, duke shfrytëzuar e përmirësuar eksperiencën e gjatë të grumbulluar nga fshatarësia jonë, të studjojnë mënyrat më të përshtatshme për sistemimin e tokave bujqësore të pjerrëta, si dhe kulturat që duhen mbjellë në këto toka.

Të organizohet mirë lufta kundër thatësisirës. Lufta kundër thatësisirës, sigurimi i vlagës dhe i ujitjes së bimëve prashitëse, është kushti i dorës së parë për rritjen e prodhimit bujqësor dhe intensifikimin e bujqësisë. Lufta kundër thatësisirës duhet të bëhet në tri drejtime:

E. para, të ruhet vlaga në tokë. Kjo arrihet nëpërmjet zbatimit në kompleks të masave agroteknike që kanë të bëjnë me formimin dhe përmirësimin e strukturës së tokës, me kullimin e përsosur, me plehërimin, me punimin e thellë, me plugimin në kushte të mira, me lesimin etj. Në pranverë, te ne, një rëndësi të posaçme për ruajtjen e vlagës, merr lesimi dhe branimi i tokës menjëherë pas plugimit. Prandaj, për ruajtjen e vlagës në tokë, punonjësit e bujqësisë duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme.

E. dyta, të merren masa për shfrytëzimin e plotë dhe me ekonomi të objekteve ujitëse, sipas kapacitetit të projektuar; të vërmirësohen metodat e ujitjes; të vihen të gjitha forcat për ndërtimin e objekteve të reja ujitëse.

Duhet thënë se shfrytëzimi i kapacitetit të veprave ujitëse, shfrytëzimi i ujit dhe teknika e ujitjes në vendin tonë, me disa përjashtime, bëhen me shumë të meta. Përdorimi i ujit dhe teknika e ujitjes nuk bëhen mirë. Kjo ndodh sepse akoma nuk është përvetësuar teknika e ujitjes dhe tokat janë të pasistemuar, nga ana tjetër, sepse mungojnë kanalet e treta të ujitjes në një sipërfaqe të konsiderueshme. E keqja është se për këtë punë tregohet pak kujdes për të mos thënë aspak. Drejtoritë e ujërave nuk i kanë dalë për zot kësaj ekonomie, nuk tregohen të rrepta për disiplinimin, kontrollin dhe ndarjen e ujërave sipas udhëzimeve dhe dispozitave në fuqi. Organet e bujqësisë, specialistët dhe drejtuesit e ndërmarrjeve dhe kooperativave bujqësore problemën e përgatitjes së tokave për ujitjen e kanë lënë në harresë; mungon organizimi i skuadrave ujitëse, natën uji nuk shfrytëzohet sa duhet, tokat përmythen dhe tejkalohen normat e ujitjes, gjë që, përveç harxhimit të tepërt të ujit, ka sjellë edhe dëme në bimët; nga derdhja e ujit jashtë masës ka pasur dëmtime në strukturën e tokës dhe atje ku tokat janë të kripura ka pasur raste kripëzimi. Gjithë këto dobësi në përdorimin e ujit dhe në ujitje vijnë se as vetë agronomët, që janë organizatorët e prodhimit, nuk e ndjekin çështjen e ujitjes si një problem me rëndësi të ma-

dhe agroteknike dhe as që e ngrenë zërin të merren masa atje ku shkelen rregullat teknike të ujitjes.

Shfrytëzimi i aftësisë ujitëse të objekteve është akoma i ulët. Në vitin 1961 kjo aftësi u shfrytëzua vetëm në masën 67 për qind në vend të detyrës së caktuar nga Plenumi i Komitetit Qendror për jo më pak se 85 për qind. Kjo është një humbje e madhe për ekonominë tonë bujqësore.

Shfrytëzimi jo i kënaqshëm i ujit, goftë nga ana e cilësisë së ujitjes, goftë nga ana e sasisë së ujit të harxhuar për çdo njësi toke, si dhe mosshfrytëzimi plotësisht i kapacitetit të veprave ujitëse, është me të vërtetë për t'u shqetësuar. Ministria e Bujqësisë dhe organet e saj, në radhë të parë drejtoritë e administrimit të ujërave dhe pastaj komitetet e Partisë dhe komitetet ekzekutive në rrethe duhet të marrin masat e nevojshme që të bëhet medoemos kthesa në lidhje me shfrytëzimin me ekonomi të ujit për ujitje dhe shfrytëzimin e plotë të kapacitetit të veprave ujitëse.

Organet e bujqësisë e të ndërtimit dhe komitetet ekzekutive të këshillave popullore të rretheve duhet të marrin masa që, në fushat ku ka përfunduar bonifikimi, të plotësohen sistemet me rrjetin e tretë ujitës, të korrigojnë dhe të plotësohen ato të meta që u vërtetuan nga jeta në objektet ujitëse. Këshilli i Ministrave të shqyrtojë në mënyrë të posaçme gjendjen e veprave të kullimit dhe të ujitjes, sidomos të objekteve me rëndësi kombëtare për bujqësinë dhe të marrë masa që në një periudhë sa më të shkurtër të jenë kryer të gjitha punimet e nevojshme që këto vepra të funksionojnë rregullisht dhe të mos i sjellin asnjë pengesë bujqësisë.

Ministria e Bujqësisë dhe komitetet ekzekutive të këshillave popullore të rretheve duhet ta konsiderojnë problemin e përmirësimit të teknikës së ujitjes si një nga detyrat më të ngutshme të bujqësisë. Mënyra më e përshtatshme e ujitjes duhet zgjedhur e përpunuar sipas tokave, relievit dhe kulturave të mbjella. Duhet hequr dorë përfundimisht nga praktika shumë e dëmshme e ujitjes me anë të përmytjes së tokës dhe të kalohet në metodën e ujitjes me lehe, me brazda ose filtrime, sikurse bëhet në shumë rrethe malore dhe në disa ekonomi të përparuara të vendit tonë. Në lidhje me këtë, është e nevojshme që në të gjitha ekonomitë bujqësore të formohen skuadra të specializuara për ujitje, të krijohen bloqe model dhe të përhapet kudo eksperiencia e më të mirëve.

Drejtoritë e ujërave duhet të përmirësojnë punën e shpërndarjes së ujit, të shfrytëzimit dhe të mirëmbajtjes së veprave ujitëse dhe të disiplinonjë përdorimin e ujit.

Me gjithë sukseset e arritura në shtimin e aftësisë ujitëse në tërësi, me gjithë punën e madhe që është bërë, prapëseprapë

nuk duhet të kënaqemi nga rezultatet e arritura. Duhet të jemi të bindur se ka mundësi të rritet më shumë sipërfaqja e ujitshme, ka mundësi që e gjithë toka e punueshme të vihet nën ujë, në kushtet e vendit tonë, po të punojmë mirë dhe të shfrytëzojmë të gjitha mundësitë për rritjen e kapacitetit ujitës. Prandaj, çdo rreth dhe ekonomi duhet të rishikojë planet për të rritur kudo edhe më shumë sipërfaqet e vaditshme. Është e nevojshme që Ministria e Bujqësisë, komitetet ekzekutive dhe komitetet e Partisë ta marrin menjëherë në shqyrtim këtë çështje, të zbulojnë dhe të studjojnë burime të reja për ujitjen, sidomos në rrethet ku sipërfaqja e ujitshme do të jetë shumë e vogël edhe në fund të planit të tretë pesëvjeçar, të caktojnë çfarë objektesh të reja duhen ndërtuar, të hartojnë projektet e nevojshme, të mobilizojnë krahët e punës dhe mjetet përkatëse teknike për ndërtimin e objekteve ujitëse. Lufta për shtimin e sipërfaqes së ujitshme duhet të përfshijë të gjithë punonjësit e bujqësisë, të gjitha fshatrat, lokalitetet e rrethet, në mënyrë që të tejkalohet detyra e shtruar në planin e tretë pesëvjeçar.

Ministria e Bujqësisë dhe organet e saj vartëse duhet të ndihmojnë më shumë, sidomos rrethet që vuajnë më tepër nga thatësira dhe ku reshjet janë më të pakta dhe jo të rregullta, për të ndërtuar sa më tepër vepra ujitëse.

Të nxitet kudo, në çdo ekonomi, fshat ose kooperativë, iniciativa për ndërtimin e veprave ujitëse. Të luftohen tendencat për kërkesa të padrejta, për të bërë vetëm vepra të mëdha ujitëse që kërkojnë mekanizma, çimento, hekur, tubacione etj; po ashtu duhen luftuar shfaqjet e shumta për të zgjeruar sipërfaqen e ujitshme vetëm duke kërkuar motopompa, elektropompa etj. Çdo rreth të orientohet për ndërtimin e veprave të vogla e të thjeshta, të cilat mund të bëhen në çdo fshat ose në disa vende të fshatit, me krahë ose me mjete të tjera që i disponojnë vetë fshatrat, si dhe me mjete e mekanizma që disponon rrethi. Të gjitha komitetet ekzekutive të këshillave popullore të rretheve duhet të marrin masa konkrete që në çdo fshat, i cili ndodhet jashtë sistemeve të mëdha të ujitjes, të ndërtohen vepra ujitëse dhe të shtohet aftësia ujitëse mbi detyrat e caktuara në planin e vitit 1965.

E treta, për ruajtjen e vlagës së tokës kanë rëndësi masat për pakësimin e influencës së erërave të nxehta, që fryjnë gjatë muajve të parë të verës. Për këtë qëllim, mbjellja e sa më shumë drurëve pyjorë në formë brezash gjatë rrugëve, kanaleve, argjinaturave të lumenjve dhe të kanaleve kryesore të bonifikimit etj. do të influencojë pozitivisht në luftimin e thatësisë.

Po të shqyrtojmë lëkundjet e korrjeve që kemi pasur çdo vit në bujqësi, del se këto e kanë burimin kryesisht në mungesën e reshjeve dhe në natyrën e erërave që fryjnë. Këtë e vërtetoj-

në të dhënat e mëposhtme mbi rendimentet në drithëra që janë realizuar gjatë vjetëve 1956-1960.

	1958	1959	1960
Rendimenti në kv/ha	9,9	11,9	7,9
Mesatarja e reshjeve në m/m për muajt maj-gusht	34,4	75,5	26,4

Sikundër shihet, çdo shtimi dhe pakësimi të reshjeve verore i përgjigjet edhe një ngritje ose ulje e rendimentit. Mirëpo, po të shikojmë të dhënat e disa stacioneve meteorologjike mbi natyrën e erërave që kanë fryrë në një vit me rendiment më të lartë dhe në një vit me rendiment më të ulët, gjatë periudhës maj-gusht, atëhere do të vërejmë se ngritjes dhe uljes së rendimentit i përgjigjet edhe shpejtësia e nxehtësisë më e madhe ose më e vogël e erërave.

Masat që zbatohen sot në bujqësinë tonë për grumbullimin dhe ruajtjen e lagështirës kanë më tepër një natyrë agroteknike dhe synojnë si në shfrytëzimin maksimal të reshjeve të mëdha dimërore, ashtu edhe në shfrytëzimin e reshjeve të pakta që bien gjatë verës; gjithashtu këto masa synojnë në grumbullimin e një sasive më të madhe uji në tokë dhe në ruajtjen e tij deri në periudhën e thatësisë duke penguar sa të jetë e mundur më tepër avullimin e shpejtë të ujit nga toka.

Për ruajtjen e vlagës së tokës, rëndësi të madhe ka plugimi i thellë i verës e i vjeshtës, lesimi e branimi i tokës në kohën e duhur dhe prashitjet e rregullta. Gjithashtu, mbjellja në formë brezash mbrojtës e plepit dhe e kavakut, e pemëve të tjera, ose e kallamit, gjatë gjithë rrugëve, buzëve të kanaleve të para e të dyta, në argjinaturat e lumenjve etj. do të ndihmonte në frenimin e efektit negativ të erërave të ngrohta, përveç dobive të tjera që i sjellin ekonomisë.

4. — Të mbjellim vetëm farë të zgjedhur, të mbjellim shpejt e në kohë optimale dhe të sigurojmë numrin e nevojshëm të bimëve për hektar

a) *Mbi farërat e zgjedhura*. Kongresi IV i Partisë e ngriti problemin e farës si njërin ndër shtatë faktorët e domosdoshëm për rritjen e rendimentit të kulturave bujqësore. Teknika e re, me të cilën është pajisur bujqësia, mund të përdoret me leverdi vetëm kur mbillen lloje farërash të pastra me prodhimtari të lar-

të. Praktika e deritanishme ka treguar se arat që mbillen me farë të pastër dhe të zgjedhur japin më shumë prodhim, për arësyse se bimët piqen në kohë dhe vilen e grumbullohen pa firo.

Këta vjetët e fundit janë marrë masa më të mira për prodhimin e farërave dhe, në krahasim me të kaluarën, janë arritur mjaft përmirësime. Sot nuk është më ajo gjendje e dikurshme kur në vendin tonë mbilleshin mbi 28—30 lloje gruri, mbi 50—60 lloje misri, shumë lloje duhani, patatesh, perimesh etj. Pakësimi i madh i këtij numri është bërë në dobi të llojeve të reja të farërave me rendimente të larta.

Në bazë të provave krahasuese shumëvjeçare të kryera nga Instituti i lartë shtetëror i bujqësisë në disa rrethe, me lloje të ndryshme të kulturave kryesore që mbillen te ne, në bazë të rezultateve që kanë arritur shumë ekonomi bujqësore, është bërë rajonizimi i llojeve më prodhimitare të grurit, misrit, duhanit, pambukut, panxhar sheqerit, patates dhe perimeve.

Në zgjedhjen e farës së grurit, ose të misrit më të përshtatshëm, ndërmarrjet shtetërore dhe kooperativat bujqësore duhet të vendosin vetë duke u mbështetur në këtë orientim të përgjithshëm dhe në eksperiencën e tyre. Duhet pasur parasysh dhe të bëhet rregull i rreptë agroteknik, që të mos e mbjellim farën e grurit më shumë se 3 vjet rresht në të njëjtën tokë ku është prodhuar vetë fara që mbillet, duke e shkëmbyer atë me të njëjtën lloj fare, por të prodhuar në një tokë tjetër. Kjo është e domosdoshme të bëhet për të mos lejuar degjenerimin e farës së grurit...

Megjithëse në rajonizimin e farërave të duhanit është bërë një punë mjaft e mirë, Ministria e Bujqësisë e udhëhequr nga kërkesat e eksportit, duhet të vazhdojë punën eksperimentale, për të siguruar më shumë të ardhura...

Krahas kujdesit më të madh që duhet treguar për ruajtjen e pastërtisë së varieteteve që kemi në prodhim të gjerë, duhet ndjekur edhe riprodhimi i farës së zgjedhur. Instituti i lartë shtetëror i bujqësisë duhet të zgjerojë koleksionin e farërave të pambukut dhe të shtojë eksperimentimin e llojeve të huaja, sidomos të vendeve mesdhetare, në mënyrë që të shfrytëzohen më mirë mundësitë e gjetjes së llojeve me prodhimtari më të lartë dhe me cilësi më të mirë për kushtet e vendit tonë.

Duhet të ruhet me kujdes fara e pambukut, cilësia e farës dhe të mos përzihen llojet. Për këtë qëllim, Ministria e Bujqësisë dhe organet e grumbullimit që merren me pastrimin e pambukut të marrin të gjitha masat e nevojshme.

... Çështja e rajonizimit të farërave, çështja e caktimit për çdo ekonomi të llojeve, që në kushtet konkrete japin rendimente të larta, është mjaft e ndërlikuar dhe kërkon një punë të vazh-

dueshme e sistematike. Prandaj, Ministria e Bujqësisë, komitetet e Partisë dhe komitetet ekzekutive duhet të marrin masa për zbatimin e rajonizimit. Herë pas here, duke u mbështetur në të dhënat e reja eksperimentale dhe të prodhimit, ta përmirësojnë atë dhe pa lëkundje të zhdukin spontaneitetin që vërehet akoma në mjaft rrethe, në lidhje me llojet e farërave që mbjellin, ashtu sikurse duhen evituar shablonizmi dhe rekomandimet jo të përshtatshme dhe të paprovuara në praktikë për çdo zonë.

Është e domosdoshme që në të ardhshmen të merren masa për shtimin e mëtejshëm të farërave elite dhe të farërave të zgjedhura që ka filluar të prodhojë Instituti i lartë shtetëror i bujqësisë. Të merren masa për të ruajtur pastërtinë e tyre dhe mbjellja të përqëndrohet në zona të caktuara. Për t'i dalë në krye me sukses kësaj pune, çdo rreth, sidomos rrethet kryesore, në bazë të rajonizimit, të marrin masa për prodhimin e farës për nevojat e veta duke siguruar edhe rezervën, të kontrollojnë me këmbëngulje masat për prodhimin e farërave dhe të sigurojnë farë me cilësi të lartë dhe me sasi të mjaftueshme.

Ministria e Bujqësisë dhe Instituti i lartë shtetëror i bujqësisë ta vlerësojnë më mirë çështjen e prodhimit të farërave elite dhe të zgjedhura dhe të krijojnë kushte për prodhimin e sasive të nevojshme në mënyrë që, për vitin në vazhdim dhe për vitin e ardhshëm, të funksionojë plotësisht rrjeti i prodhimit të farës në të tëra hallkat e nevojshme.

Furnizimi i rrjetit të shumëzimit të farës me farëra elite, sipas orientimit të dhënë nga Byroja Politike dhe nga qeveria, të bëhet për pjesën më të madhe të kulturave nga ana e Institutit të lartë shtetëror të bujqësisë dhe pjesërisht nga importi për ato lloje që nuk mund të prodhohen në vend. Shumëzimi i parë i farërave elite të kryhet nga stacionet e prodhimit të farës, të cilat duhet të organizohen dhe të pajisen me të gjitha mjetet teknike për ta kryer këtë punë si duhet. Vëmendje e madhe t'u kushtohet ekonomive të riprodhimit, të cilat do të furnizojnë më tej me farë ekonomitë e prodhimit të gjerë. Si instituti, ashtu edhe ekonomitë e shumëzimit të farërave duhet t'i kushtojnë kujdes të veçantë prodhimit të farës hibride të misrit, për ato lloje që u njihen çiftet e prindërve dhe që, në kushte të mira agroteknike, japin prodhim më të lartë se llojet e pastra. Instituti i lartë shtetëror i bujqësisë të vazhdojë punën e kërkimeve në drejtim të gjetjes së komponentëve të rinj dhe të krijimit të linjave autofekunduese. Derisa të marrin rrugë këto çështje, del e nevojshme që Ministria e Bujqësisë, komitetet e Partisë dhe komitetet ekzekutive në rrethe të mobilizojnë të gjithë kuadrot për të kryer në formë aksioni aprovimin e parcelave të farës sipas rregullave përkatëse dhe zgjedhjen e farës kalli për kalli sipas porosive të herëpashershme që kanë dhënë Komiteti Qendror dhe qeveria.

Drejtoria e farërave, me gjithë degët e saja vartëse, duhet të bëjë një punë të madhe, të kujdesshme për administrimin e mirë të farërave. Trajtimi i farës në depo, masat kundër prishjes së cilësive të llojit dhe të farës, ambalazhimi, shpërndarja dhe transporti, janë procese të rëndësishme, të cilat mund të kryhen vetëm me anë të një kujdesi të madh dhe me një regjim të rreptë nikoqirllëku. Inspektoriatet e farërave duhet të ushtrojnë nga ana e tyre kontroll të vazhdueshëm dhe sistematik, si mbi ekonomitë bujqësore ashtu edhe mbi ndërmarrjet e farërave, në mënyrë që çdo lloj fare të grumbullohet, të trajtohet dhe të shpërndahet sipas rregullave të caktuara.

Për të stimuluar drejt ekonomitë e prodhimit të farërave, Këshilli i Ministrave të caktojë kushtet e nevojshme të blerjes dhe të shitjes së farërave.

b) *Mbi afatet e mbjelljes.* Mbjellja e bimëve në afatet e caktuara është një tjetër faktor me rëndësi të madhe në procesin e prodhimit bujqësor. Rezultatet e eksperimentimit shkencor dhe të dhënat e praktikës tregojnë se në zonat e ngrohta të vendit, në përgjithësi në zonën e ullirit, afati më i mirë për mbjelljen e grurit është nga 15 tetori deri më 15 nëntor. Në zonat e ftohta mbjellja e grurit mund të fillojë një muaj më parë, sidomos për llojet e vona të vendit dhe të përfundojë dy javë më parë se në zonat e ngrohta. Sidoqoftë duhet të bëhet rregull që mbjellja e grurit të përfundojë brenda nëntorit.

Eksperiencia e fituar për kulturën e pambukut tregon se koha më e mirë për mbjelljen e tij është nga 10 prilli deri më 30 prill. Kur jemi shpejtuar në mbjellje, temperaturat e ulëta bashkë me lagështirën, gati gjithmonë, i kanë dëmtuar mbjelljet dhe kanë detyruar rimbjelljen e pambukut, ndërsa nga mbjelljet e vonuara kemi marrë rendimente të ulëta dhe prodhim me cilësi të dobët.

Për duhanin koha më e përshtatshme për mbjellje është nga 10 prilli deri më 10 maj për zonat e ngrohta dhe nga 20 prilli deri më 20 maj për zonat e ftohta. Për realizimin e mbjelljes së duhanit në afate optimale detyra kryesore është që të merren masat për prodhimin e fidaneve në kohën e duhur.

Përsa i përket misrit, në zonat e ngrohta, në tokat e kulluara mbi ujë duhet mbjellë shpejt, nga 1 prilli deri më 30 prill (në zonën e Shkodrës deri më 15 maj), ndërsa në zonat e ftohta nga 1 maji deri më 30 maj. Dëmet e shumta që u shkakton krimbi i dy gjeneracioneve misrave të mbjellë në gjysmën e dytë të majit në zonat e ngrohta, detyrojnë që misri i mbetur pa mbjellë në këto zona, deri në gjysmë të majit, të lihet për t'u mbjellë në dhjetëditorin e parë të qershorit.

Këto janë afatet më të përshtatshme për kulturat bujqësore më të rëndësishme. Natyrisht, çdo ekonomi bujqësore brenda

rrethit, në përputhje me kushtet e saj konkrete, me llojet e bimëve bujqësore që mbjell dhe duke u mbështetur në eksperiencën e saj shumëvjeçare, duhet ta zgjedhë vetë kohën më të përshtatshme për mbjelljet. Prandaj, është e domosdoshme që SMT-të, ndërmarrjet shtetërore dhe kooperativat bujqësore të marrin masa dhe të krijojnë të gjitha kushtet objektive për kryerjen e mbjelljeve në afatet më të mira agroteknike, sikurse janë kullimi, plugimi me cilësi të lartë, ruajtja e vlagës, mobilizimi dhe shfrytëzimi i plotë i të gjitha mjeteve dhe forcave të punës etj.

c) *Mbi dendësinë e bimëve për hektar.* Krahas mbjelljes në kushte dhe në afate të mira agroteknike një vëmendje të madhe duhet t'i kushtojnë punonjësit e bujqësisë sigurimit dhe dendësisë së bimëve për hektar, sepse nga numri i bimëve për hektar varet shumë prodhimi bujqësor... Sigurimi të numrit të bimëve për hektar shumë ekonomi bujqësore nuk i kushtojnë akoma vëmendjen e duhur. Megjithëse këtë vit gjendja paraqitet më mirë se vitin e kaluar, sipas të dhënave të Ministrisë së Bujqësisë, numri normal i bimëve të pambukut gjatë këtij viti është siguruar vetëm në 50 për qind të sipërfaqes së mbjellë, i bimëve të duhanit vetëm në 47 për qind dhe i bimëve të panxhar sheqerit vetëm në 48 për qind të sipërfaqes së mbjellë. Këtej del konkluzioni se organet përkatëse të bujqësisë duhet të marrin masa për të hedhur në tokë medocës për të kursyer farën, t'i kushtojnë një rëndësi më të madhe rrallimit të bimëve dhe mbjelljes së sipërfaqes së tokës në të katër cepat e saj.

5. — T'u bëjmë bimëve shërbimet kulturore në kohën, në sasinë dhe me cilësinë e duhur

Nga kryerja e shërbimeve kulturore në kohë e me cilësi të mirë, varet shumë rendimenti që do të merret. Por shërbimet kulturore bëjnë efektin e duhur kur kryhen në përputhje me kërkesat e bimëve dhe me kushtet klimatike-tokësore të zonës përkatëse.

Për kulturat e vjeshtës, në radhë të parë për të lashtat, një rëndësi të dorës së parë marrin masat për heqjen e ujërave të tepërta nga ara, me anën e hapjes së vijave kulluese, për plehërimin me nitrat, për lesimin dhe për tëharrjen e barërave të këqia.

Për kulturat pranverore, veçanërisht për kulturat prashitëse, rëndësi të madhe kanë shërbimet kulturore, si lesimi i tokës para ose pas mbirjes së bimëve, thyerja dhe shkriftimi i kores së tokës, prashitjet, plehërimet suplementare, ujitja dhe mbathja, si dhe shërbimet e veçanta të disa kulturave, siç janë çekanka e pambukut, këputja e lules së duhanit etj.

Jo më kot thuhet se «dy prashitje janë baras me një ujitje». Nga kjo kuptohet qartë roli që luajnë prashitjet për zhvillimin e bimëve.

Në vitin 1961 SMT-të kanë prashitur 25 733 hektarë kundrejt 45 900 hektarëve që e kishin planin ose 55 për qind, kurse NBSH-të realizuan 54 për qind të prashitjes së parë dhe vetëm 14 për qind të prashitjes së dytë të të gjitha kulturave prashitëse me anën e mekanikës bujqësore.

Këtu duhet përmendur fakti se si NBSH-të, ashtu edhe kooperativat bujqësore që kanë fare pak kultivatorë, shumë pak i kanë shfrytëzuar edhe ata që kanë.

Prandaj, Ministria e Bujqësisë, komitetet e Partisë dhe komitetet ekzekutive të rretheve duhet të vënë dorë seriozisht në zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me shërbimet kulturore dhe të kërkojnë shfrytëzimin racional të mjeteve të punës si lesat, maqinat e pompat spërkatëse, kultivatorët etj.

6. — Ta organizojmë më mirë luftën kundër dëmtuesve, sëmundjeve të kulturave bujqësore dhe barërave të këqia

Humbjet që shkaktojnë insektet, sëmundjet dhe barërat e këqia në prodhimet bujqësore janë mjaft të mëdha. Kështu p.sh. në kulturat e misrit vetëm nga krimbi llogaritet një humbje prej rreth 20 për qind e prodhimit në të gjithë Republikën; në të lashtat, nga barërat e këqia dhe nga sëmundjet e ndryshme, llogaritet një humbje prej 15—20 për qind; në pambuk nga krimbi i kuq, nga kalbëzimi i rrënjës, nga gomoza etj. humbasin 7—10 për qind të prodhimit; në panxharin e sheqerit, nga pleshti, nga hundëgjati, nga mijtë e arave, nga kuskuta etj. humbasin 15—17 për qind të prodhimit; në duhan nga vrugu, nga kalbëzimi i rrënjës dhe i qafës, nga bakteriozat, nga insektet e tjera humbasin rreth 30—70 për qind të prodhimit; në ullinj nga miza, tenja, koçiniljet, tuberkulozi etj. humbasin 25—30 për qind të prodhimit; në perimet, nga fitoftora, antraknoza, nga insektet etj. humbasin rreth 12 për qind të prodhimit etj. Në mënyrë të veçantë humbjet vjetore janë të mëdha në prodhimin e frutave dhe sidomos të rrushit.

Vitin e kaluar, për shkak të vrugut të duhanit, ekonomia e vendit humbi një sasi prodhimi duhani me një vleftë prej rreth 1 500 000 000 lekësh. Por këtë vit, në saje të masave komplekse të karantinës dhe të mbrojtjes së bimëve, humbjet në prodhimin e duhanit nga kjo sëmundje u frenuan me shpenzime relativisht të vogla.

Por, me gjithë sukseset e arritura, shërbimi i karantinës dhe i mbrojtjes së bimëve akoma nuk i përshtatet ritmit të përgjith-

shëm të zhvillimit të bujqësisë dhe kërkesave që i vihen asaj nga plani i shtetit.

Akoma ka mjaft raste dëmtimesh të konsiderueshme të ekonomisë bujqësore për shkak se nuk merren me kohë masa dhe nuk bëhet kur duhet luftimi i dëmtuesve ose i sëmundjeve të ndryshme. Kjo ndodh për dy arsye: së pari, sepse nuk tregohet kujdes dhe nuk organizohet mirë puna dhe, së dyti, sepse nuk merren masa me kohë për sigurimin e bazës materiale.

Kështu në vitin 1960 kooperativa bujqësore e Himarës, në agrume, pësoi një dëm prej rreth 1,5 milion lekësh nga mosorganizimi i mirë i luftës kundër merimangës së argjentë, gjë që mund të bëhej me një shpenzim prej rreth 450 mijë lekësh. Kultivuesit e panxhar sheqerit në rrethin e Korçës, për mungesë heqzakloranti, për luftimin e pleshtit të panxharit këtë vit u detyruan të rimbjellin rreth 800 hektarë me këtë bimë. Nga kjo ata humbën rreth 9,6 milion lekë, ndërsa ky dëm do të mund të evitohet me një shpenzim vetëm prej 610 mijë lekësh.

Është e domosdoshme dhe e ngutshme që shërbimi i karantinës dhe i mbrojtjes së bimëve të bëhet problem i masave të gjera të punonjësve të bujqësisë, sikurse është bërë p.sh. lufta kundër vrugut të duhanit etj. Për këtë qëllim duhet të merren masat e nevojshme organizative, të sigurohet baza materiale dhe të forcohet puna propagandistike, sidomos në drejtim të përhapjes së njohurive fitopatologjike dhe entomologjike në masat punonjëse të fshatit.

Në mënyrë të veçantë duhet treguar kujdes për luftimin e sëmundjeve dhe insekteve që dëmtojnë shumë lloje bimësh dhe të mos lejohet përhapja e insekteve të rrezikshme, siç është flutura e bardhë amerikane, që i është afruar kufirit tonë nga ana e Jugosllavisë.

Duhet të mbahet mirë parasysh se krahas mjeteve kimike, një rëndësi më të madhe duhet t'i kushtojmë luftimit të sëmundjeve e dëmtuesve të bimëve bujqësore me mjete mekanike dhe agroteknike. Nuk është e drejtë të përdoren vetëm mjetet kimike, që siç dihet importohen dhe kostojnë shtrenjt, pa përdorur të gjitha mjetet e tjera të mundshme që disponojnë ekonomitë tona bujqësore, siç është p.sh. tëharrja e grurit, shkullja dhe djegja e kallamishteve të misrit, zhdukja e të gjitha mbeturinave të duhanit ose zbatimi në një shkallë më të gjerë i disa normave agroteknike, siç është plugimi i thellë, kullimi etj. Ndërkaq, kur është i domosdoshëm përdorimi i mjeteve kimike, të merren masa si për harxhimin e tyre me nikoqirllëk të madh, ashtu edhe për mbrojtjen e shëndetit dhe të jetës së punonjësve.

7. — Të organizojmë dhe të sigurojmë korrjet, shirjet dhe grumbullimin pa firo

Sipas të dhënave të literaturës dhe konstatimeve të praktikës, nga 10 ditë vonesë në korrje, pas pjekjes së plotë, rendimenti i grurit ka zbritur 28 për qind dhe pesha hektolitrike 4,5 për qind, ndërsa duke e vonuar korrjen 20 ditë rendimenti ka zbritur në 44,5 për qind dhe pesha hektolitrike në 10 për qind.

Korrja është procesi i parë i fazës së fundit të prodhimit të drithit. Vetëm me korrjen e mirë dhe në kohën e duhur të të lashtave nuk mund të mënjanohen ose të pakësohen firot. Prandaj, është e domosdoshme të ndiqen me kujdes të gjitha hallkat e zinxhirit, d.m.th. të zbatohet rreptësisht parulla «*korr, lidh, grumbullo duajt dhe shi pa ndërprerje!*»

Kujdes i veçantë i duhet kushtuar vjeljes së të vonave veçanërisht vjeljes së duhanit. Shpeshherë nënvleftësohet dora e parë, duke u lënë pa vjelë ose duke u vjelë me vonesë. Kjo shkakton që gjethet e kësaj dore të digjen dhe të bëhen të pavlefshme. Dëmi që shkaktohet në këtë mënyrë, duke mos u njohur nga ana e ekonomive, nuk vlerësohet, por në fakt është mjaft i madh. Gjethet e fundit përbëjnë 10 për qind të prodhimit të përgjithshëm. Në qoftë se llogaritim të marrim nga çdo hektar i mbjellë me duhan «Basma» 6,5 kv/ha. duke mos u marrë gjethet e fundit nga çdo hektar do të dëmtoheshin 65 kg. duhan dhe, për të gjithë sipërfaqen e mbjellë me «Basma» prej 8,170 hektarësh, do të humbisnim 531 000 kg. duhan, baras me rreth 40 milion lekë.

Prandaj, duhet luftuar që fushata e korrjes, shirjes dhe e grumbullimit të të lashtave, si dhe vjelja dhe mbledhja me kohë e kulturave të vona të bëhet në kohën e duhur, të organizohet mirë puna dhe të merren të gjitha masat konkrete për të zhdukur firot. Kjo duhet konsideruar si detyrë e dorës së parë. Nuk ka asnjë kuptim lufta për rritjen e rendimenteve të kulturave bujqësore kur lejohet që prodhimi të humbasë, të shpëtojë nga duart në çastin përfundimtar, kur ai duhet vjelë dhe duhet çuar në depo.

Këto janë, shokë, *çështjet themelore agroteknike që përbëjnë kodin agroteknik*. Zbatimi me kujdes i tyre, veç e veç, luan një rol të rëndësishëm. Por duhet të kuptohet mirë se këto hallka janë pjesë përbërëse e një zinxhiri të vetëm, prandaj ato duhen zbatuar në tërë kompleksin e tyre, në mënyrë që secila të ndihmojë tjetrën dhe të gjitha këto hallka së bashku të ndihmojnë për ngritjen e nivelit të përgjithshëm agroteknik, për rritjen e rendimentit të kulturave bujqësore.

Një shembull i gjallë që provon efikasitetin e masave agroteknike të zbatuara në tërë kompleksin e tyre janë rendimentet e larta që arrijnë kooperativat, ndërmarrjet dhe brigadat e përparuara, si dhe parcelat e rendimenteve të larta. Në vitin bujqësor

1961—1962, ndërmarrjet bujqësore shtetërore në 2,147 hektarë me grurë, të caktuara për të marrë rendimente të larta, zbatuan një agroteknikë të lartë në të tëra hallkat: zgjodhën kryesisht parabimë leguminoze e prashitëse, i pluguan tokat 35—50 cm. thellë, i plehëruan mesatarisht me 5,4 kv/ha. plehra kimike, përdorën farë me cilësi të lartë, i mbollën në afatet optimale, siguruan mesatarisht 400-500 bimë për metër katror, muarën masa të forta për kullimin, në një pjesë të sipërfaqes përdorën lesimin dhe në ndonjë rast edhe prashitjen, zhdukën të gjitha barërat e këqia fletëgjera me herbicide dhe relativisht korrën shpejt e pa firo. Në këto parcela, megjithëse në sipërfaqe të mëdha, u muarën mesatarisht 26 — 85 kv. grurë për hektar, d.m.th. 11,22 kv. ose 71 për qind më shumë për hektar se rendimenti mesatar i realizuar nga e gjithë sipërfaqja e mbjellë në ndërmarrjet bujqësore shtetërore. A nuk është i mjaftueshëm ky shembull për t'u bindur se sa mundësi të mëdha ka bujqësia për të shtuar prodhimin në rast se kudo do të zbatohet me kujdes kodi agroteknik?

*
*
*

Për ngritjen e nivelit agroteknik të bujqësisë sonë, përveç masave të mësipërme, është e domosdoshme të tregohet kujdes i veçantë për një renditje të drejtë të kulturave bujqësore.

Rëndësia e mbjelljes së bimëve bujqësore në bazë të një renditje të drejtë e racionale, lidhur me vetitë e ndryshme biologjike të kulturave ose të grup-kulturave bujqësore, njihet që në kohët më të lashta. Historia e agronomisë tregon se me këtë problem janë marrë shumë dijetarë dhe specialistë të bujqësisë, që nga kohët e vjetra e deri në ditët tona. Të gjithë kanë pasur një synim: të përcaktonin renditjen më të mirë të kulturave bujqësore gjatë disa vjetëve në një tokë të caktuar, me qëllim që të merrej maksimumi i prodhimeve për çdo njësi të sipërfaqes së tokës nën kulturë.

Në Shqipëri, në krahina të ndryshme, janë përdorur renditje të ndryshme të bimëve bujqësore duke pasur si bazë karakterin krejt ekstensiv të bujqësisë sonë para çlirimit. Pas çlirimit, me masat e marrura nga Partia dhe nga qeveria për përparimin e bujqësisë sonë, gjendja ndryshoi mjaft. Futja dhe zgjerimi i mbjelljes së kulturave industriale, zgjerimi i sipërfaqes së mbjellë me perime e patate, përmirësimi i strukturës së drithërave në favor të të lashtave, mbjellja e kulturave të reja foragjere, mbjellja në përpjesëtime të mëdha të kulturave të dyta, mekanizimi, bonifikimi, vetë ekzistenca e ekonomive të mëdha e të organizuara e vunë dhe e vënë në një platformë krejt të re problemin e përcaktimit të renditjes së drejtë të kulturave bujqësore në vendin tonë, aq më tepër për zonën bregdetare, ku kushtet klimatike dhe uji bëjnë të mundshme mbjelljen e dy e më shumë kulturave gjatë një viti.

Në vendin tonë, sot për sot, nuk shtrohet problemi që të përpunojmë mbi baza të gjithanshme shkencore qarkullimet bujqësore, aq më pak kur dihet se qarkullimet bujqësore ngrihen mbi bazën e barërave shumëvjeçare ose të ugareve, gjë që do të kërkonte përdorimin e një sipërfaqe të madhe toke për foragjere në kurriz të kulturave të arave, sidomos të drithërave të bukës. Në kushtet tona të tanishme, kur para së gjithash nuk e kemi zgjidhur akoma problemin e sigurimit të bukës dhe kur sipërfaqet e mbjella janë të kufizuara, do të ishte gabim të shtrohej problemi i vendosjes së qarkullimeve bujqësore duke futur barërat shumëvjeçare ose ugarët në dëm të drithërave. Këtë ne e themi jo sepse qarkullimet bujqësore me barëra shumëvjeçare parimisht janë të gabuara. Jo. Qarkullimi bujqësor me barëra shumëvjeçare dhe me ugare, në vende ku ka tokë në masë të pakufizuar, është mënyra më e drejtë për shtimin e prodhimit bujqësor dhe për ruajtjen e pjellorisë së tokës, sidomos kur dihet se mungojnë plehrat organike dhe kimike. Në raste të tilla qarkullimet bujqësore janë të domosdoshme dhe duhet të respektohen rreptësisht. Por, për ne, për arësyet që u përmendën, një rëndësi të veçantë merr renditja e thjeshtë e kulturave bujqësore. Sigurimi i parabimës së përshtatshme luan një rol të dorës së parë për rritjen e rendimentit të bimëve pasardhëse. Dhe në këtë kuptim, çdo ekonomi bujqësore, çdo ndërmarrje shtetërore dhe kooperativë bujqësore, sipas kushteve të saj konkrete, duke ju përmbajtur detyrave kryesore të planit të shtetit, duhet të caktojë vetë renditjen e bimëve që japin rendimentet më të larta.

Me anë të renditjes racionale të bimëve bujqësore, ndërmarrjet shtetërore dhe kooperativat bujqësore duhet të arrijnë së paku këtë qëllim: të sigurojnë një përpjesëtim të drejtë midis bimëve prashitëse e joprashitëse, midis bimëve pranverore dhe atyre të vjeshtës, të sigurojnë parabimën më të përshtatshme për bimën pasardhëse në mënyrë që kultivimi i njërës bimë jo vetëm të mos pengojë ose të dëmtojë rritjen normale të bimëve të tjera që vijnë pas saj, por të ndihmojë në ngritjen e rendimentit të kulturave pasardhëse.

Ç'masa tekniko-organizative duhet të marrin organet e Partisë e të pushtetit, ndërmarrjet shtetërore e kooperativat bujqësore dhe specialistët e bujqësisë për t'ja arritur këtij qëllimi?

Te ne është bërë zakon që ndërmarrjet shtetërore dhe kooperativat bujqësore, para fushatës së mbjelljeve të vjeshtës, të bëjnë «destinacionin» e tokave d.m.th. të caktojnë se cilat toka do të mbillen në vjeshtë veç e veç për çdo kulturë dhe cilat do të mbillen në pranverë për të gjitha kulturat së bashku, ndërsa para fillimit të mbjelljeve të pranverës të caktojnë tokat edhe për çdo kulturë veças. Kur caktohen tokat për kulturat e vjeshtës ose të pranverës, shpeshherë, ekonomitë bujqësore bëjnë dallime duke

i ndarë tokat, si të thuash, në disa kategori: në «toka të pambukut», në «toka të grurit» në «toka të misrit» etj. Këto përcaktime kanë sigurisht kuptimin e tyre, sepse «tokat e pambukut» mbillen pothuajse çdo vit me pambuk, «tokat e misrit» akoma në disa zona nuk mbillen me grurë se janë të ulëta e mbajnë lagështirë të madhe etj. Këto dallime në kategoritë e tokave, si rregull, nuk kanë të bëjnë aspak me përbërjen e tyre fiziko-kimike, me përshtatmërinë e tyre për rritjen më mirë të njërës ose të tjetrës kulturë bujqësore, por kjo ndodh për faktin se «tokat e misrit» duke qenë më të ulëtat mbajnë më shumë lagështirë se tokat e tjera, për pasojë, nuk mund të mbillen në kohën e duhur me pambuk pse vijnë vonë, ato nuk mund të mbillen as me grurë sepse nuk kullojnë mirë dhe të lashtat dëmtohen nga dimri. Tani, pas bonifikimit të fushave kryesore të vendit tonë, ka ardhur koha që të rishikohet rrenjësisht praktika e deritanishme e «zgjedhjes së tokës për çdo lloj bime» që ka çuar dhe çon në mënyrë të pashmangshme në mbjelljen e një kulture për shumë vjet me radhë në të njëjtën tokë dhe të kalohet vendosmërisht në kaktimin e tokave në mënyrë të tillë që në këto toka të mbillen me radhë kulturat duke siguruar për secilën kulturë, brenda mundësive maksimale, parabimën më të përshtatshme. Është e kuptueshme se nuk mund të zgjidhet përfundimisht problemi i renditjes së kulturave bujqësore në qoftë se nuk do të krijohen kushte të njëllajta, të barabarta për të tërë sipërfaqen e ngastrës dhe të blokut, në mënyrë që çdo ngastër veç e veç, ashtu dhe të gjitha ngastrat e të njëjtit blok e pastaj të gjitha blonet së bashku, të së njëjtës ekonomi, objektivisht nga ana e jashtme, të kenë kushte të njëjta.

Natyrisht, në vendosjen e radhës së bimëve që do të mbillen në të njëjtën tokë (ngastër apo blok), një kujdes i veçantë duhet të tregohet për të lashtat, sidomos për grurin, sepse nga ky fakt varet shumë rendimenti i tyre. Eksperienca e shumë vjetëve tregon se, në nivelin e tanishëm agroteknik, kur bimët e mbjella kanë parabimë të mirë, japin gjithmonë rendimente më të larta, se sa kur mbillen disa vjet me radhë në të njëjtën tokë dhe kanë parabimë të papërshtatshme. NBSH-ja e Maliqit që, si rregull, i siguron grurit 85—90 për qind të sipërfaqes me parabimë prashitëse e leguminoze, zakonisht merr një rendiment prej 27—30 kv/ha. Tipik është rasti i sektorit të Gjazës të NBSH-së «29 Nëntori» në Lushnjë, ku vitin e kaluar, përveç masave të tjera, kur 94 për qind e sipërfaqes së mbjellë me grurë kishte si parabimë grurin, u muar një rendiment prej afro 4 kv/ha., ndërsa sivjet kur e gjithë sipërfaqja që u mbuall me grurë kishte si parabimë kultura prashitëse, atje u muar një rendiment prej 19,5 kv/ha. Një parcelë prej 30 hektarësh në sektorin e Rushkullit të NBSH-së «8 Nëntori» në Sukth e mbjellë me grurë, në vitin 1957 me parabimë fasule dha 26 kv/ha., në vitin 1959 me parabimë misër dha 24 kv/ha. dhe në vitin 1960 me

parabimë grurë jo vetëm që dha më pak, 18 kv/ha., por edhe u infektua rëndë nga barërat e këqia. Shembuj të tillë mund të merren edhe nga kooperativat bujqësore të rrethit të Durrësit, Lushnjës, Fierit etj. në të cilat tokat që kanë pasë qenë mbjellë 2—3 dhe 4 vjet me radhë me grurë janë infektuar rëndë nga barërat e këqia dhe kanë ulur rendimentin e grurit.

Në zgjidhjen e drejtë të problemit të renditjes së kulturave bujqësore nuk duhet të nisemi vetëm nga kërkesat e çastit të ekonomive bujqësore, vetëm për një vit, pastaj, siç thuhet shpesh, «shohim e bëjmë». Drejtuesit dhe teknikët e ndërmarrjeve e të kooperativave bujqësore duhet të punojnë për zgjidhjen e këtij problemi edhe për vitin tjetër edhe për vjetët e ardhshëm, se vetëm kështu hidhen bazat për stabilimin dhe rritjen sistematike të rendimenteve. Të veprohet ndryshe jo vetëm që dëmtohen rendimentet, por edhe fara e mirë që mund të përdoret infektohet dhe degjenerohet shpejt.

Është e domosdoshme që, jo vetëm për kulturat kryesore por edhe në caktimin e tokave për mbjelljen e kulturave të dyta, të tregohet kujdes i madh, në mënyrë që *mbjellja e kulturave të dyta të mos pengojë në asnjë mënyrë mbjelljen dhe rritjen normale të kulturave kryesore (bazë)*.

Duke u nisur nga gjendja e sotme dhe nga eksperiencia e deritanishme e ndërmarrjeve dhe e kooperativave bujqësore, duke pasur parasysh nivelin e tanishëm të bujqësisë sonë dhe perspektivat për vjetët e ardhshëm, del e nevojshme, që në vija të përgjithshme, për një renditje të drejtë e racionale të kulturave bujqësore, të merren këto masa:

a) Të studjohen dhe të përcaktohen me një vëmendje të madhe përpjesëtimet e kulturave prashitëse e joprashitëse për çdo zonë dhe «destinacioni» i tokave, d.m.th. caktimi i tokave që do të mbillen për çdo kulturë për të gjithë vitin bujqësor *të bëhet qysh në fund të muajit maj të çdo viti*, para fillimit të mbjelljes së misrit hamullor. Caktimi i tokave për çdo kulturë të konsiderohet si një nga momentet më të rëndësishme e më me përgjegjësi dhe kjo duhet të arrihet si rezultat i një studimi të hollësishëm të historikut të ngastrave, të bloqeve dhe i një pune të kujdesshme të të gjithë kuadrove e teknikëve që drejtojnë ekonominë bujqësore.

b) Të punohet që brenda një periudhe tranzitore prej 3-4 vjetësh masa e bimëve prashitëse të mbillet pas të lashtave dhe të lashtat pas bimëve prashitëse e leguminoze, duke synuar që të mos mbillen të lashta mbi të lashta në masën më shumë se 30-35 për qind të sipërfaqes, nga e cila gruri mbi grurë — jo më shumë se 25—30 për qind dhe, për asnjë arësyje, *të mos mbillet grurë mbi grurë më tepër se dy vjet me radhë në të njëjtën tokë (ngastër e blok)*.

c) Të zgjerohen më shumë kulturat leguminoze duke siguruar medoemos plotësimin e planit të mbjelljes së jonxhës, duke shtuar

veçanërisht sipërfaqen e fasules direkte si një parabimë e mirë për grurin jo vetëm si leguminoze, por edhe që e çliron shpejt tokën dhe krijon mundësitë për punimin e thellë të saj që në muajt korrik-gusht. Të shtohet mbjellja e jonxhës, trifilit, qiqrave, thjerrzave dhe e koçkullave, sidomos në zonat kodrinore e malore. Të shtohet sipërfaqja e trifilit, bathës, buxhakut, bizeles etj., për llogari të tagjisë, të kulturave foragjere ose të kulturave të tjera të dorës së dytë. Të shtohet mbjellja e hasëllit të përzier me leguminoze, sidomos e tërshërës së përzier me buxhak etj. Ndërkaq, të ngarkohen Komisioni i Planit të Shtetit, Ministria e Bujqësisë dhe Komiteti Shtetëror i Grumbullimeve që të studjojnë dhe të përcaktojnë koeficientë të leverdishëm për t'i konvertuar në drithëra, për efekte detyrimi, të gjitha llojet e leguminozeve kokërr që përdoren për ushqim për popullsinë ose për eksport, si dhe çmimet e grumbullimit për ato lloj leguminozesh që nuk kanë çmime fikse.

ç) *Misri hamullor të caktohet për t'u mbjellë kryesisht në tokat nën ujë*. Të mbahet parasysh që ai të mos mbillet në tokat që janë të infektuara nga grami ose talla, për zhdukjen e të cilave parashikohet plugimi i thellë gjatë muajve të thatë korrik—gusht. Si rregull, *misri hamullor për kokërr të mos mbillet në ato toka që do të mbillen me kultura të vjeshtës*, përveç rasteve kur ai mbillet menjëherë pas korrjeve të para dhe kur fara e misrit ka cikël të shkurtër ose kur destinohet për furazh të gjelbër ose silazh.

d) Gjithashtu të mbahet mirë parasysh që, si rregull, të mos mbillen me hasëlle të vona ato toka që janë caktuar të mbillen qysh në muajt janar-shkurt me kultura të hershme pranverore, si p.sh. me elb, patate, panxhar, jonxhë e trifil si edhe tokat kodrinore të paujtitshme, ku mbjelljet pranverore fillojnë herët. Këto toka mund të caktohen vetëm për mbjelljen e hasëlleve të hershme e që do të shfrytëzohen si të tilla deri në mes të dimrit. Në caktimin e tokave për mbjelljen e hasëlleve të zakonshme mund të preferohen, në përgjithësi, ato toka që janë të infektuara nga grami e talla, por që për mungesë mjetesh e forcash nuk është parashikuar të pluhohen thellë në verë.

* * *

Partia e ka theksuar kurdoherë se prodhimi i drithërave është hallka kryesore në bujqësi, që përcakton në mënyrë vendimtare zhvillimin e të gjitha degëve të ekonomisë bujqësore dhe të bujqësisë në përgjithësi. Shtimi i prodhimit të drithit qëndron si qëllimi kryesor i gjithë punës që duhet të bëjmë për intensifikimin e bujqësisë.

Dihet si paraqitet gjendja e prodhimit të drithit në vendin tonë. Sikurse u theksua më sipër, megjithëse në Shqipëri për vitin

1961 u prodhuan 43 për qind më shumë drithëra se në vitin 1938, prodhimi i drithit ka qenë dhe mbetet i pamjaftueshëm. Sikurse dihet, këta 3 vjetët e fundit në vendin tonë ka pasur thatësira të mëdha. Detyrat e caktuara në plan nuk u realizuan plotësisht.

E vërteta është se prodhimi i drithërave për frymë të popullsisë për vitin 1965, në krahasim me vitin 1956—1960 u rrit nga 190 kg. në 227 kg. Megjithatë edhe kjo nuk është e mjaftueshme po të shohim nevojat për drithë që ka gjithë ekonomia popullore. Edhe gjatë vjetëve të pesëvjeçarit të tretë do të na duhet të importojmë çdo vit sasi jo të pakta drithi. Prandaj, kur flasim për intensifikimin e bujqësisë, duhet të kuptojmë si detyrën më të ngutshme dhe themelore shtimin e prodhimit të drithit. Problemi i drithit të zgjidhet në vend, bile të zgjidhet jo vetëm ky problem, por të shtohen të gjitha llojet e prodhimeve bujqësore e blegtorale në atë masë që të kënaqen nevojat e popullsisë dhe të ekonomisë popullore.

Në pesëvjeçarët e ardhshëm nevojat për drithë do të jenë edhe më të mëdha nga fakti se: a) ritmi i shtimit të popullsisë në vendin tonë, sikurse dihet, është i lartë dhe kjo është një fitore e madhe që tregon përmirësimin e gjithanshëm të nivelit të jetesës së popullit tonë; b) në të ardhshmen duhet të parashikojmë që konsumi i drithit për frymë të jetë më i lartë se sa është sot; c) drithi nevojitet edhe për qëllime të tjera të ekonomisë popullore.

Duke mbajtur parasysh këto nevoja të mëdha që do të ketë vendi për drithëra do të na duhet që në të ardhshmen të prodhohet jo më pak se 350-400 kg. drithë për frymë në vit. Ç'do të thotë të arrish të sigurosh këto sasi drithi për frymë? Kjo do të thotë që duke përvetësuar toka të reja të rritet sipërfaqja e mbjellë me drithëra dhe në mënyrë të veçantë të përqëndrohet vëmendja në rritjen e vazhdueshme të rendimenteve, duke pasur si objektiv që rendimenti mesatar për çdo hektar të mbjellë me grurë të rritet vazhdimisht 25 kv/ha. dhe me misër 27 kv/ha., në krahasim me rendimentin prej 13,6 kv/ha. me grurë dhe 14,6 kv/ha. me misër që është parashikuar të merret për vitin 1965.

Nga këto shifra kuptohet qartë se sa më shumë kohë që të kalojë aq më shumë duhet menduar seriozisht dhe të merren masa që të zgjerohen sipërfaqet e mbjella me drithëra dhe sidomos të ngrihet prodhimi i drithit për çdo hektar të mbjellë.

Në bujqësinë tonë qysh sot nga shumë ekonomi ka të dhëna inkurajuese që tregojnë se ka mundësi të mëdha për të marrë rendimente të larta drithërash për çdo hektar të mbjellë.

Për vitin 1961, ndërsa rrethi i Elbasanit realizoi 6,9 kv/ha. grurë dhe 10,7 kv/ha. misër, kooperativa e Shirgjanit mori 12,4 kv/ha. grurë dhe 23,8 kv/ha. misër. Rrethi i Sarandës mori respektivisht 8 dhe 14,3 kv/ha. grurë dhe misër, ndërsa kooperativa e Konispolit mori 11,6 dhe 23 kv/ha. Rrethi i Fierit mori mesatarisht 10,6 kv/ha.

misër, ndërsa kooperativa e Zharëzës 23 kv/ha. Sektori shtetëror këtë vit mori 15,65 kv/ha. grurë, ndërsa si Republikë plani i grurit realizohet 10,3 kv/ha. Por ka ndërmarrje bujqësore shtetërore, si ajo e Maliqit që mori 27,3 kv/ha. grurë me 1 336 hektarë, Ndërmarrja shtetërore e Beratit 28,9 kv/ha. Ndërmarrja bujqësore «29 Nëntori» e Lushnjës mori 16,5 kv/ha. grurë, ndërsa rrethi i Durrësit 10 kv/ha. Rendimente të larta në grurë muarën edhe shumë kooperativa bujqësore, si p.sh. ajo e Rrëmbecit 24,7 kv/ha., e Bulgarecit 19,7 kv/ha., e Zemblakut 22,5 kv/ha., në rrethin e Beratit kooperativa e Dushnikut mori 17,4 kv/ha. dhe e Lapardhasë 18 kv/ha.; në Durrës kooperativat bujqësore të Sukthit dhe të Shijakut muarën respektivisht nga 16,9 dhe 15,6 kv/ha. grurë, në rrethin e Krujës kooperativa e Gjonmit mori 19,5 kv/ha. në gjithë sipërfaqen prej 185 ha. etj. Në çdo rreth ka shumë ekonomi që kanë marrë rendimente të larta, bile ka rrethe si ai i Dibrës, i Pukës dhe i Tropojës që në vitin 1961 muarën mesatarisht nga 16,4, 21,8, 15,3 kv/ha. misër.

Të gjithë këta shembuj dëshmojnë se sa e drejtë është direktiva që dha Kongresi IV i Partisë se

*«rruga kryesore për zhvillimin e bujqësisë dhe për shtimin e prodhimeve bujqësore... është rritja e pandërprerë e rendimenteve».*¹

Eksperienca e ekonomive që kanë marrë rendimente të larta në drithërat e bukës, në kushtet e vështira të thatësirës 3-vjeçare dhe të shirave të mëdha gjatë dimrit, megjithëse shfrytëzimi i rezervave në bujqësi ka qenë i pamjaftueshëm, na bind se ka mundësi të mëdha për të ecur shpejt në shtimin e rendimentit për çdo hektar të mbjellë me drithëra.

Që të shtohet prodhimi i drithërave të bukës duhet që çështjet agroteknike që u përmenden më sipër të zbatohen plotësisht nga të gjitha ekonomitë bujqësore. Në radhë të parë, për drithërat e bukës, është e nevojshme të shihet mundësia e mbjelljes së grurit në një sipërfaqe më të madhe se ajo që mbillet sot, atje ku këtë e lejon një renditje normale e kulturave bujqësore. Nga të dhënat shumëvjeçare rezulton se në përgjithësi prodhimi i grurit në tokat e thata të paujitshme ka qenë më i qëndrueshëm nga ai i misrit. Gruri i qëndron më tepër thatësirës, që te ne, sikurse dihet, është e shpeshtë dhe tokat e paujitshme sot zënë 65,6 për qind të sipërfaqes së punueshme. Duke synuar të mbillet sa më shumë grurë, edhe në zonat fushore të ujtitshme krijohen mundësi që të me-

¹ Enver Hoxha. Raport mbi aktivitetin e Komitetit Qendror të PPSH, Kongresi IV i PPSH, f. 94, Tiranë 1961.

rret jo vetëm prodhimi i grurit nga çdo hektar i mbjellë, por edhe që këto toka në pjesën më të madhe të mbillen shumë mirë me misër, oriz dhe me fasule etj. dhe të merren prodhime të larta. Kooperativa e Shirgjanit në vitin 1961 mori, pas grurit, 18 kv/ha. misër hamullor, ajo e Konispolit në 100 hektarë mori 13,5 kv/ha., kooperativa e Perondisë në Berat, në 110 hektarë mori 10,4 kv/ha., Ndërmarrja bujqësore e Sukthit mori 9 kv/ha. në 430 hektarë, ajo e Thumanës 8,3 kv/ha. në 962 hektarë dhe kooperativa e Mavropullit në rrethin e Sarandës, duke mbjellë mbas korrjes së grurit oriz, mori 15 kv/ha. oriz në 3 hektarë. Nëse orizi hamullor do të mbillet me fidane janë të gjitha mundësitë të merren rendimente edhe më të larta.

Zonat fushore të vendit, prej Shkodre deri në Sarandë si dhe fusha e Korçës, janë baza kryesore e prodhimeve bujqësore. Shteti ka investuar shuma kolosale për bujqësinë në këto zona, sidomos për ndërtime veprash kullimi, ujitjeje dhe për mekanizimin e bujqësisë. Këto zona janë baza e prodhimit të bimëve industriale, por janë njëkohësisht baza kryesore e prodhimit të drithërave. Prandaj, kur shtrohet çështja e rritjes së rendimenteve, këtu më tepër se kudo duhet të punohet më shumë dhe më mirë për rritjen e rendimenteve, duhet të përqëndrohen mjetet dhe mundësitë për shfrytëzimin sa më mirë të rezervave që ka bujqësia, sepse këtu ka rezerva kolosale. Organizatat e Partisë, organet shtetërore të bujqësisë, teknikët dhe specialistët e bujqësisë, punonjësit e ndërmarrjeve shtetërore dhe ata të kooperativave bujqësore duhet të futen më thellë në problemet e bujqësisë, ta organizojnë më mirë punën, të mobilizojnë të gjitha forcat dhe mjetet, të shfrytëzojnë mundësitë e mëdha që janë krijuar për shtimin e prodhimeve bujqësore, të drithërave për çdo hektar të mbjellë. Shembulli i ekonomive të dalluara për prodhime të larta drithi duhet të bëhet mësim për të gjithë kooperativistët, për punonjësit e bujqësisë dhe për organizatat e Partisë në këto zona dhe t'i nxitë ata të punojnë dhe të luftojnë ashtu si ekonomitë e përparuara, ekonomitë bujqësore që qëndrojnë prapa t'i ngrenë në nivelin e të përparuarave, të ecin bashkë me këto e të prodhojnë sa më shumë drithë për popullin dhe për atdheun.

Shumë rrethe malore dhe ekonomi kolektive të zonave malore, të rretheve fushore dhe kodrinore, kanë një eksperiencë shumë të pasur në prodhimin e misrit nga tokat e ujitshme. Kjo eksperiencë e madhe duhet të përgjithësohet në të gjitha zonat malore për të rritur rendimentin për çdo hektar të mbjellë me misër. Rrethet dhe zonat malore në të gjithë vendin, zënë rreth 35 për qind të të gjitha tokave nën kulturë që ka Republika. Në qoftë se të gjitha rrethet dhe zonat malore do të merrnin rendimentin prej 21,8 kv/ha. që mori për vitin 1961 rrethi i Pukës, rendiment ky që është 11,1 kv/ha. misër më shumë se sa rendimenti i realizuar për vitin

1961 në Republikë, atëhere problemi i bukës do të zgjidhej në një të ardhshme shumë të afërt. Partia duhet ta shfrytëzojë medoemos këtë eksperiencë të pasur. Duhet patjetër, që jo vetëm kultivuesit e misrit të zonave malore, por dhe ata të zonave fushore të shkojnë të mësojnë nga eksperiencia e prodhuesve të dalluar të misrit. Ashtu sikurse dërgojnë kooperativat një ose më shumë anëtarë të tyre në ndërmarrjet shtetërore bujqësore për të mësuar në praktikë agroteknikën, zooteknikën, rritjen e blegtorisë etj., ashtu edhe kooperativat dhe ekonomitë që kultivojnë misër të dërgojnë punëtorë të mirë, skuadërkomandantë ose brigadierë; kryetarët, agronomët dhe kuadrot drejtues të kooperativave të venë vetë pranë ekonomive të dalluara për kultivimin e misrit, të mësojnë nga eksperiencia e tyre, ta vënë atë në jetë.

Çdo përpjekje për shtimin e drithërave, çdo rezultat i arritur në shtimin e drithit, sikurse e ka vërtetuar jeta, i nxit kooperativistët në punë për të pasur rezultate në të gjitha degët e ekonomisë.

Krahas luftës për shtimin e drithërave duhet të luftohet për ngritjen e rendimenteve të të gjitha kulturave bujqësore të arave, të frutikuturës dhe të blegtorisë. Për kulturat industriale, sidomos për pambukun dhe për panxharin, të cilat mbillen në tokat më pjellore të vendit, mundësitë për rritjen e rendimenteve janë shumë të mëdha. Shembujt e ekonomive të përparuara tregojnë se me intensifikimin e bujqësisë, duke zbatuar një agroteknikë të lartë në të gjitha ekonomitë që i kultivojnë këto bimë, mund të sigurohen prodhime të larta dhe të mjaftueshme për nevojat e ekonomisë.

Duke u nisur nga rezervat e brendshme që ka bujqësia, nga masat e mëtejshme që do të merren për intensifikimin e shpejtë të bujqësisë, nga puna dhe nga lufta që duhet të bëhet vazhdimisht për zbatimin e agroteknikës së përparuar në bujqësi, duke shfrytëzuar sa më mirë mjetet dhe kushtet që ka krijuar dhe po krijon vazhdimisht pushteti për zhvillimin e bujqësisë, janë të gjitha mundësitë që në vitin 1965 të arrihen dhe të tejkalohen objektivat që caktoi Kongresi IV i Partisë për prodhimin e drithit dhe, me siguri, në pesëvjeçarët e ardhshëm prodhimi i drithit të rritet në atë masë që të kënaqen plotësisht nevojat e popullsisë dhe të gjitha nevojat e ekonomisë popullore.

Partia dhe gjithë punonjësit e bujqësisë në qendër, në rrethe dhe në fshat duhet të punojnë për të arritur këto objektiva dhe nuk ka dyshim se këto objektiva do të arrihen patjetër.

B. — PËRMIRËSIMI DHE INTENSIFIKIMI I BAZËS USHQIMORE TË BLEGTORISË, ËSHTË RRUJA KRYESORE PËR ZHVILLIMIN E MËTEJSHËM TË BLEGTORISË DHE PËR SHTIMIN E PRODUKTEVE BLEGTORALE

Problemin e blegtorisë Komiteti Qendror i Partisë e ka shqyrtuar në një plenum të veçantë qysh në vitin 1958. Detyrat e parashikuara nga plenumi për zhvillimin e blegtorisë dhe për shtimin e prodhimeve blegtorale janë përfshirë në planin e tretë pesëvjeçar. Ngritja edhe një herë e problemit të blegtorisë në këtë plenum, bëhet për vetë rëndësinë shumë të madhe që ka ky sektor i ekonomisë, si pjesë përbërëse e ekonomisë bujqësore, bëhet për vetë faktin se në këtë plenum problemet e shumta të bujqësisë shikohen si një tërësi komplekse dhe e pandarë, sepse çdo sektor ose degë e ekonomisë bujqësore duhet të zhvillohet në mënyrë të harmonizuar, ashtu si e kërkon nevoja e intensifikimit të mëtejshëm të bujqësisë sonë. Është e nevojshme t'i themi plenumit se, qysh nga viti 1958 e deri më sot, blegtoria jonë ka bërë hapa përpara, gjë që tregon se sa të drejta ishin detyrat që shtroi plenumi për blegtorinë dhe sa mundësi praktike ka për zhvillimin e mëtejshëm të blegtorisë dhe për intensifikimin e saj. Me punën që bënë Partia, organet e pushtetit, teknikët, specialistët dhe punonjësit e tjerë të bujqësisë dhe të blegtorisë u shtua numri i krerëve në të gjitha llojet, u rrit prodhimi për krerë dhe prodhimi i përgjithshëm.

Për çdo 100 hektarë tokë bujqësore në vitin 1961 në kooperativat bujqësore u prodhua më shumë se në vitin 1958, 18 kv. qumësht, 3,6 kv. mish, 0,34 kv. lesh etj. Është përmirësuar struktura e gjësë së gjallë për shtimin e atyre llojeve dhe kategorive të kafshëve që i shfrytëzojnë më intensivisht ushqimet dhe prodhojnë më shumë. Si pasojë ka ndryshuar pozitivisht edhe struktura e prodhimeve blegtorale.

Janë inkurajuese rezultatet që janë marrë nga përmirësimi i dhenve të vendit me raca të huaja. Prodhimtaria e leshit të dhenve, si rezultat i kryqëzimit, është shtuar gjatë këtyre 5 vjetëve të fundit 15-20 për qind dhe është përmirësuar në mënyrë të dukshme cilësia e tij.

Përhapja e kryqëzimit dhe e ndërimit artificial në lopët ka shpënë në ndryshimin e proporcionit midis lopëve të përmirësuara dhe të papërmirësuara në favor të lopëve të përmirësuara.

Kompleksi i faktorëve, nga i cili varet intensifikimi i mëtejshëm i blegtorisë në vendin tonë, përfshin: përmirësimin rrënjësor dhe intensifikimin e bazës ushqimore të bagëtisë, shpejtimin e ritmit të përmirësimit të racave të kafshëve, shtimin e numrit të kafshëve për çdo hektar tokë dhe zbatimin e të gjitha masave zooteknike e veterinare. Të gjitha këto masa kanë për qëllim shtimin e prodhimeve blegtorale për një njësi sipërfaqe.

1. — Mbi përmirësimin dhe intensifikimin e bazës ushqimore të blegtorisë

Në kushtet e bujqësisë sonë problemi i sigurimit të një baze të mirë ushqimore për blegtorinë nuk mund të zgjidhet vetëm për llogari të zgjerimit të sipërfaqeve të mbjella për prodhim ushqimësh të thata ose koncentrate. Bile, të dhënat tregojnë se ka mjaft raste që edhe sipërfaqja e planifikuar për t'u mbjellë me kultura foragjere nuk shfrytëzohet plotësisht. Si Republikë, kulturat foragjere direkte me gjithë tagjirat, në vitin 1960-1961 zënë 15,2 për qind të sipërfaqes së përgjithshme që mbillet me kulturat e arave dhe së bashku me kulturat e dyta arrin në 22,5 për qind të sipërfaqes së përgjithshme përkatëse; ndërsa në sektorin shtetëror, për kulturat direkte, kjo përqindje është rreth 28,8 për qind mesatarisht, kurse në disa ndërmarrje me blegtori të zhvilluar si p.sh. në NBSH-në e Sukthit, sipërfaqja e mbjellë me kulturat foragjere direkte zë 25,2 për qind, në Goranxi — 30,2 për qind të sipërfaqes dhe megjithatë problemi i bazës ushqimore nuk është zgjidhur përfundimisht as këtu. Pse ndodh kjo? Mos është shkak se nuk mjafton sipërfaqja e caktuar për të mbjellë koncentrate dhe foragjere për blegtorinë? Apo nuk shfrytëzohet si duhet kjo sipërfaqe për të marrë ato ushqime të planifikuara, në mos më shumë, për nevoja të blegtorisë? Po të kishim shumë tokë do të ishte mirë t'i linim më shumë blegtorisë, por neve toka nuk na mjafton as për prodhimin e drithërave të bukës. Çështja qëndron se *tokat e caktuara për prodhimin e ushqimeve për blegtorinë janë shfrytëzuar keq* dhe nuk është marrë rendimenti i planifikuar për çdo hektar, as nuk janë mbjellë ato kultura që japin rendiment më të lartë, nga të cilat sigurohet më shumë prodhim, më shumë kv/ njësi ushqimore për çdo hektar të mbjellë.

Ka boshllëqe të mëdha në agroteknikën që zbatohet për kulturat e caktuara për nevojat e blegtorisë, sidomos për kulturat foragjere. Në përgjithësi, për kulturat foragjere lënë tokat më të varfëra, bëjnë plehërimin më të dobët ose nuk bëjnë asnjë plehërim, nuk respektojnë afatet e shërbimeve të ndryshme kulturalë. Problemi i prodhimit të farës dhe i llojeve të foragjereve që japin rendiment më të lartë nuk është zgjidhur akoma plotësisht. Të gjitha këto vërtetojnë konceptin jo të drejtë që kanë shumë drejtues të ekonomisë bujqësore në caktimin dhe në shfrytëzimin jo të mirë të tokave për prodhimin e ushqimeve për blegtorinë. Ka mundësi të mëdha për të shtuar ushqimet blegtorale, por duhet të merren të gjitha masat që këto mundësi të shfrytëzohen.

a) *Të përqëndrohet vëmendja në prodhimin e sa më shumë ushqimeve të gjelbëra për blegtorinë.* Është e domosdoshme të shfrytëzohen tokat e caktuara për prodhimin e ushqimeve për blegtorinë kryesisht për ushqime të gjelbëra, të luftohet që për çdo

hektar të mbjellë me ushqime të gjelbëra të merren jo më pak se 40—50 njësi ushqimore për hektar.

Ekspierienca e ndërmarrjeve të përparuara ka treguar se kemi mundësi të marrim rendimente të larta, në qoftë se tokat e caktuara për blegtorinë do të mbillen në pjesën më të madhe me ushqime të gjelbëra. Njihet fakti se në ato ekonomi ku janë marrë masa praktike për shtimin e bazës ushqimore të blegtorisë, prodhimi i ushqimeve për blegtorinë për njësi sipërfaqe ka qenë shumë i lartë. Ndërmarrja zooteknike shtetërore në Tiranë në tre vjetët e fundit, 1959—1961, ka marrë për çdo hektar mesatarisht, rreth 78 kv/njësi ushqimore për hektar ose rreth 468 kv. për hektar masë të gjelbër. Këto rezultate janë arritur në saje të shfrytëzimit maksimal të sipërfaqes, të mbjelljes së atyre kulturave foragjere që japin rendimente më të larta, siç janë jonxha, trifili «Aleksandrin», misri, hasëllet e përziera me buxhak, lakra etj. Marrja e rendimenteve të tilla të larta ka lejuar që në një sipërfaqe prej 40 hektarësh tokë të mbahen 76 njësi gjedhe prej të cilave 40 krerë lopë, që kanë arritur një prodhimtari mesatare vjetore prej rreth 4 000 litra qumësht për kokë në vitin 1961, në një kohë kur nga shteti ndërmarrja është furnizuar vetëm me 270 kv. hime e 140 kv. bërsi pambuku.

Edhe në ekonomitë e tjera kemi shembuj pozitivë për marrjen e rendimenteve të larta kur sipërfaqe toke janë mbjellë edhe me ushqime të gjelbëra. Kështu, në NBSH-në e Fierit gjatë vitit 1961, në një sipërfaqe prej 23 hektarësh u muarën shtatë kositje nga jonxha e mbjellë po atë vit; në kooperativën bujqësore të Zharëzës, në një sipërfaqe prej 7 hektarësh, të mbjellë me trifil, u muarën 500 kv. masë e gjelbër për hektar; në NBSH-në e Gosës, në një sipërfaqe prej 5 hektarësh, është marrë një rendiment prej 700 kv. për hektar trifil «Aleksandrin», barazi me 120 kv/njësi ushqimore për hektar. Ja se ç'do të thotë shfrytëzimi me ekonomi i tokës, ja si krijohen mundësitë për të prodhuar më shumë mish, qumësht dhe prodhime bujqësore për çdo hektar.

Duhet të konsiderohet jo e drejtë praktika e atyre ekonomive të cilat, në strukturën e sipërfaqeve që mbjellin me bimë për ushqimin e blegtorisë, një vend të madh u lënë koncentrateve. Një praktikë e tillë ul sasinë e njësive ushqimore që mund të merren nga e njëjta sipërfaqe toke në krahasim me rastin kur foragjeret korren dhe përdoren në formë të njomë ose të gjelbër. . .

Tendenca për ta zgjidhur problemin e bazës ushqimore, në radhë të parë me anë të koncentrateve, nuk mund të mos reflektojë edhe në praktikën e të ushqyerit të bagëtisë. Në vend të ushqimeve të tjera përdoren më shumë koncentrate. Kështu p.sh. në ndërmarrjet bujqësore shtetërore, gjatë vitit 1960 për çdo kv. shtesë peshë në derrat janë konsumuar mesatarisht 6,2 kv/njësi ushqimore koncentrate, kurse gjatë vitit 1961, 4,9 kv/njësi ushqim-

more koncentrate; ndërsa dihet fare mirë se çdo kg. koncentrat i dhënë më tepër kafshëve rrit 2—3 herë atë pjesë të koston së prodhimeve blegtorale që varet nga ushqimet. Nga praktika e vendit tonë është vërtetuar se është plotësisht e mundshme që një numër dhe një kategori kafshësh mund të rriten dhe të japin prodhime mbi nivelin e prodhimtarisë që japin sot, bile edhe tej asaj që kërkohet nga plani i shtetit, kryesisht pa koncentrate dhe në radhë të parë me ushqime të gjelbëra. Kështu, p.sh., në saje të një organizimi më të mirë të të ushqyerit të kafshëve duke përdorur më shumë ushqime të gjelbëra në masën 40—60 për qind të vlerës së përgjithshme të racionit, në disa NBSH, si në Lushnjë, Thumanë, Fier, Gosë, Maliq etj., janë arritur rezultate pozitive në të ushqyerit e derrave. Në NBSH-në «Çlirimi» në Fier, gjatë nëntë-mujorit të parë të vitit 1961, janë marrë mesatarisht nga çdo dosë 4,29 kv. mish, me një kosto mesatare prej 111,1 lekë/kg. kundrejt 117,9 lekë të planifikuara, kryesisht në saje të përdorimit në shkallë më të gjerë të ushqimeve të njoma të gjelbëra, të përshtatshme për rritjen e derrave, si jonxhë, trifil etj.

Prandaj, në kushtet klimatike dhe ekonomike të vendit tonë, ne duhet t'i japim prioritet përdorimit të ushqimeve të gjelbëra, organizimit të konvejerit të gjelbër, i cili siguron marrjen e sa më shumë njësive ushqimore nga toka, shfrytëzimin e saj dy dhe tri herë në vit dhe prodhimin e ushqimeve me një kosto më të ulët, me të ushqyerit e kafshëve me ushqime të gjelbëra, të cilat preferohen dhe treten më mirë prej tyre.

Për organizimin e konvejerit të gjelbër janë arritur tashmë disa suksese në ndërmarrjet dhe në kooperativat bujqësore. Ka mjaft ndërmarrje bujqësore, si ajo e Lushnjës, Fierit, Sukthit, Lllakatundit dhe kooperativa bujqësore, si ajo e Krutjes së sipërme, Zharëzës, Cakranit, Shalësit, Perondisë, Novoselës, Vrakës, Shijakut etj., të cilat po vënë në jetë me sukses konvejerin e gjelbër. Në këto ekonomi kafshët ushqehen thuajse gjatë gjithë muajve të vitit me ushqime të gjelbëra. Por në masën dërmuese kooperativat bujqësore dhe disa NBSH akoma nuk e njohin praktikën e konvejerit të gjelbër. Shpeshherë konvejeri ndërtohet si skemë, por nuk llogariten mirë nevojat sipas muajve dhe aq më pak përputhen të dhënat në letër me atë që sigurohet në praktikë. Prandaj, janë akoma të shumta rastet kur bagëtia ushqehet në mënyrë sezonale, në dimër me kashtërat e drithërave dhe në verë me bimësinë e varfër të kullotave natyrale. Si pasojë nuk shfrytëzohet kapaciteti prodhues i kafshëve tona.

Organizimi i konvejerit të gjelbër duhet të lidhet ngushtë me shfrytëzimin e tokave afër stallave të lopëve, të derrave etj. Mbjellja me foragjere e parcelave afër stallave jo vetëm që siguron uljen e koston së ushqimeve, për shkak të shkurtimit të transportit midis vendit të prodhimit dhe vendit të konsumit të tyre,

por meqenëse në shumë raste këto parcela duke qenë afër stalla-ve mund të plehërohen, rendimenti i kulturave foragjere në to mund të jetë shumë i lartë.

b) *Të merren të gjitha masat që të silazhohen sasi të e nevojshme për ushqimin e gjedheve, jo vetëm të kooperativave bujqësore, por për të ndihmuar dhe oborret kooperativiste.* Megjithëse në krahasim me vitin 1958 më 1961 u silazhuan 192 000 ton më shumë, nuk janë shfrytëzuar mundësitë e mëdha për silazhimin e kashtës së misrit për ushqim të blegtorisë. Ka shumë ekonomi kooperativiste dhe ndërmarrje bujqësore që e nënvleftësojnë këtë problem, megjithëse u mungojnë burimet e tjera për sigurimin e ushqimeve të blegtorisë. Ka rrethe si Vlora, Tirana, Shkodra, Saranda etj., që gjatë këtyre vjetëve asnjë vit nuk e kanë realizuar planin e silazhit duke e lënë kashtën e misrit të thahet dhe të kalbet. Ky qëndrim është i palejueshëm dhe i dëmshëm. Edhe këtë vit mjaft rrethe po bëjnë pak përpjekje për të realizuar planin e silazhit. Sa kohë do të vazhdojë të shihet me kaq indiferecentizëm problemi i silazhit? Jo! Kjo gjendje nuk duhet lejuar të vazhdojë më tutje. Komitetet e Partisë në rrethe dhe organizatat bazë duhet ta marrin seriozisht në dorë punën e silazhit. Duhet që tokat e caktuara për blegtorinë të mbillen për të prodhuar ushqime për blegtorinë, misri i mbjellë për silazh në këto toka të përdoret për silazh. Përsa u përket sipërfaqeve të mbjella me misër për kokërr, janë të gjitha mundësitë që, pa dëmtuar prodhimin, kashta të përdoret për silazh. Prandaj, duhet të bëhet rregull nga të gjitha ekonomitë bujqësore prerja e misrit në fazën e dyllit. Kështu jo vetëm prodhimi i misrit nuk dëmtohet, por edhe kashta e tij shfrytëzohet për silazh për blegtorinë. Atje ku misri piqet vonë duhet t'i këputet maja në kohën kur është e gjelbër dhe të bëhet silazh. Gjethet e panxhar sheqerit dhe çdo bimë e butë ose e egër që mund të bëhet silazh duhet të mblidhen me doemos në kohë dhe të silazhohen. Këtë punë duhet ta bëjë çdo kooperativë, çdo ndërmarrje bujqësore, çdo rreth. Vështirësitë që dalin për përgatitjen e silazhit nuk duhet të bëhen shkak për të hequr dorë nga silazhi, por të bëhen përpjekje që ato të kapërcehen. Çdo vështirësi kapërcehet kur Partia e merr punën në dorë, kur çështjet e shtron si duhet me punonjësit dhe e ndjek si një problem të madh, për të cilin duhet të përgjigjen specialistët dhe organet e bujqësisë, drejtuesit e ndërmarrjeve shtetërore bujqësore dhe të kooperativave bujqësore.

c) *Të shfrytëzohen në dobi të blegtorisë të gjitha ushqimet e thara të kulturave të arave: kashtërat e të lashtave, bari, mbeturinat e bimëve industriale etj.* Nga përllogaritjet rreth 40 për qind e njësive ushqimore që merren nga toka me anë të drithërave janë nga ushqimet e ashpra. Në shumicën e ndërmarrjeve bujqësore e të kooperativave bujqësore, ushqimet e ashpra (kashta e byku) ako-

ma shfrytëzohen pa u përpunuar, gjë që shkakton humbje të ndieshme, ashtu sikurse nuk shfrytëzohen plotësisht edhe mbeturinat e industrisë ushqimore, të thertoreve, të mensave etj. për ushqim të blegtorisë. Vetëm nga bërsitë e ullirit, të pambukut dhe nga mbeturinat e industrisë ushqimore e të peshkimit mund të sigurohen 15 000 ton njësi ushqimore, të barabarta afërsisht me 10 për qind të nevojave ushqimore në concentrate për gjithë gjënë e gjallë. Këto rezerva të mëdha për ushqimin e blegtorisë të shfrytëzohen patjetër mirë dhe me nikoqirllëk, të mos vejë dëm asnjë fill kashtë ose ushqim i ashpër, të mos vejë dëm asnjë nga mbeturinat e industrisë. Ministria e Bujqësisë, Komisioni i Planit të Shtetit, Ministria e Industrisë dhe Komiteti Shtetëror i Grumbullimeve të marrin të gjitha masat e nevojshme që gjatë vitit 1963 të përdoren drejt dhe plotësisht të gjitha bërsitë dhe mbeturinat e tjera të ushqimeve.

ç) *Të përmirësojmë gjendjen e kullotave natyrale dhe t'i shfrytëzojmë ato sa më mirë.* Në konditat e vendit tonë nga gjendja e kullotave natyrale varet shumë zgjidhja e problemit të sigurimit të bazës ushqimore të blegtorisë, veçanërisht për bagëtinë e imtë. Nga kullotat dhe nga livadhet natyrale plotësohen rreth 40 për qind të nevojave vjetore të ushqimit të gjësë së gjallë. Prandaj, shfrytëzimi i drejtë, përmirësimi dhe shtimi i kapacitetit të kullotave është një problem mjaft i rëndësishëm dhe detyrë e vazhdueshme. Në mjaft rrethe për këtë qëllim është punuar mirë, por megjithatë rreth 30—35 për qind e sipërfaqes së kullotave dhe e mushave, dimërore dhe verore nuk shfrytëzohen mirë e plotësisht, për shkak se janë mbuluar me ferra, driza, gurë etj. dhe në shumë prej kullotave verore mungon uji, ndërsa mjaft kullota dimërore mbajnë lagështirë. Në konditat e përmirësimit në masë të racës së bagëtisë, sidomos të dhenve, shtimi i kapacitetit të kullotave e të mushave është i domosdoshëm. Pa këtë masë nuk mund të arrihet shtesa e duhur e prodhimit. Në kullotat shtetërore ose kolektive verore apo dimërore duhet bërë një punë e madhe në bazë të projekteve të studjuara. Për këtë qëllim të përdoren jo vetëm të ardhurat nga vetë kullotat, por po të jetë nevoja, të investohen edhe mjete suplementare nga buxheti i shtetit. Përmirësimi i kullotave të synojë në prerjen dhe shkuljen e shkurreve, në pastrimin e gurëve, dëndësimin dhe përmirësimin e bimësisë me anën e mbjelljes, të plehërimit, kryesisht me vatha lëvizëse, në sigurimin e ujit të pijshëm me anë lerash, në kanalizimin e zonave të ulëta e moçalore etj. Është shumë e leverdishme për ekonominë që në vjetët e ardhshëm të bëhen investime më të mëdha për kthimin e kullotave në toka të punuara, për të prodhuar vetëm ushqim për blegtorinë. Në qoftë se brenda 7 vjetëve do të kthejmë jo më pak se 70 000 hektarë kullota në toka të punuara dhe t'i kultivojmë me foragjere, sidomos me hasëlle, ka mundësi të dimërojnë në to një milion krerë

dhen në vend të 250 000 që dimërojnë sot. Këtë punë ne duhet ta bëjmë patjetër, por nuk duhet lejuar në asnjë mënyrë që këto toka, mbasi të punohen, të planifikohen për qëllime të tjera, përveç nevojave të blegtorisë. Ato duhet të shërbejnë vetëm për bazën ushqimore të blegtorisë. Krahas këtyre masave të vendosura rregulla të forta për zbatimin e teknikës së shfrytëzimit dhe për krijimin e mundësive të plota të ripërtëritjes natyrale të bimësisë së kullotave.

Organet shtetërore dhe kooperativat bujqësore të marrin të gjitha masat e nevojshme për përmirësimin e kullotave me qëllim që, brenda 4-5 vjetëve të ardhshëm, të dyfishohet kapaciteti kullor i tyre. Gjithashtu të merren masa për një shpërndarje më të drejtë e më racionale të kullotave në përgjithësi dhe sidomos të kullotave verore e dimërore që kanë ndërmarrjet shtetërore. Mbi këto çështje Ministria e Bujqësisë të bëjë studimet e nevojshme dhe brenda tremujorit të parë 1963 t'i paraqesë propozimet Këshillit të Ministrave.

2. — Mbi përmirësimin e racës së blegtorisë

Është një fakt i vërtetuar nga praktika dhe nga mendimi teknik që kafshët e racës sigurojnë një shfrytëzim më racional të ushqimeve në krahasim me kafshët e papërmirësuara.

Në lidhje me përmirësimin e racës së kafshëve, si faktor i intensifikimit të blegtorisë, V. I. Lenini shkruante:

«Krahas me çështjen mbi sasinë e gjësë së gjallë një rëndësi jo më të vogël, dhe disa herë bile edhe më të madhe, ka çështja e cilësisë së saj»¹.

Në NBSH-në e Vurgut, si rezultat i kryqëzimit të dhenve të vendit me racë malore të Dagestanit, të ardhurat mesatarisht për çdo dele nga leshi, qumështi e mishi (pa qengjin) janë shtuar si vijon: në vitin 1957 janë realizuar 1 593 lekë, ndërsa në vitin 1961 2 642 lekë dhe realizimi i pritshëm për vitin në vazhdim është 2 270 lekë ose 74 për qind më shumë se në vitin 1957.

Si rezultat i vënjes në jetë të vendimeve të Komitetit Qendror të Partisë mbi përmirësimin e racës së bagëtive, në 10 vjetët e fundit janë arritur rezultate të mira në përmirësimin e racës së kafshëve, në radhë të parë të dhenve, pastaj të gjedhit dhe të derrave. Dhe ja rezultatet e deritanishme:

	Gjedhe të përmirësuara në %	Dhen të përmirësuara në %	Derra të përmirësuara në %
Në koop. bujqësore	25	25	40
Në NBSH-të	100	50	100

1. V. I. Lenin. Veprat, vëll. 15, f. 114.

Por megjithatë, sidomos në kooperativat bujqësore, mbetet akoma shumë për të bërë. Ne duhet të marrim masa që në 10—15 vjetët e ardhshëm shumica dërmuese e kafshëve në vendin tonë të jenë të racës së pastër ose kryqëzime të brezave të ndryshëm. Për këtë është e nevojshme të merren masa nga ana e Ministrisë së Bujqësisë që të caktohen ndërmarrje bujqësore shtetërore të veçanta për rritjen e damazëve të nevojshëm për racë.

Sa më shpejt dhe më mirë që të sigurohet ushqimi i blegtorisë aq më shumë mundësi krijohen për përmirësimin e racës. Lopët e uritura, sado që të jenë të racës, kur nuk kanë ç'të hanë, nuk japin qumësht njëlloj si ato që s'janë të racës. Diferenca midis kafshëve të racës dhe jo të racës konstatohet dhe bëhet krahasimi kur sigurohen ushqimet sipas normës. Mund të japim një shembull të gjallë në këtë drejtim. Dy tufa lopësh të së njëjtës racë «Osfriz», të mbajtura në kushte të ndryshme të të ushqyerit, kanë dhënë rendimente krejt të ndryshme. Njëra prej këtyre tufave e mbajtur në NBSH-në «Çlirimi» në kondita jo të mira ushqimi, gjatë vitit 1961 dha 2 215 litra qumësht për lopë foragjere dhe 95 viça për 100 lopë, kurse tufa e dytë, e mbajtur në NZSH në Tiranë në kondita të një ushqimi të plotë, dha në të njëjtin vit 3 994 litra qumësht për lopë foragjere dhe 100 viça për 100 lopë.

Për përmirësimin e racës dalin probleme të reja, të cilat duhet të studjohen dhe të zgjidhen drejt nga Ministria e Bujqësisë. Duhet të përcaktohen masat e mëtejshme që do të merren për përmirësimin e racës së deles. Duhet të shqyrtohet edhe një herë problemi i rajonizimit të gjedhit. Ndoshta, për konditat e vendit tonë, përmirësimi i racës së gjedhit të vendit duhet të bëhet kryesisht me racën «Xhersej», e cila dallohet për prodhim të lartë qumështi dhe për përqindje të lartë yndyre, ndërsa racat e gjedhit me trup të madh të rriten kryesisht në fermat shtetërore dhe në kooperativat bujqësore në një masë të kufizuar.

3. — Mbi shtimin e numrit të bagëtisë për çdo 100 hektarë tokë

Ne duhet të luftojmë më me këmbëngulje për t'i shtuar krerët e bagëtive të imta, në radhë të parë në zonat malore, atje ku janë kullota natyrale dhe leshi kushton më lirë, ndërsa në zonën fushore duhet të zhvillojmë gjedhin e qumështit, derrat dhe shpendët.

Në këtë drejtim rezervat më të mëdha t'i gjejmë në shtimin e krerëve të lopëve për 100 hektarë tokë, si një kategori e tillë kafshësh që mund të përmirësojë në mënyrën më intensive nivelin e prodhimit të dy artikujve kryesorë të blegtorisë, të qumështit dhe të mishit. Vërehet tendenca e rritjes së numrit të lopëve gjatë vjetëve të fundit në krahasim me llojet e tjera të bagëtisë. Kundrejt

vitit 1957 në vitin 1961 numri i lopëve për 100 hektarë tokë bujqësore, si Republikë, është rritur nga 9,2 në 12 krerë. Nga rrethet që u kritikuan në Plenumin e nëntorit të vitit 1958, për numër të vogël lopësh për 100 hektarë tokë bujqësore ishte ai i Beratit. Ky rreth e ka rritur këtë numër nga 6,9 krerë në vitin 1957, në 10,5 krerë në vitin 1961, d.m.th. 52 për qind, kurse rrethi i Vlorës 77 për qind (nga 3,5 në 6,2). Shembulli i rrethit të Beratit, e veçanërisht i atij të Fierit i cili jo vetëm që e ngriti numrin e lopëve për 100 hektarë tokë bujqësore mbi mesataren e Republikës në vitin 1961 (13,9 krerë), por bëri një hap të madh përpara në ngritjen e prodhimit të lopëve nga 373 kg. në vitin 1957 në 913 kg. në vitin 1961 ose 245 për qind, tregon se në rrethet fushore të vendit tonë rezervat për shtimin e lopëve dhe të qumështit e të mishit nga sektori i gjedheve janë akoma të mëdha. Të gjitha rrethet e tjera që janë prapa duhet të arrijnë ose t'i afrohen nivelit të rretheve të tilla si Korça, Lushnja, Shkodra, Kruja dhe Durrësi.

Edhe numri i dosave për 100 hektarë tokë ara, sikurse u theksua, është rritur si Republikë nga 4,3 krerë në vitin 1957, në 7,4 krerë në vitin 1961, por po ta shikojmë më hollësisht këtë rritje do të vëmë re se ajo nuk është proporcionale, sepse rrethe të tilla me bujqësi relativisht ekstensive si Mirdita, Puka, Gjirokastra etj. kanë arritur respektivisht 31,5 krerë, 19,6 dhe 11,6 krerë dosë për 100 hektarë, kurse rrethe të tilla relativisht intensive, si Tirana, Berati, Korça etj. kanë respektivisht vetëm 4,9, 2,6 dhe 7,8 krerë dosë për 100 hektarë.

Për të shfrytëzuar më mirë konditat natyrale ekonomike të vendit tonë për shtimin e prodhimit të mishit edhe nga burime të tjera duhet të merren masa edhe për rritjen e pulave të detit, të patave e të rosave duke e kombinuar këtë me rritjen e peshkut, të zgjerohet më shumë rritja e lepurit të butë etj.

Duhet të përmirësohet dendësia e gjësë së gjallë për 100 hektarë tokë, si në kooperativat bujqësore edhe në ndërmarrjet shtetërore të bujqësisë. Në sektorin shtetëror të blegtorisë, ku megjithëse kemi një blegtori të zhvilluar, përsëri ka rezerva të shumta, si për rritjen e krerëve ashtu edhe për shtimin e prodhimit të në të gjitha lopët e bagëtisë.

Më shumë vëmendje duhet t'i kushtojmë këtej e tutje rritjes së numrit të kafshëve në sektorin kolektiv të kooperativave bujqësore.

Zhvillimi i të gjithë sektorëve të blegtorisë nuk do të thotë që në çdo kooperativë bujqësore të zhvillohen patjetër të gjitha llojet e gjësë së gjallë, pavarësisht nga kushtet konkrete natyrale dhe nga drejtimi ekonomik i tyre etj.

Në drejtim të madhësisë së fermave blegtorale paraqiten më mirë kooperativat bujqësore të rrethit të Lushnjës, ndërsa ato të rrethit të Elbasanit etj. kanë ferma shumë të vogla. Ka koopera-

tiva që kanë krijuar ferma të mëdha lopësh me 200—300 krerë, si p.sh. kooperativa e Zharëzës, e Cakranit, e Shijakut, e Krutjes së sipërme etj. Të dhënat tregojnë se atje ku përqëndrimi i bagëtive është më i madh edhe prodhimitaria është më e madhe dhe kostua e prodhimit më e ulët. Në NBSH-në e Maliqit, ku ka një përqëndrim më të madh derrash dhe ku rritja e derrit formon një nga degët më të rëndësishme të prodhimit, gjatë vitit 1961 është marrë mesatarisht 6,5 kv. mish nga çdo dosë, ose 80 për qind më shumë se në NBSH-në e Sukthit, ku ka një përqëndrim më të vogël derrash dhe kostua e mishit të derrit në Maliq është 116,6 lekë për kilogram ose 44 për qind më e ulët se në Sukth. Kjo duhet thënë edhe për kooperativat bujqësore. Në kooperativat e zmadhuara ekzistojnë akoma mjaft ferma blegtorale të ngritura mbi bazën e kooperativave dikur të veçanta, kështu që fermat në fakt janë akoma shumë të vogla. Në çdo sektor (ish-kooperativë e veçuar), kanë mbetur, ashtu si edhe më parë, pothuajse të gjitha llojet e bagëtisë. Gradualisht dhe sistematikisht fermat e vogla duhet të kthehen në ferma të mëdha blegtorale, në sektorë të kombinuar ose të specializuar sipas mundësive dhe burimeve të bazës ushqimore.

4. — Mbi shtimin e sasisë së prodhimeve blegtorale për 100 hektarë tokë

Shtimi i sasisë së prodhimeve blegtorale për çdo 100 hektarë tokë është treguesi kryesor i nivelit të intensifikimit të blegtorisë dhe sigurohet nga vënja në jetë e të gjitha detyrave që u përmenden më lart.

Në këtë drejtim, gjatë vitit 1961, në disa ekonomi dhe mesatarisht si Republikë, janë arritur këto rezultate:

Emërtimi	Prodhimi i mishit (kv/100 ha)		Prodhimi i qumështit (kv/100 ha)	
	1958	1961	1958	1961
Mesatarisht si Republikë	27,0	37,5	132,5	153
Rrethi i Durrësit	28,0	41,0	125,0	264
» i Fierit	32,0	38,0	146,0	178
NBSH-ja e Maliqit	52,3	86,8	110,3	280
EDE e Institutit të lartë shtetëror të bujqësisë (Kamëz)	40,7	41,0	595,6	643

Siç shihet, disa NBSH dhe rrethe të veçanta kanë arritur rezultate të kënaqshme, si p.sh., rrethi i Durrësit, NBSH-ja e Maliqit, ekonomia didaktike eksperimentale e Institutit të lartë shtetëror të bujqësisë etj. Këto rrethe dhe ekonomitë janë pikërisht ato që kanë numrin më të madh të krerëve për 100 hektarë tokë, që i kanë kafshët të racës ose të kryqëzuara dhe që i ushqejnë në mënyrë më intensive. E kundërta ndodh në rrethin e Vlorës, të Sarandës, të Elbasanit, të Krujës etj. dhe në NBSH-në e Vurgut.

Për të shtuar prodhimin e mishit në 100 hektarë tokë duhet të rriten në radhë të parë ato lloje kafshësh që shumëzohen shumë shpejt dhe shtojnë në peshë me më pak njësi ushqimore. Midis llojeve me rritje të shpejtë të zgjedhim ato kategori kafshësh që japin një shtesë më të madhe peshe brenda një kohe më të shkurtër dhe shtojnë mishin me më pak njësi ushqimore. Të tilla kategori janë derrkucat e moshës 7—8 muajshe, viçat deri në moshën 14—18 muajsh, si dhe lepujt 3—4 muajsh. Zgjatja e afatit të majmërisë në këto kategori kafshësh nuk sjell asgjë të dobishme veçse humbje të sasive të konsiderueshme të ushqimeve jo më për rritjen, por vetëm për ruajtjen e peshës së tyre.

Edhe për prodhimin e qumështit ekzistojnë mundësi që sasia e qumështit, e prodhuar për 100 hektarë tokë, të shtohet. Sidomos duhet të punohet në zonat fushore për shtimin e prodhimit të qumështit të lopëve në mënyrë që proporcioni midis sasisë së qumështit të prodhuar nga delet dhe nga dhitë nga njëra anë dhe sasisë së qumështit të prodhuar nga lopët, të ndryshojë në favor të sektorit të gjedhit, sepse lopa është kafsha që e prodhon qumështin në mënyrë intensive. Ajo harxhon për prodhimin e 1 litër qumështi dy herë më pak njësi ushqimore se delet.

Që të arrihen treguesit e vitit 1965 për të prodhuar mesatarisht si Republikë për çdo 100 hektarë tokë 256 kv. qumësht dhe 57 kv. mish ekzistojnë të gjitha mundësitë reale. Por duhen shfrytëzuar në maksimum të gjitha rezervat e përmendura më sipër për intensifikimin e blegtorisë.

Këto detyra që shtrohen për blegtorinë nuk kanë të bëjnë vetëm me blegtorinë e sektorit socialist të bujqësisë. Një pasuri e madhe blegtorale e vendit tonë është në duar të oborreve kooperativiste dhe të zonave malore të pakolektivizuara. Organet e Partisë dhe të pushtetit, sidomos Ministria e Bujqësisë dhe organet e saj, në asnjë mënyrë nuk duhet ta largojnë vëmendjen nga kjo pasuri, përkundrazi të tregojnë kujdes të madh për të. Duhet të punohet për përmirësimin e racës së kësaj blegtorie po me atë kujdes që punohet për blegtorinë kolektive; duhet siguruar çdo ndihmë për mbarështrimin e mirë të blegtorisë private dhe për luftimin e sëmundjeve e të mendohet për sigurimin e kullotave për këtë blegtori. Pasuria kullimore që ka shteti, si dhe mushat që ka çdo fshat të përdoren edhe për nevojat e kësaj blegtorie, e cila nuk duhet

lënë në mëshirë të fatit. Ministria e Bujqësisë ta studjojë sa më shpejt këtë problem dhe të paraqesë masat që duhen marrë për zhvillimin dhe rritjen e mirë të kësaj pasurie.

C. — MBI MASAT PËR ZHVILLIMIN E MËTEJSHËM TË FRUTI-VITIKULTURËS

Zhvillimi i mëtejshëm i fruti-vitikulturës është pjesë përbërëse e detyrës së madhe që shtrohet para nesh për intensifikimin e bujqësisë sonë. Duke e parë nga shumë anë çështjen del nevoja të marrim të gjitha masat për ta zhvilluar më tej fruti-vitikulturën, pse nevojat e popullit dhe të ekonomisë janë të mëdha dhe në të ardhshmen do të jenë edhe shumë më të mëdha.

Në zonat malore ku ndodhet rreth 50 për qind e popullsisë fshatare tokat për kultura arash janë shumë të kufizuara, ndërsa disponohen shumë krahë pune të lira gjatë gjithë vitit, si edhe sipërfaqe të mëdha tokash të pashfrytëzuara që mund dhe duhet të kthehen në toka të mbjella me pemë frutore dhe me vreshta.

Në bazë të verifikimit që u bë më 1961, në vendin tonë numëroreshin për çdo frymë të popullsisë 6,6 rrënjë pemë frutore, 3,5 rrënjë pjergulla, 1,7 rrënjë ullinj dhe për çdo 1 000 banorë, 6,2 ha. vreshta dhe 323 rrënjë agrume.

Shpërndarja e fruti-vitikulturës sipas sektorëve të ekonomisë bujqësore ose sipas rretheve nuk është e rregullt. Sektori socialist i ekonomisë bujqësore sidomos kooperativat bujqësore, që sot përfshijnë 86 për qind të tokës së fshatarësisë dhe 71,4 për qind të ekonomive bujqësore fshatare, kanë si pronë kolektive vetëm 47 për qind të pemëve frutore, 52 për qind të vreshtave ndërsa ullinj kanë 72 për qind dhe agrume 61,5 për qind. Në disa rrethe që kanë pak toka buke, por kushte shumë të mira për fruti-vitikulturë, krahë pune si dhe toka të vlefshme, në fakt fruti-vitikultura atje është mjaft prapa. Kështu p.sh., rrethi i Gramshit ka mesatarisht 9,7 rrënjë pemë frutore për çdo frymë, rrethi i Burrelit — 5,8, i Librazhdit — 6 dhe rrethi i Tepelenës — 8 rrënjë për çdo frymë. Ka dhe rrethe të tjera që kanë më pak rrënjë pemë frutore për frymë të popullsisë se mesatarja e të gjithë Republikës.

Zhvillimi i mëtejshëm i kulturës së ullirit dhe i fruti-vitikulturës bëhet i domosdoshëm po ta shohim edhe nga sasia e prodhimit vjetor për frymë që sigurohet sot. Në vitin 1961 u prodhuan për frymë të popullsisë mesatarisht si Republikë 40,7 kg. pemë frutore — 26,1 kg. rrush, — 19,3 kg. ullinj dhe 1,5 kg. agrume, sasi kjo që është jashtëzakonisht e paktë për plotësimin e normave të nevojave vjetore që duhet të konsumojë çdo frymë në Republikë.

Para nesh nuk shtrohet vetëm çështja e ngritjes së konsumit vjetor të frutave për frymë të kësaj popullsie që kemi sot, por duhet të mendojmë që në të ardhshmen do të shtohet edhe më shumë popullsia dhe kërkesat e saja do të bëhen më të mëdha. Nga ana tjetër, qysh sot industria ushqimore dhe eksporti kanë kërkesa të mëdha dhe në të ardhshmen këto kërkesa do të shtohen shumë. Duke e parë çështjen nga të gjitha anët del qartë sa urgjente shtrohet çështja qoftë për ullirin, qoftë për frutikulturën ashtu edhe për vitikulturën që jo vetëm të realizohet plani i tretë pesëvjeçar, por të hidhen bazat për të ecur me ritme të shpejta në të ardhshmen. Ne duhet të synojmë që në pesëvjeçarët e ardhshëm të shtohet shumë numri i pemëve frutore, i ullinjve, i agrumeve, i vreshtave etj. dhe, në mënyrë të veçantë, të shtohet prodhimi i frutave, i ullinjve, i rrushit për frymë, më shumë se një herë në krahasim me nivelin e parashikuar për vitin 1965.

Nuk është e thjeshtë puna për zhvillimin e shpejtë të kësaj dege të ekonomisë bujqësore; duhet një kohë e gjatë për të marrë frutat e pemëve të mbjella. Çështja e proporcioneve të llojeve të ndryshme të pemëve frutore, që duhen mbjellë në të ardhshmen ka rëndësi të madhe. Neve na duhen shumë lloje pemësh për të kënaqur kërkesat e popullit dhe nevojat e ekonomisë. Kërkesat e popullit janë për lloje të ndryshme pemësh frutore dhe për gjithë muajt e vitit.

Çfarë probleme na dalin përpara për zhvillimin e mëtejshëm të ullirit dhe të fruti-vitikulturës, në mënyrë të harmonizuar me degët e tjera të ekonomisë bujqësore, ashtu si kërkohet në një bujqësi intensive?

Së pari, duke u mbështetur në kushtet klimatike të vendit, në mundësinë dhe në kushtet e përshtatshme që ka çdo rreth e çdo zonë, me qëllim që të shfrytëzohen gjatë gjithë vitit krahët e punës si në zonat fushore, ashtu edhe në ato kodrinore e malore, duhet të merren masa për të kthyer tokat që nuk kanë perspektivë për kulturat bujqësore të arave në toka të mbjella me pemë, vreshta, ullinj, agrume, me pjergulla etj. Kjo është një nga detyrat kryesore që shtroi Kongresi IV i Partisë për planin, e tretë pesëvjeçar. Këtë pesëvjeçar ne duhet të mbjellim me dru frutorë 31 000 hektarë. Në këto toka do të mbillen 8,5 milion rrënjë pemë, 3,7 milion rrënjë ullinj, 1 milion rrënjë agrume, 7,7 milion rrënjë pjergulla etj.

Së dyti, të merren masa që të rritet prodhueshmëria e ullirit, e pemëve frutore dhe e vreshtave ekzistuese.

Këto dy çështje me shumë rëndësi për të ardhshmen e frutikulturës dhe të vitikulturës nuk mund t'i lënë vendin njëra-tjetrës. Aq sa duhet të tregohet kujdes për shtimin çdo vit të prodhimit të frutave dhe të ullinjve po aq, në mos më shumë, kujdes

duhet të tregohet për realizimin e planit të mbjelljeve të reja, për zënjën, rritjen dhe zhvillimin e shpejtë të tyre.

Për zgjerimin e sipërfaqeve të mbjella me dru frutorë, si gjatë këtij pesëvjeçari ashtu edhe për më vonë, duhet të nxirren mësim nga gabimet e vërtetuara në të kaluarën dhe të studjohet më në kompleks problemi i zhvillimit të ullirit, të frutikulturës dhe të vreshtave.

Çfarë çështjesh duhet të kemi parasysh për zhvillimin e ullinjve dhe të fruti-vitikulturës?

a) *Drejtimitin e ekonomisë bujqësore* që kanë rrethet ose zonat duke u nisur që këtej në bazë të kushteve klimatike tokësore dhe të mundësive të shfrytëzimit të krahëve të punës gjatë gjithë vitit.

b) *Llojet e pemëve dhe të rrushit* që duhet të zhvillohen në çdo zonë ose rreth, në mënyrë që llojet e pemëve e të hardhive jo vetëm të mbillen kudo në mënyrë të studjuar e në kriter të shëndoshë ekonomik, por në çdo zonë të mbillen ato lloje që u përshtaten më mirë kushteve konkrete, që rriten më mirë dhe më shpejt dhe që janë më të nevojshme për ekonominë.

c) *Të rregullohen proporcionet* për çdo lloj pemë frutore, si në shkallë nacionale ashtu edhe në shkallë rrethi, me qëllim që të ketë fruta normalisht gjatë gjithë vitit dhe në sasi të mjaftueshme.

Çështja themelore për shtimin e të gjitha llojeve të pemëve frutore, për zhvillimin e mëtejshëm të frutikulturës, është prodhimi i materialit mbjellës në fidanishte. Vetëm materiali i prodhuar në fidanishte do të sigurojë zhvillimin e shpejtë, të kontrolluar e me vlerë të pemëve frutore në vendin tonë.

Me qëllim që të sigurohet baza materiale për zhvillimin e frutikulturës në pesëvjeçarët e ardhshëm, d.m.th., që në të ardhshmen shtimi i frutikulturës të bëhet vetëm në fidane, është e domosdoshme që brenda vjetëve 1963-1965 të zgjerohen fidanishtet shtetërore, të shtohet numri i tyre dhe të ngrihen fidanishte nga vetë kooperativat bujqësore që kanë si drejtim kryesor frutikulturën. Në fidanishtet ekzistuese dhe në ato që do të ngrihen gjatë këtyre 3 vjetëve duhet të rishikohet struktura e fidaneve frutore, e agrumeve, e hardhive ose e ullinjve që do të pregatiten në to. Për pemët frutore, sipas kushteve të çdo zone ose rrethi dhe sipas nevojave që ka gjithë bujqësia duhet të mbillen sa më shumë specie të ndryshme, me qëllim që të normalizohet struktura e frutikulturës dhe të arrihet që të ketë fruta të freskëta gjatë gjithë vitit, ndërsa për agrumet duhet të përmirësohet proporcioni jo i rregullt që është sot midis portokalleve, mandarinave dhe limonave në favor të limonit.

Përsa u përket vreshtave duhet të ecet drejt eliminimit të llojeve të rrushit që nuk kanë vlerë ushqimore as industriale, që

kanë prodhueshmëri të ulët dhe të zëvendësohet me lloje më të mira për konsum të brendshëm dhe për eksport në formë të freskët ose të përpunuar. Duhet t'i kushtohet kujdes përhapjes së rrushit me pjekje të hershme dhe të vonshme për të plotësuar më së miri nevojat e popullit.

Një rëndësi jashtëzakonisht të madhe për vendin tonë ka ulliri, i cili siguron yndyrën, një nga prodhimet ushqimore të dorës së parë për popullin tonë. Duke u nisur nga kjo dhe nga mundësitë e mëdha që kemi Partia dhe gjithë organet shtetërore duhet të kujdesen për shtimin në maksimum të ullinjve kudo që është e mundur. Në radhë të parë duhet të plotësohen boshllëqet e mëdha që vihen re kudo nëpër ullishta dhe të krijohen bloqe të reja në kodrat e zonës së ullirit, ku ka sipërfaqe të gjera të zëna nga pyje të degraduara, nga musha e nga kullota pak produktive apo krejt inproduktive. Krahas kësaj duhet bërë një punë e organizuar mirë për kryerjen e shërbimeve kulturore, të cilat në shumicën e rasteve, lihen pas dore dhe, si pasojë, rendimentet e ullirit kanë qenë të ulëta e jo të qëndrueshme.

Kujdes i posaçëm duhet të tregohet për prodhimin e fidaneve të ullirit. Duhet të zgjerohen fidanishtet e ullinjve. Këto fidanishte duhet të jenë të veçanta në mënyrë që e gjithë vëmendja e specialistëve dhe e punonjësve që punojnë në to të përqëndrohet te prodhimi i fidaneve. Problemi i ullirit është me rëndësi jetike për të ardhshmen e popullit tonë. Në vitin 1961, u sigurua nga ulliri 26,4 për qind e yndyrnave për popullin. Në të ardhshmen kërkesat për yndyrna do të jenë më të mëdha, ndërsa baza e sigurimit të yndyrnave do të jetë ulliri. Nga problemet e mëdha që shtrohen për zhvillimin e frutikulturës më i madhi është zhvillimi i kulturës së ullirit. Shqipëria, megjithëse sot ka 2 806 000 rrënjë ullinj, në krahasim me vendet që kanë ullinj qëndron akoma prapa, qoftë për sasinë e rrënjëve për frymë të popullsisë, qoftë për prodhimin për frymë. Ne duhet të marrim masa që të realizohet patjetër detyra që shtron pesëvjeçari i tretë, si për shtimin e numrit të ullinjve, ashtu edhe për rritjen e prodhueshmërisë së ullinjve ekzistues. Puna që është bërë gjatë vjetëve 1961 dhe 1962 për mbjelljen e pemëve frutore, të ullinjve dhe të vreshtave ka qenë e kënaqshme, por ajo duhet të përmirësohet edhe më tepër gjatë vjetëve të ardhshëm duke përqëndruar kujdesin në krijimin e plantacioneve të gjera të pemëve frutore, ullinjve, agrumeve dhe vreshtave, si në sektorin shtetëror të bujqësisë, ashtu edhe në sektorin kooperativist.

Me qëllim që të merren masa me kohë për zhvillimin me perspektivë të frutikulturës, ullinjve, vreshtave dhe agrumeve, të ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe Komisioni i Planit të Shtetit ta studjojnë me kujdes këtë problem dhe t'ja paraqesin për shqyrtim qeverisë dhe Byrosë Politike.

Sikurse u tha më lart, ne duhet të marrim masa për rritjen e prodhueshmërisë, sidomos të ullinjve, të pemëve frutore dhe të vreshtave ekzistuese. Kjo është detyra aktuale që parashtroi Kongresi IV i Partisë në lidhje me frutikulturën.

Ka akoma mendime te fshatarët dhe te kooperativat bujqësore se ullinjët, pemët frutore dhe vreshtat nuk kanë nevojë për shumë shërbime, se periodiciteti në prodhime është një fenomen i natyrshëm që nuk ka të bëjë me shërbimet e përvitshme. Pikërisht për këtë arsye, ullinjve dhe pemëve frutore shërbimet u bëhen shumë të kufizuara dhe në mjaft raste nuk u bëhen fare. Insektet dhe sëmundjet dëmtojnë jo vetëm prodhimin, por edhe vetë bimët. (Nga përlllogaritjet e bëra prej specialistëve del që 25—30 për qind e prodhimit humbet vetëm për mungesë të spërkatjeve). Punimi i tokës që nuk kërkon ndonjë teknikë të veçantë, bëhet shumë i kufizuar, ndërsa prashitjet pothuajse nuk bëhen fare. Plehërimi i ullinjve, i pemëve dhe i vreshtave konsiderohet si një gjë e tepërt dhe në fakt ky përdoret vetëm kur tepron nga kulturat e tjera. Ullinjët, pemët frutore dhe vreshtat e rinj, duke u bërë në rregull shërbimet kulturore, do të hyjnë në prodhim më shpejt, do t'i shpërblejnë investimet e bëra dhe do t'i sjellin të ardhura ekonomisë.

Nga analiza që është bërë del se 73 për qind e shërbimeve kulturore për ullinjët, pemët frutore dhe për vreshtat kryhen në stinën e dimrit (në tremujorin e parë dhe të katërt), 23 për qind në tremujorin e dytë dhe vetëm 5 për qind në tremujorin e tretë. Pra, kryerja e shërbimeve për ullinjët ashtu edhe për pemët frutore dhe për vreshtat, jo vetëm që nuk bëhet pengesë për aktivitetet e tjera bujqësore, por normalizon grafikun e forcave të punës duke i aktivizuar këto për të bërë ditë-punë më shumë.

Duke u bazuar në mundësitë që ekzistojnë në çdo kooperativë bujqësore, në çdo zonë ose rreth, përse i përket përdorimit të krahut të punës në bujqësi gjatë gjithë vitit, të merren masa për shfrytëzimin e këtyre forcave sa më mirë, në mënyrë që një pjesë e tyre të angazhohet në shërbimet e rregullta të pemëve, të ullinjve dhe të vreshtave, që sot janë në prodhim. Përveç detyrave të mësipërme është e nevojshme të merren edhe këto masa:

a) Në vitin 1963 të kryhen në masën 75 për qind dhe nga viti 1964 e tutje në masën 100 për qind punimi i tokës dhe krasitjet e ullinjve, të pemëve frutore, vreshtave dhe pjergullave, ndërsa spërkatjet të kryhen sipas nevojës. Ekonomitë bujqësore duhet të luftojnë që, si orientim, për çdo vit të destinonjë për këto kultura një sasi të mirë të plehut organik. Punimet, krasitja, plehërimi dhe prashitjet të bëhen në kohë dhe me cilësi të mirë, sipas rregullave agroteknike.

b) Krasitja dhe spërkatja dimërore në të ardhshmen të kryhen në formë aksioni duke ngritur brigada të posaçme të udhë-

hequra nga mjeshtria prodhimi dhe nga specialistë. Ministria e Bujqësisë, për një kohë të caktuar, të dërgojë çdo vit në ndihmë të kooperativave bujqësore studentët, e vitit të tretë dhe të katërt të Institutit të lartë shtetëror të bujqësisë si dhe nxënësit e klasave të treta dhe të katërta të teknikumeve bujqësore së bashku me pedagogët përkatës.

c) Për të rritur interesin e anëtarëve të kooperativave dhe të kuadrove që merren me sektorin e rritjes së ullinjve dhe të fruti-vitikulturës të rishikohet forma e shpërblimit të punës që të bëhet sipas ditëve të punës, por edhe në bazë të prodhimit dhe të të ardhurave që ka sjellë puna e kryer, ashtu sikurse e përcakton vendimi Nr. 265 i Këshillit të Ministrave¹.

ç) Të gjitha kooperativat bujqësore të marrin masa që mbjelljet e pemëve frutore, të ullinjve dhe të vreshtave të bëhen kryesisht në bloqe. Të bëhet rregull që në të gjitha vreshtat shtetërore dhe kooperativiste të mbillen ullinj dhe pemë frutore në distanca të caktuara që të ruhet gjithmonë shfrytëzimi i tokës për vreshta.

d) T'i vihet kujdes shtimit të frutikulturës si në oborret kooperativiste, ashtu edhe në ekonomitë bujqësore individuale dhe sidomos në fshatrat e pakolektivizuara.

dh) Për të përballuar blerjen e fidaneve, veglave të punës dhe për shpyllëzime e qilizëm të tokave që do të mbillen në formë bloqesh, me pemë frutore e vreshta, si edhe për blerjen e plehrave kimike dhe kimikateve, të shtohet ndihma e shtetit në formë krediti agrar për ato kooperativa që nuk janë në gjendje t'i përballojnë investimet dhe shpenzimet për zhvillimin e ullinjve, frutikulturës dhe vitikulturës.

e) Instituti i lartë shtetëror i bujqësisë të përmirësojë punën shkencore dhe të nxjerrë konkluzione lidhur me përmirësimin e masave agroteknike, si shërbimet kulturore, distancat, nënshartetat, varietetet etj.

ë) Komitetet e Partisë, organizatat bazë, organizatat e rinisë dhe organet e pushtetit në qendër e në bazë të marrin masa për të përmirësuar punën në drejtim të emulacionit socialist dhe të përhapjes së eksperiencës së më të mirëve duke organizuar konsulta, seminare, konferenca etj.

Me punën e kujdesshme dhe këmbëngulëse të organizatave të Partisë, të organeve të pushtetit, të specialistëve dhe të gjithë punonjësve të bujqësisë për zbatimin e këtyre detyrave, nuk do

¹ Është fjala për vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 265, datë 16 korrik 1958 «Mbi organizimin dhe shpërblimin e punës në kooperativat bujqësore».

të jetë e largët koha kur kodrat dhe prozhet, tokat e papërshtatshme për kultura arash në vendin tonë do të kthehen në pemëtores, vreshta, ullishte dhe agrumishte, kur populli ynë do të furnizohet vazhdimisht, gjatë gjithë vitit, me fruta të freskëta dhe të shumëllojshme, kur frutat do të zënë një vend me rëndësi në eksportin tonë.

II. — MOBILIZIMI I TË GJITHA REZERVAVE TË BRENDSHME ËSHTË KUSHT I DOMOSDOSHËM PËR SIGURIMIN E RITJES SË VAZHDUESHME TË PRODHIMIT BUJQËSOR DHE PËR INTENSIFIKIMIN E BUJQËSISË

1. — Ngritja e ekonomive bujqësore të prapambetura në nivelin e ekonomive bujqësore të përparuara përbën rezervën kryesore për shtimin e shpejtë të prodhimit bujqësor dhe për intensifikimin e bujqësisë

Me gjithë rezultatet e arritura në shtimin e prodhimeve bujqësore e blegtorale, eksperiencia e deritanishme tregon se nuk është punuar mirë kudo për shfrytëzimin e plotë të kushteve që kanë ekonomitë e ndryshme bujqësore për rritjen në një masë më të madhe të prodhimeve. Me shfrytëzimin e rezervave të brendshme dhe me përhapjen e përgjithësimin e eksperiencës së përparuar në prodhim jemi akoma shumë prapa. Ka të meta dhe boshllëqe në punën e Partisë dhe të organeve shtetërore dhe ekonomike. Kjo shihet qartë nga diferencat e dukshme në rezultatet ekonomike, që ekzistojnë midis rretheve të ndryshme, ndërmarrjeve bujqësore shtetërore, kooperativave bujqësore, brigadave, skuadrave e fermave blegtorale të ndryshme, të cilat kanë kushte prodhimi afërsisht të barabarta.

Ja se çfarë tregojnë rezultatet e vitit 1961 për disa rrethe dhe ekonomi të ndryshme bujqësore: rrethi i Fierit që ka kondita e kushte të barabarta me rrethin e Lushnjes dhe me atë të Durrësit, në vitin 1961, mori për çdo 100 hektarë tokë bujqësore 457 000 lekë më shumë se Lushnja (pa llogaritur vleftën e ullirit) dhe 297 000 lekë më shumë se Durrësi; rrethi i Përmetit mori më shumë se rrethi i Tepelenës 709 000 lekë dhe nga i Skraparit 546 000 lekë për çdo 100 hektarë tokë bujqësore; rrethi i Tiranës mori më shumë se rrethi i Krujës 360 000 lekë për çdo 100 hektarë tokë bujqësore etj. Këto ndryshime midis rretheve krahasuese tregojnë se në rrethin e Fierit, të Përmetit e të Tiranës është punuar më mirë për shfrytëzimin e rezervave të brendshme, për shtimin e prodhimit, për zbatimin e kompleksit të masave agroteknike dhe zoteknike, për shtimin e numrit të gjësë së gjallë

dhe për rritjen e prodhimit të saj, për rritjen dhe forcimin e ekonomisë kooperativiste si dhe për mobilizimin e kooperativistëve për kryerjen në kohë të detyrave të ndryshme.

Ndryshime në prodhim ka edhe ndërmjet kooperativave të një rrethi, si dhe brenda vetë çdo ekonomie. Ja se çfarë tregojnë rezultatet e disa kooperativave në rrethe të ndryshme, të cilat kanë pothuajse kushte të barabarta për vitin 1961.

Rrethi	Kooperativa bujqësore	Të ardhura të përgjithshme për 100 ha. tokë bujqësore (në mijë lekë)	Diferenca + (në mijë lekë)
Lushnjë	Këmishtaj	5362	2020
	Bishqethmi	3342	—
Fier	«Vilhelm Pik»	5989	2174
	Pojan	3815	—
Gjirokastër	Llovinë	5734	2790
	Pepel	2944	—
Korçë	Rrëmbec	5853	820
	Tërovë	5033	—

Këto ndryshime të mëdha në të ardhurat e kanë burimin në mosshfrytëzimin e drejtë të të gjitha mundësive që ekzistojnë në kooperativën e Bishqethmit, Pojanit, Pepelit e Tërovës për shtimin e prodhimit. Kështu p.sh., si rezultat i një zbatimi më të mirë të kodit agroteknik dhe i kujdesit më të madh që tregohet për blegtorinë dhe për rritjen e prodhimit të saj, kooperativa e Këmishtajt ka marrë më shumë se ajo e Bishqethmit për çdo 100 hektarë tokë 194 kv. drithëra buke, 39 kv. qumësht, 17 kv. mish. Si përfundim ajo ka ndarë për ditë-pune 90 lekë më shumë se ajo e Bishqethmit. Kooperativa bujqësore «Vilhelm Pik» në Fier ka realizuar më shumë se ajo e Pojanit 85 kv. drithëra, 112 kv. qumësht, 12 kv. mish, ka 5 lopë dhe 48 dhen e dhi më shumë për 100 hektarë tokë bujqësore dhe ka ndarë 46 lekë më shumë për ditë-pune. Ndërsa kooperativa bujqësore e Llovinës ka realizuar për 100 hektarë 2 790 000 lekë prodhim më shumë se ajo e Pepelit, sepse për çdo 100 hektarë tokë ka marrë 448 kv. drithëra buke, 83 kv. qumësht dhe ka 6 lopë e 159 dhen e dhi më shumë për 100 hektarë dhe 555 krerë shpendë më shumë për 100 hektarë drithëra.

... Shembuj të shumtë ka edhe në blegtori. Kështu p.sh.; ndërsa NBSH-ja e Beratit nga lopët e racës «E kuqja e stepës» dhe të kryqëzuara në 1961 ka marrë 2 565 litra qumësht për çdo

lopë foragjere, NBSH-ja e Elbasanit nga lopët «Buraja Latviskaja», të cilat janë të një race me prodhimi më të lartë qumështi, ka marrë vetëm 1 905 litra qumësht për çdo lopë foragjere dhe NBSH-ja e Lezhës mori 2 239 litra qumësht. Rezultatet e mira të NBSH-së së Beratit shpjegohen me kujdesin për një ushqim dhe trajtim më të mirë të lopëve, me organizimin e ndërzimeve si dhe me zbatimin më të mirë të masave zooveterinare. Në NBSH-në e Beratit lopëve, gjatë gjithë vitit, u është siguruar ushqim i mirë, pa ndërprerje, ndërsa në NBSH-të e Elbasanit e të Lezhës, në periudha të caktuara, gjatë vitit lopët kanë vuajtur për ushqim, janë dobësuar dhe e kanë ulur prodhimtarinë e qumështit.

Siç shihet këto diferenca të mëdha në prodhim tregojnë se sa mundësi ka për shtimin e prodhimit bujqësor. Këtu duhet të përqëndrohet vëmendja dhe kujdesi i Partisë dhe i organeve të bujqësisë; ekonomitë bujqësore që janë prapa të mësojnë nga eksperiencia e ekonomive të përparuara. Të luftohet me këmbëngulje që prodhimi bujqësor i çdo kooperative ose ferme shtetërore të ngrihet në nivelin e ekonomive bujqësore të përparuara.

Për këtë arsye, Ministria e Bujqësisë dhe Instituti i lartë shtetëror i bujqësisë, të gjitha organet ekonomike, shtetërore dhe të Partisë që merren me bujqësinë ta organizojnë më mirë studimin e rezultateve më të mëdha të arritura nga ekonomitë bujqësore, brigadat, skuadrat e nga fermat blegtorale në prodhimet bujqësore e blegtorale dhe të përgjithësojnë kudo eksperiencën e përparuar duke përdorur format më të shpejta e më frutdhënëse.

Kooperativat bujqësore, sikurse kanë filluar të veprojnë një pjesë e tyre, duhet të praktikojnë më gjerë dërgimin e kooperativistëve në ndërmarrjet bujqësore për t'u specializuar në punë të ndryshme bujqësore e blegtorale dhe për të përfituar nga eksperiencia e mirë e tyre. Ndërmarrjet bujqësore shtetërore duhet të kuptojnë më drejt dhe të punojnë më mirë për të përgjithësuar eksperiencën e përparuar midis tyre dhe t'i ndihmojnë më shumë kooperativat bujqësore. Ato duhet të bëhen, ashtu si ka porositur Partia, vatra të përhapjes së njohurive agrozooteknike, të eksperiencës së përparuar dhe të metodave të reja.

Çështja e përhapjes së eksperiencës së përparuar është një problem i madh, me të cilin duhet të merren më seriozisht të gjitha organet e Partisë e të pushtetit dhe të aktivizohen gjallërisht të gjithë specialistët dhe kuadrot e bujqësisë si dhe vatrat e shtëpitë e kulturës të NBSH-ve, të kooperativave bujqësore dhe të SMT-ve.

Gjithashtu shtypi, radioja dhe kinostudjoja të merren më shumë me përhapjen e eksperiencës së përparuar të ekonomive bujqësore dhe Ministria e Bujqësisë të marrë masa bashkë me Institutin e lartë shtetëror të bujqësisë për botimin e më shumë broshurave, në të cilat të përgjithësohet eksperiencia e përparuar në bujqësi, blegtori, frutikulturë etj.

2. — Shtimi i pjesëmarrjes në punë dhe përdorimi sa më racional dhe gjatë gjithë vitit i forcave të punës, është një rezervë tjetër e me rëndësi që duhet shfrytëzuar më mirë për intensifikimin e bujqësisë.

Rritja e mëtejshme rendimentit të kulturave bujqësore dhe e prodhimeve blegtorale kërkon patjetër një pjesëmarrje më të gjerë të anëtarëve të kooperativave bujqësore në punën e përbashkët, kërkon një mobilizim më të madh në punë të gjithë punonjësve të degëve të ndryshme të bujqësisë dhe një disiplinë të fortë në prodhim, për të kryer në kohë dhe me cilësi të lartë punimin e tokës dhe shërbimet kulturore të bimëve. Kjo kërkon që organet e Partisë dhe të pushtetit, në rrethe e në bazë, ta konsiderojnë problemin e përdorimit racional dhe gjatë gjithë vitit të fuqisë punëtore si kusht kryesor për realizimin e detyrave që shtron Partia për intensifikimin e mëtejshëm të bujqësisë, *sepse puna është burimi i të gjitha vlerave materiale dhe sepse vetëm me punë mund të sigurohet rritja e prodhimeve dhe të përmirësohen kushtet e jetesës së masave punonjëse.*

Me gjithë rezultatet e arritura në këtë drejtim, pjesëmarrja në punë akoma është relativisht e ulët. Kështu, gjatë vitit 1961, çdo kooperativist i aftë për punë realizoi mesatarisht 229 ditë-pune, ndërsa ka rrethe që janë larg kësaj mesatareje. . .

Mesatarja e ditëve të punës është akoma e ulët për shkak se nuk marrin pjesë në punë të gjitha forcat e afta për punë, nuk realizohet minimumi i ditëve të punës nga një numër i konsideruar i anëtarëve dhe nuk punohet kudo dhe në mënyrë të organizuar për të siguruar front pune në çdo periudhë të vitit. . .

Në mjaft rrethe, krahas të metave të evidentimit të rregullt të krahëve të punës dhe pjesëmarrjes së tyre në punë, dobësi ka edhe në lidhje me realizimin e minimumit të ditëve të punës. Si Republikë në vitin 1961, 40,1 për qind e krahëve të punës, shumica prej të cilëve janë gra, nuk e kanë realizuar minimumin e ditëve të punës... Rezervë të madhe për shtimin e pjesëmarrjes në punë ka sidomos te gratë, të cilat në mjaft rrethe bëjnë akoma pak ditë-pune, nuk marrin pjesë rregullisht në punë dhe nuk realizojnë minimumin e ditëve të punës. Në këtë drejtim, në mjaft raste, ka influencuar për keq edhe përcaktimi jo i saktë i kuptimit të minimumit të ditëve të punës dhe të lëvizjes së «300-ditëshit» dhe kjo ka çuar deri aty sa disa kooperativa bujqësore kanë caktuar si minimum të detyrueshëm 300 ditë-pune. Kjo bën që të mos diferencohet lëvizja e përparuar nga minimumi i ditëve të punës dhe, meqenëse një minimum i tillë nuk realizohet, në fakt ulet edhe vetë vlera e lëvizjes së «300-ditëshit». Bile disa, për të realizuar «300-ditëshin», ulin normat e punës duke gënjyer kë-

shtu veten e duke dëmtuar vetë punën, lëvizjen e «300-ditëshit».

Po ta llogarisim në shkallë Republike mospjesëmarrjen në punë dhe mosplotësimin e minimumit të ditëve të punës, vetëm për vitin 1961, kemi një humbje prej 13 000 000 ditë-pune.

Numri i ditëve të punës të realizuara mesatarisht nga çdo kooperativist i aftë për punë është akoma i ulët, jo vetëm si Republikë, por edhe duke i krahasuar rrethet e ndryshme me njëri-tjetrin. Kjo ndodh përveç të tjerave edhe për faktin se nuk tregohet kujdes i njëjtë dhe nuk është parë si një çështje me rëndësi sigurimi i vazhdueshëm i frontit të punës në çdo periudhë të vitit. Kështu p.sh. ndërsa në rrethin e Fierit gjatë dy vjetëve të fundit çdo kooperativist i aftë për punë ka plotësuar 249 ditë-pune, në atë të Lushnjës dhe të Durrësit përkatësisht 13 dhe 52 ditë-pune më pak. Në rrethin e Sarandës çdo kooperativist ka realizuar 253 ditë-pune, ndërsa në atë të Beratit 20 dhe në të Vlorës 40 ditë-pune më pak. Në rrethin e Tropojës çdo kooperativist i aftë për punë ka realizuar 194 ditë-pune, ndërsa në rrethin e Burrelit 20, të Peshkopisë 35, të Rrëshenit 48 dhe në rrethin e Kukësit 50 ditë-pune më pak se Tropoja. Në rrethin e Përmetit gjatë dy vjetëve të fundit, çdo kooperativist i aftë për punë ka realizuar 241 ditë-pune, ndërsa në atë të Skraparit 34, në të Gramshit 43, në të Librazhdit 68 ditë-pune më pak se Përmeti etj. Këta shembuj tregojnë më së miri se në fshat ka shumë forca pune që nuk përdoren gjatë gjithë vitit në bujqësi. Është e domosdoshme që çdo ekonomi kooperativiste të marrë masa për zbatimin e statutit nga të gjithë anëtarët për të marrë pjesë aktive në punët e kooperativës gjatë gjithë vitit, për të zgjeruar aktivitetin ekonomik duke krijuar front pune sikurse janë hapja e tokave të reja, punimi i tokës qilizme, bërja e taracave dhe sistemimi i tokave, kryerja e të gjitha shërbimeve agroteknike ndaj pemëve të ndryshme frutore, kullimi i tokave, zgjerimi i sipërfaqes së ujtitshme me anën e kanaleve etj., punë këto që mund të bëhen në periudhën e dimrit ose kur vëllimi i punës në shumë rrethe është relativisht më i vogël.

Në zonat ku ka më shumë krahë pune si në Korçë, në Peshkopi etj. dhe në përgjithësi në zonat kodrinore e malore, një kujdes i veçantë duhet të tregohet për mbjelljen e më shumë kulturave industriale siç është duhani, ose i kulturave prashitëse, si patatja, qepa, hudhra, perimet etj., që kërkojnë punë shumë dhe sjellin të ardhura të mira, si dhe të organizojnë aktivitete ndihmëse, me qëllim që të sigurohet punë e vazhdueshme për kooperativistët dhe të realizohen më shumë të ardhura.

Për realizimin me sukses të këtyre detyrave është e domosdoshme që të mbahen mirë në bazë të regjistrimit të gjitha forcat e afta për punë dhe të përdoren drejt ato. Minimumi i ditëve të punës për burrat e gratë të caktohet në bazë të kushteve konkre-

te të çdo kooperative bujqësore, si për ditët e punës, për çdo muaj. Organizatat e Partisë dhe kryesitë e kooperativave bujqësore të analizojnë herë pas here pjesëmarrjen ritmike të anëtarëve në punë dhe të bëjnë një punë të madhe sqaruese, jo vetëm për të rritur pjesëmarrjen, por edhe për të forcuar disiplinën në punë. Të krijojnë kushte më të mira për një pjesëmarrje sa më të gjerë të grave në punë, duke shtuar numrin e kopshteve e çerdheve për fëmijë, të furrave të bukës, duke caktuar fronte pune të përshtatshme afër shtëpive për gratë shtatzana dhe me shumë fëmijë etj. Të organizohet më mirë puna e emulacionit socialist për zhvillimin e mëtejshëm të lëvizjes së «300-ditëshit», por jo duke ulur normat. Të përhapet sa më gjerë lëvizja për të fituar titullin e skuadrave dhe brigadave të punës socialiste, lëvizja për të bërë 1 dynym qilizmë me krahë për çdo anëtar të kooperativës etj. Të luftohen tendencat që komunistët të punojnë në sektorë pune në ditë-pune fikse etj.

Organizatat e Partisë duhet të luftojnë për përmirësimin e punës me norma dhe të zbatojnë norma sa më të drejta e të studjuara mirë... Për këtë qëllim duhet të ngrihen pranë rretheve dhe kooperativave bujqësore komisione të veçanta që të studjojnë herë pas here normat dhe Ministria e Bujqësisë gjatë vitit 1962 të studjojë dhe të përcaktojë për rrethet normat orientuese të bazuara në eksperiencën e realizimit të normave gjatë dy vjetëve të mëparshëm.

3. — Mbi shfrytëzimin racional të mjeteve dhe veglave të punës

Gjatë vjetëve të fundit janë shtuar shumë mjetet e mekanizuara në bujqësi. Ato përbëjnë 72 për qind të të gjithë fuqisë tërheqëse. Deri në 30 korrik të këtij viti NBSH-të dhe SMT-të kishin 5 860 traktorë me 15 kuaj-fuqi që i takon 2,05 traktorë me 15 kuaj-fuqi për çdo 100 hektarë tokë që mund të mekanizohet. Në zonën e SMT-ve, çdo 100 hektarëve tokë të mundshme për t'u mekanizuar i takon 1,6 traktorë me 15 kuaj-fuqi, ndërsa në NBSH-të 2,3 traktorë me 15 kuaj-fuqi.

Krahas rritjes së fuqisë motorike është përmirësuar puna edhe në drejtim të shfrytëzimit më të mirë të traktorëve e të maqinerive bujqësore. Në vitin 1961 plani në unitet hamullor u realizua nga SMT-të 106 për qind dhe nga NBSH-të 115 për qind. Përmirësime janë bërë edhe në realizimin e planit sipas zërave të punimeve si dhe në shfrytëzimin e tipave të ndryshëm të traktorëve e të maqinave bujqësore.

Por a është shfrytëzuar mekanika bujqësore ashtu si ka po-

rositur vazhdimisht Partia? Fakti që në vitin 1961 nuk realizuan planin 5 nga të 25 SMT-të që kemi gjithsejt, fakti që mekanika bujqësore e SMT-ve dhe e NBSH-ve nuk e realizoi planin në disa punime të rëndësishme siç janë prashitjet, korrjet, silazhimet etj., si edhe fakti që mjaft tipa traktorësh (4 tipa në SMT dhe 8 tipa në NBSH) nuk realizuan ngarkesën e planifikuar tregon se në këtë drejtim puna është e pakënaqshme.

Keq paraqitet gjendja e shfrytëzimit racional të traktorëve po të bëjmë krahasime ndërmjet SMT-ve. Kështu çdo traktor S-80-100 në SMT-në e Myzeqesë realizoi 1 730 hektarë më pak se në atë të Beratit, në SMT-në e Kukësit 1 020 hektarë më pak se në atë të Peshkopisë, në SMT-në e Kavajës traktorët Dt-54 bënë secili 1 452 hektarë, ndërsa në atë të Delvinës vetëm 825 hektarë unitet hamullor.

Nga kontrolli që është bërë për shfrytëzimin e çdo tip traktori në disa SMT del se nga 136 traktorë S-80-100, ngarkesën nuk e kanë realizuar 58 prej tyre; nga 780 traktorë Dt-54 nuk e realizuan ngarkesën 275 prej tyre dhe nga 207 BTZ nuk e realizuan 84 prej tyre etj. Për punë të dobët në manevrimin dhe shfrytëzimin e traktorëve në gjashtëmujorin e parë të këtij viti, në SMT-në e Peshkopisë nga 36 traktorë vetëm 14 e realizuan planin, ndërsa 4 nuk janë vënë fare në punë. Raste të një shfrytëzimi joracional të të gjithë traktorëve ka edhe në SMT-të e përparuara. Kështu p.sh. SMT-ja e Fierit ka realizuar planin e vitit 1961 sipas zërave, por nga 4 traktorë S-80-100 dy nuk e kanë realizuar ngarkesën, nga 51 traktorë Dt-54 nuk e kanë realizuar 10 etj. Ka SMT e NBSH që disa traktorë e maqineri nuk i vënë fare në shfrytëzim. Kështu SMT-ja e Elbasanit nuk ka vënë në shfrytëzim 5 traktorë, e Shijakut — 14, e Korçës — 13, e Shkodrës — 10, e Gjirokastrës — 4 traktorë etj. Keq me vënjen në përdorim të maqinerive të ardhura nga importi janë edhe NBSH-të, në të cilat vjet nuk punuan fare 8 për qind e traktorëve dhe 39 për qind e tyre nuk realizuan ngarkesën e caktuar etj.

Nga shembujt e mësipërm del qartë se në shfrytëzimin e mekanikës bujqësore kemi rezerva të mëdha që akoma nuk po vihen në shërbim të bujqësisë. Është koha që organet shtetërore dhe ato të Partisë të preokupohen më seriozisht për shfrytëzimin e plotë të maqinerive bujqësore. Duhet të hiqet dorë nga ndjekja e realizimit të planit në përgjithësi. Plani të quhet i realizuar kur janë kryer të gjitha proceset e punës në bujqësi dhe kur çdo traktor ka realizuar planin duke punuar në bujqësi dhe jo në punë të tjera.

Një problem tjetër i madh, që është njëkohësisht edhe një rezervë e madhe për kryerjen shpejt të punimeve në bujqësi e në blegtori, është sigurimi i një numri të mjaftueshëm të krerëve të

kafshëve të punës. Kësaj pasurie të madhe vjetët e fundit nuk i është kushtuar dhe nuk po i kushtohet kujdes i duhur. Janë bërë skartime të shumta si në qetë e punës të moshës së kaluar, ashtu edhe të atyre 1—3 vjeç dhe nuk janë marrë masa për rritjen e mirë të viçave meshkuj. Të gjitha këto kanë shkaktuar një rënje të madhe në kafshët e punës.

Pakësimi i pendëve të qeve ka vështirësuar punën në shumë rrethe, sidomos në zonat kodrinore e malore për punimin dhe mbjelljen dhe në zonat fushore për transportimin e prodhimeve të barit, kashtës dhe të ushqimeve të tjera për blegtorinë, për transportin e plehut në ara, për punimin e mezhdave, anët e ngastrave etj. Për zgjidhjen e këtij problemi të madh duhet të preokupohen seriozisht Ministria e Bujqësisë, organet e pushtetit e të Partisë në rrethe dhe vetë ekonomitë bujqësore. Brenda 3—4 vjetëve të ardhshëm, kryesisht nga riprodhimi i brendshëm, çdo ekonomi bujqësore duhet të plotësojë medoemos nevojat për qe pune. Ndërmarrjet bujqësore shtetërore të marrin masa për rritjen e mirë të viçave meshkuj dhe këta t'u shiten ekonomive bujqësore për punë.

Një rezervë tjetër e rëndësishme dhe që lot rol të madh në punët e bujqësisë, për rritjen e rendimentit në punë është edhe prodhimi me cilësi sa më të mirë i veglave të punës, i maqinave të thjeshta bujqësore si dhe mirëmbajtja e meremetimi i tyre në kohë e me cilësi të mirë. Ka ardhur koha që për prodhimin e veglave dhe të maqinive bujqësore të bëhet një punë më e përgjendruar. Bashkimi qendror i kooperativave të artizanatit duhet të marrë masa për të organizuar reparte të posaçme për prodhimin e veglave bujqësore standard sipas nevojave të bujqësisë dhe t'i jepet fund praktikës që përdoret sot duke prodhuar vegla bujqësore me cilësi të dobët dhe jo sipas nevojave të bujqësisë. Ka ardhur koha që çdo kooperativë bujqësore dhe çdo ndërmarrje bujqësore shtetërore të organizojë vetë punishte të posaçme për riparimin e veglave bujqësore për t'i pasur kurdoherë në gatishmëri të mirë. Ministria e Bujqësisë, Bashkimi qendror i kooperativave të artizanatit dhe Komisioni i Planit të Shtetit ta marrin në studim këtë çështje, të caktojnë standardet dhe masat që duhen marrë për prodhimin e veglave bujqësore në të ardhshmen.

4. — Shfrytëzimi i drejtë dhe në mënyrë racionale i fondit të tokës përbën një nga rezervat më të mëdha të bujqësisë sonë.

Ka shumë shfaqje që tregojnë se toka nuk shfrytëzohet si duhet. Shumë lehtë vendoset që toka shumë të vlefshme për bukë të hiqen nga fondi i tokës bujqësore dhe të përdoren për qëllime të tjera, ashtu sikurse ndodh që ekonomi kooperativiste dhe ndër-

marrje shtetërore tokat e vlefshme për bukë i përdorin për të mbjellë kultura shumëvjeçare, në një kohë kur në vendin tonë ka me dhjetëra mijë ha. toka kodrinore të pashfrytëzuara, të cilat janë shumë të përshtatshme për kulturat frutore dhe për ullinj, vreshta etj. Tregohet pak vëmendje nga organet dhe nga punonjësit e bujqësisë që një tokë prodhimtare me kushte të mira, të mos shfrytëzohet si duhet për të marrë prej saj 2—3 prodhime në vit, ose të shfrytëzohet me shumë kultura njëherësh. Nuk luftohet sa duhet që të merren sa më shumë prodhime dhe të ardhura nga e njëjta sipërfaqe e mbjellë. Këto çështje përbëjnë një rezervë shumë të madhe në bujqësi. Prandaj, organizatat e Partisë dhe organet e pushtetit duhet të tregojnë vëmendje të madhe.

a) Të ndalohet rreptësisht përdorimi i panevojshëm i tokës bujqësore për qëllime të tjera. Që nga çlirimi dhe deri në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 1962 janë përdorur për qëllime jobujqësore, si për rrugë, kanale, ndërtime të ndryshme për banesa, shkolla, objekte industriale etj., jo më pak se 10 për qind e të gjithë sipërfaqes së tokave të reja që janë hapur gjatë 18 vjetëve të pushtetit popullor.

Me gjithë porosinë e vazhdueshme të Partisë dhe të qeverisë, megjithëse për këtë qëllim Presidiumi i Kuvendit Popullor nxori dekretin «Mbi kursimin e fondit të tokës në ndërtim dhe vepra të tjera»¹, janë vërtetuar shpërdorime të theksuara të fondit të tokës duke bërë ndërtime të çdo natyre, rrugë, fusha sportive etj., në toka pjellore shumë të vlefshme për bujqësinë. Këto janë bërë edhe kur kishte mundësi që të përdroreshin për këtë qëllim toka jobujqësore ose toka me prodhimtari të ulët. Këtu nuk është fjala vetëm për objektet me rëndësi nacionale, por sidomos për ndërtimet e shumta që bëhen nga rrethet, ndërmarrjet, kooperativat dhe nga vetë fshatarësia. Për shembull, në kooperativën bujqësore të Sukthit në rrethin e Durrësit, nga komiteti ekzekutiv i këshillit popullor të rrethit ishte aprovuar për troje një sipërfaqe prej 92 hektarë tokë e klasit të parë, nga 24 hektarë që ishte nevoja. Një sipërfaqe e tillë do të mjaftonte për ndërtimin e një qyteti të ri, si ai i Kukësit që është sot. Ka raste kur fillohen ndërtime pa leje, siç ka vepruar Ndërmarrja e transportit në Patos e cila, jashtë zonës së caktuar për ndërtime, në toka buke kishte filluar ndërtimin e një rezervuari për larjen e automjeteve. Është lejuar shpërdorimi i fondit të tokës pjellore në periferi të shumë qyteve, si p.sh. në Fier, Durrës, Lushnjë, në Tiranë etj., për ndërtime banesash të pastudjuara dhe që nuk kanë të bëjnë aspak me planin rregullues të qytetit. Janë përdorur sipërfaqe të mëdha tokash në ndërmarrjet bujqësore shtetërore për ndërtimin e sektoreve dhe të objekteve të tjera të pastudjuara mirë. Çdo vit si pa

¹ Është fjala për dekretin e Presidiumit të Kuvendit Popullor Nr. 3303, datë 24 korrik 1961.

gjë të keq po prishen tokat, për ndërtime, nga kooperativat bujqësore dhe nga entet shtetërore, pa menduar dëmin e madh që i bëhet ekonomisë, duke u udhëhequr nga interesat e ngushta ose nga dëshirat. Në shumicën e fshatrave vazhdojnë të bëhen ndërtime ekonomike dhe banesa pa kritere të drejta e të shpërndara. Komitetet ekzekutive të këshillave popullore dhe vetë Ministria e Bujqësisë po e zvarrisin shumë caktimin definitiv të zonave për ndërtimin e fshatrave në bazë të direktivave të dhëna nga Komiteti Qendror dhe nga qeveria.

Një dëm të madh ka shkaktuar dhe shkakton çdo ditë vendosja e shtyllave të shumta telefonike dhe e shtyllave elektrike të tensionit të lartë, pa asnjë kriter dhe pa llogaritur interesat e prodhimit bujqësor, pa autorizimin përkatës si përcaktojnë dispozitat e qeverisë në lidhje me ndërtimin e vijave telefonike dhe ato të tensionit të lartë. Veçanërisht pa përgjegjësi ka qenë puna e disa ndërmarrjeve gjeologjike, të cilat në sipërfaqet ku kanë bërë kërkime i kanë kthyer dhe po i kthejnë tokat pjellore në lëndina, në rrugë etj., duke i lënë materialet andej-këtej pa kriter ose duke bërë instalime e duke krijuar kantiere pa autorizim nga organet përkatëse, pa menduar aspak për të kursyer sa më shumë tokë, kështu po i sjellin dëme bujqësisë. Kësaj praktike duhet t'i jepet fund sa më parë. Ministria e Bujqësisë, komitetet e Partisë dhe komitetet ekzekutive të këshillave popullore të rretheve nuk duhet të bëjnë asnjë lëshim në zbatimin e dekretit dhe të të gjitha udhëzimeve të qeverisë për këtë çështje. *Çdo përjashtim e çdo pakësim i fondit të tokës për qëllime jobujqësore, pasi të jetë studjuar me kujdes, do të bëhet vetëm me autorizim ose me vendim të Këshillit të Ministrave.* Në asnjë mënyrë nuk duhet të preket toka e kooperativave bujqësore, as nga vetë kooperativistët dhe as nga ndonjë organ shtetëror, për çdo arësye qoftë, pa kryer më parë veprimet e rregullta sipas ligjeve në fuqi mbi të drejtën e pronësisë. Komitetet ekzekutive të këshillave popullore dhe çdo ent tjetër shtetëror apo kooperativist, ndalohen kategorikisht të prekin tokat bujqësore të kooperativave, pa e shtruar çështjen në kooperativë për të marrë mendimin e saj dhe *pa marrë më parë aprovimin e Këshillit të Ministrave.*

b) *Ta shfrytëzojmë plotësisht tokën.* Në një kohë kur po bëhet një punë e madhe dhe me kosto të lartë për të shtuar sado pak sipërfaqen e punueshme të tokës, shpeshherë me pjellori të ulët, në disa rrethe, në ndërmarrje e në kooperativa bujqësore ka toka që lihen pa u mbjellë ose që nuk shfrytëzohen plotësisht. Kështu, për shembull, rrethi i Tiranës, gjatë vitit bujqësor 1960—1961, nuk mbolli fare 1 221 hektarë tokë ose 7 për qind të të gjithë tokës arë, rrethi i Krujës 3.038 hektarë ose 18 për qind, rrethi i Korçës 1 306 hektarë ose 3 për qind, rrethi i Fierit nuk mbolli fare 2 693

hektarë ose 6 për qind etj., pa përmendur faktin që në shumë rrethe ka ndërmarrje dhe kooperativa bujqësore, të cilat nuk punojnë dhe nuk e mbjellin cep më cep ngastrën, lënë rrugë të gjera dhe të panevojshme, gjerde dhe mezhda të paprishura, pemë e drurë në mes të ngastrave, të cilët jo vetëm që zënë sipërfaqe toke, por edhe pengojnë mjetet e mekanizuara etj. Është bërë një zakon i keq që kur pastrohen kanalet, dheu nuk përhapet në ara, por lihet në vend dhe krijohen argjinatura të panevojshme e të dëmshme.

A mund të lejohet kjo pakujdesi në përdorimin e tokës? Jo, në asnjë mënyrë! Tokën ne duhet ta shfrytëzojmë cep më cep për nevoja të bujqësisë, për prodhime bujqësore. Asnjë pëllëmbë tokë të mos lihet pa u punuar dhe pa u mbjellë. Partia në fshat dhe organet e bujqësisë duhet ta ngrenë me të madhe paraqonjesve të bujqësisë çështjen e shfrytëzimit me kujdes të tokave dhe t'u jepet fund dobësive që janë vërtetuar deri tani.

c) *T'i marrim tokës më shumë se një prodhim gjatë një viti.* Marrja e dy dhe e tre prodhimeve në vit nga e njëjta sipërfaqe toke është një tjetër detyrë e rëndësishme që shtroi Kongresi IV i Partisë për shtimin e prodhimeve bujqësore e blegtorale. Në të gjitha zonat bujqësore të ulëta e të ngrohta të vendit tonë kushtet e klimës lejojnë për të marrë më shumë se një prodhim në vit. Në zonën bregdetare ka gati kudo mundësi të mëdha për mbjelljen e hasëlleve të vjeshtës, ndërsa në zonën e ftohtë malore duhet të përhapet gjerësisht eksperiencia e NBSH-së së Maliqit dhe e disa kooperativave të rrethit të Korçës, të cilat për hasëlle të hershme në pranverë përdorin thekrën.

Zgjedhja e tokave për mbjelljen e hasëlleve kërkon kujdes të madh. *Hasëllet në asnjë mënyrë nuk duhet të bëhen shkak të prishet renditja e kulturave bujqësore.* Zakonisht çdo vit prej kohës së korrjes të të lashtave (qershor-korrik) dhe deri në mbjelljen, në këto toka të kulturave pranverore (në mars-prill të vitit të ardhshëm), qëndrojnë pa u kultivuar, pa u shfrytëzuar afro 150 000 ha. tokë pa bërë fjalë për afro 19 000 ha. tokë që është e mbjellë me ullinj. Gjithë kjo tokë që rezervohet për kulturat pranverore po të shihet me atë sy që thotë Partia, t'i marrim tokës dy dhe më shumë prodhime brenda 1 viti, ka mundësi që një pjesë e mirë e saj të përdoret për hasëlle. Sikur vetëm 1/4 e sipërfaqes që rezervohet për t'u mbjellë me misër në pranverë të punohet në shtator të vitit të mëparshëm dhe të mbillet me hasëlle do të mbilleshin jo më park se 40 000 ha. hasëlle; me këto hasëlle mund të ushqehen gjatë dimrit 30 për qind e dhenve të Republikës. Kurse në fakt vitin e kaluar, megjithëse u mbollën hasëlle më shumë se çdo vit tjetër, përsëri u mbollën vetëm 18 805 hektarë ose 50 për qind kundrejt planit. Ndërsa disa rrethe, jo vetëm janë larg shfrytëzimit të mundësive që kanë, por kanë realizuar planin nën mesataren e Republikës. Një ndër shkaqet e kësaj gjendjeje është edhe

mungesa e farës, por fara nuk ka si të sigurohet në qoftë se për këtë çështje nuk do të mendohet dhe luftohet nga çdo ekonomi, nga të gjitha rrethet dhe nga organet shtetërore të bujqësisë.

Në lidhje me mbjelljen e hasëlleve, një kujdes më i madh duhet të tregohet për mbjelljen e tyre duar-duar dhe të veprohet sikurse kanë filluar të veprojnë mjaft ekonomi shtetërore dhe kooperativiste në rrethin e Lushnjës, të Fierit etj., që dorën e parë të hasëllit e mbollën qysh në muajin korrik-gusht, ndërsa më vonë bënë mbjelljen e farës së tërshërës ose të thekrës të përzier me buxhak, me koçkulla, me bizele foragjere etj.

Krahas mbjelljes së hasëlleve, një vëmendje më e madhe duhet t'i kushtohet mbjelljes së misrit hamullor, si për kokërr, ashtu edhe për masë të gjelbër për blegtori. Mjaft ekonomi i kanë shfrytëzuar mirë mundësitë që kanë pasur për marrjen e prodhimeve nga misri hamullor. Por në shumë raste mbjelljen e misrit hamullor disa e bëjnë jo për të marrë prodhimin, por për të thënë se u realizua plani. Një punë e tillë është e dëmshme dhe nuk justifikon as mundin as shpenzimet. Në vitin 1961 p.sh. kushtet atmosferike ishin shumë të favorshme për mbjelljen e misrit hamullor dhe në fakt në këtë vit është mbjellë më tepër se çdo vit tjetër. Mirëpo, nga 52 554 hektarë të mbjellë me misër hamullor u volën vetëm 37 039 hektarë. Nga sipërfaqja e vjelë, në fakt u muar një rendiment shumë i ulët, p.sh. nga misri për kokërr 5.4 kv/ha., ndërsa nga misri për silazh vetëm 67 kv/ha. E keqja është se në 15 515 hektarë ose në 29,5 për qind të sipërfaqes së mbjellë me misër hamullor, nuk u muar asnjë lloj prodhimi. Kështu ka ndodhur në shumë rrethe dhe në kooperativa si p.sh. në Fier, në Durrës etj. Në këtë mënyrë shpenzohen shuma të mëdha të hollash, karburant e materiale konsumi dhe kooperativat janë të detyruara t'i paguajnë SMT-të për punën e bërë. Një punë e tillë nuk ka ç'na duhet. Partia ka thënë të mbjellim hamullore për shtimin e prodhimit bujqësor e jo për të bërë shpenzime të kota. Prandaj, çështja e misrit hamullor duhet kuptuar drejt: *të mbillen me misër hamullor vetëm ato toka që japin prodhim dhe kur mbjellja e hamullore me misër nuk pengon mbjelljet e vjeshtës.* Gjithashtu pasi nga arat janë vjelë kulturat kryesore të mbillen ato kultura të dyta që janë më të përshtatshme për ta shfrytëzuar tokën gjatë kohës që është në pushim.

Duhet luftuar me këmbëngulje që të shtohen sa më shumë sipërfaqet e mbjelljeve të dyta në hamullore dhe të arrihet patjetër që të merret prodhimi i planifikuar nga çdo hektar tokë e mbjellë me hamullore. Mjaft kooperativa dhe ndërmarrje bujqësore të rrethit të Durrësit, Elbasanit, Shkodrës, Krujës, Lushnjës etj., kanë marrë rendimente të mira nga misri hamullor. Eksperienca e tyre ka treguar se kushti i parë për të siguruar prodhimin e planifikuar nga misri hamullor është ujitja. *Misri hamullor duhet të*

mbillet kryesisht në tokat nën ujë, ndërsa në tokat mbi ujë të mbillet vetëm kur ato kanë vlagë të mjaftueshme dhe garantojnë mbirjen dhe rritjen e tij pak a shumë normale, ndryshe këto toka të shfrytëzohen me kultura të tjera të dyta. Por si u tha më lart mbjellja e misrit hamullor të mos pengojë në asnjë mënyrë mbjelljet e vjeshtës dhe të mos mbillen tokat e infektuara me gram ose tallë të cilat duhet të plugohen thellë menjëherë pas korrijës së të lashtave me qëllim që të digjen gjatë verës dhe të zhduken barërat e këqia. Kur tokat e caktuara për t'u mbjellë me misër hamullor janë parashikuar të mbillen me të lashta, atëhere fara e misrit hamullor duhet të ketë cikël të shkurtër që të piqet e të korret shpejt dhe të lirohen me kohë tokat për të lashta.

Megjithëse hasëllat dhe misri hamullor përbëjnë bazën kryesore të marrjes së dy prodhimeve nga e njëjta tokë, ndërmarrjet shtetërore dhe kooperativat bujqësore sipas kushteve konkrete duhet të shfrytëzojnë për këtë qëllim të gjitha mundësitë, të gjitha mënyrat dhe kombinimet, siç është mbjellja e fasules me cikël të shkurtër për dy herë me radhë ose e fasules dhe e bostaneve në shoqërim me misrin, mbjellja e perimeve 2—3 herë gjatë vitit, mbjellja e foragjereve të gjelbëra njëra pas tjetrës 2—3 herë me radhë. Në tokat e ujitshme mbjellja e orizit hamullor me fidane është e këshillueshme të praktikohet sidomos në Shkodër, Sarandë, Krujë dhe në Durrës, ku janë mundësitë të merren rendimente të larta.

Natyrisht, mbjellja e dy dhe e tri kulturave bujqësore gjatë një viti në të njëjtën tokë varfëron pjellorinë dhe dëmton strukturën e saj, në qoftë se nuk shoqërohet me plehërim, me punimet e thella, me shërbime të veçanta dhe në radhë të parë me plehërimin organik. Prandaj, ndërmarrjet shtetërore dhe kooperativat bujqësore të marrin masa që, në luftën për t'i marrë tokës më shumë se një prodhim gjatë një viti, të zgjedhin njëkohësisht në kompleks të gjithë faktorët që kondicionojnë suksesin e kësaj pune.

Një tjetër mundësi për të marrë dy dhe më shumë prodhime nga e njëjta sipërfaqe toke jep edhe mbjellja e kulturave të dyta në pemëtoret. Rezultate veçanërisht të mira janë arritur nga mbjellja e perimeve në pemëtore. Tani që jemi në periudhën e shtimit të vrullshëm të fruti-vitikulturës, kudo që ka pemëtore, ullinj, agrume, vreshta të reja etj., duhet të bëhet rregull që tokat e zëna me pemë frutore e ullinj të punohen dhe të mbillen me kultura të arave. Derisa pemët janë akoma të reja, kur kurorat i kanë të vogla, në mes tyre mund të mbillen patate, panxhar, perime e bimë leguminoze, ndërsa në vreshtat dhe në ullishtet të mbillen ato kultura që jo vetëm nuk dëmtojnë, por përkundrazi e ndihmojnë zhvillimin dhe prodhimin e vreshtave e të ullirit, siç janë qiqrat, qepët, hudhrat ose leguminoze për përmbysje si ba-

tha etj. Në vitin 1962 Ndërmarrja bujqësore shtetërore e Vorës, me gjithë thatësirën e madhe mori 8 kv/ha. qiçra të mbjella në vreshtë me një sipërfaqe prej 63 hektarësh. Shembuj për shoqërimin e kulturave drusore me kultura të arave ka plot në ndërmarrjet shtetërore dhe në kooperativat bujqësore. Veç shoqërimin të pemëve frutore dhe të vreshtave me bimë të arave janë mundësitë që, sidomos ullishtat, të mbillen me agrume (atje ku bëhen agrume, nespulla, fiq, shegë, bajame etj.), sikurse kanë vepruar mjaft kooperativa të zonës së Himarës, ndërmarrjet bujqësore shtetërore të Vlorës, Beratit, Shkodrës etj. Kjo praktikë duhet përhapur kudo dhe në sipërfaqe të gjera. Për këtë komitetet e Partisë, komitetet ekzekutive dhe organizatat bazë të Partisë të luftojnë më shumë për t'i marrë tokës më shumë se një prodhim në vit kudo që këtë e favorizojnë kushtet.

Këto janë, shokë, disa nga aspektet kryesore që tregojnë se në bujqësi ka rezerva të mëdha në çdo drejtim. Sa më mirë të organizohet puna për shfrytëzimin e këtyre rezervave, sa më shumë që ta kuptojnë punonjësit e bujqësisë rëndësinë e madhe që kanë këto rezerva për shtimin e prodhimeve bujqësore e blegtorale, për zhvillimin e shpejtë të bujqësisë dhe të luftojnë për t'i shfrytëzuar këto, atëherë më tepër mundësi krijohen për të realizuar me sukses detyrat që shtroi Kongresi IV i Partisë, atëherë më shpejt mund të ecet drejt një bujqësie të përparuar dhe intensive.

* * *

Sikurse shihet, problemi i intensifikimit të bujqësisë është një problem i madh dhe i ndërlikuar. Prandaj, zhvillimi i çdo dege të ekonomisë bujqësore duhet parë jo i shkëputur, por i lidhur ngushtë dhe i harmonizuar me njëri-tjetrin. me qëllim që të bëhet një zhvillim i gjithanshëm i bujqësisë dhe të arrihet në një rritje me ritme më të shpejta të prodhimeve bujqësore e blegtorale. *Puna për intensifikimin duhet të shërbejë, në radhë të parë, për të realizuar me sukses planin e tretë pesëvjeçar të bujqësisë.* Arritja e nivelit të prodhimeve bujqësore e blegtorale që parashikon plani i tretë pesëvjeçar për vitin 1965 dhe mesatarisht gjatë gjithë pesëvjeçarit të jetë një bazë shumë e rëndësishme për një rritje më të shpejtë të prodhimit bujqësor në të ardhshmen.

Siç dihet, nevojat e vendit tonë për prodhime bujqësore e blegtorale janë shumë të mëdha. Ne, edhe me nivelin e sotëm të jetesës jemi të detyruar të sigurojmë nga importi me shumë vështirësi një pjesë të prodhimeve kryesore ushqimore, sidomos drithëra buke, oriz, yndyrna, sheqer etj. Në të ardhshmen, këto nevoja do të rriten në mënyrë të vazhdueshme, për arsye të shtimit të numrit të popullsisë dhe të rritjes së nivelit të jetesës, për arsye të

zgjërimit të industrisë sonë ushqimore e të veshmbathjes dhe të nevojës së domosdoshme për të shtuar eksportin e disa prodhimeve bujqësore dhe blegtorale. Po si do të përballohen? Rruga e importit nuk është rruga e zgjidhjes së këtij problemi kaq të rëndësishëm. Ne duhet të marrim të gjitha masat që këto nevoja t'i zgjidhim në vend, duke zhvilluar bujqësinë me ritme të shpejta, duke e bërë bujqësinë tonë gjithnjë më intensive.

Me investimet e mëdha që janë bërë deri tani për bujqësinë dhe me ato që parashikohet të bëhen sipas planit të tretë pesëvjeçar, janë krijuar dhe do të krijohen kushtet e nevojshme materiale për një rritje të ndieshme të prodhimeve. Por këto kushte materiale sidomos në ato rrethe dhe ndërmarrje bujqësore, ku shteti ka bërë investime më të mëdha, duhet të shfrytëzohen me kujdes dhe nikoqirllëk të madh. Duhet të realizojmë dhe të tejkalojmë me çdo mënyrë, për shembull, ata tregues mbi të cilët kemi llogaritur leverdishmërinë e kryerjes së veprave të mëdha të bonifikimeve dhe të ujitjes. Kështu duhet ta kuptojnë detyrën të gjitha ato rrethe ku shteti ka bërë investime kolosale për ndërtimin e objekteve të mëdha bujqësore.

Ne mendojmë se krahas me punën që bëhet për të realizuar me sukses detyrat e pesëvjeçarit të tretë, duhen caktuar disa pikësynime sipas zonave, rretheve dhe në shkallë Republike, se ku duhet të arrijë niveli i prodhimeve kryesore bujqësore për të ardhshmen.

Objektivi ku duhet të arrijmë në të ardhshmen me intensifikimin e bujqësisë është rritja e rendimenteve mesatare si Republikë: për grurin mbi 25 kv/ha., për misrin mbi 27 kv/ha., për orizin mbi 35 kv/ha., për panxhar sheqerin mbi 200 kv/ha., për pambukun 20 kv/ha., për perimet mbi 200 kv/ha., dhe për patatet 150 kv/ha., ndërsa mesatarisht të merren nga çdo lopë 2 000 litra qumësht, dhe për 100 ha. tokë nën kulturë (duke përfshirë livadhet, kullotat e mushat) të merren 400—480 kv. qumësht dhe 75—90 kv. mish peshë e gjallë.

Në rrethet dhe në zonat më të rëndësishme bujqësore të vendit sikurse janë ato të Korçës, Fierit, Lushnjës dhe Durrësit, ku shteti ka bërë investime më të mëdha në bujqësi, objektivi ku duhet të synojmë në të ardhshmen për shtimin e prodhimeve bujqësore dhe blegtorale duhet të jetë: për grurin 26 kv/ha., për misrin 26 kv/ha., për pambukun 20 kv/ha., për panxhar sheqerin 260 kv/ha., për qumështin 2 000—2 200 litra mesatarisht nga çdo krerë lopë, mish për çdo dosë 600—650 kg. dhe lesh nga çdo dele mesatarisht 3—3,5 kg. Për çdo 100 ha. tokë bujqësore (duke përfshirë përveç tokës arë, livadhet, kullotat dhe mushat) të luftohet për të marrë 400—480 kv. qumësht, 80—90 kv. mish peshë e gjallë dhe 4—4,5 kv. lesh.

Rrethet Shkodër, Lezhë, Krujë, Elbasan, Vlorë, Berat dhe Sarandë duhet të kenë si objektiv që në të ardhshmen të realizojnë mesatarisht për çdo hektar të mbjellë: grurë 22 kv/ha., misër 23 kv/ha., oriz 35 kv/ha., pambuk 19-20 kv/ha., qumësht 2 000 litra mesatarisht nga çdo lopë, mish peshë e gjallë 650 kg. mesatarisht nga çdo dosë dhe lesh mesatarisht 3—3,5 nga çdo dele dhe për çdo 100 ha. tokë arë dhe kullotë së bashku 350—360 kv. qumësht, 80—85 kv. mish peshë e gjallë dhe 4—4,5 kv. lesh.

Sektori shtetëror duhet të ketë si objektiv në të ardhshmen që të arrijë mesatarisht këta tregues kryesorë: në prodhimin e drithërave gjithsejt — jo më pak se 2 000 kv. për 100 hektarë tokë arë. Rendimentet për grurin dhe për misrin t'i rritë në jo më pak se 30 kv/ha., pambukun mbi 20—22 kv/ha., panxhar sheqerin 380 kv/ha., qumështin 3 300 litra mesatarisht nga çdo lopë, mish peshë e gjallë 9 kv. nga çdo dosë dhe lesh 4 kg. nga çdo dele etj.

Rrethet e tjera, duke u bazuar në orientimet që caktohen për rrethet e mësipërme dhe në bazë të kushteve që ka çdo rreth, çdo ekonomi për rritjen e kulturave bujqësore dhe të blegtorisë, duhet të përcaktojnë vetë objektivat ku duhet të arrijnë në të ardhshmen për rritjen e rendimenteve të kulturave bujqësore dhe të prodhimeve blegtorale për çdo 100 ha. tokë. Duke caktuar këto objektiva, çdo rreth dhe çdo ekonomi do ta kenë më të qartë punën e madhe që kanë për të bërë jo vetëm për realizimin e planit të tretë pesëvjeçar, por edhe për të hedhur baza të tilla që në të ardhshmen të shpejtohet ritmi i shtimit të prodhimit bujqësor. Nga të dhënat që u paraqitën në kapitullin ku u analizuan problemet e zbatimit të masave agroteknike doli se që tani ka shumë ndër-marrje shtetërore dhe kooperativa bujqësore, të cilat kanë arritur rendimente shumë më të larta se rendimentet mesatare që u përmendën më sipër si për kulturat e arave ashtu dhe në blegtori. Kjo do të thotë se mundësitë për shtimin e prodhimit bujqësor janë, por që këto mundësi të shfrytëzohen duhet që çdo ekonomi, çdo rreth të luftojë që të gjitha ekonomitë bujqësore të ngrihen në nivelin e ekonomive më të përparuara. Nga ana tjetër ekonomitë e përparuara që kanë arritur të prodhojnë qysh sot mbi objektivat që i caktohen rrethit, duke u nisur nga përfundimet e arritura dhe në bazë të ritmeve që u caktuan më lart si mesatare, të shtrojnë detyra të tjera më të mëdha që duhet t'i plotësojnë në të ardhshmen.

Është e nevojshme që ta kuptojmë mirë të gjithë se rritja e prodhimeve bujqësore dhe blegtorale dhe sidomos e drithërave të bukës në kushtet e sotme përbën detyrën kryesore ekonomike për gjithë vendin. Dihet se duke realizuar plotësisht detyrat e pesëvjeçarit të tretë në bujqësi, në fund të vitit 1965 do të prodhojmë mesatarisht për çdo frymë të popullsisë si Republikë: drithëra buke 227 kg., pambuk 15,5 kg., perime e patate 110 kg;

mish peshë e gjallë 35 kg., qumësht 170 litra, rrush 40 kg., ullinj 10,6 kg. dhe fruta 43 kg. Këta tregues, megjithëse kanë një rritje të ndieshme në krahasim me realizimet mesatare të vjetëve 1956-1960, nuk janë të mjaftueshëm për të plotësuar si duhet nevojat e popullsisë dhe të ekonomisë popullore për prodhime bujqësore dhe blegtorale, prandaj shtrohet si detyrë që në perspektivë të synohet për shtimin e prodhimeve bujqësore dhe blegtorale në një masë të tillë që të arrijmë të prodhojmë për frymë të popullsisë 350—400 kg. drithëra, 18—20 kg. pambuk, 140—160 kg. perime e patate, 25—30 kg. ullinj, 70—80 kg. rrush, 100—110 kg. fruta, 40—45 kg. mish peshë e gjallë dhe qumësht 200—220 litra për frymë etj.

Shtimi i prodhimit bujqësor ka rëndësi vendimtare për të ardhshmen e ekonomisë popullore. Çdo mosrealizim i detyrave në bujqësi ka pasoja në jetën e popullit dhe në gjithë ekonominë, prandaj është e domosdoshme të merren seriozisht masa që të zbatohen në kohë dhe mirë të gjitha detyrat që shtrohen për intensifikimin e bujqësisë. Lufta për rritjen e rendimenteve të kulturave bujqësore dhe të blegtorisë, për shtimin e prodhimit bujqësor në përgjithësi, duhet të bëhet e vazhdueshme e organizuar në të gjitha degët e bujqësisë, nga të gjithë punonjësit e bujqësisë dhe nga organizatat e Partisë për të shfrytëzuar të gjitha rezervat në bujqësi. Detyrat e mëdha që shtrohen para bujqësisë sonë, nga ana tjetër, duhet të tërheqin vëmendjen e të gjitha organeve shtetërore që kanë detyra në drejtim të bujqësisë për të marrë masa që t'i plotësojnë me kujdesin më të madh duke i ardhur në ndihmë bujqësisë me të gjitha mjetet dhe mundësitë për shtimin e shpejtë të prodhimit bujqësor.

Duke i parë në këtë prizëm nevojat e mëdha që ka vendi ynë sot për prodhime bujqësore dhe që në të ardhshmen këto nevoja do të jenë edhe më të mëdha, del e domosdoshme që t'i vihet një rëndësi e veçantë sidomos intensifikimit të bujqësisë në zonat më pjellore të vendit ku shteti ka bërë investime të mëdha, të përdoren edhe më shumë mjete materiale dhe financiare për shtimin e prodhimeve bujqësore dhe blegtorale. Gjithashtu të shikohen mundësitë që ka ekonomia popullore për të ardhshmen e të bëhen më shumë investime në sektorin e bujqësisë për zhvillimin dhe intensifikimin e saj me ritme më të shpejta.

Shokë,

Zbatimi i detyrave të mëdha që shtrohen para bujqësisë sonë, si për realizimin e planit të tretë pesëvjeçar ashtu edhe për intensifikimin e bujqësisë, kërkon që të ngrihet në një nivel më të lartë drejtimi i ekonomisë bujqësore në përgjithësi dhe në mënyrë të veçantë forcimi ekonomik-organizativ i kooperativave bujqësore. Nga niveli i organizimit dhe i drejtimit të punës në koopera-

tivat bujqësore varet e ardhshmeja e ekonomisë kolektive, realizimi i detyrave që shtroni plani, përmirësimi i gjendjes ekonomike dhe kulture të anëtarëve. Prandaj, sot dhe në të ardhshmen duhet të punohet gjithmonë e më shumë me kujdes të madh e me këmbëngulje për forcimin organizativ dhe ekonomik të kooperativave bujqësore, për ngritjen e kooperativave bujqësore në përgjithësi në nivelin e kooperativave bujqësore më të përparuara.

Kooperativat bujqësore kanë akoma shumë të meta, si në drejtimin ekonomik, ashtu edhe nga ana organizative. Këto të meta mund të bëhen pengesë serioze për realizimin e detyrave të planit dhe mund të sjellin dobësimin e tyre në rast se nuk merren masa për t'i ndrequr ato me kohë. Në këtu nuk do të ndalemi të analizojmë çështjet organizative të kooperativave bujqësore, sepse kjo duhet bërë posaçërisht në çdo rreth e kooperativë. Këtu ne mund të themi se, në lidhje me forcimin organizativ të kooperativave bujqësore, është vendimtar zbatimi i përpiktë i statutit të kooperativave dhe i vendimit Nr. 265 të Këshillit të Ministrave mbi organizimin e punës në kooperativë. Vënja në jetë e këtyre dy dokumentave të rëndësishëm është vendimtare për jetën e kooperativave. Nga ana tjetër Këshilli i Ministrave dhe Ministria e Bujqësisë duhet të japin udhëzime të përpikta mbi zgjidhjen e shumë problemeve organizative dhe ekonomike aktuale që kanë lindur në jetën e kooperativave bujqësore nga vetë zhvillimi i tyre, siç është problemi i normave, i shpërblimeve, i furrave, i pensioneve, i paradhënjeve etj. Gjithashtu, Ministria e Bujqësisë dhe Drejtoria e bujqësisë e Komitetit Qendror të Partisë, të studjojnë mundësitë e shtrirjes së kolektivizimit në forma të thjeshta edhe në zonat malore, ku nuk është bërë kolektivizimi dhe t'i paraqesin Komitetit Qendror të Partisë propozimet përkatëse. Njëkohësisht është e këshillueshme që në ato fshatra ku janë ngritur kooperativat bujqësore dhe ka akoma familje fshatarësh të pa-kooperuar të punohet për t'i bindur këta fshatarë që të futen në kooperativë me vullnetin e tyre të lirë.

Shokë,

Sukseset që janë arritur në bujqësi janë të mëdha. Këto suksese dëshmojnë më së miri për vijën e drejtë marksiste-leniniste të Partisë sonë, për kujdesin që ka treguar Partia dhe pushteti për zhvillimin e bujqësisë, për punën vetëmohuese të njerëzve tanë, për vënjen në jetë me sukses të vijës së Partisë, për transformimin socialist të fshatit dhe për zhvillimin e bujqësisë në rrugën socialiste. Në punë dhe në luftë për kapërcimin e vështirësive dhe të pengesave të shumta u rritën e u kalitën organizatat e Partisë, organet e pushtetit dhe të bujqësisë, kuadrot tanë që punojnë në bujqësi, gjithë punonjësit e bujqësisë dhe të fshatit.

Tashmë njerëzit që punojnë në sektorin e bujqësisë dhe në

fshat kanë fituar dije dhe eksperiencë, ata jo vetëm që kanë pasuruar njohuritë e tyre mbi agrozooteknikën, por njohin më mirë problemet që kanë të bëjnë me organizimin dhe me drejtimin e ekonomisë së madhe bujqësore. Organizatat e Partisë dhe organet e pushtetit në bazë dhe në rrethe e kanë përmirësuar në mënyrë të dukshme metodën e punës. Problemet e bujqësisë dhe të fshatit janë bërë probleme të të gjithë komunistëve, të kuadrove që merren me bujqësi dhe me fshatin, të organeve të pushtetit dhe të Partisë në bazë dhe në rrethe e kjo shihet nga puna e përditshme që ata bëjnë dhe nga rezultatet që kanë arritur në bujqësi. Kjo është një fitore e madhe e Partisë sonë. Por kjo që është bërë deri tani nuk është e mjaftueshme. Tani ne jemi përpara situatave të reja, na dalin detyra të reja më të mëdha dhe më të ndërlikuara që kërkojnë më shumë dije, aftësi organizative dhe drejtuese.

Tani jemi futur në një fazë të re të ndërtimit socialist të vendit, punojmë për transformimin e vendit tonë nga një vend agro-industrial në një vend industrialo-agrar, prandaj kërkohet që bujqësia të zhvillohet me ritme sa më të shpeja. Ritmi vjetor i shtimit të prodhimit bujqësor në këtë pesëvjeçar është më i shpejtë se ritmi i shtimit të prodhimit industrial. Kjo do të thotë se në bujqësi duhet të bëhet një hap më i madh përpara në krahasim me atë që kemi bërë deri tani. Kushtet objektive janë krijuar dhe çdo ditë ato bëhen më të favorshme për të shpejtuar ritmin e zhvillimit të bujqësisë sonë.

Por a mjafton të kemi vetëm kushtet objektive të favorshme për të realizuar detyrat e mëdha që na shtrohen në bujqësi? Jo! Këto kushte nuk japin rezultate vetëvetiu. Për këtë kërkohet punë dhe përpjekje e madhe, kërkohet mobilizimi i të gjitha forcave dhe shfrytëzimi sa më i mirë i të gjitha mundësive dhe mjeteve që kemi në dispozicion, kërkohet organizimi më i mirë dhe drejtimi më i kualifikuar i punëve në bujqësi.

Duhet të përmirësohet metoda e punës dhe e drejtimit si nga ana e organeve të Partisë ashtu edhe nga organet e pushtetit pse ka akoma shumë të meta dhe dobësi. Në radhë të parë duhet të ngrihet në një nivel më të lartë puna politike dhe organizative e Partisë me masat dhe ta lidhim atë më ngushtë me detyrat ekonomike. Me fjalë të tjera duhet të ngrihet puna e Partisë dhe e organeve të pushtetit në të gjitha instancat në nivelin e detyrave të mëdha që ka shtruar Partia para bujqësisë sonë. Këtë punë nuk ka kush ta bëjë përveç organizatave të Partisë. Partia ka forca të mjaftueshme që merren me bujqësinë. Atje punojnë rreth 18 000 komunistë, atje është forca më e madhe e rinisë së organizuar që numëron rreth 70 000 anëtarë, atje janë organizatat e tjera të masave, teknikët dhe specialistët e bujqësisë, mekanizatorët dhe drejtuesit e ekonomisë kooperativiste, punonjësit e pararojës të bujqësisë etj., atje Partia ka një aktiv të gjerë, me të cilin duhet të

punojë më mirë për të mobilizuar masat për zgjidhjen e çdo problemi që u shtrohet përpara. Pa vënë në lëvizje në formë të organizuar gjithë këto forca nuk mund të arrihen rezultate.

Detyrat e mëdha që shtrohen në bujqësi kërkojnë rritjen e rolit pararojë të komunistëve në punë, forcimin e jetës së brendshme të organizatave të Partisë, lidhjen e tyre ngushtë me masat, udhëheqjen e vazhdueshme mbi organizatat e masave. Është e domosdoshme të ngrihet roli udhëheqës për zbatimin e vijës së Partisë në organizatat bazë të ndërmarrjeve bujqësore shtetërore dhe në stacionet e mekanikës bujqësore, të cilat, si ndërmarrje socialiste duhet të bëhen shembull përpara ekonomive bujqësore kooperative dhe individuale jo vetëm për organizimin e mirë të punës dhe vënjen në jetë të metodave të përparuara në bujqësi, por edhe për prodhimin e lartë bujqësor.

Duke pasur parasysh rëndësinë e madhe që kanë kooperativat bujqësore për të ardhshmen e bujqësisë sonë dhe dobësitë që shfaqen në shumë raste në kooperativat, forcimi i punës së Partisë në drejtim të kooperativave bujqësore merr rëndësi të veçantë. Duhet të ngrihet niveli i punës së organizatave të Partisë në kooperativat bujqësore. Partia në bazë duhet të ndihmojë dhe të kërkojë që organet e pushtetit sidomos ato të bujqësisë t'i ndihmojnë vazhdimisht nga afër kooperativat bujqësore për çështjet themelore që kanë të bëjnë me forcimin organizativ, me zbatimin e statutit dhe me zhvillimin e degëve të ekonomisë bujqësore kolektive.

Kujdes i veçantë duhet të tregohet nga ana e organizatave të Partisë dhe nga organet shtetërore të bujqësisë për çështjet e kuadrit. Mbi kuadrot qëndron një barrë e madhe, ata duhet të bëhen organizatorët dhe udhëheqësit e vërtetë të prodhimit të madh bujqësor në ekonomitë kolektive, ata duhet ta udhëheqin punën për intensifikimin e bujqësisë. Duhet jo vetëm të punohet shumë për përgatitjen e kuadrit të ri specialist dhe drejtues të prodhimit bujqësor, por edhe të ngrihet më lart niveli politik dhe ideologjik si dhe niveli profesional i kuadrit ekzistues. Këta kuadro duhet të pasurojnë njohuritë e tyre me të reja të shkencës dhe të teknikës bujqësore, të njohin mirë organizimin e ekonomisë bujqësore, çështjet e planifikimit dhe të drejtimit të ekonomisë, të zhvillimit të degëve dhe problemet e intensifikimit të bujqësisë. Për këtë qëllim është e nevojshme të rishikohen puna dhe programet në gjithë sistemin e arësimit bujqësor, sidomos të shihet puna e kursit të lartë dyvjeçar pranë Institutit të lartë shtetëror të bujqësisë dhe shkollës së kooperativave bujqësore në mënyrë që të përgatiten më shumë kuadro drejtues për kooperativat sidomos ekonomistë, planovikë dhe punonjës të llogarisë.

Pa ngritjen e nivelit agrozooteknik të masave punonjëse të bujqësisë nuk mund të zgjidhen me sukses detyrat në bujqësi,

prandaj kurset agrozooteknike pa shkëputje nga puna, ato me korrespondencë si dhe seminarët duhet të organizohen dhe të udhëhiqen me kujdes nga Ministria e Bujqësisë, nga organet e saj dhe nga specialistët e bujqësisë. Organizatat e Partisë me punën edukative që bëjnë me masat duhet t'i nxitin ato që t'i ndjekin rregullisht format e arësimit bujqësor dhe të përfitohet sa më shumë nga këto.

Me qëllim që të ndihmohet bujqësia me kuadro, në këtë fazë të rëndësishme të zhvillimit të saj, është e nevojshme të shihet me shumë kujdes shpërndarja e kuadrit duke i dhënë kurdoherë precedencë prodhimit dhe sidomos në kooperativat bujqësore të cilat e ndajnë shumë nevojën për kuadrin specialist.

Ministria e Bujqësisë duhet ta përmirësojë ndihmën ndaj bazës duke e përqëndruar më tepër kujdesin në çështjet e planifikimit të bujqësisë, të zhvillimit të harmonizuar të degëve të ekonomisë bujqësore, në forcimin ekonomiko-organizativ të kooperativave bujqësore për zbatimin e statutit të kooperativave bujqësore dhe në drejtimin e ekonomisë kooperative. Kujdes të veçantë ajo duhet të tregojë për shfrytëzimin e rezervave të mëdha në bujqësi duke i dhënë ndihmë bazës me ekipe, duke bërë bashkë me to studime të ndryshme që kanë të bëjnë me zhvillimin e bujqësisë dhe me shtimin e prodhimit bujqësor. Të forcojë punën në ekonomitë bujqësore shtetërore dhe në ndërmarrjet e ndryshme që lidhen ngushtë me bujqësinë sidomos në SMT-të, në ndërmarrjet e ujërave pyjore etj. Përgjithësimi i eksperiencës së përparuar dhe përhapja e njohurive të shkencës dhe të teknikës bujqësore në kuadrot dhe në gjithë punonjësit e bujqësisë mbetet kurdoherë një nga detyrat themelore jo vetëm për organizatat e Partisë, por edhe për Ministrinë e Bujqësisë dhe për organet që ajo drejton.

Me qëllim që specialistët e bujqësisë, që punojnë në shkollat bujqësore dhe në punë shkencore ose në punë të tjera të bujqësisë, të lidhen ngushtë me jetën, me praktikën, t'i njohin nga afër problemet e bujqësisë, është e nevojshme që përveç kohës së caktuar për punën praktike të ngarkohen herë pas here me detyra të posaçme në bazë ku të mësojnë, të punojnë dhe të ndihmojnë nga afër bujqësinë. Duhet të përmirësohet akoma puna shkencore në bujqësi. Organet që merren me studime shkencore në bujqësi duhet t'u futen më thellë problemeve, të nxjerrin konkluzione që ndihmojnë praktikisht në zgjidhjen e detyrave që shtrohen përpara bujqësisë sonë. Punonjësit e shkencës duhet të lidhen më ngushtë me jetën duke bashkëpunuar me kuadrin specialist të bujqësisë që është në prodhim dhe me njerëzit e pararojës në bujqësi, të cilët kanë një eksperiencë të pasur dhe të vlefshme edhe për punën shkencore.

Këto janë, shokë, çështjet që Byroja Politike mendoi të shtronte para këtij plenumi. Detyrat që shtrohen në këtë raport

janë plotësisht të realizueshme. S'ka asnjë dyshim se nën udhëheqjen e Komitetit Qendror me në krye shokun Enver, e gjithë Partia jonë, komunistët që punojnë në sektorin e bujqësisë, kuadrot specialistë të bujqësisë, drejtuesit e ekonomisë bujqësore shtetërore dhe kooperativiste, gjithë fshatarësia jonë punonjëse, do të venë të gjitha forcat dhe do të arrijnë suksese në zhvillimin e mëtejshëm të bujqësisë sonë. Realizimi i plotë i këtyre detyrave që shtrohen para bujqësisë sonë do të jetë një tjetër fitore e madhe për Partinë dhe për popullin tonë dhe një grusht tjetër i rëndësishëm për armiqtë tanë, imperialistët dhe revizionistët. Ne jemi të bindur se asnjë blokadë e komplot revizionist i Nikita Hrushovit, asnjë rrethim imperialist ose revizionist nuk do të na ndalë nga rruga jonë e lavdishme dhe ne do të dalim patjetër në breg nga këto dallgë të kohës dhe do të marshojmë përpara si kurdoherë fitimtarë në rrugën e socializmit dhe të komunizmit.

Botohet sipas broshurës: Raport i Byrosë Politike të KQ të PPSH «Mbi masat për zhvillimin e mëtejshëm të bujqësisë, për sigurimin e rritjes së vazhdueshme të prodhimit bujqësor» mbajtur nga shoku Hysni Kapo. Tiranë, 1962

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 260, 31 tetor 1962

V E N D I M

I PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË MBI APROVIMIN E RAPORTIT «Mbi MASAT PËR ZHVILLIMIN E MËTEJSHËM TË BUJQËSISË PËR SIGURIMIN E RRRITJES SË VAZHDUESHME TË PRODHIMIT BUJQËSOR»

28 tetor 1962

Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH në mbledhjen e tij të mbajtur më 26-28 tetor 1962, pasi dëgjoi raportin e Byrosë Politike «Mbi masat për zhvillimin e mëtejshëm të bujqësisë për sigurimin e rritjes së vazhdueshme të prodhimit bujqësor» mbajtur nga shoku Hysni Kapo dhe diskutoi mbi çështjet e rëndësishme që u ngritën në raport,

Vendosi:

Ta aprovojë njëzëri raportin e mësipërm të paraqitur nga Byroja Politike, i cili të vlejë si program pune për marrjen e masave për zhvillimin e mëtejshëm të bujqësisë, për të siguruar rritjen e vazhdueshme të prodhimit bujqësor.

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Botohet sipas broshurës: Raport i Byrosë Politike të KQ të PPSH «Mbi masat për zhvillimin e mëtejshëm të bujqësisë, për sigurimin e rritjes së vazhdueshme të prodhimit bujqësor» mbajtur nga shoku Hysni Kapo. Tiranë, 1962

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 259, 30 tetor 1962